

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPS TE SHQIPERISE
INSTITUTI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

HISTORIA
E
LETËRSISË SHQIPTARE
TË
REALIZMIT SOCIALIST

TIRANË, 1978

.04300081

MAIN

HARTUAR

NGA:

**ABDURRAHIM MYFTIU, DALAN SHAPLLO, DRITA SILIQL,
JORGO BULO, KOÇO BIHIKU, LUAN KOKONA**

KRYEREDAKTOR:

KOÇO BIHIKU

MAKET

Tirazhi: 6000 kopje

Formati: 60 x 88/16

Stash. 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «MIHAL DURI» — Tiranë, 1978

04300084

MAIN

HARTUAR

NGA:

ABDURRAHIM MYFTIU, DALAN SHAPLLO, DRITA SILIQL,
JORGO BULO, KOÇO BIHIKU, LUAN KOKONA

KRYEREDAKTOR:

KOÇO BIHIKU

MAKET

Tirazhi: 6000 kopje

Formati: 60 x 88/16

Stash. 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «MIHAL DURU» — Tiranë, 1978

PG 9606
.2
S6 457
1987
MAIN

PARATHËNIE

«Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist» është përpjekja më e plotë për të ndriçuar në mënyrë sa më tërësore rrugën e zhvillimit të letërsisë së sotme që nga fillimet e saj e deri në ditët tona. Vepra është hartuar nga një grup autorësh të përbërë prej punonjësish shkencorë të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të RPSSH dhe studiuesish të tjerë të letërsisë, bashkëpunëtorë të Institutit.

Procesi dhe dukuritë letrare në këtë vepër janë ndriçuar mbi bazën e dokumenteve të Partisë dhe të veprave të shokut Enver Hoxha.

Nëpërmjet analizës së arritjeve më të shquara të gjinive kryesore, kjo vepër synon të japë rrugën e formimit dhe të zhvillimit të pandërprerë të letërsisë sonë të realizmit socialist në lidhje të ngushtë me luftën për ndërtimin e shoqërisë socialiste, si edhe përpjekjet e shkrimtarëve të sotëm për zgjidhjen e detyrave që u ka vënë përpara shoqëria në etapat e ndryshme të zhvillimit të saj historik. Në vepër është ndriçuar roli udhëheqës i Partisë në zhvillimin dhe në pasurimin e letërsisë shqiptare të realizmit socialist, lufta që ka zhvilluar ajo për një art në shërbim të masave punonjëse, për një art militant, të frymëzuar nga idealet e socializmit dhe të komunizmit.

Autorët janë përpjekur të tregojnë larminë e individualiteteve artistike, që karakterizon letërsinë shqiptare të realizmit socialist; objekt analize janë bërë veprat më të shquara, të cilat kanë sjellë kontribut në zhvillimin e letërsisë sonë, në pasurimin e saj ideor dhe artistik. Duke karakterizuar veprat më të rëndësishme, është pasur parasysh edhe vendi

që kanë zënë e roli që kanë luajtur ato në kohën kur janë botuar.

Objekt i analizës shkencore janë bërë veprat e mirëfillta letrare. Përsa i përket publicistikës, ajo nuk është përfshirë në tekst, janë analizuar vetëm shkrimet publicistike të periudhës së Luftës Nacionalçlirimtare, të cilat mbajtën peshën kryesore në përpjekjet e letërsisë sonë për edukimin dhe mobilizimin e masave për luftë.

«Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist» iu shtrua në vitin 1975 një diskutimi të përgjithshëm, ku morën pjesë arsimtarë, njerëz të kulturës, shkrimtarë, kritikë, pedagogë të letërsisë në shkollat e larta etj. Krahas vlerësimit pozitiv, pjesëmarrësit në diskutim në të njëjtën kohë bënë edhe vërejtje e sugjerime, të cilat ndihmuan në ripunimin e veprës.

Grupi i hartuesve shpreh bindjen se kjo vepër do t'u shërbejë si studentëve të degëve të letërsisë, ashtu edhe masave më të gjera të lexuesve për njohjen sa më të plotë të historisë së letërsisë sonë të realizmit socialist.

HYRJE

Ngadhënjimi i revolucionit popullor dhe çlirimi i Shqipërisë nga pushtuesit e huaj, ashtu si në historinë e gjithë vendit, shënuan një etapë të re edhe në historinë e letërsisë shqiptare. Lëvizja çlirimtare që shpërtheu gjatë viteve të pushtimit fashist, ndryshe nga lëvizjet e mëparshme të popullit shqiptar, solli jo vetëm shpëtimin nga zgjedha e huaj, por edhe një përmbyse të thellë në marrëdhëniet shoqërore e politike që sundonin para Çlirimit në Shqipëri. Si rezultat i kësaj lufte, u shkatërrua sundimi politik i klasave shfrytëzuese, i çifligarëve dhe i borgjezisë së madhe, dhe pushteti kaloi në duart e popullit.

Përmbyseja e klasave të vjetra sunduese hapi rrugën për ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Masat punonjëse me punë dhe me përpjekje heroike brenda një periudhe historike relativisht të shkurtër, në tre dhjetëvjeçarë, arritën t'ia ndryshojnë rrënjësisht fytyrën vendit. Marrëdhëniet e vjetra ekonomike ua zunë vendin marrëdhëniet e reja socialiste. U ngrit industria socialiste dhe u krye kolektivizimi i bujqësisë. Të gjitha këto bënë që të kapërcehet prapambetja shekullore e trashëguar nga e kaluara dhe të sigurohet zhvillimi i lirë dhe i pavarur i vendit në rrugën e socializmit.

Shndërrimi i Shqipërisë në një shtet socialist modern u arrit me luftë dhe me përpjekje të pashembullta; krahas shpartallimit të qëndresës së mbeturinave të klasave shfrytëzuese dhe të orvatjeve të tyre për të kthyer të kaluarën, u desh t'i bëhej ballë veprimtarisë armiqësore të borgjezisë imperialiste dhe të revizionistëve modernë, të cilët nuk lanë dhe nuk po lënë gur pa luajtur që të pengojnë ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Me gjithë vështirësitë e mëdha që hasi, Shqipëria çau përpara, zhvilloi forcat e veta prodhuese, mbrojti lirinë dhe pavarësinë e vet dhe po ecën e sigurt në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Pjesë e pandarë e procesit të përgjithshëm të ngritjes së rendit socialist ishte edhe formimi i një letërsie të re. Kjo detyrë që shtronte historia, përcaktoi gjithë rrugën e zhvillimit të letërsisë shqiptare pas Çlirimit, e cila pasqyroi shndërrimet që u shtollën në jetën e vendit dhe në të njëjtën kohë ndihmoi me mjetet e veta në luftën për ndërtimin e shoqërisë së re.

Nevoja për të pohuar sistemin e ri shoqëror dhe për të shkallmuar mbeturinat e marrëdhënieve të vjetra e të ideologjisë së vjetër përfutuan partishmërinë komuniste si një nga veçoritë kryesore të letërsisë shqiptare të realizmit socialist. Në qoftë se në të kaluarën, në periudhën e paraçlirimit, shkrimtarët ishin në konflikt me shoqërinë çifligaro-borgjeze të kohës, në rendin socialist ku janë përmbysur klasat shfrytëzuese dhe pushtetin e kanë në dorë masat punonjëse, konflikti midis artit dhe shoqërisë është zhdukur. Shkrimtarët e sotëm nuk kanë interesa të tjera për të mbrojtur veç interesave të masave punonjëse; në politikën e shtetit popullor ata shohin realizimin e idealit të tyre: krijimin e një jete të lumtur dhe të lirë për masat e gjera të popullit. Prandaj ata e ndiejnë veten të lidhur ngushtë me luftën për ndërtimin e rendit socialist dhe me punën e tyre krijuese kontribuojnë aktivisht në përmbushjen e kësaj detyrë të madhe historike. Veprat më të mira të Sh. Musarajt, I. Kadaresë, D. Agollit, Ll. Siliqit, F. Gjatës, S. Spasses, Dh. S. Shuteriqit, J. Xoxes, K. Jakovës, T. Laços etj. japin dorë në zgjidhjen e detyrave që shtron ndërtimi socialist, duke brumosur tek njerëzit një ndërgjegje të re ideologjike dhe politike, duke i pajisur ata me mendime dhe ndjenja të reja.

Partishmëria komuniste nuk është një element i jashtëm i veprave letrare artistike që realizohet përmes deklaratave ose skenave që ilustrojnë idetë e autorit; partishmëria shfaqet në brendinë ideore të veprave letrare, në zgjedhjen e karaktereve shoqërore, në procesin e tipizimit të këtyre karaktereve, në interpretimin ideor dhe në vlerësimin e tyre emocional; ajo është e shkrirë në tërë sistemin e figurave të veprës.

Partishmëria komuniste siguron pasqyrimin e thellë dhe

besnik të jetës. Ideologët dhe shkrimtarët borgjezë, në orvatjet e tyre për të diskretituar realizmin socialist, sulmet kryesore i kanë drejtuar dhe i drejtojnë kundër partishmërisë komuniste. Sipas tyre shkrimtarët që mbrojnë interesat e masave punonjëse nuk janë në gjendje të pasqyrojnë me vërtetësi jetën, të japin kuadro tipike të realitetit. Kjo është një nga shpifjet më banale dhe më të ulëta të shërbëtorëve të borgjezisë, të cilën po e përsëritin me zell edhe revizionistët modernë, të fshehur pas frazeologjisë marksiste. Përvoja e artit tonë të realizmit socialist tregon se aspiratat subjektive të krijuesve, që qëndrojnë në pozitë e socializmit, nuk vijnë në kundërshtim me logjikën e jetës. Prirja themelore e zhvillimit historik të vendit është sot lufta e masave punonjëse për ndërtimin e shoqërisë socialiste, prandaj duke pasqyruar përpjekjet e vetëdijshme të masave për ngritjen e socializmit, artistët tregojnë të vërtetën e jetës. Partishmëria i ndihmon artistit të hetojë dhe të pasqyrojë proceset e rëndësishme që zhvillohen në gjirin e shoqërisë socialiste, ta shohë dhe ta interpretojë realitetin në dritën e idealeve të socializmit dhe të komunizmit. Për krijuesit tanë partishmëria është një cilësi organike, në të cilën gjen shprehje kërkesa e tyre e brendshme për t'i shërbyer popullit, Partisë.

Partishmëria komuniste nuk e ndrydh lirinë e punës krijuese dhe as e frenon iniciativën e artistit, prandaj janë fare të pathemelta pohimet e ideologëve të borgjezisë reacionare se partishmëria komuniste bie ndesh gjoja me natyrën e artit. Tashmë është sqaruar se arti gjithnjë ka pasur dhe ka karakter klasor, se ai është i lidhur me forca dhe lëvizje të caktuara shoqërore. Përvoja e historisë së letërsisë botërore nuk njih asnjë rast që artisti të ketë qëndruar jashtë luftës shoqërore. Çështja është se cilës force dhe cilës ide shoqërore u shërben arti. Lidhja me idetë përparimtare të epokës, me forcat e reja shoqërore, të cilat në veprimtarinë e tyre kanë shprehur prirjet progresive të zhvillimit historik, ka qenë gjithnjë për artin burim lulëzimi dhe përparimi. Kjo vërtetohet plotësisht edhe nga përvoja e letërsisë shqiptare të realizmit socialist, e cila, duke marrë pjesë në luftë për shndërrimin socialist të vendit, fitoi mundësi të pakufishme zhvillimi. Ideat socialiste i kanë dhënë letërsisë së sotme një shtytje të fuqishme përpara, i hapën shtigjet

një lulëzimi të gjithanshëm. Dhe kjo është shprehur si në brendinë e thellë dhe të rëndësishme ashtu edhe në nivelin e saj të lartë artistik. Në sajë të këtyre faktorëve u rrit shumë ndikimi i letërsisë mbi shoqërinë; asnjëherë në të kaluarën letërsia shqiptare nuk ka pasur atë peshë në zhvillimin shpirtëror dhe mendor të njerëzve, siç e ka sot, kur e ka lidhur veten me idenë e ndërtimit të shoqërisë socialiste. Shkrimtarët e sotëm shqiptarë lëvrojnë lirisht talentin, kërkojnë dhe zbatojnë forma të ndryshme artistike që shërbejnë për të pasqyruar në mënyrë sa më të plotë realitetin socialist në zhvillimin e vet revolucionar.

Kuptohet se, duke u përpjekur të tregojnë jetën në tërësinë e kontradiktave dhe të aspektëve të shumta të zhvillimit të saj, shkrimtarët nuk mund të mos pasqyrojnë në frymë kritike shfaqjet negative, të cilat janë mbeturina të botës së perënduar çifligaro-borgjeze ose rezultat i ndikimit të ideologjisë së sotme borgjeze dhe revizioniste. Në jetë e reja zë vend jo vetëm me anë të përhapjes së shembullit pozitiv, por edhe duke kritikuar ashpër çdo gjë që pengon zhvillimin e saj. Megjithatë ndryshe nga realizmi kritik i viteve 30, për të cilin karakteristikë themelore ishte patosi i mohimit të shoqërisë së kohës, letërsia e sotme ka si synim pohimin aktiv të rendit socialist. Kjo do të thotë se shkrimtarët e sotëm në veprat e tyre theksojnë në radhë të parë dukuritë e reja, që hyjnë në jetën e shoqërisë gjatë luftës për zhvillimin e saj në rrugën e socializmit. Letërsia e sotme përshkohet nga bindja në mundësitë e mëdha të rendit socialist për të ecur gjithnjë përpara dhe për të përmbysur të gjitha pengesat që frenojnë zhvillimin e tij të pandalshëm drejt caqesh të reja; ajo është plot besim në të ardhmen, shpreh sigurinë e popullit në fitoren përfundimtare me gjithë vështirësitë e shumta dhe të ndryshme që përcjellin luftën për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit.

Sikurse të gjitha sferat e jetës shoqërore, edhe letërsia është zhvilluar nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të Partisë. Si forca drejtuese e gjithë jetës së vendit, Partia ka luftuar për zhvillimin e mbarë të krijimtarisë letrare-artistike. Duke njohur rolin e madh shoqëror që luan arti, ajo ka kërkuar që letërsia të jetë e lidhur ngushtë me problemet e mëdha të jetës së vendit dhe të ndihmojë efektivisht për ngritjen dhe

forcimin e rendit të ri shoqëror. Në Kongresin IV të Partisë lidhur me detyrat e letërsisë dhe të arteve, shoku Enver Hoxha ka thënë: «*Ato duhet të militojnë më shumë dhe më mirë në luftën për edukimin e masave dhe për mobilizimin e tyre drejt fitoreve të reja në rrugën e ndërtimit të socializmit*»¹. Misionin e tij si edukator i masave shkrimtari e përmbush kur zotëron parime të drejta marksiste-leniniste të kuptimit të jetës, të shoqërisë dhe të individit. Që në ditët e para pas Çlirimit Partia ka theksuar nevojën që në fushën e kulturës të luftohej «*...kundër bazave të shtrembra ideologjike*», që shkrimtarët si gjithë njerëzit e kulturës, «*... të pajisen... me shkencën e vërtetë që i shërben popullit dhe vetëm popullit*»². Në vendimet e kongreseve të saj si dhe në dokumentet e posaçme kushtuar çështjeve të letërsisë dhe të arteve, Partia i ka porositur vazhdimisht shkrimtarët dhe artistët që të përvetësojnë teorinë marksiste-leniniste, sepse pa një sistem pikëpamjesh shkencore mbi shoqërinë dhe mbi natyrën është e vështirë që jeta socialiste të pasqyrohet me vërtetësi në veprat letrare. «*...sa e nevojshme është për shkrimtarin e artistin, — ka thënë shoku Enver Hoxha, — të njohë ligjet e zhvillimit të mendimit, proceset psikike të njeriut, rolin e kushteve materiale të jetës në formimin e ideve të personazheve që ata krijojnë në veprat e tyre*»³. Duke punuar me durim dhe me ngulm Partia ka arritur që njerëzit e letërsisë dhe të arteve t'i edukojë me frymë të shëndoshë ideologjike, t'i pajisë me botëkuptimin marksist-leninist.

Nga ana tjetër, Partia u ka ndihmuar shkrimtarëve që të njohin thellë detyrat që ka zgjidhur dhe po zgjidh shoqëria shqiptare në rrugën drejt socializmit, proceset që janë zhvilluar dhe zhvillohen në gjirin e saj. Vendimet dhe dokumentet e ndryshme të Partisë, të cilat përmbajnë analiza të thella të shoqërisë sonë e të kontradiktave që janë zgjidhur në etapa të ndryshme të zhvillimit të saj, të luftës së klasave që ka shoqëruar ndërtimin e socializmit, u kanë dhënë dorë njerëzve të letërsisë që, përmes njohjes së detyrave

1) E. Hoxha, **Vepra**, vëllimi 20, Tiranë 1976, f. 223.

2) E. Hoxha, **Vepra**, vëllimi 4, Tiranë 1970, f. 46.

3) E. Hoxha, **Vepra**, vëllimi 23, Tiranë 1977, f. 549.

themelore të jetës së vendit dhe të rrugëve të përmbushjes së tyre, të shohim qartë perspektivën historike. Kjo ka pasur dhe ka rëndësi vendimtare për punën krijuese të shkrimtarëve, që janë orientuar drejt në proceset e ndryshme të ndërtimit socialist, të cilin e kanë bërë objekt të pasqyrimit artistik në veprat letrare; shkrimtarët dinë të dallojnë atë që është kryesore dhe karakteristike në morinë e ngjarjeve dhe të dukurive që zhvillohen përreth, e shikojnë shoqërinë socialiste si shoqëri që ruan në vetvete gjallëri të veçantë dhe mundësi të pashtershme zhvillimi dhe mbi këtë bazë dinë të zgjidhin drejt konfliktet që shtrojnë në veprat e tyre.

Partia në të gjitha fazat e ndërtimit socialist ka ndjekur me vëmendje proceset që janë zhvilluar në letërsinë dhe artet tona. Duke i trajtuar çështjet që ka nxjerrë zhvillim letrar në dritën e doktrinës marksiste-leniniste mbi artin, Partia ka përgjithësuar përvojën artistike dhe ka formuluar përfundime të rëndësishme e me vlerë të madhe për zhvillimin e mëtejshëm të realizmit socialist. Në dokumentet e Partisë janë zgjidhur një varg çështjesh me rëndësi të madhe teorike të procesit historiko-letrar si: çështja e zhvillimit të letërsisë sonë në rrugën e realizmit socialist si metodë krijuese dhe drejtim letrar, që u përgjigjen kërkesave ideologjike të shoqërisë shqiptare pas Çlirimit; çështja e heroit të veprave të sotme letrare; çështja e traditës dhe e novatorizmit; çështja e pasurimit të pandërprerë të realizmit socialist krahas zhvillimit të shoqërisë; çështja e luftës së papajtueshme kundër shfaqjeve të ndryshme konservatore dhe borgjezo-revizioniste në brendi dhe formë si kusht i domosdoshëm për zhvillimin e mbarë të letërsisë dhe të arteve të realizmit socialist; çështja e karakterit kombëtar dhe e mbështetjes në folklor etj.

Historia e letërsisë së sotme flet për luftën që është bërë në periudha të ndryshme kundër shfaqjeve të huaja ideologjike në lëmin e krijimtarisë artistike. Në hapat e para të letërsisë shkrimtarëve tanë iu desh të luftonin kundër pikëpamjes së disa letrarëve reaksionarë, sipas së cilës letërsia e re duhet të qëndronte larg problemeve politike dhe shoqërore të kohës, larg luftës për ndërtimin e socializmit. Në të njëjtën kohë u godit teza që ishte kundër frymës socia-

liste në krijimtarinë letrare dhe pranonte ekzistencën e rrymave e të drejtimeve antipopullore në letërsinë e sotme. Në vitet e para pas Çlirimit u demaskuan edhe qëndrimet sektare dhe nihiliste që e kishin burimin në nënvleftësimin e rolit të artit në luftën e masave punonjëse për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Gjatë historisë së vet letërsia shqiptare e realizmit socialist u ndesh me armiqtë të ndryshëm, të cilët u orvatën të largonin shkrimtarët nga lufta për ngritjen e jetës së re. Në mesin e viteve 50 pati ndonjë element që mori në mbrojtje zhvillimin e një poezie romantike abstrakte, të shkëputur nga problemet e rëndësishme të shoqërisë. Një luftë e ashpër dhe konsekuente kundër ndikimeve të artit dhe të letërsisë borgjeze e revizioniste u ndez veçanërisht në mesin e viteve 60 dhe në fillim të viteve 70. Në këtë periudhë tehu i kritikës u drejtua kundër prirjes për të nxirrosur realitetin socialist, kundër shfaqjeve të humanizmit abstrakt mbiklasor, kundër frymës së çheroizimit, hermetizmit dhe largimit nga tabani kombëtar e, lidhur ngushtë me këtë, kundër përcmimit të krijimtarisë gojore artistike të popullit etj.

Realizmi socialist u rrit dhe u forcua edhe në luftë kundër shfaqjeve dhe prirjeve konservatore, që frenonin përpjekjet e shkrimtarëve për të pasuruar letërsinë me brendi dhe forma të reja të shprehjes. Shfaqjet më tipike të konservatorizmit në fushën e krijimtarisë artistike kanë qenë rutina, druajtja nga kërkimet novatore, interesimi i theksuar për imtësitë etnografike, dhe, në përgjithësi, për traditat e vjetruara në jetën e malësisë etj.

Megjithëse shënon një etapë të re në historinë e letërsisë shqiptare, realizmi socialist nuk është i shkëputur nga zhvillimi i mëparshëm letrar. Ai u rrit dhe u formua duke ruajtur dhe vazhduar më tej çdo gjë me vlerë që u krijua në të kaluarën në lëmin letrar. Fryma patriotike, lidhja e ngushtë me jetën e vendit, karakteri popullor, realizmi — këto përbëjnë disa nga traditat e shëndosha që trashëgoi letërsia e sotme.

Originaliteti i zhvillimit historik të vendit tonë qëndron, ndër të tjera, edhe në faktin se populli shqiptar, si rrallë-kush nga popujt e tjerë, ka qenë i detyruar të luftonte shekuj të tërë për liri dhe pavarësinë kombëtare. Kjo vuri vulën

edhe në karakterin e letërsisë shqiptare, historinë e së cilës e përshkon patosi patriotik. Pothuajse të gjithë shkrimtarët e shquar të së kaluarës, duke nisur nga Naim Frashëri e deri te Migjeni, nga De Rada e deri te Noli, i ka karakterizuar ndjenja e flaktë patriotike, dashuria për vendin, besimi në forcat e popullit shqiptar, aspirata e palëkundur për jetë të lirë dhe me dinjitet, lufta këmbëngulëse për çlirimin dhe pavarësinë e atdheut. Kjo frymë vijon edhe në letërsinë e realizmit socialist. Natyrisht, ashtu si gjithë brendia ideore e letërsisë së sotme, dhe patriotizmi i saj u zhvillua mbi një bazë konkrete historike, mbi bazën e marrëdhënieve të reja shoqërore dhe të ideologjisë socialiste si ideologji sunduese. Kështu që në rrethanat e reja patriotizmi në veprat letrare fitoi cilësi të reja, ai është patriotizëm socialist. Në vetëdijen e shkrimtarëve të sotëm fati i atdheut është i lidhur ngushtë me interesat e masave punonjëse, që u bënë zot të vendit, gjithashtu dhe me mbrojtjen e fitoreve të revolucionit.

Fryma përparimtare në letërsinë shqiptare u përcaktua nga lufta e popullit për çlirimin e tij shoqëror. Idetë përparimtare kanë qenë idetë kryesore që frymëzuan letërsinë shqiptare dhe përcaktuan karakterin e saj popullor. Në veprat e De Radës dhe të Çajupit, të Mjedës dhe të Nolit, të Migjenit dhe të Asdrenit, të Gramenos dhe të Postolit, të Stërmillit dhe të letrarëve të viteve 30 u shpreh aspirata e popullit për lumturi dhe drejtësi shoqërore.

Realizmi si parim i pasqyrimit me vërtetësi të jetës në shfaqjet e saj tipike, është një nga traditat e çmuara të letërsisë së sotme. Dihet se në letërsinë shqiptare parimi realist mori zhvillim sidomos në vitet 30, në krijimtarinë e shkrimtarëve përparimtarë. Pasqyrimi i karaktereve shoqërore në përputhjen e tyre të brendshme me marrëdhëniet shoqërore që i përftojnë, gjeti shprehjen e tij më të plotë në krijimtarinë e Migjenit. Në periudhën e fundit të jetës së tij Migjeni krijoi karaktere të plota tipike, në mendimet dhe veprimet e të cilëve gjetën pasqyrim veçoritë thelbësore të shoqërisë shqiptare të asaj epoke. Kuptohet se realizmi i tij dhe i letrarëve të tjerë përparimtarë, nuk ishte veçse një realizëm kritik; autorët përparimtarë, duke u mbështetur në rrymën ideore të lëvizjes demokratike, i bënë në veprat

e tyre një kritikë të ashpër rendit ekzistues, marrëdhënieve shoqërore, moralit dhe artit reaksionar antipopullor.

Duke vazhduar dhe pasuruar më tej traditat më të mira artistike vendase e duke i ngritur ato në një shkallë të re më të lartë nga pikëpamja historike, në përputhje me kërkesat e reja të jetës së popullit shqiptar dhe me zhvillimin e marrëdhënieve shoqërore e historike, letërsia e sotme shfrytëzon në të njëjtën kohë edhe arritjet e mendimit artistik përparimtar botëror, e në radhë të parë të realizmit socialist si etapë e re në zhvillimin artistik të njerëzimit. Ndër autorët, përvoja e të cilëve ka qenë e çmuar për letërsinë e re shqiptare në procesin e formimit të saj, duhen përmendur M. Gorki, V. Majakovski, H. Barbys etj. Arritjet më të mira të këtyre autorëve, si realizmi, pasqyrimi i rolit aktiv të masave etj. u shfrytëzuan nga shkrimtarët tanë në përpjekjet që këta nisën pas Çlirimit për pasqyrimin e shndërrimeve socialiste, për krijimin e veprave të gjera epike dhe për zotërimin më të thellë të parimit realist të pasqyrimit të jetës.

Gjatë përvetësimit të arritjeve më pozitive të përfaqësuesve revolucionarë të realizmit socialist, letërsia e sotme shqiptare ka ruajtur gjithnjë origjinalitetin dhe pavarësinë e vet. Ajo lindi mbi truallin e jetës kombëtare, u përgatit nga shndërrimet revolucionare që nisën në jetën e vendit që në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe u thelluan më tej, pas Çlirimit, në periudhën e pushtetit popullor. Në punën e tyre për të shfrytëzuar përvojën pozitive botërore në lëmin artistik shkrimtarët tanë të realizmit socialist kanë sprapsur çdo gjë të huaj, që nuk i shërbente zgjidhjes së detyrave ideore dhe artistike që shtroheshin përpara tyre: pohimit të marrëdhënieve socialiste. Kështu, kur në Bashkimin Sovjetik pushtetin e uzurpuan revizionistët dhe kultura e arti sovjetik hynë në rrugën antisocialiste dhe antirevolucionare, shkrimtarët tanë u vunë gardh ndikimeve ideore dhe artistike, që morën jetë atje pas degjenerimit të letërsisë dhe të arteve sovjetike, dhe ndezën zjarrin e luftës kundër koncepteve dhe praktikave letrare revizioniste. Që prej asaj kohe letërsia jonë e realizmit socialist e ka përforcuar luftën e vet kundër artit dhe letërsisë borgjeze e revizioniste. E ndërgegjeshme për detyrat që i dilnin, ajo

u vu në mbrojtje të vendosur të traditave më të mira të realizmit socialist në shkallë botërore, të cilat po i përpunon dhe po i pasuron më tej në kushtet e luftës së ashpër ideologjike që zhvillohet sot midis marksizëm-leninizmit nga njera anë dhe revizionizmit e ideologjisë reaksionare borjeze nga ana tjetër.

Një nga meritat më të rëndësishme të veprave të shkrimtarëve tanë është karakteri kombëtar që i shquan. Kjo veçori e tyre rrjedh nga fakti se letërsia jonë e realizmit socialist u formua dhe u zhvillua si letërsi e një populli që ngriti me duart e veta jetën e tij të lumtur. Shkrimtarët kanë pasqyruar madhësinë e përpjekjeve të masave punonjëse për ndërtimin e socializmit në Shqipëri, kanë treguar luftën e popullit tonë për të përballuar sulmet dhe komplotet e armiqve të ndryshëm, të imperialistëve dhe të revizionistëve dhe, përmes kësaj, kanë vënë në dukje frymën e paepur, gjallërinë e rrallë dhe aspiratën e pamposhtur për të rrojtur i lirë dhe zot i fateve të tij, etjen e pashuar për përparim, veçori që lindën në karakterin e popullit gjatë rrugës së tij të vështirë nëpër shekuj dhe i ngriti në një shkallë më të lartë dhe i pasuroi socializmi. «Pasqyrimi i realitetit të ri socialist në zhvillimin e tij revolucionar dhe me kontradiktat e kohës, që i japin letërsisë dhe artit dramaticitetin dhe konfliktet e nevojshme, — këtu qëndron, — ka thënë shoku Enver Hoxha, duke folur për fizionominë e veçantë të artit tonë socialist, — përmbajtja e re që i jep forcën letërsisë e artit tonë të realizmit socialist. Dhe një përmbajtje e tillë patjetër çon edhe në kërkime e në gjetje formash të reja. Të gjitha këto, si edhe mbështetja fort në truallin kombëtar, në krijimtarinë e trashëgiminë kulturore përparimtare të popullit tonë, i japin letërsisë dhe artit socialist atë origjinalitet dhe atë novatorizëm që e dallojnë nga të tjerët, jo vetëm si krijimtari e një populli dhe e një kombi të caktuar, por edhe për tiparet që fiton kjo krijimtari përmes kushteve të luftës kundër imperializmit e revizionizmit modern dhe për revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit»¹).

1) E. Hoxha, Raport mbi veprimtarinë e KQ të PPSH, mbajtur në Kongresin VI të PPSH. (1 nëntor 1971), Botimi i dytë, Tiranë 1971, fq. 159-160.

Lidhja e ngushtë me jetën e masave ka përcaktuar edhe karakterin popullor të letërsisë së sotme, që përbën një tipar tjetër të saj të rëndësishëm. Shkrimtarët tanë kanë rrahur problemet më të rëndësishme të popullit, kanë treguar sakrificat dhe përpjekjet për të ndërtuar jetën e tij të lirë, pa padronë dhe armiq mbi krye. Në të njëjtën kohë veprat e tyre janë të thjeshta dhe të qarta për masat. «Arti dhe kultura jonë socialiste, — ka thënë shoku Enver Hoxha, — duhet të mbështeten në tokën tonë amtare, në popullin tonë të mrekullueshëm, ato duhet të burojnë nga populli dhe të jenë plotësisht në shërbim të tij, të qarta e të kuptueshme për popullin, por aspak «bamale e pa ide»¹).

Letërsia shqiptare e realizmit socialist lindi dhe u formua duke shfrytëzuar pasurinë gojore të popullit, e cila ka qenë dhe mbetet edhe sot e kësaj dite gurrë e gjallë që ushqen krijimtarinë e shumë autorëve të sotëm. Marrëdhëniet e krijimtarisë letrare-artistike me folklorin nuk kanë qenë të njëjta në të gjitha etapat që ka përshkuar letërsia. Format e ndikimit të folklorit në letërsi kanë ndryshuar në përputhje me zhvillimin dhe pasurimin e kësaj të fundit. Në vitet 50 pati një shfrytëzim intensiv të krijimeve poetike gojore, çka u përcaktua jo vetëm nga fakti se ekzistonte një traditë pozitive në këtë fushë, por edhe nga nevojat e kohës që kërkonin një art me frymë popullore si në brendi ashtu edhe në formë. Në të njëjtën kohë duhen vënë në dukje se huanimi në shkallë të gjerë i subjekteve, i figurave dhe i motiveve të folklorit ose trajtimi i ngjarjeve të kohës me mjetet e poetikës së krijimeve popullore, u përcaktua nga gjendja ku ndodhej letërsia e re, përvoja e së cilës në vitet e para të pasqyrimin ishte ende e pamjaftueshme në pasqyrimin epik të jetës, sidomos në përgjithësimet të gjera artistike. Më vonë, duke nisur nga vitet 60, format e lidhjes së letërsisë me folklorin zhvillohen më tej; në këtë fazë ndikimi i krijimtarisë poetike gojore shfaqet jo në veçoritë e

1) E. Hoxha, Raport mbi Veprimtarinë e KQ të PPSH, mbajtur në Kongresin V të PPSH, (1 nëntor 1966). Botimi i dytë, Tiranë, 1966, f. 137.

jashtme të gjuhës, të stilit, të subjektit etj., por në vetë procesin krijues. Poetët dhe prozatorët shfrytëzojnë mënyrën e perceptimit artistik të dukurive dhe të ngjarjeve, me të cilën është pasqyruar përvoja historike e popullit, shfrytëzojnë strukturën stilistikore dhe intonative të rrëfimit popullor, parimet e përgjithshme të organizimit të gjuhës artistike të krijimeve folklorike etj.

Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist është karakterizuar nga pasurimi i vazhdueshëm i saj si në pikëpamje të ideve ashtu edhe të formës artistike; në rrugën e vet arti ynë si pasqyrë besnike e shoqërisë socialiste ka shënuar një varg arritjesh të rëndësishme që e kanë bërë atë të fitojë lexues edhe jashtë vendit. Deri më sot janë përkthyer në gjuhë të huaja një numër veprash të shquara të letërsisë sonë: romane, poema, përmbledhje tregimesh e vjershash të I. Kadaresë, D. Agollit, Ll. Siliqit, F. Gjatës, K. Jakovës, S. Spasses, Dh. S. Shuteriqit etj. Me forcimin e lëvizjes revolucionare kundër shtypjes kapitaliste dhe sundimit të revizionistëve modernë, interesimi për letërsinë dhe artet tona të realizmit socialist ka ardhur duke u rritur në mënyrë të pandërprerë. Veprat më të mira të letërsisë sonë kanë bërë për vete publikun e huaj lexues me brendinë e shëndoshë ideore, me besnikërinë ndaj idealeve socialiste, me frymën e lartë të partishmërisë, me shpirtin heroik dhe optimizmin luftarak që i shquan si dhe me nivelin e tyre artistik.

II

Në goftë se e marrim letërsinë e realizmit socialist në thelbin e vet, do të vemë re se veçoria themelore që e dallon nga letërsia e mëparshme është brendia e re ideore. Letërsia e sotme lindi mbi bazën e shndërrimit rrënjësor revolucionar të shoqërisë shqiptare; ajo pasqyron realitetin socialist, tregon luftën e masave punonjëse për ndërtimin e shoqërisë së re. Në brendinë e letërsisë së sotme problematika dhe patosi janë aspektet në të cilat shfaqet në mënyrë më të plotë dhe më të qartë novatorizmi i veprave të shkrimtarëve të sotëm. Problematika dhe patosi përbëjnë

atë element ligjësor dhe historikisht të papërsëritshëm të brendisë së krijimtarisë së shkrimtarëve të realizmit socialist, i cili me veçoritë e tij përcakton gjithë frymën e veprave të tyre letrare dhe u jep tipare të reja edhe veçorive të tyre të përgjithshme historikisht të papërsëritshme. «*Realizmi socialist*, — ka thënë shoku Enver Hoxha, — është pasqyrimi me besnikëri i jetës socialiste që po ndërtojmë në të gjitha aspektet e saja, i transformimeve kolosale materiale dhe me temp revolucionar që pëson vendi ynë, shoqëria jonë, njerëzit tanë...»¹. Pas Çlirimit objekti kryesor i pasqyrit artistik në veprat letrare u bë procesi i formimit të shoqërisë së re në anët e saj të ndryshme, përpjekjet e masave punonjëse për mposhtjen e qëndresës së forcave reaksionare të përmbysura dhe për vendosjen e marrëdhënieve të reja shoqërore, lufta politike dhe ideologjike e shoqërisë së re kundër botës borgjeze dhe revizioniste, që përpiqet më kot ta pengojë.

Duke vënë në qendër ndërtimin e shoqërisë socialiste, shkrimtarët e sotëm bënë hero kryesor masat punonjëse, autorët e të gjitha shndërrimeve që janë kryer e po kryhen në jetën e vendit. Në letërsinë e sotme nuk ka vepër të rëndësishme e me vlerë, shkruar mbi revolucionin popullor ose mbi jetën socialiste, në të cilën masat të mos zënë vend qendror në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Në veprat e tyre shkrimtarët kanë treguar rolin përherë në rritje të masave, veprimtarinë e tyre krijuese në lëmin e historisë, përpjekjet e tyre heroike për shndërrimin socialist të vendit. Mënyra e re e pasqyrit të masave në letërsinë e sotme rrjedh nga baza e re ideore në të cilën ajo mbështetet. Autorët përparimtarë të paraçlirimit nuk e shikonin masën si forcë të gjallë krijuese; në veprat e tyre masa, më të shumtën e herës, kundrohej kryesisht si viktimitë e shtypjes së egër shoqërore, që heq të zitë e ullirit dhe nuk ka vetëdijen e forcës dhe të drejtave të veta. Vetëm në letërsinë e realizmit socialist populli u pasqyrua si forcë vendimtare e zhvillimit historik. Shkrimtarët e sotëm e paraqesin drejt jetën dhe veprimtarinë e masave në për-

1) E. Hoxha, Raporte e fjalime (1967-1968), Tiranë 1969, f. 486.

gjithësi dhe të përfaqësuesve të tyre të veçantë, lidhjet dhe marrëdhëniet midis masës dhe individit.

Në procesin e ngritjes së jetës socialiste u shfaq dhe u formua njeriu i ri, i pajisur me tipare të reja shpirtërore dhe morale, që shpreh në karakterin e tij veçoritë thelbësore të epokës sonë. Letërsia jonë e realizmit socialist gjatë më se tridhjetë vjetëve të jetës së saj ka krijuar një varg personazhesh që mishërojnë karakterin e heroit të kohës sonë, të luftëtarit aktiv dhe të vetëdijshëm për ndërtimin e rendit të ri. Në pasqyrimin e heroit pozitiv shfaqet në mënyrë të qartë fryma pohuese e letërsisë së sotme, e cila i jep dorë fitores së elementeve socialiste në jetë. «Nëpërmjet këtij heroi triumfon e reja në jetë, pra, do të triumfojë edhe në art; kapërcehet ose shembet e vjetra në jetë, pra, do të kapërcehet e shembet edhe në art, krijohet shembulli i gjallë i punës krijuese, pra, do të krijohet edhe në art një shembull që t'i frymëzojë masat me dashurinë për punën, me shpirtin e sakrificës e të vetëmohimit për çështjen e socializmit. Nëpërmjet këtij heroi del perspektiva, zbulohet e ardhmja, shfaqet optimizmi revolucionar i jetës, pra, do të dalë edhe qëndrimi i shkrimtarit apo i artistit në favor të këtij realiteti të ri në zhvillim, në favor të së resë që shkon përpara dhe që shkrimtari dhe artisti kanë për detyrë ta mbrojnë e ta ndihmojnë të zhvillohet, si bartës, edhe ata, të idealeve të mëdha të komunizmit»¹. Çështja e pasqyrimin të karakterit të njeriut të pararojës e ka preokupuar letërsinë që në ditët e saj të para. Shkrimtarët paraqitën në veprat e tyre heroin e ri të kohës që lindi dhe u formua në zjarrin e luftës çlirimtare kundër pushtuesve fashistë dhe klasave sunduese. Paraqitja e gjithanshme dhe e plotë e fizionomisë shpirtërore dhe morale të njeriut të ri, e ndërtuesit aktiv dhe të vetëdijshëm të socializmit, ka qenë dhe vijon të jetë në qendër të vëmendjes së letërsisë si detyrë artistike e dorës së parë.

Në shumë vepra letrare është pasqyruar edhe e kaluara historike, lëvizjet çlirimtare të masave popullore kundër zgjedhës kombëtare dhe shoqërore, por, ndonëse e kanë he-

dhur vështrimin edhe në ngjarjet e rëndësishme të historisë kombëtare, shkrimtarët e sotëm kanë shtruar dhe rrahur në veprat e tyre ato probleme ideore që sugjeronin kërkesat e shoqërisë socialiste, detyrat që qëndronin përpara saj në etapat e ndryshme historike.

Veçori tjetër e rëndësishme e letërsisë së sotme është metoda e re artistike e pasqyrimin të jetës. Dihet se një pjesë e rëndësishme e shkrimtarëve përparimtarë të viteve 30 zbatuan në krijimtarinë e tyre parimin realist të pasqyrimin të jetës; kur u vishnin heronjve të veprave të veta mendime, veprime dhe marrëdhënie të caktuara, ata niseshin nga logjika e brendshme e karaktereve të tyre shoqërore, të krijuara nga marrëdhëniet shoqërore të epokës. Shkrimtarët e sotëm nuk kufizohen me pasqyrimin e karaktereve të njerëzve, të sjelljes dhe të vetëdijes së tyre në vartësi nga rrethanat shoqërore ekzistuese, siç bënte letërsia realiste përparimtare. Në bazë të njohjes së ligjeve të zhvillimit të shoqërisë ata janë në gjendje t'i pasqyrojnë karakteret tipike jo vetëm në rrethanat tipike të formuara prej kohësh, por edhe në perspektivën e zhvillimit të tyre, paraqitur kjo perspektivë në mënyrë konkrete nga pikëpamja historike. Kjo përbën veçorinë e re cilësore të metodës krijuese të letërsisë së sotme e cila, duke u mbështetur në një kuptim të drejtë shkencor të jetës, është në gjendje që përmes karaktereve tipike të pohojë dukuri të jetës edhe kur këto sapo kanë nisur të shfaqen.

Paraqitja e karaktereve të njerëzve në perspektivën e zhvillimit të tyre, nuk do të thotë t'i zbukurosh ata, nuk do të thotë t'i tregosh si duhet të jenë, por ashtu siç janë. Realizmi socialist nuk merret me zbukurimin e jetës. Shkrimtarët dhe artistët synojnë të japin një pasqyrim besnik të jetës së shoqërisë sonë. Të paraqitësh drejt këtë shoqëri, e cila është duke u zhvilluar në mënyrë të vrullshme, kjo kërkon që ta shikosh atë në ndryshim e sipër, që në ditën e sotme të diktosh elementet e së ardhmes, të së nesërme, që lindin vazhdimisht në gjirin e saj. Prandaj artisti i realizmit socialist u kushton vëmendje dukurive dhe shfaqjeve të reja, përpjet që në sjelljet dhe në veprimet e njerëzve të pararojës të zbulojë prirjet dhe shfaqjet e reja në shoqërinë socialiste. Dhe këtë e bën duke e pasqyruar jetën e gjallë ashtu siç është me

1) Dokumentet kryesore të PPSH, vëll. IV, Tiranë 1971, f. 570.

vështirësitë dhe kontradiktat që e shquajnë, me konfliktet e saj, në të cilat bën pjesë si lufta kundër armiqve të brendshëm ashtu edhe lufta kundër veprimtarisë armiqësore që bota kapitalisto-revizioniste zhvillon kundër Shqipërisë socialiste. Në veprat e sotme letrare jeta paraqitet në plotësinë e saj, pa i fshehur vështirësitë dhe të metat. «Pasqyrimi i realitetit të ri socialist në zhvillimin e tij revolucionar dhe me kontradiktat e kohës, që i japin letërsisë dhe artit dramaticitetin dhe konfliktet e nevojshme, — ka thënë shoku Enver Hoxha në raportin e mbajtur në Kongresin VI të PPSH, — këtu qëndron përmbajtja e re që i jep forcën letërsisë e artit tonë të realizmit socialist»¹.

Realizmi socialist zotëron mundësi reale për të trajtuar një problematikë të larmishme, të pasur dhe të shumanshme. Ai i përfton dhe i vlerëson karakteret e njerëzve, marrëdhëniet e tyre dhe botën e tyre të brendshme në dritën e problemeve të ndryshme ideore, që dalin nga proceset e shumta të ndërtimit të shoqërisë së re. Çdo shkrimtar, duke u nisur nga përvoja e vet jetësore, nga prirjet e veta ideore dhe krijuese, përqëndrohet në hetimin dhe në pasqyrimin artistik të sferave të caktuara të jetës së shoqërisë së sotme, në trajtimin e një rrethi të caktuar problemesh ideore. Me këtë është e lidhur larmia e stileve dhe e mjeteve artistike-krijuese, që shquan letërsinë e sotme. Në realizmin socialist ekzistojnë mundësi për shfaqjen dhe zhvillimin e individualiteteve më të ndryshme krijuese artistike. Mjafton të krahasojmë Sh. Musaranë dhe D. Agollin, I. Kadarenë dhe Ll. Siliqin, J. Xoxën dhe Dh. S. Shuteriqin, S. Spassen dhe F. Gjatën, A. Çaçin dhe K. Jakovën, për t'u bindur për pasurinë e mjeteve dhe të formave artistike që përdorin ata në punën e tyre krijuese letrare. Larmia e stileve dhe e mënyrave të krijimit e ka karakterizuar letërsinë e sotme në të gjitha periudhat e saj. Në këto dhjetë vjetët e fundit, me ardhjen në radhët e saj të një numri të konsiderueshëm

forcash të reja krijuese me origjinalitet të spikatur, është bërë më i pasur diapazoni i mënyrave individuale krijuese në letërsinë tonë. Por, duke vënë në dukje këtë veçori të letërsisë së sotme, nuk duhet harruar se me gjithë dallimet në mënyrën e të shkruarit, në mjetet e shprehjes artistike, shkrimtarët e sotëm i bashkon baza ideore, metoda e realizmit socialist dhe kuptimi i njëjtë i detyrave themelore që shtron populli përpara krijimtarisë letraro-artistike. Përvoja e deritanishme ka dëshmuar se sukseset më të shquara janë arritur mbi bazën e botëkuptimit marksist-leninist, të partishmërisë komuniste dhe të shfrytëzimit të gjithçkaje pozitive dhe me vlerë, që ka hyrë në fondin e letërsisë së sotme.

Do të ishte gabim që realizmi socialist të kundrohej si diçka e dhënë një herë e përgjithnjë, që nuk ndryshon më. Përfytyrimi i realizmit socialist si diçka e ngurosur që s'pranon asnjë element të ri që sjell zhvillimi i jetës, është dogmatik dhe në kundërshtim me vetë faktet e historisë së tij. Merret vesh se, si pjesë e pandarë e shoqërisë sonë socialiste, e cila shkon gjithnjë përpara dhe në çdo etapë kapërcen në një fazë të re të procesit të saj, edhe realizmi socialist i është nënshtruar procesit të zhvillimit historik dhe në këtë zhvillim ka fituar veçori të reja. Në përpjekjet e saj për të dhënë një pasqyrim sa më të plotë të shoqërisë së re, letërsia e realizmit socialist është pasuruar si në pikëpamje të brendisë ashtu edhe të formës. Duke ruajtur në thelb bazën e vet ideore, ajo gjatë procesit të rritjes së vet, ka fituar një kuptim më të thellë të problemeve dhe të aspekteve të veçanta të jetës në përputhje me zhvillimin e mendimit politik e shoqëror të Partisë, ka arritur të përfshijë në sferën e pasqyrimin artistik proceset dhe prirjet e reja, që janë shfaqur në lëvizjen e vendit drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Mundësitë krijuese të letërsisë së sotme janë shfaqur si në gjerësinë e realitetit të pasqyruar në veprat letrare ashtu edhe në paraqitjen e thellë dhe realiste të jetës, në analizën psikologjike të karaktereve. Krahas kësaj, për t'iu përgjigjur kërkesave estetike të lexuesve dhe duke ndier nevojën për të rrokur realitetin e ri në gjithë gjerësinë e aspekteve të tij, letërsia ka përpunuar mjete dhe forma të reja të shprehjes artistike.

Pasurimi i realizmit socialist vijon në mënyrë të pandër-

1) E. Hoxha, Raport mbi veprimtarinë e KQ të PPSH mbajtur në Kongresin VI të PPSH, (1 nëntor 1971), Tiranë 1971, f. 159-160.

prerë, ai shkon dora-dorës me zhvillimin e shoqërisë socialiste, me gjallërimin e madh që ka marrë jeta shoqërore në etapën e re në të cilën ka hyrë revolucioni socialist në Shqipëri, pas Letrës së Hapur të KQ të PPSH (1966) drejtuar popullit shqiptar.

Forcimi i letërsisë shqiptare të realizmit socialist eci bashkë me njësimin dhe kristalizimin përfundimtar të gjuhës letrare kombëtare. Dihet se për shkak të rrethanave të njohura historike dhe kulturore, deri në Çlirimin e vendit letërsia shqiptare u zhvillua në dy variante të gjuhës letrare; kjo gjendje vijoi, sigurisht, në mënyrë të kufizuar edhe në periudhën e parë, deri aty nga mesi i viteve 50. Por, megjithëse pati autorë që ndoqën variantin letrar verior, prirja themelore e letërsisë artistike ishte përdorimi i normës letrare sa më të njësuar. Kjo erdhi sepse shumica e shkrimtarëve e kuptuan se brendisë së rëndësishme kombëtare të veprave të tyre duhej t'i përgjigjej plotësisht forma e njësuar e shprehjes gjuhësore. Në krijimtarinë e tyre ata vunë të gjitha forcat për ngulitjen dhe përhapjen e normës letrare.

Në periudhën e parë krahas luftës për kristalizimin e gjuhës letrare kombëtare u bënë përpjekje edhe për të zbuluar pasuritë e pasqyeshme të gjuhës, duke nxjerrë në dritë dhe duke ngritur në normë një shumicë fjalësh dhe shprehjesh nga gurra popullore e të gjitha krahinave, që nuk delnin në variantet letrare të mëparshme. Në këto përpjekje letërsia dha një ndihmë të çmuar. Në vitet e pushtetit popullor gjuha e letërsisë artistike u bë më e pasur dhe më e larmishme, në të hynë shumë fjalë, forma dhe shprehje nga ligjërimi popullor bisedor dhe nga të folmet e krahinave të ndryshme. Kjo ndikoi pozitivisht në pasurimin e mjeteve të shprehjes gjuhësore të letërsisë artistike. Rëndësia e kësaj dukurie bëhet edhe më e qartë po të kemi parasysh se në vitet 30 në shtyp dhe në botime të tjera u ngushtua sfera e përdorimit të fjalëve dhe të shprehjeve të gjuhës popullore. Kjo dukuri preku edhe veprat e një vargu autorësh të rinj, të cilët në gjuhën e krijimeve të tyre kishin shumë elemente të ligjërimin libror, gjë që nuk mund të mos çonte në varfërimin e mjeteve të shprehjes letrare. Pas Çlirimit gjendja ndryshoi në drejtim të kundërt; gjuha e letërsisë artistike

iu drejtua burimit popullor për të gjetur mjete shprehëse të reja. Në këtë ndikoi fort ndryshimi i përbërjes së inteligjencies, në këtë mes edhe i inteligjencies së artit. Shkrimtarët që vinin nga shtresat e gjera të popullit, futën në gjuhën letrare shumë elemente të të folmes së tyre, sidomos nga fusha e leksikut. Më të shumtën e herës këto ishin fjalë nga ligjërimi i përditshëm, fjalë dhe shprehje popullore, që ndonëse në fillim i përkisnin së folmes krahinore që përdorin vetë shkrimtarët, duke pasur vlera të domosdoshme për gjuhën letrare, u rrënjosën dalngadalë në të, duke marrë me kohë vlerën e normës. Nga gurra popullore u morën edhe njësi frazeologjike, të cilat i rritën vlerat emocionale e shprehëse të gjuhës. Në pasurimin e gjuhës së letërsisë artistike, krahas përbërjes së shkrimtarëve, luajti rolin e saj edhe tematika e re e letërsisë së realizmit socialist. Hyrja në veprat letrare e heronjve që mishëronin përfaqësuesit e krahinave dhe të grupeve të ndryshme shoqërore, nevoja për të karakterizuar mjedisin e tyre konkret jetësor, bëri që shkrimtarët, veçanërisht prozatorët, t'u drejtoheshin shtresave të tilla të gjuhës, si: dialektalizmave, kraharizmave dhe ligjërimin të përditshëm.

Duke nisur nga mesi i viteve 50, kur procesi i kristalizimit dhe i njësimin të gjuhës letrare u bë më dinamik, roli i letërsisë artistike në këtë proces u rrit akoma më tepër. Kjo lidhej me rritjen e mëtejshme të përgjegjësisë së shkrimtarëve, të cilët erdhën duke e kuptuar përherë e më shumë se çështja e qëndrimit ndaj gjuhës nuk ishte diçka vetjake, por çështje me rëndësi të përgjithshme kombëtare. Me daljen në dritë të veprës, gjuha e saj bëhet pronë e atyre që e lexojnë, pronë e gjithë popullit. Duke qenë se në veprat artistike shfaqet karakteri real i normës, nga shkalla e respektimit të normës letrare në veprat artistike varet edhe përhapja e zotërimit i saj. Një varg autorësh hoqën dorë nga përdorimi i variantit letrar verior, u mbështetën ngaherë e më shumë në gjuhën e përbashkët letrare dhe kjo sollu me vete ndryshimin e peshës dhe të rëndësisë së letërsisë artistike në procesin e formimit përfundimtar të gjuhës letrare. Veprat e shkrimtarëve nisën të luajnë rolin e laboratorit, ku krahas sferave të tjera, u përpunua trajta e shkruar e gjuhës letrare. Veçori dalluese e kësaj periudhe është se,

duke zbatuar me vetëdije e më me ngulm normën e njësuar, letërsia artistike u bë në një shkallë akoma më të lartë përhapëse e saj në masat e gjera. Të ndërgjegjshëm për rolin që u takon të luajnë, shkrimtarët po japin tashti ndihmën e tyre të madhe për përhapjen e ngulitjen e normës letrare, si dhe për përsosjen e pasurimin në përgjithësi të gjuhës letrare kombëtare.

III

Për të studiuar dhe kuptuar historinë e letërsisë duhet një periodizim i saktë dhe i argumentuar nga pikëpamja shkencore, që jep dorë të dalin në pah veçoritë kryesore të procesit letrar. Një periodizim i tillë është ai që mbështetet në faktet dhe në dukuritë më të rëndësishme të letërsisë, në ato dukuri që shënojnë kthesë në zhvillimin e saj. Por, duke vendosur në themel të periodizimit dukuritë dhe ngjarjet e jetës letrare, duhet mbajtur fort parasysh rëndësia e faktorëve shoqërorë politikë në zhvillimin letrar. Historia e letërsisë nuk mund të shkëputet nga jeta e shoqërisë, nga lufta e klasave, por, kuptohet, se ndikimi i rrethave shoqërore e politike shprehet në jetën e artit në mënyrë të tërthortë, në përputhje me veçoritë e tij, si formë specifike e ndërgjegjes shoqërore; ky ndikim shfaqet në brendinë dhe në karakterin e zhvillimit të letërsisë. Në veçoritë e këtij zhvillimi duhet të mbështetet periodizimi i procesit letrar.

Në zhvillimin historik të letërsisë shqiptare të realizmit socialist mund të caktohen tri periudha, të cilat përputhen me periudhat e historisë së vendit që nis me Luftën Nacionalçlirimtare dhe vjen në ditët tona.

Në periudhën e parë, e cila zë fill me lindjen e shtypit ilegal antifashist dhe shkon deri më 29 nëntor 1944, zhvillohet revolucioni popullor, në sajë të të cilit u çlirua vendi nga pushtuesit e huaj, u shembën për tokë klasat sunduese çifligaro-borgjeze dhe pushteti kaloi në duart e popullit. Në gjithë historinë e letërsisë shqiptare kjo periudhë shquhet si periudha kur nxjerr kryet një letërsi e re për nga tematika e problematika. Brenda e saj u bë lufta e

popullit shqiptar kundër pushtuesve nazifashistë dhe armiqve të brendshëm; në veprat letrare u pasqyrua entuziazmi luftarak, vetëdija e lartë politike, shpirti i sakrificës dhe i vetëmohimit që karakterizoi masat popullore në këto vite. Veçori e rëndësishme që shqoi prodhimin letrar të kësaj periudhe nga letërsia e mëparshme, është kuptimi i ri i popullit, i cili qoftë në këngët dhe marshet partizane, qoftë në skicat dhe tregimet, përshkruhet si forcë që jo vetëm nuk e la veten të mashtrohej nga klasat sunduese, por kishte ndërgjegjen e plotë të interesave të tij. Me këtë është lidhur heroi i ri dhe partishmëria revolucionare, që shqoi prodhimin letrar të kësaj periudhe.

Në periudhën e dytë (29 nëntor 1944 — fundi i viteve 50) zhvillimi i letërsisë u përcaktua nga lufta për shndërrimin socialist të vendit. Shkatërrimi i rendit të vjetër ekonomik e shoqëror, zhdukja e marrëdhënieve të shfrytëzimit dhe të shtypjes, kryerja e një vargu shndërrimesh ekonomike, shoqërore dhe ideologjike, ndërtimi i industrisë socialiste, kolektivizimi socialist i bujqësisë etj., me një fjalë ndërtimi i themeleve të shoqërisë socialiste, — kjo përbën brendinë e kësaj periudhe historike në jetën e vendit. Nën ndikimin e këtyre ngjarjeve të rëndësishme formohet plotësisht realizmi socialist si drejtim letrar dhe metodë krijuese. Kryerja e këtij procesi u bë gjatë zgjidhjes së detyrave artistike që shtronte përpara vendi: pasqyrimi i kthesës rrënjësore që shënoi ngadhënjimi i revolucionit popullor në historinë e vendit, si dhe ngadhënjimit në jetë të marrëdhënieve të reja socialiste. Karakteristike për këtë periudhë është paraqitja e gjerë realiste e jetës së vendit në vitet e pushtimit fashist dhe sidomos e luftës çlirimtare popullore kundër sundimit të huaj. Krahas kësaj shkrimtarët trajtuan edhe problemet që nxirrte ndërtimi i jetës së re, procesi i formimit të njeriut të tipit socialist.

Periudha e tretë, që nis me fillimet e viteve 60 dhe vjen në ditët tona, është periudha e konsolidimit dhe e zhvillimit të mëtejshëm të realizmit socialist. Në këtë kohë kish përfunduar ndërtimi i bazës ekonomike të socializmit; vendi hyri në një etapë të re, në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Lufta për zgjidhjen e kësaj detyre historike po zhvillohet në kushtet e rrethimit të dyfishtë, impe-

rialist dhe revizionist; armiqtë bënë përpjekje të mëdha për të penguar ecjen përpara të revolucionit socialist në Shqipëri. Në këto rrethana detyra kryesore ishte që të dilte në pah me qartësi madhështia historike e popullit shqiptar, që bëri revolucionin popullor dhe e çoi atë deri në fund, në revolucionin socialist, të tregoheshin lidhur me këtë mundësitë dhe aftësitë e popullit për të kapërcyer të gjitha pengesat që kishin dalë dhe do të dilnin në rrugën drejt fitores së plotë të socializmit në Shqipëri. Letërsia iu drejtua së kaluarës dhe sidomos epopesë së luftës çlirimtare të masave të popullit kundër pushtuesve nazifashistë; ajo tregoi gjallërinë dhe frymën e paepur të popullit shqiptar ndër shekuj, atë vrull forcash dhe energjish që ngjalli revolucionin në masat, vullnetin e tyre të papërkulur për ekzistencë dhe zhvillim të lirë e të pavarur.

Në këtë periudhë u shfaqën në mënyrë më të plotë mundësitë e mëdha krijuese të realizmit socialist; në veprat më të mira letrare të kësaj periudhe jeta socialiste u paraqiti në mënyrë të gjerë, u pasqyruan shumë procese dhe dukuri të rëndësishme shoqërore, u skalitën karaktere të plota letrare me botën e tyre të brendshme shpirtërore. Krahas thellimit të problematikës dhe forcimit të bazave realiste, tipar i rëndësishëm i kësaj periudhe është edhe pasurimi i mëtejshëm artistik i letërsisë së sotme.

Zhvillimi i letërsisë po ecën në vijë ngjitjeje. Në jetën socialiste kanë nxjerrë krye dukuri dhe konflikte të reja të përfutuara nga lufta që bën sot i gjithë populli për të vazhduar me guxim dhe konsekuencë revolucionin socialist dhe për të mbrojtur fitoret e arritura. Shkrimtarët kanë vënë të gjitha forcat për të zgjidhur detyrat artistike që shtrohen sot përpara tyre. Me veprat që krijojnë ata japin dorë për edukimin e punonjësve me frymë revolucionare, me vendosmëri dhe këmbëngulje në punë, me guxim dhe optimizëm luftarak.

K R E U I

FILLIMET E LETËRSISË SHQIPTARE TË REALIZMIT SOCIALIST

Lindja e letërsisë së sotme shqiptare është lidhur me ngjarjet historike që u shtollën gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur populli shqiptar, i udhëhequr nga komunistët, rrok armët për të dëbuar pushtuesit fashistë dhe për të çliruar vendin. Në këto vite nën ndikimin e ideve të revolucionit popullor u shfaq një letërsi me tipare të reja ideore dhe artistike.

Pushtimi fashist më 7 prill 1939 ishte një goditje e rëndë për popullin shqiptar, i cili kishte luftuar shekuj të tërë për lirinë dhe pavarësinë kombëtare. Skllavëria e huaj shënoi për Shqipërinë regres nga të gjitha pikëpamjet: ekonomike, politike, kulturore etj. Gjendja e masave punonjëse u keqësua më tej; mbi kurrizin e tyre, shtypjes së klasave shfrytëzuese vendase, iu shtua edhe një zgjedhë tjetër, ajo e kapitalistëve italianë. Krahas kësaj, për zbatimin e qëllimeve të tyre kolonialiste, pushtuesit fashistë morën një varg masash shkombëtarizuese. Që në ditët e para të pushtimit në Shqipëri erdhën 20000 italianë; pas tyre do të silleshin nga Italia edhe dhjetëra mijë kolonë të tjerë, të cilët do të vendoseshin në tokat më të mira të vendit. Politikën e tyre të italianizimit autoritetet e pushtimit e zbatuan me këmbëngulje sidomos në jetën kulturore dhe shoqërore. Si mësim i detyrueshëm në shkolla u fut kultura fashiste, gjuha italiane u bë gjuhë e dytë zyrtare. Traditat e kulturës kombëtare u përçmuan dhe u braktisën.

Shfrytëzimi i egër ekonomik dhe pesha e shtypjes kombëtare ngjallën zemërimin e vendosur të popullit, i cili nuk

linter rast pa shprehur kundërshtimin e tij ndaj pushtuesit të huaj. Protestat, grevat dhe demonstratat që shpërthyen në muajt e parë të pushtimit fashist erdhën duke u shtuar dhe morën shpejt karakterin e një lëvizjeje të gjerë popullore. Shpirti i qëndresës së masave kundër pushtuesve fashistë ishin komunistët, të cilët, pas 7 prillit 1939, e shfaqën veten si e vetmja forcë politike e aftë për të drejtuar luftën e popullit shqiptar kundër fashizmit italian. Me themelimin e Partisë Komuniste Shqiptare më 8 nëntor 1941 lëvizja popullore çlirimtare mori karakter të organizuar dhe përpjesëtime të gjera, duke përfshirë në radhët e veta punëtorë, fshatarë, të rinj dhe forcat e tjera të shëndosha të vendit. Nga fundi i vitit 1941 dhe fillimi i vitit 1942 prej grevave dhe demonstratave kalohet në luftën e armatosur. Çetat dhe njësitet partizane që vepronin në të gjithë vendin, në përpjekje të ashpra me armiqtë, arritën në fund të vitit 1942 të çlironin zona të gjera. Pushtuesit fashistë u përpoqën të shtypnin me hekur dhe me zjarr qëndresën e popullit shqiptar. Qindra veta u vranë ose u masakruan në mënyrë barbare, qindra të tjerë u hodhën në burgje dhe u internuan në kampe përqendrimi dhe gjetkë. Me gjithë terrorin e egër, vala e luftës popullore sa vinte e rritej; vrullin e saj nuk e ndalën dot as edhe përpjekjet e klasave të vjetra sunduese, të cilat përballë rritjes së shpejtë të lëvizjes, shpejtuan të grumbullojnë forcat e tyre dhe me anë të organizatave tradhtarë dhe antikombëtare që krijuan, u orvatën të pengonin çlirimin kombëtar dhe shoqëror të popullit. Por masat e gjera popullore ishin të vendosura ta çonin deri në fund luftën e nisur për çlirimin e vendit dhe krijimin e një Shqipërie demokratike popullore.

* * *

Pas 7 prillit 1939, ashtu si për të gjithë intelektualët patriotë edhe për shkrimtarët, kryesore ishte përcaktimi i qëndrimit ndaj pushtimit fashist dhe sidomos gjetja e rrugëve për të shpëtuar Shqipërinë nga gjendja e rëndë dhe poshtëruese në të cilën ndodhej. Lidhur me këtë në gjirin

e shkrimtarëve u shfaqën dy qëndrime të kundërta. Një palë qëndronin larg forcave të shëndosha politike të vendit, nuk kishin besim tek masat popullore dhe e shikonin me pesimizëm të ardhmen. Shqipëria, sipas tyre, kishte hyrë pas 7 prillit 1939 në një periudhë të errët të historisë së saj, fundi i së cilës nuk dihej. Në këto rrethana detyra e shkrimtarëve shqiptarë, mendonin ata, ishte ruajtja dhe mbajtja gjallë e gjuhës si shenjë e kombësisë përmes botimit të shkrimeve letrare në organet që nxirrte pushtuesi. Kjo, sipas tyre, ishte më e shumta që mund të bënin në ato kushte shkrimtarët shqiptarë për të përmbushur detyrën e tyre ndaj vendit. Duke u nisur nga pozita të tilla, ata vetë nisën të botojnë shkrime në të cilat trajtonin temën e dashurisë, të kurbetit ose bënin nga pozita të përgjithshme iluministe kritikën e traditave dhe të zakoneve prapanike në jetën familjare, të marrjes së gjakut etj. Kuptohet se ky qëndrim oportunist i çoi këta autorë në rrugë pa krye, sepse shkrimet e tyre ishin larg nevojave të vërteta të jetës së vendit dhe kërkesave që epoka historike shtronte përpara letërsisë shqiptare. Me forcimin e lëvizjes çlirimtare popullore dhe me organizimin e shtypit ilegal antifashist, u bë akoma më e qartë se ky prodhim letrar, që gjeti vend në faqet e shtypit të administratës fashiste, ishte i dëmshëm, sepse tërthorazi pengonte hedhjen e të gjitha forcave të shëndosha të vendit në luftën pa kompromis kundër pushtuesve nazi-fashistë.

Pjesa më e shëndoshë e shkrimtarëve, të cilët në vitet 30 kishin qenë lidhur ngushtë me grupet komuniste (Sh. Musaraj, A. Çaçi, A. Varfi etj.) morën qëndrim të prerë kundër pushtimit fashist. Duke e pasur të qartë se ç'përfaqësonte skllavëria e huaj për fatet e Shqipërisë, ata jo vetëm nuk botuan asgjë në organet e shtypit që nxori administrata fashiste, por u bënë thirrje edhe letrarëve të tjerë që të mos botonin asnjë shkrim në faqet e shtypit zyrtar. Përveç kësaj, ata në muajt e parë pas 7 prillit bënin agitacion në rrethet e intelektualëve për të sabotuar iniciativat demagogjike të pushtuesve fashistë dhe të veglave të tyre në fushën e kulturës. Por me gjithë qëndrimin e prerë antifashist, këta autorë në fillim nuk e patën plotësisht të qartë perspektivën historike.

Rëndësi të madhe për gjithë letërsinë shqiptare pati

themelimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë, e cila tregoi rrugën dhe mjetet për çlirimin kombëtar dhe shoqëror të popullit. Forcat e shëndosha letrare e kuptuan se detyra e letërsisë shqiptare ishte të ndihmonte luftën kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit, se vetëm fitorja e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, e udhëhequr nga Partia Komuniste Shqiptare, do të hapte për letërsinë, ashtu sikurse hapi në të vërtetë, mundësi të papara zhvillimi dhe lulëzimi. Kështu, në zjarrin e luftës së masave popullore kundër fashizmit italian dhe e frymëzuar nga idetë e saj, lindi një letërsi me veçori të reja ideore dhe artistike. Kjo letërsi jetoi me problemet kryesore të kohës, me detyrat e ngutshme të luftës kundër armiqve të popullit shqiptar. Autorët e saj edukuan njerëzit me ndjenjën e dashurisë së zjarrtë për popullin, me frymën e urrejtjes ndaj skllavëruesve të huaj e të bashkëpunëtorëve të tyre dhe të luftës konsekuente dhe pa kompromis kundër tyre. Në veprat e tyre ata i kënduan heroizmit të masave, evokuan aktet burrërore të luftëtarëve të lirisë, të komunistëve dhe të partizanëve që ranë në fushën e betejës në përlëshje të pabarabartë me armiqtë. Kontribut me vlerë dhanë ata në stigmatizimin pa mëshirë të tradhtarëve, përfaqësuesve të klasave të vjetra sunduese dhe sidomos të organizatave tradhtarë të «Ballit Kombëtar» dhe të «Legalitetit», që bashkuan armët me pushtuesit e huaj për të zhdukur me zjarr dhe hekur luftën çlirimtare revolucionare të popullit shqiptar.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e nxori kështu letërsinë shqiptare nga gjendja e rëndë në të cilën ajo u ndodh pas 7 prillit 1939 e i dha një zhvillim të ri cilësor.

Djepi i letërsisë së re ishte shtypi ilegal i cili luajti rol të rëndësishëm për sqarimin dhe mobilizimin e masave në luftë kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm. Në gusht të vitit 1942 nisi të botohej «Zëri i popullit», organ i Partisë Komuniste Shqiptare, të cilin e drejtonte vetë shoku Enver Hoxha. Përveç artikujve publicistikë, që zinin vendin kryesor, në faqet e «Zërit të popullit» u botuan edhe shkri-me letrare, si vjersha, reportazhe etj. Një përkrahje të madhe formimit të letërsisë së re i dha sidomos «Kushtrimi i lirisë», i cili bëri një punë të madhe për nxitjen e autorëve të rinj, duke botuar veprat e tyre të para dhe duke i ndih-

muar ngandonjëherë edhe nga ana profesionale. Zhvillimit të letërsisë së re i ndihmoi edhe revista letrare «Liria», që doli në Shkodër me ndërprerje nga gushti 1943 e deri në tetor 1944. Shkrime letrare botuan në faqet e tyre edhe organet e tjera, si «Bashkimi», «Gruaja shqiptare», gazetat e xhepit dhe organet e tjera, që nxirrnin formacionet e ndryshme partizane.

1

Lëvizja çlirimtare kundër pushtuesve fashistë u dha shtytje të ndjeshme energjive të masave. Vulli krijues i popullit, i cili e kishte kuptuar se përfaqësonte forcën vendimtare të ndryshimeve që po përshkonin jetën e vendit, gjeti pasqyrim edhe në fushën e krijimtarisë letrare, e cila e bëri jetën e vet në faqet e organeve ilegale të luftës, në fletë të veçanta të daktilografuara ose mbeti dorëshkrim.

Ky prodhim letrar u shfaq që në hapat e para të qëndresës së organizuar dhe me zgjerimin e lëvizjes antifashiste popullore vjen e shtohet dhe merr një karakter masiv. Krijimet e pjesëmarrësve të luftës ishin kryesisht këngë dhe vjersha të shkurtra me temë nga ngjarjet e kohës. Autorët e tyre, partizanë ose të rinj antifashistë, shumica syresh me talent, bënë hapat e parë në fushën letrare. Në disa nga krijimet e këtyre autorëve ushtruan ndikim këngët revolucionare të kohës, si «Kënga e partizanëve të kuq», «Pararoja», «Fusha, ju fusha», «Flamur i kuq», «Përpara jetës» etj., të cilat, të përkthyer ose të përshtatura që më parë, u përhapën dhe u bënë të njohura në masat e gjera të rinisë, veçanërisht në periudhën e parë të luftës.

Në këngët dhe në vjershat e pjesëmarrësve të luftës shprehej hidhërimi për atdheun e robëruar, flitej për ndjekjet dhe poshtërimet që hiqnin njerëzit, për pakënaqësinë dhe urrejtjen e përgjithshme të popullit ndaj skllavërisë së huaj. Në të njëjtën kohë në to gjeti shprehje gatishmëria e tij për ta çliruar atdheun nga zgjedha e të huajit. Në një këngë theksohet vendosmëria për të luftuar deri në shporrjen e armikut: «Shqipëri, o mëma jonë; /Ne kurrë s'do durojmë/ Q'armiku i popullit tonë/ Për jetë këtu të sundojë». Shumë vjersha dhe këngë përfaqësojnë grishje të zjarrtë për luftë, ato u bënë thirrje shqiptarëve të ndershëm që të

mos rrinin duarkryq, por të rrokkin armët kundër pushtuesit fashist. Për këtë flasin edhe titujt e disave prej tyre: «Zëri i atdheut», «Nevoj'e mëmëdheut sot», «Çaste kushtrimi» etj. Në këngën «Kushtrimi» i bëhej thirrje popullit të ngrihej kundër pushtuesve fashistë:

*Para, o trima, mos rriini,
Koha po ik e s'qëndron,
ju sot fashizmit t'i bini,
nesër do t'jetë tepër vonë.
Dridhshëm dëgjohet buria,
në luftë të gjithëve na thërret,
në luftë për vdekje a për jetë.*

Në lëvizjen e përgjithshme popullore kundër fashizmit italian një rol të madh luajti rinia shqiptare, e cila u karakterizua nga një frymë e lartë patriotike dhe gatishmërie për sakrificë. Për luftën dhe veprat e të rinjve rrëfejnë shumë këngë të kohës: «O, të rinj dhe të reja», «Shoqes fshatare», «Shoqes», «Roja djaloshare» etj. Në to fashizmi cilësohet si armiku më i egër i rinisë. Rinia nuk e duroi skllavërinë e huaj, ajo ishte ndër të parat që iu përgjigj thirrjes për luftë, sepse, siç thuhet në emër të të gjithë të rinjve dhe të rejave të popullit, në një këngë të njohur të atyre viteve, «në paq'dhe në liri/ gjejm'shpëtimin tonë». Në disa këngë theksohet ideja se shpresa të mëdha në revolucionin popullor kishte vënë femra shqiptare si pjesa më e shtypur dhe e privuar nga të drejtat që i përkisnin: «Neve qemë si bagëtia, / Çdo liri na qe grabitë, / Ashtu donte tirania, / Të na lente ne pa dritë, / Po edhe drita ja agoi / Dhe do të mbetet përgjithmonë».

Në mënyrë të gjerë në krijimet poetike të masave u pasqyrua lufta për çlirim. Në shumicën e tyre spikat ideja e karakterit të gjerë popullor të lëvizjes, e cila përshkruhet si lumë i papërmbajtur që zbrët të fshijë të gjithë armiqtë. Me gëzim të madh flitet për zgjerimin e radhëve të lëvizjes popullore antifashiste dhe për shtimin e numrit të partizanëve, që godasin me guxim forcat e armikut («Shqipja jonë mori malet», «Kah na erdhën këta partizanë», «Marsh partizan», «Ani vishma djalino»). Shumë këngë me figura dhe imtësi prekëse artistike lartësojnë aktet heroike të dëshmo-

rëve të luftës. Sakrificës supreme të luftëtarëve të lirisë i këndohet me nota trishtimi burrëror, por nuk është kjo nota sunduese. Në këngët kushtuar dëshmorëve fryma elegjiake ia lë vendin besimit të patundur në fitoren mbi armiqtë dhe, lidhur me këtë, pothuajse të gjitha kanë si motiv përmbyllës sigurinë se amaneti për të cilin dhanë jetën dëshmorët, do të realizohet. Një pjesë e këtyre këngëve, si «Dalngadalë po vjen behari», «Shokut Qemal Stafa», «Dëshmorët e Piskupatit» etj. hyjnë në fondin e letërsisë revolucionare të kësaj periudhe.

Krijimtaria poetike e masave kishte po ato veçori që karakterizuan të gjithë letërsinë e luftës: mohimin e gjithçkaje të vjetër që kishte çuar në skllavërimin e vendit dhe aspiratën për një të ardhme më të mirë për masat popullore. Por si jehonë e drejtpërdrejtë e ndjenjave dhe e dëshirave të vegjëlisë, kjo krijimtari e shprehu këtë synim të përgjithshëm të popullit në mënyrë më të hapur. Me këtë shpjegohet fakti që shumë vjersha dhe këngë flisnin për jetën e re që do të lulëzonte pas Çlirimit, kur pas shporrjes së pushtuesve të huaj do të përmbushej dëshira e masave për drejtësi shoqërore. Në një vjershë të gjatë anonime bota e vjetër e shtypjes dhe e mjerimit paraqitet në figurën e kullës, e cila përfytyrohet si simbol i së kaluarës së urryer. Duke iu përgjigjur armiqve që shpifnin për komunistët dhe i cilësonin si «anarkistë», autori i panjohur thotë se shoqëria e vjetër do të zhduket jo se «neve rrëmuja na pëlqen, po sepse duam që vuajtja dhe mjerimi të mos sundojnë përmbi dhe».

Një përhapje të mirë patën edhe krijimet demaskuese satirike. Pjesëmarrësit e luftës shkruan një varg këngësh satirike kundër forcave tradhtare, veçanërisht kundër «Ballit Kombëtar» dhe «Legalitetit» («Kënga e Ballit», «Abaz aga don me ardhë» etj.). Këto këngë që ishin shumë popullore vinin në lojë orvatjet e armiqve për të penguar lëvizjen popullore dhe stigmatizonin veprën e tyre tradhtare.

Temat dhe idetë karakteristike të krijimeve poetike të masave i gjejmë më të plota në veprën e Memo Metos (1911-1944), i cili është një nga përfaqësuesit më të shquar të këtij prodhimi artistik. M. Metoja la një tok vjershash dhe këngësh, në të cilat u shprehën në një formë origjinale aspiratat për drejtësi shoqërore të masave popullore në luf-

tën e tyre kundër pushtuesve fashistë dhe klasave shfrytëzuese që bashkëpunonin me ta.

Me forcë të veçantë në krijimet e M. Metos kumbon motivi i luftës kundër fashizmit italian dhe bashkëpunëtorëve të tij. Liria e humbur nuk dhurohet, ajo fitohet me luftë dhe përpjekje, prandaj thotë poeti duhet të përgatitemi për sakrificë dhe humbje të hidhura që duhen përballuar me guxim dhe heroizëm. Lotët nuk sjellin veç dëm, sepse ulin vrullin e luftës dhe pakësojnë vendosmërinë e njerëzve për luftë. Kjo është ideja e poezisë «U hap lajmi, ulërima» e cila mbyllet me vargje që tingëllojnë si grishje e zjarrtë për luftë:

*Le të hidhemi në luftë
djalë e plak,
se liria i ka rrënjët
veç në gjak¹.*

Në vjershën «Do dal malit» autori tregoi entuziazmin patriotik që kishte pushtuar rininë shqiptare. Dashuria e zjarrtë për atdheun, gadishmëria për të rrokur pushkën e për t'u bashkuar me shokët partizanë, dëshira për vepra heroike — këto janë veçoritë që shquajnë heroinën, në karakterin e së cilës Metoja dha vajzën shqiptare të kohës.

*Jam një vajzë shqipëtare,
vajzë mali
e kam forcën, e kam zëmrën
si të djalit.*

*Do marr trastën plot me bomba
me fyshek,
do t'i bëj prita armikut
në çdo shtek².*

Në vjershat dhe në këngët e M. Metos Lufta Nacionalçlirimtare shikohet si luftë që punëtorët dhe fshatarët bëjnë jo vetëm kundër fashizmit italian, por dhe kundër borgje-

zisë e bejlerëve, si klasa që kishin tradhtuar interesat e kombit dhe kishin shitur vendin të huaji. Janë ata, thotë poeti, që i pinë gjakun vegjëlisë, duke e detyruar të kërruste shpinën gjithë ditën në punë. Vjersha «Ne po vuajmë e po heqim» mbaron me thirrjen drejtuar punëtorëve dhe fshatarëve të bashkohen, sepse kanë po një armik. Aspirata e masave popullore për drejtësi shoqërore që ata besonin ta realizonin me luftën kundër fashizmit, u shpreh në mënyrë më të hapur në vjershën «Për liri». Shqipëria e pasqirimit, sipas mendimit të poetit, duhet të jetë një Shqipëri e re, pa shtypje e shfrytëzim, ku njerëzit të rrojnë të lirë dhe të lumtur; ajo duhet të jetë një Shqipëri ku të mos ketë as fashistë, as trathtarë dhe as «padronë».

Në më të shumtën e këngëve të tij M. Meto u nis nga folklori, duke marrë mjetet stilistike dhe fjalorin poetik të këngëve popullore. Përkrah me këtë, ai u ndikua në një shkallë të mirë edhe nga letërsia e kultivuar, gjurmët e së cilës i gjejmë në mjaft këngë. Aty-këtu gjejmë në krijimtarinë e tij figura, shprehje e motive të këngëve revolucionare që ishin popullore në atë kohë.

Poet tjetër, krijimtaria e të cilit u zhvillua në kapërcyell të folklorit dhe të letërsisë është Shefqet Peçi. Shumicën e vjershave dhe të këngëve të këtij autori e përshkon patosi i luftës për liri («Mesaplik, luginë e fortë», «Mallakstra brigje-brigje», «U ngreva dhe dola»). Në to i këndohet patriotizmit dhe shpirtit luftarak të popullit; rrëfehët për ndeshje konkrete të partizanëve me forcat e armikut.

*Mallakstra tym e flakë
në beteja në stuhi,
u derdh gjaku mu si lumë,
se lufton për Shqipëri.¹*

Në krijimet e Sh. Peçit takojmë edhe motive elegjiake. Me ndjenjë krenarie poeti u drejtohet dëshmorëve, shokëve të tij të luftës, kujton veprat heroike të të rënëve, shpreh hidhërimin për vdekjen e tyre, por në të njëjtën kohë i siguron, se «tradhtarët do t'na japin llogari» («Memo Metos»).

1) Sh. Peçi, *Shqipëri vend i bekuar*, Tiranë 1964, f. 47.

1) M. Meto, *Këngë për liri*, Tiranë 1955, f. 31.
2) Po aty, f. 37-38.

Letërsia e re e mori lëndën nga realiteti i ri, nga lufta e masave popullore për çlirimin kombëtar dhe shoqëror. Iniciatorët e saj, si ata që kishin hyrë në jetën letrare në mesin dhe viteve 30, Sh. Musaraj, A. Çaçi, Dh. S. Shuteriqi, ashtu dhe një varg letrarësh të rinj, që nisën të bëjnë emër në këto vite si F. Gjata, Ll. Siliqi, K. Jakova, Z. Sako, V. Bala, A. Banushi etj., ishin pjesëmarrës aktivë të lëvizjes çlirimtare popullore. Duke kryer detyra si punëtorë partie, propagandistë apo redaktorë të botimeve ilegale, ose duke milituar në radhët partizane, ata patën mundësi të njihnin nga afër dukuritë e reja që po lindnin në jetë: frymën heroike të pjesëmarrësve të lëvizjes, të komunistëve, të të rinjve dhe të të rejave, aktet e guximshme të partizaneve dhe partizanëve trima, vetëdijen e tyre të lartë politike.

Lëndën e re shkruarët e trajtuan në format dhe llojet që lejonin rrethanat e veçanta në të cilat ata krijuan. Poezia, si lloji më operativ, zuri në këtë letërsi kryet e vendit; kërkesat që paraqiste jeta u dhanë nxitje gjinive të shkurtra poetike, si vjershës, këngës, fejonit në vargje dhe këngës satirike. Proza artistike njohu në ato vite një zhvillim të pakët; u lërua skica, reportazhi dhe tregimi i shkurtër. Pati përpjekje për të punuar llojet dramatike, u shkrua ndonjë dramë («Margarita Tutulani» e A. Çaçit), disa skeçe satirike, ku viheshin në lojë armiqtë («Federali» i Z. Sakos etj.).

EPOPEJA E BALLIT KOMBËTAR

Një nga veprat më të shquara të letërsisë së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare është «Epopeja e Ballit Kombëtar» e Sh. Musarajt. Kjo vepër u botua ilegalisht në pranverë të vitit 1944. Për nga problematika, mprehtësia satiriko-publicistike dhe mjetet e shprehjes artistike, vepra ka afri të madhe me shkrimet publicistike të kësaj kohe, të vetë autorit, sidomos me pamfletin «Dje dhe sot». Ashtu si në këtë vepër, edhe në «Epopenë e Ballit Kombëtar», siç e tregon titulli, Musaraj i vuri vetes si detyrë t'i hiqte cipën demagogjisë së ballistëve, të zbulonte pas frazeologjisë pseudopatriotike qëllimet e vërteta që kërkonte të arrinte «Balli Kombëtar». Vepra përfshin një

sërë episodesh nga veprimtaria antipatriotike e ballistëve, të cilat kanë si funksion të ilustrojnë sa më mirë idenë e autorit. Të gjithë këto i japin veprës së Musarajt tiparet e një pamfleti poetik.

«Balli Kombëtar» tregohet në vepër si një organizatë që s'ka asgjë të përbashkët me pjesën më të shëndoshë të popullit shqiptar që luftonte për çlirimin e vendit nga pushtuesit fashistë. Përkundrazi, ai u krijua për të sabotuar këtë luftë, duke përçarë popullin dhe duke ngjallur mosbesim ndaj qëndresës kundër fashistëve italianë. Për këtë qëllim ballistët marrin kontakt me autoritetet pushtuese fashiste me të cilët arrijnë të përfundojnë edhe një protokoll bashkëpunimi. Përkundër kësaj gjendjeje në të cilën u ndodhën ballistët pas rënies së Musolinit dhe kur Italia ishte në prak të kapitullimit, është plot komizëm të natyrshëm. Autori ka mundur të japë me një satirë të goditur konfuzionin që ka kapur ballistët. Të alarmuar nga rrokullisja e papritur e ngjarjeve, krerët e «Ballit» turren të shpëtojnë prej katastrofës që u kanosej si bashkëpunëtorë të pushtuesve fashistë, duke marrë poza prej patrioti, duke u shtirë sikur u dhimbsej Shqipëria. Efekti satirik në vepër krijohet nga kontrasti midis fjalëve zhurmëmëdha të ballistëve dhe bëmave të tyre. Pikërisht ata njerëz, që s'kishin hedhur asnjë pushkë kundër të huajit, dhe që deri dje ishin në kompromis dhe bashkëpunonin me të, na shfaqen tani, që po gremisej fashizmi, sikur të paskeshin qenë kundërshtarë të tij dhe të persekutuar prej tij:

Flet Ali' beu:

— «Luftë për atdhe!
se sot atdheu
pret shumë nga ne.¹

*Na zjen ndër deje
gjak shqipëtar
s'durojmë kurrë
zgjedhë barbari...»²*

Për të penguar fitoren e popullit dhe për të rrëmbyer pushtetin, ballistët vrapojnë të dalin në mal, por edhe në

¹ Sh. Musaraj, *Epopeja e Ballit Kombëtar*, Tiranë 1948, f. 14.
² Po aty, f. 15.

këtë çast ata vetëm bërtasin «luftë për atdhe», dhe s'bëjnë tjetër veçse shtrohen në gosti e ngrënë dolli. Autori parodizon fjalët dhe veprat e krerëve të «Ballit»; pompoziteti dhe enfaza që përdorin për të maskuar veprimet e tyre tradhtarë bien në kundërshtim me faktet e jetës, çka i bën qesharakë këta njerëz që orvaten ta paraqesin veten si të caktuar nga historia për të shpëtuar Shqipërinë.

Nëpërmjet fjalëve të ballistëve të cilët ndonjëherë vlerësojnë saktë veprimet e tyre ose nëpërmjet pasazheve ku tregohet historia e bashkëpunimit të tyre me nazistët, autori zbulon thelbin antikombëtar të kësaj organizate. Kur populli ua prishi planet, krerët e «Ballit» i kapi tërbimi dhe u treguan të gatshëm madje jo vetëm t'ua dorëzojnë Shqipërinë të huajve, por edhe ta mbysin në gjak e ta kthejnë në gërmadhë, veç populli të mos fitonte. Fjalët e kreut të ballistëve, Lumo Skëndos, thënë në një çast dëshpërimi të madh, janë një rrëfim i hapur i qëllimeve që ndiqnin në të vërtetë ballistët në veprimtarinë e tyre:

*Desh bërë Shqipëria
det e tërmet
që t'vin në mende
ky djall milet.¹*

Kontrasti satirik, mjeti artistik i preferuar i autorit, është përdorur me mjeshtëri. Në këtë plan shtillet e gjithë historia e «Ballit Kombëtar», i cili në fillim doli me pretendimin qesharak të lozte rol shpëtimtar në fatet e Shqipërisë, por mbaroi, si gjithë organizatat e tjera tradhtarë, në prehër të pushtuesit hitlerian. Ky ishte fundi i logjikshëm dhe këtë ide Musaraj arrin ta zhvillojë me paraqitjen satirike të diskreditimit të plotë të ballistëve. Gjatë pushtimit nazist, të përçafuar me zogistët, me xhandarët dhe me reaksionarët më të tërbuar të vendit, ballistët thurnin plane të reja për të mposhtur popullin. Një fushatë e madhe shpifjesh të ulëta shpërtheu kundër Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Kori i tradhtarëve me ballistët në krye njëzëri mallkonte, shante e kërcënonte të gjithë ata që ishin kundër

pushtuesit gjerman; pjesëtarët e lëvizjes cilësohen «tradhtarë» dhe lufta e partizanëve si shkatërrimtare për Shqipërinë. E gjithë kjo propagandë përcillet nga ballistët me zhurmë të madhe për ta nxjerrë veten si «shpëtimtarë», «patriotë të vërtetë», që u qan zemra për «bashkim» e «atdhe».

Për autorin «Balli Kombëtar» ishte jo vetëm organizatë antikombëtare dhe antipopullore, por edhe një forcë politike e paaftë për të luajtur ndonjë rol sadopak të rëndësishëm në jetën e vendit. Në vepër ka gjetur shprehje ideja e nulitetit politik dhe moral të kësaj organizate, krerët e së cilës dinin vetëm të mburrëshin për merita që s'i kishin dhe të mbanin fjalime pompoze për heroizma që nuk i kryen. Ballistët, si njerëz pa merita, përshkruhen mjaft gjallë veçanërisht në skenën e fundit kur shohin se planet e tyre u përmbysën dhe Shqipëria po çlirohej nga zgjedha e huaj. Në këtë pjesë, plot imtësi të goditura satirike jepet nervozizmi dhe tmëri që i ka pushtuar ballistët përballë forcës së pathyeshme të partizanëve, zbulohet qartë se ç'përfaqësonin këta nga pikëpamja morale. Ata i kap paniku sepse shihnin se afronte ora e shpagimit për krimet e tyre. Përpëlitjet e ballistëve janë për shkrimtarin të hequrit shpirt të atyre forcave shoqërore që e polli këtë organizatë; me «Ballin Kombëtar» Musaraj damkosi si tradhtarë bejlerët, tregtarët e pasur, nëpunësit e lartë dhe intelektualët anti-patriotë.

Në stigmatizimin e «Ballit Kombëtar» dhe të krerëve të tij autori përveç mjetit të vetëdemaskimit, të cilin e përdor shpesh (përmendim rastin kur Lumo Skëndoja vetë nxjerr në shesh qëllimet e vërteta dhe taktikën e gabuar të ballistëve, të cilët vepruan si në «*vaft kadilerësh*», kur u përpoqën të mbahen patriotë në sytë e njerëzve, duke bashkëpunuar në të njëjtën kohë me pushtuesit e huaj), shfrytëzon edhe forma të tjera satirike. Vënia në gojë të ballistëve pranë fjalëve të larta, sublime, si atdheu, Shqipëria, liria etj. të fjalëve fare të zakonshme, që thonë gjëra të vogla e madje banale, është një mjet që i jep dorë shkrimtarit të zbulojë me forcë falsitetin e asaj që deklarojnë ballistët. Kështu p.sh. ballistët mbajnë fjalime patriotike duke pirë raki me meze: «*Pa nis dollia, / theren kurbanët, / vardha rakia, / posht'italianët*», «*Pije me fund, / të kam ri-*

1) Po aty, f. 28.

xha, /shëndet i flamurit,/ s'i thon'shaka». Po kështu Mithat Frashëri flet për shkatërrimet që ka pësuar Shqipëria nga fashistët dhe ka parasysh rastin e mbylljes vetëm një herë të dyqanit të tij nga kuestura italiane. Në vizatimin e ballistëve, shihet syri i mprehtë i poetit, i cili ka ditur të gjejë imtësi satirike demaskuese. Kështu ballistët i paraqet të dalin në mal duke marrë me vete pizhama dhe duke pasur në vend të armëve «gota dhe enë». Shpesh ballistëve autori u vë në gojë orientalizma, që ndihmojnë të dalë në pah me qartësi më të madhe fizionomia e tyre shoqërore e politike, si njerëz të rritur në ambiente bejlerësh ku sundon kultura dhe shija anadollake (vaft kadilerësh, nefëz, bej, devlet, yryç).

Ballistëve dhe forcave të tjera tradhtarë shkrimtari u kundërvë popullin, që është zgjuar dhe i kupton qëllimet dhe planet e armiqve. Dajë Ceni me fjalët e tij shpreh në mënyrë simbolike zgjimin e popullit, i cili në zjarrin e luftës u bë i vetëdijshëm për interesat e veta dhe fitoi pjekuri politike sa të shquante fytyrën e vërtetë të ballistëve, të cilët i quan me përbuzje «buallica».

Për t'i dhënë veprës një frymë sa më demaskuese, autori ndërhyr në shtjellimin e episodeve duke dhënë gjykimin e tij mbi çka rrëfen.

«Epopëja e Ballit Kombëtar» është shkruar nën ndikimin e satirës popullore, e cila ka gjetur pasqyrim në figurat e veçanta dhe në përgjithësi në vetë mënyrën e të tallurit të krerëve të «Ballit». Karakterin popullor veprës ia japin sidomos proverbat dhe shprehjet me ngjyresë satirike të marra nga folklori ose nga ligjërimi i njerëzve të thjeshtë: «u ranë pendët», «kur u pjell viçi pse të mos venë», «varur buzët si strehë hauri», «i ranë potkonjtë, «i u nxi balli si fund kusie», etj.

Gjuha është e thjeshtë, stili i natyrshëm dhe plot gjallëri. Vargu, pesërrokësh popullor, i ka shtuar gjithashtu vepër karakterin e zhdërvjellët.

Sapo u botua si fletë volante në një shtypshkronjë ilegale, vepra u përhap me shpejtësi dhe u bë mjaft e njohur në rininë antifashiste dhe në radhët partizane. E thurur si alternativë i fjalimeve të krerëve të Ballit, të rrëfimit të autorit dhe të ndërhyrjeve të Dajë Cenit, ajo mësohej lehtë

përmendësh dhe ndonjëherë u luajt si pjesë teatrale. Në frymën e saj u shkruan një varg imitimesh nga pjesëmarrës të luftës.

«Epopëja e Ballit Kombëtar» u botua vetëm pjesërisht; pas Çlirimit autori i shtoi veprës dhjetëra vargje, të cilat nuk kishte arritur asokohe t'i përfundonte.

* * *

Një pjesë e forcave të reja që erdhën në letërsi në këto vite si F. Gjata dhe K. Jakova etj., bënë emër me këngët e tyre revolucionare, ku gjeti pasqyrim fryma heroike e kohës, patriotizmi dhe shpirti i sakrificës të popullit.

Forca dhe bukuria e këngëve të F. Gjatës qëndronte në pasqyrimin e atmosferës romantike që kishte përfshirë vendin në vitet e luftës, në shprehjen e entuziazmit me të cilin populli luftonte për çlirimin e vet. Në «Kushtrimi» (1942) jepet pamja e hovit patriotik që kishte rrëmbyer njerëzit («*la parmendën sot fshatari, s'mbeti burrë në shtëpi*»), vrulli i tyre në përlëshje me armiqtë («*turren gjithë si rrufeja, /mbi armik e mbi barbar*»). Atmosfera luftarake e atyre viteve u shpreh edhe në këngën «Ato maja rripa-rripa», shkruar një vit më vonë, më 1943, kur lëvizja popullore ishte kthyer në një rrymë të papërmbajtur dhe po fshinte nga dheu skllayërinë e huaj.

Në themel të këngës «Kudo malet buçasin» është aspirata e flaktë për të ardhmen e bukur dhe siguria në ngadhënjimin e saj të shpejtë:

*S'ka më pranga mizore
për popullin shqiptar!
Do vijë dita jonë
me paqe dhe liri,
të lumtur do të jetojnë
fshatar' e puntori.¹*

Shumica e këngëve të F. Gjatës flasin për luftën e rinisë antifashiste, për aspiratat dhe idealet e saj. Në «Këngën

1) F. Gjata, **Këngët e maleve**, Tiranë 1954, f. 29.

e rinisë» autori u drejtohej moshatarëve të tij, të rinjve dhe të rejave, me thirrje që të rroknin armët kundër të huajit, sepse vetëm me luftë sigurohej e ardhmja e bukur:

*Rini, rini, ti djeg si zjarr,
armiqtë kalli ti në varr.
Me gjak të ardhmen mbro rini,
e ardhmja është lumturi!¹*

Në këngën «Plaku dhe i riu» poeti dha në formë të përgjithësuar vetitë karakteristike të të rinjve, që iu përgjigjën menjëherë thirrjes së atdheut. Në këtë vjershë F. Gjata shfrytëzoi motivin e uratës që plaku, si përfaqësues i brezit të vjetër që i kishte dalë dikur zot vendit përballë sulmit të huaj, i jep brezit të ri për luftë, motiv ky i njohur në letërsinë e Rilindjes Kombëtare. Thirrjes së plakut për të marrë pushkën dhe për të dalë partizan, i riu i përgjigjet plot gatishmëri:

*... — Do të shkoj,
do të shkoj e do të luftoj
atje tej në mal e shteg.
Me një gunë, me dyfeg²*

Këngët e F. Gjatës shquhen nga notat patetike, grishjet dhe apostrofat e zjarra, leksiku solemn, që krijon një gjendje shpirtërore entuziaste, notat prej marshi.

«Kënga e tre heronjve» e K. Jakovës ishte ndër veprat më të njohura në vitet e luftës. Ajo fitoi popullaritet jo vetëm se i bëri jehonë qëndrimit burror të tre komunistëve të njohur, akti i të cilëve u mësua shpejt në të gjithë vendin, duke ngjallur kudo ndjenja admirimi dhe krenarie, por edhe me frymën e saj epiko-heroike. Këngën e përshkon tejndanë ndjenja e krenarisë për heroizmin e parrëfyer të shokëve, që përshkruhen si njerës me karakter të fortë dhe trima të papërkulur. Devotshmëria e lartë ndaj idealit, guximi dhe urrejtja e thellë për armikun — këto tipare karakteristike të heronjve dalin në pah në fjalët që thonë në çastin

2) Po aty f. 22.
3) Po aty, f. 24.

e fundit. Me frymën e paepur dhe me përbuzjen krenare për vdekjen ata u gjasojnë personazheve të rapsodive, të dhënë me viza madhështore si në lapidar.

*Çka po thot' Kadija:
— Flak' le t'kallet shpija
t'a marr vesh Shqipnija
se na i dalim zot.
Çka po thot' Perlati:
— Burra bahi gati,
se ka ardh' sahati,
t'hujt me i dhan' barot.»¹*

Vrulli patriotik i rinisë ka gjetur pasqyrim në këngën «Shqiponja partizane» të po këtij autori, e cila është shkruar në kadencën e marshit.

Në ato vite lindën shumë këngë kushtuar dëshmorëve që ranë në demonstrata ose në luftë me armë në dorë kundër armiqve («Kënga e Asim Zenelit» e Q. Buxhelit, «Mine Pezës» e B. Levonjës dhe shumë këngë të tjera, autorët e të cilave ishin pjesëmarrës të luftës ose kuadro drejtuese në terren ose në ushtri). Përveç lartësimit të aktit heroik të dëshmorëve, veçori e përbashkët e këtyre këngëve është se zakonisht përfundojnë me shprehjen e vendosmërisë për të marrë hakun e shokëve të rënë.

Me zgjerimin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe me krijimin e formacioneve të mëdha luftarake, të brigadave dhe të divizioneve, lindën marshet dhe himnet partizane («Marshi i Brigadës I Sulmuese» shkruar prej komandantit të saj, shokut Mehmet Shehu, «Marshi i Divizionit I Sulmuese» dhe «Marshi i Korparmatës I» të Sh. Musarajt, «Himni i Ushtrisë Nacionalçlirimtare» i A. Varfit etj.). Në marshet dhe himnet partizane u shpreh gëzimi i popullit për krijimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e cila thirret «shpresë e madhe» që «shkrin hekur mbi armiq» dhe «i jep popullit liri». Në «Marshin e Brigadës I Sulmuese» u shpreh ideja se ushtria partizane është ushtria e popullit, është arma që do të çlirojë klasat e shtypura nga zgjedha

1) K. Jakova, Heronjt e Vigut dhe vjersha e këngë të tjera, Tiranë 1953, f. 47.

shoqërore. Këtu gjejmë një nga tiparet e reja ideore të letërsisë së Luftës Nacionalçlirimtare:

*Për fshatar', për puntor,
kemi armët në dorë
gjak do të derdhet mbi dhe sa t'i çlirojmë.*

Marshet dhe himnet partizane shquhen nga fryma luftarake, intonacionet burrërore dhe ritmet energjike.

Krahas këngëve, marsheve dhe himneve revolucionare në letërsinë e luftës, sado më pak, u lërua edhe vjersha e shkurtër, zakonisht me karakter liriko-epik.

Në vitet e qëndresës popullore antifashiste A. Çaçi shkroi vjersha dhe këngë, të mbushura me atmosferën romantike të periudhës së luftës, si «Syri i nënës», «Po duket majë malit», «Lumi i popullit», «Përpara në luftë», «Më këmbë janë ngritur» etj.

Në vjershën «Syri i nënës» poeti vizatoi figurën e përgjithësuar romantike të nënës shqiptare, e cila sakrifikoi gjënë më të dashur për çlirimin e popullit. Kur u vra djali i vetëm, ajo e fshehu thellë në gjë dhimbjen dhe trokiti derë më derë, duke grishur njerëzit në luftë kundër të huajit:

*«një sy që pata nuk e kam,
ai m'u shua si një re
e pash' që shkoi si rufe,
tani kam bij' e bija shumë,
një popull ngjeshur me liri»¹*

Entuziazmi patriotik i masave, i cili vinte duke u rritur dita-ditës, ka gjetur pasqyrim në krijimet «U lag me gjak» dhe «Lumi i popullit». Në vjershën agjitative «U lag me gjak» poeti jep guximin e masave në ndeshjen me armiqtë:

*Kudo dëgjohet zëri i lirisë,
populli i zbatuar, i çveshur dhe i vrarë,
hidhet i tëri mu në zjarr i pari,
gjakun e bijvet trima për të marrë»²*

1) A. Çaçi, **Klithmat e dheut**, Tiranë 1945 (dorëshkrim).
2) Po aty.

Të tjera nota mbisundojnë në vjershat kushtuar dëshmorëve «Ngrehu, o Margaritë», «Kujtimit të martirit komunist Ali Demi». Poeti shprehu këtu dhembjen për humbjen e shokëve dhe bindjen se flija e tyre nuk do të shkojë kot, vendin e tyre e zunë luftëtarë të rinj, që ndjekin me guxim rrugën e shokëve të rënë.

Në vjershat e tij të para, Ll. Siliqi i këndon me nota entuziaste patriotizmit dhe vullnetit të pathyeshëm të popullit shqiptar, i cili, me gjithë terrorin e egër, nuk iu shtrua zgjedhës së huaj. Mizoritë e fashizmit barbar e forcuan edhe më tepër dashurinë e tij për jetë të lirë e të pavarur. Kjo frymë e paepur e mbush poetin me një ndjenjë krenarie, e cila është shprehur përmes figurave patetike («Pezës»). Në vjershën «S'flen ma Shqipnia» autori shpërthen në vargje patetike:

*na vranë e varën bijt e ndër mjerime
u mbyt dhe po shkretnohet Shqipnija.*

*Por s'flen ajo! Në kamb' sot populli mbarë
me zjarr të zemrës djeg edhe qëllon
zaptuesin aq mizuer, t'shitun, tradhtarë, —
robnin kurr s'ka durue, as nuk duron!*

Krenaria për frymën heroike të komunistëve është shprehur edhe në vjershën «Heroit Vojo Kushi». Qëndresa burrërore e Vojo Kushit dhe e shokëve të tij, të rrethuar nga qindra armiq të shoqëruar edhe me tanke, vizatohet me ngjyra heroiko-legjendare. Heronjtë e rrethuar cilësohen «fatosa», Vojoja krahasohet me «luanin që nuk lidhet», kurse shtëpia thirret «kala».

Vjershat «Brankos», «Xhavitit» dhe «Gjikës» e çojnë lexuesin në sferën e vuajtjeve subjektive të poetit, i cili kujton, i helmuar, shokët e vet të ngushtë, që ranë në luftë. Ata ishin njerëz me dhunti të çmuara, me shpirt dhe synime fisnike, që do t'i jepnin shumë këtij vendi e këtij populli, por jeta e tyre e re u këput në çastin kur forcat shpirt-

1) Ll. Siliqi, **Rruga e lumturisë, Vjersha** 1950, f. 20.

tërore po shpërthenin me hov. Kujtimi i shokëve të rënë e mbush poetin me hidhërim të madh.

Në këto vite vjersha me temë nga veprat heroike të luftëtarëve të lirisë shkruan edhe Dh. S. Shuteriqi. Poema «O Ptoleme» (1944) është një klithmë e thekshme për humbjen e shokut të afërm, me të cilin autorin e lidhin jo vetëm të njëjtat qëllime në jetë, po edhe kujtimet e viteve të fëminisë e më vonë shoqëria e ngushtë. Poema është ngritur si një antitezë e shtjelltë në mes të pjesëmarrësve të Lëvizjes Nacionalçlirimtare, që i karakterizojnë synimet fisnike, dhe i ballistëve, zogistëve e gjithë pseudopatriotëve, të zhytur në lumën e tradhtisë e të imoralitetit shoqëror e politik. Dëshpërimi i madh i poetit për shokun e humbur, dëshpërim që s'ka të qetësuar, është shfaqur me anë aludimesh herë-herë të paqarta dhe asociacionesh të largëta që e vështirësojnë kuptimin e idesë poetike.

Në poemën «Lufta» Dh. S. Shuteriqi paraqiste kasaphanën imperialiste me figura groteske. Klasat sunduese që shkaktuan luftën, i duken autorit si «korba t'zez» që rrijnë «mbi stërvina». Po kjo luftë s'ka për t'u dalë mbarë se ja krisi edhe «lufta jonë», «lufta e popullit zot» kundër shtypësve gjakatarë.

* * *

Vend të rëndësishëm në prozën e luftës zë publicistika, zhvillimi i së cilës u përcaktua nga nevojat e ngutshme të organizimit të qëndresës kundër fashizmit. Për të ngritur masat në luftë për çlirimin e vendit duhej shkatërruar propaganda djallëzore e armikut, duhej zbuluar fytyra e vërtetë e fashizmit, synimet e tij skllavëruese në Shqipëri. Krahas kësaj, masave u duhej krijuar besimi në forcat e tyre, ato duhej të bindeshin se rruga e shpëtimit të atdheut ishte rruga e luftës së vendosur dhe pa kompromis kundër fashizmit italian dhe veglave të tij. Publicistika vuri të gjitha forcat për zgjidhjen e këtyre detyrave; ajo mbushi popullin me besim në fitore, edukoi njerëzit me urrejtjen ndaj armikut dhe me gatishmëri për sakrifica.

Gjinitë e publicistikës që morën më shumë përhapje në vitet e luftës, qenë artikulli publicistik, pamfleti dhe skica. Për të parin ishin karakteristike arsyetimet e autorit, analiza dhe vlerësimi i hapur i ngjarjeve dhe i fakteve politike. Pamfleti u shqua për larmi në përdorimin e mjeteve artistike; në të një rol të madh luanin më shumë përshkrimet artistike. Saktësia në pasqyrimin e fakteve, imtësitë konkrete, synimi për të dhënë atë që ishte kryesore në jetë, vizatimi i shpejtë i njerëzve të popullit dhe i luftëtarëve të lirisë, — këto janë disa nga veçoritë e skicave të periudhës së luftës.

Në lëmin e publicistikës u dallua veçanërisht udhëheqësi i Partisë dhe i luftës shoku Enver Hoxha; shkrimet e tij vunë themelet e publicistikës revolucionare, që lindi në zjarrin e luftës çlirimtare kundër pushtuesve fashistë. Në shkrimet e shokut Enver Hoxha iu dha përgjigje problemeve të mprehta e të ndërlikuara që iu paraqitën popullit shqiptar në një nga çastet më të rëndësishme të historisë së tij; ato shprehën interesat e aspiratat e masave për një jetë të lirë dhe të lumtur. Fryma e lartë patriotike dhe revolucionare, mbrojtja e pasionuar dhe konsekuente e intereseve të masave, qëndrimi i patundur parimor ndaj të gjithë armiqve të atdheut dhe të popullit, qartësia dhe argumentimi i shëndoshë i çështjeve, stili i gjallë dhe energjik, gjuha e kuptueshme janë veçoritë kryesore dalluese të publicistikës të periudhës së luftës të shokut Enver Hoxha.

Vend qendror në shkrimet publicistike të shokut Enver Hoxha zuri lufta kundër pushtimit fashist dhe tradhtarëve. Populli shqiptar i kishte pritur me pushkë ushtritë pushtuese fashiste dhe pas 7 prillit 1939 e vazhdoi qëndresën e tij kundër skllavërisë së huaj. Por interesat e atdheut dhe të vetë masave popullore kërkonin që kjo qëndresë të rritej dhe të forcohej më tej e të kthehej në një lëvizje të gjerë, të vetëdijshme dhe të organizuar. Për të mobilizuar dhe për të organizuar masat e gjera në luftën për çlirim, duhej zhvilluar një punë e madhe për edukimin dhe sqarimin e tyre politik. Për këtë duhej të demaskoheshin plotësisht demagogjia e shtypit fashist dhe parullat kapitulluese të elementëve reaksionarë. Duke iu referuar fakteve të shumta të viteve të para të pushtimit, autori tregoi se fa-

shizmi si «regjim i hajdutëve dhe i gangsterëve» i solli të këqija dhe mjerime të reja popullit shqiptar, mbi kurriz të të cilit, përveç zgjedhës së klasave shfrytëzuese vendase, kishte nisur të rëndonte edhe zgjedha e kapitalistëve italianë. Shoku Enver Hoxha zbuloi planet kriminale të pushtuesve të huaj për kolonizimin e Shqipërisë, tregoi se si jerarkët fashistë, në bashkëpunim me tradhtarët dhe spekulorët e mëdhenj vendas, duke organizuar shoqëri aksionare, u turrën si «banda e Al Kapones» për të grabitur me egërsi dhe në shkallë të gjerë pasuritë e vendit, djersën dhe mundin e bujkut shqiptar duke e shtyrë atë në varfëri gjithnjë e më të madhe («Krijimi i Shoqërisë Anonime Bujqësore», «Shoqëria SASTEB — kusëri kolosale e organizuar nga Merlika e fashizmi për të rrëmbyr kafshatën e gojës të fakir-fukasës»). Populli shqiptar, theksonte autori, e ka kuptuar se pas 7 prillit 1939 u vu në lojë fati i tij, e ardhmja e tij. Fashizmi italian kishte si qëllim t'u rëmbente tokën shqiptarëve, t'i kthente ata në skllëvër, «raja», dhe pastaj t'u përgatiste varrin dhe t'i zhdukte si komb. Rruga e vetme për të shpëtuar prej kësaj gjendjeje ishte lufta me armë në dorë kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve. «Liria nuk dhurohet, por fitohet», kjo ide përshton si lajtmotiv shumë artikuj publicistikë, në të cilët theksohet vazhdimisht e në mënyrë këmbëngulëse se liria dhe pavarësia e atdheut do të fitohet duke u ngritur me guxim kundër robërisë së huaj, duke goditur pa mëshirë fashistët italianë dhe veglat e tyre, duke shkatërruar planet kriminale të armiqve ndaj Shqipërisë, duke e zhvilluar me vendosmëri dhe pa kompromis luftën për çlirim. Lidhur me këtë shoku Enver Hoxha demaskoi ashpër parullat e «politikanëve të falimentuar», sipas të cilëve nuk ishte nevoja të derdhej gjak, se fitorja mund të arrihej duke bërë kompromis me fashizmin. «Lufta s'bëhet me trëndafila dhe as me pambuk, dhe liria s'fitohet me fjalë dhe as me kompromise, por me vuajtje e gjak»¹, pohon autori në mënyrë të prerë dhe gjithë urrejtje për këta njerëz, të cilëve nuk u interesonte që populli të organizohej dhe të hidhej në luftë kundër pushtuesve të huaj.

1) E. Hoxha, *Vepra*, vëllimi 1, Tiranë 1968, f. 247.

Garanci e çlirimit nga zgjedha fashiste ishte lufta e vetë popullit. Ideja qendrore e artikullit «7 prill, dita e zisë dhe dita e luftës» është ideja se populli shqiptar duhej ta mbështeste shpresën e çlirimit në forcat e veta. «Vetëm me forcën, vullnetin, trimërinë tonë, vetëm me bashkimin e çeliktë që ka karakterizuar popullin tonë përpara çdo rreziku, vetëm me luftën e ashpër e të paprerë, — shkruan autori, — do ta fitojmë lirinë, do ta çlirojmë atdheun tonë, do t'i japim popullit shqiptar begatinë dhe lumturinë»¹. Në kundërshtim me parullat e armiqve të cilët flitnin poshtë e përpjetë se populli shqiptar nuk ishte në gjendje të zgjidhte vetë çështjet e tij jetike, se fati i tij do të caktohej nga jashtë, prej të huajve, shoku Enver Hoxha tregoi se masat popullore, të pajisura me vetëdijen e interesave dhe të forcës së tyre, ishin të afta të shkatërronin zgjedhën fashiste dhe të arrinin qëllimin e fundit, çlirimin e vendit dhe krijimin e një Shqipërie të lirë dhe popullore. Ngjallja e besimit të masave në forcat e tyre, u arrit në zjarrin e luftës, përvoja e së cilës e ndihmoi popullin shqiptar të kuptonte se «... shpëtimin duhej ta kërkonte nga forcat e gjalla të tija...»².

Qëndresa heroike kundër skllavëruesve të huaj shikohet në shkrimet publicistike të shokut Enver Hoxha në lidhje të ngushtë me të kaluarën heroike të popullit shqiptar, me traditat e tij patriotike dhe revolucionare. Asnjëherë, vë në dukje autori, populli shqiptar nuk i ka hedhur armët për liri, asnjëherë nuk është mposhtur nga rrebeshet e shumta që i kanë rënë mbi krye. Ai ka gjetur gjithnjë në veten e tij forca dhe ka ditur të luftojë për mbrojtjen e tokës dhe të lirisë së vet. Autori evokon bëmat e Skënderbeut, figurat e shquara të së kaluarës, N. Frashërin, I. Qemalin, L. Gurakuqin, B. Currin etj., luftëtarët trima për çlirimin e Shqipërisë, S. Bellkamenin, G. Butkën, Ç. Topullin, M. Qullin, A. Rustemin dhe S. Musanë me luftëtarët e 1920-ës, të gjithë ata që u përpoqën për lirinë dhe përparimin shoqëror të vendit. Këto tradita lridashëse dhe heroike, thekson shoku Enver Hoxha, ruhen të gjalla tek shqiptarët, të

1) E. Hoxha, *Vepra*, vëllimi 1, Tiranë 1968, f. 257.

2) Po aty f. 491.

cilët me qëndresën e tyre burrërore kundër zgjedhës fashiste i shtuan dhe i pasuruan më tej ato.

Në një varg shënimesh dhe skicash («Tre heronj për lirinë e atdheut», «Populli i Tiranës nderoi kujtimin e heroit të popullit Vojo Kushi», «Myslim Peza, Baba Faja Martaneshi», «Luftëtari trim Haxhi Lleshi dhe çeta e tij kreshnike» etj), u bëhet jehonë ngjarjeve të ditës, në të cilat u shfaq patriotizmi dhe heroizmi i popullit kundër pushtuesve të huaj. Në to flitet me krenari për aktet e guximshme të komunistëve dhe të patriotëve në ndeshje me armiqtë, për çetat vullnetare dhe partizane, që përfytyeshin me trimëri me forcat fashiste, ngrihet lart sakrifica e dëshmorëve të luftës. Në skicën «Kështu luftoi populli shqiptar. (Shteg më shteg me çetat partizane dhe vullnetare, që luftojnë me tërbim okupatorin fashist)», shkruar në janar 1943, shoku Enver Hoxha jep me viza të gjalla e të shpejta entuziazmin patriotik që kishte përfshirë popullin në luftë për çlirimin e atdheut, dashurinë e tij të madhe për luftëtarët e lirisë, me të cilët ndau kafshatën e fundit të bukës, gatishmërinë e njerëzve të thjeshtë për të bërë sakrifica edhe më të mëdha për çështjen e lirisë. Skica përbëhet nga disa tablo, në të cilat përshkruhen episode karakteristike të periudhës së luftës. Fryma emocionale e rrëfimit, qartësia dhe thjeshtësia janë veçoritë dalluese të skicës.

Ndjenja e krenarisë për patriotizmin dhe guximin e masave popullore, për karakterin e gjerë masiv të luftës, për madhështinë e kësaj epopeje, e cila për këtë quhet «luftë heroike», «luftë kreshnike» është ndjenja që sundon në shumë artikuj. Luftën Nacionalçlirimtare kundër robërisë fashiste shoku Enver Hoxha e quan ngjarje të paparë në historinë e tij të mbushur me luftëra dhe përpjekje të vazhdueshme për liri dhe pavarësi. «Kurrë në historinë e popullit tonë, — shkruan autori, — nuk ishte parë një luftë e tillë, ku të merrnin pjesë pa përjashtim që prej të vegjëlve gjer te mëmat tona plaka, kurrë s'ishte parë që gjithë energjitë e këtij populli të vogël, duke shqelmuar çdo paragjykim dhe zakon prapanik, të drejtoheshin në një luftë të ashpër për liri dhe pavarësi»¹. Bindja e thellë se lufta e masave popu-

llore do të kurorëzohej me fitoren e plotë mbi armiqtë, përshkon si pe i kuq shkrimet publicistike të shokut Enver Hoxha.

Në shkrimet e tij shoku Enver Hoxha më se një herë vë në dukje se detyrë e ngutshme ishte shpëtimi i vendit nga zgjedha fashiste dhe krijimi i një Shqipërie të re dhe se përmbushja e kësaj detyre kërkonte bashkimin e popullit shqiptar, e të gjithë forcave patriotike dhe përparimtare të vendit. Por në të njëjtën kohë shoku Enver Hoxha tregoi në mënyrë të qartë se lufta çlirimtare e masave nuk mund të kufizohej vetëm me dëbimin e të huajve. Populli, shkruante shoku Enver Hoxha, nuk e bënte luftën «për berihaj», por për liri dhe për një të ardhme të lumtur. Që në fillim, kur ngriti popullin në këmbë kundër fashizmit italian dhe klasave reaksionare sunduese, Partia, shkruante shoku Enver Hoxha, e ka pasur fort të qartë se lufta do të çohej më tej, zhdukja e skllavërisë fashiste nuk ishte qëllimi i fundit, por shkallë e domosdoshme për arritjen e një objekti më të largët revolucionar, ndërtimin e socializmit në Shqipëri. «Aktualisht PKSH, — shkruante shoku Enver Hoxha në janar 1943, — lufton në krye të Frontit N.-Çl. (ose për frontin e përbashkët kundër okupatorit) për çlirimin e vendit dhe për një Shqipëri demokratike të re. Kjo është etapa e parë e luftës sonë. Kjo nuk do të thotë se ne nuk punojmë dhe nuk përgatisim etapën e dytë. E para e përgatit diktaturën e proletariatit»¹.

Në shkrimet e shokut Enver Hoxha pohohet me forcë ideja e rolit vendimtar të popullit në ngjarjet e mëdha historike që përshkuan jetën e vendit. Në sajë të luftës së masave, të heroizmit dhe të sakrificave të tyre u shkatërruan planet e armiqve ndaj Shqipërisë. «Koha e re nxori në shesh faktorin popull, e nxori në tribunën e historisë më të fortë se kurdoherë. Tani ai ka marrë fjalën, ka marrë pushkën, kurse politikanët dhe dallaveraxhinjtë kanë mbetur me gënjeshtër, me intrigat dhe me paragjykimet e tyre në atë anë të barrikadës»². Duke folur për zhvillimin e revolucionit popullor në Shqipëri, autori pohon se faktori themelor i fitores janë masat, të cilat e treguan veten forcë aktive historike, me

1) E. Hoxha, **Vepra**, vëllimi 2, Tiranë 1968, f. 281.

1) E. Hoxha, **Vepra**, vëll. 1, Tiranë 1968, f. 163.

2) E. Hoxha, **Vepra**, vëll. 2, Tiranë 1968, f. 290.

vetëdije të lartë politike dhe të vendosura për ta çuar deri në fund luftën për çlirimin kombëtar dhe shoqëror «Lufta jonë çlirimtare, — shkruante autori, — e nxori popullin në krye dhe këtu e vetëm këtu qëndron arsyeja e fitores. Populli ynë dha prova në këtë luftë të shenjtë se nuk ishte në dekadencë morale sikundër shpresonin tradhtarët, por ishte një popull me shpirt përparimtar dhe progresiv, në të kishte një vitalitet të çuditshëm, në të vlonte ideja e çlirimit dhe e përparimit».¹

Në prag të Çlirimit, në artikujt e shokut Enver Hoxha iu kushtua rëndësi e veçantë çështjes së përgatitjes së popullit për të marrë pushtetin në dorë dhe për të drejtuar jetën e vendit. «Sot, — pohon autori në artikullin «Nga Kongresi i Përmetit në çlirimin e plotë të Shqipërisë», — populli është zot, sot ai vetëvendos, dhe kundër vullnetit të tij asgjë nuk mund të bëhet».² Pozita e re që gëzon populli shprehet jo vetëm në faktin që merr pjesë i tëri në pushtet, por edhe në të drejtën e tij që të kontrollojë njerëzit që ka zgjedhur në pushtet, «... t'i kritikojë dhe t'i heqë, në rast se ata nuk punojnë ose punojnë në dëm të tij».³

Populli shqiptar me luftën e vendosur dhe pa kompromis që zhvilloi kundër pushtuesve italianë, dha një kontribut të rëndësishëm në përpjekjet e përbashkëta të popujve të shtypur për shkatërrimin e murtajes fashiste, lufta e tij shërbeu si nxitje e madhe për shumë popuj që ishin ngritur për të hequr qafe zgjedhën e huaj. Kjo i siguroi popullit shqiptar simpatinë dhe përkrahjen e popujve të tjerë liridashës, të cilët flitnin me admirim për luftën, për frymën e tij të pamposhtur. «Lufta e popullit tonë, — shkruante shoku Enver Hoxha në artikullin «Vendimet historike të Mbledhjes së dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, mbajtur në qytetin e Beratit», — eci përpara me hapa të habitshme; në momentet më të vështira të luftërave çlirimtare të popujve të tjerë të shtypur, heroizmi i popullit tonë shërbente si nxitës dhe shenjë admirimi për luftëtarët e atyre vendeve vëllezër».⁴

1) E. Hoxha, *Vepra*, vëllimi 2, Tiranë 1968, f. 375.

2) Po aty, f. 286.

3) Po aty, f. 379.

4) Po aty, f. 375-376.

Fitorja e masave popullore mbi armiqtë shikohet e pandarë nga roli drejtues dhe udhëheqës i Partisë Komuniste, flamurtarja dhe udhëheqësja e luftës për liri, pavarësi dhe të ardhme të lumtur. Partia jo vetëm siguroi bashkimin e çeliktë të të gjitha forcave të shëndosha të vendit, duke kapërcyer pengesa të shumta dhe të ndryshme, por e udhëhoqi këtë luftë me guxim dhe pjekuri të lartë. Ajo e fitoi të drejtën si Parti udhëheqëse e popullit shqiptar në sajë të luftës, të përpjekjeve dhe të sakrificave të saj të shumta, të gjakut të anëtarëve të saj më të mirë. «Historia do të shkruajë epopenë legjendare të popullit tonë në luftën antifashiste, heroizmat e pashoqe të partizanëve shqiptarë, të luftëtarëve të katundeve dhe të qyteteve, të ushtrisë së prapavijave, rolin e madh e të pavdekshëm të Partisë Komuniste të Shqipërisë».¹

Në publicistikën e shokut Enver Hoxha, krahas temës së luftës heroike dhe vetëmohuese të masave, vend të rëndësishëm zënë artikujt që i kushtohen demaskimit të armiqve, tradhtarëve, pseudopatriotëve, politikanëve dallkawkë, ballistëve dhe të veglave të tjera të pushtuesve të huaj, të cilët i drejtuan tërë forcat e tyre kundër popullit që po u shpëtonte përgjithnjë nga duart. Me forcë të pamëshirshme u fshikullua sidomos agjenti i vjetër i fashizmit italian, një nga figurat më të urryera të jetës politike shqiptare, Mustafa Merlika — Kruja. Duke përdorur të dhëna biografike, fakte nga jeta politike bashkëkohore dhe, sidomos duke folur për manevrat e tij të rrezikshme demagogjike, autori vizatoi portretin satirik të tradhtarit. Figura e Merlikës u zbulua përmes epitetëve që tipizojnë thelbin e tij si shërbëtor i vjetër dhe besnik i pushtuesve italianë. Me forcë të veçantë u goditën orvatjet e këtij agjenti të njohur për ta hequr veten në sytë e popullit si «nacionalist». Në artikullin «Fjalimi i tradhtarit, mbajtur më 22 nëntor 1942», manevrat e M. Krujës krahasohen me veprimet e prestidigjitorit që ia fsheh publikut sahatin e vet duke thënë se e humbi. Edhe tradhëtari për t'i hedhur popullit pluhur syve nuk e përmendte më fjalën «fashizëm» në fjalimet e tij, ndonëse i shërbente

1) E. Hoxha, *Vepra*, vëllimi 2, Tiranë 1968, f. 281

me aq besnikëri si përpara. Fshikulli satirik bie pa mëshirë edhe mbi krerët e tjerë të reaksionit, si Lumo Skëndo, Mehdi bej Frashëri, Ali Këlcyra dhe eksponentët e tjerë të «Ballit». Autori i godit ashpër këta «zotërinj të kolltuqeve dhe të kompromiseve», të cilët, pasi ishin përlyer «në çdo punë të qelbur», pas kapitullimit të Italisë shpejtuan «të përvehtësomini luftën e djalërisë shqiptare» dhe t'i vinin mbi krye popullit «regjime shtypëse dhe klika hajdutësh e tradhtarësh».

Në procesin e luftës çlirimtare masat popullore u edukuan politikisht; ato mësuan të mposhtin «çdo dredhi» dhe «çdo poshtërsi» të klasave shfrytëzuese dhe të mos lejonin që t'u rrëmbenin frytet e luftës së tyre. «I ka gënjyer mendja të gjithë ata që besojnë ndryshe; — shkruante autori, — mjerë ata që s'po shohin se sa përpara është populli ynë, që s'po e kuptojnë ende se s'gënjehet kollaj ky popull shqiptar i vitit 1943 me dëngla dhe me fjalë bombastike që mbulojnë regjime tmerrri e urie; mjerë ata që s'kanë kuptuar shpirtin e kësaj djalërie heroike dhe hovin e saj mbinjerëzor!»¹. Kur Ushtria Nacionalçlirimtare po çlironte hap pas hapi të gjithë vendin dhe armiqtë, të tmerruar nga marshimi i pandalshëm i popullit kryengritës, zunë të thurin intriga të reja me shpresë që të ruanin privilegjet e tyre, autori i paralajmëronte se përpjekjet e tyre ishin të kota dhe se ata nuk mund t'i shpëtonin fundit të tyre të pashmangshëm: «Të gjitha këto poshtërsi do të marrin fund për së shpejti nën grushtin e shëndoshë të popullit shqiptar dhe të Ushtrisë së tij Nacionalçlirimtare»².

Shkrimet publicistike të shokut Enver Hoxha shquhen jo vetëm për brendinë e thellë, përgjithësimet e rëndësishme që ngërthejnë dhe frymën luftarake, por edhe për meritat e veçanta artistike. Në gjithë larminë e shkrimeve të shokut Enver Hoxha (artikuj, shënime, skica, pamflete etj.) gjejmë një varg tiparesh të përbashkëta nga pikëpamja e formës dhe e stilit që e shquajnë publicistikën e tij në gjirin e publicistikës së luftës.

1) E. Hoxha, *Vepra*, vëll. 2, Tiranë 1968, f. 89.

2) Po aty, f. 295.

Një nga tiparet dalluese të stilit publicistik të shokut Enver Hoxha është fryma e pasionuar. Disa nga shkrimet janë ligjërata të zjarrta, me fuqi të madhe agjitative, që përshkohen nga intonacioni oratorik. Në të ndjehet e gjallë fjalla e autorit, i cili sqaron, porositi, bind dhe nxit lexuesin për të mbajtur qëndrim aktiv ndaj çështjeve kryesore të jetës. Këtë tipar e vëmë re në një radhë artikujsh, si «28 nëntori, dita e bashkimit të popullit shqiptar kundër zaptuesit fashist», «Pa mëshirë», «Fjalimi i tradhtarit, mbajtur më 22 nëntor 1942», «7 prill, dita e zisë dhe dita e luftës» etj. Në artikullin «Pa mëshirë», pasi përshkruhen barbarizmat e fashistëve italianë, autori flet me nota të ngritura patetike për frymën e paepur të popullit shqiptar: «E di mirë fashizmi italian se sa i vlen lëkura; e di mirë fashizmi italian se si luftonin djemtë e Selam Musajt, që, me «dyfegje të lidhura me gjalmë, me sëpata dhe me hanxharë, i dërmuan; e di mirë fashizmi italian se shqiptarit për ta fituar lirinë s'i trembet syri nga topat dhe nga aeroplanët e tij, e dinë mirë këlyshët e Duçes se malet e Shqipërisë janë çerdhet e çetave tona, çerdhe nga do të vërshulen si dragonj bijtë e Shqipërisë për t'i shfarosur përgjithmonë ata dhe tradhtarët e vendit tonë».

Malet tona po gjëmojnë, çetat tona po armatosen, çetat tona po godasin. Dëshira e shqiptarëve të vërtetë po përmbushet».

Shkrimet publicistike të shokut Enver shquhen nga fryma aktive dhe dinamizmi. Me këtë lidhet edhe përdorimi i shpeshtë i apostrofës dhe i thirrjeve: «Të hidhemi edhe një herë të vendosur, më të bashkuar dhe me besim të patundur në fitore, në luftën kundër invaduesit, në këtë luftë tonë të shenjtë...».

Në shumë shkrime të mëvonshme nis të spikatë elementi analitik; në disa prej tyre, që ndërtohen zakonisht si panoramë e zhvillimit të situatës politike ose të luftës çlirimtare, përgjithësohet rruga e përshkuar nga populli kryengritës, zbulohen brendia dhe veçoritë e çdo etape, tregohen faktorët që përcaktuan fitoret e arritura, nxirren detyrat e mëtejshme që u dilnin masave.

Karakterit i mprehtë demaskues është një veçori tjetër e rëndësishme e stilit të shkrimeve publicistike të shokut

Enver Hoxha. Kundër të gjithë atyre që u orvatën të pengonin fitoren e popullit, autori drejtoi goditjet e tij dërrmuese; arma që përdor është ironia e cila rëndom shkon deri në sarkazëm therëse. Efekti satirik arrihet me mjete të kursyera; parullat dhe sjelljet e armiqve satirizohen zakonisht me dy-tri viza dhe me detaje që ngërthejnë ngjyrim të veçantë emocional dhe shprehësi të lartë; për të vënë në lojë fashistët dhe tradhtarët, autori u drejtohet gjithashtu parodisë dhe kontrasteve satirike, përdor fjalë me kuptim të kundërt për ironi etj.

Kërkesave të këtij stili u përgjigjet edhe zgjedhja, përpunimi dhe përdorimi i mjeteve gjuhësore që autori, me shije të hollë gjuhësore dhe horizont të gjerë kulturor, i merr në radhë të parë nga burimi i gjallë popullor.

Në publicistikën e shokut Enver Hoxha ndihet kujdesi i autorit për të qenë sa më i kuptueshëm prej masave, të cilave u drejtohej. Për çështjet e ndërlikuara politike, për kuptimin e thellë të ngjarjeve dhe të fakteve të ndryshme të luftës, për konkluzionet dhe detyrat që rridhnin nga zhvillimet e reja politike dhe ushtarake, në shkrimet publicistike flitet me fjalë të thjeshta dhe të sakta, që japin drejt thelbin e asaj që ngjiste në jetën e vendit. Kjo ishte në përputhje me parimin që popullit t'i thuhej «*e vërteta ashtu si e ka bërë mëma, e vërteta lakuriqe*»¹, pa stërhollime dhe zbukurime të tepërta, të zhveshura nga fraza boshe dhe të fryra. Së këtejmi rrjedh shprehja gjuhësore e përpiktë, e qartë dhe e ngjeshur e shkrimeve publicistike të shokut Enver Hoxha, e cila është arritur duke shfrytëzuar me zhdërvjelltësi mjetet e shprehjes nga të gjitha ligjërimet dhe stilet, të lidhura në mënyrë organike. Kështu, krahas lokucioneve gramatikore librore, si «nga shkaku i...», «me qëllim që...», etj., ndërtimeve me togje emërore, si «bërja e aksioneve», «mbajtja qëndrim», «thëthitja e gjakut» etj. përdoren mjete karakteristike të ligjërimin bisedor, si «dëftej», «lypset», «qorras», «açik», «qëmoti» etj. Të afërta për masat shkrimet publicistike i bënte edhe përdorimi i gjerë i frazeologjisë popullore (p.sh. «u vjen festja vërdallë», «ngopet

me lugë të zbrazët», «i bën hesapet pa hanxhinë», «s'shkel në dërrasë të kalbët» etj.), i fjalëve të urta (p.sh. «fshati që duket s'do kallauz», «në vend që t'i vesh vetulla, i nxjerr sytë» etj.).

Duke qenë e qartë dhe e kuptueshme, publicistika e shokut Enver Hoxha në të njëjtën kohë shquhet nga fryma e theksuar emocionale që vjen nga përdorimi i epiteteve, metaforave, krahasimeve dhe fjalëve me kuptim të figurshëm, të cilat ndihmojnë për të dhënë heroizmin dhe vulltin e qëndresës së masave (p.sh. «çerdhe shqiptonjash», «lule e patriotizmit», «fatosë», «dragonj», «kala e pathyeshme e rezistencës së popullit shqiptar» etj.). Forcë të veçantë emocionale kanë sidomos epitetet që karakterizojnë përfaqësuesit e kampit armik (p.sh. Mustafa Mërlika *tradhtari*, *korb i zi*, *bimbash* i fashizmit, *çakalli* Hilmi Leka, *banditi* Abaz Kupi etj.). Ndikimi emocional i shkrimeve është arritur edhe me mjete të tjera, si përsëritja, rreshtimi i fjalëve me intensitet ngritës etj. (p.sh. «Të rinjtë tanë u internuan, u burgosën, u torturuan, u pushkatuan, u vunë në litar, po nuk u përkulën» etj.).

Shkrimet publicistike të shokut Enver Hoxha, me brendinë e thellë dhe formën e lartë artistike, kanë një forcë të madhe vepruese dhe ndikuese e njëkohësisht përbëjnë një shembull të shkëlqyer të stilit të ri politiko-shoqëror.

Publicist i njohur i luftës ishte Nako Spiru. Në ato vite, ai u shfaq si mjeshtër i pamfletit politik. Objekt i satirës së tij ishin politikanët e kalbur, miqtë e Luogotencës, agjentët e «Kolonës së Pestë» dhe njerëzit e tyre, që përhapnin poshtë e lart fjalë për të diskredituar luftën e popullit shqiptar: «*tradhtarët*», «*dallaverexhinjtë*», «*intrigantët profesionistë*, që kanë hy në të gjitha kombinacionet politike», «*intelektualët e kalbur*», «*reaksionarët fanatikë*», «*arrivistët e rinj në fushën e politikës*», që duke i hequr vetes një bojë nacionaliste, bënin çmos për t'i vjedhur popullit lirinë dhe për të sunduar mbi të si në të kaluarën, «*kalemxhitë e shitur*», që nxirrnin fletushkat antipopullore të Komandës gjermane dhe të organizatave tradhtarë. Në themel të mjeteve artistike kushtuar demaskimit të armikut, qëndron ballafaqimi i hapur i fakteve, kontrasti në mes asaj që thonin armiqtë dhe veprave të tyre.

1) E. Hoxha, *Vepra*, vëll. 1, Tiranë 1968, f. 46.

Në artikujt e vet N. Spiru zbuloi fytyrën e «Ballit Kombëtar». Për origjinën e «Ballit», për elementët politikë dhe shoqërore që e përbënin, për qëllimet që ndiqte kjo organizatë, flitet me krahasime dhe epitete të goditura. Në «Ballin Kombëtar» shkruante autori «prehen» *«njerëzit ma antipopullorë, ma antidemokratë të Shqipërisë, njerëzit që kanë qenë kurdoherë kundër përpjekjeve dhe luftërave çlirimtare të popullit, dhe ajo që asht ma keq, i japin tonin politikës së tij»*¹.

Autori nxirrte qartë në pah mospërputhjen në mes të dukjes së jashtme dhe thelbit, në mes të pretendimeve të ballistëve dhe brendisë së veprës së tyre. Që kur u krijua, po në mënyrë të veçantë pas kapitullimit të Italisë, «Balli Kombëtar» nisi të çirrej me të madhe se *«është gjakosur»* me pushtuesit italianë «për Shqipërinë», se *«ka bërë sakrifica të shumta»* për çlirimin e vendit. N. Spiru i përqeshte këto pretendime me një sarkazëm dërmuese, duke treguar me fakte të kundërtën: *«Balli Kombëtar» s'ka çliruar akoma një katund»;* qëllimi i «Ballit», thoshte autori, është që me *«një pushkë këtu, një pushkë aty... me kalie me pare fallco në histori»*, të krijojë *«epoqe aty ku s'ka»*².

Në artikujt e N. Spirit, përshkruhej me ngjyra shumë të gjalla roli tradhtar i «Ballit Kombëtar» gjatë pushtimit nazist, bashkëpunimi i tij me ushtritë hitleriane për të mbytur me gjak dhe hekur lëvizjen e popullit. Me zemërim flitet në to për djegiet, plaçkitjet, dënimet dhe terrorin e çetave balliste në fshatra dhe në qytete, për arrestimet, torturat dhe masakrat që bënin komandantët e «Ballit» për të mposhtur rininë shqiptare.³

Temë tjetër e rëndësishme e publicistikës së N. Spirit ishte çështja e rinisë, problemet e jetës dhe të luftës së saj. Në mjaft artikuj tingëlloi me forcë ideja e aspiratave të pastra dhe fisnike të rinisë shqiptare, që u hodh në luftë

1) N. Spiru, **Mbi bashkëpunimin e popullit shqiptar**, «Zëri i popullit» shtator 1943, numër special, f. 1.

2) N. Spiru, **Çështje të ditës**, Po aty, tetor 1943, f. 2.

3) Shih: **Kriminalët**, Fletë e «Kushtrimit të lirisë» dhjetor, 1943, nr. 5; **Akoma dy fjalë për Ballin**, Botim i posaçëm i «Zërit të popullit», prill 1944, etj.

në emër të një së ardhmeje të lumtur për popullin. Këtë rini, autori e mbrojti nga shpifjet e propagandës fashiste dhe të agjentëve të «Kolonës së Pestë», nga *«miqtë» e Luogotenencës*, *«zotërinj me bark dhe ofiqe»*, që në të kaluarën ishin mësuar të shisnin Shqipërinë në *«tregun e politikës ndërkombëtare»*; atyre nuk u *«leverdiste»* që rinia kishte rrokur pushkën dhe luftonte; këta *«kompromisaxhinj»* orvateshin ta diskreditonin luftën e saj, si *«punë axhamijsh»*. Një përgjigje dërmuese këtyre njerëzve u dha autori me artikullin «Përgjigjemi», botuar në «Kushtrimin e Lirisë», në numrin e marsit të vitit 1943, që pati jehonë të gjerë në shtresat e rinisë. Kontrasti satirik ishte mjeti me të cilin nxirrej në shesh fytyra e vërtetë e këtyre elementëve reaksionarë. Në fillim rreshtohen parullat, që përhapnin njerëzit e «Kolonës së Pestë» dhe pastaj jepet karakteristika morale e psikologjike e atij ambienti, që i ushqente dhe i popullarizonte këto shpifje kundër rinisë. Autori i qëllon ata me pendën e tij dërmuese. Luftën, sakrificat, idealet e rinisë N. Spiru i mbrojti me energji të madhe sidomos gjatë pushtimit hitlerian, kur tradhtarët, duke nisur me «Ballin Kombëtar» e duke mbaruar me «Legalitetin», u hodhën për t'i rrëmbyer popullit fitoren nga duart. Kur rinia jonë luftonte, bënte sakrifica, tradhtarët, shkruante autori, ishin *«në prehën t'Imperos»*. Autori tallej me shpresat e kota të politikanëve reaksionarë, të cilët i gënjente mendja se rinia luftonte për ta: *«Ne marshojmë drejt së nesërme plot dritë, tue i kthye krahët një herë përgjithmonë të kaluemes së errët»*¹.

Pamfletet e N. Spirit shquhen për stilin e gjallë dhe trajtimin e thjeshtë të problemeve; ato janë të shkurtra dhe konkrete. Zakonisht, ato shkasin e marrin nga një fakt i caktuar i jetës politike të ditës ose nga ndonjë parullë e propagandës armike. Për kompozicionin e shumicës prej tyre është karakteristike paraqitja në fillim e ndonjë ngjarjeje ose ndonjë parulle të armikut; pastaj vjen analiza. Shpesh

1) **Rruga jonë**, Fletë e «Kushtrimit të lirisë», dhjetor 1944, nr. 5, f. 6.

autori përdor ironinë, sarkazmën, parodinë, kontrastin etj. Epitetet janë në përgjithësi të ngjeshura me fuqi të madhe demaskuese. Komandantët e «Ballit» cilësohen «*tiranët e ve-gjël*», kurse gazetarët e fletushkave të tij «*qatipët e ballit*». Shumë shprehje të këtyre pamfleteve tingëllojnë si aforizma (p.sh. «atje ku zbulohesh rrobja e Fashios, populli kthente shpinën», «asht zor me la gjakun e nesërm»). Ndonjëherë ideja zbulohet me anë të paradoksit (p.sh. «... u kanë deklarue heroikisht luftë italianëve, mbasi u shërbyen deri dje»; «Hitleri i drejtohet Evropës që ta shpëtojë. Cilës Evropë i bën apel Hitleri? Evropës që i qit themelet?»; etj.). Për të nxjerrë më mirë në shesh fytyrën e armikut, autori përdori mënyra të thëni të gjuhës së popullit. Kështu për të karakterizuar taktikën e krerëve reaksionarë, të cilët, për të penguar bashkimin e gjithë forcave në luftë kundër fashizmit, kapeshin pas gjërave të vogla, thuhet se «Balli Kombëtar» kërkon «të gjejë qimen në vezë», «të kapet pas qimes», kurse për propagandën e armikut: «manevrat e Hitlerit s'pinë ma ujë», «s'hanë bar mileti».

Në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, veprimtari publicistike dhe letrare zhvilloi edhe Shefqet Musaraj. Në «Kushtrimi i lirisë», «Zëri i popullit» dhe në «Buletin e Zërit të popullit», ai botoi artikuj, fejtone, skica, reportazhe dhe pamflete. Në shkrimet e tij Sh. Musaraj zbulonte fytyrën e vërtetë të pushtuesve fashistë. Duke trajtuar se si gjatë Luftës së Dytë Botërore, fashizmit i doli boja dhe njerëzit kudo në Evropë e kuptuan shpejt se ç'përfaqësonte ai, autori pohonte se atij «as qentë s'i afrohen, jo njerëzit». Duke i dhënë përgjigje propagandës zyrtare, ai nxirrte në shesh fytyrën e vërtetë të fashizmit si armik i Shqipërisë e i popullit shqiptar. Në «Armiku s'ngopet me gjak», «Ngjarje e komente», «Marifete nga të fashizmit» etj., flet me urrejtje dhe zemërim për djegiet dhe plaçkitjet që bënin trupat fashiste, për mizoritë e tyre kundër popullsisë së paarmatosur etj. Gjithë përbuzje dhe nëveri flet Sh. Musaraj për veglat e fashizmit, të cilat i quante «vegla që mbajnë kombësi shqiptare». Në artikujt «Zëri i Vlorës» dhe «Mustafa Kruja fsheh diellin me shoshë», autori zbulonte fytyrën antikombëtare dhe reaksionare të agjentit të vjetër të fashizmit italian, duke e cilë-

suar atë me epitete që nxirrnin qartë në shesh thelbin e veprave të tij prej tradhtari të urryer: «gogol i ndyrë», «kryepërgjegjës i mijëra krimeve në kurriz të popullit shqiptar».

Sh. Musaraj zotëron në mënyrë të veçantë sarkazmën popullore. Shkrimet e tij të luftës janë plot fjalë dhe shprehje nga e folura e përditshme. Pseudopatriotët, politikanët e vjetër profesionistë, të cilët ishin mësuar ta mbanin veten si «prijës» të popullit, e që thonin se populli shqiptar mund ta fitonte lirinë e vet «*edhe pa gjak, por vetëm me dallavere, me ca kompromise biçimi*»¹, autori i quan «*kapëdanë të kohës*», që mundohen «*ta mbajnë veten për nacionalistë me ferman*»². Në artikullin «Kolona e Pestë po i tepëron gjynahet» tregohet se këto parulla e kanë burimin te «Kolona e Pestë» dhe se këta njerëz përpiqen të pengojnë kështu popullin që të luftojë fashizmin dhe të fitojë me duart e veta lirinë e pavarësinë e humbur. «*Populli ynë, — pohonte autori — s'ka më pse t'u varë torbën kapëdanëve të Kolonës së Pestë, që po ngjiren së mbjelli andej-këtej parulla dekurajonjëse, parulla frike, parulla që fundi-fundit s'kanë tjetër burim përveç atij të fashizmit dinak*»³.

Një vend të dukshëm jo vetëm në publicistikën e Sh. Musaraj, por në tërë letërsinë e Luftës Nacionalçlirimtare, zë pamfleti «Dje dhe sot». Kjo vepër u shkrua në janar të vitit 1944, në kohën kur gjithë reaksioni, i grumbulluar dhe i drejtuar prej Gestapos, çirrej se Lufta Nacionalçlirimtare ishte në dëm të Shqipërisë, se gjermanët nuk kishin ardhur si pushtues dhe se «nuk do të përzihen aspak në punët e brendshme të vendit». Qëllimi i tyre ishte të ngjallnin hutim në popull, ta përçanin dhe ta largonin atë nga lufta kundër pushtuesve hitlerianë. Autori demaskoi manevrat e tyre djallëzore, tregoi se çfarë ishin njerëzit që bashkëpunonin me gjermanët kur kapitulloi Italia fashiste. «*Myflizët*», shkruan autori, u vërsulën të shpallin «*indipendencën që po u falte Adolf Hitleri*». Sh. Musaraj jep një karakteristikë të qëlluar të kampit të armiqve: «*Po shtiren si patriotë, ata që s'kishin*

1) «Kushtrimi i lirisë», korrik 1943, nr. 12, f. 19.

2) «Zëri i popullit», shkurt 1943, nr. 1, f. 9.

3) Po aty.

çarë ndonjëherë kokën për fatin e atdheut», mbeturinat e fashizmit italian, që «kishin fshehur në shtëpitë e tyre këmishat e zeza», «duaxhit e çmendur të nazizmit», që komentonin dikur me entuziazëm nëpër sallat e kafeneve «komunikatat e bujshme të Wermachtit», pseudopatriotët të cilët thonin se «është detyra kombëtare, që i shtrëngon t'i heqin kapellën ushtrisë gjermane», dhe «Balli Kombëtar», shton autori, «daullja që mban avazin në orkestrën e tradhtarëve»¹. Me një gjuhë të mprehtë, plot figura dhe shprehje të gjalla, zbulohen qëllimet e vërteta të fushatës demagogjike, që kishin shpërthyer spiunët e Komandës gjermane dhe organizatat tradhtarë në shërbim të saj.

Publicistika e Sh. Musarajt shquhet për stilin e rrjedhshëm e tërheqës dhe për ngjyrat e qarta, me të cilat përkruhen njerëzit e ngjarjet, për gjuhën e pasur me fjalë dhe shprehje të zgjedhura popullore.

Sh. Musaraj në vitet e Luftës shkroi edhe një tok skicash të ndryshme. Zgjimi i masave popullore, ndryshimet e thella që ngjajnë në psikologjinë e tyre nën ndikimin e ngjarjeve të lëvizjes, lindja dhe formimi tek ata i një ndërjegjeje të lartë politike, gjeti pasqyrim tek skicat «Djemtë e fshatit», «Në pragun e lirisë», «Nëna e Zijait», «Shtek më shtek me partizanët e Divizionit I S» etj. Skicën «Djemtë e fshatit», autori e ka ndërtuar si përskrim të një vizite në një fshat të Labërisë në janar 1942 dhe në dhjetor të po atij viti. Në pjesën e parë të skicës, fshatarët janë nxjerrë të shushatur prej fatkeqësisë që u kanë rënë mbi krye, të shtypur nga varfëria dhe padia. Kur i takon sërish, shkrimtari i gjen të ndryshuar fare. Lëvizja që kishte nisur kundër të huajve, i kishte nxjerrë nga pasiviteti ku lëngonin, i kishte ndihmuar ta shikonin qartë dhe me besim jetën, i kishte bërë luftëtarë të lirisë. «Milicët e xhandarët ven'e vinë. Kërkojnë kryengritësit. Po kush ua var trastën. Kryengritës jemi të tërë nashti. S'ka më ujdëra me armiq. E kemi kuptuar tej për tej, se ku na pikon shtëpia. Dajmë ta ndajmë të zezën nga e bardha... E varfëra unë, sa e humbur kam qenë!»², thotë një grua plakë.

1) Sh. Musaraj, **Dje dhe sot**, Tiranë 1944, f. 2.
2) «Kushtrimi i lirisë», mars 1943, f. 14.

«Shtek më shtek me partizanët e Divizionit I Sulmues» është një tog vizatimesh dhe skenash të shkurtër nga marshimi i këtij formacioni ushtarak për çlirimin e Shqipërisë së Veriut në verë 1944. Me dy-tri viza, autori jep figurat e partizanëve trima, që nuk i lodhte as rruga e gjatë, as privacionet e shumta të jetës në male. Ata jetonin me një dëshirë e me një mendim: të dërmonin armikun dhe të çlironin sa më parë atdheun. «Të rrih kështu me duar lidhur, si rrimë ne, nuk i thonë jetë partizane. Ata zagarë, si duket, nuk kanë nijet të vijnë fare. Pse nuk jep urdhër komanda t'i sulmojmë atje ku janë fshehur, brenda në qytet?»¹ — thonë partizanët e Brigadës IV, të pakënaqur se kishin një javë që s'po binin në luftë me gjermanët dhe me mercenarët. Syri i mprehtë i autorit dikton ato elemente të reja që kultivoi në karakterin e njerëzve jeta partizane: thjeshtësinë, frymën e solidaritetit, ndjenjën e madhe të dashurisë që e shtynte tjetrin të linte kryet për shokun, shpirtin heroik, ndjenjën e përgjegjësisë ndaj popullit, gatishmërinë për sakrificën më të lartë për idetë e Partisë. «Shtek më shtek me partizanët e Divizionit I Sulmues» përskohet nga ideja e karakterit të thellë popullor dhe çlirimtar të luftës.

Gjatë kohës së luftës skica letrare shkruan A. Çaçi dhe autori i ri Gjistikë Kuqali.

Në skicën «Gruri» A. Çaçi tregoi lidhjen e ngushtë të partizanëve me popullin. Çetat partizane u ndihmojnë fshatarëve të korrin grurin dhe i mbrojnë ata nga fashistët që sulen të bëjnë shkrumb e hi frytin e djersës së tyre. Shfaqja e vetëdijes revolucionare në masat është ideja e skicës «Muhabet me një katundar të çliruar» ku flitet për gëzimin e popullit të zonave të çliruara nga zgjedha fashiste. Te skica «Ku e gjeta Kushtrimin e lirisë» tregohet si Lufta Nacionalçlirimtare zgjoi njerëzit e thjeshtë dhe çoi idetë e reja dhe në krahinat më të largëta; këtu ravizohet figura e një lopçari, plot etje për të mësuar sa më shumë nga lufta e popullit për çlirim. «Dy vëllezër: një luftë, një varr» dhe

1) Sh. Musaraj, **Shtek më shtek me partizanët e Divizionit I Sulmues**, [pa v.b.] 1944, f. 9.

«Nata e fundit e një martiri» i kushtohet heroizmit të komunistëve. Në skicën e parë ravizohet portreti lirik i Margarita Tutulanit; paraqiten ndjenjat dhe synimet e pastra të heroinës, e cila vuri të gjitha forcat dhe zotësitë e saj për t'i hapur sytë femrës shqiptare dhe për ta ngritur atë në luftë kundër fashizmit italian që ishte dhe lufta për çlirimin e saj. Në shkrimin «Nata e fundit e një martiri» përshkruhet qëndrimi burror i Shyqyri Ishmit në çastet e fundit të jetës së vet, devotshmëria e tij e patundur ndaj çështjes së popullit. Skicat e A. Çaçit janë të thjeshta, ato përshkohen nga fryma patetike. Autori ka synuar në radhë të parë të fiksojë faktet, që vënë në dukje shpirtin heroik të luftëtarëve të lirisë.

Gjikë Kuqali (1921-1944) temat për skicat e veta i nxori nga lufta e rinisë shqiptare kundër fashizmit italian. Krenar për frymën e vetëmohimit të rinisë, autori vë në dukje vetëdijen e lartë të kësaj rinie («Njëzet e pesë vjeç djalë» dhe «N'atë dhomë matanë»). Në skicën e parë përshkruhet akti i guximshëm i një të riu, i cili preferon më mirë të vdesë sesa t'u bjerë në dorë armiqve. Autori fizionominë e heroit e ka pikturuar me dy-tri viza me ndonjë imtësi mjaft shprehëse. Edhe skica «N'atë dhomë matanë» flet për rrugën e luftës dhe të sakrificave që zgjodhi pa luhajtje rinia shqiptare. Te «Gjaku» gjeti pasqyrim një aspekt i rëndësishëm i atyre viteve: pajtimi i gjaqeve të vjetra në zjarrin e luftës kundër pushtuesve të huaj. Gj. Kuqali tregon se si qëllimi i përbashkët u ndihmoi njerëzve të zhdukun nga ndër-gjegjja e tyre paragjykimet e vjetra shoqërore. Në shkrimet e pakta të Gj. Kuqalit shquhet një talent jo i rëndomtë prej rrëfimtari, që zotëron një gjuhë të saktë dhe stil të rrjedhshëm.

*
*
*

Letërsia e Luftës Nacionalçlirimtare u zhvillua brenda një periudhe të shkurtër; nga fundi i vitit 1941, kur nisën të botohen traktet e para të Partisë e deri në çlirimin e vendit nga pushtuesit nazifashistë dhe tradhtarët e vendit

më 29 nëntor 1944. Megjithatë, prodhimi letrar i këtyre viteve pati rëndësi historike, sepse pikërisht në të gjejmë fillimet e realizmit socialist në letërsinë shqiptare. Ajo që bie në sy mbi të gjitha në prodhimin letrar të kësaj periudhe dhe e bën këtë një dukuri të re në historinë e letërsisë shqiptare është heroi i saj, në të cilin u mishërua tipi i luftëtarit për çlirimin kombëtar dhe shoqëror të popullit. Në karakterin e këtij heroi, që e gjejmë në këngët dhe në marshet partizane, në vjershat lirike dhe në skicat e reportazhet artistike, autorët theksuan vetëdijen e lartë politike, dashurinë e madhe për popullin, vendosmërinë për të dhënë edhe jetën për çlirimin e tij, hovin shpirtëror që kishte ngjallur tek ai ideali i luftës çlirimtare. Letërsia e periudhës së luftës pohoi epërsinë morale dhe shpirtërore të luftëtarëve të lirisë mbi armiqtë.

Për fillimet e realizmit socialist flet edhe mënyra e re e pasqyrimit të popullit. Në skicat dhe shkrimet e ndryshme në prozë, në «Epopenë e Ballit Kombëtar», etj. u tregua zgjimi i masave, të cilat ishin plotësisht të vendosura për të mos lejuar më që t'i mashtronin klasat sunduese si në të kaluarën. Masat ishin të bindura se lufta kundër pushtuesit fashist do të sillte me vete në mënyrë të pashmangshme ndryshime të thella në gjendjen e tyre; ato kishin rrëmbyer armët jo vetëm për të dëbuar të huajt nga Shqipëria, por edhe për çlirimin e tyre shoqëror.

Një nga veçoritë karakteristike të letërsisë së periudhës së luftës çlirimtare është optimizmi historik, i cili buronte nga perspektiva e qartë që lëvizja e gjerë e masave popullore i hapi letërsisë shqiptare. Qoftë kur flasin për aktet heroike të luftëtarëve të lirisë, të komunistëve dhe të partizanëve, qoftë kur fshikullojnë armiqtë, sidomos organizatat tradhtarë, autorët u jepnin mundësi lexuesve të shihnin se ngjarjet po zhvilloheshin në drejtim të forcimit të vazhdueshëm të lëvizjes së masave popullore dhe të dobësimit të armiqve, se rezultati i fundit i kësaj ndeshjeje do të ishte fitorja e popullit mbi armiqtë e tij shekullorë.

Si pasqyrim i luftës së popullit shqiptar për çlirimin e tij kombëtar dhe shoqëror, letërsia e kësaj periudhe nuk mund të mos përshkohej nga fryma e partishmërisë. Kjo shihet jo vetëm në veprat me karakter demaskues satirik,

në të cilat vihen në lojë përpjekjet e kota të klasave shfrytëzuese për të penguar vrullin e luftës çlirimtare të masave popullore, por në të gjithë prodhimin letrar të viteve të luftës, në të cilin çdo ngjarje apo fakt u shikua dhe u vlerësua nga pozitrat e popullit kryengritës, të interesave të tij themelore.

Këto arritje novatore dëshmojnë se në vitet e Luftës Nacionalçlirimtare lindi letërsia shqiptare e realizmit socialist.

KREU II

LETËRSIA SHQIPTARE E PERIUdhËS SË FORMIMIT TË PLOTË TË REALIZMIT SOCIALIST

(29 nëntor 1944 — fundi i viteve 50)

1

Brenda periudhës që nis me vendosjen e pushtetit popullor dhe shkon deri në fund të viteve 50, u shemb për tokë rendi i vjetër ekonomik dhe shoqëror e politik dhe u hodhën bazat e shoqërisë socialiste. Hapat e para u bënë fill pas Çlirimitt, me kryerjen e një varg shndërrimesh të thella shoqërore dhe ekonomike, që kishin si synim likuidimin e plotë të klasave të vjetra sunduese dhe krijimin e kushteve të nevojshme për ndërtimin socialist. Ndër masat më të rëndësishme që u ndërmorën ishte zbatimi i reformës agrare, e cila çrrënjosi të gjitha mbeturinat e sistemit feudal dhe shpëtoi fshatarësinë nga shtypja dhe shfrytëzimi shekullor. Krahas kësaj me ligje të veçanta u shndërruan në pronë të përbashkët të popullit, minierat, fabrikat, uzinat, centralet elektrike etj. Pas përmbysjes së gjithë sistemit të marrëdhënieve të vjetra shoqërore, masat punonjëse iu përveshën punës për ngritjen e socializmit. Për të çarë udhën përpara e për të hedhur bazat e shoqërisë së re duhej zhdukur prapambetja e madhe teknike dhe ekonomike e trashëguar nga e kaluara, duhej organizuar rrënjësisht ekonomia, duheshin zhvilluar me vrull të gjitha degët e saj. Në fillim të viteve 50 nis puna për të ndërtuar industrinë socialiste. Me ritme të shpejta u ngritën njëra pas tjetrës dhjetëra fabrika dhe uzina të reja. U hodhën bazat

e industrisë së rëndë, u zgjerua dhe u zhvillua më tej industria e lehtë dhe lindën një varg degësh të prodhimit industrial, që nuk ekzistonin më parë. Industrializimi pati një rëndësi të madhe; ai forcoi bazën ekonomike të pushtetit popullor dhe ndihmoi për ngadhënjimin e plotë të marrëdhënieve të reja në prodhim. Gjatë kësaj kohe ngjanë ndryshime të thella edhe në fshat, i cili u fut në një rrugë të re zhvillimi. Nga viti 1957 nisi zëvendësimi me ritme të shpejta i pronës individuale me pronën e madhe kolektive, proces që u krye në fund të viteve 50. Hapat e para në ndërtimin socialist u hodhën në rrethanat e një lufte të ashpër klasore; borgjezia e madhe, bejlerët dhe forcat e tjera reacionare, të nxitura e të përkrahura nga imperialistët anglo-amerikanë dhe armiqtë e tjerë të jashtëm, s'lanë gjë pa bërë për të kthyer pozitën që kishin humbur.

Gjatë ndërtimit të themeleve të shoqërisë së re morën rëndësi të veçantë problemet e revolucionit kulturor. Para së gjithash dilte nevoja që t'i jepej fund padijes së madhe që u trashëguar nga regjimet e së kaluarës, të ngrihej niveli i kulturës së masave në përputhje me detyrat që shtronte shndërrimi socialist i jetës së vendit dhe të pajiseshin ato me ideologjinë marksiste-leniniste. Ndër detyrat e para ishte zhdukja e analfabetizmit, i cili në prak të çlirimit përfshinte 83% të punonjësve. Fill pas vendosjes së pushtetit popullor vendi u mbush me kurse dhe shkolla mbrëmjeje, që u ndoqën nga mijëra njerëz. Si rrjedhim i një pune këmbëngulëse prej disa vitesh, më 1955-1956 mori fund analfabetizmi nga radhët e punonjësve nën moshën 40 vjeç. Kjo pati rëndësi të madhe, sepse krijoi kushtet që masat të merrnin pjesë në mënyrë më të ndërgjegjshme, më aktive dhe më të gjerë në ndërtimin e jetës së re.

Në kuadrin e realizimit të revolucionit kulturor, pas çlirimit u mbyllën të gjitha institucionet e vjetra, të cilat kishin qenë vatra të përhapjes së ideologjisë reacionare. Një pjesë e institucioneve të mëparshme, si radioja etj., u riorganizuan në përputhje me politikën e pushtetit të ri. Në krye të tyre u vunë njerëz të sprovuar në luftë, besnikë ndaj popullit. Institucionet e reja kulturorë u bënë qendra të propagandimit të ideologjisë së re. Në të njëjtën kohë nisi një punë e madhe për botimin e literaturës mark-

siste-leniniste. U përkthyen dhe u botuan një sërë veprash të veçanta të klasikëve të marksizëm-leninizmit si «Manifesti i Partisë Komuniste» i K. Marksit dhe e F. Engelsit, «Ludvig Fojerbahu dhe fundi i filozofisë klasike gjermane», «Origjina e familjes, e pronës private dhe e shtetit» të F. Engelsit, «Ç'të bëjmë?», «Majtizmi, sëmundja foshnjore e komunizmit», «Imperializmi, faza më e lartë e kapitalizmit» etj. të Leninit, «Çështje të leninizmit» etj. e Stalinit. Më 1958 botohen në dy vëllime «Vepra të zgjedhura» të K. Marksit dhe F. Engelsit, «Vepra të zgjedhura» të Leninit. Në vitet 50 nis botimi në gjuhën shqipe i veprave të Leninit në 36 vëllime dhe i veprave të Stalinit. Krahas kësaj, u shpall një luftë e papajtueshme ideologjisë çifligaro-borgjeze; u demaskuan dhe u goditën ashpër ndikimet e filozofisë idealiste, konceptet dhe shprehitë e ndryshme borgjeze dhe feudale, apolitizmi dhe formalizmi.

Një punë e madhe u krye edhe për organizimin e arsimit në përputhje me kërkesat e ndërtimit socialist. E vendosur mbi themele të reja ideologjike dhe shkencore, shkolla mori një zhvillim të paparë: u zbatua arsimi fillor i detyrueshëm, u zgjerua shumë rrjeti i shkollave shtatëvjeçare, duke u përfshirë në të shumica e fëmijëve të moshës përkatëse. U rrit numri i shkollave të mesme të plota, të arsimit të përgjithshëm dhe profesional. Hovi i gjerë i ndërtimit të ekonomisë dhe të kulturës shtronte nevojën e përgatitjes së specialistëve në vend. Më 1946 në Tiranë çeli dyert Instituti Pedagogjik Dyvjeçar, hap i parë drejt arsimit të lartë. Në vitin 1951 u ngritën pesë institute të larta mësimore; në 1957 këto u shkrinë dhe u riorganizua arsimi i lartë, duke u themeluar Universiteti i Tiranës, qendra më e madhe arsimore e shkencore e vendit. Suksese të rëndësishme u arritën edhe në zhvillimin e shkencës; u themelua Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH, dhe shumë qendra dhe institucione të tjera shkencore, të cilat organizuan veprimtarinë kërkimore-shkencore në fusha të ndryshme.

Kështu në fund të viteve 50, mbi bazën e sukseseve të rëndësishme në lëmin shoqëror dhe ekonomik u bënë hapa të rëndësishme edhe në ngritjen e kulturës së re socialiste.

Përkrah me kulturën, bëri përpara edhe letërsia. Me vendosjen e rendit popullor u krijuan kushte shumë të favorshme për veprimtarinë letraro-krijuese. Në këtë kohë hidhen bazat për një zhvillim më të gjerë dhe më të organizuar të letërsisë. Me gjithë mungesat dhe vështirësitë që haste vendi në ato vite, Partia dhe pushteti morën masa për t'u krijuar shkrimtarëve e artistëve kushte të përshtatshme pune. Për të nxitur krijimtarinë letraro-artistike, nisën të organizohen konkurse të ndryshme, shtohen mundësitë për të botuar sa më shumë vepra letrare. Në vitin 1949 u botua ligji për mbrojtjen e të drejtave të autorit. Ngjarje e rëndësishme ishte themelimi në nëntor 1945 i Lidhjes së Shkrimtarëve, i së parës organizatë të këtij lloji në Shqipëri, e cila i vuri vetes si detyrë të bashkonte të gjitha forcat letrare, që kishin shpallur gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në ndërtimin e Shqipërisë së re dhe në zhvillimin e revolucionit kulturor.

Bërthamën kryesore të lëvizjes letrare të kohës e përbënin shkrimtarët pjesëmarrës të Luftës Nacionalçlirimtare. Pas Çlirimit atyre iu hapën mundësitë që të zhvilloheshin më tej nga ana artistike dhe të formoheshin si shkrimtarë të realizmit socialist. Poema satirike «Do të bëhen zgjedhjet» dhe reportazhet nga jeta e sotme e Sh. Musarajt, novelat e Dh. S. Shuteriqit, tregimet dhe skicat e F. Gjatës, të Z. Sakos, të J. Xoxës, vjershat dhe poemat e A. Çaçit, Ll. Siliqit, etj., drama «Halili dhe Hajrija» dhe komedia «Dom Gjoni» të K. Jakovës etj., ishin veprat e para të letërsisë së re që nisi të zhvillohej pas Çlirimit.

Në radhët e letërsisë së re hynë një varg shkrimtarësh përparimtarë disa prej të cilëve kishin me vete një veprimtari pak a shumë të gjatë letrare. Fitorja historike e popullit shqiptar mbi forcat obskurantiste, çlirimi i vendit prej zgjedhës së sunduesve të huaj, shndërrimet e thella që po kryeshin në lëmin ekonomik, shoqëror dhe kulturor, ushtruan ndikim pozitiv në krijimtarinë e këtyre shkrimtarëve. Të frymëzuar nga entuziazmi i përtëritjes së jetës së vendit, ata e vunë talentin në shërbim të masave popullore. Disa syresh, si N. Bulka, H. Stërmilli, S. Spasse, hynë

pa vështirësi të mëdha në rrugën e letërsisë së re; afërsia me idetë demokratike dhe fryma përparimtare e krijimtarisë së tyre në vitet 30 ua bënë më të lehtë kalimin në pozita të reja ideore dhe artistike. Për një palë tjetër riedukimi zgjati më shumë dhe u bë duke kaluar ndonjëherë pengesa jo të vogla.

Ndër problemet qendrore të jetës letrare në këtë periudhë ishte problemi i rrugës nëpër të cilën do të ecte letërsia e re, problemi i ideshmërisë dhe i partishmërisë komuniste, problemi i qëndrimit të letërsisë ndaj jetës etj. Me politikën e saj në fushën e kulturës Partia, duke çmuar rolin e madh edukativ shoqëror të artit, kërkonte një letërsi që të mirrte pjesë aktive në ndërtimin e jetës së re, duke edukuar njerëzit në përpunime me kërkesat që paraqiste shndërrimi i shoqërisë shqiptare. Duke folur për karakterin e kulturës së re, shoku Enver Hoxha ka thënë më 1954, se ajo «... duhet t'u shërbejë besnikërisht interesave të klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, t'u shërbejë këtyre klasave si armë e fuqishme për të ndërtuar socializmin dhe për të luftuar tërë armiqtë e klasës»¹.

Në jetën letrare të viteve të para të pasçlirimit u pasqyrua situata e ndërlikuar në të cilën nisi ndërtimi socialist, sidomos lufta e klasave që zhvillohej në lëmin politik dhe ideologjik.

Letërsia e re që në hapat e saj të parë ndeshi në qëndrimin armiqësor të përfaqësuesve të rrymave letrare antipopullore, të cilët, duke fshehur qëllimet e tyre të vërteta, kishin mundur të hynë në organizatën e shkrimtarëve. Si shprehës të interesave të klasave të përmbysura, që në atë kohë po bënin qëndresë të tërbuar kundër rendit të ri, shkrimtarët antipopullorë u orvatën në mënyrë të fshehur, por ndonjëherë edhe haptazi, të pengonin zhvillimin e letërsisë. Ata dolën kundër përpjekjeve të shumicës së shkrimtarëve për të marrë pjesë aktive në ngritjen e jetës së re dhe për këtë qëllim mbrojtën tezën reaksionare të «artit për art». «...kohët e fundit, — shkruante njeri nga letrarët reaksionarë — ka filluar të bëhet fjalë, se arti duhet të ketë qëllime edukative, politike, etj. Mua më duket se një pikëpamje e tillë

1) E. Hoxha, *Vepra*, vëllimi 12, Tiranë 1972, f. 164.

është e gabuar, se atëherë në vend të artit do kemi moral, histori, politikë, por jo art të vërtetë. Po ta përdorë artisti vullnetin e tij për të kthyer artin në një instrument didaskalik, po ta bëjmë artin shërbëtor të politikës ose të moralit, atëherë s'ka më art»¹. Këto mendime ishin drejtuar kundër letërsisë së re, e cila shprehte interesat e masave punonjëse që revolucionin popullor i bëri zotër të jetës.

Letrarët borgjezë u ngritën kundër parimit të partishmërisë, të cilin e quanin si kufizim që i vihej artistit në punën e tij krijuese; vetëdijes, momentit të vetëdijshëm, ata i vunë përballë intuitën, dhe me këtë kërkonin t'i shtynin shkrimtarët në rrugën e krijimeve subjektivistike e pa vlerë shoqërore. Në këtë frymë disa nga këta letrarë shkruan edhe vepra, që shquheshin nga fryma e indiferentizmit dhe nga mungesa e idesë.

Dëm të madh letërsisë së re i solli edhe veprimtaria e S. Malëshovës. Duke shfrytëzuar postin e ministrit të kulturës, ai shtrembëroi politikën e Partisë në lëmin e kulturës dhe të arteve. S. Malëshova nuk kishte besim në masat punonjëse dhe mbicmonte forcën e klasave të rrëzuara nga pushteti. Së këtejmi ridhte oportunitizmin dhe qëndrimet liberale që shfaqte në problemet e zhvillimit të kulturës së re. Në një kohë kur Partia kërkonte që letërsia të mirrte pjesë aktive në ndërtimin e socializmit, S. Malëshova mori në mbrojtje shkrimtarë reaksionarë, që sulmuan parimin e partishmërisë së letërsisë. Në lëmin e ideve ai predikonte butësi dhe tolerancë ndaj tezave dhe doktrinave reaksionare. Besnik në përruljen e tij para kulturës borgjeze, S. Malëshova jo vetëm nuk kishte besim në forcat e reja letrare që dolën nga gjiri i Luftës Nacionalçlirimtare, por edhe shfaqte ndaj tyre një përcimim të hapur. Qëndrimi i tij liberalo-borgjez u shpreh edhe në çështjen e qëndrimit ndaj trashëgimit kulturor të së kaluarës. S. Malëshova ishte për integrimin e kulturës antipopullore çifligaro-borgjeze në kulturën e re. Letrarët reaksionarë, si Gj. Fishtë, F. Konicën etj., ai i vinte barabar për sa i përket rëndësisë për shoqërinë socialiste, me përfaqësuesit e shquar të letërsisë përparimtare, si N. Frashërin, Nolin, Migjenin etj.

1) Shih: «Bota e re», Tiranë 1945, Nr. 2, f. 16.

Të udhëhequr nga Partia, shkrimtarët, që e kishin lidhur krijimtarinë e tyre me çështjen e socializmit, shpartalluan pikëpamjet armiqësore të letrarëve antipopullorë, mbrojtën rolin e madh edukues shoqëror të artit, nevojën e lidhjes së tij me jetën dhe përpjekjet e masave punonjëse. Ata luftuan që letërsia e re që po krijohet t'i shërbente ndërtimit socialist, të edukonte njerëzit me koncepte dhe ndjenja të reja.

Krahas pikëpamjeve borgjeze reaksionare lidhur me krijimtarinë letrare, Partia luftoi edhe kundër shfaqjeve nihiliste sektare në çështjen e qëndrimit ndaj trashëgimit letrar të së kaluarës. Në vitet e para pas Çlirimit për këtë problem kishte paqartësi. Aty-këtu i vihej vizë çdo gjëje pozitive në historinë e kulturës kombëtare, mohohet rëndësia e traditave të letërsisë patriotike dhe përparimtare të së kaluarës. Dëm të madh solli fryma e mohimit të trashëgimit kulturor të së kaluarës në përgjithësi dhe përcimimi për artet dhe kulturën në veçanti, që nxiste K. Xoxe me njerëzit e tij. Partia i kundërshtoi ashpër këto pikëpamje vulgarizuese e nihiliste dhe u ndihmoi shkrimtarëve të kuptojnë drejt rëndësinë e traditave dhe të vlerave pozitive të së kaluarës në ndërtimin e letërsisë së re. Më 1950 me vendim të KQ të PPSH në gjithë vendin u përkujtuam me madhësi jubiletë e katër prej figurave më të shquara të Rilindjes Kombëtare: i K. Kristoforidhit, i N. Frashërit, i S. Frashërit dhe A. Z. Çajupit. Në të njëjtën kohë nisi studimi i vëmendshëm dhe popullarizimi i krijimtarisë së shkrimtarëve përparimtarë të së kaluarës. U botuan artikuj dhe studime mbi veprën e N. Frashërit, A. Z. Çajupit, Migjenit etj.

Konferenca III e Lidhjes, që u mbajt në tetor të vitit 1949, bëri bilancin e rrugës së përshkuar nga letërsia e re që nga Çlirimi e deri në atë kohë dhe përcaktoi detyrat për zhvillimin e saj të mëtejshëm. Vëmendje të madhe pjesëmarrësit e Konferencës i kushtuan problemit të afrimit të letërsisë me jetën, problemit të brendisë ideore dhe problemit të partishmërisë komuniste të veprave letrare. Konferenca vuri në dukje si fakt pozitiv shtimin e kontakteve të krijuesve me popullin, me jetën e re, por në të njëjtën kohë u theksua nevoja, që këto lidhje të zgje-

roheshin më tej, që shkrimtarët të jetonin më intensivisht me ngjarjet e mëdha të kohës, me gëzimet dhe me shqetësimet e masave. Shkrimtarët, thuhej në raportin që u mbajt në Konferencë, duhet «të frymëzohen në krijimet e tyre, ... nga heroizmi dhe hovi revolucionar i masave në luftën për ndërtimin e bazave të socializmit; të krijojnë lidhje të ngushta me masat e popullit dhe të marrin pjesë aktive në jetën dhe në luftën e tyre të sotme; të ndjekin zhvillimin e shoqërisë sonë, që bëhet sot në formë të organizuar dhe me plan, nën drejtimin e Partisë dhe të Shtetit»¹. Lidhur me këtë u theksua rëndësia e forcimit të frymës së partishmërisë komuniste në të gjithë krijimtarinë letrare.

Çështja tjetër e rëndësishme së cilës iu kushtua shumë vëmendje në punimet e Konferencës, ishte ajo e metodës krijuese të realizmit socialist. Si në raport ashtu edhe në diskutimet u theksua se realizmi socialist duhet të bëhet metodë krijuese e gjithë shkrimtarëve, udha nëpër të cilën do të ecë letërsia e re. Shkrimtarët, thuhej në rezolutën e Konferencës, duhet «të bëjnë për vete metodën e realizmit socialist dhe ta bëjnë këtë metodë bazë të krijimeve të tyre letrare; të bëjnë përpjekje për ngritjen e tyre ideopolitike, duke përvetësuar teorinë shkencore të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit në lëmin e arteve e të kulturës, dhe të japin gjithë kontributin e tyre për ndërtimin e letërsisë sonë në formë nacionale dhe me përmbajtje socialiste»².

Në Konferencë iu dha vend edhe problemit të qëndrimit ndaj trashëgimit kulturor vendas dhe të huaj. Letërsia e re, u tha në diskutimet, nuk mund të zhvillohet duke lënë mënjanë çdo gjë të mirë nga letërsia kombëtare dhe ajo botërore. Për këtë u rekomandua që shkrimtarët të mësojnë nga përfaqësuesit e shquar të letërsisë përparimtare vendase dhe veçanërisht nga krijimtaria artistike gojore dhe nga gjuha e gjallë dhe e pasur e popullit.

Duke pasur parasysh ngritjen e vazhdueshme të ni-

velit kulturor të masave, etjen e tyre të madhe për lexim, konferenca diskutoi edhe problemin e shtimit të prodhimit letrar, të rritjes së numrit të veprave, si rruga e ngritjes së rolit të letërsisë në edukimin e njerëzve. Në lidhje me këtë u prek çështja e zgjerimit të radhëve të letërsisë nëpërmjet tërheqjes dhe aftësimit sa më të shpejtë të talenteve të reja nga gjiri i popullit. Për këtë qëllim, me vendim të Konferencës, nisi botimi i gazetës «Letrari i ri» (1949-1953), e cila dha kontribut për zbulimin dhe edukimin e të rinjve me talent.

Konferenca kurorëzoi luftën e zhvilluar pas Çlirimit për demaskimin e shfaqjeve të ideologjisë armike dhe në mënyrë të veçantë të koncepteve liberalo-borgjeze. Duke dërmuar përpjekjet e armiqve të Partisë dhe të pushtetit popullor për të penguar krijimtarinë letrare, Konferenca sheshoi rrugën për një zhvillim më të mbarë të saj në rrugën e realizmit socialist.

Në vitet 50 letërsia rritet në mënyrë të ndjeshme. U forcuan në pikëpamje artistike shkrimtarët që kishin nisur punën letrare në vitet 30, gjatë luftës kundër pushtuesve fashistë ose fill pas Çlirimit. Shumë prej tyre dalin me vepra të pjekura letrare. Krahas kësaj radhët e letërsisë plotësohen me forca të reja të talentuara. Në këtë periudhë u krijuan një varg veprash me vlerë, në të cilat jeta u pasqyrua me vërtetësi dhe me nivel të denjë artistik. Vend të rëndësishëm vijoi të zërë tema e luftës kundër pushtuesve fashistë, e cila tërhoqi vëmendjen e shkrimtarëve jo vetëm me frymën heroike të ngjarjeve dhe të akteve të njerëzve, por edhe me konfliktet e rëndësishme shoqërore që karakterizuan jetën e vendit në atë periudhë. Në romanet «Ata nuk ishin vetëm» të S. Spasses, «Përmbysja» të F. Gjatës, «Çlirimtarët» të Dh. S. Shuteriqit autorët u përpoqën të vizatojnë kuadrin e gjerë epik të jetës së shoqërisë shqiptare në prag dhe gjatë përleshjes me pushtuesit e huaj dhe veglat e tyre dhe, lidhur me këtë, paraqitën më thellë dhe nga anë të ndryshme rolin e Partisë si frymëzuese dhe organizatore e lëvizjes popullore antifashiste.

Krahas kësaj, shkrimtarët, qofshin prozatorë, poetë apo dramaturgë, vunë kujdes të paraqesin në veprat e tyre

1) Konferenca III e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë (9-12 tetor 1949), Tiranë 1950, f. 110.

2) Po aty, f. 110.

edhe ndryshimet socialiste, luftën midis botës së vjetër dhe rendit të ri që po zinte rrënjë dhe po forcohej çdo ditë e më shumë. Në dramën «Toka jonë» të K. Jakovës, në romanet «Kënetat» të F. Gjatës dhe «Afërdita përsëri në fshat» të S. Spasses, në poemat «Mësuesi» e «Miku» të Ll. Siliqit, në novelat, tregimet dhe vjershat e Sh. Musarajt, të Dh. S. Shuteriqit, të F. Gjatës, të A. Çaçit, të J. Xoxës, të Z. Sakos, të L. Qafëzezit, të A. Banushit, të S. Çomorës, të M. Gurakuqit, etj. dhe në shkrimet e autorëve të tjerë u vizatua procesi i vështirë i ndërtimit të jetës së re, ashpërsimi i luftës së klasave, u pasqyruan mendimet dhe ndjenjat e reja të njerëzve.

Zgjerimi i sferës së realitetit socialist në veprat letrare, paraqitja e aspekteve dhe e konflikteve të reja të periudhës së Luftës Nacionalçlirimtare, synimi për të dhënë në mënyrë sa më të plotë botën e pasur shpirtërore të njeriut të ri — të gjitha këto u dhanë shkas kërkimeve edhe në lëmin e formës artistike, përdorimit të mënyrave dhe të mjeteve të reja të pasqyrimit artistik të jetës.

Në pasurimin dhe zhvillimin e krijimtarisë letrare kontribut me vlerë dhanë penat që erdhën në letërsi sidomos në pjesën e dytë të viteve 50. Kujdesi i Partisë për letërsinë, sukseset e para të revolucionit kulturor sollën një lulëzim të paparë të aftësive krijuese të masave, ndihmuan që të merrte rrugë problemi i kuadrit letrar, i cili kishte qenë shumë i mprehtë më parë. Kjo bëri që të hynin në radhët e shkrimtarëve një numër i madh talentesh të reja dhe jeta e letërsisë të bëhej më e gjallë dhe më e pasur. Në këtë periudhë shfaqen një varg emrash të rinj, si: I. Kadare, D. Agolli, Dh. Xhuvani, N. Prifti, A. Abdihoxha, D. Shaplllo, D. Siliqi, D. Bubani, V. Ziko, S. Pitarka etj. Shumica erdhën në letërsi me temën e ndërtimit socialist; në krijimet e tyre u paraqitën tiparet e reja thelbësore të njerëzve tanë, veçanërisht të rinisë, që u rrit në atmosferën e rendit të ri shoqëror. Duke prekur probleme të reja ose duke lëruar më thellë temat që ishin trajtuar më parë, disa nga penat e reja e pasuruan letërsinë nga brendia, përtërinë gjuhën, sollën një larmi mjjetesh dhe shprehjesh artistike.

Rritja dhe pasurimi i mëtejshëm i letërsisë nuk u arrit

lehtë pa vështirësi. Për të kapur caqe të reja u desh të kapërceheshin një varg të metash dhe prirjesh të gabuara artistike, të cilat pengonin përparimin e letërsisë. Në praktikën letrare pati shfaqje të skematizmit, të deklarativizmit dhe të retorizmit të zbrazët. U vu re një farë nënvleftësimi i individualitetit krijues dhe prirja për paraqitjen e gjërave të njohura. Në praktikë, kjo çoi si pasojë edhe në nënvleftësimin e kërkimeve novatore, gjë që i dha shkas shfaqjes së një vargu të metash si: rutina, shabllonizmi, figurat stereotipe, monotonia e temave dhe e formave të mishërimit të tyre artistik etj. Lidhur me mundësitë dhe rrugët e pasurimit të krijimtarisë letrare si në brendi, ashtu edhe në formë, dhe të përtëritjes së mjeteve artistike të poezisë në përputhje me zhvillimin dinamik të jetës, dhe, më tej lidhur me marrëdhëniet në mes të traditës e novatorizmit në poezinë e sotme, në faqet e shtypit letrar, kryesisht të gazetës «Drita», në fund të viteve 50 u ndez një diskutim i gjerë. Diskutimi nxori në pah nevojën e domosdoshme të përtëritjes së formave dhe të mjeteve poetike të pasqyrimit të jetës dhe bëri të qartë se ulja e kërkesave në krijimtarinë letrare ishte e dëmshme, se frika e ndonjë letrari se mos kërkimet novatore u hapin shtegun krijimeve subjektivistë, formalistë ishte pa vend. Si rezultat i shkëmbimit të mendimeve të ndryshme, u kapërcyen konceptet artistike frenuese dhe kërkimet novatore u quajtën si diçka e ligjshme dhe e domosdoshme për përparimin e krijimtarisë letrare. Përpjekjet e një vargu autorësh për pasurimin e letërsisë në brendi dhe në formë u përkrahën nga Partia, e cila e shihte këtë si kërkesë të vetë jetës socialiste, të pasur dhe të larmishme, dhe si nevojë të domosdoshme për të kënaqur shijet estetike të masave të lexuesve. «Përpjekjet që po bëhen nga disa shkrimtarë e artistë drejt novatorizmit në poezi, pikturë, grafikë etj. duhet të frymëzohen kurdoherë nga qëllimi për të pasuruar letërsinë dhe artin tonë të ri, duke u mbështetur në trashëgiminë më të mirë letrar të popullit tonë dhe gjithnjë mbi bazën e realizmit socialist. Partia përkrah çdo gjë të re, të bukur e të shëndoshë, duke luftuar njëkohësisht çdo tendencë formaliste e armiqësore për artin tonë të ri socialist», — thuhej në Vendimin e KQ të

PPSH «Mbi zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe të ar-
teve», mbajtur në maj 1961¹.

Zhvillimi i përgjithshëm i letërsisë në këtë periudhë
u përcaktua nga përpjekjet e të gjithë krijuesve për pas-
qyrimin sa më të plotë të realitetit socialist, të konflikteve
dhe të proceseve që merrnin jetë nga lufta midis botës
së vjetër dhe botës së re. Me gjithë sukseset serioze që
ishin arritur, shkrimtarët nuk kishin krijuar ende figura
të gjalla të përfaqësuesve të klasës punëtore; pak vepra
kishin për jetën dhe aktet heroike të masave punonjëse.
Zbrazëti të ndjeshme vëreheshin edhe në pasqyrimin e je-
tës së re të fshatit shqiptar, të vështirësive dhe kontra-
diktave që lindnin në procesin e kalimit të tij në rrugën
socialiste. Në veprat kushtuar aktualitetit jo gjithnjë traj-
toheshin konfliktet e mprehta reale të jetës, lufta këmbë-
ngulëse dhe plot vetëmohim e masave, gjë që sillte me
vete si pasojë vizatimin e përciptë të karaktereve të per-
sonazheve. Të meta kishte edhe në thurjen e subjektit, në
organizimin e kompozicionit dhe në gjuhën e veprave let-
rare; kjo tregonte se duhej bërë një punë me përgjegjësi
dhe ngulmuese nga të gjithë krijuesit për përvetësimin e
mjeshtërisë artistike. Këto probleme ishin në qendër të
punimeve të Kongresit I të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe
të Artistëve të Shqipërisë, që u mbajt në maj 1957. Kongresi
vuri në dukje se letërsia kishte shënuar përparime të më-
dha në krahasim me fillimet e saj, por, megjithatë, ajo
vijonte të mos u përgjigjej ende si duhej kërkesave të le-
xuesve, niveli kulturor dhe estetik i të cilëve ishte ngrit-
tur mjaft. Duke e quajtur si detyrë themelore të krijim-
tarisë letrare pasqyrimin sa më të gjerë dhe më thellë të
ndërtimit socialist, Kongresi i porositi shkrimtarët që të
drejtonin vëmendjen e tyre në radhë të parë në konfliktet
që mirrin shkas nga përpjekjet e masave punonjëse për
të kapërcyer prapambetjen shekullore dhe për të ngrit-
tur shoqërinë e re. Lidhur me trajtimin më të gjerë të te-
matikës aktuale, vend të rëndësishëm në punimet e Kongre-
sit zuri çështja e njohjes së realitetit, çështja e lidhjes më

1) Nëntori, 1961, Nr. 6, f. 7.

të ngushtë me jetën e popullit. Nga krijuesit u kërkua që
të jetonin më intensivisht me problemet e mëdha të jetës
së vendit, me zhvillimet e reja të shoqërisë socialiste në
ngritje e sipër, të studionin me ngulm proceset dhe ndry-
shimet shoqërore. Krahas pasurimit të mëtejshëm të te-
matikës dhe të problematikës së krijimtarisë u shtrua de-
tyra e ngritjes së mjeshtërisë artistike. Krijimtaria letrare
ishte vënë në rrugën e pjekurisë, por për të ecur me ritmin
e zhvillimit të jetës, duhej edhe një njohje e mirë e mje-
shtrisë. Kongresi tërhoqi vëmendjen e shkrimtarëve lidhur
me nevojën e shtimit të përpjekjeve për zotërimin e më-
tejshëm të teknikës së punës letrare, për ngritjen e nivelit
të përgatitjes profesionale në përputhje me detyrat e mëdha
që qëndronin përpara shkrimtarëve. Në të njëjtën kohë
Kongresi porositi shkrimtarët që të forconin formimin e tyre
ideologjik, duke zotëruar në mënyrë akoma më të thellë e
në mënyrë organike botëkuptimin marksist-leninist.

Rëndësi të veçantë Kongresi pati edhe për faktin se u
doli zot parimeve të realizmit socialist, duke i mbrojtur
ato nga sulmet e revizionistëve, që ishin bërë asokohe gjë
e shpeshtë dhe pothuajse e modës në një varg vendesh
socialiste, ku në krijimtarinë letrare po forcoheshin prir-
jet antisocialiste dhe ndikimet e letërsisë borgjeze dekadente.

3

Letërsia e re nisi udhën e vet nën përshtypjen e fuqi-
shme të Luftës Nacionalçlirimtare, si ngjarje e madhe his-
torike, që shënoi kthesë rrënjësore në jetën e vendit.
Shkrimtarët iu drejtuan viteve të luftës për të treguar kom-
pleksitetin e ngjarjeve dhe të marrëdhënieve politike mi-
dis klasave dhe shtresave të ndryshme shoqërore, procesin
e diferencimit që ndodhi në radhët e tyre. Duke pasqy-
ruar konfliktet kryesore politike të epokës dhe zgjidhjen
e tyre në procesin e zhvillimit revolucionar të jetës, letër-
sia vuri në dukje rëndësinë e madhe historike të Luftës
Antifashiste Nacionalçlirimtare për fatet e vendit, tregoi
se si me ngadhënjimin e revolucionit popullor u flakën
tej klasat e vjetra sunduese dhe të gjithë forcat reaksio-
nare dhe antipopullore që me shekuj i kishin qëndruar

në zverk Shqipërisë. Përkrah me këtë shkrimtarët paraqitën edhe heroizmin e vegjëlisë, cilësitë e reja morale e shpirtërore, që shfaqën njerëzit e thjeshtë në vitet e kësaj sprove të rëndë.

Krijimtaria letrare e kësaj periudhe erdhi vazhdimisht duke u zgjeruar dhe duke u pasuruar në brendi; aspekte të reja të jetës tërheqin shkrimtarët. Thuajse në të njëjtën kohë krahas Luftës Nacionalçlirimtare, objekt i vëmendjes së tyre u bë edhe jeta e sotme e popullit me proceset e reja që nisën të shtillen në gjirin e saj, marrëdhëniet shoqërore socialiste, jeta dhe përpjekjet e ndërtuesve të shoqërisë së re, gëzimet dhe brengat e tyre. Kuptohet, në fillim tema e jetës së re gjeti pasqyrim në vjershat dhe këngët, por krahas gjinive të vogla, ndërtimi socialist u pikturua edhe në vepra të gjinive të mëdha, si romane, drama e poema.

Në vitet 50 në tematikën e letërsisë hyri edhe e kaluara historike. U botuan vepra, që pasqyrojnë jetën e rëndë, plot mundime e brenga të fshatarëve të varfër dhe të vegjëlisë së qytetit para Çlirimit, arbitraritetin dhe parazitizmin e klasave të pasura, zgjimin shoqëror të masës dhe ndeshjet e para, spontane, të paorganizuara të fshatarësisë revolucionare me bejlerët dhe agallarët.

Sado pak në letërsi gjeti pasqyrim edhe tematika ndërkombëtare, solidariteti i popullit shqiptar me popujt e vendeve socialiste, me masat punonjëse dhe klasën punëtore të shteteve kapitaliste, si dhe me popujt e të gjithë rruzullit tokësor që luftonin kundër planeve luftënxitëse të imperialistëve anglo-amerikanë dhe forcave të tjera reaksionare.

Zhvillimi letrar në vitet 50 u karakterizua nga një pasuri relativisht e mirë në lloje dhe gjini, sidomos po të kihet parasysh se e kaluara nuk la në këtë fushë ndonjë trashëgim të rëndësishëm për sa i përket formave të mëdha në prozë.

Poezia, duke nisur nga vjersha politike, balada, soneti, lirika e peizazhit dhe e mendimit e duke përfunduar me poemat liriko-epike dhe ato epike, me subjekt, është lloji i krijimtarisë letrare që pati një zhvillim të mbarë në këtë periudhë. Karakteristike për poezinë ishte patosi qytetar; shumë krijime poetike ngërthyen një brendi të gje-

rë dhe ndonjëherë këtë e bënë duke thyer kufijtë gjinorë të caktuar nga traditat e mëparshme.

Lirika e kësaj periudhe u përfaqësua nga vjersha politike qytetare, nga vjersha e shkurtër me përmbajtje lirike emocionale, që i këndonte jetës së re, nga lirika filozofike, lirika e natyrës, lirika e dashurisë etj. Një kapitull të veçantë në poezinë e kësaj periudhe formon satira në vargje, e cila u zhvillua si në format e vogla, ashtu edhe në të mëdhatë.

Përveç lirikës merr zhvillim edhe lloji i poemës. U lërua më shumë poema liriko-epike, e cila u shfaq që në vitet e para pas Çlirimit. Sikurse gjithë lirika, poema në fillim u shqua nga notat deklamative oratorike, gjë që gjen shpjegimin e vet në entuziazmin dhe vrullin e ngritjes së jetës së re. Më pas, poema liriko-epike pësoi një varg ndryshimesh cilësore. Shprehjes së mendimeve dhe të ndjenjave entuziaste ia zuri vendin paraqitja konkrete e njeriut dhe e botës së tij të brendshme, interesimi për ngjarje dhe fakte të rëndomta të jetës. Brendia e re çoi në ndryshimin e strukturës së brendshme të këtij lloji poetik. Poema liriko-epike e pjesës së fundit të viteve 50 mori karakterin e një ligjërimi të shtuar ose të monologut lirik, gjuha u bë më e thjeshtë dhe stilistika më shprehëse.

Synimi për të dhënë në mënyrë sa më të plotë figurën e njeriut të ri, të partizanit, të ndërtuesit të jetës socialiste, çoi në shfaqjen edhe të poemës epike, tregimtare. Në vitet 50 u shkruan shumë poema të tilla. Disa poema epike, ato në të cilat karakteri i heroit u zbulua përmes episodesh konkrete dhe imtësish realiste shprehëse, u pritën mirë nga publiku lexues dhe hynë në fondin e poezisë shqiptare të realizmit socialist, por pati mjaft poema që vuanin nga karakteri thjesht përshkrues; në to mendimet dhe ndjenjat nuk zbuloheshin përmes marrëdhënieve midis personazheve të veprës, por deklaroheshin nga poeti. Narracioni i thatë dhe vrullet lirike, që futeshin në poemë vend e pa vend, vargjet e zbrazëta dhe figurat e shfrytëzuara së tepërmi, ishin të metat kryesore të këtyre poemave.

Një pasuri e gjerë llojesh dhe formash artistike dallonte edhe prozën, ku u vu re një zhvillim i mirë i skicës dhe i tregimit. Në një varg tregimesh të kësaj kohe gjejmë një

subjekt, që shtillet në mënyrë të lidhur, por disa tregime afrohen shumë me skicën ose reportazhin letrar, ku zakonisht mungon subjekti si element organizues dhe ngjarja shtillet lirisht, duke u ndërprerë nga arsyetime ose përshkrime lirike dhe ku, si rregull, veprimi nuk i nënshtrohet rreptësisht një vije të caktuar zhvillimi. Në prozën e kësaj periudhe ndeshim edhe me një tip tjetër tregimi, ku në themel të subjektit qëndron një ngjarje dramatike dhe veprimi zhvillohet në mënyrë të përmbledhur e të shpejtë. Krahas tregimit në këtë periudhë mori përhapje edhe skica, e cila me saktësinë e dokumentit u rrëfeu lexuesve për ndodhi dhe fakte historike. Me këtë është e lidhur lindja e prozës dokumentare, që përshkroi beteja të rëndësishme të njësive partizane, akte të larta heroike të komisarëve, të komandantëve dhe të partizanëve të thjeshtë. Skica u përdor sidomos për të dhënë historinë e objekteve të reja industriale.

Po dukuria më e shënuar dhe më e rëndësishme në këtë periudhë është lindja e romanit shqiptar të realizmit socialist. Para Çlirimit ky lloj letrar sapo nisi të bënte hapat e parë; me veprim të thjeshtë, me thurje naive të ngjarjeve dhe me një numër të vogël personazhesh, romani i mëparshëm i ngjiste më shumë novelës. Në të ndikoi poetika e sentimentalizmit, që u shpreh në interesin e tepruar për peripecitë e shumta që hasnin heronjtë derisa bashkoheshin dhe në notat e shumta melodramatike. Romani i sotëm shënoi një dukuri të re në historinë e letërsisë shqiptare. Kuptohet, se në vitet 50 romani ishte në fillimet e tij: gjithsej u botuan afro dhjetë romane. Megjithatë në romanet e parë vihen re një varg tiparesh të reja. Qoftë kur pasqyron shoqërinë shqiptare në vitet e Luftës Nacionalçlirimtare dhe rikrijon të shkuarën historike, qoftë kur u jep vend konflikteve familjare dhe çështjeve etike e morale, romanin e sotëm e karakterizon synimi për të krijuar karaktere tipike të gjalla, të cilat në mendimet dhe në veprimet e tyre zbulojnë ligjëroritë thelbësore të jetës. Synimi për të rrahur probleme të mëdha shoqërore çoi në forcimin e frymës epike, që gjeti shprehje në synimin për të dhënë përgjithësime të gjera artistike, për të vizatuar pamje të shtrira të proceseve që shtillen në shoqëri. Megjithëse në këtë periudhë kemi vetëm përpjekjet e para për krijimin

e romanit — epike, vetë synimi për të krijuar kuadro epike të jetës dëshmonte se letërsia kishte hyrë në rrugën e pjekurisë së vërtetë artistike.

Në dramaturgji, pati vepra të llojeve të ndryshme — komedi, drama historike, drama politiko-shoqërore dhe drama etiko-morale. Megjithatë kjo fushë e krijimtarisë letrare eci rryeshëm. Në zhvillimin e vet dramaturgjia u ndesh me të meta të ndryshme, si skematizëm, natyralizëm dhe një farë prirjeje për t'u marrë së tepërmi me imtësitë etnografike të jetës.

POEZIA

1

Poezia e kësaj periudhe u përshkua nga patosi i jetës së re, ajo shprehu entuziazmin që ngjalli tek njerëzit lufta për ndërtimin e shoqërisë socialiste, vendosmërinë e tyre për të mbrojtur fitoret e revolucionit.

Në krye poetët shprehën ndjenjën e gëzimit dhe të krenarisë të masave të popullit, të cilët zhdukën zgjedhën e huaj dhe i hapën vendit një rrugë të ndritur zhvillimi. Karakteristike për poezinë në hapat e saj të parë ishin motivet heroike. Nga epopeja e lavdishme e luftës kundër pushtuesve të huaj poetët zgjodhën ato ngjarje dhe fakte, në të cilat u shfaq me qartësi të veçantë entuziazmi patriotik i viteve të luftës, guximi dhe shpirti i lartë i sakrificës që shquajti luftëtarët për çlirimin e vendit. Admirimi për frymën heroike të kësaj periudhe u shpreh në vjersha, balada dhe poema, të shkruara më të shumtën e herës me nota patetiko-burrërore.

PRISHTINA

Një nga veprat më të njohura dhe më prekëse të viteve të para pas Çlirimit është poema «Prishtina» (1949) e Ll. Siliqit. Ll. Siliqi në këtë kohë ishte një nga figurat më aktive të letërsisë së re dhe luajti rol të shënuar në krijimin e poezisë politike luftarake, të përshkuar nga fryma e partisë. I vetëdijshëm për misionin shoqëror të poezisë, Ll. Siliqi zhvilloi një veprimtari të gjerë si poet, duke u bërë jehonë ngjarjeve të rëndësishme të vendit, vrullit të punës ndërtimore dhe ndodhive të jetës politike ndërkombëtare. Për talentin e tij janë karakteristike notat patetike, ligjërimi plot pasion, fryma publicistike, pasuria e

përjetimeve vetjake. Një vit pas botimit të poemës «Prishtina», ai doli para lexuesit me vëllimin «Rruga e lumturisë», në të cilin përmbloodhi krijimet e tij më të mira që nga koha kur nisi punën e tij letrare. Tre vjet më vonë, më 1955, pa dritën e botimit përmbledhja «Vjersha dhe poema», e cila u shqua nga pasuria e temave dhe e ideve.

«Prishtina» është vepra më e mirë e Siliqit me temë Luftën Nacionalçlirimtare.

Në hartimin e poemës «Prishtina» poeti mori shkas nga një fakt politik i jetës së vendit pas Çlirimit. Ngadhënjimi i revolucionit popullor i egërsoi qarqet reaksionare të Perëndimit të cilat me qëllime të caktuara nisën të çirreshin në shtypin e tyre se Shqipëria gjoja nuk paskish luftuar krahas popujve të tjerë të robëruar për zhdukjen e murtajes fashiste. Kundër këtyre shpifjeve të ulëta, u ngrit i gjithë opinioni i vendit dhe i çori perden kësaj prapaskene të kurdisur nga forcat reaksionare botërore për qëllime agresive. Në poemë sikur kumboi me forcë zëri i vetë popullit, shpërthimi i zemërimit të tij kundër provokacioneve të ulëta të armiqve, ndjenja e ligjshme e krenarisë së masave që mundën ushtritë e armatosura mirë të pushtuesve nazifashistë.

Fishklojn si gjarpij:

se dielli që sot na ndriçon

a'i errët si nata!

Se gjaku që derdhën dëshmorët

i kua jo nuk asht!

Se fushat, qytetet,

e lumejt e brigjet,

e kodrat, e malet,

nuk kan' shka tregojnë¹

— thërret poeti gjithë zemërim, duke pasur parasysh shpifjet e dashakëqijve të Shqipërisë. Kodrat dhe malet, qytetet dhe fshatrat e atdheut janë dëshmitarë të epopesë së madhe të luftës, të sakrificave që bëri populli në vitet e që-

1) Ll. Siliqi, **Prishtina**, Poemë, Tiranë 1949, f. 3.

ndresës së ashpër kundër pushtesve të huaj; ato, thotë poeti, tregojnë se «me gjak na çdo pllamb' kemi la».

Fushata propagandistike e qarqeve agresive të Perëndimit kundër Shqipërisë së re ishte vetëm një shkak i jashtëm për hartimin e poemës e cila u dha formë mbresave dhe meditacioneve të mëparshme të poetit mbi Luftën Nacionalçlirimtare si ngjarje e madhe në historinë e përpjekjeve shekullore të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi kombëtare, për drejtësi shoqërore.

Poema «Prishtina» është shkruar si fjalim poetik plot emocion, që ndërpritet nga apostrofa e thirrje patetike. Poeti kujton episodet më të lavdishme dhe emocionuese të viteve të luftës, sjell në mend Qemalin, Perlatin, Margaritën, Manushin, Jordanin dhe i fton të tregojnë si luftuan dhe si bënë fli jetën e tyre të re që populli të gëzojë lirinë, fton të gjithë dëshmorët të flasin për luftën dhe therorinë e tyre. Me mijëra njerëz dhanë jetën në këtë luftë; të panumërta janë humbjet dhe shkatërrimet që pësoi vendi. Këto sakrifica janë për poetin dëshmia më e gjallë e kontributit që dha populli shqiptar për mposhtjen e armikut të përbashkët:

*Po t'ngrihej sot zani i të vramve,
njizetetetmijësh
nji kor i stuhijshëm,
nën kambë do t'dridhej gjith dheu!*

Të shumta janë ngjarjet që flasin për luftën e popullit shqiptar, por fantazisë së poetit i flet në mënyrë shumë të qartë historia tragjike e kampit të Prishtinës, ku më 1944 nazistët pushkatuan 104 veta. Me viza konkrete poeti përshkruan çastet e llahtarshme që kaluan të internuarit në këtë vend të mallkuar. Ka këtu imtësi realiste mjaft shprehëse që zbulojnë stoicizmin e patriotëve, të cilët me gjithë vuajtjet e rënda nuk u thyen, po qëndruan si burrat para vdekjes. Kampi nuk ishte «një dhomë me njerëz të shuem», thotë autori, por një «depo me zjarr e barot». Fundi tragjik i patriotëve nuk e cenon atmosferën e ndritur të po-

1) Po aty, f. 6.

emës. Sakrifica e tyre nuk shkoi kot, ajo solli lirinë kaq të dëshiruar.

Populli luftoi për një çështje të madhe, për ngadhënjimin e një ideali të lartë. Luftën Nacionalçlirimtare poeti e quan «diell që shkjeu natën e robnisë» dhe tani «verbon» gjithë ata që nuk ja duan të mirën Shqipërisë. Kudo që shkelën, në të gjitha krahinat që çliruan, partizanët çuan «nji shpresë, nji dritë e'i flamur». Në sajë të trimërisë së tyre, jo vetëm njerëzit, por edhe «fushat e malet frymë morën përsëri».

Duke folur për ditët e gëzuara që jeton populli, poeti thekson se fitorja mbi armiqtë u arrit, sepse në krye të masave ishte Partia. Për poetin ajo është simboli i qëndresës së popullit në vitet e përlëshjes për jetë a vdekje me fashistët. Me ton patetik ai i këndon Partisë si frymëzuese e qëndresës së pamposhtur përballë armikut, si burim që ushqente njerëzit me forcë morale dhe besim në fitore:

*Parti!
... Sa shpresë
e guxim
edhe zjarr
na ngjallë
na ndezë
në gjil!...
Kurrherë s'e humbëm na shpresën...
se dritën që lindi
nga gjaku i dëshmorve
s'do mundet njeri me e mohue!*

Ndërsa demaskon shpifjet e armiqve të Shqipërisë, poeti mendon për të ardhmen e popujve; bën thirrje për vigjilencë kundrejt planeve djallëzore që po kurdisin armiqtë. Si «hijena», thotë ai, forcat reaksionare kërkojnë të ringjallin regjimet e shtypjes që popujt varrosën përgjithnjë, t'i fusin këta nën zgjedhën e vjetër.

Brendia e poemës përcaktoi edhe veçoritë stilistike dhe strukturën e saj intonative. Fjala e poetit në mbrojtje të të

1) Po aty, f. 15-16.

drejtave të popullit shqiptar tingëllon e fuqishme me apostrofat e dendura drejtuar heronjve të rënë, maleve dhe fushave të atdheut («O flitni, o shokë që vdiqët për ne», «Tregona, Qemal, si punove, si u shkrive si re») dhe me thirrjet patetike («Prishtinë! Sa tmerr! Sa trishtim»). Intonacionet plot vrull ndjenjash, karakteristike për poemën, përforcohen nga përdorimi i foljeve në krye të fjalive («Ndëgjoni! Po lehin çakejt», «Shikoni si ngrihet prap dora e kapitalit»). Poema është ndërtuar në formë shkalle; çdo shkallë është herë-herë edhe varg më vete. Kjo ka dhënë mundësinë që vargu të fitojë formën e një fjalimi të emocionuar. Autori ka marrë parasysh nevojën e ritmit. Vargu i poemës është organizuar dhe ka në bazë amfibrahun, me gjatësi të ndryshme, që i jep veprës frymën solemne.

* * *

Përhapja e motiveve heroike i dha shtysë lërimin të llojit të baladës. Për letërsinë e paraçlirimit ishte karakteristike balada me motiv idilik fshatarak, që kishte për hero bariun ose bareshën, të cilët rronin të lumtur në gjirin e natyrës. Balada e sotme u zhvillua si vjershë me subjekt, që ka në themel një situatë heroike. Më të shumtën e rasteve ajo pasqyron akte të jashtëzakonshme trimërie të komunistëve dhe të partizanëve, që japin jetën për çlirimin e popullit. Zakonisht subjekti thuret rreth ngjarjesh të vërteta historike dhe ka si hero persona realë.

Në themel të subjektit të baladës «**Komisari**» (1947) të Z. Sakos është vendosur lufta burrërore dhe vdekja heroike e Asim Zenelit në grykën e Mezhgoranit. Heroi u pikturua thujse me po ato ngjyra me të cilat paraqiten trimat e këngëve historike popullore. Poeti mjetet artistike të folklorit i përdori në përshkrimin e betejës dhe të vdekjes së heroit, në motivin e amanetit etj. Në baladë gjeti shprehje patosi i heroizmit partizan; komisari është mishërimi më i lartë i ndjenjës së detyrës ndaj popullit dhe i shpirtit të sakrificës. Nuk është dëshpërimi që hero i provon në minutat e fundit të jetës së vet, por ndjenja krenare se po

vdes me nder në fushën e luftës. Përbuzja për vdekjen për hir të idealit të çlirimit të vegjëlisë del si një nga veçoritë dalluese të komunistëve:

*Në pyeçin shokët për mua,
ku u vra, ku u qëllua,
mes për mes në kraharuar,
po me shok'e i gëzuar,
faqebardhë, syqëruar.¹*

Në mënyrë të thjeshtë lirike dhe me imtësi prekëse Z. Sako dha në baladën «Maro nëna» (1955) figurën e njeriut të thjeshtë të popullit që nuk kurseu asgjë për luftën.

Heronjtë e baladave «Doli nëna në çardhak» (1946) dhe «Kur kthei Drita në kësollë» (1945) të V. Balës, janë njerëz të përfshirë nga entuziazmi i luftës për çlirim. Në baladën e parë flitet për një nënë shqiptare, e cila rrok pushkën dhe shkon në mal për t'i zënë vendin të birit, që ra në luftë për liri. Edhe në baladën «Kur kthei Drita në kësollë» poeti vizatoi një figurë romantike. Drita, partizania e re, në përpjekje me armiqtë humbi njerin sy, por nuk është fare e dëshpëruar, kur sheh se populli fitoi «lirinë dhe tokën». Në këto balada kryesorja është paraqitja e atmosferës heroike të viteve të luftës; autori tregoi hovin shpirtëror të heronjve, entuziazmin e tyre në luftë kundër armiqve.

Në këto vite poetët rrihnin të mishëronin në veprat e tyre tipin e partizanit dhe të komunistit, si përfaqësues i njeriut të ri që nxori koha. Rruga për zgjidhjen e kësaj detyre artistike ishte ajo e veprave të llojit epik, ku jeta pasqyrohet në pamje objektive. Baladat me praninë në to në mënyrë të theksuar të elementit lirik, nuk jepnin dorë sa duhet për këtë punë, prandaj poetët i kthyen sytë nga poema si forma që do t'u ndihmonte të tregonin në mënyrë të gjerë ngjarjet e Luftës Nacionalçlirimtare, veprat heroike të luftëtarëve të lirisë. Duke u përpjekur që të krijonin tipin e komunistit e të partizanit, poetët synuan jo aq të përshkruanin heronjtë në mënyrë të gjithanshme, duke zbu-

1) Z. Sako, **Vjersha**, Tiranë 1955, f. 21.

luar karakterin e tyre në rrethanat në të cilat ata ndodheshin dhe vepronin, por më tepër të tregonin ndërgjegjen e lartë të heronjve dhe atë gjendje të ngritur shpirtërore që ngjalli tek ta ideali, të cilit i kishin kushtuar jetën. Kjo përcaktoi frymën romantike të shumë poemave të kësaj periudhe si «Biri i Partisë» i A. Varfit, «Gjaku i falun» i V. Balës, «Komunisti» i L. Qafëzezit etj.

Heroi i poemës së A. Varfit «**Biri i Partisë**» (1949) është një komunist, të cilin xhandarët bëjnë çmos për ta gju-njëzuar. Për heroin sypatrembur nuk na njoftohet as një fakt ose veçori; madje ai s'ka edhe emër, ai është komunisti në përgjithësi. Ideja poetike zbulohet me anë të dyluftimit me fjalë që zhvillohet midis tij dhe armiqve. Ndeshja e tyre fiton një kumbim të gjerë: ajo del si përpjekje e botës së dritës me botën e errësirës dhe të dhunës. Armiqët orvaten të tërheqin të burgosurit në llumin e tradhtisë dhe të turpit, ku janë zhytur vetë. Por më kot; komunisti nuk pranon të shkelë mbi idealin e vet. Heroi kthehet kështu në një personifikim të madhërishtëm të pastërtisë morale dhe të besimit të patundur të komunistëve në ngadhënjimin e çështjes së popullit.

Në themel të subjektit të poemës «**Gjaku i falun**» (1953) të V. Balës qëndron një ngjarje dramatike nga vitet e luftës. Është historia e një partizani të ri, Shpend Sadrisë, të cilit i kanë vlarë të atin për punë toke. Zakoni kërkonte që të merrej gjaku, ndryshe shtëpia e të vrrarit mbulohej me turp. Vendin kryesor në poemë e zë përshkrimi i luftës shpirtërore të heroit, në ndërgjegjen e të cilit normat e vjetra morale ndeshen me konceptet e reja që sollin me vetë Lëvizja Nacionalçlirimtare. Por prirja më tepër për të rrëfyer ngjarjen sesa për të pasqyruar jetën përmes pamjeve artistike, nuk i dha dorë autorit të zbulonte me thellësi idenë e rëndësishme që rridhte nga ngjarja. Rrëfimi i shpejtë i historisë, pengoi që të zbulohet në mënyrë të thellë dramatismi i gjendjes së heroit, lufta e rreptë në ndërgjegjen e tij midis përfytyrimeve të reja morale dhe zakoneve prapanike. Fundi i lumtur — martesë e heroit me vajzën e hasmit — e ka topitur mprehtësinë e idesë së veprës, duke futur një notë sentimentale.

Temën e heroizmit të pashembullt që treguan njerëzit

në vitet e luftës e preku edhe L. Qafëzezi në poemën «**Komunisti**» (1953). Vëmendjen kryesore autori e përqendroi në përshkrimin e synimeve të larta morale dhe, veçanërisht, të hovit shpirtëror që ngjalli te heroi detyra. Megjithëse e sheh se aksioni që ka vendosur të kryejë mund t'i kushtojë edhe jetën, ai nuk heq dorë nga vendimi për të shpëtuar shokët e rrethuar. Autori ka theksuar ndjenjën e lartë të detyrës, që shquan heroin. Gëzimi se shpëtoi shokët dhe kështu përligji besimin e tyre është gjëja më e çmuar për të. Kjo brendi ka përcaktuar edhe stilin patetiko-emocional të veprës, me digresionet lirike, apostrofet e shumta dhe kujtimet e së kaluarës. Në një farë shkalle fryma e veprës është shprehur edhe në tregimin e poetit, i cili, herë pas here, në ndonjë rast edhe pa ruajtur ndjenjën e masës, del në faqet e poemës për të shprehur admirimin për shpirtin e lartë të vetëmohimit, që karakterizon komunistët.

Në përpjekjet e tyre për të pasqyruar pjesëmarrësit e luftës, komunistët dhe partizanët, disa poetë iu drejtuan përvojës artistike të folklorit. Në ndonjë rast ata morën ndonjë subjekt nga fondi i krijimtarisë gojore poetike, por e ndryshuan atë në përputhje me konceptin e tyre artistik, siç është rasti i poemës «**Kënga e partizanit Benko**» të F. Gjatës. Më të shumtën e herës, lëndën e marrë nga epeja e Luftës Nacionalçlirimtare, poetët e trajtuan duke u mbështetur në mjetet artistike dhe stilistike të krijimeve të folklorit («**Herojt e Vigut**» e K. Jakovës).

Në poemën «**Herojt e Vigut**» (1953)

HEROJT E VIGUT

rrëfëhet një ngjarje e vërtetë historike. Më 21 gusht 1944, në Vig të Mirditës, një çetë partizane prej pesë vetash rrethohet nga një bandë mercenarësh të Gjon Marka Gjonit, vegël e fëlliqur e gjermanëve. Pas disa orë lufte të ashpër kundër një armiku të madh në numër, të pesë trimat bien në fushën e nderit. Për të treguar këtë ngjarje, në të cilën gjeti shprehje fryma heroike e viteve të luftës, K. Jakova iu drejtua folklorit, ku gjeti mjetet e nevojshme artistike për të dhënë madhështinë morale të partizanëve, qëndresën e tyre të pamposhtur përballë bandës së mercenarëve. Ai hua zoi nga këngët e trimërisë disa elemente poetike, si: hi-

perbolizimin e ngjarjeve, paraqitjen monumentale të personazheve, zhvillimin e veprimit në mënyrë të shpejtë dramatike dhe përdorimin e «fjalës» së heronjve, si mjet kryesor për karakterizimin e tyre.

Poeti i vizaton partizanët në gjasim me heronjtë e këngëve të trimërisë, viganë nga shtati, me tipare kreshnike. I tillë është Ndoc Ded Marku, një nga pjesëtarët kryesorë të çetës, tek i cili është mishëruar guximi, urrejtja e pashuar kundër armikut dhe dashuria për liri, që shquan partizanët. Ndoc Deda është jo vetëm fisnik e trim, por edhe i pashëm, i pajisur me një forcë trupore të rrallë. Një përshkrim të tillë poeti e krijon me anë metaforash dhe krahasimesh hiperbolike, që përdoren kaq shumë në këngët e trimërisë në Veri:

*Ndoc Ded Marku u ka pri,
shtatin gjat' porsì selvi,
synin pish' turrin duhi.
S'e lodh buka as s'e lodh moti,
zemra e ti fuçi baroti,
djall ma trim nuk ka Miloti.¹*

Në një paraqitje të tillë, heroi del si mishërim madhështor i burrërisë dhe i trimërisë. Ky ton ruhet edhe kur flitet për heronjtë e tjerë.

Thelbi heroik i karakterit të personazheve zbulohet në mënyrë të plotë në përshkrimin e ndeshjes së pabarabartë me pritën e bashibozukëve. Këtu, në të vërtetë, fillon edhe vepra, sepse dy këngët e para s'janë veçse ekspozicion, nëpërmjet të të cilit lexuesi njihet me heronjtë, me qëllimin e udhëtimit të tyre dhe me armiqtë, të cilët, të njoftuar që më parë për lëvizjen e çetës, i kanë zënë pusi në Vig të Mirditës.

Përshkrimi i luftës së çetës me mercenarët përbën pjesën më të rëndësishme të poemës, ku realizohet ideja e autorit. Partizanët ndodhen në një situatë që nxjerr në pah bukur fizionominë e tyre morale dhe politike. Që në fillim, të pestë ata e dinë se si do të marrë fund ndeshja me pritën,

1) K. Jakova, *Herojt e Vigut (poemë) dhe vjersha e këngë të tjera*, Tiranë 1953, f. 3.

por kjo nuk i tremb. Partizanët e ndiejnë përgjegjësinë e madhe që bie mbi ta, prandaj, në këto çaste të jashtëzakonshme, mendimet dhe dëshirat e tyre përmbliohen në një ide të vetme dhe të qartë — të qëndrojnë si burrat, ashtu siç e kërkon emri i komunistit, i cili nuk i ndan fjalët nga veprat.

Në vetëdijen e partizanëve besnikëria ndaj çështjes së Partisë është shkrirë me përfytyrimin tradicional të burrërisë në malësi: trimat që janë lidhur me një ide, nuk i spraps nga fjala e dhënë as vdekja:

*... fjala e folme në kuvend,
La me gjak ma mir' ze vend.¹*

Gjatë përshkrimit të qëndresës burrërore të çetës, autori, duke iu rreshtur stilizimit në frymën e këngëve të kreshnikëve, u vesh partizanëve tipare më reale. Në këngët III, IV dhe V në figurën e tyre dalin në pah cilësitë e luftëtarit të radhës së parë për çështjen e popullit, të komunistit, për të cilin ligji më i lartë është fjala e Partisë. Ata shkojnë drejt vdekjes me ndërgjegje të qetë se detyrën që u ka ngarkuar Partia e përmbushën me nder. Dëshira e tyre e fundit është që të lajmërohen shokët se nuk i turpëruan. Ky motiv është theksuar në amanetin e njësitit, dhënë me vargje shumë prekëse:

*— Amanet, o mori male,
kur ushtria ktu të dalë
shokve ton' ju me m'iu falë,
me i tregue si kem'luftue,
si jem' vra si jem'coptue
rreth e rreth prit' ngujue.²*

Çeta e vogël vepron dhe lufton e rrethuar nga forcat reaksionare, por nuk jepet, sepse ka përkrahjen edhe të fshatarëve të varfër. Kjo përbën një nga idetë e rëndësishme të poemës. Duke folur për partizanët, autori më se një herë përmend dashurinë e sinqertë që ushqejnë malësorët për ta. Në çastet e fundit të jetës së tyre partizanët kujtojnë

1) Po aty, f. 18.

2) Po aty, f. 16.

me mirënjohje fshatarët e varfër të Mirëditës, të cilët i pritën dhe i mbajtën luftëtarët e lirisë duke mos marrë parasysh kërcenimet e armiqve. Fjalët që thonë partizanët në këto çaste shquhen nga një frymë e ngrohtë dhe nota prekëse.

Përshkrimi i luftës në frymën e folklorit dhe sidomos karakterizimi i njerëzve përmes fjalës drejtuar armiqve, ka bërë që heronjtë të mos dalin me veçori të theksuara individuale dhe të jenë disi të përgjithshëm. Veçori të për-bashkët ata kanë burrërinë dhe qëndrimin heroik ndaj jetës dhe kjo i përgjigjet konceptit poetik të vetë autorit.

Heroizmin dhe shpirtin e sakrificës së çetës së vogël poeti e përshkruan si tipar karakteristik të atyre viteve, kur një entuziazëm i paparë patriotik kishte përfshirë gjithë popullin. Kjo temë trajtohet në vepër nëpërmjet figurës së malësorit plak Dedë Markola, pikturuar gjithashtu me ngjyra epike. Kur merr lajmin se iu vra djali, ai mbahet si burrat e malësisë. «Nuk i luajti fytyra' i herë, nuk u prish, nuk u ngatrrue», — thotë poeti. Mynxyra që i ra mbi krye, ia shton edhe më tepër mërinë për armikun. Megjithëse i rënduar prej viteve, ai rrok pushkën dhe shkon vetë me partizanët për çlirimin e Mirditës.

Si në veprat epike popullore, në poemën «Herojt e Vigut» është përdorur gjerësisht antiteza. Karakteri i partizanëve, fizionomia e tyre morale dhe shpirtërore janë dhënë në kontrast me tradhtinë, pabesinë dhe ligësinë e armiqve, të cilët janë përshkruar me viza të shpejta, por konkrete.

Në zhvillimin e subjektit të poemës luajnë rol të rëndësishëm ndërhyrjet lirike të autorit, i cili shpesh ua jep fjalën heronjve që të shprehin mendimet dhe ndjenjat e tyre, por, herë-herë futet edhe vetë në mes tyre, si person veprues. Ai jo vetëm rrëfen për ndeshjen e çetës me armiqët, por u drejtohet partizanëve me pyetje retorike, u jep atyre zemër, shan dhe mallkon tradhtarët. Si rezultat poema ka fituar në strukturë elemente dramatike.

Për hartimin e poemës «Herojt e Vigut» u shfrytëzua jo vetëm mënyra poetike popullore e përshkrimit të betejës dhe të personazheve, por edhe stilistika e metrika e folklorit. Vargu me të cilin u hartua poema është tetërrokshi popullor monokolon.

Në poetët të cilët u përpoqën të transmetojnë heroizmin e viteve të luftës kundër pushtuesve fashistë dhe veglave të tyre, ishte edhe F. Gjata. Me viza të thjeshta poeti riprodhon pamje konkrete nga jeta partizane, tregoi mendimet dhe ndjenjat e luftëtarëve të lirisë («Roja», «Rrugët e maleve», «Bije bryma përmbi male», «Burim në mal» etj.). Më dendur poeti trajtoi motivin e sakrificave që bëri populli i thjeshtë për të shpëtuar atdheun nga kthetrat e armiqve. Në vjershat «Mora pushkën, më nuk prita», «Ç'ke që qan moj nënëzë?», «Dhimbja e nënës» etj. paraqitet fryma e pamposhtur e nënave partizane, djemtë e të cilave shkuan në luftë dhe nuk u kthyen më. Figurën e popullit patriot, të cilin asgjë nuk e trembi në rrugën e luftës, sepse është i vetëdijshëm se pa sakrifica nuk mund të sigurohet liria, poeti e vizatoi në «Baladën e prindërve», që shquhet nga dramatizmi dhe fryma e optimizmit. Vepra më e shënuar poetike e F. Gjatës me temë nga lufta heroike e partizanëve është «**Kënga e partizanit Benko**» (1954). Në hartimin e saj autori shfrytëzoi motivin e baladës së Ago Imerit, të cilën e përpunoi duke i dhënë një frymë aktuale. Heroi i poemës nuk është trimi tradicional i folklorit, i cili nisët për në luftë ditën e parë të martesës (se ç'luftë është kjo nuk dihet), por biri i vegjëlisë që rrok pushkën për çlirimin e vendit dhe bie si burrat në fushën e betejës. Benkoja, vërtet, ka shumë ngjashmëri me heroin e lirikës sonë popullore; ai është trim, i shkathët dhe i hedhur në jetë, por, në të njëjtën kohë, autori e ka veshur atë me disa tipare reale konkrete, që e bëjnë karakterin e tij më të përcaktuar nga pikëpamja historike-shoqërore. Benkoja është i riu i viteve 40, i cili, kur krisi pushka kundër pushtuesve të huaj, mori malet dhe u bashkua me partizanët. Për heroin e tij poeti rrëfen në mënyrë të thjeshtë, pa efekte. Vepra është shkruar si historia e heroit, dhënë kjo në mënyrë të përgjithshme. Karakteri i tij zbulohet përmes rrëfimit të thjeshtë të autorit dhe disa përshkrimeve të shpejta, të cilat krijojnë një atmosferë të hareshme lirike në vepër. Notat liriko-emocio-

nale sundojnë edhe në skenën e vrasjes së heroit, e cila është dhënë me viza të kursyera:

*Ujë t'gurgullon,
ujët rrjedh e shkon*

*dhe rrëkezat qeshin...
Vetëm Benko trimi,
vrrarë te burimi,
duket ujë pi
po nuk ngopet dot!¹*

Karakteri i përgjithshëm i pasqyrimit të jetës i jep veprës një kuptim më të gjerë sesa paraqitja e një fakti tipik të epokës. Autori e shfrytëzoi motivin popullor për të simbolizuar në fatin e heroit patriotizmin e popullit, i cili ka jetuar gjithnjë me shqetësimet e atdheut dhe i ka dalë gjithnjë zot me armë në dorë lirisë dhe pavarësisë së tij.

Me përpjekjet e gjithë poezisë për të krijuar vepra të rëndësishme mbi luftën kundër pushtuesve fashistë dhe veglave të tyre, mbi fizionominë shpirtërore të pjesëmarrësve të luftës, mbi veprat e tyre burrërore bashkuan përpjekjet e tyre edhe penat e reja; D. Siliqi, I. Kadareja, D. Bubani etj. Krenaria për popullin që nuk iu nënshtrua zgjedhës së huaj, por u ngrit për lirinë dhe pavarësinë e vet u shpreh në vjershat «Helmësi» dhe «Pranvera erdhi, por s'lulzoi» të D. Siliqit. Në «Plaga» poeti me nota të ngrohta lirike vizatoi figurën e një infermiereje të re partizane, e cila u shërben plot kujdes dhe dashuri shokëve të plagosur.

Vjersha «Përpara pushkatimit» (1959) e D. Bubanit, në të cilën flitet për pushkatimin e dy të rinjve, përshkohet nga fryma heroike. Me mjete të kursyera autori vizatoi figurën e pamposhtur të rinisë që derdhi gjakun për çlirimin e atdheut. Në poezitë «Nëna», «Ishujt e Italisë» etj. I. Kadareja patriotizmin e flaktë dhe frymën e vetëmohimit i tregoi si tipare karakteristike të masave të popullit në vitet e përleshjes së rreptë me armiqtë.

1) F. Gjata, *Këngët e maleve*, Tiranë 1954, f. 9, 15.

* * *

Ndër poemat kushtuar pasqyrimin të pjesëmarrësit të luftës çlirimtare popullore kundër pushtuesit fashist shquhen «Poema e udhës» dhe «Poemë për babanë dhe për vete» të D. Agollit.

Në «Poemën e udhës» (1958) shkrimtari synoi të përgjithësojë me mjete liriko-epike përvojën jetësore të brezit të atyre të rinjve të cilët morën malet dhe u bënë luftëtarë të lirisë kur nuk u kishte dërsitur ende mustaqja. Poema është thurur si rrëfim i ngrohtë dhe i singertë i heroit për veten e tij, për përvojën e vet në radhët partizane dhe për hapat e parë në ngritjen e jetës së re. Biografia e heroit është biografia tipike e përfaqësuesve më revolucionarë të popullit të cilët në thirrjen e Partisë për t'u ngritur në luftë kundër pushtuesve të huaj dhe klasave shfrytëzuese panë mishërimin e aspiratave të tyre shoqërore. Rinia e heroit nisi atëherë kur ishte mbushur kupa e durimit dhe populli i revoltuar po ngrihej kundër shkaktarëve të mjerimeve të tij. Ishin këto vite të vështira, por vendimtare për fatin e atyre bijve të popullit të cilët revolucionin i gjeti të mitur:

*Me krismën e dyfeqeve në male,
me ngritjen e raketës n'errësirë,
me vrull e hymnit «Internacionale»
i thash' un' fëminisë lamtumirë.»*

Historia e brezit të ri të pjesëmarrësve të luftës shpallet si rrugë e vështirë, gjatë së cilës ata fituan tipare të reja morale, u kalitën si revolucionarë. Heroi i poemës e quan veten si luftëtar të thjeshtë të revolucionit. Duke dalë partizan, ai e di siç pohon dhe vetë se nuk bëri gjë tjetër veçse kreu detyrën si bir i popullit.

*Hero un' kushedi dhe nuk kam qënë,
po vendin tim e mbrojta dhe e çmova
dhe mund për të dëshmor të kisha rënë!²*

1) D. Agolli, *Në rrugë dolla...*, Vjersha dhe poema, Tiranë 1958, f. 45.
2) Po aty, f. 47.

Nëpër poemë kalon motivi i «rrugës», i cili, sikurse në përfytyrimet e popullit, shpreh kërkimin e një fati të ri ndeshjen me jetën e madhe. Me këtë motiv, poeti tregon se duke shkuar partizan, heroi del në rrugë të re, në «udhën që zgjodhi populli». Është kjo udha e luftës për realizimin e aspiratës së popullit për çlirimin shoqëror. Edhe pasi u shporr i huaji dhe populli u bë zot i vendit, fati i heroit zbulohet përmes motivit të «rrugës». Në kushtet e reja historike «Rruga» simbolizon të ardhmen socialiste, që e josh heroin me romantikën e jetës së re. Ideja e jetës së lirë, ideja e heroizmit të rinisë që kapërcen vështirësitë dhe ngre me duart e veta të ardhmen e bukur, përshkon pjesën e dytë të poemës. Me viza të thjeshta dhe të kursyera përshkruhet puna e ndërtuesve të hekurudhës, vështirësitë dhe privacionet që hasin ata. Të rinjve u qëllon të punojnë «në baltë e shi e diell, në tym të verdhë dhe erë», por jeta e tyre, plot heroizëm dhe ëndrra romantike, ka një bukuri të veçantë.

Në «Poemën e udhës» u shfaqën në mënyrë të plotë veçoritë e stilit të D. Agollit: thjeshtësia e tregimit, vizatimi konkret i personazheve, intonacionet bisedore. Në vizatimin e heroit autori është i kursyer dhe u shmanget frazave të përfryra. Si për të kaluarën ashtu edhe për jetën e tij pas Çlirimit, ai rrëfen thjesht, me pak fjalë. Poeti me qëllim e thekson pamjen e zakonshme të heroit, duke shprehur këmbështu qëndrimin e tij negativ ndaj enfazës dhe retorizmit të zbrazët. Karakteri i rëndomtë i fjalëve i jep rrëfimit të poetit forcën bindëse dhe e bën ligjërimit të komunikues. Kësaj i dha dorë edhe kompozicioni i poemës, e cila është thurur si rrëfim i heroit lirik; ky hero rrëfen për vete me tonin e një bisede të ngrohtë sikur të ishte midis shokësh të vjetër.

Tema e brezit të ri dhe figura e pjesëmarrësit të luftës dhe të ndërtimit socialist e tërhoqi. D. Agollin edhe në «**Poemën për babanë dhe për vete**» (1958). Edhe këtu autori synon paraqitjen konkrete të mjedisit, poetizimin e gjërave të zakonshme dhe të thjeshta. Ai krijon figura të goditura të njerëzve të thjeshtë, të cilët kryejnë vepra të larta pa bujë dhe pa u mburrur. Një figurë e tillë është ajo e babait, përfaqësuesit të brezit të vjetër, që kishte qëndruar

gjithnjë në roje të interesave të vendit. Përvoja e hidhur e së kaluarës i ka mësuar atij të hapte sytë, që «qeni të mos t'ia hajë shkopin». Këtë përvojë të historisë ia mëson edhe të birit, të cilin e rrit si veten, patriot të vërtetë. Në karakterin e babait, i cili për vete flet me modesti, poeti paraqiti përfaqësuesin e masave popullore, që gjithnjë ka rrojtur me hallet e vendit, me shqetësimin e vazhdueshëm për fatet e tij. Ky tipar e shquan atë edhe në vitet e para të pasçlirimit, kur përpara vendit ngriheshin vështirësi, të shumta, por shpejt fiton qetësinë shpirtërore pasi sheh se brezit të ri nuk ia «ha qeni shkopin». Heroi i veprës ka shumë tipare të përbashkëta me heroin e «Poemës së udhës», sepse si i pari i përket brezit të ri mbi shpatullat e të cilit ra një barrë e rëndë, por fisnike-shpëtimi i vendit nga varfëria dhe skllavëria e huaj. Duke kaluar nëpër zjarrin e revolucionit popullor, ai bëhet luftëtar i vetëdijshëm i çështjes së masave dhe fiton përvojën e brezit të vjetër të kalitur në beteja të parreshtura për liri dhe drejtësi shoqërore. Pas Çlirimit, kur nisi lufta për ngritjen e jetës së re, ai është në vijën e parë të frontit të punës dhe në të njëjtën kohë, mban sytë hapur ndaj çdo rreziku që mund t'i kanoset atdheut.

Prirja për të vizatuar figurën e partizanit me anë të imtësive dhe të pamjeve konkrete, për të treguar mendimet edhe ndjenjat e njerëzve u shfaq edhe në një varg vjershash, që u botuan në fund të viteve 50. Fryma konkrete dhe vërtetësia e përshkrimit të jetës partizane spikat edhe në vjershën «Mjeku partizan» të M. Gurakuqit, «Operacioni» i L. Qafëzezit etj. Në harmoni me këtë prirje janë edhe ato krijime poetike, që flasin për ndjenjat intime të heronjve të cilët, ndonëse të kapitur nga uria, të ftohtët dhe pagjumësia, ruanin në zemrat e tyre të gjalla dashurinë për të afërmit, për nënën, gruan dhe fëmijët («Ëndërr partizane» e A. Varfit, «Partizanët» e M. Xhaxhiut).

2

Problemi i përvetësimit artistik të realitetit të ri u shtrua që në fillim përpara poezisë; përvoja e saj erdhi duke u pasuruar krahas depërtimit të saj gjithnjë e më thellë në proceset shoqërore.

Në krijimet më të mira poetike gjetën pasqyrim ndjenjat e gëzuara të masave të cilat, pasi u bënë zot të fateve të tyre, iu përveshën gjithë vrull krijues ngritjes së jetës së re, u ravizua figura e njeriut të ri, të devotshëm ndaj atdheut, ndërtues i palodhur i rendit socialist dhe mbrojtës i fitoreve të revolucionit.

Pjesa më e madhe e poezisë së viteve të para të ndërtimit socialist, ishte një lirikë e ngritur emocionale, shpesh me nota solemne. Duke marrë shkas nga përfundimi i ndonjë objekti të rëndësishëm ose duke u frymëzuar nga fakte të punës së madhe ndërtimore, poetët shprehnin harenë për fitoret dhe perspektivën e bukur që u hap para vendit. Ky ngazëllim formoi brendinë e krijimeve poetike të para kushtuar ndërtimit socialist. Jeta e sotme u pasqyrua në mënyrë të përgjithshme, pa elemente konkrete përshkrimi. Shprehja e emocioneve të gëzimit dhe të hovit shpirtëror karakterizon vjershat e Ll. Siliqit, A. Çaçit, M. Gurakuqit, L. Qafëzezit, Dh. S. Shuteriqit, D. Siliqit, V. Balës, D. Bubanit, A. Varfit etj.

Në «Atdheu» të Ll. Siliqit ka gjetur pasqyrim entuziazmi për sukseset e arritura në ngritjen e shoqërisë socialiste. Jetën e sotme të atdheut poeti e përfytyron ecje të pandalshme, drejt caqesh të reja; atë e shquan dinamizmi dhe hovi krijues:

*Si prrue, që zbret luginash tue këndue
dhe çdo pengesë rrugës kapërcen,
o vendi im i ri ti shëmbëllen!*¹

Në vjershën «Unë dolla sot» të A. Çaçit janë shprehur emocionet e gëzuara të njeriut të thjeshtë të popullit, që e ndien veten zot të vendit, të cilin me djersën dhe mundin e vet po e zbukuron çdo ditë e më shumë. Të njëjtën ide e gjejmë edhe në poezinë «Kur pyesja nanën» të D. Siliqit ndërtuar si krahasim midis rrojtjes së vështirë dhe plotmungesa të njerëzve të varfër në regjimet antipopullore dhe jetës së tyre të lumtur pas Çlirimit. Edhe në vjershën «Motrës» të po këtij autori kujtimet e hidhura të së ka-

1) Ll. Siliqi, Vjersha dhe poema, Tiranë 1953, f. 6.

luarës e theksojnë edhe më shumë harenë e njerëzve të thjeshtë për ditët e lumtura që gëzojnë. Në mënyrë origjinale ideja e ndryshimeve të mëdha që kanë ndodhur në jetën e vendit, është shprehur në poezinë «Shtegu i harruar» të D. Bubanit. Vepra është shkruar si tregim i një plake që ka njohur brengat e kurbetit. Shtegu i malit, nga nisheshin njerëzit për në kurbet, sot nuk shkelet më; i braktisur dhe i mbuluar prej barit, ai ka mbetur si kujtim i së kaluarës së urryer, që u përmbys përgjithnjë.

Poetët shprehën jo vetëm ndjenjat e gëzimit dhe të krenarisë për jetën e re që po lulëzon, por synuan të vizatonin figurat e njerëzve të sotëm, që punojnë me hov dhe frymë të lartë vetëmohimi për ndërtimin e jetës socialiste. Heroina e vjershës «Këngë për sulmuesen e tisazhit» të Dh. S. Shuteriqit është një vajzë e thjeshtë, që thyen pranngat e fanatizmit dhe shkon të punojë në fabrikë, ku del dy herë sulmuese. Ideja se jeta socialiste krijoi mundësi për zhvillimin e lirë të aftësive dhe të prirjeve të individit shprehet përmes imtësive lirike. Edhe në vjershën «Brigadierja në tribunë» të A. Banushit fizionomia shpirtërore e njeriut të ri, mendimet dhe ndjenjat e tij zbulohen me anë të mjeteve lirike. Në historinë e brigadieres, që ngrihet në tribunë dhe plot krenari rrëfen për ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur në fshatin e vet, autori tregon se sa lart e ngriti epoka e Partisë njeriun e thjeshtë, fshatarin e djeshëm të shtypur dhe të përbuzur, që klasat shfrytëzuese s'e përfillnin as si njeri.

Toni entuziast përshkon edhe ato vjersha, të thurura si portret i përfaqësuesit të masave punonjëse — i punëtorit, i kooperativistit, i të riut etj., — ose si përshkrime dhe skena nga puna e tyre ndërtimore. Të tilla ishin vjershat e A. Çaçit, M. Gurakuqit, D. Siliqit, V. Balës, A. Varfit, L. Qafëzezit etj., ku vizatohen aspekte nga jeta e të rinjve vullnetarë në ngritjen e hekurudhave të para, e kooperativistëve dhe e punëtorëve në objektet e ndryshme industriale.

Lirizmi, fryma e theksuar emocionale bëri që shumë prej këtyre vjershave të viheshin edhe në melodi («Këngë për sulmuesen e tisazhit» dhe «Gruri i ri» të Dh. S. Shuteriqit, «Derdhet gruri si flori» e A. Varfit, «Kanali i Myzeqesë» e A. Çaçit etj.). Krahas kësaj u shkruan shumë kë-

ngë për gëzimin e punës dhe për heronjtë e ndërtimit socialist («Heroi Hajdar T. Goriçani» e A. Varfit, «Këngë për traktoristët» e A. Banushit etj).

Populli shqiptar është i pamposhtur dhe plot gjallëri e frymë krijuese — ky është patosi i vjershës «Një ulli në breg të Jonit» të D. Siliqit. Poeti është i sigurtë se Shqipëria do të marshojë përpara drejt socializmit, drejt së ardhmes së bukur dhe të ndritur.

Me temën e jetës së lumtur është e lidhur në mënyrë organike tema e Partisë. Në shumë krijime poetike me entuziazëm dhe hov ndjenjash flitet për meritat e mëdha të Partisë në fitoret madhështore që arriti populli pas Çlirimit, për ditët e lumtura që i solli ajo popullit. Veprat e reja, që po ndërtohen kudo nëpër Shqipëri poetit Ll. Siliqi i duken si një këngë «që atdheu i thuri Partisë», «këngë që ngrihet lart si flamur»; kjo ide kumboi edhe në vjershat «Partinë mbi të gjitha» të N. Bulkës, «O diell i jetës sonë» të A. Varfit, «Flamur fitoresh» të L. Qafëzezit etj. Figurën e Partisë që e shpëtoi popullin nga zgjedha ku lëngonte dhe i tregoi udhën e lirisë dhe të përparimit të hovshëm, poetët e krijuan me mjete të zgjedhura poetike dhe plot solemnitet.

Duke nisur nga mesi i viteve 50 nxjerr krye interesimi për faktet e jetës së përditshme, për pasqyrimin e njeriut të ri me mendimet dhe ndjenjat e tij karakteristike. Poetët e rinj, D. Agolli, I. Kadare, V. Ziko etj. iu rreshtën frazave të përgjithshme dhe notave odike, krijimet e tyre kushtuar ndërtimit socialist shquhen nga karakteri konkret i brendisë dhe i formës. D. Agolli i kushtoi rëndësi saktësisë dhe lakonizmit të shprehjes së mendimit, ai hoqi dorë pothuajse nga konvencionet letrare dhe përdori një rrëfim poetik të thjeshtë dhe të qartë. Poetizimi i fakteve dhe i ndodhive të rëndomta, aftësia për të parë në to atë që është karakteristike për jetën socialiste në ngjitje e sipër formon një nga tiparet e stilit të tij. Në vjershën «Mëngjez» kemi pamjen plot lëvizje të qytetit të sotëm shqiptar. Përmes imtësive të goditura poeti jep dinamizmin e shoqërisë së re, elementet e reja që po shfaqen në pamjen e përtërirë të atdheut. Në vjershën «Hapat e mija në asfalt» zbulohet ngazëllimi i njeriut të thjeshtë që me duart e veta po ngre

jetën e lumtur. Ai e ndien veten zot të vendit, zot të fateve të veta dhe për këtë është krenar. Për heroizmin e ndërtesve të hidrocentralit të Shkopetit, po ashtu në mënyrë të thjeshtë autori rrëfen edhe në poezinë «Nga fletorka e shënimeve». Pamja që vizatohet është plot vërtetësi. Njerëzit janë paraqitur në mjedisin e vërtetë të punës, në përpjekjet këmbëngulëse për të mposhtur shkëmbin dhe lumin. Në vjershën «Këmishët» poeti u këndoi duarve të shkathëta dhe të palodhura të një gruaje që lan këmishët e djersitura dhe me pluhur të punëtorëve në bregun e Bisticës. Kemi një poetizim të goditur të punës për ndërtimin e socializmit. Ato duar të thjeshta, thotë autori, mund të bënin «gjithçka», edhe «të përkëdhelnin tastierën e pianos», dhe libra «të shfletonin ndër biblioteka të mëdha», dhe «pipëzën e kashtës për të pirë limonadë në Dajti mund të shpinin me delikatesë në buzë», veçse tani ato bëjnë një punë modeste por fisnike dhe të dobishme për shoqërinë, u shërbejnë njerëzve të punës.

Patosi i jetës së re dhe të lumtur përshkon edhe poezitë e D. Agollit, që flasin për fshatin e sotëm. Poeti me mënyrë të qetë dhe të shtruar rrëfen për jetën e njerëzve në fshatin e sotëm, për gëzimet dhe shqetësimet e tyre të reja. Vjersha «Në shtigjet e tua» është thurur si përshkrim lirik i një vizite në fshat. Fshati i sotëm shqiptar nuk është më fshati i dikurshëm, me çatitë në të rënë, të thurura me purteka, me zjarrin në mes të kasollës dhe tymin që nxinte muret, me jetën që ishte «më e hidhur se duhani». Në kontrast me këto kujtime të heroit, del kuadri i jetës së përtërirë socialiste, dhënë përmes fjalëve të xha Shabanit, përfaqësues tipik i vegjëlisë fshatare. Poezia «Nga këngët e xha Taqit» përbëhet prej disa skenash ku përmes situatash humoristike Agolli pasqyron gëzimin e njerëzve që socializmi i ka bërë zot të fatit të tyre. Për të rënë në jetën e fshatit tregohet edhe në vjersha të tjera, shkruar me intonacione të qeta rrëfimtare, të ndërprera nga vargje, ku zëri i poetit tingëllon herë me zemërim dhe krenari («Malësori») dhe herë me një lirizëm të hareshëm («Ëndrra»).

Edhe në krijimet e V. Zikos gëzimi i jetës së lumtur është dhënë përmes fakteve dhe imtësive të rëndomta. «Rroga e parë» është ndërtuar si rrëfimi poetik i jetës së hero-

inës, sidomos të viteve të rinisë që kishin kaluar përmes vuajtjesh dhe brengash të hidhura. Për autorin fati i heroinës simbolizon fatin e vegjëlisë. Vjersha mbyllet me vargjet e fillimit ku me disa fraza jepet portreti lirik i heroinës, e cila me një sinqeritet të çiltër, i gëzohet fatit të vet të lumtur, që i qeshi në pushtetin popullor. Edhe në qendër të poezisë «Vajza fjongokuqe» kemi përshkrimin e një fakti të thjeshtë në të cilin zbulohet atmosfera e lirë dhe e gëzuar që sundon kudo në jetën e vendit. Mësuesja e re që shkon gjithë gaz e optimizëm për të punuar në fshatin e largët, është një nga mijëra e mijëra të rinj e të reja, që në të katër anët e vendit punojnë për ta bërë më të lumtur jetën. Për vjershën janë karakteristike imtësitë e gjalla, «Zonja» bashkë me plakën që kanë mëshirë për mësuesen e re, theksojnë më fort vrullin e papërmbajtur të jetës së re.

Në vitet 50 u shfaq edhe poezia e ndjenjave intime. Një varg poetësh (I. Kadareja, D. Agolli, D. Siliqi, D. Bubani etj.) shkruan vjersha në të cilat i këndohej dashurisë rinore, ndjenjës së miqësisë dhe të shoqërisë, shprehej bota e brendshme e njeriut të sotëm të çliruar nga prangat e koncepteve dhe të traditave prapanike. Karakteristike për këto poezi ishte lirizmi i butë dhe plot ëmbëlsi, që herë përziejhet me nota humorit dhe herë me një nostalgji të lehtë.

3

Pasqyrimin të ndërtimit socialist iu kushtuan edhe një varg poemash, të ndryshme për nga problematika dhe për nga veçoritë e tyre si lloj.

ASHTU MYZEQE

Një nga poemat e para shkruar për jetën e re është «Ashtu Myzeqe» (1947) e A. Çaçit. Çlirimi i vendit përqendrohet në vepër si shpëtimi i vegjëlisë nga skllavëria e rëndë shoqërore e rendit të vjetër shfrytëzues. Kjo ide është realizuar përmes antitezës së gjerë midis jetës së vështirë të Myzeqesë në të kaluarën dhe ditëve të lumtura, që aguan me fitoren e revolucionit popullor në fshatrat e kësaj krahe. Duke përdorur imtësi shprehëse, poeti tregon për jetën e Myzeqesë para Çlirimit, e cila nuk ishte veçse agoni

e pafund. Gjithçka, bujqit, toka dhe pemët, thotë poeti, mbanin vulën e frikës dhe të fatkeqësisë, në të cilën rronin njerëzit. Me fytyra të nxira si «hije të natës», të zbatshur e të zhveshur myzeqarët hiqnin zvarrë këmbët nëpër tokën që punonin, por që ish «e huaj» për ta. Jeta e tyre ishte zinxhir mundimesh dhe vuajtjesh. Ashtu si njerëzit dhe natyra ishte pa jetë e pa gaz. Sundimi i pashpirt i beut i kishte kthyer këto anë në një vend të shkretëtë, «pa lule, pa erë, po ferrë». U desh Lufta Nacionalçlirimtare nën udhëheqjen e Partisë që të zhdukeshin armiqtë shekullorë të fshatarësisë punonjëse — beu dhe sejmenët e tij. Në Myzeqenë e dikurshme, buzëplasur, ku asnjëri s'kishte parë gëzim me sy, «dheu ka marrë një vulë të re». Robëria u zhduk, njerëzit shpëtuan dhe jeta po merr pamje të përtërirë.

Në kontrast me pamjen e zyrtë dhe të vrazhdë me të cilën hapet vepra, në këngën e fundit para poetit shfaqet një kuadër plot dritë dhe optimizëm. Një gëzim i fortë ngrihet nga thellësia e zemrës e shpërthen me hov të papërmbajtur. Dhe kthehet kjo ditë e çlirimit të Myzeqesë në një ditë feste jo vetëm e njerëzve, por edhe e gjithësisë. Pasi shpëtuan nga shtypja e djeshme, myzeqarët, me besim e vullnet të lirë, përqafojnë format e reja të jetesës dhe të të punuarit. E kaluara u mësoi se, duke qenë të përçarë, asnjëherë nuk do të mund të shpëtonin përfundimisht nga mjerimi dhe nevoja, prandaj edhe janë të parët që i përgjigjen thirrjes së Partisë për të bashkuar mjetet dhe forcat në punë:

*Agimi ka rënë
dhe fusha po qesh...
E nisën betejën
për jetën e re,
punojnë bashkuar
njëzetë pendë qe,
ashtu Myzeqe!¹*

Nga ana e frymëzimit dhe e mënyrës së pasqyrimin të jetës poema e A. Çaçit është një vepër e llojit lirik. Ideja poetike është zbuluar nëpërmjet vizatimit të përgjithësuar të

1) A. Çaçi, *Ashtu Myzeqe*, Poemë, Tiranë 1947, f. 30.

casteve kryesore të jetës së Myzeqesë. Poema i ngjet një triptiku ku çdo pjesë i përgjigjet një etape të rëndësishme të jetës së myzeqarëve: pjesa e parë periudhës para Çlirimit, e dyta viteve të luftës dhe e treta kohës pas fitores së revolucionit popullor. Në çdo pjesë ideja zbulohet përmes imtësive të gjalla realiste. Varfërinë e zezë të fshatit myzeqar në të kaluarën autori e vë në pah nëpërmjet historisë së dhemshur të bujqve të mjerë të cilët në «zemër të natës» me «plaçka në krah largohen nga fshati», sepse beu «bleu të tjerë». Imtësi që ngërthejnë përgjithësime artistike, poeti përdori edhe kur paraqet fatin e Myzeqesë gjatë luftës edhe pas Çlirimit.

Ndonjëherë ideja shprehet përmes figurave simbolike; kështu «zjarri i shuar» është jeta myzeqare para Çlirimit. Kuptim simbolik ka edhe kuadri nga jeta e re e vendit, të cilin autori e ka ndërtuar me anë të katakrezës;

*Fabrika
nis jetën e re
dhe tymi
që del nga oxhaku
shpërndan errësirën.¹*

Ngazëllimit lirik që formon brendinë e veprës i përgjigjet edhe vargu, një amfibrah dykëmbësh i cunguar që alternohet me amfibrahun njëkëmbësh. Ky ndërtim metrik ka përcaktuar rrëfimin e ngadalshëm; rima zakonisht e saktë, takohet rrallë në poemë.

* * *

Në poemën «Miku» (1953) Ll. Siliqi shprehu patosin e jetës së re. Brendinë emocionale të veprës e përbëjnë mendimet dhe ndjenjat e heroit, Hasan Fanit, përfaqësues tipik i masave punonjëse. Hareja që e ka pushtuar atë, optimizmi dhe dashuria e tij për jetën e re, zbulohen në kon-

1) Po aty, f. 30.

trast me kujtimet e hidhura të së kaluarës, me vuajtjet që kishte hequr nën regjimet antipopullore. Heroi bën pjesë ndër ata njerëz të guximshëm që nuk i ulën asnjëherë kryet përpara veprimeve arbitrare të njerëzve të fuqishëm, sunduesve mizorë.

*Në hasmëri më shkoi gjithë jeta
me aga e me bejlerë¹,*

- thotë heroit për veten e tij. Guximi, dashuria për lirinë, ndjenja e dinjitetit si njeri dhe urrejtja e thellë për shfrytëzuesit janë cilësitë që e shquajnë karakterin e tij. Sa herë që u ndesh me armiqtë e vet, nuk e uli asnjëherë kokën, me gjithë që vuajti gjithë jetën. Prandaj Hasan Fani iu përgjegj menjëherë thirrjes së Partisë për luftë kundër të huajve dhe veglave të tyre; ndonëse i shkuar në moshë ai ishte ndër të parët në fshat që rroku pushkën kundër pushtuesve fashistë. Heroi është optimist dhe plot besim në të ardhmen e vendit. Ndjenja kryesore që sundon në ndërgjegjen e tij është gëzimi për ditët e lumtura që po jeton, hareja se më në fund edhe atij i qeshi fati dhe pleqërinë po e kalon i lumtur. Por, po aty, një trazim nis e shqetëson në shpirt; ai është pak i trishtuar, se ditët po i mbarojnë (është përtej të njëqindave), kur njerëzit po jetojnë mirë e do të rrojnë edhe më mirë në të ardhmen, prandaj dëshiron që edhe vdekja t'i vijë «pak më vonë»:

*«Eh, shum herët n'bot' ke le,
shum pak gzim ke pa mbi dhe,
shum pak gzim n'kët jet'ke pa!
Eh! Hasan, o Hasan Fani,
t'kishe le ma von' paksa!...»².*

Për poetin dëshira e heroit për të rrojtur sa më shumë është shprehje e atmosferës së gëzuar që karakterizon jetën e popullit pas çlirimit.

Në poemë ka gjetur shprehje autoriteti i madh i Partisë

1) Ll. Siliqi, *Vjersha dhe poema*, Tiranë 1953, f. 55.

2) Po aty, f. 59.

në popull, lidhjet e saj të ngushta me masat dhe dashuria e njerëzve të thjeshtë për udhëheqësin e saj, shokun Enver Hoxha. Heroi është plotësisht i vetëdijshëm se vetëm në sajë të Partisë erdhën këto ditë të bardha për popullin, prandaj për të dhe prijësin e saj ruan mirënjohjen më të thellë në zemrën e tij.

Poema është ndërtuar si histori e heroit, karakteri i të cilit zbulohet përmes rrëfimit për të kaluarën dhe jetën e tij të sotme, por ndonjëherë mendimet dhe emocionet e heroit deklarohen, gjë që ka sjellë që figura e tij të dalë jo sa duhet e gjallë.

Synimi për të vizatuar njeriun e ri, jetën, mendimet dhe shqetësimet e tij është karakteristik edhe për poemat e tjera që shkroi Ll. Siliqi në këtë periudhë siç është edhe poema «Mësuesi» (1955). Në këtë poemë autori tregon ndër-gjegjen e lartë dhe heroizmin e njerëzve tanë në luftë për ngritjen e shoqërisë së re. Si prototip i heroit të veprës, Dritan Shkabës, shërbeu Mësuesi i Popullit, Ndreç Ndue Gjoka, që dha jetën në ndeshje me forcat e vjetra shoqërore të malësisë. Në vizatimin e figurës së heroit rol të rëndësishëm luajnë digresionet lirike në të cilat zbulohen mendimet dhe aspiratat e tij fisnike, lartësia e idealit që e frymëzon në jetë: emancipimi shpirtëror i malësorëve. Para syve tanë ngrihet figura e një djali të popullit, që ia ka kushtuar veten luftës për krijimin e një jete të lumtur e të gëzuar për vegjëlinë. Në mënyrë më të qartë fizionomia morale dhe mendore e heroit del përmes shtjellit të veprimit. Ll. Siliqi tregon se si heroit, i frymëzuar nga ndjenja e zjarrtë e dashurisë për vendin dhe nga pasioni për punën e mësuesit, hap dhjetëra shkolla në fshatrat dhe përgatit kuadrin e nevojshëm për to, duke mposhtur vështirësi dhe pengesa të shumta. Shpirti fisnik i heroit, vetëmohimi me të cilin i kushtohet realizimit të ëndrrës së vet, del në pah në kontrast me veprimet e kobshme dhe të pabesa të forcave të errëta të malësisë, të priftit, të bakallit dhe të elementëve të tjerë obskurantistë.

Krahas Dritan Shkabës, në poemë del edhe figura e heroit lirik, ndjenjat dhe mendimet e të cilit i gjejmë në apostrofat drejtuar natyrës shqiptare, në thirrjet retorike dhe shpërthimet lirike. Duke treguar jetën e heroit, poeti

flet për ndjenjat dhe mendimet, shpjegon dhe komenton veprimet e tij, por vende-vende, lirizmi kalon caqet dhe shtyn në plan të dytë pasqyrimin e karakterit të heroit.

Edhe poema «Gjeto Plaku» (1955) e M. Gurakuqit ka në themel një ngjarje të vërtetë. Është historia e një fshatari nga një zonë e Shqipërisë së Mesme, i cili më 1950 rrethoi bashkë me organet e sigurimit dhe fshatarët e tjerë diversantët që i kishin trokitur si miq, dhe, kur pa se këta nuk dorëzoheshin nuk ngurroi t'i vinte zjarrin shtëpisë për të zhdukur armiqtë. Por autori e përpunoi subjektin në përputhje me synimin e tij për të treguar patriotizmin e masave punonjëse, devotshmërinë e tyre ndaj rendit të ri. Heroi i poemës është një malësor i varfër që tërë jetën është përpjekur të jetojë me nder, duke gëzuar namin e mirë të burrit me karakter të fortë dhe të njeriut me sinder. Ai i arrente fort sunduesit e Mirditës, Kapedanin dhe pasuesit e tij, që mbanin në frikë dhe shtypnin malësorët. Ndeshjet me Kapedanin i kishin sjellë Gjeto telashe e trazira në jetë, po ai s'e uli asnjëherë kokën. Poeti e ka vizatuar heroin, duke i mbetur besnik së vërtetës së jetës. Gjetoja është tipi i malësorit, i cili ndonëse e çmon shumë nderin, në jetë u përmbahet paragjykimeve dhe koncepteve shoqërore të vjetra me të cilat rendi i fisit kishte trullësuar mendjet e malësorëve. Kjo del sidomos në episodin e bisedës së partizanëve me Gjeton, i cili e ka vështirë t'u qërrë besë fjalëve të tyre. Ai kujton se pushteti i Kapedanit është i patundur në Mirditë. «Kapidanin zor kush se e lot», - u përgjigjet ai me skepticizëm partizanëve. Po megjithatë, ai i dëgjon me vëmendje fjalët e tyre lidhur me çlirimin e shpejtë të vegjëlisë. Në psikologjinë e malësorit të varfër, që e kishte ndierë thundrën e ashpër të arbitraritetit, nisnin të zgjohen dyshime dhe mendime të reja, që kapërthehen me mentalitetin e vjetër. Lufta në shpirtin e heroit zhvillohet me ashpërsi, por fitorja është me anën e së resë.

Këngët më të rëndësishme të poemës janë ato ku rrëfhet jeta e Gjeto pas Çlirimit. Këtu vendin kryesor e zë episodi i ardhjes së diversantëve në shtëpi dhe akti heroik i malësorit. Ardhja e diversantëve në shtëpi e shqetëson shumë atë, sepse si njeri që është i tëri me rendin e ri, i shumë atë, sepse si njeri që është i tëri me rendin e ri, i drehet çdo keqkuptimi të rastit që mund të njollosë biogra-

finë e tij. Por shpejt e merr veten nga ky hutim i çastit. Duke fshehur urrejtjen e madhe që ushqen për ta, Gjetaja arrin t'i gënjejë diversantët dhe të verë në gjumë vigjilencën e tyre. Në përshkrimin e luftës që ndizet përreth shtëpisë për t'i kapur diversantët kemi një skenë të gjallë të shpërthimit të patriotizmit popullor.

Poema është mbështetur në folklor, gjë që shihet në mjetet stilistike të poezisë gojore, apostrofat, fjalët, me të cilat personazhet i drejtohen njëri-tjetrit në zjarrin e luftës. Vargu është dhjetërrokëshi i rapsodive jo gjithnjë i rimuar.

Tema e jetës së re të njerëzve pas Çlirimit në poemën «Këngë e re për dashurinë e vjetër» (1959) e D. Siliqit zbulohet nëpërmjet antitezës midis rrojtjes së tyre të rëndë para fitores së rendit popullor, nga njera anë dhe shfrytëzimit të egër e vuajtjeve çnjerëzore që heqin masat punonjëse në vendet kapitaliste nga ana tjetër. Subjekti i veprës ka si themel historinë e zakonshme të një çifti të rinjsh fshatarë, të cilët me gjithë vullnetin dhe përpjekjet për t'i shpëtuar kamxhikut të varfërisë, nuk arritën dot të nxirrin bukën e gojës. I dëshpëruar nga skamja dhe dertet, që e kishin mbushur, Xheloja, heroi i poemës, lë gruan e re bashkë me djalin e vogël dhe me zemër të plasur shtrëngohet të marrë udhën e kurbetit. Njëzet vjet të tëra u end nëpër Evropë e Amerikë dhe ky ishte për të një kalvar i vërtetë. Në përshkrimin e vuajtjeve të Xhelos, autori tregon tragjedinë e qindra e qindra të papunëve në vendet e huaja; ai rrëfen, se si në kontakt me realitetin e egër shembej në mënyrë të dhimbshme shpresa e tyre për të vënë «pasuri». Vitinat luksoze dhe reklammat plot vezullim i prisnin me indiferentizëm këta fatkeqë, të cilët, për të mos vdekur nga uria, pranonin të bënin çdo punë, sado e rëndë që të ishte. Jeta gjithnjë me shqetësime dhe me punë raskapitëse ua shkaktërronte shëndetin.

*Po i mpakeshin atij fuqitë
si i mpaken djellit në janar.¹*

1) D. Siliqi, *Këngë e re për dashurinë e vjetër*, Tiranë 1959, f. 57.

– thotë poeti për Xhelon.

Heroi kryesor i poemës është Afërdita, te e cila është shprehur ideja themelore e veprës. Sikurse e gjithë vegjelia, ajo provoi jetën e zezë të së kaluarës. Asaj iu permbys ëndrra modeste për të pasur jetën e vet familjare, megjithëse luftoi me guxim krah për krah me burrin kundër skamjes. Pasi iku i shoqi në mërgim, ajo, «baba e nënë» për feminë, u robëtua tërë jetën në shi e diell, duke punuar atë copë arë që kishte, dhe në këtë luftë të vështirë harxhoi rininë dhe shëndetin e vet:

*Ajo hije burrë ish apo grua
që i binte arës pa pushim
me hosten në dorë e dukej thua
se një valle hiqte pa mbarim?¹*

Përveç privacioneve dhe mundimeve të pafund që hiqte për të siguruar kafshatën e përditshme, Afërdita ishte shtrënguar të luftonte edhe për të mbrojtur veten nga gojë e këqija. Afërditës, ashtu si njerëzve të tjerë të varfër dhe të shfrytëzuar, iu ngjall shpresa për ditë më të mira vetëm pasi Partia ndezi luftën kundër të huajve. Kur në Shqipëri malet u mbushën me partizanë, ajo rroku pushkën dhe u bashkua me luftëtarët e popullit. Pas Çlirimit, për të nisi një jetë e re.

Veçori dalluese e poemës «Këngë e re për dashurinë e vjetër» është rrëfimi poetik i shtruar, imtësitë konkrete jetësore, vizatimi i personazheve në situata tipike.

Ndër veprat më të shquara poetike me temë ndërtimin socialist është edhe poema «Ringjallja» (1959) e Ll. Siliqit, shkruar me rastin e 15-vjetorit të çlirimit; ajo u kushtohet Atdheut socialist, sukseseve dhe fitoreve të rëndësishme që u arritën në ato vite pune dhe përpjekjesh të mëdha. Autori e thuri veprën si panoramë poetike me pamje e skena nga jeta e sotme dhe lufta për ngritjen e shoqërisë socialiste. Pjesët e kësaj panorame, për nga bre-

1) Po aty, f. 27.

ndia dhe nga stili, janë nga më të ndryshmet. Apostrofat patetike që i drejtohen Atdheut dhe Partisë, ndiqen prej vizatimesh realiste; pas rrëfimit prekës për aktin heroik të ushtarit që mbrojti me gjak kufirin e Republikës, vijnë përshkrime lirike dhe peizazhe nga qytetet dhe krahinat e vendit; legjenda e bukur dhe plot lirizëm mbi dashurinë e vërtetë dhe besnike të dy të rinjve fshatarë ndërpritet nga strofat plot zemëratë dhe urrejtje për ata që shtynë urtë e një lufte të re. Në pajtim me këtë thurje ndryshon edhe toni i rrëfimit, por intonacionet oratorike janë ato që mbi-sundojnë në vepër.

Poema hapet me vargje në të cilat shprehet hareja e papërmbajtur që i gufon në zemër poetit, kur para syve të tij ngrihet pamja e Atdheut të gëzuar në një mëngjes pranveror:

Mirëmëngjez,
o toka jonë e lirë,
pa bej,
tuxhar
e hasëm.
Parmendë
e pushkë
e pendë,
vëlla,
shtrëngoi mirë!¹

Në këngët që vijnë më pas, poeti, duke e ruajtur këtë frymë optimizmi, nis e rrëfen me mburrje për ndryshimet që i sheh syri kudo, për fabrikat dhe qendrat e reja industriale, për Cërrikun, Kurbneshin, Bulqizën, për njerëzit e rinj që po ngrënë «godinën e socializmit», për perspektivat e ndritura, dhe për besimin e masave punonjëse në të ardhmen. Ndonjëherë rëndësinë e ndryshimeve historike që u kryen pas Çlirimit, autori e jep përmes përshtypjeve dhe ndjenjave të ndonjë personi tjetër që nxjerr në vepër. E tillë është skena me plakun në kampin e pushimit, apo takimi me fshatarin plak, të cilin kooperativa e shpëtoi nga skamja dhe vuajtjet. Kur rrëfen për shpërthimin e jetës së re në Shqi-

1) Ll. Siliqi, Ringjallja, Poemë, Tiranë 1960, f. 7.

përi, poeti përdor shpesh antitezën. Kështu kënga e parë është ndërtuar si përjasje e pamjeve të qarta, plot dritë të së tanishmes, me kujtimet e hidhura të së kaluarës, të viteve të sundimit të egër të klikës së Zogut, të dhëna me viza groteske.

Në qendër të veprës është figura e heroit lirik, i cili, si rrëfyes i ngjarjeve, lot një rol të madh në shtjellimin e idesë së veprës. Për gjithçka, poeti flet jo si dëshmitar i thjeshtë, por si pjesëmarrës aktiv i ndryshimeve të mëdha që kanë ngjarë në jetën e vendit. Ai e ndien veten të lidhur ngushtë me popullin dhe krijimtarinë e vet letrare e shikon si pjesë të punës së madhe që bëhet për ngritjen e botës së re, prandaj shpesh i drejtohet vetes me pyetjen, sa i përgjigjet poezia e tij heroizmit dhe përpjekjeve plot sakrificë që bën populli për ndërtimin e socializmit. Kjo notë lirike individuale rritet në këngën e fundit dhe bëhet kryesore. Poeti fillon të flasë tani në shumës, thotë «na» dhe është krenar se brezit të tij i ra barra e vështirë, po e lartë, të çajë brazdat e para drejt jetës së re. Brezave që vijnë ai u lë si amanet ta çojnë më tej çështjen e madhe të popullit, t'ia shtojnë edhe më lavdinë dhe lumturinë atdheut:

... E na
do jem' krenarë,
që nga duart tona
ju e rrokët flamurin,
nga t'parët tanë
që e rrokëm na ma parë!
Do jem' krenarë,
që fjalën «Komunizëm»
e shkruem të parët
na
në atë flamur!¹

Ideja e mundit dhe e përpjekjeve që i kushtoi popullit lufta për shkatërrimin e botës së vjetër, thirrja për të qenë vigjilentë përballë planeve djallëzore të armiqve, formon brendinë e shumë vargjeve të frymëzuara.

1) Po aty, f. 44.

Poema «Ringjallja» shquhet për larmi intonacionesh; notat patetike gërshetohen me rrëfime të buta lirike, hareja me shpërthim ndjenjash zemërimi. Fjalori i saj përbëhet prej fjalësh dhe krahasimesh të gjalla. Disa figura përshkojnë gjithë veprën si lajtmotive; e tillë është fjala «ringjallje», e cila fut në poemë një atmosferë festive. Poeti flet për ringjallje të Shqipërisë dhe të jetës, ai sheh si «zambaku zbardhon», «pemët gjelbërojnë» dhe na fton «të kridhemi në të hareshmen turmë». Jeta e popullit krahasohet me një «valle përpjekjesh, andrrash, ngjyrash». Fjalët me ngjyresë të theksuar poetike (fiskajë, i magjishëm, andrim, zambak, i madhërisëm etj.) karakterizojnë leksikun e poemës deri në fund. Në përputhje me ndërtimin e përgjithshëm intonativ, vepra është plot thirrje, pohime, pyetje retorike. Të shumta janë sidomos apostrofat, të cilat shërbejnë jo vetëm si mjet stilistik, por edhe për të krijuar në poemë një atmosferë ngazëllimi dhe hareje.

«Ringjallja» është thurur në formë të shkallëzuar. Nga vargjet janë nxjerrë në radhë më vete ato fjalë që mbajnë peshën kryesore të idesë së veprës. Poema është shkruar në jamb pesëkëmbësh, rima është kryesisht e kryqëzuar.

Duke hequr dorë nga frazat e përgjithshme dhe duke përdorur figura që japin mundësi për ta paraqitur në mënyrë më të plotë dhe më të gjallë realitetin socialist, poetët e rinj nuk iu rreshtën patetikës përmes së cilës shprehën ngazëllimin për ndryshimet e vrullshme që po pëson vendi në rrugën e industrializimit socialist. Pikërisht, notat e ngritura poetike dhe mendimet e rëndësishme karakterizojnë dy poemat e I. Kadaresë, që kanë për temë ndërtimin e jetës së re, «Ëndërr industriale» (1960) dhe «Shënime për brezin tim» (1960).

ENDËRR INDUSTRIALE gjinale. Në kohë me shi poeti ka qëndruar para një fushe plot pëllgje, dhe në fantazinë e tij merr trup qyteti i ri, ku do të prodhohet çelik. Duke vërejtur punëtorët që ngulnin piketa, para syve të tij shpaloset si një vegim i bukur pamja e qytetit të ardhshëm industrial. Pikërisht shtohen e shtohen dhe marrin përvijimet e ndërtesave vigane, që gjëmojnë nga zhurma shurdhuese e maqinave. Në sfondin e mjegullt, poetit i shfaqet vargu i fabrikave, që derdhin çelik dhe oxhaqet e tyre vjellin natë e ditë tym të zi. Ngritja e këtyre qyteleve, simbol i epokës socialiste në Shqipëri, e entuziazmon poetin, e mbush atë plot krenari, prandaj shpërthen në vargje patetike:

*Metali do të derdhet
metali i parë
Shqipëria do të japë metal të saj,
çelik të gjallë¹*

*.....
avujt kuq e zi
dhe flamujt kuq e zi,
Ky qytet i shqiptarëve
për shqipëtarët.*

*Dhe s'do të mbajë ai emra të bujshëm:
«Qytet i diellit»,
«Qyteti i parajsës»
«Qyteti i lumturisë».
Ky do të quhet thjesht:
Qyteti i ri industrial
i RP të Shqipërisë.²*

Në qytete të rinj si ky, poeti sheh sigurinë për të ardhmen socialiste të Atdheut, përmes këtij «qyteti të hekurt», «ushtarët e armikut s'do të marshojnë kurrë», Shqipërisë,

*kohrat s'do t'i hedhin me radhë
hi dhe pluhur mbi kokë.³*

— thotë poeti.

1) I. Kadare, *Shekulli im*, Vjersha dhe poema, Tiranë 1961, f. 95.

2) Po aty, f. 91.

3) Po aty, f. 101.

Për të ai qytet i ri është qytet «i pavdekur», se është qytet i ndërtuar në epokën e socializmit. Por, në goftë se armiqtë do të guxojnë të prekin Atdheun, atëherë:

*armë të tmerrshme do të derdhim,
në gjoks të hasmit plumb të hedhim;¹*

Rëndësinë e madhe të përparimit që po bën vendi, autori e zbulon edhe me anë të paralelizmave historike. Duke folur për Shqipërinë socialiste, që tani prodhon edhe metal për vete, ai kujton vargun e gjatë të martirëve të kombit, të cilët dhanë jetën duke luftuar me shpata të kalitura me «hekur të huaj». Me forcën e fantazisë së vet, poeti përpiqet të hedhë sytë edhe në jetën e ardhshme të këtij qyteti, të përfytyrojë se si do të rritet dhe do të lulëzojë ai, se si do të rrojnë dhe punojnë njerëzit e tij. Format e reja të jetës do të zënë rrënjë aty dhe do të zhvillohen në luftë me botën e vjetër, me mendimet, me ndjenjat dhe me pasionet e ushqyera dhe të nxitura nga morali patriarkal. Këtë ide poeti e ka shprehur me anë të hiperbolës dhe të konvencionit. Plaku i thinjur, që zbrit nga bjeshkët për të vrarë të bijën, që «e koriti», sepse e la të fejuarin dhe u bë metalurge, është personifikim i rendit të vjetër familjar e shoqëror, që, i egërsuar përpiqet t'i bëjë qëndrësë sulmit të pandalshëm të socializmit. Po, kjo është e kotë, furrat martin, me «ulurima sirenash» dhe «mijëra sy shkëndijash dhe avujsh» «të tmerrshëm», do t'i thonë «ndal» së vjetrës.

«Me syza të zeza» të kërrusur mbi «fise oksidrike», me shtylla të tensionit që përshkojnë tokën e saj kryq e tërthor, me oxhaqe të larta fabrikash — me këto tipare shfaqet figura e Shqipërisë socialiste në poemën «Shënime për brezin tim».

*E shoh Republikën
në mëngjeze industriale
me kombinezon veshur
Republikën time
q'akoma mban qeleshe.²*

1) Po ay, f. 96.
2) Po aty, f. 66.

Kjo figurë, e përgjithësuar gjerësisht, e atdheut të ri, zërthehet në një varg krahasimesh dhe figurash të tjera plot forcë shprehëse, të ndërtuara me elemente të marra drejtpërdrejt nga puna ndërtimore, që zien në të katër anët e vendit.

Për të zbuluar në mënyrë sa më të qartë dhe bindëse procesin e madh të shndërrimit socialist dhe sidomos të ardhmen e sigurt që Partia po i gatit Shqipërisë, autori përdor në poemë asociacione historike. I tillë është rrëfimi i legjendës mitologjike të Akeronit e të Karontit, apo kujtimi i fundit të turpshëm që pati lufta e Gentit, mbretit të ilitëve kundër romakëve. Akeronin dhe Karontin poeti e sjell në mend kur flet për Bistricën, për centralin elektrik që po ngrihej mbi këtë lumë. Kujtimi i fakteve dhe i ngjarjeve të së kaluarës së largët është një shkas për poetin për të folur për «brezin» e vet dhe veprat e mrekullueshme që ai po kryen në Shqipërinë e re:

*Po tani më dëgjo mua xha Karont,
të të tregoj diçka
nga bota jonë e të gjallëve.
Të tregoj për brezin tim
që varkën tënde
do ta coptojë rëzë maleve;
Të tregoj për brezin tonë,
që mbi tryezë, ku pleqtë lozin dominonë
në vend të 4-3-shit,
Harushën e madhe mund të zbresë!
Se ka një forcë të madhe
sot Shqipëria
q'u shtohet maleve, stuhive, krenarive
të saj,
forca e re:
Partia!¹*

1) Po aty, f. 69.

Në këto pjesë, stili ndërron; nga notat lirike, emocionuese të një bisede të thjeshtë, zëri i poetit kalon në ton patetik. Me vargje oratorike nis e mbyllet dhe rrëfimi mbi fundin e palavdishëm të mbretit Gent:

Ne

*rrugë të tjera çajmë,
të pathyer,*

*Çdo hark triumfi të huaj për lajmë,
nderin e atdheut
më lart se këto male e mbajmë!*

Në këto vargje merr jetë motivi i vazhdimit të traditave patriotike luftarake nga brezi i sotëm i Shqipërisë, motiv që zë vend të rëndësishëm në poemë. Në emër të ndërtuesve të rinj të shoqërisë socialiste, në radhët e të cilëve fut edhe veten, poeti shpreh vendosmërinë për ta mbrojtur jetën e re të popullit nga çdo armik që do të orvatet ta prishë. Nuk ka qetësi dhe paqe për njerëzimin përparimtar dhe Shqipërinë, pohon autori, derisa në botë janë gjallë forcat e zeza të imperializmit.

«Ëndërr industriale» dhe «Shënim për brezin tim» i përkasin llojit të poemës liriko-epike. Në themel të veprave janë ndjenjat dhe mendimet që lindin nga soditja e fakteve të jetës së sotme. Kjo ka përcaktuar edhe kompozicionin e të dyja këtyre veprave. Si «Ëndërr industriale» ashtu edhe «Shënime për brezin tim» shtillen si monolog lirik; poeti rrëfen për ato që sheh në realitetin e sotëm, për ndërtimet madhështore, për fytyrën e re që po merr atdheu, për dëshirat dhe synimet e brezit të ri, që po ngre shoqërinë socialiste. Kapërcimet e poetit nga tema në temë, që ndonjëherë janë edhe të papritura e të befasishme, nuk janë të pamotivuara. Ato kanë një lidhje të brendshme, që përcaktohet nga toni emocional koherent i poetit, nga mahnitja dhe gëzimi për dinamizmin e ecjes përpara të atdheut. Ky

1) Po aty, f. 72.

ndërtim si bisedë me vetveten, ka përcaktuar nga ana tjetër, vargun tonik, që ngrihet mbi sintaksën e të folurit të zakonshëm. Poeti e zhvesh vargun e tij prej muzikalitetit që rrjedh nga ruajtja strikte e sasisë së theksave dhe të rrokjeve duke u përpjekur të sigurojë më shumë një numër të caktuar theksash në çdo varg.

E re në këto poema është edhe stilistika. Autori u shmanget figurave, që i japin me hollësitë e tyre faktet dhe sendet reale. Ai synon të përdorë figura të përgjithësuarra gjerësisht. Kjo ka sjellë që figurat dhe krahasimet vigane, groteske e fantastike me ngjyra ekspresive, të jenë ndër mjetet stilistike që përdor autori për të shprehur idenë e vet.

I. Kadareja, duke futur në veprat e veta fjalë nga më të rëndomt (gavetë, pension) dhe duke krijuar me to kompozita (vargje-binarë) e zgjeroi qarkun e leksikut dhe arriti kështu të shtojë forcën shprehëse të vargut. Rimat janë të larme dhe origjinale. Krahas rimave të sakta (të guxojë-xixëllojë, vini-bini), ndeshemi në rima të pasakta, ku janë të përbashkëta vetëm zanoret e rrënjës së fjalës (vjetër-vjet, maleve-madhe) ose në rima të përafërta (rrëmujës-rrokopujë, valëve-stërkalave). Për rimat janë vënë fjalë jo të rastit, por të tilla që njëkohësisht kanë rëndësi në shtjellimin e konceptit poetik të veprës.

Shumë vjersha lirike të I. Kadasës shquhen nga përpjekja për të zbuluar botën e pasur shpirtërore të rinisë sonë, mendimet dhe aspiratat e atyre të rinjve, jeta e vetëdijshme e të cilëve nisi pas Çlirimit. Pikërisht kjo është brendia e poemës lirike «Ëndërrimet» (1957) në të cilën I. Kadareja shprehu ndjenjat e gëzuara të rinisë sonë. Janë këto ndjenja të një rinie që ka fatin të rrojë në epokën e socializmit, të rritet në një atmosferë të lirë, pa frikën e urisë, të papunësisë dhe të së nesërme së pasigurt. Në heroin lirik të poemës, tek i cili mishërohet gjallëria dhe optimizmi i të riut të kohës, spikat dashuria për atdheun. Për

lirinë dhe lumturinë e atdheut socialist rinia jonë është gati të luftojë dhe të flijohet:

*Ne do të thinjemi
që ti mos thinjesh kurrë,
që mos krrusesh po të jesh i ri;
që plagët që të la koha e shkuar,
të mbyllen përsëri.*

*Sikur, atdhe i shtrenjtë,
t'i thrrësësh brezit tonë:
«Radhën ke»!*

*Për ne alarmi yt do të jetë i shenjtë,
do të jetë ligj për ne.¹*

Figura e njeriut tonë të ri, rritur në atmosferën e shndërrimeve shoqërore-kulturore, plot besim dhe optimizëm në të ardhmen, shfaqet edhe në krijimet lirike të poetëve të tjerë (D. Agolli, A. Shehu, D. Siliqi).

* * *

Në vitet 50 vëmendjen e poetëve e tërhoqi tema ndër-kombëtare sidomos tema e internacionalizmit proletar. Shumë krijime përshkohen nga ndjenja e respektit dhe e mirënjohjes ndaj udhëheqësve të Revolucionit të Madh të Tetorit dhe themeluesve të shtetit të parë socialist në botë, Leninit dhe Stalinit («Në Mauzole», e Ll. Siliqit, «Leninit» e I. Kadare, «Me ty Stalin» e A. Çaçit, cikli poetik «Njeriut të madh e të thjeshtë» të D. Bubanit).

Te poezia «Në Mauzole» Ll. Siliqi flet për dashurinë e pakufishme që njerëzit e thjeshtë të çdo kombësie dhe vendi ruajnë në zemër ndaj kujtimit të udhëheqësit gjenial të proletariatit botëror, Leninit. Për poetin forca e ideve të Leninit është garancia e «lirisë së fituar» dhe e fitores së ardhme të popujve mbi tiranët. Figura e Leninit vizatohet me tipare monumentale, simbol vigan i socializmit fitimtar,

1) I. Kadare, *Endërrimet*, Lirika dhe poema, Tiranë 1957, f. 119.

shpresë e njerëzimit në luftën e shpëtuar nga skllavëria e shoqërisë me klasa:

*Dhe dora e tij,
që botës drejtimin tregoi,
e ngrime nga akulli i vdekjes
si grusht,
do mbesi ndër shekuj
mburojë e lirisë së fitueme,
si grusht i njerzis që kërkon:
tiranët përpjet me vorrue
dhe botën e re me naltue.¹*

Nderimi i thellë për udhëheqësin e madh të proletariatit botëror bashkohet me ndjenjën e mirënjohjes, sepse nën flamurin e Leninit «të bijtë e popullit tim, — thotë autori, — ngritën pishtarin e ri mbi natë e stuhi».

«Në Mauzole» është shkruar me një stil solemn. Trashëgimi i ideve të revolucionit të madh krahasohet me «fanarin», që drejton «anijet... me dalë n'limanin e jetës mes rrahjes së egër».

Pasqyrim origjinal gjeti figura e Leninit në vjershën «Leninit» të I. Kadare. Poezia është nisur si ankim i poetit, se shumë herë u mat të shkruante për Leninin, por gjithnjë vjershat i dolën «të buta», «lirike», kurse «Ai» duhet dhënë përmes furtunës revolucionare. Më në fund dilema merr rrugë. Lenini nuk qe vetëm luftëtar i pamposhtur, por edhe njeri në kuptimin më të plotë e më të thellë të kësaj fjale, që e donte jetën në shfaqjet e saj më të larta:

*Po nuk ka gjë: Iliçi le të jetë
në mes peizazheve që dua shumë.
Mes rrugëve, mes fushave të qeta,
ku zhurmëron një lis, ku rrjedh një lumë.
Sepse Ai në eci nëpër shqota,
në rrugët plot me erëra tetori,
i deshte bukuritë e kësaj bote²*

1) Ll. Siliqi, *Rruga e lumturisë*, Vjersha, Tiranë 1950, f. 45.

2) I. Kadare, *Endërrimet*, Lirika dhe poema, Tiranë 1957, f. 10.

Poetët i bënë jehonë edhe luftës së madhe që zhvillohet në të katër anët e rruzullit tokësor, në Azi, Afrikë, Amerikën Latine e gjetkë për të hedhur tej skllavërinë kombetare dhe shoqërore. Krijimet poetike me këtë temë përshkohen nga fryma e solidaritetit ndërkombëtar, nga urrejtja ndaj çdo force të shtypjes dhe të poshtërimit të njeriut, nga përkrahja e fortë e luftës së drejtë të popujve. Vajza kongoleze, që kërcen (poezia «Kongo, Kongo» e D. Agollit), ngjall simpatinë e thellë të poetit dhe në të njëjtën kohë zëmëratën e tij kundër atyre që shtypin dhe grabisin popullin kongolez:

*Nëpër Vjenë shkonte një zezake,
shkonte edhe këngën linte pas,
kish dy vëthë bakri si tabake,
kurse Kongua është plot elmaz!¹*

Dhimbja për fatin tragjik të punonjësve në vendet kapitaliste përshkon vjershat «Reklama» dhe «Në kafe» të D. Agollit. Te vjersha «Reklama» ideja poetike është zbuluar me anë të kontrastit; dritat e reklamave që shkëlqejnë me mijëra dhe të verbojnë sytë sapo erret, e nënvizojnë edhe më fort gjendjen tragjike të një invalidi, që zvarriset rrugë më rrugë, duke lypur e duke pështyrë gjak. Vjersha «Në kafe» flet për një fakt tjetër nga jeta e Evropës kapitaliste, por ideja e autorit, zbuluar përmes kontrastit poetik, është po ajo; jeta e vegjëlisë në këto vende është e mbushur plot brenga dhe trishtime. Përshkrimi lakonik i fakteve jetësore, aftësia për të gjetur imtësi poetike të goditura, mënyra e thjeshtë «prozaike» e rrëfimit dhe mungesa e figurave retorike — këto janë veçoritë e këtyre poezive të D. Agollit, të shkruara me varg të lirë.

Në vitin 50 në poezinë e sotme vend me rëndësi zuri motivi i luftës për paqe. Shumë vjersha flasin për dëshirën e madhe të popullit shqiptar për të rrojtur në paqe, për luftën që ai bën bashkë me njerëzimin përparimtar kundër forcave agresive. Një nga vjershat e para kushtuar motivit të paqes është «Sa malet rrofsh, ushtri e madhe e paqes» (1950) e Ll. Siliqit. Në fillim poeti shpreh harenë për

¹) D. Agolli, *Hapat e mija në asfalt*, Tiranë 1961, f. 67.

sukseset e mëdha që ka arritur atdheu, por këtë gëzim e trazon mendimi se në botë ka forca të cilat duan që «furtuna vatrat t'na përlajë». Imperializmi amerikan, kreu i reaksionit ndërkombëtar, përshkruhet nga poeti me ngjyra fantastike e groteske («tejtje oqeanit kthetrat mpreh një mostër, tue zgjatun kryet jashtë strofullit të vet, dhambët kërcëllon»). Poeti është i bindur se planet e armiqve do të dësh-tojnë, ai ka besim se popujt e botës do t'ua ndalin dorën forcave të errëta që kërkojnë t'i venë flakën botës.

Në këtë kohë, lidhur me kushtet në të cilat ngrihej Shqipëria e re, kur klasat e përmbysura dhe armiqtë e jashtëm nuk lanë gur pa luajtur për të penguar ndërtimin socialist, merr zhvillim edhe poezia satirike, rrënjët e së cilës shkojnë në satirën e viteve të luftës. Poezia satirike e viteve 50 synoi në radhë të parë demaskimin e botës së vjetër, të ideologjisë dhe të moralit të saj.

Një ndër krijimet e para satirike është «Do bëhen zgjedhjet» (1948) e Sh. Musarajt. Poema vë në lojë me një sarkazëm të fortë klasat e përmbysura, ëndrrat dhe planet e tyre për të kthyer kohën e vjetër. Kësaj autori ia ka arritur përmes pasqyrimin të mendimeve dhe të dëshirave të «heroit» të veprës, sidomos të tërbimit që e ka kapur tek sheh marshimin përpara të jetës së re. Entuziazmi që ka rrëmbyer popullin, hovi, që karakterizoi pas Çlirimit jetën shoqërore dhe politike, puna ndërtimtare që vlon në të gjitha anët e Shqipërisë, të gjitha këto e egërsojnë «heroin», «esnaf të vjetër», i cili kujton me nostalgji vitet e shkuara, kur paria që ishte «dje gjithë lezeti» që «te xhandari e gjer te mbreti», sundonte në Shqipëri, ashtu siç i pëlqente. Gjendjen e re, ai e quan «babiloni», sepse solli në fuqi «milet-harbunë». Merita e autorit është se në portretin satirik të armikut të rendit të ri, dha tërbimin e klasave sunduese, që përmbysi revolucionin popullor, shpresat e tyre të kota për të rifituar pozitën e humbura.

Sh. Musaraj jo vetëm demaskon, po bën thirrje për vijëllencë, sepse armiku «s'e le zanatin». Të pakënaqurit, duke nisur nga bejlerët e tregtarët e mëdhenj e deri te kleri

reaksonar, jo vetëm shfrehjë kundër popullit, por edhe veprojnë për të rrëzuar me forcë rendin e ri, dhe, kur dështojnë në këtë rrugë, ndërrojnë shpejt «thoj e lëkurë» dhe orvaten të fusin një këmbë në pushtet dhe aty të zhvillojnë sabotim e diversion.

Për nga veçoritë artistike, sidomos për nga parimi i ndërtimit të figurës «Do bëhen zgjedhjet» qëndron afër poemës së po këtij autori «Epopeja e Ballit Kombëtar». Thelbi i armikut del në shesh përmes fjalëve që ai thotë, të cilat tingëllojnë si vetëdemaskim. Poeti ka shfrytëzuar mjetet e shprehjes ironike të ligjërit të përditshëm dhe disa figura të poezisë gojore.

Përfaqësuesit e botës së vjetër, që rrojnë me nostalgjinë e së kaluarës dhe ëndërrojnë kthimin e kohës kur bënë në Shqipëri ashtu siç donin vetë, vihen në lojë dhe në krijimet e poetëve të tjerë satirikë. Tek «Vaji» i N. Bulkës beu ankohet për kohët e këqija që erdhën; ai vajton çifligun që ia morën «harbutët» dhe e lanë si mos më keq. Portretin e përfaqësuesit të shtresave të larta që e kanë parë Shqipërinë si çiflig të tyre, autori e dha në vjershën «Atdhedashuri», thurur gjithashtu në formën e monologut satirik. Edhe T. Miloti në vjershën «Jeta» tallet me shpresat e klasave të përmbysura që historia i hodhi në koshin e vjetërsirave. Te vjersha «29 Nëntor» vihen në lojë shpresat e tyre për të ardhur prapë në fuqi me ndihmën e një zbarkimi të «miqve» të përtejdetit. Tipin e beut që pat qenë person me rëndësi, A. Varfi, në vjershën «Ëndrra e Mahmut bej Pilafit», e pikturoi me ngjyra groteske. Duke përdorur epitete dhe hollësi mjaft karakteristike, poeti arrin ta tregojë bukur mentalitetin dhe psikologjinë prej anadollaku të këtyre «trimave të pilafit», në duart e të cilëve ishte fati i vendit në kohën e Zogut.

Në vjershën «Vesel Spathari» A. Banushi krijoi tipin e një matrapazi të vjetër që orvatet t'u përshtatet rrethanave të reja. Duke gjetur syleshë rreth vetes, ai arrin të fitojë besimin e drejtuesve të një ndërmarrjeje dhe të bëjë karrierë të shpejtë. Tek rrëfen për jetën dhe veprimtarinë e këtij njeriu, poeti i shpjegon këto si tipike për sjelljen pas Çlirimit të ish-klasave shfrytëzuese; konformizmi është një nga format përmes së cilave armiqtë përpi-

qen të hyjnë në botën e re, duke i qëndruar njëherazi besnik mentalitetit dhe moralit të klasës nga vijnë.

Shumë krijime të poetëve i janë kushtuar satirizimit të shfaqjeve negative në jetën e sotme, që ishte pasojë e ndikimeve të huaja ideologjike. Fshikullohet ashpër sidomos burokrati, i cili me shkresurinat e panevojshme dhe qëndrimin formalist pengon zgjidhjen e shpejtë të problemeve. Këtë tip poetët e paraqitën në situatat më të ndryshme, por gjithnjë vunë në dukje interesimin e tij të jashtëm për mbarëvajtjen e punës. Në vjershën «Kol Drithëraku» S. Çomora krijoi portretin e gjallë të burokratit, që vihet në lëvizje për të plotësuar nevojat e popullit, vetëm atëherë kur sheh se kjo gjë është edhe në interes të vet. Këtu fjala e shkrimtarit gërshtohet edhe me monologun që nxjerr në dritë të plotë fytyrën e vërtetë të këtij karakteri shoqëror.

Të metat dhe veset e njerëzve, shprehitë e tyre negative, mbeturina të moralit të vjetër shoqëror, si servilizmi, kopracia, hipokrizia etj., përqeshen në një varg krijimesh hartuar zakonisht si epitafe ose portrete, plot lakonizëm në shprehje, dhe me humor të natyrshëm.

Normat e moralit patriarkal, qëndrimi poshtëruës dhe fyes ndaj gruas, fanatizmi, sjellja mendjehetë në dashuri etj. janë shfaqje të tjera negative që u vunë në shënjestër nga poetët satirikë («Zylyf Esnafi» dhe «Maksut shkollari» të T. Milotit, «Burri përparimtar» i D. Bubanit, «Allafranga me tanuz» dhe «Më rreh zemra për dy vasha» të A. Banushit etj.).

Në një tok vjershash, si «Rubai të Çurçillit» e N. Bulkës, «Racizëm» e S. Çomorës, «Në hanë» dhe «Kolonialistët» të T. Milotit, «Rrugë pa rrugë» e D. Bubanit etj., fshikullohen planet e tërbuara të imperializmit, arti dhe kultura borgeje, denoncohet roli i veglave të imperializmit, i revizionistëve dhe i Vatikanit.

Me gjithë realizimet e veta, poezia satirike eci rryeshëm në krahasim me kërkesat e jetës. Cektësia në pasqyrimin e jetës, temat e vogla dhe pa domethënie të gjerë shoqërore, rendja pas një humori të lehtë, që arrihej në sajë të natyralizmave në gjuhë dhe te imtësive të jashtme komike - këto janë të metat kryesore në fushën e satirës.

PROZA

1

Ashtu sikurse në poezi, edhe në prozë, vëmendja kryesore u drejtua në ngjarjet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Autorët treguan frymën e guximit dhe të sakrificës, që shfaqën partizanët dhe populli, fiksuat elementet e reja që u dukën në ndërgjegjen e njerëzve. Shkrimet e para në prozë, më të shumtën e rasteve kishin karakter dokumentar, në to flitej për ngjarje të vërteta dhe për njerëz realë. Botimi i kujtimeve, i skicave dhe i shkrimeve të tjera dokumentare u përcaktua nga nevoja për t'u njoftuar lexuesve sa më shumë fakte të heroizmit të masave popullore në vitet e përleshjes me pushtuesit e huaj. Kjo i përgjigjej entuziazmit të lartë patriotik që ngjalli në popull ngadhënjimi i revolucionit popullor dhe çlirimi i atdheut nga zgjedha nazifashiste. Kuptohet se prozatorët që shfrytëzuan në krijimtarinë e tyre mbresat dhe vëzhgimet e drejtpërdrejta nga pjesëmarrja në lëvizjen popullore çlirimtare, u përpoqën të përshkruajnë fakte dhe ngjarje më karakteristike, të zbulojnë kuptimin e tyre të brendshëm. Veprat me karakter dokumentar luajtën rol të madh në hapat e parë që po bënte letërsia për të përvetësuar realitetin e ri historik.

* * *

Ndër veprat më të para kushtuar epopesë heroike të Luftës Nacionalçlirimtare ishte libri «**Kujtime nga jeta e Brigadës I Sulmuese**» i Mehmet Shehut, që doli në dritë më 1945.

Autori evokoi disa nga episodet luftarake dhe manovrimet e guximshme të Brigadës I Sulmuese, sidomos ato të periudhës së operacionit armik të dimrit 1943-1944. Përmes rrëfimit të gjallë e plot vërtetësi jepet vetëdija e lartë e partizanëve, fryma e tyre e paepur përballë presionit të gjithanshëm të armikut dhe pengesave të natyrës, gatishmëria për sakrificën e epërme në emër të idealit të çlirimit të popullit.

Libri hapet me kujtimet rreth betejave, që u zhvilluan në nëntor të vitit 1943 në lëndinat e Kapajt (Mallakastër). Me viza të shpejta dhe energjike, autori tregon si partizanët, ndonëse të paktë në numër dhe në kushte të vështira, duke vepruar me mprehtësi dhe zgjuarsi, rrethojnë e shfarosin një kompani gjermanësh. Kryesorja në këtë përshkrim është paraqitja e vendosmërisë dhe e guximit që shfaqin partizanët. Kjo ide del më e plotë në rrëfimin e aktit heroik të Gjok Doçit¹, i cili rrëzohet nga një bombë gjermane, që e goditi mu në kraharor tek po sulmonte në krye të partizanëve të vet kundër një grupi nazistësh. Me fraza të shkurtra dhe në mënyrë të thjeshtë rrëfëhet edhe për ndeshjen e rreptë të janarit 1944 në Tendën e Qypit (Skrapar), ku mbetën të vrarë 120 gjermanë. Frymën heroike të partizanëve e japin qartë fjalët e komunistit Mefail Rozani, i cili kërkon që komanda t'i lërë partizanët të hidhen sa më parë në sulm. «Mos kemi ardhur këtu për të ngrënë qofte apo për të fjetur», thotë ai mënjane, si i pakënaqur nga që e urdhërojnë të presë shenjën e sulmit. Dhe kur nis beteja, Mefaili shquhet për vrullin me të cilin hidhet në krye të kompanisë së vet dhe bie në një përleshje të ashpër i vetëm kundër tre hitlerianëve.

Vendin kryesor në libër e zë përshkrimi i inkursionit tanimë legjendar, që një pjesë e brigadës, e ngarkuar me mision të posaçëm, bëri në Shqipërinë e Mesme në dimër të vitit 1944, përmes zonash armike dhe në kushte jashtëzakonisht të vështira të natyrës. Në këtë pjesë shfaqet përpara lexuesve në tërë madhësinë e vet fizionomia e lartë

¹ Gjok Doçi nga Lura (Peshkopi) mban titullin «Heroi i Popullit».

morale dhe shpirtërore e partizanëve si njerëz të tipit të ri. Të vetëdijshëm për rëndësinë e madhe të misionit që u është ngarkuar, ata udhëtojnë natë e ditë, duke pushuar shumë pak, sa për të marrë forca për të vijuar më tej rrugën, ecin në shi dhe në dëborë shpesh edhe zbatuar, u qëllon të kalojnë ditë të tëra pa futur gjë në gojë, sepse zonat nëpër të cilat kalojnë janë të pabanuara ose sepse disa fshatra që janë nën ndikimin e armikut nuk u nxjerrin bukë, marshojnë ngandonjëherë edhe pa udhërrëfyes, por me gjithë këto mungesa dhe vuajtje nuk dëshpërohen, morali i tyre është i lartë, vullneti i papërkulur. Përveç pengesave shpeshherë të jashtëzakonshme të natyrës, siç është Kaptina e Martaneshit, ku shtresa e borës ishte katër metra dhe partizanët e kalojnë megjithëse mbahej nga banorët e atyre anëve si e pakapërcyeshme në dimër, brigada në rrugën drejt objektivit të saj, Shëngjergjit, ndesh një armik tjetër më të rrezikshëm: kolonat e nazistëve dhe turmat e mercenarëve, që e ndjekin këmba-këmbës, i zënë shpeshherë shtigjet dhe kur arrijnë ta futin në rrethim, hidhen si bisha të egra për ta zhdukur. Gjatë gjithë marshimit, në ndeshje të ashpra me armiqtë, në situatat dramatike dhe të rënda, në të cilat ndodhen herë pas here, partizanët shfaqin cilësitë e tyre të mrekullueshme si njerëz të kalitur nga ana ideologjike, njerëz me karakter të fortë, me vullnet të pathyeshëm, me shpirt të rrallë sakrifice dhe me moral të lartë, që e dinë përse luftojnë dhe janë gati të japin jetën për idealin e Partisë. Këto cilësi dalin në pah me forcë të veçantë në disa nga episodet më dramatike të udhëtimit, si në luftën e Skroskës, ku partizanët çanë rrethimin e parë në sajë të gjakftohtësisë dhe të guximit, në luftën në mal të Letmit, ku brigada i shpëton zhdukjes së plotë në sajë të manovrimit të shpejtë dhe të zgjuar të komandës së saj, në luftën prej nëntë orësh me forcat naziballiste në Val të Martaneshit etj.

Në luftë kundër gjermanëve dhe ballistëve partizanët dalin fitues, sepse i frymëzon një qëllim i lartë, ata tregohen të shpejtë, e njohin mirë taktikën e armikut, manovrojnë me shkathtësi, dhe çdo herë marrin vendime që ua përmbysin planet naziballistëve.

Stili është lakonik dhe i thjeshtë. Tek rrëfen për peri-

pecitë e brigadës, autori është i përmbajtur në shprehjen e emocioneve; forca e librit qëndron në vërtetësinë e fakteve, që lënë mbresë të thellë tek lexuesit.

Hov të dukshëm letërsia dokumentare artistike mbi Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare mori në mesin e viteve 50. Në këtë periudhë dalin njeri pas tjetrit një varg librash të shkruar nga pjesëmarrës të ngjarjeve: «Ditari partizan» (1956) i G. Kollumbit, «Pëllëmb e gjak» (1959) i N. Rinos etj.

Tek «Ditari partizan» (1956) i G. Kollumbit pasqyrohen ngjarjet e luftës që kanë ndodhur në qarkun e Korçës nga shtatori 1943 deri në tetor 1944. Aty paraqitet forca shpirtërore e partizanëve, ndjenja e lartë e detyrës, dashuria e madhe që ata kanë për popullin. Në libër ka plot skena, ku me vërtetësi përshkruhen mungesat dhe vështirësitë në mes të të cilave ata jetojnë dhe luftojnë. Duke pasur përballë një armik të madh e të egër, të pajisur shumë mirë, partizanët shpesh shtrëngohen të bëjnë manovrime të gjata dhe të udhëtojnë me ditë e net, të zhveshur, të urtuar, me këmbë të ngrira, por asnjëherë s'e lënë veten t'i kapë dëshpërimi e pesimizmi. Besimi se me Partinë në krye do t'i shkatërrojnë armiqtë, është ndjenja që i karakterizon partizanët në situatat më të rënda. Ata janë vizatuar edhe në kohë pushimi, kur nuk kanë luftime; në këto skena të zakonshme, ku nuk mungojnë shakatë dhe qyfyret, shfaqet dashuria e partizanëve për njëri-tjetrin, shpirti i solidaritetit dhe humanizmi i tyre. Autori përvijon me ngjyra të goditura disa tipa dhe ngjarje të kohës. Interes paraqesin njerëzit e popullit, mikëpritja dhe dashuria me të cilën fshatarët i rrethojnë partizanët, entuziazmi dhe simpatia që ngjall në zemrat e tyre lufta e drejtë dhe qëndrimi zemërapur i komunistëve.

«Ditari Partizan» është shkruar me intonacionet e një bisede të shtruar. Kjo i ka dhënë veprës një frymë lirike. Ngadonjëherë autori s'kufizohet me përshkrimin e fakteve, po shfaq përshtypjet e veta, arsyeton dhe jep gjykime rreth ngjarjeve që rrokullisen në sytë e tij.

Libri «Pëllëmbë e gjak» (1959) i N. Rinos është një tok skicash përmbi luftimet e zhvilluara nga Batalioni I i Brigadës I dhe nga Brigada XXIV, dhënë me një farë rendi kronologjik. Vetë lloji ka lejuar të jepen përshkrime të shtjella,

të pasura me skena dhe episode. Autori ia ka dalë të paraqesë me viza të gjalla këmbënguljen dhe vendosmërinë që i karakterizon bijtë e popullit, besnikërinë e tyre ndaj çështjes dhe shpirtin e paepur që ata shfaqin në përpjekjet me armikun (skicat «Në kodrat e Bal-Bardhit», «Dy luftime fitimtare», «Pëllëmbë e gjak» «Në kodrat e Çerenecit»).

Me shkathtësi letrare është dhënë sidomos historia prekëse e pionierit katërmbëdhjetëvjeçar Isuf Gjergjeveca, i cili luftoi dhe u vra si trimat («Dy luftime fitimtare»). Përshkrime tërheqëse të veprave heroike që tregojnë partizanët në përlëshje të rreptë me gjermanët dhe forcat tradhtarë, hasen edhe në faqe të tjera të librit.

Ndër vepra të tjera dokumentare mbi Luftën Nacionalçlirimtare, po përmendim librin «Nga Kuçi në Vishegrad» (1958) të R. Bedos, përmbledhjen e kujtimeve të pjesëmarrësve të luftës «Në rrugën e heroizmave» (1959) etj.

*
*
*

Fakte reale të përshkruara ashtu siç ishin, qëndrojnë në themel edhe të skicave e të tregimeve të F. Gjatës, të Dh. S. Shuteriqit, të Z. Sakos, etj. Autorët fiksuari ndodhi karakteristike për jetën dhe veprat e partizanëve. Në aktin e guximshëm të të riut partizan, i cili spraps me përbuzje propozimin e fashistëve se do t'i falnin jetën në qoftë se do të shkelte kasketën me yll të kuq, F. Gjata besnikërinë e partizanëve ndaj çështjes së popullit dhe gadishmërinë për të flijuar edhe jetën në emër të saj, e përshkroi si tipar karakteristik të partizanëve («Djaloshi»). Këtë ide ka edhe skica «Çeliku», që flet për vdekjen heroike të një partizani të ri që kishte marrë në trup njëzet e dy plagë. Disa shkrime si «Lufton nëna», përshkohen nga mburrja për patriotizmin dhe guximin e njerëzve të popullit, të cilët revolucionin i bëri të vetëdijshëm për interesat e tyre. Në karakterin e Xha Limit autori vuri në dukje rritjen ideore të njerëzve të thjeshtë në zjarrin e luftës kundër pushtuesve të huaj dhe tradhtarëve. Heroi është përfaqësuesi i fshatarësisë patriote, që kishte luftuar gjithnjë në të kaluarën për Shqipëri, por duke mos fituar gjë, e kishte humbur besimin se vegjëlja do të shpëton-

te ndonjëherë nga zgjedha që i rëndonte mbi qafë. Lufta çlirimtare nën udhëheqjen e Partisë i ktheu atij besimin në çlirimin e popullit. Këto veçori të karakterit të heroit dalin përmes mendimeve dhe kujtimeve të tij, që jepen në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë.

Guximin dhe heroizmin si tipare të kohës së luftës i përshkruan në skicat e tij edhe Z. Sako. Në përgjithësi faktet që autori njofton janë tipike për kohën. Historia që tregohet në skicën «Automatiku i Aliut» jep me ngjyra të gjalla karakterin e partizanëve, të cilët i përballonin me stoicizëm dhe forcë të rrallë shpirtërore humbjet e shokëve. Në skicën «Babai» tregohet një fakt prekës, por shumë karakteristik për frymën e sakrificës në vitet e luftës: një partizan i thjeshtë, në çastin e fundit të jetës nxjerr nga xhepi një napolon të vjetër, të ruajtur me kujdes, e thotë: «Edhe këtë kam, jepe ndihmë për Partinë Komuniste». Në «Medalja e Trimërisë» Z. Sako dha përfaqësuesin tipik të masës së gjerë të pjesëmarrësve të luftës kundër pushtuesve fashistë. Duke folur me humor të lehtë e buzagaz për huqin e heroit, i cili ka qejf të mburret vend e pa vend me trimëritë e tij, autori thekson në karakterin e tij dashurinë e sinqertë për atdheun, si veçori karakteristike të fshatarësisë punonjëse që mbajti mbi shpatullat e saj barrën kryesore të luftës kundër pushtuesve fashistë. Karakterin masiv të luftës, patriotizmin si ndjenjë që përfshiu të gjithë popullin, të mëdhenj dhe të vegjël. Z. Sako e paraqiti në historinë e partizanit të vogël, pionierit nga Suha. Heroi i skicës çlirimin e vendit nga të huajt e shikon si detyrë edhe të të vegjëlve; ai bashkë me të mëdhenjtë përshkoi me guxim rrugën e gjatë të përpjekjeve dhe të privacioneve, nëpër të cilat kaloi batalioni partizan, ku bënte pjesë. Në këto përpjekje ai rritet dhe piqet si luftëtar i ndërgjegjshëm për çështjen e popullit («Taqi nga Suha»).

Në disa skica gjetën pasqyrim marrëdhëniet e reja, që shkishin ekzistuar asnjëherë më parë midis njerëzve. Si duke kaluar nëpër zjarrin e luftës njerëzit flakin tej zakonin e hasmërisë si diçka që binte në kundërshtim me përfytyrimet e reja morale që solli lufta — kjo është historia që rrëfëhet në skicën e shkurtër «Pajtimi me gjak». Kurse në skicën «Balena», Z. Sako tregoi se në vitet e luftës nxori

kryet një humanizëm i ri, i cili u shpreh në kujdesin dhe dashurinë e madhe për njeriun, që karakterizonte partizanët në marrëdhëniet midis tyre.

Në prozën kushtuar pasqyrimin të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare që në fillim u vu re përpjekja për të mos u kufizuar me fiksimin e ngjarjeve reale; disa autorë synuan t'i përpunojnë në pikëpamje artistike vëzhgimet dhe përshtypjet e drejtpërdrejta nga jeta. Kjo bëri që të lërohej edhe tregimi, si lloj i prozës së shkurtër, që jep mundësi për përgjithësime artistike.

Në tregimet «Për cil po bien këto daulle» dhe «Dyshimet e Jonuz Ranxhës», të dyja të botuara në vitin 1946, Dh. S. Shuteriqi tregoi patriotizmin e fshatarësisë gjatë luftës, gadishmërinë e saj për të bërë çdo sakrificë për çlirimin e vendit. Në këto dy tregime autori krijoi dy tipa të fshatarësisë sonë punonjëse, që mishërojnë në vetvete dy rrugë të ndryshme në radhët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Heroi i tregimit «Për cil po bien këto daulle» është një bari dhensh, i cili nis të kuptojë se vetëm lufta e partizanëve do ta shpëtonte atë dhe shokët e tij nga mjerimi në të cilin lëngonin. Disa keqkuptime të rastit i japin një karakter të veçantë vajtjes së tij në çetë, por edhe përmes historisë jo të zakonshme që rrëfëhet në tregim, del qartë dashuria e njerëzve të thjeshtë për vendin dhe gadishmëria e tyre për të luftuar kundër armiqve të jashtëm dhe të brendshëm.

Në tregimin «Dyshimet e Jonuz Ranxhës» Dh. S. Shuteriqi u përpoq të përftojë karakterin e fshatarit të mesëm, i cili mori pjesë në luftë duke kapërcyer mëdyshjet dhe paragjykimet, që e pengonin të shihte qartë perspektivën e luftës. Si tip Jonuz Ranxha ka shumë anë të përbashkëta me Xha Limin e F. Gjatës. Është ky tipi i fshatarit që ka marrë pjesë në përpjekjet e vegjëlisë për çlirimin e atdheut dhe për një jetë më të mirë, por kur pa se frytet e tyre i rrëmbyen klasat e larta, e humbi shpresën se masat e popullit do të arrijnë ndonjë ditë të fitojnë mbi armiqtë e tyre. Por Dh. S. Shuteriqi e drejtoi vëmendjen në mëdyshjet dhe në luhajtjet që provon heroit. Për të zgjidhur këtë detyrë autorit iu desh të përdorë mjetet psikologjike të pasqyrimin, me anën e të cilave synoi të nxjerrë në pah ndeshjen e

mendimeve dhe të synimeve të kundërta në shpirtin e Jonuz Ranxhës. Me anë të monologut të brendshëm, dhe si domos përmes ligjërit të drejtë jo të mirëfilltë, është zbuluar psikologjia e ndërlikuar e tij.

Autori i kupton qartë lëkundjet e heroit, i cili i urren bejlerët dhe agallarët që kanë qenë gjithnjë bashkë me të huajt, dhe dëshiron me gjithë zemër çlirimin e atdheut, por përvoja e hidhur e së kaluarës e ka bërë skeptik dhe skepticizmi i tij shkon ndonjëherë deri në fatalizëm. «Ik prej shiut, dil në breshën», — thotë Jonuz Ranxha sikur do të bëjë konkluzionet e luftërave çlirimtare të popullit në të kaluarën. Por, sipas autorit, nuk është vetëm kjo arsyeja e pshtjellimit shpirtëror të heroit. Në përsjattjet e Jonuz Ranxhës mbi atë që e mundon, zbulohet një anë tjetër e karakterit të heroit. Si njeri i moshuar dhe me paragjykimet e vjetra, ai e ka të vështirë të kuptojë deri në fund dukuritë e reja që solli me vete lufta popullore. «Filloi të përmbysset kjo botë», — thotë me vete tek sheh se në krye të luftës qëndronin njerëz të rinj, të dalë nga gjiri i vegjëlisë, njerëz, të cilët, sipas mentalitetit të tij të vjetër, «s'ia patën mbushur mendjen kujt, prej një dere edhe ma të humbët se vetja». Këtë element të ri të luftës ai nuk e kupton, sepse e pengon paragjykimi, sipas të cilit në ballë të luftës kundër të huajit duhet të ishin si herët, familjet e njohura brez pas brezi si «derë pushke».

Diskutimi që zhvillohet midis Jonuz Ranxhës e partizanëve që i kanë ardhur si miq në shtëpi, shërben për të nxjerrë më në pah kontradiktat e brendshme të heroit, por në të njëjtën kohë aty tregohet se patriotizmi që e ka shquar gjithnjë e ndihmon atë të kapërcejë më në fund mëdyshjet dhe lëkundjet, që kishin penguar djemtë e tij të marrin pjesë me armë në dorë në luftën e përgjithshme popullore kundër pushtuesve nazistë dhe veglave të tyre.

«Nusja» (1947) i F. Gjatës dhe «Kurorat e Masar Beut» (1949) i J. Xoxës tregojnë dështimin e ballistëve gjatë viteve të Luftës. Në këto vepra, të shkruara në një kohë kur ishte arritur fitorja mbi armiqtë e popullit, vihen në lojë orvatjet e ballistëve gjatë luftës për të penguar ngadhënjimin e popullit. Në tregimin e parë, me anë të kontrastit midis sjelljes prej kapadaiu të Tafil Agës në fillim dhe

pamjes qesharake në skenën e fundit, kur vijnë partizanët dhe e zbulojnë pas vellos së nusërisë, autori ka paraqitur kotësinë e orvatjeve të klasave sunduese për të mbajtur nën sundimin e tyre vegjël.

«Kurorat e Masar Beut» i J. Xoxës ka në themel një ngjarje që i gjason anekdotës, por që ndërthen një dukuri tipike për vitet e luftës. Në karakterin e «heroit» shkrimtari është përpjekur të paraqesë tipin e beut që e ka parë Shqipërinë gjithnjë si çiflik të tij. Arroganca, egërsia, etja për pushtet, gjë që kërkonte ta arrinte duke shitur edhe interesat e vendit, — të gjitha këto veçori të karakterit të tij si tip shoqëror dalin përmes rrëfimit të së kaluarës së tij. Skena e fundit nxjerr në pah me qartësi dështimin e plotë të bejlerëve për të sunduar si në të kaluarën edhe në kushtet e reja politike dhe shoqërore, kur populli ishte zgjuar dhe kishte rrokur pushkën për çlirimin e vet.

Aftësia për të pasqyruar atë që ishte karakteristike për vitet e luftës kundër pushtuesve fashistë dhe veglave të tyre, nuk u fitua menjëherë nga prozatorët. Theximi i anëve tragjike të ngjarjeve, fryma sentimentaliste dhe imtësitë natyraliste ishin disa nga të metat e shkrimeve të para në prozë me temë nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Në vitet 50 tregimi eci përpara; duke u mbështetur në përvojën e mbledhur, tregimtarët fituan aftësinë për përgjithësime artistike, për të paraqitur në mënyrë më të plotë karakteret e heronjve. Në tregimin «Rinia e prindërve» (1959) F. Gjata iu kthye sërish temës së heroizmit partizan, duke synuar që të përftojë në mënyrë më të thellë qëndrimin burror të njerëzve dhe motivet që i udhëhiqnin ata në veprimet e tyre. Në tregim është nxjerrë tipi i njeriut të thjeshtë të popullit, që në vitet e luftës u bë i vetëdijshëm për të drejtat e tij dhe u rrit në pikëpamje shpirtërore. Episodi i fundit, kur heroina vendos të hidhet nga shkëmbi për të mos i rënë në dorë armikut zbulon atë shkallë të lartë vetëdije historike, në të cilën i ngriti revolucionin masat. Rrëfimi në vetë të parë i ka dhënë dorë autorit të zbulojë tiparet morale, ndjenjat fisnike dhe sidomos thjeshtësinë që i karakterizonte partizanët. Në «Rrethimi» (1955) F. Gjata tregoi se vështirësitë e jetës partizane vunë në provë karakterin e njerëzve; në zjarrin e luftës u kalit dhe u for-

cua më tej gjithçka e pastër dhe e shëndoshë nga pikëpamja morale, dhe u flak tej çdo element i huaj që kishte hyrë rastësisht në radhët partizane. Perlati, komisari i batalionit, mishëron tipin e partizanit të devotshëm, që mbi të gjitha i vë interesat e popullit; për mbrojtjen e tyre ai është gati të bëjë çdo sakrificë. Ky tipar i karakterit të tij del në dritë, kur qëllon mbi shokun e tij të viteve të rinisë, Luan Dragotin, kur ky trembet që në vështirësitë e para që has në jetën partizane dhe gjatë rrethimit të batalionit orvatet të dorëzohet te armiku, duke tradhtuar shokët e tij. Tregimi, ndërton mbi bazën e antitezës së karaktereve, shquhet nga fryma dramatike që e përshkon. Në vizatimin e figurës së heroit autori fut në punë rrëfimin për jetën e mëparshme të heronjve.

Forca e madhe e ideve të luftës popullore çlirimtare, të cilat bënë për vete edhe njerëz që në fillim ishin të huaj për të, është problemi që Dh. S. Shuteriqi rreh në tregimin «Xha Demi» (1953). Heroi i veprës është njeri me biografi jo të zakonshme, të cilit gjithë jeta i kish shkruar ters. Kjo kishte bërë që t'u rreshtej njerëzve dhe të mbyllej në vetminë e tij. Ndryshimet që ndodhin në vetë jetën, sidomos entuziazmi patriotik që përfshin të gjithë popullin, çajnë koracën e indiferentizmit, pas së cilës ishte strukur heroit dhe ndezin interesimin për fatin e vendit edhe tek ky njeri, të cilin bregat e jetës dhe paragjykimet e kishin bërë mizantrop. Ashtu si për tregimin «Dyshimet e Jonuz Ranxhës» edhe për këtë vepër, është karakteristik psikologjizmi; autori e ka drejtuar vëmendjen e tij në pasqyrimin e përjetimeve që provon heroit i gjendur përballë zhvillimit të ngjarjeve të reja të jetës.

Lufta për çlirimin e vendit ishte një ndeshje e ashpër që u zhvillua jo vetëm midis forcave kundërshtare, por shpesh ndau në dysh familje. Lidhja e fortë me interesat e ngushta të klasës shtyu vëllanë të ngrihet kundër vëllait, babain kundër të birit. Një situatë e tillë, antagonizmi midis babait ballist dhe djalit që mori anën e popullit kryengritës, qëndron në themel të tregimit «Brenga e një partizani» (1960) të D. Shaplllos, në të cilin vëmendja kryesore është drejtuar në paraqitjen e mundimeve shpirtërore të partizanit të ri, kur merr vesh se i ati është arrestuar dhe gjyqi

partizan e dënoi me pushkatim për krimet e kryera. Lidhjet gjinore janë të forta, por mbi dashurinë ndaj njeriut më të afërt qëndron dashuria për popullin, për vendin, për atdheun, e cila përbën kushtin themelor për një jetë me vlerë të plotë të individit. Kjo është ideja e veprës që autori ka ditur ta shprehë duke iu rreshtur zgjidhjes së përciptë dhe deklarative të problemit. Merita e tregimit qëndron në imtësitë e goditura psikologjike me anë të të cilave janë pasqyruar përjetimet dhe ndjenjat që provon heroi në këto caste të rënda të jetës së tij, pështjellimi shpirtëror që ai kalon derisa më në fund e kupton se vendi i tij është në mes të popullit si luftëtar i vendosur për çlirimin e tij jo vetëm nga pushtuesit e huaj, po edhe nga veglat e tij.

Në tregimin «Tre pleqtë dhe Mihali katër» (1958) J. Xoxa përmes një subjekti humoristik tregoi lidhjen e ngushtë të popullit me bijtë e tij që luftonin në mal kundër pushtuesve nazistë dhe veglave të tyre. Në vepër rrëfëhen peripecitë komike që u ndodhën tre qytetarëve dhe një partizani, deri sa arrijnë të takohen me batalionin partizan. Kjo histori pakëz e koklavitur i ka dhënë dorë autorit të vizatojë ndonjë tip me kolorit nga shtresat e popullit.

2

Në skicat dhe tregimet gjetën pasqyrim disa aspekte të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe, në radhë të parë, ngjarjet heroike. Përpara letërsisë së re qëndronte detyra që të paraqiste me tërë madhësinë e saj ndeshjen e ashpër midis pushtuesve të huaj dhe klasave shfrytëzuese nga njëra anë dhe masave popullore nga ana tjetër, shfaqjen e popullit në këto vite si forcë historike vendimtare, rolin e madh të komunistëve në realizimin e kthesës historike që ngjau në jetën e vendit. Pasqyrimi në mënyrë të gjerë i ngjarjeve dhe i konflikteve dramatike të periudhës së luftës nxiti shkrimtarët të lërojnë format e mëdha të prozës, siç ishte romani. Nevoja për të kaluar në llojin e romanit u ndie edhe në opinionin letrar të kohës. «Është folur se priten prej nesh vepra të mëdha, romane... Kjo është e drejtë, se të tilla vepra do të pasqyrojnë më mirë

dramaticitetin e madh të ngjarjeve që kemi jetuar e po jetojmë prej dhjetë vjetësh e këtej: atë të vjetër që po shembet dhe të së resë që po ngrihet»,¹ — thuhej në raportin e mbajtur në Konferencën III të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, që zhvilloi punimet në tetor të vitit 1949.

Përpjekja e parë për të rrokur në mënyrë të gjerë luftën çlirimtare antifashiste ishte romani «Çlirimtarët» i Dh. S. Shuteriqit (pjesa e parë, 1952, pjesa e dytë, 1955). Autori i vuri vetes si detyrë të tregojë veprimtarinë e gjerë të komunistëve në organizimin dhe drejtimin e qëndresës së popullit shqiptar kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve të vendit. Në karakterin e Hajdar Reçanit gjetën shprehje karakteristikat dalluese të komunistëve, të cilëve u ra përsipër barra të nxjerrin masat nga pasiviteti, t'u sqarojnë atyre gjendjen e rëndë në të cilën lëngonte atdheu dhe se ç'duhej bërë për ta shpëtuar atë, të rrënjosnin tek njerëzit besimin në forcën e popullit për të mposhtur armiqtë. I qartë për rrugët që duheshin ndjekur për fitimin e lirisë, agjikator i zoti, që dinte të fliste me përfaqësuesit e shtresave të ndryshme me gjuhën që ata e kuptonin, ai vendos kontakte me punëtorë, çirakë, zejtarë, të rinj dhe të reja, studentë dhe intelektualë, të cilët i ndihmon të kuptojnë qëllimet dhe idetë e luftës kundër pushtuesve fashistë. Hajdar Reçani ia kushton veten tërësisht çështjes së mobilizimit të popullit në luftë kundër zgjedhës së huaj dhe përpiqet që asnjë njeri i ndershëm të mos mbesë jashtë lëvizjes, jashtë ndikimit të ideve të saj. Kundër kujtdo që orvatet të pengojë emancipimin politik të masave të popullit, ai mban qëndrim të prerë, sepse në të shihet përpjekjet e armiqve të popullit për të sabotuar luftën për fitimin e lirisë. Sidomos i pamëshirshëm është ai kundrejt manevrave të agjentëve të klasave sunduese, siç ishte Leks Lala, krerët e çetave balliste, etj.

Devotshmëria ndaj çështjes së popullit, puna e palodhur për zgjimin dhe organizimin e masave në luftë kundër armiqve, guximi, fryma e papajtueshme ndaj armiqve shquan

¹) Konferenca III e Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë (9-12 tetor 1949), Tiranë 1950, f. 25.

edhe Col Trepanishtin, që përfaqëson të rinjtë që në zjarrin e luftës u formuan si drejtues dhe organizatorë të zotë. Krahas kësaj në këtë personazh autori ka synuar të theksojë rëndësinë e madhe të revolucionit popullor në jetën e rinisë shqiptare, e cila në programin e Partisë Komuniste gjeti rrugën e realizimit të idealit të një Shqipërie të lulëzuar dhe të lirë. Me gjithë përpjekjet e autorit, figurat e këtyre personazheve dolën të zbehta; episodet e romanit synojnë më tepër të ilustronjë idenë e rolit drejtues të komunistëve sesa të zbulonjë anë të caktuara të karaktereve të personazheve.

Më mirë autori ia doli të tregojë zgjimin e masave, rritjen e tyre politike dhe ideologjike në ndikimin e revolucionit popullor. Tek Dokë Trepanishti është shprehur ideja e aspiratës së thellë të vegjëlisë për drejtësi shoqërore. Doka kishte hequr të zotë e ulla nga bejlerët dhe rreshperet, të cilët me rryshfete dhe dëshmitarë të rremë i grabitën tokën dhe e hodhën në mes të katër rrugëve. Duke u qëndruar zullumeve të fuqishme, ai nuk e humbi kurrë shpresën se do të vinte dita e përmbysjes së shfrytëzuesve të egër dhe të pazaptë. Ishte kjo urrejtje e thellë ndaj klasave shfrytëzuese arsyjeja që Doka iu përgjegj menjëherë thirrjes së komunistëve për t'u ngritur në luftë kundër pushtuesit të huaj dhe klasave shfrytëzuese. Në ndikimin e ngjarjeve të jetës, pakënaqësia e hershme dhe e fshehur thellë në vetëdijen e heroit kthehet në një qëndrim të vetëdijshëm kundër të gjithë atyre që mbanin popullin nën zgjedhë e në mjerim. Luftën që nisi kundër fashizmit ai e shikon sikurse gjithë populli jo vetëm si rrugën për të zhdukur zgjedhën e huaj, por edhe si luftë për të përmbysur klasat shfrytëzuese. Momë Hatija përfaqëson tipin e gruas së thjeshtë, që lëvizja e zgjoi dhe i mbushi jetën me një brendi të re. Duke përdorur imtësitë karakteristike të ambientit, autori tregoi ndjenjat dhe mendimet e reja që shfaqen në ndërgjegjen e saj në ndikimin e luftës së përgjithshme kundër pushtuesve fashistë.

Romani «Çlirimtarët» ishte menduar si një panoramë e gjerë e shoqërisë shqiptare në vitet e pushtimit fashist, me një galeri personazhesh që përfaqësonin klasat dhe grupet e ndryshme shoqërore. Por mungesa e përvojës në lëmin e

romanit shumëplanësh, kompozicioni i paarritur, racionalizmi, e penguan autorin të përmbushë shtetimin e vet. Nga përfaqësuesit e kampit armik më i realizuar doli Leks Lala. Herë me anë të digresionit dhe herë me anë të imtësive satirike, autori diti të pasqyrojë me ngjyra të gjalla fizionominë e vërtetë politike të nacionalistit borgjez, i cili kishte luftuar në të kaluarën lëvizjet çlirimtare të vegjëlisë. Autori tregoi se në kushtet e reja, kur çështja e luftës kundër pushtuesit të huaj u shtrua qartazi dhe klasave kryesore shoqërore u duhesh të përcaktonin qëndrimin e tyre, armiqve iu bë gjithnjë e më e vështirë ta mashtronin vegjëlinë. Me forcimin e luftës antifashiste popullore dhe shtimin e bashkëpunimit të klasave të larta me pushtuesit, del në dritën e saj të vërtetë thelbi i karakterit të veprimtarisë së Leks Lalës, si armik i tërbuar i masave popullore dhe mbrojtës i interesave të klasave sunduese.

Në romanin «Përmbysja» (1954) vëmendjen e F. Gjatës e tërhoqi problemi i formimit të vetëdijes revolucionare në fshatarësinë e varfër, i rolit të saj në luftë për çlirimin e vendit. Dihet se fshati përbënte bazën kryesore të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare; ai jo vetëm i strehoi partizanët, i mbajti ata me bukë, por dha forcën e gjallë që mbushi radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Mijëra e mijëra fshatarë rrokën armët dhe shkuan në çetat partizane; nga gjiri i tyre në zjarrin e luftës dolën komandantë dhe drejtues të zotë ushtarakë.

Ecuria kryesore e ngjarjeve të subjektit lidhet me fatin e heroit kryesor, Luftar Bregut, në karakterin e të cilit autori mishëroi veçoritë thelbësore të elementëve më të përparuar të fshatarësisë së varfër. Karakteri i Luftarit zbulohet në lidhje të ngushtë me ngjarjet e jetës së fshatit si dhe me ato që përshkonin jetën e gjithë vendit aso kohe: pushtimin fashist, qëndresën e popullit kundër skllavërisë së huaj, shpërthimin e lëvizjes së organizuar të masave nën udhëheqjen e komunistëve. Në fillim Luftari, ashtu sikurse bashkëfshatarët e tij të varfër, ishte i paditur, megjithëse e ndiente thellë peshën e rëndë të mjerimit ai nuk e njihte rrugën e shpëtimit. Varfëria e madhe që nuk iu nda asnjëherë familjes së tij, orvatjet e dëshpëruara për të shpëtuar nga taksidari edhe atë pak gjë që kishin, shtypja e

egër shoqërore e shtynin atë të binte shpesh në pesimizëm. Por prirja kryesore e karakterit të tij ishte mospajtimi me shtypjen shoqërore dhe urrejtja e thellë ndaj shfrytëzuesve, e cila gjen shkrim në protestën spontane individuale. «Po unë s'jam kafshë që të vdes për ty», — i kundërshton agait të fshatit, Sulltan Rodhes, kur ky kërkon që të punojë pa shpërblim arat e tij. Kjo pakënaqësi ndaj marrëdhënieve shoqërore ekzistuese fiton qartësi dhe bëhet e vetëdijshme me zhvillimin e ngjarjeve. Pushtimi fashist i vendit, shpërthimi i lëvizjes çlirimtare popullore dhe fillimi i luftës partizane e shpejtojnë procesin e zgjimit të Luftarit dhe të formimit të tij si revolucionar. Pasi kupton të vërtetën lidhur me shkaqet e vuajtjeve të vegjëlisë, ai çlirohet nga pesimizmi dhe nga fryma e protestës anarkike individuale, hidhet me të gjitha forcat në lëvizjen popullore çlirimtare, vihet në krye të bashkëfshatarëve, të cilët i udhëheq në luftë kundër fashizmit dhe veglave të tij. Në faqet ku përshkruhet jeta e tij në radhët partizane, Luftari del si njeri i guximshëm, i vendosur, i shkathët, i pajisur me disiplinë të vetëdijshme. Sprovat dhe vështirësitë e ndryshme të jetës partizane e kalitin atë më tej; në përpjekjet dhe ndeshjet me armiqtë zbulohen edhe cilësitë e tij si drejtues i aftë ushtarak. Përvoja e paktë artistike nuk i dha dorë autorit të tregojë rritjen e brendshme të heroit. Episodet e jetës partizane që kanë për qëllim të tregojnë zhvillimin e Luftarit nuk zbulojnë si duhet tiparet e reja me të cilat pasurohet fizionomia e tij morale dhe shpirtërore nën ndikimin e ngjarjeve të jetës.

Ideja e rritjes dhe e zgjimit politik dhe shoqëror të fshatarësisë së varfër është treguar edhe në një varg personazhesh të tjerë, si Gurka, shoku i ngushtë i Luftarit, Xha Teli, Xhemal Lëkunda etj. Secili prej tyre ka rrugën e tij në lëvizjen e përgjithshme popullore. Gurka, i rritur pa prindër, në mes mungesash dhe vështirësish të shumta, merr pjesë menjëherë në luftë se në të sheh shpëtimin nga zgjedha e të huajit. Edhe xha Teli, kryetari i Këshillit Nacional-çlirimtar të fshatit, i cili vritet si burrat pa e ulur kokën përpara armiqve, përfaqëson tipin e fshatarit që e përkrahu pa rezervë luftën. Kurse Xhemal Lëkundës iu desh të mposhtë një varg mëdyshjesh derisa arriti të bindet se lufta

me armë është e vetmja rrugë e shpëtimit të fshatarësisë nga shtypja dhe shfrytëzimi që rëndonte mbi kurrizin e saj.

Zgjimin dhe aktivizimin e masave popullore në luftë autori e shikon si rezultat të punës së madhe dhe gjithë durim që zhvillojnë komunistët. Në roman është nxjerrë tipi i punëtorit komunist, i cili zhvillon një veprimtari të palodhur për të sqaruar njerëzit lidhur me shtypjen e masave popullore dhe për të kallur në ndërgjegjen e tyre idenë e luftës kundër armiqve. Stil Mërtiri luajti një rol të rëndësishëm në zgjimin e Luftarit dhe tërheqjen e tij në radhët e lëvizjes, por, duke e lënë një personazh episodik, autori i hoqi vetes mundësinë të karakterizonte në mënyrë të plotë tipin e udhëheqësit të masave. Qëllimi i shkrimtarit për ta zgjidhur këtë detyrë me anë të Mina Savës, komisarit të batalionit, nuk është realizuar plotësisht, sepse ai qëndron në periferi të subjektit. Episodet në të cilat del ky personazh, pak ndihmojnë për zbulimin e idesë së romanit.

Duke treguar zgjimin dhe hedhjen në luftë të masave popullore, autori thekson se ky ishte një proces i vështirë, që u realizua në luftë me orvatjet e klasave shfrytëzuese për të ruajtur sundimin e tyre mbi masat popullore. Në figurën e Sulltan Rodhes, F. Gjata dha karakterin e agait të fshatit, që gjithë jetën u kishte thithur gjakun si shushunjë fshatarëve. Për të shtuar mallin dhe gjënë e vet, ai përdorte çdo mjet, jo vetëm mashtrimin, por edhe vrasjen, mjaft që kjo të forconte pushtetin e tij në jetën e fshatit. Sulltan Rodhja i shikonte fshatarët si kafshë, ushqente për ta një urrejtje të madhe dhe i shfrytëzonte pa mëshirë. «Njeriun mendoje, kafshën jo, se s'ka gojë të flasë», — deklaroi ai me cinizëm. Në veprimtarinë e tij shfrytëzuese ai ka përkrahjen e plotë të pushtetit reaksionar me ndihmën e të cilit arrin të shtjerë në dorë tokat më të mira të fshatit. Veçoritë thelbësore të karakterit shoqëror të Sulltan Rodhes zbulohen gjatë zhvillimit të veprimit. Zgjimi dhe aktiviteti që zhvillojnë fshatarët si pjesëmarrës të luftës kundër pushtuesve fashistë, e tërbojnë Sulltan Rodhen; për të ruajtur sundimin e tij ai bashkohet me fashistët italianë dhe më pas bëhet komandant i një çete balliste, që vepron aktivisht kundër partizanëve. Në vizatimin e figurës së tij autori për-

dori imtësitë satirike, të cilat ndihmojnë për të nxjerrë në shesh antipatriotizmin, egërsinë dhe zvetënimin politik dhe moral të Sulltan Rodhes.

Në romanin «Përmbysja» krahas kapitujve të shkruara në një nivel të mirë artistik, ka edhe shumë faqe të zbehta, në të cilat ngjarjet janë dhënë në mënyrë të sipërfaqshme. Kjo e metë bie në sy sidomos në gjysmën e dytë të romanit, ku veprimi ecën me ritëm të përshpejtuar dhe episodet nuk ndihmojnë për zhvillimin e mëtejshëm të karaktereve të personazheve. Edhe nga pikëpamja gjuhësore kjo pjesë qëndron nën nivelin e pjesës së parë.

NJË VJESHTË ME STUHI

Në themel të romanit «Një vjeshtë me stuhi» (1959) është vënë antiteza politike dhe morale midis pjesëmarrësve të lëvizjes, bijve të popullit të thjeshtë që i janë kushtuar tërësisht çështjes së lartë e fisnike të çlirimit të atdheut nga zgjedha e huaj, nga njëra anë, dhe armiqve të popullit dhe gjithë atyre që përfaqësojnë botën e vjetër të shfrytëzimit dhe të errësirës, nga ana tjetër. Këtë antitezë A. Abdihoxxha e ka ndriçuar nga një kënd i caktuar shikimi. Në karakteret e përfaqësuesve të grupit të vogël ilegal, autori ka vënë në dukje si veçori thelbësore: pastërtinë e ndjenjave dhe të synimeve në jetë, vendosmërinë për çështjen e popullit, stoicizmin përballë vështirësive dhe frymën optimiste. Në këtë ai sheh epërsinë e tyre morale ndaj përfaqësuesve të kampit armik; tek pjesëtarët e grupit të vogël që vepron ilegalisht në qytet u dha shëmbëlltura e njeriut të ri që nisi të shfaqet në vitet e luftës kundër pushtuesve fashistë dhe armiqve të brendshëm. Petriti mishëron tipin e djalit të popullit, që ka kaluar një fëmëni me halle. Njeri pa shumë fjalë, energjik, i palodhur, ai është kudo ku e lyp nevoja, në mal tek partizanët, ose në qytet për të organizuar punën e teknikës. Episodet e subjektit nxjerrin në shesh ndjenjat fisnike të heroit, forcën e karakterit, besnikërinë e patundur ndaj idealit, të cilit i ka kushtuar jetën. Në skenën «Nein» shfaqet devotshmëria e tij pa kufi ndaj çështjes së popullit. Skena e dyluftimit me fjalë me majorin gjerman, dhënë kjo me viza psikologjike, tregon vetëdijen e lartë, besnikë-

rinë dhe vendosmërinë e patundur, besimin e tij të plotë në fitoren mbi armiqtë. Fryma romantike që karakterizon Petritin në veprimtarinë që zhvillon spikat edhe në hovin shpirtëror që i ngjall ndjenja në dashurinë e pastër dhe fisnike, që ushqen për Lumton. Marrëdhëniet e pastra midis dy të rinjve zbulohen në një varg skenash lirike, nga të cilat shquhet kapitulli «Nën qiellin me re».

Bashkëluftëtare e ngushtë e Petritit dhe një nga pjesëtarët më të vendosura të grupit është Lumtoja, në karakterin e së cilës u mishëruan tiparet më të mira të rinisë shkollore, që, e frymëzuar nga ndjenja patriotike, u hodh pa rezervë në radhët e lëvizjes. Dëshirën për t'i shërbyer atdheut asaj ia kalli në shpirt i ati, një arsimitar, i ndershëm dhe patriot, i ushqyer me traditat e rilindasve. Edhe Lumton e karakterizojnë synimet e larta dhe fisnike në jetë. Detyrat që i ngarkohen ajo i kryen me pasion dhe konsekuencë revolucionare të veçantë. Qartësia e qëllimit si dhe vetëdija e thellë politike si tipare dalluese të karakterit të saj shfaqen në mënyrë të plotë në kohën kur është e burgosur dhe sidomos në çastet e fundit përpara se ta ekzekutojnë. E bindur në drejtësinë e çështjes që kishte përqaftuar, pa fije luhateje në shpirt, ajo nuk hiqet nga rruga e zgjedhur, megjithëse e di fatin e vet. Ditët e pakta të jetës që i kanë mbetur i kalon me ndërgegje të qetë dhe me mendje të kthjellët. Megjithëse sheh se nuk ka shpëtim, Lumtoja nuk pushon së mbrojturi nga shpifjet e ulëta të armiqve çështjen e çlirimit të vendit për të cilin jep jetën. Në këtë pjesë të romanit mbizotërojnë ngjyrat romantike heroike. Me vërtetësi, duke përdorur imtësitë psikologjike autori ka përshkruar çastet e fundit të vajzës, shqetësimin e saj të brendshëm dhe të natyrshëm se po vdes në moshën më të bukur të jetës. Lumtoja është dhe mishërimi i pastërtisë morale të jetës. Lumtoja është dhe mishërimi i pastërtisë morale. Në burg ajo u bën ballë me guxim dhe u jep përgjigjen e duhur orvatjeve të poshtra të Nazmi Beut dhe e rrëfen veten me dinjitet të vërtetë njerëzor. Dashurisë për Petritin i qëndron besnike deri në vdekje dhe nuk lë asnjëri ta përlyejë këtë ndjenjë, që e mban të pastër në shpirtin e vet. Cilësi të larta morale, synime të bukura në jetë, parime të shëndosha morale autori vë re jo vetëm tek përfaqësuesit më aktivë të lëvizjes, por edhe tek njerëzit e thjeshtë

të popullit. Ndonëse episodikë, disa nga përfaqësuesit e ve-gjëlisë, si usta Dineja, nanë Dana, daj Murati me veprimet dhe qëndrimin e tyre në çastet më dramatike të jetës, - shumica e tyre vriten duke plotësuar detyrën ndaj vendit - bëjnë që të kumbojë edhe më me forcë ideja themelore e romanit - bukuria e lartë shpirtërore e pjesëmarrësve të lëvizjes çlirimtare, epërsia e tyre morale ndaj armiqve.

Si veçori dalluese të armiqve e tradhtarëve autori ka theksuar mizorinë, egoizmin, motivet çnjerëzore dhe antiko-mbëtare që i frymëzojnë ata. Për të vënë në pah këtë ide shërben sidomos Nazmi Beu, komandanti i rinisë balliste, të cilin autori e sajoi për të stigmatizuar të gjitha forcat antipopullore, që bashkëpunuan me armiqtë. Si karakter i caktuar shoqëror Nazmi Beu zbulohet përmes marrëdhënieve të tij me Lumton. Pasi e ka arrestuar vajzën, ai përpiqet ta bindë që të martohet me të dhe të braktisë shokët, por kur sheh që nuk nxjerr gjë, orvatet ta mposhtë duke e shnderuar. Rëndësia e këtij episodi qëndron jo vetëm në faktin se zbulon në mënyrë më të plotë karakterin e Nazmi Beut; i marrë në lidhje të ngushtë me ngjarjet politike kryesore të kohës, ky episod fiton në roman një kuptim më të gjerë sesa demaskimi i degjenerimit të tij moral. Duke rrëfyer për dëshirat dhe mendimet me të cilat jeton Nazmi Beu, autori ka treguar se sa vlenin nga pikëpamja morale dhe shpirtërore njerëzit e «Ballit Kombëtar» që kishin pretendimin se historia i kishte thirrur të mbronin interesat e atdheut. Duke treguar frikën dhe pasigurinë që ndien Nazmi Beu, kur sheh që ngjarjet rrokullisen në kundërshtim me dëshirat e ballistëve, frikë që shfaqet në nervozizmin dhe gjumin e shqetësuar e me ëndrra të llahtarshme që bën, A. Abdihoxha e thekson kuptimin e vet për ballistët si forcë pa vlerë morale dhe politike, e dënuar nga historia të zduket bashkë me klasën shfrytëzuese që e polli.

Edhe përfaqësuesit e tjerë të kampit armik ndihmojnë që të dalë në pah ideja se çdo gjë e shëndoshë, pozitive asokohe ishte në anën e popullit, kurse në stanin e reaksionit ishin grumbulluar njerëz të ulët, pa vlerë morale dhe shpirtërore. Në karakterin e Demir Tyxharit autori ka vënë në dukje indiferentizmin e plotë të shtresave të pasura për ha-llet e vendit. Gjithë jetën e vet ky njeri kishte menduar të

grumbullonte sa më tepër pasuri. Florinjve që trashëgoi nga i ati u shtoi ato që grumbulloi duke punuar si avokat dhe duke bërë jetën e një kopraci të neveritshëm. Për hir të kësaj pasurie, gjatë ndeshjes së popullit me pushtuesit fashistë ai u mblodh në interesat e veta si kërmilli në guaskë, u orvat ta kalonte kohën e luftës në qetësi e të dilte në fund i padëmtuar dhe, si rrjedhim, më i përfituari nga të gjithë. Djalit të vet, Qamilit, që është hedhur në lëvizje, i lutet, e këshillon dhe më në fund i kanoset që të largohet nga lëvizja, se po i lë «pasurinë pa trashëgimtar». Duke e bërë Demir Tyxharin agjent vullnetar të pushtesve nazistë, autori e nënvizoi akoma më tepër antipatriotizmin e intelektualëve me prejardhjen nga shtresat e larta, të cilat në çastet e rëndësishme që po kalonte vendi shikuan inte-resat e tyre të ngushta vetjake.

Duke futur në roman major Francin, shefi i Gestapos të qytetit, autori plotëson me ngjyra të tjera vizatimin e fizio-nomisë morale dhe politike të kampit armik. Në figurën e majorit nazist theksohet egërsia, urrejtja për popullin shqiptar, mizoria, cinizmi dhe dinakëria. A. Abdihoxha iu rresht paraqitjes së thjeshtësuar, pllakateske të oficerit na-zist; pasqyrimi i sjelljes së jashtme të kulturuar të major Francit, pas së cilës fshihet një bishë e vërtetë, i ka ndih-muar shkrimtarit ta japë me ngjyra të goditura individua-le karakterin e oficerit nazist. Episodet e romanit ndihmojnë për të zbuluar metodat dinake që përdor ai për të mposhtur kundërshtarët e për t'i detyruar të dobëtit e frikacakët t'i shërbejnë qenërisht. Fytyra e këtij xhelati me kulturë ka dalë në shesh me qartësi të veçantë në bisedën që zhvillon me Petritin në burg. Major Franci nuk është një vrasës i thjeshtë e brutal, por një xhelat që dhunën dhe terrorin e egër që përdorin nazistët gjermanë përpiqet t'i justifikojë me arsyttime të karakterit historik dhe filozofik. Thelbi i tij prej obskurantisti dhe reaksionari të tërbuar shprehet në konceptin që ka për luftën si faktor që çon përpara shoqërinë njerëzore.

Për karakterizimin e personazheve, krahas veprimeve dhe marrëdhënieve që krijohen midis heronjve, autori ka futur në punë edhe imtësitë e jashtme, të cilat kanë shpre-himësi të veçantë. Për të theksuar egërsinë e oficerit të Ges-

tapos, vihen në dukje sytë e tij, që «as i ndizeshin as i dukeshin», kurse tek Nazmi Beu qeshja e tij historike. Kur punët i venin mirë, Demir Tyxhari «fërkonte me duart e tij të buta barkun». Në karakterizimin e personazheve nga radhët e armiqve përdoret edhe intonacioni i rrëfimit në të cilin futen theksa ironikë. Në figurën e Petritit dhe të Lumtos theksohen emocionet e ndritura, të cilat shpeshherë zbulohen përmes përjasjes me natyrën, që vizatohet shpesh me ngjyra të qarta dhe optimiste.

Gjuha është e saktë dhe e punuar; autori përpiket t'i përshkruajë në mënyrë të përpiktë dhe të gjallë sendet dhe pamjen e njerëzve.

3

Proza e re iu vu pasqyrimin të jetës së re që në ditët e para pas Çlirimit. Në fillim tematika e ndërtimit socialist zuri vend në llojet e shkurtra (skica, tregimi dhe novela); më pas u shfaqën edhe romanet kushtuar pasqyrimin të luftës dhe përpjekjeve të masave punonjëse për ngritjen e shoqërisë socialiste.

Ndër veprat e para që flisnin për shqetësimet dhe aspiratat e reja të njerëzve, duhet të përmenden tregimet «Ky çuni i madh i Salë Cenit» (1946) i Dh. S. Shuteriqit dhe «Përsheshi i Paput» (1949) i J. Xoxës. Gëzimin që ngjalli tek masat e popullit vendosja e pushtetit popullor, nga i cili prisnin realizimin e ëndrrave të tyre, Dh. S. Shuteriqi e tregoi përmes ndjenjave që provon një djalë i mitur fshatar kur merr vesh se së shpejti do të zbatohet reforma agrare. Ana më e fortë e tregimit është paraqitja e gjendjes shpirtërore të heroit, spontaneiteti dhe qashtërsia e përjetimeve të tij, të cilat shfaqen përmes dialogut të natyrshëm dhe karakteristik. Në qoftë se Dh. S. Shuteriqi prirej drejt imtësive lirike që zbulojnë psikologjinë e heroit, në tregimin e Xoxës mbisundon toni i lehtë humoristik. Për brengat e një kategorie fshatarësh të moshuar që ende ndodhen nën pushtetin e mentalitetit të vjetër dhe për këtë shkak mbetën prapa në jetë, autori rrëfen me një humor dashamirës. Subjekti i tregimit ka karakter anekdo-

dik; ngjarja që rrëfëhet në të është jo e rëndomtë, por kjo nuk i heq asaj kuptimin e përgjithshëm që ka. Përmes episodit komik shkrimtari ka arritur të tregojë me vërtetësi mundimet që heq heroi derisa arrin të kuptojë rrugën e drejtë në të cilën hyri vendi pas Çlirimit. Në shkrimet e para, kuptohet, u fiksuan fakte karakteristike të jetës. Në vitet 50 nisën përpjekje për të kaluar nga faktet dhe episodet e veçanta në paraqitjen e dukurive më thelbësore të jetës. Shkrimtarët e drejtuan vëmendjen në pasqyrimin e jetës së fshatit, të proceseve dhe të konflikteve që zhvilloheshin në të. Nga tregimet dhe novelat kushtuar punës ndërtimore në fshat duhet përmendur: «Uji fle, hasmi s'fle» e F. Gjatës dhe «Bereqeti» e Z. Sakos, të botuara në vitin 1951. Që të dyja këto vepra nuk shquheshin për thellësi në pasqyrimin artistik të jetës dhe të karaktereve të njerëzve. Megjithatë duhet thënë se autorët mundën të paraqesin atmosferën e tendosur të fshatit shqiptar pas zbatimit të reformës agrare, ashpërsinë e luftës së klasave në këtë periudhë, të tregojnë filizat e ndërëgjegjes së re shoqërore në fshatin shqiptar. Në personin e Nure Zybës F. Gjata dha tipin e kulakut, që ushqen një urrejtje të thellë për pushtetin e ri dhe bën çmos për të penguar fshatarët që t'i përgjigjen thirrjes së pushtetit për të zhvilluar bujqësinë dhe shtuar prodhimin. Fizionominë e vërtetë të armikut të klasës autori e ka nxjerrë në dukje duke shfrytëzuar sidomos episodet e subjektit, të cilat janë në funksion të plotë të idesë. I tillë është episodi ku Nure Zyba nxit arrixhinjtë për të prishur bereqetin në arën e tij me qëllim që të mos i dorëzonin asnjë kokërr grurë shtetit. Autori ka ditur të paraqesë karakterin e ndërlikuar që merr lufta e klasave, intrigat dhe manovrat e djallëzuara të armikut për të diskredituar njerëzit e pararojës në fshat ose për të shfrytëzuar për qëllimet e tij armiqësore elementin që ka hyrë kontrabandë në radhët e organizatës së partisë. Por në qoftë se tipin e kulakut autori e vizatoi me ngjyra pak a shumë të gjalla, luftëtarët e së resë, komunistët dhe përfaqësuesit e fshatarësisë së varfër, dolën të zbehtë, vizatimit të karaktereve të tyre nuk iu kushtua vëmendja e duhur.

Edhe në novelën «Bereqeti» faqet më me vlerë janë ato

ku përshkruhen veprimet e kulakut, i cili, duke përdorur manovra të djallëzuara, arrin të ngrejë elementët e prapambetur nga pikëpamja politike nga gjiri i fshatarëve të varfër kundër urdhëresave të shtetit për grumbullimin. Demaskimit të armikut autori ia ka arritur përmes heroit kryesor të novelës, Basho Gorit, tip mjaft me kolorit, që përfaqëson njeriun e thjeshtë, plot paragjykime shoqërore të cilat e pengojnë të marrë pjesë aktive në jetën e re. E keqja më e madhe është se përfytyrimet e tij patriarkale i shfrytëzon me dinakëri kulaku, i cili e përdor Bashon për të përhapur parrullat e tij çmobilizuese ndër fshatarë.

Ngjarjet e pasqyruara në novelën «Llaz Qesarati» (1959) të Sh. Musarajt i përkasin një faze tjetër të jetës së fshatit shqiptar. Është koha kur fshatarësia shqiptare nga ekonomitë individuale kaloi në organizimin socialist të bujqësisë. Autori i vuri vetes si detyrë që të tregojë karakterin e ndërlikuar të këtij procesi, i cili shoqërohej me një luftë të vështirë të njerëzve me vetveten, me konceptet dhe shprehjet e jetës së vjetër që i tërheqin ata prapa. Për të treguar procesin e vështirë të riedukimit Sh. Musaraj e mori heroin e vet nga ajo pjesë e përparuar e fshatarësisë, e cila për rrethanat e jetës së vet kishte një farë përvoja politike. Tek Llaz Qesarati kemi tipin e fshatarit të varfër, i cili kishte marrë pjesë aktive në luftën e djeshme kundër pushtuesve fashistë dhe veglave të tyre; në ato vite shtëpia e tij u bë bazë e sigurt e partizanëve, vetë ai nuk kurseu asgjë për të përmbushur detyrat që i ngarkonin në fshat. Pas Çlirimit mori tokë nga Reforma Agrare dhe iu përvesh punës me mish e me shpirt, sa brenda një kohe të shkurtër arriti të mëkëmbet mirë nga pikëpamja ekonomike dhe të numërohet në fshat ndër ata në gjendje më të mirë. Kjo bëri që ai të mos i përgjigjet me gatishmëri thirrjes për të ngritur kooperativën dhe me qëndrimin e tij të ndikojë negativisht edhe në një pjesë të fshatarëve, të cilët nuk pranojnë të bashkojnë tokën, mjetet dhe krahet e punës në një ekonomi të përbashkët. Ringjallja e ndjenjës së pronës në vetëdijen e heroit shpjegon jo vetëm qëndrimin e tij ndaj idesë së kolektivizimit të bujqësisë, por edhe shfaqjen e disa tipareve jo të shëndosha në karakterin e tij. Me intuitën e tij artistike shkrimtari mundi të

hetojë dhe të vërë në dukje një dukuri negative që vihej re tek disa përfaqësues të fshatarësisë punonjëse aso kohe: zbehjen e vetëdijes klasore. Pasi e rregulloi mirë gjendjen ekonomike, Llaz Qesarati nisi të priret drejt rrehatllëkut, në karakterin e tij nxjerr krye butësia ndaj armikut, gjë që u shpreh në krushqinë që zë me kulakun e fshatit fqinj Toli Rërezën, armik i njohur i pushtetit popullor. Vëmendjen kryesore autori e përqendroi në pasqyrimin e luftës së brendshme shpirtërore të Llaz Qesaratit, sidomos, të procesit psikologjik të zgjimit të tij, kur sheh se si i tërhequr nga interesi i ngushtë i pronarit të vogël, u gjend pa dashur në anën e armiqve të rendit të ri. Musaraj ia ka dalë të tregojë me ngjyra të gjalla se si në ndikimin e ngjarjeve të jetës, në ndërgjegjen e heroit dalin sërish në dritë veçoritë e fshatarit të lidhur ngushtë me jetën e re, që ishin mbuluar nga pluhuri i rehatisë vetjake.

Duke futur në vepër si personazh episodik Toli Rërezën, autori jo vetëm motivoi nga një anë tjetër ngurrimet që shfaq Llazi për të hyrë në kooperativë, por e zgjeroi tablonë e jetës së fshatit në prag të kolektivizimit. Rreth çështjes të ngrihet apo jo kooperativa, ndesheshin interesat e forcave kundërshtarë: të fshatarësisë punonjëse të udhëhequr nga Partia, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, të kulakëve, të cilët bënë një luftë të ashpër kundër zhvillimit të fshatit në rrugën e kolektivizimit. Toli Rëreza është armiku dinak, i pabesë dhe i zgjuar. Ai vepron me kujdes, duke i fshehur qëllimet e tij, më tepër shtyn të tjerët të dalin kundër ngritjes së kooperativës, siç bën me Gori Pishën, që i përdor si vegla të tij, sesa flet dhe vepron vetë. Duke ditur se sa të forta i ka rrënjët tek Llazi Qesarati psikologjia e pronës së vogël, ai arrin për një farë kohe ta tërheqë atë pas vetes.

Në lidhje të ngushtë me heroin është dhënë i deleguari nga Tirana për ngritjen e kooperativës, Xhoxhi Driza, i cili lot rol të rëndësishëm në zhvillimin e veprimit dhe në zgjimin e Llaz Qesaratit. Duke ditur mirë logjikën e luftës së klasave, ai u hap sytë bujqve për punë të kooperativës dhe demaskon veprimet e djallëzuara të armiqve. Mprehtësia politike, njohja e thellë e psikologjisë së fshatarit të varfër, urtësia në zgjidhjen e çështjeve të ngatërruara të

fshatit — këto tipare prej udhëheqësi të zot dalin në pah veçanërisht në skenën e mbledhjes së gjithë fshatit, shkruar me dorë të sigurt dhe të saktë. Me këtë personazh Sh. Musaraj kontribuoi në pasqyrimin e udhëheqësit komunist të periudhës së ndërtimit të socializmit.

Vepra ka një subjekt shumë të thjeshtë; në të vërtetë ai përbëhet nga dy ngjarje: vizita që i bëjnë heroit në shtëpi sekretari i organizatës-bazë të partisë me të deleguarin, dhe mbledhja e fshatit për punën e ngritjes së kooperativës. Por autori ka ditur të vizatojë në mënyrë të goditur personazhet kryesore të veprës duke përdorur dialogun, të ngjeshur me mendime e ndjenja, si dhe imtësitë karakteristike. Vend të rëndësishëm zënë edhe kujtimet e së kaluarës si dhe tregimi i autorit për ngjarjet që kanë ndodhur më parë, gjë që ndihmon të zbulohen në mënyrë më të plotë personazhet kryesore.

«Isha unë, Çobo Rrapushi» (1960) është novelë humoristike. Sh. Musaraj qesëndis në këtë vepër përmes një humori të lehtë e të lezetshëm frymën e rehatllëkut, që kishte prukur në vitet e para pas Çlirimit një kategori të vogël njerëzish, të cilët kishin luftuar me armë në dorë për të dëbuar pushtuesit fashistë. Çobo Rrapushi përfaqëson ata luftëtarë, të cilët kujtuan se për meritat e tyre pas Çlirimit të vendit i priste një jetë e shkujdesur dhe plot qejfe. «Që t'i bie shkurtër, — thotë për vete heroit — mua më ish mbushur mendja në kohën e luftës se kur do të vinte liria, do ja shtronim «ku leh qen e ku del tym» dhe sa për punë, as që do e vinin ujët në zjarr». Këto dëshira që s'kishin asgjë të përbashkët me frymën e mobilizimit për punë që kërkonte vendi, autori i vë në lojë me takt. Komizmi i veprës rrjedh nga mospërputhje midis pretendimit të heroit se dhe ai bën pjesë ndër njerëzit e përparuar, dhe fakti se, duke iu rreshtur punës dhe duke kërkuar një jetë të rehatshme, ai u gjend në radhët e njerëzve që i kishte lënë prapa jeta. Çobo Rrapushi është një personazh mjaft piktoresk. Autori ia ka lënë fjalën heroit që të tregojë vetë për ato që mendon dhe aspiron. Rrëfimi në vetë të parë ka dhënë dorë që të dalë në pah në mënyra të gjalla situata komike, në të cilën bie, dhe të vizatohet me ngjyra shumë të individualizuara figura e tij. Heroi i

novelës, si tip që rron më tepër me të kaluarën, vihet në lojë dhe përmes kontrastit artistik, që krijohet nga përshkrimet e jetës së fshatit të ri, të koncepteve dhe të ndjenjave të reja që janë shfaqur në fizionominë morale dhe shpirtërore të njerëzve të tij, nga njëra anë dhe mënyrës së jetesës së Çobos, nga ana tjetër.

Gjuha e veprës mbështetet në ligjërimin e përditshëm të fshatit lab, ajo është e pasur në fjalë dhe frazeologji. Autori ka arritur përmes imtësive reale të pikturojë botën shpirtërore të heroit dhe të japë bukur koloritin lokal.

Në novelën «Tana» (1955) F. Gjata e drejtoi vëmendjen në pasqyrimin e njeriut të ri të rritur dhe formuar në betejat e luftës për ngritjen e shoqërisë socialiste. Por karakterin e njeriut të ri autori e zbuloi pjesërisht në veprimtarinë e tij prodhuese; cilësitë e reja që brumosi në ndërgjegjen e tij shoqëria, F. Gjata i vuri në pah duke e pasqyruar atë në sferën e marrëdhënieve vetjake. Kjo u përcaktua edhe nga zgjedhja e heroit të veprës, në qendër të së cilës është një kooperativiste e re, Tana, që mishëron në karakterin e vet tipin e gruas së sotme shqiptare, që pushteti popullor e bëri anëtar të barabartë të shoqërisë. Tana shquhet si luftëtare e zjarrrtë për jetën e re; e përfshirë nga entuziazmi i punës së lirë ajo vë gjithë forcat e saj për zhvillimin dhe lulëzimin e kooperativës, me punën e saj ka fituar dashurinë dhe respektin e veçantë të gjithë bashkëfshatarëve, të cilët e çmojnë si punëtore të palodhur, që s'kursen asgjë për të mirën e përgjithshme. Por Tana lufton që gruaja të njihet si anëtare e barabartë e shoqërisë jo vetëm në jetën shoqërore, por edhe në jetën familjare. Pikërisht në mënyrën se si e vendos fatin e vet duken qartë tiparet e saj si përfaqësuese e gruas së sotme shqiptare, të emancipuar jo vetëm ekonomikisht, por edhe shpirtërisht. E bindur se është e zonja e jetës së vet, Tana lufton kundër elementëve të prapambetur dhe fanatikë, që në emër të respektimit të zakoneve «të mira» të fshatit, u orvatën të fusin hundët në punët e saj vetjake dhe t'i mohojnë të drejtën që ta rregullojë jetën e saj ashtu siç e sheh vetë të arsyeshme. Në sajë të karakterit të pavarur dhe bindjes së thellë në drejtësinë e vet, Tana ngadhënjën mbi të gjitha pengesat që has. Guximin e Tanës, që ngrihet

kundër zakoneve të vjetra dhe mbrojtësve të tyre, autori e shpjegon me ndryshimet shoqërore që kanë ndodhur në jetë; fshatarët e mbrojnë Tanën nga veprimet e padrejta të kryetarit të kooperativës dhe e ndihmojnë që ajo të marrë atë që do, sepse janë të bindur se kjo i përgjigjet frymës së moralit të ri. Historia e përpjekjeve të heroinës për të zgjidhur ashtu siç dëshiron çështjen e vet i ka dhënë dorë autorit të paraqesë dhe anë të tjera të jetës së fshatit, por kjo është dhënë në mënyrë të shpejtë, pa thellësi; karakteret e personazheve sapo janë skicuar. Zbutja e vështirësive që kalon heroina, dhe, në përgjithësi, një farë prirje zbkuruese e ka dobësuar forcën artistike të veprës.

Nga mesi i viteve 50 proza e shkurtër e zgjeron horizontin e saj ideor dhe tematik; në këtë kohë ajo plotësohet edhe me pena të reja të talentuara, që sjellin kontributin e tyre në zhvillimin e prozës (N. Prifti, Dh. Xhuvani, D. Shaplo etj.).

N. Prifti shkroi një varg tregimesh, në të cilat paraqiti rrënjosjen e koncepteve dhe të traditave të reja në jetë, lindjen e vetëdijes socialiste tek njerëzit, dashurinë e tyre të flaktë për vendin. Në qendër të tregimit «E fejuara» është Sadetja, një vajzë e thjeshtë fshatare. E rritur brenda katër mureve të shtëpisë dhe e shtrënguar nga rrethanat e jetës të përballojë që në moshë të njomë të gjitha punët e shtëpisë, ajo është mësuar të zbatojë çka e urdhërojnë të tjerët, sidomos babai. Që në fëmëni i kishin ngulur në kokë se vajza nuk ka të drejtë të ketë dëshira të tjera përveç dëshirave të prindërve. Por pushteti i moralit patriarkal në ndërgjegjen e saj nuk zgjati shumë: kur sheh me sytë e vet se njeriu me të cilin do ta martojë i ati është në moshë shumë të madhe në krahasim me të, pothuaj sa vetë i ati, dhe veç kësaj i shëmtuar, Sadetja vendos të mos pajtohet me këtë martesë poshtëruese për të. Autori ka arritur ta motivojë nga ana psikologjike rritjen shpirtërore të vajzës së re, duke treguar si në ndërgjegjen e saj forcohen dalngadalë, pa u vënë re, filizat e moralit socialist, dhe bëjnë në fund që Sadetja, sado e rëndë që është për të, të shkelë mbi vullnetin e të atit dhe të ikë me atë që donte. Në mënyrën se si zgjidhet konflikti midis Sadetes dhe babait të saj autori zbuloi ndryshimet e rëndësishme

që kanë ndodhur në fshatin shqiptar, rrënjosjen e normave socialiste në jetën e tij. Për fitoren e mentalitetit të ri tek banorët e fshatit flasin edhe tregimet «Çupa më e vogël» dhe «Brazda e fundit». Në heroin e tregimit «Brazda e fundit» N. Prifti nxori tipin e fshatarit, të cilin përvoja e mësoi të shohë qartë se, duke u ndarë nga fshati që ka hyrë në kooperativë, ai e ka të vështirë t'ua dalë mbanë vështirësive dhe andrrallave të jetës.

Në tregimin «Zenel Dauti» shkrimtari rrëfen për patriotizmin e ri që shquan masat. Kjo ndjenjë e fortë për vendin e shtyn Zenel Dautin, heroin e veprës, të ngrihet mbi ndjenjat e gjinisë dhe të vrasë dhëndrin e vet, sapo merr vesh që ky i fundit, i hedhur si diversant, ka vrarë kryetarin e këshillit të fshatit. Autori ka treguar në mënyrë të natyrshme se si në ndërgjegjen e fshatarit plak piqet ideja e hakmarrjes; heroi merr një vendim të tillë pa vështirësi të mëdha, sepse ndjenja e urrejtjes për botën e vjetër është shumë e thellë tek ai.

Siç e tregon edhe titulli, heroi i tregimit «Një ndër të shumtët» (1959) është një njeri i thjeshtë, shofer i një auto-ambulance në një qytet të vogël. Me hollësi të goditura shkrimtari tregon se si jeta e ndihmon këtë hero që më parë ndiqte në jetë parimin «unë e bëra timen, punë e tyre tashti», ta shikojë detyrën e vet me sy të ri, me syrin e punëtorit të vetëdijshëm, që mbi gjithçka vë interesin e përgjithshëm.

Tregimet e N. Priftit ngjasin me përshkrime; ngjarjet rrjedhin në mënyrë të lirë, pa u përfshirë në një veprim të organizuar. Shpesh në kornizën e tregimit hyn një pjesë e mirë e jetës së heronjve dhe zgjidhja e konfliktit vjen dalngadalë, pa çaste të veçanta dramatike. Kthesat shpirtërore, autori i jep nëpërmjet përshkrimit të rezultatit të këtyre.

Në krijimtarinë e Dh. Xhuvanit si tregimtar gjejmë një prirje tjetër krijuese; ky autor synon të bëjë analizë psikologjike, të zbulojë impulset e brendshme të sjelljes së heronjve. Kjo ka përcaktuar problematikën e vëllimit të tij «Këmbana e fundit» (1960).

Dh. Xhuvani rrëfen për fate të ndërlikuara njerëzish. Shumica e tregimeve të Dh. Xhuvanit janë ndërtuar mbi ngjar-

je jo të rëndomta. Dhanili, heroi i tregimit «Këmbana e fundit», një punëtor i ri, kalon çaste dramatike në jetën e vet; i ati, një prift i moçëm, kërkon me ngulm që i biri t'i kushtohet karrierës kishtarë. Ngjarja shkakton një shtrëngatë të vërtetë në familje. I rritur në atmosferën e lirë të pasqirimit, djaloshi shkon me vendosmëri kundër dëshirës së t'et dhe refuzon t'ua sakrifikojë jetën e vet «viteve që perëndojnë». Duke përdorur imtësi të goditura psikologjike, autori ka treguar dashurinë e madhe të heroit për jetën e re, e cila mposht ndjenjat që burojnë nga lidhjet gjinore, kur këto ndjenja bien ndesh me synimet e reja të njerëzve. Simpatia e hapur për priftin plak, i cili tronditet thellë kur e kupton se i biri do ndjekë rrugën e vet në jetë, ka topitur mprehtësinë e idesë së veprës. Një ngjarje e jashtëzakonshme qëndron edhe në themel të subjektit të tregimit «Miku». Tridhjetë vjet heroi i veprës, një fshatar i varfër, kishte rrojtur i veçuar nga të tjerët, pa miq, sepse një rast që i ndodhi në të ri e bëri të humbasë besimin se ka miqësi të vërtetë në botë. Që atëherë i preu të hyrat dhe të dalat me gjindjen dhe rrojti si kërmilli në guackën e vet, duke i kaluar i vetëm hallet dhe brengat e jetës. Por kohët ndryshuan, socializmi vendosi marrëdhënie të reja midis njerëzve, të cilët në sjelljen e tyre udhëhiqen nga fryma e solidaritetit dhe e kolektivizmit socialist. Kjo solli përmbysjen e rregullit të rreptë që prej tridhjetë vjetësh ishte vendosur në shtëpinë e tij. Xhuvani e ka gjetur me vend çastin që përcaktoi kthesën e thellë në jetën e heroit, i cili braktis mentalitetin e tij individualist dhe përfshihet nga atmosfera e jetës së lirë. Në një varg tregimesh Xhuvani pasqyroi edhe njerëzit e rinj, që punojnë gjithë entuziazëm për ndërtimin e socializmit. Në tregimin «Mbi degën e prerë» (1959) autori tregon fizionominë morale të njeriut të ri. Heroi i veprës është një mjek i ri, i cili me ndërgjegje të lartë dhe dashuri të pakufishme lufton për t'i shpëtuar njerëzit nga thonjtë e vdekjes dhe në këtë punë humane sheh kuptimin e jetës së vet.

Ndër autorët që u përpoqën të tregojnë riedukimin e njerëzve, tiparet e reja që shfaqen në ndërgjegjen e tyre në procesin e ndërtimit socialist bën pjesë edhe D. Shaplo, tregimet e të cilit shquhen nga psikologjizmi dhe ngjyrat

e buta lirike. Në «Një kafe me pak» rikrijohet atmosfera e viteve të para pas Çlirimit, tregohen përpjekjet për të ngjallur tek njerëzit koncepte të reja për jetën. Duke përshkruar mendimet dhe brengat e një nëpunësi, të cilit i propozojnë të shkojë në fabrikë sepse vendi i tij është shkurtuar, autori tregon procesin e vështirë të çlirimit të njerëzve nga mbeturinat e ideologjisë së vjetër. Njohje të mirë nga autori të botës dhe të psikologjisë së shtresave mikroborgjeze gjejmë edhe në tregimin «Në shtëpinë e vjetër», në të cilin është paraqitur perëndimi i botës së vjetër.

Në tregimin «Përtëritje» (1960) D. Shaplo u përpoq të tregojë se me sa mund dhe vështirësi krijohet familja socialiste. Skënderi, heroi i veprës, është konceptuar si tipi i intelektualit të ri, që punon gjithë entuziazëm dhe shquhet si gazetar me talent, por i kënaqur tepër nga vetja dhe egoist. Kjo ka bërë që t'i lejojë vetes të shkelë normat e moralit socialist dhe në këtë mënyrë të prishë familjen e tij. Konflikti zhvillohet pa dramatizëm të veçantë; autori e bën heroin të kuptojë arsyet e prishjes së harmonisë së familjes dhe të pranojë gabimin e vet.

Nga mesi i viteve 50 botohen romanet e para për ndërtimin e jetës socialiste, ndër të cilat duhen përmendur, si më të realizuar nga ana artistike, «Afërdita përsëri në fshat» i S. Spases dhe «Këneta» i F. Gjatës.

Vepra e parë e rëndësishme me të cilën S. Spasse hyri në letërsinë e re, ishte romani «Ata nuk ishin vetëm» (1952), kushtuar pasqyrimin të shfrytëzimit të fshatarësisë së varfër në regjimin çifligaro-borgjez. Romani «Afërdita përsëri në fshat» (1955) kishte një tematikë tjetër, në të autori bëri objekt pasqyrimi realitetin socialist. Vepra dëshmonte për forcimin e mëtejshëm ideor dhe artistik të autorit, për përvetësimin gjithnjë e më të thellë prej tij të metodës së realizmit socialist.

AFËRDITA PËRSËRI NË FSHAT

Në qendër të romanit «Afërdita përsëri në fshat» është fshati Grykas, një fshat tipik i Jugut, që ka marrë pjesë aktive në luftën e përgjithshme kundër pushtuesve fashistë dhe veglave të tyre. Ngjarjet e pasqyruara në të, i përkasin periudhës nga çlirimi i vendit deri në vitin 1946, kur u zbatua Reforma Agrare. Shestimi i autorit ishte të tregonte fshatin që sapo kishte dalë nga lufta, problemet dhe kontradiktat e jetës së tij, përpjekjet e fshatarëve për të shëruar plagët e luftës dhe për të nisur jetën e re, ndeshjen e ashpër klasore midis fshatarësisë së varfër, nga njëra anë, dhe pa-sanikëve të fshatit, nga ana tjetër.

Romani hapet me skenën e ardhjes së Afërdita Skënderajt në fshatin Grykas, ku kishte nisur karrierën si mësuese vjete të shkuara. Tashti në Grykas vjen një Afërditë tjetër; ajo nuk është mësuesja e dikurshme, heroina e romanit «Afërdita», plot iluzione, që besonte në forcën e arsimit për të shpëtuar fshatarët e varfër nga vuajtjet dhe padija, por intelektualja komuniste, që ka kaluar shkollën e Luftës Nacionalçlirimtare dhe e ka kuptuar se vetëm pas përmbyesjes së klasave shfrytëzuese krijohen kushtet për një jetë të lirë dhe të lumtur për fshatarësinë e varfër.

Heroina është paraqitur në një gjendje shpirtërore entuziaste, që nuk shpjegohet vetëm me pasionin e flaktë të saj për punën. Kushtet e përshtatshme që krijoi pushteti popullor për ndriçimin e mendjes së masave, që është ëndrra e saj më e dashur, ka ngjallur tek ajo vrull të ri shpirtëror. Është ky ideal i lartë qytetar që e shtyn atë të vijë vullnetarisht në Grykas, ku vë të gjitha forcat për të ndihmuar përparimin dhe lulëzimin e gjithanshëm të fshatit. Me interesimin dhe përpjekjet e saj këmbëngulëse hapet shkolla filllore dhe brenda një kohe të shkurtër hidhen themelet e shkollës tetëvjeçare. Afërdita bën një punë të gjerë edukative edhe jashtë mureve të shkollës, drejton kursin për zhdukjen e analfabetizmit, zhvillon herë pas here biseda mbi tema të përgjithshme kulturore dhe shkencore, lufton kundër zakoneve të vjetra, sidomos kundër zakoneve që pengojnë emancipimin e femrës etj. Ajo shfaqet edhe si aktiviste shoqërore; i kushton rëndësi sqa-

rimin politik të masave me qëllim që këto të bëhen të vetëdijshme për detyrat e mëdha ekonomike dhe politike të kohës.

Afërdita është në qendër të romanit, por megjithatë ajo nuk u bë personazhi që t'ia nënshtronte vetës zhvillimin e subjektit. Kjo ka rrjedhur për arsye se vetë ajo si karakter është konceptuar në mënyrë të njëanshme. Në figurën e saj janë theksur ato veçori që e tregojnë atë si njeri që zhvillon veprimtari iluministe dhe më pak si udhëheqëse politike e masave, si mishërim i heroit pozitiv, i komunistit që udhëheq aktivisht në praktikë masën në luftën për ngritjen e jetës së re.

Ana më e fortë e romanit qëndron në pasqyrimin plot vërtetësi të fshatit shqiptar të periudhës së rindërtimit, sidomos të gjendjes shpirtërore të fshatarëve të varfër fill pas Çlirimit, të vështirësive dhe të kontradiktave të jetës që ishin përcaktuar nga veçoritë e periudhës historike që kalonte gjithë vendi, kur pushteti i ri sapo ishte vendosur dhe nuk kishte nisur ende nga reformat ekonomike dhe shoqërore. Për gjendjen e fshatit në këto vite autori flet pa i fshehur vështirësitë: njerëzit nuk kishin ku të futnin kokën, sepse pjesa më e madhe e kasolleve ishte djegur. Të zhveshur dhe të zbathur, fshatarët mbahen në këmbë, duke marrë një grusht miell herë tek njeri dhe herë tek tjetri. Bindja se revolucionin popullor ka për qëllim të rregullojë rrënjësisht gjendjen e popullit, i bën ata të kenë besim se së shpejti jeta e tyre do të përmirësohet. Por kur shohin se agallarët e fshatit jo vetëm që dolën nga lufta me pasuri të padëmtuar, por edhe po e shtojnë, duke kërkuar borxhet e vjetra, fshatarët ngrejnë supet të habitur, duke menduar për ndonjë çast se ndoshta asgjë s'ka për të ndryshuar, se njerëzit do të rrojnë si qemoti: mënjanë të pasurit, me mall dhe gjë që s'ka të numëruar, dhe në anën tjetër të varfërit, me urinë dhe sëmundjet që ua kanë bërë jetën të padurueshme. Këto dyshime të vegjëlisë fshatare autori i paraqiti në mënyrë të plotë përmes përshkrimit të përjetimeve të xha Nelos, në figurën e të cilit dha përfaqësuesin tipik të fshatarëve të këputur. Në karakterin e xha Nelos, autori vuri në dukje dashurinë e fortë për jetë të lirë dhe të lumtur, urrejtjen e thellë ndaj agallarëve, ve-

ndosmërinë për të luftuar deri në zhdukjen e tyre të plotë si klasë. Në të vërtetë, xha Nelon autori e konceptoi jo si fshatar të zakonshëm, por si tipin e fshatarit që ish'te i vetëdijshëm për gjendjen dhe të drejtat e bujqve të varfër. Këto anë të karakterit të heroit dalin në shesh përmes 'trëgimit të së kaluarës së jetës së xha Nelos, që s'kishte qenë veçse një zinxhir përpjekjesh pa sukses për t'i shpëtuar mjerimit. Thelbi i karakterit të xha Nelos si fshatar me vetëdije klasore shfaqet pas Çlirimit. Ai e thotë hapur se me të pasurit nuk ka pajtim, prandaj jo vetëm që vetë nuk paguan asnjë lek, por u bën thirrje fshatarëve të këputur si vetja që të mos paguajnë borxhet që i kanë afendikoit të fshatit, të cilin e demaskon hapur në sytë e të gjithëve si ushujzë të fshatarëve të varfër. «Me të jemi kacafytur tërë jetën, po tani... dale në do t'i shkojë». Kur beu, në muajt e parë pas Çlirimit dërgoi nga Tirana sejmënin e vet për të mbledhur borxhet e vjetra, xha Neloja nuk ia zgjat shumë fjalët, por merr iniciativën dhe në krye të fshatarëve më të vendosur e dëbon atë nga fshati. Xha Neloja është mbështetja e Këshillit të fshatit në zbatimin e masave ekonomike kundër shfrytëzuesve. Besimi i patundur në të ardhmen e lumtur është një nga veçoritë e karakterit të tij dhe këtë besim nuk ia tronditin as edhe fatkeqësitë vetjake që i bien mbi krye. Ai mezi pret realizimin e reformës agrare, që e kishte ëndërruar gjatë gjithë jetës së tij. «... Mos vdeksha, pa futur parmendën në selishtet e pa e parë Drizën naa, shesh! Ndryshe s'do të më trefë dheu» — kjo është dëshira e tij e flaktë.

Në roman ka edhe një varg personazhesh të tjera që mishërojnë përfaqësuesit e fshatarësisë së varfër, si xha Shemoja e xha Tirka, të cilët nuk kanë ndonjë rol të pavarur; ata janë futur në roman për të nxjerrë më mirë në pah gjendjen e përgjithshme shpirtërore në prag të realizimit të reformave të rëndësishme që ndërmerren pushteti popullor. Mendimet e shqetësuara që nxjerrin krye herë pas here në ndërgjegjen e fshatarëve të varfër, autori i shpjegon me situatën e veçantë fill pas Çlirimit, kur klasat shfrytëzuese ushqenin ende shpresë të ruanin privilegjet e tyre. Ato besonin se revolucioni popullor do të degjeneronte në revolucion të zakonshëm demokratiko-borgjez, dhe

kjo do t'u jepte mundësi të qëndronin në këmbë si zotër të jetës. Në roman janë paraqitur me vërtetësi orvatjet e të pasurve për t'iu përshtatur gjendjes dhe për t'u pasuruar më tej. Afendikoi i fshatit, Llaqi Driza, nga një anë, bën çmos për të fshehur pasurinë e mbledhur në rrugë të paligjshme në të kaluarën, duke deklaruar vetëm një pjesë të saj, nga ana tjetër, përpiqet të rregullojë dhëndrin e tij si nëpunës në sharrat e Malizonjës për të siguruar fitime të reja. Kur me masat e pushtetit popullor, u përmbysën planet e tyre dhe toka po u shkiste nën këmbë, ata përdorën terrorin si mjet për të shpëtuar nga zhdukja si klasë; vrasin xha Nelon dhe me këtë përpiqen t'u shtien frikën të tjerëve, që të mos e marrin tokën që u dha pushteti popullor. Por me këtë s'bëjnë tjetër veçse shpejtojnë fundin e tyre.

Veprimi i romanit «Afërdita përsëri në fshat» rrjedh ngadalë, pa çaste të forta, megjithëse atë e përshkon një konflikt i mprehtë. Ngjarjet fitojnë forcë dramatike kur afrohet zgjidhja e konfliktit që përputhet me shpronësimin e pasanikëve të fshatit. Karakteret e personazheve kanë dalë më tepër nëpërmjet rrëfimit të autorit dhe pak nëpërmjet episodeve të subjektit. Në faqet e romanit janë përdorur kujtimet nga e kaluara; ndërhyrjet lirike, paraqitja e natyrës dhe sidomos skenat dhe imtësitë konkrete nga jeta e përditshme e heronjve.

* * *

Pas novelave «Uji fle, hasmi s'fle» dhe «Tana» F. Gjata shkroi romanin «Kënetë» me temë nga aktualiteti socialist. Kjo vepër përveç faktit se autori synoi të pasqyronte aspekte të rëndësishme të jetës së vendit pas Çlirimit, ka rëndësi sepse shënoi një rritje të mëtejshme të talentit të tij, të aftësive të tij si prozator.

KËNETA

Në «Kënetë» (1959), për herë të parë në letërsinë shqiptare të realizmit socialist puna ndërtimore e masave punonjëse u pasqyrua përmes tablosh të gjera artistike.

Si lëndë për veprën shërbyen ngjarjet dhe faktet nga puna e mijëra punonjësve të rrethit të Korçës, punëtorë, fshatarë, nëpunës, të rinj dhe të reja, për tharjen e kënetës së Maliqit. Kuptohet se «Kënetë» nuk është historia e vërtetë e aksionit të Maliqit, por vepër artistike, në të cilën, pa dyshim, u shfrytëzuan shumë fakte e të dhëna reale, për të dhënë një pasqyrim të përgjithësuar artistik të jetës, që nënkupton në radhë të parë interpretimin ideor dhe vlerësimin emocional të karaktereve shoqërore.

Romani «Kënetë» ka shumë personazhe që përfaqësojnë klasa edhe grupe të ndryshme shoqërore; autori ka mundur t'i pajisë ata me tiparet individuale, që i bëjnë të besueshëm dhe të gjallë. Veçoritë thelbësore të karaktereve të personazheve zbulohen në lidhje të ngushtë me ecurinë e punimeve për tharjen e kënetës, me qëndrimin që mbajnë heronjtë ndaj aksionit.

Në qendër të romanit është populli, masa e vullnetarëve, të cilët përpiqen me të gjitha forcat për të tharë kënetën brenda afatit. Me këtë lidhet një nga veçoritë e veprës, shfrytëzimi i gjerë i skenave masive, në të cilat autori synoi të pasqyrojë jetën e shumanshme të kolektivit të kantierit, si punën për hapjen e kanalit kullues, luftën për kapërcimin e pengesave që nxirrnin inxhinierët sabotatorë (shembja e barakës, furnizimi i shtrregullt me ujë, shembja e digës etj.), jetën e vullnetarëve në kohën e lirë (mbledhjet e kursit kundër analfabetizmit, mbledhjet e ndryshme me karakter politik, aktivitetet e ndryshme kulturore etj.). Meritë e autorit është se vullnetarët i pasqyroj jo si masë amorfe, por si kolektiv i përbërë nga individë që kanë veçoritë e tyre, mendimet dhe dëshirat e tyre. Përfaqësuesit më karakteristikë të masës janë Hasan Saraçi, Liman Hysa, xha Kasemi, Dalipi etj. Tek Hasani dhe Limani autori mishëron idenë e përpjekjeve heroike të punëtorëve për rimëkëmbjen e shpejtë të vendit dhe ndërtimin e jetës së re. Ata s'kursejnë asgjë për përfundimin e aksionit, shquhen për ndërgjegje të lartë politike dhe kjo e ka burimin te

vetëdija e tyre si zotër të jetës. Kjo vetëdije ka gjetur shprehje në fjalët që Liman Hysa i thotë drejtorit të punimeve, një armiku të betuar të rendit të ri: «Dëgjo, inxhinier! Ti akoma si qëmoti mban qëndrim prej zotërie me punëtorët. Po iku ajo kohë, përgjithmonë! Ne tashti jemi zotër dhe s'lejojmë njeri të na marrë nëpër këmbë. Dëgjon! Jemi zotër!». Të bindur thellë se rendi i ri që po lindte nuk e kishte të lehtë të çante përpara, ata jo vetëm punojnë, por në të njëjtën kohë edhe vigjilojnë. Që të dy, Hasani dhe Limani, kanë nuhatje të mprehtë klasore dhe janë ndër të parët që e kuptojnë se mungesat dhe zvarritjet e ndryshme në punime flasin se dikush saboton në kantier.

Në skenat masive shkrimtari ka ditur të pasqyrojë me vërtetësi heroizmin e vullnetarëve, entuziazmin e flakët me të cilin ata punojnë për tharjen e kënetës. Por F. Gjatën e interesoi në mënyrë të veçantë problemi i rritjes ideologjike të masës në procesin e punës, i riedukimit të saj në frymën e kolektivizmit socialist. Pjesa më e madhe e vullnetarëve janë fshatarë, që gjithë jetën ishin rropatur në copën e tokës së tyre; kjo jetë kishte bërë që përfytyrimet dhe konceptet e botës së vjetër, të mbështetura në pronën private, të kishin rrënjë të thella në ndërgjegjen e tyre. Autori tregon se shumë vullnetarë erdhën në aksion me një barrë mbeturinash. Në fillim ata nuk e kishin të qartë qëllimin e punës që do të bënin; pati asish që pasi punuan një farë kohe, vendosën të braktisnin aksionin, të nxitur nga interesat e tyre vetjake, por masa e madhe e vullnetarëve qëndroi deri në fund duke kaluar kështu një shkollë të vërtetë. Tek ajo nis e shfaqet vetëdija e rëndësisë së detyrës, besimi në veten e tyre. «Ne i nxorëm rrënjët gjermanit e jo të mos thajmë një kënetë», — thonë vullnetarët plot besim në forcat e tyre. Puna për tharjen e kënetës u ndihmoi atyre të kuptojnë se vetëm në pushtetin popullor u çliruan nga shtypja e egër shoqërore e klasave sunduese dhe shpëtuan nga jeta e vjetër plot vuajtje dhe poshtërim që kishin bërë në të kaluarën. Kjo ndërgjegje i bëri ata të punojnë me të gjitha forcat në aksion dhe të lidhen ngushtë me punën. Në roman ka skena ku përmes imtësisht të goditura, jepen përpjekjet e mëdha të vullnetarëve për të përmbushur detyrat, durimi i tyre përballë

privacioneve që hasin në jetën e përditshme dhe përballë pengesave të ndryshme që u nxjerr fshehurazi grupi i sabotatorëve. Megjithëse të veshur dhe të mbathur keq, megjithëse shumë syresh flenë jashtë, sepse s'ka baraka për të gjithë, vullnetarët nuk dëshpërohen përpara vështirësive të shumta, por punojnë me shpirt të lartë vetëmohimi; kjo del qartë në skenën ku përshkruhet shpërthimi i rrebeshit të madh, që desh rrëzoi për tokë digën dhe sidomos në skenën e përmytjes, që provokuan inxhinierët armiq për të shkatërruar një herë e mirë aksionin e madh të tharjes së kënetës së Maliqit. Në këto skena autori diti të paraqesë në mënyrë bindëse vendosmërinë e vullnetarëve për të mposhtur çdo pengesë dhe për të çuar deri në fund mbarimin e aksionit.

Konfliktin që zhvillohet në mënyrë të fshehur midis masës së vullnetarëve dhe inxhinierëve sabotatorë, shkrimtari e paraqiti në gjithë ashpërsinë e tij. Armiaqët veprojnë në mënyrë të vendosur për të zbatuar udhëzimet e padronëve. Duke përfutuar nga fakti që gjithë drejtimi teknik i punimeve ishte në duart e tyre, ata arritën për një farë kohe t'u nxirrnin vështirësi vullnetarëve dhe të dëmtonin punën. Autori tregon format dhe mënyrat e ndryshme që përdorin inxhinierët për të ngjallur pakënaqësi tek vullnetarët dhe kësisoj t'i shtrëngonin ata që të braktisnin aksionin. Nëpërmjet paraqitjes së veprimtarisë sabotuese dhe jetës së tyre vetjake, F. Gjata ka arritur të nxjerrë në pah fytyrën e vërtetë të armiqve: antipatriotizmin, egoizmin klasor, urrejtjen e tërbuar që ushqejnë ndaj pushtetit të ri, rënien e tyre morale. Këto veçori thelbësore të përfaqësuesve të klasave shfrytëzuese të cilat, për të rikthyer privilegjet që gëzonin në të kaluarën, nuk ngurrojnë t'ua shesin atdheun imperialistëve, janë mishëruar në mënyrë të gjallë te Kujtim Shaqiri, personazhi më i realizuar në pikëpamje artistike nga radhët e armiqve. Te ky autori vizatoi armikun e rrezikshëm, që vepron kundër rendit socialist i shtyrë nga urrejtja e thellë dhe ndjenja e hakmarrjes së pamëshirshme. Ai është zhveshur nga ndjenja e dashurisë për vendin. Sigurisht, në një farë shkalle kjo shpjegohet me faktin se ai është agjent i vjetër i zbulimit amerikan, por e marrë në vështrim të gjerë kjo veçori flet për frymën antipatriotike të klasave sunduese, sidomos të bejlerëve, të cilët e kanë parë gjithnjë vendin si çiflig të tyre. Ba-

shkëpunëtorët e tij si Vasil Minga me të shoqen, inxhinieri italian dhe bashkë me ta Abdi Sharra, drejtuesi teknik i mëparshëm, të cilit i zuri vendin Kujtim Shaqiri, me veçoritë e tyre plotësojnë karakterizimin e armiqve si fundërrina shoqërore, si njerëz pa parime morale, që e shesin atdheun për rehatinë e tyre vetjake. Këtë ide të rëndësishme në roman e thekson një personazh tjetër i rëndësishëm inxhinier Mborja, i cili i jep dorë autorit për paraqitjen më të plotë të jetës shoqërore të viteve të pasqirimit dhe për zhvillimin e mëtejshëm të veprimit të subjektit. Te inxhinier Mborja shkrimtari pasqyroi tipin e intelektualit të vjetër të ndershëm, që pas Çlirimit mori anën e popullit dhe vuri në shërbim të ndërtimit të Shqipërisë së re energjitë dhe aftësitë e veta. Inxhinier Mborja e kishte ndier veten gjithnjë të lidhur me vendin dhe kishte pasur si qëllim të jetës së tij t'i shërbente zhvillimit dhe lulëzimit të atdheut. Si patriot dhe njeri i ndershëm, pas Çlirimit ai u vu në shërbim të pushtetit popullor i shtyrë nga dashuria për vendin. Në kantierin e Maliqit ai jo vetëm punoi me ndërgjegje të lartë, por u ngrit kundër inxhinierëve, kur u bind se ata me veprimet e tyre kishin për qëllim të sabotonin aksionin.

Ndeshja midis vullnetarëve, të udhëhequr nga komunistët, dhe inxhinierëve sabotatorë merr fund me arrestimin e armiqve dhe me tharjen e kënetës.

Në përputhje me karakterin dramatik të ngjarjeve në faqet e fundit rrëfimi ecën me ritëm dinamik; autori i pasqyroi me gjallëri ngjarjet që lidhen me përfundimin e aksionit; lajmi mbi zbulimin e sabotatorëve ngjalli një zemërim të thellë tek vullnetarët, të cilët shtojnë vrullin dhe mobilizimin në punë, duke bërë kështu që aksioni të kurorëzohet me sukses.

Fryma novatore e romanit «Kënetë» u duk jo vetëm në pasqyrimin e vrullit ndërtimtar të masave të popullit, të gatishmërisë së tyre për të mos kursyer djersën dhe energjitë për ndërtimin sa më të shpejtë të jetës së re, por edhe në krijimin e heroit pozitiv me ngjyra të gjalla.

Pikërisht i tillë është Stavri Lara. Rruga e tij në jetë është tipike për të rinjtë e popullit. Që herët ai provoi në kurriz të vet shfrytëzimin dhe shtypjen klasore; për të nxjerrë bukën e gojës, ende i mitur, hyri në punë si mekanik. Kur shpërtheu lëvizja e përgjithshme kundër pushtuesve fashistë, mori pjesë në të. Më vonë doli në mal dhe luftoi në radhët e Ushtrisë Na-

dionalçlirimtare deri në çlirimin e plotë të vendit dhe madje mori pjesë në luftimet që zhvilluan forcat tona për çlirimin e Malit të Zi dhe të Kosovës. Kur ishte partizan u pranua në radhët e Partisë.

Bindjet e thella ideologjike, devotshmëria ndaj çështjes së popullit, dëshira për punë, gatishmëria për të vënë aftësitë e tij në shërbim të masave të popullit, urrejtja e thellë për armiq-të e vegjëlisë, këto janë tiparet organike të karakterit të Stavri Larës. Çdo takim me heroin në faqet e romanit na njuh me një aspekt të ri të botës së tij të brendshme. Karakterin e tij autori e vizatoi në lidhje të ngushtë me ngjarjet themelore të kantierit. Çështjet që e shqetësojnë atë janë nga më të ndryshmet; që nga organizimi i punës edukative me vullnetarët e punëtorët, dhe sigurimi i materialeve më të nevojshme për sektorët e ndryshëm të kantierit, deri te çështja e strehimit të të gjithë vullnetarëve dhe përmirësimi i ushqimit të tyre. Stavri Lara është udhëheqës i ri i masave, në fillim pa përvojë të mjaftueshme, por që gjatë drejtimit të punës rritet bashkë me masën dhe bëhet një drejtues i pjekur dhe i matur. Ai e kupton rëndësinë dhe karakterin e ndërlikuar të aksionit që do të kryhet, prandaj i kushton atij gjithë forcat, duke jetuar në mënyrë intensive me të gjitha ndodhitë dhe të papriturat e kantierit. Përmasë përshkrimi të jetës dhe të punës së personazhit kryesor, F. Gjata tregoi se si me punë të pareshtur dhe me luftë këmbëngulëse e të vendosur për të mposhtur vështirësitë e shumëllojta që u nxirrnin armiqtë, komunistët arritën të organizonin masën e madhe të vullnetarëve, të përbërë nga njerëz të ndryshëm e të pamësuar me punë të organizuar e me disiplinë; nga njerëz plot koncepte dhe shprehje individualiste, nën ndikimin e komunistëve vullnetarët fitojnë besim në forcat e tyre dhe në pushtetin popullor, marrin flatra nga perspektiva e suksesit. Përvoja si komisar gjatë viteve të luftës e kishte mësuar Stavrin të punonte me durim me njerëzit; për të janë të huaja metodat administrative e burokratike. Ai përpiqet që të bindë njerëzit në drejtësinë e vijës së Partisë, duke u mbështetur në faktin se fshatarësinë punonjëse e lidhin interesa të shumta me pushtetin popullor. Mbledhja në Vloçisht për regjistrimin e vullnetarëve dhe sidomos skena ku përpiqet të bindë vullnetarët që kërkonin të largoheshin nga aksioni, vënë në pah cilësitë e Stavrit si agjikator i zoti, që me fjalën e vet të thjeshtë, por bin-

dëse, di t'u fitojë zemrat njerëzve. Stavri e shfaq veten edhe njeri me iniciativë, ai në situatat e vështira është në gjendje të orientohet drejt. Kur në shtratin e lumit doli shkëmbi dhe punimet për tharjen e kënetës u vunë në rrezik, ai interesohet për të gjetur dinamitin dhe shkon vetë deri në Tiranë për ta siguruar. Pikërisht kjo lidhje e ngushtë me punën, me njerëzit e ndihmon atë të kuptojë i pari se pengesat e shumta duhet të jenë shfaqje të veprimtarisë armiqësore. Në procesin e punës për drejtimin e njerëzve, për sqarimin dhe edukimin e tyre ideologjik e politik, vetë Stavri pëson ndryshime; ai mëson në punë e sipër shumë gjëra që nuk i njihte; studion me kujdes përvojën e përditshme dhe merr masa për të mënjeluar pengesat që dalin në punë. Kështu, kur numri i vullnetarëve arriti dhjetë mijë veta, ai i organizoi në brigada, kompani e toga, gjë që lejoi një drejtim e shfrytëzim më të mirë të kohës së punës dhe solli forcimin e disiplinës. Duke i qëndruar besnik së vërtetës së jetës, F. Gjata në figurën e heroit, krahas anëve pozitive që janë kryesore në karakterin e Stavrit, vuri në dukje edhe disa të meta, siç është të nguturit, gjaknxehtësia që e çonte ndonjëherë në gjykime të njëanshme, si në rastin me inxhinier Mborjen, të cilin e qortoi rëndë për qëndrim të pandërgjegjshëm në punë, duke e ngatërruar pa të drejtë me inxhinierët reaksionarë.

Stavri Lara nuk është vetëm luftëtari i vendosur për ngri-tjen e rendit të ri, por edhe njeri me ndjenja të çiltërta në jetën vetjake. Ai ruajti të pastër dashurinë për Rinën, vajzën e mësuesit të thjeshtë, dhe i mbeti besnik ndjenjës së tij deri në fund. Marrëdhëniet e Stavrit me Rinën, pastërtia që karakterizon të dy të rinjtë, të cilët janë lidhur fort me njëri-tjetrin në punën e përbashkët për të mirën e popullit, fiton simpatinë e lexuesit.

I vizatuar si njeri i gjallë, me të mirat dhe me të metat e tij, që fiton përvojë të re nga dita në ditë dhe rritet si udhëheqës masash dhe në të njëjtën kohë i vizatuar edhe me botën e tij intime, Stavri doli si mishërim i gjallë i heroit pozitiv.

Në sajë të meritave ideore dhe artistike romani «Kënetë» u bë një nga veprat më të shquara të letërsisë sonë të kësaj periudhe. Autori ia doli të realizojë synimin e tij për të treguar përpjekjet e masave punonjëse për ngritjen e rendit të ri socialist, luftën klasore që shoqëron këto përpjekje. Subjekti i

romanit është pleksur me ngjarje të marra drejtpërdrejt nga rryma e gjallë e jetës. I gjetur është edhe kompozicioni, i cili lidh në mënyrë të natyrshme të gjitha pjesët e veprës dhe ndihmon të dalin në pah me qartësi ngjarjet kryesore. Në funksion të zbulimit të idesë kryesore të romanit janë edhe komponentët e tjerë të veprës: skenat masive, sidomos skenat e punës në kënetë, peizazhi, portretet e personazheve të dhëna shkurt, imtësitë konkrete dhe plot shprehimësi, digresionet lirike etj.

4

Në prozën e kësaj periudhe mori zhvillim edhe lloji satirik. Disa shkrimtarë fshikulluan mbeturinat e moralit të vjetër që pengonin rritjen dhe zhvillimin e shoqërisë socialiste, treguan orvatjet e përfaqësuesve të botës së vjetër për t'u përshtatur rrethanave të reja dhe për të dëmtuar në këtë mënyrë më lehtë ngritjen e jetës socialiste. Aktiv në fushën e satirës në këto vite ishte Sh. Musaraj, i cili shkroi një varg tregimesh dhe skicash që shquhen nga humori i natyrshëm dhe i lezetshëm popullor. Disa krijime të Sh. Musarajt kanë në qendër figurën e rrëfimitarit, i cili është pjesëmarrës i ngjarjeve që tregon. Objekt i preferuar i satirës së autorit ishin veçanërisht agallarët, që heshtazi, duke u shtirur ndonjëherë si njerëz që janë me pushtetin, përpiqeshin të largonin fshatarët nga rruga e drejtë. I tillë është Mete Agai, që ngrihet kundër punës kolektive në fshat («Hesapet e Mete Agait»), Seit Efendiu, të cilit fshatarët ia zbuluan të gjitha të palarat në kohën e regjimeve antipopullore dhe të pushtimit fashist («Uthull për inatçinjtë»), Nalo Ziu me Meçe Beun, me orvatjet e tyre qesharake për të kthyer të kaluarën, («Peshqeshi i vitit të ri» dhe «Ç'kërkoi, gjeti»). Në një tok skicash të tjera Sh. Musaraj vuri në lojë me një buzagaz të lehtë të meta të ndryshme në punën e disa nëpunësve, si prirjen për mbledhje të tepërta, që bëheshin kohë pa kohë, zvarritjet e punëve, etj. («Nuk qethet dashi me shelegë», «Punë pa punë», «Të reja nga kryeqyteti. Nëpër Tiranë»). Për shqetësimet e reja të fshatarëve, për patriotizmin e tyre, për edukimin e tyre me ndjenjën e kolektivizimit socialist, flitet me një humor dashamirës në ciklin me skica me titull «Ver' e vjetër në vozë të re». Heroi, xha Teloja, përfaqëson tipin e fshatarit të varfër, të lidhur ngushtë me pushtetin popullor, po që nuk arrin të rrokë me-

njëherë të renë në punë dhe në jetë, sepse e pengojnë disa koncepte të vjetra. Autori tregon si jeta e ndihmon heroin të zhvishet nga mentaliteti prapanik.

Në rrugën e qesëndisjes të të metave që shfaqeshin në jetë shkuan edhe autorë të tjerë, si N. Prifti, M. Zalosnjaja, etj. Në shkrimet e veta humoristike N. Prifti goditi traditat patriarkale, që e mbanin gruan në skllavëri poshtëruese («Jase Kapllani dhe gratë»), supersticionet e ndryshme, që pengonin çlirimin shpirtëror të njeriut («Lëkura e ujkut»), burokratizmin, formalizmin dhe mungesën e ndërgjegjes në punë («Telegrami», «Detyra e re», «Shtëpia e teto Prokos»). Kritika e zakonshme të vjetra, sidomos e paragjytimeve fetare, formon brenndinë e tregimeve humoristike të M. Zalosnjës («Hallo Makbuleja ka shkelur xhindet», «Bakllavatë e Sheme Shaqirit» etj.).

Ndër veprat e prozës humoristike të kësaj periudhe janë për t'u shënuar tregimet e M. Kallamatës. Nëpërmjet një humori të leztshëm autori qesëndis burokratizmin, formalizmin, mungesën e ndërgjegjes në punë, indiferentizmin etj. Vepra më e mirë e këtij autori është tregimi fantastik «Kthimi i astronautit» (1959), thurur si rrëfim i një shkrimtari mbi kthimin e vet në tokë pas një udhëtimi prej 194 vitesh në kozmos. Nëpërmjet përshtypjeve rreth asaj që sheh në Shqipëri dhe bisedave me njerëzit e shekullit XXII, autori qesëndis bukur një varg të metash, siç është shfrytëzimi i keq i pyjeve, përgjimi i profesioneve që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me prodhimin dhe lakmja për t'u bërë nëpunës, besimi i madh i disa shkrimtarëve në veten e tyre etj. «Kthimi i astronautit» dëshmon për fantazinë e shkathët të shkrimtarit, për aftësinë e tij në krijimin e situatave komike bindëse, për zbulimin me mjeshhtëri të idesë artistike. Në skicat «Lart e poshtë» (1955) dhe «Simfoni e pambaruar» (1955) Kallamata, duke i trashur ngjyrrat, vë në lojë rutinën burokratike, maninë e disa drejtuesve për mbledhje të shumta, pa vend e pa shkak, të cilat u topitnin njerëzve energjitë.

5

Në prozën e viteve 50 një vend të madh zuri paraqitja e jetës së kaluar të vendit. Interesimi për epokat e mëparshme historike u përcaktua nga nevojat e kohës. Në kushtet e luftës

për ndërtimin e shoqërisë së re masat punonjëse ndienin nevojën të njihnin në mënyrë sa më të plotë historinë e kaluar të vendit, ashtu siç ishte zhvilluar ajo në të vërtetë, pa shtrembërimet dhe cungimet e historiografisë zyrtare feudalo-borgjeze. Shndërrimet e thella që u kryhen në shoqëri pas Çlirimit rritën interesimin sidomos për të njohur gjendjen e vegjëlisë nën regjimet antipopullore, jetën dhe luftën e saj për drejtësi shoqërore. Në një varg veprash, autorët përshkruan shtypjen e egër feudale, jetën e vështirë të popullit, sidomos të fshatarësisë, zgjimin e vegjëlisë dhe luftën e saj për drejtësi shoqërore.

* * *

**ATA NUK ISHIN
VETËM** Në romanin «Ata nuk ishin vetëm» S. Spasse, jep një pamje besnike të rrojtes së rëndë, të kredhur në mjerim dhe vuajtje të parrëfyeshme të fshatarësisë para Çlirimit. Periudha që autori ka paraqitur në vepër, është nga më të vështirat në jetën e masave të fshatit gjatë ekzistencës së regjimit çifligaro-borgjez: janë vitet 1935-1936, kur varfëria arriti kulmin dhe uria u ndeh edhe në krahinat bujqësore.

Në vepër ka mjaft skena dhe përshkrime të qëlluara, ku, me realizëm, pasqyrohet gjendja e zyrtë, pa ndonjë shkëndijë shprese e fshatarëve, shtypja që pësojnë ata nga beu dhe nga qehallarët e tij. Para lexuesve del vargu i fshatarëve të Drithasit, me fytyra të vrenjtura e të thara nga mundimi. Pjesa më e madhe e tyre mezi arrinin ta nxirrnin bukën vetëm për dy muaj; për të fituar kafshatën e gojës, gjatë dimrit, një palë bënin dru e qymyr dhe i shisnin në Korçë e në fshatrat përreth, kurse të tjerët shkonin edhe më larg, në Durrës e Tiranë, ku punonin si hamej, qymyrxhinj apo punëtorë rrugash. Po edhe ky kurbet i brendshëm s'ua lehtësonte jetën. Këtë problem autori e ka futur në roman që në fillim, me skenën e ardhjes së beut në Drithas dhe të drekës që fshatarët i shtrojnë atij. Në këto faqe, në mënyrë të tërthortë pasqyrohet gjendja e shtypur dhe e nënshtruar e fshatarësisë. Kur beu u kërkoi 150 napolona për gjysmën e prodhimit, një shumë fort e

madhe kjo për gjendjen e tyre të këputur, fshatarët nuk kanë guxim të ngrenë zërin dhe të mbrojnë veten. Në mes të ditës, me mënyrat më brutale dhe më poshtëruese, beu u grabiti dhe u rrëmben frytin e djersës së tyre. Mjaft skena të romanit, sidomos ato ku qehallarët, plot arrogancë e kapadaillëk, kalojnë nga lëmi në lëmë dhe shajnë fshatarët me fjalët më të vrazhda, kanë një rëndësi të madhe njohëse. Autori ka mundur të zbulojë nëpërmjet tyre format e egra anadollake të shfrytëzimit dhe të shtypjes, që ekzistonin në fshatin shqiptar të paraçlirimit dhe u mirrin frymën njerëzve. Tema e gjendjes së rëndë të fshatarëve, të zhveshur nga të drejtat më elementare si njerëz, është trajtuar në mënyrë më të plotë në kapitullin e tretë, ku flitet për dasmën e djalit të xha Koroveshit. Përmes përshkrimit të gjallë të dasmës që priset dhe veçanërisht të episodit të «mollës së lumturisë», që mbeti në baltë e shkelur nga thundra e kalit të beut, shkrimtari, në formë simbolike, paraqiti atë gjendje të poshtëruar, ku njerëzit janë privuar nga mundësia për t'u mbrojtur nga fyerjet e t'i dalin zot vetes kundër beut, kur ky me brutalitet, s'u lë të gëzojnë as ato pak ditë të bardha që kanë në jetën e tyre të zezë.

Pamjen e vrazhdë të vuajtjeve dhe të brengave e plotësojnë edhe kujtimet plot skena mizore dhe rrënjëthënë mbi zullumet dhe hakmarrjet e bejlerëve kundër fshatarëve, mbi metodat e ndryshme që ata shpikin për të poshtëruar dhe torturuar njerëzit e pambrojtur, kujtime këto që fshatarët i kishin dëgjuar nga gjyshërit dhe stërgjyshërit e tyre. Në shumë pika, nga ashpërsia dhe brutaliteti, këto skena dhe veprime të kujtojnë mizoritë e feudalëve despotë në përrallat orientale.

Fshatarët s'i shtypte vetëm beu. Skena e ardhjes së kryerjohësit dhe e tagrambledhësit, të dhëna me viza të gjalla, tregojnë se armik tjetër i vegjëlisë fshatare ishte edhe shteti reaksionar, përfaqësuesit e të cilët i grabisnin drithasit po me atë egërsi, të pashembëllt si beu. Me metodat e frikësimit, të kërcenimit me burg dhe të dinakërisë, nëpunësit u shkëpusin bujqve paratë e fundit që kanë ose i detyrojnë të futen edhe më tej në borxhe tek fajdexhinjtë e fshatit. Me këto ngjarje plotësohet në vepër kuadri i zyrtë i varfërimit të madh të njerëzve, i jetës së tyre, që është kthyer në gëllitje plot ankth.

Duke paraqitur vuajtjet dhe shtypjet që pësojnë fshatarët, autori njëkohësisht ka vënë në dukje etjen e tyre të madhe për

jetë të lirë. Në roman rrëfëhet, se me ç'kënaqësi ata sodisin prej së largu kullën e beut që po digjej bashkë me grurin që ai u kishte grabitur disa ditë më parë. Ka në roman skena të gëzueshme dhe të gjalla ku del se, me gjithë kushtet e rënda, fshatarët e ruajnë optimizmin e tyre në jetë. Në pjesën e fundit të veprës tregohet se në mes tyre forcohet shpirti i solidaritetit, ata afrohen dhe fillojnë ta përkrahin më shumë njeri-tjetrin. Po kjo përkrahje tani fiton nota të reja, është shprehje e pakënaqësisë dhe e qëndresës së vetëdijshme kundër beut. E tillë është skena e fundit, kur ata jo vetëm i ndihmojnë Gjikes për ndërtimin e shtëpisë, por edhe përlëshen me xhandarët, që kanë ardhur t'i marrin me dhunë për të punuar angari në vilën që ngre beu.

Gjatë gjithë romanit, përmes episodesh dhe skenash të karakterit të ndryshëm, dalin disa karaktere tipike fshatarësh. Më e plotë ndër to është ajo e xha Koroveshit. Me këtë personazh autori i ka dhënë temës që trajton një tingëllim më të gjerë. Xha Koroveshi është fshatari që në të ri kish luftuar bashkë me shokët e Çerçiz Topullit dhe të Mihal Gramenos kundër turqve, me shpresën se, pasi të çlirohej Shqipëria, populli do të rronte më mirë. Shteti shqiptar u formua, por jeta e njerëzve mbeu e rëndë dhe e padurueshme siç kishte qenë edhe më parë. I hidhëruar nga kjo, xha Koroveshi e humbi besimin se fshatarët do të mund të fitonin ndonjëherë të drejtat e tyre dhe të jetonin si njerëz, ai shikon si të pashpresë çdo orvatje për t'i kundërshtuar shfrytëzimit dhe shtypjes. Me këtë gjendje shpirtërore ai del në faqet e para të romanit. «E ç'thua, more nipçe, ku mund të ngrejme ne kokë ndonjëherë: Këtu vendi është i mallkuar, edhe ne njerëzit jemi të mallkuar. Nuk mjafton kjo tokë e thatë, nuk mjaftojnë këto shkrepë e këto stralla, ja edhe beu që të na shtypi kripë mbi kokë. Çdo tjetër? E ti flet se do të vijë dita të bëhet jo kështu, jo ashtu!... Rri mos llap kot, se ka edhe më keq»¹, këto fjalë ai i thotë nipit të vet, Gjikes, në fillim të librit. Autori tregon në mënyrë të natyrshme se si dalngadalë nga fjalët e Ali Kelmendit dhe të nipit si edhe nga jehona e demonstratave antiqeveritare të atyre viteve, xha Koroveshi merr guxim dhe në

disa raste del si shprehës i pakënaqësisë së fshatit për shtypjen që i bëhet. Po në të njëjtën kohë, me këtë personazh autori tregon gjithashtu se sa të vështirë e kanë fshatarët që të çlirohen nga frika dhe nga ajo ndjenjë nënshtrimi që kishte ngulitur tek ta shtypja shekullore.

Në romanin «Ata nuk ishin vetëm» S. Spassja u orvat të krijonte dhe tipin e fshatarit që, me ndihmën e komunistëve të grupit të Korçës, i hapen sytë dhe fillon të veprojë, duke tërhequr pas vetes në rrugën e luftës së klasës edhe bashkëfshatarët e tij. Tek Gjike Shpati, autori vë në dukje se si dufi protestues i popullit, që privacionet dhe vuajtjet e pafund e kishin platitur, është gati të çajë shtresën e mosbesimit e të druajtjes, nën të cilën ziente dhe të gjejë shkrim në raste të ndryshme. Në vepër rrëfëhet se, më parë, Gjika, ashtu si fshatarët e tjerë, nuk i kishte kuptuar arsyet e peshës së rëndë të varfërisë dhe të zgjedhës së beut, edhe pse e ndjente fort këtë peshë. Kjo vinte, nga që ai besonte se bota ishte ndërtuar e tillë, që një palë të rraskapitej në punë, kurse të tjerët të gëzonin të mirat. Nga këto mendime karakteristike për fshatarësinë e shtypur patriarkale, Gjika nis të heqë dorë vetëm kur bëjë në kontakt me komunistët. Po duhet thënë se rastet, kur Gjika me ton të ashpër ia kthen fjalën beut në sy të gjithë fshatarëve, kundërshtimi i teyguximshëm për kohën që ai i bën taksidarit për të mos paguar taksat, pjesëmarrja e tij në mbledhjet e Grupit Komunist të Korçës, organizimi i djegies së kullës etj., janë ngjarjet që të kujtojnë më shumë vitet e luftës, kur fshatarët të përkrahur nga çetat partizane, çanin hambarët dhe depot e grurit që u kishte rrëmbyer shteti, u kundërshtonin bejlerëve të paguanin të dhjetat, duken pra të avancuara nga ana historike.

Romanin e përshkon konflikti popull-armiq. Autori arriti të krijonte personazhe negative mjaft të gjalla. Ata që shtypnin dhe shfrytëzonin fshatarët janë dhënë me vërtetësi, si Kapllani beu, zot i plotë i fshatit Drithas. Që në faqet e para, nëpërmjet një digresioni të gjatë, autori na njeh me të kallarën e tij, me veprat e ulëta dhe të ndyra që kishte bërë në kurriz të popullit, me karakterin e tij prej kriminelit. Kapllan beu, si përfaqësues i një familjeje të vjetër feudalësh, që kishin qenë gjithnjë me turqit dhe kishin sunduar me egërsi të madhe në ato vise, shquhet si armik i lëvizjes kombëtare.

1) S. Spasse, *Ata nuk ishin vetëm*, Tiranë 1952, f. 14.

Nën Perandorinë Otomane, ai ishte nga njerëzit më të besuar të «Baba Dovletit», dorë e djabatë e mytesarifëve dhe e valive të Korçës, të Manastirit dhe të Janinës, dhe si i tillë «Vriste e priste të gjithë ata që flisnin shqip edhe që mendonin të bënin një Arnautistan të shkëputur nga Dovleti»¹. Bashkë me bashibozukët e vet beu mori pjesë në masakrimin e dëshmorëve të Orman Çiflikut. Në rendin çifligaro-borgjez ai mbeti prapë njeri i besuar i qeverisë, deputet dhe person me influencë në rrethet e larta të regjimit. Qeveria i kishte ndërtuar posaçërisht, me të hollat e popullit, edhe një vilë në Tiranë. Krahas antipatriotizmit, në këtë personazh autori ka theksuar egërsinë prej anadollaku që ai shfaq me fshatarët, brutalitetin me të cilin fyen dhe poshtëron njerëzit. Kapllan beu është veshur gjithashtu me tiparet e njeriut shumë të ulët nga morali. Jeta parazitare që bën, ka përfutur tek ai pasione të ulëta, dëshirën për ta kaluar kohën në dëfrime dhe orgji. Janë këto veçori të gjithë klasës feudale, e cila karakterizohej prej zvetënit moral dhe prej paaftësisë për të ushtruar ndonjë rol sado pak pozitiv në jetën e vendit. Kapllan beu është vizatuar, si figurë thellësisht tipike; mentaliteti dhe psikologjia e tij, janë karakteristike për tërë shtresën së cilës i përket.

Rrako Ferra, afendikoi i fshatit, është mishërimi i veseve më të këqija të klasës së vet. Duke u dhënë njerëzve borxhe me fais shumë të lartë, ai arriti të vinte një pasuri të madhe. Kur bashkëfshatarët nuk ia kthenin të hollat në kohë bashkë me përqindjen që disa herë kalonte dyfishin e borxhit të marrë, ai u rrëmbente pa ngurim e keqardhje kopenë e dhenve, ndonjëherë edhe tokën. «Llokmaxhiu na e hëngri shpirtin», shprehen me urrejtje fshatarët për të. Rrako Ferra e ka mirë me të gjithë, me beun, me kryetarin e komunës, me postëkomandantin, me taksidarin, me priftin, me spahinë e me çdo njeri që ka një farë pushteti në dorë. Ai është ortak i tyre i ngushtë me grabitjet që i bëjnë popullit dhe me dinakëri zhvat pjesën më të majme për vete. Rrako Ferra ka një mëri të madhe për fshatarët, të cilët i quan me përbuzje «trutharë». Si vegël e Kapllan beut, ai spiunon gjithë ata që nuk duan të paguajnë «gjysmën» ose në mënyra të ndryshme u bëjnë qëndresë urdhrave të tij. Për ta

1) Po aty, f. 43.

hequr qafe Gjokë Shpatin ai s'le gjë pa bërë; arrin deri atje sa, me ndërhyrjen e beut ta burgosë. Rrako Ferra është dhënë me psikologjinë karakteristike të shfrytëzuesit të egër të popullit. Pasurinë që ka mbledhur dhe pozitën e tij të fortë, ai i shpjegon si shfaqje të «zotësisë dhe shkathtësisë» së vet në jetë, në kundërshtim me «dembellëkun» e bashkëfshatarëve. Në këto arsyeime, të cilat dalin ca si shpesh në roman, dëgjohen edhe nota të një farë pasigurie e frike të brendshme, që ai ka në vetve. Rrako Ferra është vizatuar disa herë si karikaturë; përshkrimi i veprimeve dhe i lëvizjeve të tij, plot servilizëm dhe përunjësi të neveritshme para beut, në fillim të romanit ka një theks ironik. Me tone tallëse ai është paraqitur dhe në pjesë të tjera të veprës.

Në romanin «Ata nuk ishin vetëm», krahas paraqitjes së jetës së rëndë të fshatarëve, ka mjaft pjesë të përshkuara nga fryma e një lirizmi tërheqës. Të tilla janë skenat në natyrë të dashurisë së çiltër rinore të Vasilikës dhe të Petros ose të Vitos dhe Bejkos. Ndjenjat e tyre theksohen edhe më shumë përmes përjasjes me natyrën, me peizazhin lirik të butë. Vepra ka skena e përshkrime etnografike në të cilat ka gjetur pasqyrim mënyra e jetesës së fshatarëve, doket, gëzimet, ritet e tyre tradicionale (kapitulli mbi dasmën, kremtimi i festave familjare etj.). Ato i japin veprës një pamje më të gjallë dhe më të larme.

«Ata nuk ishin vetëm» ishte vepra e parë e madhe e S. Spasses pas Çlirimit; romani zë vend me rëndësi në krijimtarinë e autorit, e cilat tashmë kish hyrë në mënyrë të sigurtë në rrugën e realizmit socialist. Mbështetja në botëkuptimin e ri e ndihmoi autorin të pasqyrojë drejt kontraktat shoqërore të epokës, rëndësinë e masave në jetën e vendit dhe rrugët e shpëtimit të tyre nga zgjedha çifligaro-borgjeze.

Herói i novelës «Për pak tokë dhe një grua» (1959) të Dh. Xhuvanit në shembullin e fatit të vet dhe të njerëzve të tij të afërt njeh padrejtësinë e rendit shoqëror të kohës. Njeri i thjeshtë nga populli, që gjithë jetën kishte ushqyer një ëndërr të

thjeshtë: të blejë një copë tokë dhe të martohet me vashën që dashuronte prej kohësh, Thimo Çavallari luftoi deri në fund për të mbrojtur të drejtën e vet për lumturi, por me gjithë këmbënguljen dhe qëndresën që shfaq, dështon në përpjekjet e tij. Fundi tragjik thekson me forcë jetën e zymtë dhe të pashpresë të masave punonjëse në regjimin çifligaro-borgjez të Zogut. Vetë karakteri dhe biografia e heroit ngërthejnë një vlerë të thellë njohëse. Subjekti i novelës, me të gjitha imtësitë dhe episodet e tij, thekson idenë e gjendjes së pasigurt të masave punonjëse, karakterin armiqësor të rrethanave shoqërore të ekzistencës së tyre, vuajtjet dhe privacionet e panumërta me të cilat ishte mbushur jeta e njerëzve të thjeshtë.

Tek Pandi, gjyqtari i ri i cili i rrëmbeu të fejuarën Thimo Çavallarit, autori deshi të paraqesë tipin e një nëpunësi të lartë, nga shtresat e pasura, të cilin nis ta vrasë ndërgjegjja kur e kuptoi se kishte vepruar në mënyrë të poshtër, duke e trajtuar vajzën e rrëmbyer si metresë. Por autori nuk mundi të motivojë sa duhet nga ana psikologjike veprimet dhe përjetimet e këtij personazhi, i cili vepron më tepër nga ana e jashtme. Në veprë ndihet një frymë melodramatike, gjë që shihet jo vetëm në faktin se autori e ka vënë Pandin në rolin e rivalit dhe të prokurorit që i ngarkohet çështja e akuzës së Thimos, por edhe në theksimin e tepruar të vuajtjeve shpirtërore të këtij të fundit pas kryerjes së krimit, si dhe në figurën e Ganiut, të Sotirit etj.

Tregimet «Ditët e sprasme të Gjergj Golemit» dhe «Fyelli i Tanës» të Dh. Shuteriqit, «Kapedani» i J. Xoxës, «Në gjolet e Gjyralës» i Dh. Xhuvanit pasqyruan ngjarjet e së kaluarës së largët.

Në «Ditët e sprasme të Gjergj Golemit» (1957) Dh.S. Shuteriqi me ngjyra të gjalla përshkroi çastet e vështira që erdhën për vendin pas vdekjes së Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriotit, përçarjen dhe dasitë që hynë tek princët, shthurjen e bashkimit të dikurshëm përballë turkut, dhe, së fundi, qëndresën e fortë të masave popullore e të një pjese të parisë së Shqipërisë ndaj ushtrive të sulltanit. Në qendër të veprës është figura e Gjergj Golemit, kryezotit të Shpatit, Çermnikës, Myzeqesë dhe Kaninës; e njerit prej komandantëve më të afërt dhe besnikë të Skënderbeut. Ai është jo vetëm luftëtari trim, por edhe udhëheqësi i urtë, me përvojë për të drejtuar njerëzit dhe çështjet e mëdha politike e ushtarake; Gjergji e ka të qartë se ku mund

ta shpjerë përçarja Arbërinë. Këtij konceptimi të figurës së Gjergj Golemit i shkon edhe portreti i jashtëm fizik që është gjithashtu madhështor dhe imponant. Gjergj Golemi është dhënë me viza heroike, të ngjashme me ato të figurave të kreshnikëve të këngëve legjendare popullore. Meritë e tregimit është krijimi besnik i atmosferës së shekullit XV, me jetën, doket dhe njerëzit.

Këtë gjë autori ka mundur ta japë me anë të përdorimit të leksikut arkaik dhe sidomos të riprodhimit të stilit të kronikave historike, me gjuhën e tyre karakteristike, plot terma të teksteve fetare dhe shprehje të ngritura soleme. Tek «Fyelli i Tanës» (1958) me historinë e Mirit dhe të Tanës, të fëmijëve të tyre si edhe të fyellit magjik, Shuteriqi tregoi optimizmin dhe ndjenjën e pastër të dashurisë, që e ka shquar gjithë popullin, shpirtin bujar, miqësinë dhe dëshirën për të bukurën, që njerëzit e thjeshtë të maleve ditën t'i lavronin e t'i ruanin si vlera shpirtërore të mrekullueshme, të cilat u ndihmuan atyre të qëndrojnë nëpër dallgët e shekujve. Ky motiv ka gjetur shtjellim të mëtejshëm edhe në përshkrimin e shpatarakëve të sotëm; në ngjyrat poetike e të ëmbla që shkrintari ka përdorur për paraqitjen e tyre, si edhe në theksimin e tipareve burrërore dhe të forta, me të cilat ata janë veshur në tregim, e që disa herë i afrojnë këta njerëz me personazhet e tregimeve epike legjendare të popullit. Ngjarrja jepet përmes fjalëve të xha Shahinit, një shpataraku të moçëm dhe të vojtur. Kjo i ka dhënë tregimit një frymë emocionale të theksuar dhe një lirizëm të qashtë.

Tipin e kaçakut e krijoi me ngjyra romantike edhe J. Xoxa tek «Kapedani» (1958). Në këtë veprë përmes historisë së çobanit, Leks Kapedanit, që vret beun për të mbrojtur nderin e familjes së vet, autori pasqyroi protestën spontane dhe urrejtjen e vegjëlisë kundër padrejtësive dhe arbitrarietetit të bejlerëve, që kanë përkrahjen e autoriteteve turke. Në tregim paraqitet edhe miratimi që gjen vepra e Leks Kapidanit tek fshatarët e tjerë, të cilët vuanin nga zullumet e beut. Me temë nga jeta e kaçakëve shqiptarë që luftonin e beut. Me temë nga jeta e kaçakëve shqiptarë që luftonin kundër turqve është shkruar edhe tregimi «Çezma e floririt» (1958) e N. Priftit. Por vëmendjen e autorit e tërhoqi jo thelbi i karakterit të kaçakëve si shprehës të protestës spontane të masave popullore, por ndjenjat e tyre vetjake. The-

melin e subjektit e formon një legjendë popullore mbi dashurinë e pafat të një kaçaku për një vashë të thjeshtë fshatare. «Çezma e floririt» ka frymën optimiste dhe qashtërsinë lirike të legjendave popullore. E pasur e plot kolorit është edhe gjuha e tregimit, që ka marrë shumë prej leksikut dhe frazeologjisë së ligjërimit të thjeshtë popullor e të krijimeve folklorike.

DRAMATURGJIA

Zhvillimi i dramaturgjisë së re është lidhur me lindjen dhe rritjen e teatrit profesionist. Më 1945 nga grupet teatrale të njësiteve partizane dhe nga aktorë të grupeve të tjera diletante krijohet në Tiranë Teatri i Shtetit (sot Teatri Popullor). Teatro të tjera dramatike u ngritën më pas në Korçë, në Shkodër, në Durrës dhe në Elbasan. Krahas kësaj pranë ndërmarrjeve, shkollave, institucioneve shtetërore, u ngritën shumë grupe teatrale amatore. Gjithë kjo veprimtari nxori problemin e repertorit të ri. Në fillim puna nisi kryesisht me pjesë autorësh të huaj, por dalngadalë me rritjen e dramaturgjisë së re, një vend përherë e më të madh zunë në repertor veprat e autorëve vendas.

Sprovat e para të dramaturgëve të sotëm ishin komedi, të cilat u hartuan në vitet 1948-1949: «Prefekti» dhe «Cani Hoxhë» të B. Levonjës, «Don Gjoni» i K. Jakovës etj. Këto vepra të vogla, prej 1-2 aktesh të thurura zakonisht mbi një subjekt të thjeshtë e të shkruar kryesisht për grupet amatore, e mirrin temën në shumicën e rasteve nga vitet e pushtimit fashist ose nga jeta e pasçlirimit (lufta kundër armiqve të pushtetit të ri, vënia në lojë e fanatizmit dhe e padijes etj). Ato patën sukses në kohën e tyre dhe lojtën një rol pozitiv për edukimin e njerëzve në frymë të re, por, duke qenë të paarritura përsa i takon anës artistike, disa syresh nuk lanë gjurmë në dramaturgjinë e re.

Ndër veprat e para dramatike, që patën jehonë të gjatë në skenë, është komedia «**Prefekti**» (1948) e B. Levonjës. Në këtë vepër autori pasqyroi përpjekjet e veglave të fashizmit italian kundër lëvizjes popullore çlirimtare. Në komedi është nxjerrë një person real, një prefekt, i cili gjatë pushtimit fashist tregoi një zell të veçantë për të shtypur qëndresën e popullit të Tiranës. Edhe ngjarjet e pasqyruara në vepër janë

reale, sigurisht, autori në procesin krijues i ka theksuar dhe zmadhuar ato, por në subjektin e komedisë ngjarjet ruajnë pothuaj atë forcë dhe mprehtësi që i shquanin në jetë.

Prefekti si tip letrar është një arritje e shënuar e B. Levonjës. Komizmi i fjalëve dhe i veprimeve të prefektit fitojnë një kumbim të gjerë në sajë të vlerës së tyre karakterizuese. Ai përfaqëson tipin e bashkëpunëtorit të urreyer të fashizmit italian, që u shërbeu këtyre me servilizëm dhe përunjësi të neveritshme. Si vegël e ndërgjegjshme e të huajit, ai i zbaton urdhrat që merr me zell të madh. Qëllimi i tij është të zhdukë lëvizjen çlirimtare antifashiste të masave popullore, tek e cila sheh rrezikun kryesor për privilegjet e klasës së vet. Është kjo pikërisht që e ka bërë të vihet në shërbim të fashistëve italianë. Sikurse të gjithë nëpunësit e lartë të regjimit fashist, ai përpiqet me çdo mënyrë që nga posti që ka të nxjerrë sa më shumë përfitime për vete. Ryshfetet, mashtrimet dhe grabitjet e njerëzve janë një nga preokupimet e tij kryesore gjatë përmbushjes së detyrave.

Prefekti është në radhë të parë mishërim i natyrës së egër dhe reaksionare të veglave të pushtuesit fashist. Por ai ka edhe vetitë e tij që i theksojnë më tepër tiparet negative të karakterit të tij shoqëror. Ai është njeri i trashë, mendjepakët dhe anadollak në shpirt. Kjo ka vënë vulën e saj në të gjithë sjelljen e prefektit, në jetën e tij intime, në marrëdhëniet me gruan, në mënyrën se si merr ryshfete, në format që përdor në veprimtarinë e tij kundër lëvizjes (nxitja e dasive fetare, përhapja e shpifjeve të ulëta kundër partizanëve etj.).

Tek prefekti kemi një përzierje komike të sigurisë së jashtme me frikën e vazhdueshme që ka ai nga partizanët, të cilët i fanepsen në çdo hap. Pikërisht ky kontrast midis mburrjeve të tij se është zot i plotfuqishëm i kryeqytetit, nga njëra anë, dhe tmerrit që e zë kur merr vesh se në Tiranë kanë hyrë fshehurazi partizanët ose dëgjon se ka shpërthyer ndonjë demonstratë antifashiste, nga ana tjetër, përcaktoi komizmin e veprës. Frika që e ndjek prefektin në çdo hap del në pah bukur në episodin e fshehjes të djalit të tij poshtë tryezës, që është një nga episodet më të goditura të komedisë.

Në veprë mungon një veprim me fillim dhe fund; subjekti formohet nga një varg skenash pa ndonjë lidhje të ngushtë dhe të domosdoshme midis tyre. Në këto skena është përfshirë e

shoqja bashkë me të birin, të cilët me fizionominë e tyre mendore e morale ndihmojnë të zbulohet në mënyrë më të plotë karakteri i prefektit si injorant, mashtrues dhe qesharak. Për karakterizimin e personazheve shërbeu sidomos ligjërimi, por ndonjëherë natyralizmat në gjuhë u përdorën për efekt të jashtëm.

Duke pasqyruar orvatjet e kota të armiqve për të penguar fitoren e masave popullore, shkrimtari tregoi se ç'përfaqësonin nga pikëpamja morale, politike dhe mendore tradhtarët, tek të cilët u mbështetën fashistët italianë. Veglat e armikut ishin antipatriotë, dallkawkë, politikanë të shitur, nëpunës reaksionarë, njerëz që jo vetëm nuk kishin kredi në popull, por edhe pa vlera intelektuale dhe morale, agallarë apo bejlerë, injorantë, që gjithë jetën kishin shtypur dhe shfrytëzuar egërsisht popullin, kriminelë ordinerë dhe njerëz të poshtër. Këtu qëndron dhe vlera shoqërore njohëse e komedisë e cila shquhet nga humori i natyrshëm.

* * *

Hap të rëndësishëm në përparimin e dramaturgjisë së sotme, shënuan veprat e K. Jakovës «Halili dhe Hajria» (1949) dhe «Toka jonë» (1954). Këto drama u shquan për thurjen e goditur të subjektit dhe për skalitje më të plotë të karaktereve.

Me dramën «**Halili dhe Hajria**» K. Jakova i pari nisi trajtimin e temës historike në letërsinë e sotme. Në themel të dramës është vendosur një ngjarje e shekullit XVIII, kënduar edhe në këngën popullore «Fryni era, u çil taraba». Halil Gërria, person historik, në krye të një grushti malësorësh trima ka ngritur krye kundër turqve, duke u prishur kështu atyre planet për nënshtrimin e Malësisë së Madhe.

Drama shquhet nga vërtetësia historike; autori ka mundur të tipizojë në frymë krijuese prirjet themelore të epokës, që është pasqyruar në dramë. Në figurën e Halilit shquajmë tiparet karakteristike të një patrioti të flakët, që nuk e duron zgjedhën e huaj, ai është trim, i urtë dhe fisnik nga shpirti. Gjëja më e shtrenjtë për të është liria; urrejtja e fortë ndaj atyre që kanë prishur qetësinë dhe punën paqësore të fshatarëve, e shtyri të rrokë pushkën dhe të dalë maleve për të luftuar armiqtë. Lufta e Halilit kundër turqve del pak në subjektin e dramës. Tiparet

e tij prej luftëtari të paepur dhe të vendosur shfaqen në mënyrë më të plotë në skenën e ekzekutimit të tij. Autori ka theksuar tek Halili entuziazmin luftarak që i ka ngjallur në shpirt çeshtja për të cilën lufton. Ky hov shpirtëror, që buron nga ideali i lartë patriotik, e bën të mos marrë parasysh vdekjen dhe t'u përplasë në sy turqve urrejtjen që ushqen për ta. Megjithëse e ka xhelatin bri vetes, Halili i jep një përgjigje sa të guximshme po aq krenare Pashës, që orvatet ta gjunjëzojë: «Luftojnë malet tona... Ky vend ash yni... Ne nuk i lajmë haraç një zoti të huaj. Nuk durojmë babën me na ra e jo ma kërbaçin e halldupit anadollak. Mos i rrudh dhambët se burri i malësisë nuk trembet».

Ideja e shpirtit të paepur të shqiptarëve, e dashurisë së flaktë të tyre për vendin, shprehet edhe në qëndrimin e bashkëluftarëve të ngushtë të Halilit, Sokolit dhe Mustës, vëllait të tij të vogël, në figurat e të cilëve spikat po ajo frymë heroizmi dhe trimërie e rrallë, si te Halili.

Luftëtarët trima zenë pak vend në veprimin e subjektit të dramës, në themel të të cilit është vënë jo lufta kundër pushtuesve turq, por orvatjet e Sulejman Pashës dhe të njerëzve të tij për të shtënë në dorë të gjallë Halil Gërrinë. Në kapjen e Halilit autori i ka dhënë një rol jo të vogël Hajrijes, e çila ndihmon kësisoj për zhvillimin e veprimit. Hajrija është pasqyruar në mënyrë të njëanshme. Në aktin e parë ajo shfaqet si gjithë malësorët e tjerë, me një urrejtje të thellë kundrejt pushtuesve të huaj, tek të cilët sheh armiqtë e vendit dhe të vëllait. Te përbuzja që ka për të fejuarën, djalin e bajraktarit të Rranzës, që është bërë vegël e turqve, ajo shfren edhe mërinë e vet për këta të fundit. Por kjo ndjenjë nuk është e thellë tek ajo. Kështu s'kalon shumë dhe Hajria shtie dashuri me Bejtash Agën, njerin nga veglat më besnike të Pashës. E verbuar nga kjo ndjenjë, Hajria harron armiqtë e të vëllait me turqit dhe pa dashur u ndihmon këtyre për të zënë Halilin. Kapja e Halilit dhe bremjet e ndërgegjes që provon e motra i japin veprës karakterin e një tragjedie. Në fillim Hajria shkel mbi detyrën e saj ndaj vendit për hir të ndjenjës vetjake, pastaj pa dashur bëhet vegël e armiqve për kapjen e të vëllait. Kjo i shkakton kontradikta të forta, që rrjedhin nga njëra anë nga pozita e saj si grua e Bejtash Agës dhe nga ana tjetër nga synimi i saj për të mbrojtur interesat e lëvizjes së patriotëve, që udhëhiqte Halili. Pasi ka kuptuar gabimin e vet, Haj-

ria merr fëmijën dhe bashkohet me shokët e Halilit që luftojnë kundër turqve. Por gjithë ky gërshetim ngjarjesh e bëri Hajrien pak të besueshme si karakter. Dhe kjo erdhi nga koncepti i autorit për dashurinë, çka bëri që Hajria t'i ngjasë shumë një heroine romantike, të rrëmbyer nga ndjenja e fortë e dashurisë që nuk njej arsye, sesa një malësoreje shqiptare të shekullit XVIII.

Duke i pasqyruar armiqtë vetëm në përpjekje për të gjetur mënyrat se si ta kapin të gjallë Halilin, autori ka arritur të zbulojë me qartësi fizionominë e tyre morale dhe shpirtërore; ai ia doli të tregojë egërsinë dhe pabesinë e turqve, të cilët janë pa skrupuj në arritjen e qëllimeve të tyre të ulëta. Në pasqyrimin e tyre K. Jakova përdori portretin kolektiv, por në të njëjtën kohë disa përfaqësues të tyre i vizatoi në mënyrë më të plotë, duke u dhënë edhe më shumë vend në subjekt. Me Bejtash Agën autori stigmatizon ata karrieristë, të cilët, për të arritur qëllimet e tyre, përdorin mjetet më të poshtra, shkelin edhe traditat më të shtrenjta të shqiptarëve, duke prerë mikun në besë. Ai është bërë njësh nga pikëpamja ideologjike e morale me turqit, duke përvetësuar veset e tyre të neveritshme: pabesinë, intrigat dhe tradhtinë. Duke pasqyruar kampin e armikut, shkrimtari demaskon thelbin mizor të pushtuesit turk, që shprehet në metodat e egra dhe të ulëta që përdornin për të thyer shqiptarët. Oborri i Pashës së Shkodrës është një fole intrigash e spiunësh, ku në çdo qoshe thuren plane të kobshme. Marrëdhëniet në mes njerëzve përcaktohen nga etja e tyre për t'u pasuruar ose për t'u ngritur më lart në hierarkinë shtetërore.

Në dramën «Halili dhe Hajria» u shfaq prirja e K. Jakovës për të thurur subjekte tërheqëse, të pasura me ngjarje dhe zotësia për të dhënë me viza të gjalla ambientin historik dhe për të krijuar personazhe me ndjenja dhe mendime karakteristike për kohën e pasqyruar në dramë. Dialogu është i shkathtë e i natyrshëm dhe shërben mirë si mjet për të karakterizuar personazhet.

TOKA JONË

«Toka jonë» është vepra dramatike më me vlerë e kësaj periudhe si përsa i takon idesë, ashtu edhe për nga thellësia e pasqyrimin realist të jetës. Ndonëse nga ana e jashtme duket sikur tema e dramës është zbatimi i Reformës Agrare dhe lufta

këmbëngulëse e fshatarëve për të thyer qëndresën e kulakut, në të vërtetë, brendia është më e gjerë se ngjarjet që shtjellohen drejtpërdrejt në dramë. K. Jakova në këtë vepër tregon se ç'forma të përcudshme merrte shtypja dhe arbitrariteti i kulakut në kushtet e jetës para Çlirimit si dhe rolin e madh çlirimtar të revolucionit popullor për njerëzit e thjeshtë.

Pasojat e sundimit të egër të të pasurve që mirrin nëpër këmbë të drejtat më elementare të njerëzve, duke u shkatërruar atyre jetën, kanë gjetur mishërim të gjallë në historinë e Lokës. Në fatin e saj shkrimtari tregon tragjedinë e parrëfyeshme të popullit nën monarkinë çifligaro-borgjeze të Zogut. Lokja është një grua e thjeshtë populli, me synime modeste në jetë. Të dy me burrin, të çilin e donte me shpirt, punonin atë copë tokë që kishin dhe jetonin në varfëri, por me nder. Por shumë shpejt, ëndrra e saj u gremis. Jeta iu rrënuar, sikurse jeta e sa e sa grave malësore të pambrojtura dhe pa përkrahje, mbi krye të cilave qëndronte si shpatë frika e çnderimit nga tekat shtazarake të pasanikut të fshatit, të kryetarit të Komunës apo të xhandarit. E dëbuar nga shtëpia e vet, pasi ia vranë të shoqin, dhe e ndjekur nga shpifjet e Tuç Makut, Lokja merr rrugën nëpër malësi duke punuar e jetuar si argate, e përvëlur nga malli për të rrojtur me familjen e vet dhe nga aspirata për një jetë të denjë njerëzore. Me gjithë mynxyrën që i ra mbi krye, Lokja nuk e lëshoi veten shpirtërisht dhe shpresën, se një ditë e drejta e saj do të dalë në shesh, nuk e humbi. Por kjo ishte bindja naive e njerëzve me paragjykime patriarkale, të cilët shpresojnë se e drejta sado që ta mohojnë, do të fitojë. Autori tregon se shpëtimi i Lokës erdhi si rezultat jo i përkrahjes së individëve të veçantë zemërmirë, por i përmbykses së gjithë asaj bote të ngritur mbi dhunën, grabitjen e pabesinë. Kjo ka gjetur shprehje në vetë subjektin e dramës, e çila në të vërtetë nis atëherë kur Lokja kthehet në fshat, duke ndier në mënyrë të paqartë në ndërgjegjen e vet, se me Çlirimin i erdhi fundi tragjedisë së saj. Duke na njohur me historinë e dhimbshme të Lokës dhe me përpjekjet e saj e të djalit të vogël Murrashit, për të zënë vendin e vet sërish në shoqëri, autori zbulon thelbin human të rendit të ri, i cili i ktheu njeriut të thjeshtë dinjitetin, duke e çliruar nga fyerjet dhe poshtërimet me të cilat ishte plot jeta e paraçlirimit. Rëndësia e madhe e ndryshimeve që epoka e re solli në jetën e fshatarëve zbulohet në fjalët e vetë Lokës:

«M'u duk vetja si n'andërr. Të gjithë këta bujq të shkretë po marrin tokë. U ka ndryshue fytyra. Ecin ma serbes. Ka hikë frika nga kasollet e bujqve. Të flasin për Tuç Makun si për një qen të zgjebosur»¹. Lokja e kupton se Çlirimi i vendit nuk i ka sjellë vetëm asaj shpëtim, por gjithë njerëzve, që si ajo, vuanin nën thundrën e të pasurve, nën frikën e turpit dhe të urisë. Bindja se pushteti popullor është i saj, e ndihmon të ngrihet në një shkallë më të lartë të vetëdijes shoqërore. Drama mbyllet me fjalët e Lokës që ritheksojnë më me forcë idenë themelore, çlirimin shoqëror dhe shpirtëror të njeriut të popullit, që rilind për një jetë të vetëdijshme dhe krijuese: «Murrash i nanës, sa e bukur asht kjo fusha jonë, vendi ynë, toka jonë»².

Nga ana e jashtme mund të duket se drama ka konflikt familjar, në të vërtetë nuk është ashtu; konflikti që ka shpërthyer në familjen e Gjokajve pasqyron një konflikt të gjerë shoqëror, qëndresën e masave të varfra fshatare kundër shfrytëzuesve të tyre. Në karakterin e Tuç Makut autori ka theksuar egërsinë e klasave shfrytëzuese, dinakërinë e tyre dhe mungesën e plotë të skrupujve në rrugët që ndiqnin për të shtypur dhe për të mbajtur nën zgjedhë vegjëlina. Ai përfaqëson botën e errët të së kaluarës, botën e gjakpirësve dhe të shushunjave të masave të varfra. Me kërcënime, dhunë e mjete të tjera, ai ka mundur të grumbullojë në duart e veta tokat më të mira dhe, duke shfrytëzuar ngushticën e madhe për bukë që kanë fshatarët, ia ka dalë të fusë nën vete shumë njerëz. Zotërimi i një pasurie të madhe e fuqia që i ka dhënë kjo, ka bërë që Tuçi të mos u njohë kufi veprimeve të veta. Për të arritur qëllimet e tij, ai nuk kursen asgjë, bile edhe jetën e atyreve që i prishin punë. Historia e Lokës hedh dritë të plotë mbi karakterin e tij prej grabitqari dhe kriminel. Fizionomia shoqërore e Tuç Makut, si armik i egër i fshatarësisë së varfër, del në mënyrë më të qartë në veprimet që ndërmer pas Çlirimit për të mbrojtur interesat e veta si klasë. I egër dhe dinak, ai zhvillon një veprimtari të gjerë kundër masave të pushtetit popullor, duke kurdisur intriga nga njëra anë dhe nga ana tjetër duke vepruar së bashku me të gjithë

1) K. Jakova, *Toka jonë*, Dramë në katër akte, Tiranë 1955, f. 36.
2) Po aty, f. 76.

armiqtë e rendit të ri. Ndonëse në pamje të jashtme Tuç Maku e paraqit veten të qetë, zhvillimi i ngjarjeve e bën të humbë sigurinë në vetvete. Ai e kupton sa vjen e më tepër se po i afrohet fundi. Kjo e bën ngaditë më të egër e më brutal. Mbështetja në kriminelët e arratisur për tërheqjen e kafshëve të punës, përpjekja për ta bërë Murrashin për vete dhe pastaj vendimi për ta zhdukur, orvatjet për vrasje të tjera, — të gjitha këto tregojnë se, si përfaqësues i klasave sunduese, ai do të kryejë shumë krime përpara se të largohet nga skena.

Lufta për rehabilitimin moral dhe kthimin e Lokes në shtëpi, bëhet jo vetëm kundër Tuç Makut, po edhe brendapërbrenda familjes së Gjokajve. I verbuar nga besimi që ka ndaj Tuçit dhe i lidhur me normat patriarkale të jetës, Leka nuk e shikon drejt çështjen e konfliktit të Lokes me Tuç Makun. Për shumë kohë, ai sillet keq me nënën dhe kundërshton me ngulm që ajo të pranohet në shtëpi. Edhe pas letrës që mori nga Murrashi, Leka në thelb nuk ka ndryshuar mendim për Loken. Vetëm në aktin e dytë, kur Murrashi zgjidh lëmshin e ngatërruar me vjet dhe zbulon para të gjithëve prapaskenën e veprimeve të poshtra të Tuç Makut, Leka e kupton se ç'rol të pahijshëm kishte lojtur në këtë histori të shëmtuar. Autori tregon se sa të vështirë e ka Leka të çlirohet nga paragjykimet e vjetra morale, pushteti i të cilëve është ende i fortë në shpirtin e tij.

Fundi i ndeshjes së ashpër që zhvillohet midis kulakut e veglave të tij dhe bujqve të varfër, tashmë dihet; fitorja është në anën e këtyre të fundit. Vendosija e rendit popullor zgjoi energjitë aktive, që flinin prej shekujsh në gjirin e masës. Në fshatrat e Bregut të Matës, dikur të drojtura e të humbura, janë shfaqur njerëz të rinj, të guximshëm, të zhveshur nga paragjykimet e vjetra shoqërore, që kishin gozhdur energjitë e vegjëlisë. I tillë është Murrashi, udhëheqësi i masës së varfër fshatare. Tek ky personazh autori ka pasqyruar njeriun e ri të fshatit të këtyre anëve, i cili pasi flaku tej verigat e moralit patriarkal, lufton gjithë entuziazëm kundër botës së vjetër. Murrashi dallohet për vetëdije të larta klasore dhe pjekuri politike. Ushtria e kaliti dhe e bëri komunist. Fizionomia e tij si njeri me frymë partie shfaqet në qëndrimin që mban ndaj çështjes, që i shqetëson bashkëfshatarët, reformës agrare, dhe në mënyrën si i zgjidh mosmarrëveshjet që zienin prej kohësh në familjen e tij. Këto dy probleme ai i sheh si një të vetëm, si shprehje të veçantë të

luftës së klasës që zhvillohet në fshat. Për të Tuç Maku është armiku i klasës, shtypësi dhe shfrytëzuesi i gjithë fshatarëve të varfër, dhe pastaj, si i tillë, edhe armik i familjes së tij.

Problematika e gjerë e dramës «Toka jonë», (gjendja e rëndë e fshatarëve në të kaluarën, format e ndryshme të shtypjes së egër të kulakut, roli frenues i paragjykimëve të vjetra shoqërore, shpëtimi i fshatarësisë me ngadhënjimin e revolucionit popullor, lufta e klasave pas Çlirimit, Reforma Agrare etj.) ka përcaktuar edhe kompozicionin e subjektit. «Toka jonë» ka një ndërtim të veçantë; në kornizën e dramës ka hyrë pjesa e fundit e veprimit, ajo pjesë ku konflikti, i cili ka filluar shumë kohë më parë jashtë dramës, po i afrohet zgjidhjes. Kjo ka bërë që në dramën «Toka jonë» të ketë pak lëvizje dhe veprim të jashtëm, dhe një rëndësi të madhe të marrë plani retrospektiv, në të cilin ka gjetur vend e tërë parahistoria e ngjarjes, që ka formuar subjektin e pjesës. Në aktin e parë që zë afro gjysmën e veprës, janë ekspozuar fakte dhe çështje, zhvillimi i të cilave do të formojë brendinë e akteve të ardhshme dhe janë nxjerrë pothuajse gjithë personazhet kryesore, por në të njëjtën kohë aty lexuesi nis të njihet me historinë e marrëdhënieve në mes Lokes dhe Tuç Makut, me parahistorinë e konfliktit shoqëror që formon themelin e konfliktit të veprës. Pas ekspozimit, veprimi ecën me shpejtësi drejt zgjidhjes së konfliktit. Kjo shihet në gjithë aktin e dytë, ku lëmshi i ngatërresave në familjen e Gjokajve fëtohet dhe nga fytyra e Tuç Makut bie maska që kishte vënë. Të dy aktet që vijnë, tregojnë se si pas demaskimit të kulakut zhvillohen ngjarjet, se si armiqtë ndahen mënjanë dhe tërbohen kundër fshatarëve, se si Tuç Maku organizon vrasjen e Murrashit dhe më në fund kapet nga vetë populli.

Karakteri i dramës me konflikt të mprehtë shoqëror ka përcaktuar edhe ndërtimin e figurave, të cilat zbulohen në planin e kontradiktave që përshkojnë jetën e fshatit. Autori ka lënë në figurat e heronjve të dramës atë që është më thelbësore për ta, si mishërim i vetive dhe i prirjeve të karaktereve sociale që përfaqësojnë. Kjo ka bërë që figurat e personazheve kryesore, si Lokja, Tuç Maku etj. të vizatohen me ngjyra të ngjeshura, me theksimin e asaj që është tipike për ta. Megjithëse drama nuk ka ndonjë veprim të pasur me lëvizje dhe episode të ndryshme autori ka mundur t'i karakterizojë ato në mënyrë bindëse duke u vënë në gojë një gjuhë shumë të individualizuar.

Mjeshtëria e K. Jakovës u shpreh sidomos në ndërtimin e dialogut, i cili ndonëse lakonik dhe konciz tejmasë, është plot dramatikizëm, gjë që lejon të zbulohen me qartësi veçoritë e karaktereve.

* * *

Në qoftë se në periudhën e parë, dramaturgjia ecën rryshëm dhe vepra ka pak, duke nisur nga mesi i viteve 50, ajo shkon më tutje në rrugën e vet. Konkursët letrare të shpallura me raste përvjetorësh të ndryshme, dhanë dorë që të dalin vepra të reja dramatike dhe radhët e autorëve të shtohen me emra të rinj. Në këtë periudhë bëhen të njohur S. Pitarka, S. Çomora, N. Luca, D. Bubani, V. Ziko etj. Rrethi i temave dhe i subjekteve zgjerohet mjaft; por vendin qendror e zë tema e Luftës Nacionalçlirimtare. Në këtë kohë u shkruan një varg pjesësh dramatike dhe skeçesh, në të cilat u pasqyruan aspekte të ndryshme të luftës popullore kundër pushtuesve fashistë, zgjimi i masave nën ndikimin e ideve të reja etj. por, me të meta jo të vogla, si skematizmi, zbehtësia e figurave të personazheve, mungesa e veprimit ose thurja e tij e dobët etj. Shumica e tyre nuk patën jetë të gjatë. Drama që zuri vend në repertorin e teatrove është «**Familja e peshkatarit**» (1955) e S. Pitarkës. Autori i veprës i vuri si qëllim vetes të pasqyrojë konfliktin që ka lindur në gjirin e një familje punonjësish lidhur me qëndrimin ndaj luftës kundër pushtuesve të huaj, konflikt që e ka ndarë atë më dysh. Shumica e familjes merr pjesë në radhët e lëvizjes popullore antifashiste, përveç djalit të madh, i cili qëndron në anën e kundërt të barrikadës. Vepra e S. Pitarkës është thurur si kronikë në të cilën fiziollohen në familje. Personazhet kryesore në dramë janë: Dini, marangoz, pjesëmarrës aktiv i lëvizjes, dhe vëllai i tij i madh, Selimi, tipi i njeriut me shpirt të zbrazët, që mendon për vete. Dini vepron pak në dramë, por nga çka thotë dhe bën, dalin në pah veçoritë kryesore të karakterit të tij, si besnikëria e lartë ndaj çështjes së çlirimit të popullit, qartësia e synimeve dhe guximi që shfaq në plotësimin e detyrave të tij. Gjakftohtë, i përmbajtur, me vullnet të hekurt, ai di të orientohet në çdo situatë, sado e koklavitur qoftë ajo. Kjo anë e karakterit të tij

del qartë sidomos në skenën kur merr vesh se për shkak të kallëzimit të një provokatori shokët e tij rrezikohen të kapen prej policisë italiane. Në këtë skenë krahas guximit shfaqet edhe dashuria e tij për shokët, ndjenja e solidaritetit revolucionar.

Dini ka autoritet tek Petriti, vëllai më i vogël, dhe te e motra, të cilët në sajë të punës së tij marrin pjesë në lëvizje dhe më pas hidhen në radhët partizane. Ai arrin të fusë besim në fitoren mbi armiqtë edhe te i ati, i cili ndonëse e do vendin dhe ruan në shpirt një urrejtje të thellë për armiqtë, në fillim tregohet skeptik në mundësitë e popullit për të shporrur armiqtë nga vatra e vet.

Te Selimi autori ka dashur të japë njeriun, që nuk ushqen asnjë ndjenjë dhe aspiratë fisnike. I shturur nga ana morale, ai mendon vetëm për të plotësuar dëshirat dhe endjet e tij të ulëta. Egoizmi dhe zvetënimi moral e shpirtëror shkojnë tek ai njësh me kozmopolitizmin, me përbuzjen për popullin shqiptar, dhe me nënshtrimin ndaj çdo gjëje të huaj. Kjo ka përcaktuar edhe qëndrimin e tij ndaj lëvizjes popullore antifashiste, për të cilën shprehet me përbuzje dhe madje me urrejtje. Për këtë arsye bën çmos për të larguar vëllezërit e tij nga ndikimi i saj. Pasojë logjike e këtij qëndrimi është edhe vënia e tij në mënyrë të vetëdijshme në shërbim të kuesturës fashiste. Mirëpo autori nuk zbuloi me qartësinë e duhur tek heroi thelbin e tij. Me një të kaluar enigmatike, Selimi ka dalë i pamotivuar sa duhet nga ana psikologjike dhe shoqërore. Disa skena, sidomos ato që zbulojnë marrëdhëniet e tij me Vehipin dhe me Shemen, e afrojnë atë me heronjtë tradicionalë melodramatikë.

Ideja e dashurisë së flaktë të masave popullore për vendin, që formon strumbullarin e veprës, është shprehur edhe përmes karakterit të kryetarit të familjes së Brugajve, dhe të detarit të vjetër, xha Shazos. Jonuz Bruga është dhënë me viza që paraqesin interes nga ana njohëse. Ai është përfaqësuesi i vegjëlisë që ka provuar në kurriz të gjitha të këqijat e shoqërisë me klasa. Ai ushqen një urrejtje të thellë për pushtuesit fashistë, por shtypja e rëndë shoqërore dhe ekonomike ka topitur tek ai shpresën se populli do të shpëtonte ndonjëherë nga armiqtë e tij. Autori tregon se lufta çlirimtare, e cila përfshiu në radhët e veta nga ditë e më shumë shtresa të gjera të popullit, ngjalli në ndërgjegjen e Jonuz Brugës besimin se këtë herë masat do të sigurojnë lirinë dhe pavarësinë e vërtetë, për të

cilën kishte derdhur kaq gjak në të kaluarën. Duke e nëmur Selimin si tradhtar, ai në të njëjtën kohë merr në mënyrë të vendosur anën e Dinit dhe të Petritit.

Fryma patriotike shquan edhe shokun e tij, xha Shazon, i cili i jep uratën dhe e nis djalin e tij në mal, tek partizanët. Xha Shazoja i urren thellë fashistët dhe i bëhet zemra mal kur merr vesh për forcimin e lëvizjes çlirimtare të masave popullore. Besimi i patundur në fitoren e shpejtë mbi armiqtë përbën tiparin kryesor të karakterit të tij.

*
*
*

Pas Çlirimit, krahas ecjes përpara të ndërtimit socialist, fitoi rëndësi të posaçme problemi i brumosjes tek njerëzit i një ndërgjegjeje të re morale. Pajisja e masave me tiparet e moralit komunist ishte një proces i vështirë, që po realizohej në luftë të pareshtur me mentalitetet e vjetra, karakteristike për shoqërinë me klasa. Letërsia, qoftë duke pasqyruar Luftën Nacionalçlirimtare, qoftë duke paraqitur vrullin e punës ndërtimtare, bënte një punë të madhe për edukimin e njerëzve me mendime dhe ndjenja, të çliruara nga njollat e shoqërisë së vjetër. Por me thellimin e luftës për hedhjen e bazave të shoqërisë së re, shkrimtarët u kushtuan vëmendje përherë e më të madhe edhe problemeve të edukimit moral të njerëzve. Kujdes trajtimit të kësaj teme i vuri sidomos dramaturgjia.

Patosi i dramës «**Motra Katerinë**» (1959) e V. Zikos qëndron në demaskimin e individualizmit mikroborgjez, të egoizmit dhe të prirjes për jetë parazitare. Megjithëse në dramë tregohet një ngjarje e ngushtë familjare — është fjala për mosmarrëveshjet që lindin në një shtëpi punonjësish për shkak të nuses së djalit — struktura e veprës është përcaktuar nga fakti se ajo ka karakter të mprehtë ideologjik. Problemi kryesor i veprës sqarohet përmes qëndrimit të personazheve ndaj çështjeve themelore që i shqetësojnë, veçanërisht ndaj çështjes së zgjedhjes së profesionit, të rrugëve për sigurimin e lumturisë në jetë etj. Individualizmi shikohet në dramë si shfaqje e mentalitetit të huaj, bartësit e të cilit janë njerëz të rritur në një atmosferë ku njerëzit mendojnë për vete dhe përpiqen të sigurojnë favore nga jeta pa i merituar ato (Vali, Leti). Në karakterin e Valit, nuses së

shtëpisë, spikatin me qartësi të madhe tipare që ngjallin tek lexuesit neveri, si individualizmi i tërbuar, zbrazëtia shpirtërore dhe përbuzja për punën. Ideali i saj është një jetë e rehatshme, e zhytur në kënaqësi të vogla. Kur vendosi për t'u martuar, ajo mendoi më shumë për të gjetur një burrë që t'i siguronte një komoditet tipik mikroborgjez, një jetë të kufizuar brenda mureve të shtëpisë, një jetë meskine. Edhe në se do që burri të ketë sukses dhe të bëhet gazetar i shquar, kjo dëshirë lind tek ajo sepse në këtë mënyrë shpreson të përmbushë aspiratën e saj për jetë të rehatshme, duke mos zhvilluar asnjë punë të dobishme për shoqërinë. Thelbi i karakterit të saj duket në mënyrën se si u martua dhe sidomos në rrugët dhe mjetet që përdor për ta «shpëtuar» motrën e vet nga emërimi si mësuese në fshat. Këto imtësi zbulojnë tek ajo mungesën e parimeve morale, pranimin e leverdisë si qëllim të jetës. «Në jetë duhet pranuar çdo gjë që të sjell leverdinë më të vogël», — pohon ajo me cinizëm. Pretendimi i saj për jetë të rehatshme e me komoditet buron nga ideja që ka për veten si individ i jashtëzakonshëm, si njeri me aspirata të larta në jetë, të cilat nuk ia kuptojnë dhe nuk ia çmojnë të tjerët. Kjo bashkohet tek ajo me foddullëkun, me përbuzjen që ka për masat punonjëse, për njerëzit e thjeshtë të cilët i shikon si njerëz të një kategorie «të ulët», të mësuar me privacione materiale, si njerëz që duhet të sakrifikohen për «të zgjedhurit» si ajo dhe e motra e saj.

Autori e dënon Valin si tip shoqëror, dëshirat dhe aspiratat e saj i shikon si të huaja për shoqërinë socialiste, por në të njëjtën kohë ai shpjegon edhe pse këta tipa kanë, qoftë edhe për një farë kohe, sukses në jetë. Me pamjen e tyre të jashtme tërheqëse, me pozat prej njeriu me botë të pasur shpirtërore, ata arrijnë të gënjejnë njerëzit diktonde pas fjalëve të mëdha për cili nuk qe, në gjendje të diktonte pas fjalëve të mëdha për diçka «të ndritur» fytyrën e urryer të Valit. Andoni nuk është vetëm njeri i butë dhe pa vullnet; ai është pakëz edhe ambicioz dhe ka etje për lavdi personale. Është pikërisht kjo pikë e dobët e karakterit të tij, që e shfrytëzon Vali, duke e bërë atë për vete. Për autorin Andoni, me gjithë të metat, nuk është njeri i humbur; skena e fundit e dramës sugjeron idenë se ai nisi të hapte sytë dhe të kuptonte se ç'ngjau në shtëpinë e tij.

Valit, me moralin e saj prej individualisteje të tërbuar, në dramë i kundërvihet nëna e Andonit, Thomaidha, Pandi, shoku i

ngushtë i tij, dhe sidomos Katerina. Të gjithë këta dalin si bartës të moralit të shëndoshë popullor. Katerina është e reja e ditëve të sotme, e brumosur me parime dhe koncepte të reja. Në karakterin e saj autori theksoi sidomos modestinë në jetë dhe dashurinë e sinqertë për të afërmit për të cilët sakrifikon edhe të ardhmen e saj, siç vepron kur i sëmuret nëna. Katerina bëhet një personazh akoma më tërheqës edhe me një anë tjetër të shpirtit të saj: me mënyrën se si e kupton jetën, me optimizmin dhe besimin që karakterizon mendimet dhe veprimet e saj. Në kundërshtim me Valin dhe të motrën e saj, Letin, ajo e do punën; Katerina jo vetëm që nuk sheh asgjë fyese në profesionin e punëtores së trikotazhit, por shkon të punojë gjithë dëshirë në fabrikë.

Brendinë e rëndësishme të veprës autori e ka zbuluar përmes pasqyrimin të qëndrimit të personazheve ndaj çështjes së cili është kuptimi i jetës, përmes paraqitjes së mendimeve dhe të synimeve të tyre. Vepra ka shumë skena të cilat, po të merren më vete, duket sikur nuk lozin ndonjë rol në zhvillimin e veprimit, por ato kanë rëndësi sepse në mënyrë graduale zbulojnë tiparet thelbësore të personazheve. Egoizmin e Valit autori e ka nxjerrë në pah kryesisht duke e bërë atë të shprehë hapur pikëpamjet e veta mbi jetën, mbi martesën etj. Ky mjet në vizatimin e figurës së Valit mban me vete nëntekst ironik. Veçori tjetër karakteristike e dramës «Motra Katerinë» është mënyra e qetë me të cilën shtjellohet veprimi nga ana e jashtme. Ngjarjet rrokullisen me ngadalë, pa përpjekje dhe tronditje, por në të vërtetë vepra ka një konflikt dramatik. Gjatë zhvillimit të veprimit kemi ndeshjen e koncepteve, shprehive dhe shijeve të kundërta, përplasjen e dy moraleve të kundërta, që nuk puqen në asnjë pikë dhe që shprehin qëndrime krejt të ndryshme ndaj problemit themelor që shqetëson heronjtë, qëllimit të jetës dhe mënyrës si duhet kuptuar ajo. Merita e autorit është se, duke mos u tërhequr nga fryma sentimentaliste banale, arriti të japë një dramë realiste me brendi shoqërore të rëndësishme. E metë e dramës është zbulimi i pamjaftueshëm i mendimeve dhe i ndjenjave të personazheve kryesore.

Në gjysmën e dytë të viteve 50 tema historike nis e rrihet edhe në dramaturgji. Në këtë kohë u botuan dramat «Shtatë shaljanët» e N. Lucës, «Trimi i mirë me shokë shumë» e

S. Pitarkës, etj. të cilat bënë objekt pasqyrimi ngjarje të ndryshme të së kaluarës.

Në dramën «Shtatë shaljanët» (1958) N. Luca synoi të tregojë trimërinë dhe shpirtin liridashës të malësorëve. Historia që është vënë në themel të subjektit i përket fillimit të shek. XIX, kur Ibrahim Pashë Bushati kërkoi nga malësitë e Veriut që t'i jepnin ushtarë për sulltanin. Konfliktin e veprës e shquan fryma dramatike, e cila përcaktohet nga qëndresa e malësorëve, të cilët nuk pranojnë në asnjë mënyrë që t'u rrëmbejnë të drejtat që i kishin fituar me luftëra të parreshtura. Nga personazhet që përfaqësojnë malësorët, shquhet Deli Pjetra, tek i cili autori pasqyroi malësorin trim, plot dashuri për vendin, fisnik. Ai është i vendosur në përpjekjet e tij për të ruajtur të paprekur autonominë, që gëzonte malësia dhe lidhur me këtë çështje nuk pranon asnjë kompromis me armikun ose njerëzit e mashtruar prej tij. Kur ngjarjet e vënë në krye të malësorëve kryengritës, Delia i udhëheq ata me guxim dhe vendosmëri kundër planeve djallëzore të sulltanit dhe veglës së tij, Ibrahim Pashë Bushatit.

Kundërshtimi që shaljanët i bëjnë urdhrin të sulltanit nuk është paraqitur si një episod i veçantë i asaj kohe, por si shfaqje karakteristike e asaj pakënaqësie që vlonte prej kohësh në gjirin e popullit ndaj sundimit të egër turk. Në dramë kjo ka dalë përmes disa personazheve që luajnë rol të caktuar në zhvillimin e veprimit dhe zbulimin e idesë, siç janë Osmani, armatar shkodran, i biri i tij Ahmeti, Tringa dhe Mrija etj.

Duke folur për qëndresën burrërore të malësorëve autori vë në dukje edhe rrethanat e vështira në të cilat e zhvillojnë malësitë e Veriut luftën e tyre për të mbrojtur privilegjet që u jipte autonomia. Pikërisht për të kuptuar këtë anë të jetës së kohës shërben një personazh me interes në dramë: Vuksan Gjoni. Vuksani është njeri i ndershëm dhe trim, sikurse të tjerët edhe ai e çmon si gjë shumë të shtrenjtë lirinë që gëzonin malësorët, por mendon se autonomia e Shalës mund të ruhet edhe pa derdhur gjak, vetëm duke bërë disa lëshime. Ky qëndrim, që e vë atë në opozitë të përkohshme me bashkëfshatarët, ishte rezultat i ndikimit të Ibrahim Pashë Bushatit, të cilit i besonte si pasardhës i Karamahmutit dhe si shqiptar, prandaj dhe pranon të shkojë në emër të pashës për të bindur malësorët për të dhënë ushtarë për sanxhakun e Shkodrës. Zhvillimi i

litetin shoqëror dhe krahas theksimit të anës shoqërore të karaktereve të pasqyruara.

Forcimi i letërsisë shqiptare në pozita të reja ideore dhe artistike u bë gjatë përvetësimit nga ana e krijuesve të realitetit të ri historik. Për shkaqe të njohura kryet e vendit në këtë periudhë e zuri tema e Luftës Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre. Vëmendjen e shkrimtarëve e tërhoqën aktet heroike të njerëzve të thjeshtë, të partizanëve dhe të komunistëve, cilësitë e reja që u shfaqën në ndërgjegjen e tyre nën ndikimin e ideve të luftës dhe të përpjekjeve të popullit me armiqtë. Më pas, me fitimin e pjekurisë së domosdoshme ideore dhe artistike, krijuesit i vunë vetes detyra më të ndërlikuara. Ata synuan të hetonin ligjë-soritë historike që çuan në ngadhënjimin e revolucionit popullor; lidhur me këtë iu kushtua vëmendje pasqyrimin të konflikteve politike dhe shoqërore, që përshkuan vendin në vitet e pushtimit fashist. Kuptohet se kjo ishte detyrë e madhe artistike. Shkrimtarët treguan antipatriotizmin e klasave të larta shfrytëzuese, bashkëpunimin e tyre politik dhe ushtarak me armiqtë, rolin e madh historik të komunistëve, punën e gjerë që zhvilluan ata për edukimin dhe mobilizimin në luftë të masave të gjera popullore etj. Përkrah temës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, iu kushtua kujdes edhe pasqyrimin të ndërtimit të jetës së re. Në fillim mbisunduan veprat në të cilat u shpreh entuziazmi i punës ndërtimtare që kishte përfshirë vendin, përpjekjet e njerëzve për të plotësuar detyrat e tyre, lufta e klasave që përcillte ngritjen e jetës socialiste. Më pas, përveç paraqitjes së fakteve të ndryshme të jetës, shkrimtarët synuan të tregojnë botën e brendshme të njerëzve, luftën midis mbeturinave të mentalitetit të vjetër dhe botëkuptimit socialist. Këtë detyrë krijuesit rrahën ta zgjidhjin sidomos me lëndën që ofronte shndërrimi revolucionar i fshatit, procesi i vështirë i riedukimit të fshatarit, i shkëputjes së tij nga mentaliteti dhe psikologjia e pronarit të vogël, me lëndën që ofronte në përgjithësi lufta për formimin e individit socialist.

Me gjithë përpjekjet për të pasqyruar në mënyrë sa më të gjerë ngritjen e shoqërisë së re, letërsia e marrë në tërësi mbeti prapa nga ritmet e zhvillimit të jetës. Nuk u arrit të pasqyroheshin në veprat letrare shumë aspekte dhe dukuri të rëndësishme të shndërrimit socialist të vendit. Sidomos pak u bë për

të pasqyruar jetën dhe përpjekjet e klasës punëtore, punën e saj heroike në objektet e mëdha industriale. Edhe disa momente të rëndësishme të jetës së fshatit shqiptar, si zbatimi i Reformës Agrare, ngritja e kooperativave të para bujqësore dhe lidhur me këtë futja e mënyrës së re të të jetuarit dhe të punuarit, kapërcimi i traditave dhe i zakoneve të vjetra etj. nuk gjetën pasqyrimin e tyre në veprat artistike. Kjo shpjegon faktin pse pati pak personazhe të gjalla dhe të plota që mishëronin në karakterin e tyre veçoritë thelbësore të njeriut të përparuar të kohës, të përfaqësuesit të klasës punëtore dhe të fshatarësisë kooperativiste, të komunistit dhe të drejtuesit të masave.

Letërsia në këtë periudhë u bë më e larmishme si në lloje letrare ashtu edhe në mjete e forma të shprehjes artistike. Kjo erdhi me zgjerimin e përvojës jetësore të vetë letërsisë, e cila synoi ta përfshinte në mënyrë më të plotë realitetin socialist. Kjo sollti me vete përdorimin e mjeteve dhe të formave më të ndryshme artistike. Brezat e ndryshëm të krijuesve, në përputhje me përvojën e tyre jetësore, me prirjet individuale dhe me interesat e tyre artistike, kontribuan për ta bërë më të larmishme pamjen e letërsisë. Përpjekjet për ta pasuruar letërsinë u shtuan sidomos duke nisur nga gjysma e dytë e viteve 50, me ardhjen e një vargu talentesh të reja, të cilat me krijimtarinë e tyre i zgjeruan në mënyrë të ndieshme mundësitë shprehëse të letërsisë shqiptare të realizmit socialist duke përtërirë stilistikën, gjuhën dhe mjetet letrare. Përpjekja për të gjetur forma dhe mënyra të reja të pasqyrimin artistik formon një nga tiparet karakteristike të letërsisë së sotme, e cila nuk mbeti në arritjet e mëparshme, por u përpoq të përtërihej dhe të pasurohej krah për krah me zhvillimin dhe pasurimin e jetës.

Ngadhënjimi i plotë i realizmit socialist në letërsinë shqiptare, përpunimi i formave dhe i mjeteve artistike që dhanë dorë për paraqitjen në mënyrë të plotë dhe me ngjyra të gjalla të brendisë së re të jetës, ardhja e penave të reja krijuan mundësitë për zhvillimin me ritme më të shpejta të krijimtarisë letrare. Kjo periudhë mund të shikohet si koha kur letërsia e re grumbullon forcat për një zhvillim më të vullshëm në të ardhmen. Dhe me të vërtetë, në vitet 60-70 u vërejt një rritje e rëndësishme sasiore dhe cilësore e letërsisë së realizmit socialist, e cila zbuloi në mënyrë më të plotë aftësitë e saj krijuese. Brendia dhe forma e saj pasurohet në lidhje të ngushtë me zhvillimin e gjithanshëm të shoqërisë shqiptare.

KREU III

LETËRSIA SHQIPTARE E PERIUdhËS SË FORCIMIT DHE TË PASURIMIT TË REALIZMIT SOCIALIST

(1961-1973)

1

Forcimi dhe pasurimi i mëtejshëm i letërsisë së realizmit socialist përkoi me periudhën kur vendi hyri në fazën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, kur krahas zhvillimit dhe thellimit të revolucionit socialist në të gjitha fushat Partia dhe vendi u angazhuan në luftë të ashpër kundër tradhtisë së revizionistëve modernë.

Kongresi IV i Partisë, që u mbajt në shkurt të vitit 1961, nxori konkluzionin se baza ekonomike e socializmit u ndërtua si në qytet ashtu edhe në fshat, se me fitoren e marrëdhënieve socialiste në prodhim u zhdukën klasat shfrytëzuesë dhe mbetën dy klasa mike, klasa punëtorë dhe fshatarësia punonjëse. Shndërrimet e thella ekonomike dhe shoqërore, puna e lirë socialiste, në procesin e së cilës formohet dhe kalitet njeriu, veprimtaria edukuese ideologjike e Partisë sollën ndryshime të dukshme edhe në figurën morale të njeriut tonë të ri, në qëndrimin e tij në punë, në shoqëri dhe në familje. Me ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit, vendi hyri në një etapë të re historike — në etapën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Kongresi përcaktoi detyrat e etapës së re, përmbushja e të cilave do të shënonte një hap të rëndësishëm përpara në ndërtimin e bazës materialo-teknike të socializmit, do të shpejtonte shndërrimin e Shqipërisë nga një vend agraro-industrial në një vend industrialo-agrar, do të çonte në ngritjen më tej të nivelit material dhe kulturor të masave punonjëse.

Puna ndërtimore e masave të popullit u zhvillua në re-

thana jashtëzakonisht të ndërlikuara ndërkombëtare. Veprimtarisë armiqësore të imperialistëve anglo-amerikanë dhe shërbëtorëve të tyre, të cilët bënin çmos për të sabotuar ndërtimin socialist në Shqipëri dhe për të përgatitur agresion kundër saj, iu shtuan presioni, ndërhyrja dhe sabotimet e revizionistëve modernë, me revizionistët sovjetikë në krye. Në bashkëpunim me imperialistët, revizionistët modernë ngritën një bllokadë të egër ekonomike, për të mbytur socializmin në Shqipëri, por planet e tyre dështuan. Me gjithë vështirësitë që u krijuan nga rrethimi imperialisto-revizionist, ndërtimi socialist në Shqipëri vijoi pa ndërprerje. Shantazheve dhe presioneve të armiqve masat punonjëse iu përgjigjën duke shumëfishuar përpjekjet për përmbushjen e detyrave të planit dhe duke shtrënguar edhe më shumë radhët rreth Partisë dhe Komitetit të saj Qendror. Uniteti i çeliktë i popullit me Partinë u ngrit në një shkallë edhe më të lartë.

Kongresi V i Partisë, që u mbajt në nëntor të vitit 1966, kishte si bosht kryesor çështjen e revolucionarizimit të mëtejshëm të jetës së vendit mbi bazën e zhvillimit dhe të thellimit të revolucionit ideologjik dhe kulturor. Entuziazmi patriotik, që lindi në kushtet e luftës kundër bllokadës për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit socialist, u ngrit pas Kongresit V në një shkallë më të lartë. Në të gjithë anët e vendit shpërthyen një varg iniciativash dhe lëvizjesh revolucionare me pjesëmarrjen e gjerë të masave, të cilat i dhanë goditje të ndjeshme ideologjike borgjeze dhe revizioniste, konservatorizmit dhe patriarkalizmit. Lufta kundër burokratizmit, intelektualizmit dhe shfaqjeve të tjera të huaja ideologjike, bëri që të shpërthenin plot vrull energjitë krijuese të masave, rriti ndjenjën e përgjegjësisë së njerëzve për problemet e shoqërisë dhe pjesëmarrjen e tyre në drejtimin e jetës së vendit. Të gjitha këto ngjallën hov të paparë tek masat punonjëse, të cilat shfaqën një frymë të lartë revolucionare në jetë dhe në punën e tyre ndërtimore. Në përpjekje për të kapërcyer vështirësitë dhe pengesat që nxori lufta për të çuar përpara revolucionin socialist, ata kryen akte të larta vetëmohimi e sakrifice, treguan ndërgjegje të lartë politike dhe frymë krijuese.

Në etapën e re në të cilën hyri lufta për ndërtimin e socializmit në Shqipëri, përpara letërsisë shtroheshin detyra të rëndësishme. Me veprat e tyre shkrimtarët duhet të ndihmonin

akoma më shumë për edukimin dhe kalitjen e gjithanshme revolucionare të njeriut tonë, për shtimin e entuziazmit luftarak dhe të energjive krijuese të masave punonjëse. Të vetëdijshëm për rolin e tyre të rëndësishëm në luftën për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste, shkrimtarët vunë talentin e forcat e tyre për të ngritur krijimtarinë letrare e artistike në lartësinë e kërkesave të kohës. Ata në veprat e tyre u bënë jehonë problemeve të rëndësishme të jetës së vendit. Fjala artistike nxiti njerëzit për punë vetëmohuese, forcoi dashurinë dhe krenarinë për atdheun socialist, ngjalli urrejtjen për armiqtë.

Në këtë periudhë Partia u kushtoi vëmendje të madhe problemeve të letërsisë. Zhvillimi i letërsisë, problemet e reja që solli thellimi i mëtejshëm i revolucionit ideologjik dhe kulturor nga njëra anë dhe ashpërsimi i luftës ideologjike në shkallë ndërkombëtare, nga ana tjetër, shpjegojnë rëndësinë e posaçme që iu kushtua në këtë periudhë çështjeve të letërsisë dhe të arteve. Në dokumentet e Partisë dhe në fjalimet e shokut Enver Hoxha është theksuar edhe një herë me forcë se arti i realizmit socialist ka për detyrë të pasqyrojë realitetin e ri, të frymëzojë njerëzit në rrugën e ndërtimit të socializmit. Duke pasqyruar luftën e të kundërtave në ndërgjegjen e njerëzve dhe në shoqëri, letërsia duhet të pohojë realitetin socialist, të nxjerrë në pah prirjet dhe anët e tij pozitive, të luftojë kundër shfaqjeve negative dhe të vërë në dukje të renë, së cilës i përket e ardhmja. Kjo kërkesë, që Partia ka shtruar gjithnjë para shkrimtarëve, formon përmbajtjen kryesore të dokumenteve të saj të këtyre viteve.

Lufta e Partisë në këtë periudhë ka pasur si synim mbrojtjen e parimit të partishmërisë komuniste, thellimin e karakterit kombëtar dhe të frymës popullore të artit të realizmit socialist, forcimin e pasqyrimin me vërtetësi të jetës etj. Teju i kësaj lufte u drejtua kundër estetikës borgjeze dhe revizioniste. Partia ka mbrojtur parimet e estetikës marksiste-leniniste dhe i ka zhvilluar ato në kushtet e vendit tonë, duke dhënë kështu kontribut me rëndësi në pasurimin e mëtejshëm të teorisë marksiste-leniniste mbi artin.

Një nga shfaqjet e shënuara të kujdesit të vazhdueshëm të Partisë për letërsinë dhe artet është vendimi i KQ të Partisë «Mbi zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe të arteve», që doli në qershor të vitit 1961. Për sqarimin e shkrimtarëve dhe të

artistëve lidhur me detyrat që shtronte Partia, një rëndësi të madhe luajti fjala e shokut Enver Hoxha dhe referati i shokut Ramiz Alja mbajtur në mbledhjen e gjerë me shkrimtarë dhe artistë, organizuar në korrik të vitit 1961 me iniciativën e KQ të Partisë. Në këto materiale iu dha përgjigje e qartë dhe e plotë çështjeve të ngutshme që nxirrte zhvillimi i artit të realizmit socialist në fazën e re në të cilën ai kishte hyrë.

Në Vendimin e KQ të PPSH theksohej se lufta për ndërtimin e plotë të Shqipërisë Socialiste dhe thellimi i mëtejshëm i revolucionit ideologjik e kulturor kërkonin një zhvillim edhe më të madh të letërsisë dhe të arteve. Përpara krijuesve dilte detyra e forcimit të partishmërisë komuniste dhe e ruajtjes së pastërtisë ideore, e pasqyrimin të gjithanshëm të jetës, e paraqitjes më të plotë e më të gjallë të heroit pozitiv. Vendimi trajtoi çështje të tjera të rëndësishme që kishte nxjerrë krijimtarja letrare, si çështjen e marrëdhënieve midis traditës dhe novatorizmit, çështjen e theksimit të mëtejshëm të karakterit kombëtar të artit socialist shqiptar etj. Partia i porosiste shkrimtarët që të jenë gjithmonë novatorë, ta shikojnë novatorizmin në radhë të parë në brendi dhe të mbështeten në punën e tyre krijuese në arritjet më të mëdha të artit shqiptar të realizmit socialist. Vëmendje e posaçme në materialet e Partisë iu kushtua sidomos problemit të karakterit kombëtar. Në fjalën e shokut Enver Hoxha iu bë një trajtim i qartë teorik problemit të karakterit kombëtar të artit. Karakteri kombëtar i krijimtarisë letrare dhe artistike, tha shoku Enver Hoxha, përcaktohet nga veçoritë thelbësore të karakterit të popullit të cilat shprehen në patriotizmin e flaktë, në dashurinë e fortë për jetë të lirë dhe të pavarur, në trimërinë dhe frymën e paepur, në aspiratën e zjarrtë për përparim shoqëror dhe kulturor etj. Këto veçori janë rezultat i jetës historike të popullit shqiptar nëpër shekuj. Kjo tezë e shokut Enver Hoxha shërbeu si busull e sigurt në përpjekjet e krijuesve për thellimin e karakterit kombëtar të artit tonë të realizmit socialist. Ajo u tregoi shkrimtarëve dhe artistëve se zgjidhja e kësaj detyre është e lidhur me pasqyrimin sa më të plotë të veçorive karakteristike të popullit, të formuara historikisht dhe të pasuruara më tej në kushtet e shoqërisë socialiste. Vetëm duke njohur nga afër dëshirat, mendimet dhe ndjenjat e tij, mund të krijohen vepra me frymë të spikatur kombëtare.

Rëndësi të madhe për zhvillimin e arteve dhe të letërsisë së

realizmit socialist pati Plenumi XV i KQ të Partisë, i cili mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike të KQ «Mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave». Plenumi XV i KQ të PPSH, mbajtur në tetor të vitit 1965, u zhvillua në kohën e ashpërsimit të mëtejshëm të luftës ideologjike kundër pikëpamjeve borgjeze dhe revizioniste dhe kundër disa shfaqjeve të ndikimeve të huaja në krijimtarinë letrare e artistike. Plenumi u ndal në problemet themelore të zhvillimit të letërsisë së realizmit socialist. Ai shtroi si detyrë kryesore që letërsia të pasqyronte më gjerë edhe më thellë jetën dhe punën e masave punonjëse, që në krijimtarinë letrare-artistike të forcohej parimi i partishmërisë komuniste, që në veprat letrare t'i kushtohej më shumë vend heroit pozitiv, i cili duhet të paraqitet në mënyrë të gjithanshme dhe të thellë.

Plenumi theksoi nevojën e domosdoshme të lidhjes gjithnjë e më të ngushtë me realitetin socialist, të njohjes së thellë dhe të vazhdueshme të jetës së popullit, të përpjekjeve dhe të luftës së tij për të arritur fitore të reja në ndërtimin e shoqërisë së re. Si në raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH, që u mbajt në Plenum, ashtu edhe në fjalën e mbylljes së shokut Enver Hoxha, u theksua me forcë problemi i njohjes së aktualitetit dhe i historisë së popullit, problemi i thellimit të karakterit kombëtar të letërsisë së realizmit socialist dhe problemi i ngritjes së mëtejshme të nivelit kulturor të krijuesve etj.

Një rëndësi e veçantë iu kushtua problemit të forcimit të vigjilencës revolucionare ndaj ndikimeve të huaja borgjezo-revizioniste. Plenumi dënoi shfaqjet e humanizmit abstrakt, të objektivizmit borgjez, të nxirosjes dhe të lustrimit të realitetit, të individualizmit etj., të cilat kishin gjetur shprehje në ndonjë vepër, dhe tërhoqi vëmendjen në çështjen e forcimit të mëtejshëm të luftës për ruajtjen e pastërtisë së parimeve krijuese të realizmit socialist. Kritika që iu bë shfaqjeve të gabuara në krijimtarinë letrare e artistike dhe porositë e KQ të Partisë ndihmuan për një zhvillim të mëtejshëm të letërsisë në rrugën e realizmit socialist dhe mprehën vigjilencën e shkrimtarëve ndaj shfaqjeve të huaja ideologjike.

Kongresi V i Partisë shtroi para letërsisë një sërë detyrash të rëndësishme, që dilnin lidhur me thellimin e mëtejshëm të revolucionit ideologjik e kulturor. Detyra kryesore në lëmin e krijimtarisë artistike ishte thellimi i mëtejshëm i frymës revo-

lucionare të letërsisë dhe të artit tonë. «Partia, — tha shoku Enver Hoxha në Raportin mbajtur në Kongres, — shtron detyrën që letërsia dhe artet të bëhen një armë e fuqishme në duart e Partisë për edukimin e punonjësve me frymën e socializmit e të komunizmit, ... që në qendër të krijimtarisë të vihen heronjtë e kohës sonë — punëtorët, fshatarët, ushtarët, intelektualët popullorë dhe kuadrot revolucionarë, njerëzit e rinj të edukuar nga Partia, ata që me vetëmohim e heroizëm punojnë e luftojnë për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e lulëzimit e lulezimit të Atdheut socialist»¹. Kongresi shtroi me forcë edhe një herë çështjen që shkrimtarët dhe artistët ta kërkojnë frymëzimin në popull, që temat e veprave të tyre t'i marrin nga jeta e gjallë. Problemin e frymës popullore në veprat artistike Partia e pa lidhur ngushtë me karakterin kombëtar të artit, me mbështetjen në truallin e jetës së vendit. Për t'i njohur dhe për t'i interpretuar drejt fenomenet e jetës, u tha në Raportin e mbajtur nga shoku Enver Hoxha, duhet të përvetësohet më mirë marksizëm-leninizmi jo vetëm «nëpërmjet librave», por edhe në luftën për zbatimin e vijës së Partisë, përmes pjesëmarrjes aktive në punën ndërtimore. Krahas forcimit të përmbajtjes ideologjike të veprave letrare, u shtrua detyra që shkrimtarët dhe artistët t'i kushtojnë rëndësi edhe formës artistike.

Kongresi tërhoqi edhe një herë vëmendjen e shkrimtarëve dhe të artistëve në çështjen e ruajtjes së pastërtisë ideore të krijimtarisë artistike, të theksimit në veprat letrare të frymës së partishmërisë komuniste dhe të forcimit të luftës kundër ndikimeve të artit borgjez revizionist.

Në fjalën e mbajtur në vitin 1968 në Konferencën e 17-të të Partisë për Tiranën shoku Enver Hoxha, ndër çështje të tjera, trajtoi edhe çështjet e letërsisë e të artit, sidomos problemin e raportit midis traditës dhe novatorizmit. Shoku Enver Hoxha dënoi si qëndrimet nihiliste, ashtu edhe qëndrimet konservatore në këtë çështje, tregoi se mohimi i traditës është sot një prirje e theksuar e artit dekadent borgjez që ka hequr dorë nga traditat pozitive të së kaluarës, se borgjezia reaksionare

1) E. Hoxha, Raport mbi veprimtarinë e KQ të PPSH, mbajtur në Kongresin V të PPSH, 1 nëntor 1966, Botimi i dytë, Tiranë 1966, f. 136.

me «izmat» e ndryshme që nxit dhe përkrah në art, orvatet të largojë vëmendjen e artistëve nga shoqëria e t'i çojë ata në rrugën e shthurjes dhe të degjenerimit moral e ideologjik. Në qoftë se konservatorizmi është kundër përpjekjeve për kërkime të reja në fushën e krijimtarisë letrare, nihilizmi nënçmon traditën, e sheh zhvillimin e artit si diçka të shkëputur e jo në mënyrë dialektike. Të dyja këto prirje janë të gabuara. Duke folur për novatorizmin, shoku Enver Hoxha vuri në dukje se realizmi socialist duhet parë në zhvillim të pandërprerë. «Realizmi socialist, — tha shoku Enver Hoxha, — nuk paraqitet aspak në forma statike, të ngurta, ai zien, është në zhvillim të përhershëm e të vazhdueshëm. . .»¹. Në fjalën e tij në Konferencën e 17-të të Partisë për Tiranën shoku Enver Hoxha, theksoi rëndësinë e kritikës parimore e konstruktive, në lëmin e krijimtarisë letrare, dënoi qëndrimet subjektive e të njëanshme në rrahjen e çështjeve të zhvillimit aktual letrar.

Kongresi II i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, që u mbajt më 1969, duke u mbështetur në mësimet e Partisë, bëri bilancin e punës që nga Kongresi i parë. «Në periudhën midis dy Kongreseve të Lidhjes, — u tha në raportin e Komitetit drejtues, — letërsia dhe artet shqiptare të realizmit socialist kanë njohur një sërë suksesesh të shquara, që i kushtohen punës së vullnetshme të shkrimtarëve dhe artistëve tanë, besimit të tyre të plotë në çështjen e socializmit e në të ardhmen e atdheut, lidhjes së tyre të ngushtë me Partinë e me interesat e popullit»². Kongresi nënvizoi se në këto dhjetë vjetët e fundit letërsia arriti një pjekuri më të madhe «Atë që ne e quajmë «shenjë pjekurie» për letërsinë e artin tonë para kësaj dekade, — u tha në raport, — sot mund ta çmojmë si një fenomen që ka marrë zgjerim»³. Kongresi u caktoi si detyrë njerëzve të letërsisë dhe të arteve që të viheshin në radhët e para të luftës për thellimin e revolucionit ideologjik e kulturor, që të ruhej dhe të zhvillohej më tej fryma e partishmërisë komuniste dhe të pasqyrohej më mirë aktualiteti socialist. Kongresi u shndërrua në një tri-

1) E. Hoxha, Të zbatojmë me këmbëngulje e në mënyrë krijuese detyrat për revolucionarizimin e Partisë e të jetës së vendit, Tiranë 1968, f. 43.

2) Kongresi II i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë. Botimi i posaçëm, «Nëntori» 1969, f. 12.

3) Po aty, f. 13.

buñë të rrahjes së mendimit për një tok çështjesh të përmbajtjes dhe të mjeshtërisë. Aty u theksua edhe një herë me forcë rëndësia e përvetësimit më të thellë të botëkuptimit marksist-leninist. Kongresi ishte një shprehje e unitetit të shkrimtarëve dhe të artistëve rreth Partisë; ai dëshmoi për pjekurinë e artit tonë dhe për rëndësinë kombëtare dhe ndërkombëtare të suksesit të realizmit socialist në vendin tonë.

Kongresi VI i Partisë (nëntor 1971) vlerësoi përparimet e ndjeshme që u arritën në lëmin e krijimtarisë letrare dhe artistike dhe ritheksoi si nevojë të domosdoshme që të forcohej e të çohej më tej lufta për mbrojtjen e parimeve themelore të realizmit socialist kundër estetikës dhe artit borgjez e revizionist, kundër ndikimeve të formalizmit dhe të dekadentizmit që mund të shfaqen në krijimtarinë letrare si rezultat i presionit ideologjik imperialisto-revizionist. Në raport u nënvizua veçanërisht nevoja e njohjes më të thellë të kontradiktave të jetës, të interpretimit dhe të zbulimit të tyre të drejtë, sidomos në dramaturgji e në prozë. Pasqyrimi i kontradiktave në art e në letërsi, u tha në raport, nuk është qëllim në vetvete. Letërsia duhet të pasqyrojë kontradiktat e mprehta shoqërore dhe konfliktet që lindin mbi bazën e tyre për të pohuar të renë dhe për të stigmatizuar të vjetrën, për të ndihmuar ecjen përpara të revolucionit socialist, për të çimentuar unitetin moralo-politik të popullit.

2

Cilat janë karakteristikat kryesore të procesit letrar në këtë periudhë? Në ç'fushë qëndrojnë arritjet më të shënuara të letërsisë artistike?

Në këtë periudhë letërsia shqiptare e realizmit socialist bëri përparime të ndjeshme. Duke ndjekur traditat më të mira të mëparshme, ajo forcoi përmbajtjen e vet. Si rezultat i përvetësimit më të thellë të teorisë marksiste-leniniste, konfliktet jetësore janë zbuluar në mënyrë më të gjerë dhe më të plotë, dukuritë dhe njerëzit në veprat letrare janë shikuar në prizmin e luftës së klasave. Kjo ka çuar në forcimin e frymës së partishmërisë komuniste në krijimtarinë letrare, në thellimin e interpretimit të jetës nga pozitë e marksizëm-leninizmit. Pohimi i botëkuptimit revolucionar në letërsi u arrit përmes një lufte

të vazhdueshme kundër botëkuptimit borgjez e mikroborgjez, feudal dhe patriarkal. Në këtë periudhë u shkruan vepra me frymë të lartë partie, si «Përse mendohen këto male», «Devoll-Devoll», «Alarme të përgjakura», «Para Agimit», «Komisari Memo», «Përsëri në këmbë», «Cuca e maleve» etj.

Në përpjekje për të rrokur në mënyrë të gjithanshme realitetin socialist dhe për t'iu përgjigjur kërkesave gjithnjë në rritje të lexuesve, letërsia arriti suksese të rëndësishme në të gjitha llojet. U kapërcyen një varg të metash të periudhës së mëparshme dhe u arritën rezultate në luftë kundër skematizimit, rutinës, vizatimit të cekët të personazheve, kundër përdorimit të një gjuhe ndonjëherë jo shumë shprehëse etj., të cilat ishin vështirësi të rritjes. U shënua një përparim i mëtejshëm në pasqyrimin më të thellë dhe në gdhendjen më të mirë të figurave të personazheve, gjë që u arrit në sajë të ngritjes së nivelit ideor të krijesve dhe të zotërimit më të mirë prej tyre të mjeshtërisë artistike. Këto dëshmonin për pjekurinë ideore dhe artistike të letërsisë shqiptare të realizmit socialist.

Karakterit kombëtar i letërsisë ka ardhur duke u theksuar dhe duke u zhvilluar si në përmbajtje, ashtu edhe në formë. Porositë e Partisë për t'u mbështetur më fort në truallin e jetës së vendit, për të gjetur atje përmbajtjen dhe larminë artistike kanë ndihmuar në thellimin e karakterit kombëtar të letërsisë. Problematika, fryma që ka përshkuar veprat letrare kanë qenë thellësisht kombëtare; në to janë zbuluar më mirë veçoritë psikike të popullit tonë. Ashtu si edhe në periudhën e mëparshme, në veprat letrare heronjtë u vendosën në mjedise kombëtare; kjo u arrit përmes luftës kundër kuptimit të jashtëm të karakterit kombëtar, kundër imtësive natyraliste, të cilat pengonin pasqyrimin realist të ambienteve. Në këtë periudhë u theksuan ato veçori të formës kombëtare të letërsisë, të cilat e dallojnë atë nga letërsitë e tjera dhe që lidhen ngushtë me përmbajtjen e saj. Si edhe më parë, dialogu me frymë popullore zuri vend me rëndësi në veprat letrare; figuracioni, sidomos në poezi, u mbështet për herë e më shumë në fondin e folklorit, si edhe në mundësitë e mëdha të fjalës shqipe për një shprehje të pasur figurative.

Veçori tjetër e jetës letrare në këto vite është thellimi i frymës popullore të letërsisë, që në radhë të parë u shpreh në faktin se populli u vu më mirë në qendër të veprave artistike.

Populli është pasqyruar në lëvizjet e mëdha historike nëpërmjet individëve që e përfaqësojnë ose nëpërmjet portretit kolektiv të masës që luan rol vendimtar në zhvillimin e ngjarjeve historike.

Si rezultat i revolucionarizimit të mëtejshëm të jetës së vendit dhe i forcimit të luftës në frontin ideologjik, shkrimtarët i pasqyruan më thellë kontradiktat e jetës; krahas kontradiktave joantagoniste, ata paraqitën në veprat e tyre edhe kontradiktat antagoniste, në zbulimin dhe zgjidhjen e të cilave kanë zënë pozita të drejta ideore. Edhe përmes kësaj ata kanë ndihmuar për edukimin ideoestetik të masave. Të udhëhequr nga mësimet e Partisë, krijuesit kanë ditur të dallojnë kontradiktat joantagoniste nga kontradiktat antagoniste, kanë luftuar konceptet e huaja dhe bartësit e tyre kur këta nuk janë ndrequr. Konfliktet janë trajtuar në plan shoqëror dhe moral. Në shumë vepra letrare janë pasqyruar çaste dramatike dhe kthesa të rëndësishme në jetën e personazheve, por jo gjithnjë janë treguar në mënyrë të plotë motivet shoqërore dhe psikologjike të sjelljeve e të veprimeve të personazheve. Herë-herë ka munguar paraqitja e ndeshjeve të hapura dhe të fuqishme midis koncepteve dhe qëndrimeve të kundërta në jetë.

Karakteristikë e kësaj periudhe ka qenë paraqitja e gjithanshme e botës shpirtërore të heroit të epokës. Virtytet e larta morale: shkrirja me popullin, qëndrimi revolucionar ndaj problemeve që shtronte etapa e re e jetës së vendit, kanë qenë tiple paret kryesore të heroit të letërsisë, i cili është pasqyruar si njeri i veprimit, si transformues i shoqërisë dhe i natyrës; në të njëjtën kohë shkrimtarët kanë paraqitur edhe botën e tij të brendshme. Letërsia e kësaj periudhe i ka kushtuar vëmendje çështjes së pasqyrimin të komunistit, të njeriut të thjeshtë të popullit, të fshatarit, të punëtorit, dhe të intelektualit popullor. Shkrimtarët kanë gdhendur një radhë karakteresh pozitive, si: Qemal Orhanaj në romanin «Para agimit», komisari Memo dhe komandanti Rrapo në romanin «Komisari Memo», Din Hyka në romanin «Përsëri në këmbë», Cuca në dramën «Cuca e maleve» etj. Personazhe pozitive janë skalitur edhe në tregimet e N. Priftit, T. Laços, Dh. Shuteriqit, A. Kondos etj.

Llojet epike të krijimtarisë letrare, si romani etj., kanë ndjekur rrugën e zhvillimit të tyre të mëtejshëm dhe janë

pasuar në përmbajtje dhe në formë. Të gjitha veprat më të mira të kësaj gjinie janë marrë me historinë e karaktereve ose me zbulimin e tyre në rrethana të caktuara shoqërore-historike. Format e pasqyrit kanë qenë të ndryshme; krahas mënyrës së njohur tregimtare, janë dukur edhe vepra ku narracioni gërshetohet me meditimin, me një paraqitje poetike të fakteve jetësore. Cilatdo qofshin mënyrat krijuese, letërsia e ka thelluar më tej frymën e vet novatore dhe e ka pasqyruar jetën me tablo të gjera si; te «Lumi i vdekur», «Para agimit» etj., nëpërmjet historisë së zbulimit dhe të formimit të karaktereve në procesin e luftës revolucionare, si te «Komisari Memo» ose nëpërmjet portretizimit kolektiv dhe dialogut të figurshëm e me tendosje të mendimit, si te «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» etj.

Letërsia në këtë periudhë ka ecur më tej, edhe nga ana artistike. Kjo gjë u shpreh në radhë të parë në rritjen e mjeshtërisë së shkrimtarëve në skalitjen e figurave. U krijuan një varg karakteresh tipike, që mishërojnë në mendimet dhe veprimet e tyre veçoritë dhe prirjet përparimtare të jetës në zhvillimin e saj revolucionar. Përgjithësime të gjera u shprehën në pamjet më sintetike që u realizuan në lëmin e prozës, e cila ka mundësi të pasqyrojë konflikte të forta shoqërore, dhe në poezi, që priret drejt shprehjeve lakonike. Këto përgjithësime i gjejmë në romanin «Lumi i vdekur» të J. Xoxes, në romanet «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» i I. Kadaresë, e «Komisari Memo» i D. Agollit, dhe në shumë vepra të autorëve të tjerë. Format artistike kanë qenë të ndryshme; përvoja e këtyre viteve tregoi se në praktikën letrare mund të mbizotërojë njëra ose tjetra, por, çdo herë, analiza ka shoqëruar sintezën dhe sinteza analizën.

Si pasojë e pasurimit të perceptimeve dhe e thellimit të mendimit, në këtë periudhë është përdorur më shumë konvencioni artistik, simboli, hiperbola dhe figura të tjera. Në veprat letrare të kësaj periudhe diçka e re ishte konvencioni, i cili është përdorur me vend. Autorët që i janë drejtuar këtij mjeti artistik, kanë synuar të theksojnë idenë artistike; ata i kanë zmadhuar dukuritë negative për t'i vënë në lojë ato dhe për të zbuluar më mirë thelbin e tyre.

Shtimi i aftësisë së letërsisë për përgjithësime të rëndësishme artistike, për të pasqyruar jetën në mënyrë të gjerë, me pamje epike ka çuar në ngjeshjen e veprave letrare me men-

dime të thella. Është kapërcyer karakteri përshkrues, sidomos në disa krijime poetike. Mendime dhe ndjenja të rëndësishme janë shprehur në mënyrë të ndryshme, sipas individualitetit krijues të çdo artisti.

Tregues tjetër i konsolidimit të letërsisë së realizmit socialist është pasurimi i llojeve letrare me veçori të reja. Ndryshime të rëndësishme cilësore kanë shënuar të gjitha gjinitë, por, në etapa të caktuara, disa gjini kanë dalë në krye të përpjekjeve për një nivel më të lartë. Subjektet janë bërë më të larmishme, janë thyer caqet e zhvillimit të subjektit sipas një skeme të caktuar. Poetizimi në veprat letrare i dukurve dhe i ngjarjeve, që në pamje të jashtme duken të rëndomta, ka zgjeruar sferën e subjekteve. Në vijat kryesore është kapërcyer fragmentarizmi i dikurshëm, që vihej re në kompozicionin e romaneve. Kultura gjuhësore ka ardhur duke u ngritur; shkrimtarët bënë përpjekje për të përdorur një gjuhë më të pasur dhe më të pastër, të zhveshur nga provincializmi gjuhësor dhe nga fjalët e shprehjet e ngushta dialektore. Nga ana tjetër janë luftuar shtampat, shfaqjet e një gjuhe të zbehtë, joshpëhëse, ku humbasin ngjyrat dhe individualiteti i të folurit. U vu re zgjedhja dhe përdorimi më i goditur dhe më i efektshëm i leksikut nga ana kuptimore dhe emocionale. Përparime janë bërë edhe në sistemin figurativ dhe në mjetet stilistike. Sintaksa poetike u bë më e zhërvjelltë. Si pasojë e lidhjes më organike të krijesve me jetën, u luftuan shfaqjet e deklarativizmit dhe të retorizimit.

Konsolidimi i një drejtimi letrar duket edhe në pohimin më të plotë të individualiteteve artistike, gjë që dëshmon pjekurinë e një letërsie. Pasurimi dhe zhvillimi i pareshtur i jetës socialiste, rritja e gjithanshme e njeriut tonë, nevoja e domosdoshme për pasqyrimin e realitetit në mënyrë të gjithanshme, grumbullimi i një përvoje më të pasur nga ana e shkrimtarëve si edhe shtimi i mjeshtërisë sollën me vete zhvillimin e dukshëm të individualiteteve krijuese. Nxitja për kërkime të reja ka bërë që të shtohen shkrimtarët me fizionomi të spikatur artistike. Stilet që kanë përdorur autorët të ndryshëm dhe që lidhen me individualitetin e tyre janë të larmishme dhe kjo dëshmon për mundësitë e mëdha që kanë shkrimtarët tanë për të shfaqur prirjet dhe aftësitë e tyre. Ka stile që i mbetën më besnike formës tradicionale, me të cilën autorët shprehin përmbaj-

tjen e re, stile që flasin për një evolucion të brendshëm në përvetësimin krijues të traditës dhe që sjellin elemente të reja të formës. Nga ana tjetër ka stile që e thyejnë më shumë traditën nga pikëpamja e formës. Realizmi gërshetohet hera-herës edhe me nota romantike që burojnë nga realiteti. Sidomos në poezi u vu re prirja për të pasqyruar kulmet sublime apo hovet shpirtërore të njeriut të sotëm. Një varg autorësh krijues modelet popullore. Ardhja në radhët e letërsisë e shumë forcave krijuese artistike me individualitet të spikatur, që sollën elemente të reja, sidomos në fushën e poezisë dhe të tregimit, e bëri akoma më të pasur e më të larmishme letërsinë.

Tipar karakteristik i krijimtarisë letrare në këtë periudhë është shtimi i rolit të saj në jetën e shoqërisë, forcimi i karakterit të saj militant. Kjo u arrit në luftë kundër ndikimeve të artit borgjez dhe revizionist, që prekën krijimtarinë e autorëve të veçantë. Në mesin e viteve 60 u botuan vepra, në të cilat u errësuan anët pozitive të jetës dhe u frynë ato negative, gjë që çoi në një pasqyrim të shtrembëruar të njerëzve tanë, të fizionomisë së tyre morale dhe shpirtërore («Rrethimi i bardhë» dhe «Tuneli»). Prirja e pasqyrimin të njëanshëm të jetës u vërejt edhe në disa tregime të vëllimit «Zhurra e erërave të dikurshme». Në ndonjë vepër si «heronj» u paraqitën njerëz të lëkundshëm ose me shumë të meta («Drama e partizanit pa emër»). Shfaqje e huaj ishte edhe objektivismi mbiklasor, që në ndonjë vepër çoi në zbukurimin e armiqve («Dueli»).

Në fund të viteve 60 dhe në fillim të viteve 70 si rezultat i shtimit të presionit ideologjik armiqësor, në krijimtarinë letrare u dukën sërish shfaqje të huaja, të cilat u përhapën me nxitjen aktive të armiqve të Partisë, F. Paçrami dhe T. Lubonja.

Në këto vite pati shkrime në të cilat njerëzit dhe dukuritë e realitetit socialist u paraqitën në frymë të rreme; kontradiktat e jetës nuk u konceptuan drejt dhe, si pasojë, ato u zgjidhën nga pozita të gabuara. Kjo u duk në ndonjë vepër që shtrembëronte luftën e shoqërisë sonë kundër burokratizmit, i cili u paraqit si e keqe e pashërueshme. Me këtë lidhet prirja e çetorizimit, e errësimit të idealit pozitiv dhe të perspektivës historike. Lidhur me këto shtrembërime ka pasur edhe ndikime moderniste, të cilat u shprehën në pasqyrimin e njeriut në frymën e konceptit të jetërsimit, në atmosferën pesimiste, që sun-

donte në ndonjë vepër, në shkrirjen e «un-it» të poetit në sende dhe dukuri të ndryshme të natyrës, në një lloj erotizmi të sëmurë etj. Ndikimet moderniste u shprehën edhe në formën e disa veprave letrare, në figurat e errëta, hermetike dhe në një figuracion të kërkuar, që në disa krijime u bë qëllim në vetvete.

Shfaqje të huaja u vërejtën edhe në mendimin kritik. Disa elementë me prirje liberale u përpoqën të përligjin shfaqjet e huaja në letërsi; në artikujt e tyre ata mbrojtën pikëpamjen e gabuar të copëzimit të personazhit, të heqjes dorë nga konceptimi tërësor i heroit pozitiv, mbivlerësuan rolin e simbolikës dhe të konvencionit në letërsi, ngatërruan traditën me konservatorizmin, dolën kundër pranisë së heroit ose të personazhit pozitiv në veprat satirike.

Krahas ndikimeve borgjeze dhe revizioniste, u luftuan edhe shfaqjet konservatore në krijimtarinë letrare dhe artistike. Ndonëse më parë ishin goditur konceptet prapanike, rutina etj., ato nxirrnin kryet aty-këtu në letërsi. Më të shumtën e herës konservatorizmi në brendinë e veprave letrare u shfaq në formën e idealizimit dhe të zbukurimit të formave të vjetra të organizimit të jetës shoqërore, sidomos të krahinave malore, të pasqyrimin me ngjyra tërheqëse të zakoneve dhe të mjediseve patriarkale etj. Shfaqje konservatore në formën artistike ishte theksimi i tepruar i imtësive etnografike, situatat sentimentaliste dhe efektet melodramatike.

Shfaqjet e huaja që u vërejtën në lëmin e krijimtarisë letrare e artistike ishin të pjesshme. Në përgjithësi letërsia u zhvillua në rrugë të mbarë. Ajo ka luajtur një rol të rëndësishëm si ndihmëse e Partisë në brumosjen revolucionare të njeriut tonë.

Brendia e letërsisë ka ardhur duke u bërë më e pasur dhe më komplekse. Vendin kryesor e zunë disa tema dhe ide që lindën nga kërkesat e kohës. Idetë që burojnë nga konceptimi marksist-leninist i jetës dhe nga detyrat aktuale që shtron shoqëria jonë, janë shprehur në vepra me tematikë të larme. Në poemat, vjershat, romanet, tregimet e dramat e kësaj periudhe është nënvizuar ideja e qëndresës së popullit, e rrugës së

tij historike të mbushur plot përpjekje të pareshtura për të mbrojtur lirinë dhe ekzistencën e vet, është theksuar ideja e gjallërisë dhe e forcës së tij të pathyeshme kundër armiqve të ndryshëm. Mjafton t'u hedhim një sy disa veprave, për t'u bindur se kjo ide ka spikatur me qartësi në letërsinë e kësaj periudhe, gjë që shpjegohet me rrethanat historike në të cilat zhvillohej vendi. Duke vënë në qendër të veprave popullin, shkrimtarët, përmes formave të ndryshme artistike, kanë shprehur idenë se historia e vendit është historia e luftërave heroike dhe burrërore kundër armiqve të shumtë dhe të ndryshëm, se, me gjithë shtypjen, padrejtësitë e klasave shfrytëzuesë dhe të pushtuesve të huaj, populli ka ruajtur nëpër shekuj një potencial të madh shpirtëror. Kjo ide është theksuar në disa vepra të rëndësishme letrare të gjinive dhe të autorëve të ndryshëm.

Po ta shohim në tërësi letërsinë e kësaj periudhe, do të vëmë re se vendin kryesor në të e ka zënë tema aktuale. Në veprat letrare jeta e sotme është pasqyruar me aspektet e saj të shumta. Në to u paraqitën zhvillimet e reja revolucionare të jetës, veprat e shumta të heroizmit masiv dhe individual, lufta për formimin e plotë të fizionomisë morale të njeriut të sotëm dhe për konsolidimin e familjes së re, të mbështetur mbi baza të shëndosha, lufta kundër zakoneve prapanike dhe konservatore, si dhe kundër shfaqjeve liberale dhe moderniste.

Vend të rëndësishëm në letërsi ka zënë tema e klasës punëtore, e cila në këtë periudhë është trajtuar më shumë në prozë, në dramaturgji e në poezi. Shkrimtarët me veprat e tyre kanë sjellë në letërsi optimizmin e klasës punëtore, vetëdijen e lartë ideologjike dhe shpirtin e saj të çiltër dhe luftarak. Por, me gjithë arritjet pozitive, duhet thënë se deri tani klasa punëtore është paraqitur ende pak përmes karaktereve të gjalla, me botën e tyre të brendshme shpirtërore. Jeta shtronte si detyrë që klasa punëtore të pasqyrohej më mirë përmes luftës për thellimin e tipareve të saj si klasë. Vëmendjen e shkrimtarëve e tërhoqën edhe problemet moral-etike, në trajtimin e të cilave u arritën suksese, ndonëse këto nuk janë parë gjithmonë në lidhje të ngushtë me problemet shoqërore.

Një vend të rëndësishëm në veprat e kësaj periudhe ka zënë edhe tema e Luftës Nacionalçlirimtare. Në veprat me këtë temë del prirja për të pasqyruar heroizmin e popullit, në për-

leshje të rrepta me armiqtë, karakterin e ndërlikuar të marrëdhënieve midis klasave të ndryshme gjatë revolucionit popullor. Lufta Nacionalçlirimtare është pasqyruar në dritën e kërkesave të sotme të shoqërisë shqiptare. Qëndresa e masave kundër pushtuesve nazifashistë, forca krijuese e popullit, ideja e rolit udhëheqës të Partisë përbëjnë bazën e veprave me këtë temë. Tema e luftës është shumë e gjerë; shkrimtarët i janë kthyer e do t'i kthehen edhe në të ardhmen kësaj teme, për të zbuluar faqe të ndritura të luftës së popullit dhe për të theksuar ato anë, të cilat i bëjnë jehonë luftës së masave punonjëse për të çuar më tej revolucionin socialist.

Veprat me temë historike nga e kaluara kanë nxjerrë në pah idenë e unitetit të popullit. Krahas me këtë, letërsia është përpjekur të vendosë ngjarjet në një sfond të gjerë shoqëror-historik. Për jetën e rëndë të masave në të kaluarën dhe për ngjarjet e shquara historike të epokave të mëparshme janë shkruar vepra me vlerë. Në trajtimin e temave nga historia janë kapërcyer dhënia së tepërmi pas imtësive etnografike, konceptimi i sipërfaqshëm i patriotizmit dhe zgjidhjet melodramatike të konflikteve në veprat letrare. Krahas detyrës së madhe të pasqyrimin të aktualitetit, letërsisë i mbetet për të çelur rrugë të reja edhe në këtë fushë.

4

Në këtë periudhë, krijimtaria letrare shquhet për një pasuri të madhe në lloje dhe gjini të ndryshme letrare. Kjo erdhi si pasojë e kërkesës për një pasqyrim më të plotë e më të gjithëanshëm të realitetit dhe, në të njëjtën kohë, si rezultat i përparimit të përgjithshëm të letërsisë, e cila kishte mbledhur një përvojë të gjerë e të çmuar. Llojet dhe gjinitë letrare ndoqën rrugën e tyre të zhvillimit; në lidhje të ngushtë me ecjen përpara të jetës përmbajtja dhe veçoritë e tyre të reja u pasuruan dhe u thelluan më tej.

Në këtë periudhë u përsos më tej forma artistike e veprave letrare, e cila, me gjithë dobësitë që ende vihen re, ka dhënë dorë që të shprehet më mirë brendia e veprave. Proza zgjeroi sferën e subjekteve dhe shfrytëzoi më mirë mundësitë e kom-

pozicionit; ajo u bë më plastike, më e larmishme. Në disa vepra në prozë u arrit një shprehje më koncize dhe më e figurshme e idesë artistike. Në dramaturgji pati përpjekje për të përdorur një dialog më të shkathët e më të pasur dhe për t'u larguar nga mënyra emfatike e të folurit.

Mund të thuhet pa e tepruar se synimi për të pasqyruar me pamje epike jetën ka qenë tipari kryesor i kësaj periudhe. Veprimi, bëmat, heroizmi i masës dhe i individit, zhvillimi dinamik i ngjarjeve kanë përcaktuar edhe zhvillimin intensiv të llojeve epike. Prandaj në këtë periudhë u lërua më tej romani, i cili pati një përparim të vullshëm. U lërua edhe poema me prirje epike. Dramat, duke vënë në qendër të tyre popullin, ngjarje shoqërore me rëndësi historike të madhe dhe ndeshjet klasore, patën një tingëllim epik; kjo s'do të thotë se nuk u zhvilluan edhe vepra me prirje lirike. Në veprat epike ose dramatike zuri më shumë vend lirizmi; i cili buron nga hovet e brendshme të heroit lirik dhe nga ndjenjat fisnike të njeriut të sotëm, nga harmonia e marrëdhënieve midis individit dhe shoqërisë. Zhvillimi i lirikës ishte diçka e natyrshme; ai i ka rrënjët në pasurimin e vazhdueshëm të botës së brendshme të njeriut në rendin socialist. Tiparet e lirikës janë përcaktuar nga raportet e reja të individit me shoqërinë.

Procesi i revolucionarizimit të mëtejshëm të jetës ka nxjerrë më në pah kontradiktat e realitetit; kjo ka dhënë dorë që drama të shtrojë konfliktet dramatike e të pasqyrojë ndeshjen e ashpër midis së resë dhe së vjetrës.

Në këtë periudhë poezia ka qenë në radhët e para të frontit letrar; roli i saj është bërë më aktiv, më mobilizues. Poezia ka arritur përgjithësim të mëdha dhe është pasuruar me mendime. Vetë jeta dhe zhvillimi i brendshëm i poezisë kanë përcaktuar edhe zhvillimin e llojeve të saj. Poema është lëruar më gjerë dhe është kristalizuar si lloj. Lidhur me poemën, në Kongresin II të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve u tha: «Duke u bërë më e figurshme dhe më filozofike, poezia u largua mjaft nga një farë narracioni që disa herë e çonte në prozaiëm. Kontribut në pasurimin e letërsisë me tipa dhe ambiente kanë sjellë një varg poemash tregimtare. Por rezultatet më të shquara në thellimin realist të poezisë i arriti vjersha me ka-

rakterin e saj liriko-epik, e kështu edhe poema e quajtur «poema-sintezë.»¹

Zhvillim të mirë njohu edhe lirika qytetare, e cila pasqyroi ndjenjat e poetit lidhur ngushtë me ngjarjet e mëdha të epokës. U lërua edhe lirika e dashurisë dhe e peizazhit, e cila pati përfaqësues të talentuar. Gërshetimi i çasteve epike me çastet lirike, ka qenë karakteristikë e kësaj periudhe. Në procesin e zhvillimit të tyre, llojet e ndryshme letrare nuk kanë qëndruar të veçuara nga njëra-tjetra. Në këtë periudhë u vu re një bashkëveprim i theksuar midis tyre.

Romani u zhvillua gjerësisht si rrjedhim i kërkesës për ta rrokur jetën në tërësinë e vet dhe për të pasqyruar më mirë lidhjet e individit me shoqërinë, si dhe procesin e revolucionarizimit të shoqërisë shqiptare. Pati lloje të ndryshme të romanit. Në këtë periudhë u kristalizua plotësisht romani shoqëror. Brenda këtij lloji mund të dallojmë disa nënloje, si romanin historiko-shoqëror, me pamje të përgjithësuar, siç është «Lumi i vdekur», që trajton historinë e shtresave të gjera shoqërore dhe raportet e tyre në një periudhë të caktuar historike, romanin shoqëror-psikologjik, («Përsëri në këmbë», «Kullat»), që niset gjithashtu nga analiza shoqërore, por i vë vetes si qëllim të tregojë kthesat shpirtërore të karaktereve. Krahas me këto në këtë periudhë letërsia u pasurua edhe me një tip të ri romani, që e shquan një formë origjinale, siç është «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» ose «Kronikë në gur», të cilat kritika i ka përcaktuar si romane poetiko-filozofike ose simbolike. Situatat jetësore shkrihen këtu me situatën konvencionale, që përgjithësojnë dhe fuqizojnë idenë. Edhe në këto romane vërehet një shtrirje epike, por më e përqendruar, romani poetiko-filozofik është më i ngjeshur në mendime dhe ndjenja. Në këtë periudhë u lërua edhe romani kronikë, siç është «Para agimit» dhe «Kronikë e viteve të paharruara», ku rrjedha e ngjarjeve ka përcaktuar subjektin dhe rrugën e zhvillimit të personazheve. Në këtë periudhë u shfaqën romanet e para satirike, si «I fundit i oxhakut» i M. Kallamatës, «Fshati midis ujërave» i K. Jakovës etj.

1) Kongresi II i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve të Shqipërisë, «Nëntori» 1969, Botimi i posaçëm, f. 14.

Tregimi dhe novela kanë pasur zhvillim të dukshëm. Është lëruar tregimi psikologjik dhe tregimi që mbështetet më shumë në përshkrimin e një ndodhie sesa në paraqitjen e kthesave shpirtërore të karaktereve. Në tregimet e kësaj periudhe fabula ka luajtur më pak rol; nga ana tjetër është rritur rëndësia e subjektit, i cili është bërë më i larmishëm gjë që ka ndihmuar në pasqyrimin në mënyrë më të plotë të jetës.

Në dramaturgji më shumë është lëruar drama shoqërore. Janë shkruar edhe drama, të cilat, duke u mbështetur në një fakt real, u kanë bërë jehonë ngjarjeve të ditës, heroizmit të masave. Gërshetimi i skenave dramatike me skenat epike ka qenë karakteristikë e kësaj periudhe. Komedia ka pasur zhvillim të paktë, ndonëse janë shkruar edhe komedi me vlerë si: «Karnavalet e Korçës» e S. Çomorës dhe «Fytyra e dytë» e D. Agollit.

POEZIA

Në këtë periudhë u shënuan arritje të rëndësishme në lëmin e poezisë. Sfera e pasqyrimin të jetës në veprat poetike u zgjerua në mënyrë të ndjeshme. Dalin në dritë shumë vepra të shquara në të cilat në formë të lartë artistike gjetën pasqyrim ngjarjet e mëdha të epokës: «Përse mendohen këto male» dhe «Shqiponjat fluturojnë lart» të I. Kadaresë, «Baballarët» dhe «Devoll, Devoll» të D. Agollit, «Borizanët» e Ll. Siliqit, «Alarme të përgjakura» e F. Arapit etj. Poezia hyri në një etapë më të lartë të zhvillimit të vet, tipar karakteristik i të cilit ishte shtimi i ndikimit të saj në ndërgjegjen e lexuesve. Poetët iu reshtën përherë e më shumë të metave të mëparshme si deklarativizmit, frazave të përgjithshme etj. Qoftë poetët me përvojë të gjatë, qoftë penat e reja që erdhën në radhët e letërsisë në këtë periudhë, iu drejtuan problemeve të rëndësishme dhe më të ngutshme, synuan të kuptojnë edhe të zbulojnë thelbin e asaj që shihnin në jetë. Në përpjekje për të pasqyruar sa më thellë e në mënyrë të gjithanshme realitetin socialist dhe botën shpirtërore të njeriut të sotëm, ata e ngjeshën vargun me mendim, kërkuan dhe përdorën një formë poetike më konkrete dhe më shprehëse.

Në përtëritjen e poezisë me brendi dhe me mjete të reja artistike ndikim të drejtpërdrejtë patën ngjarjet që lidheshin me thellimin e mëtejshëm të revolucionit ideologjik dhe kulturor, entuziazmi revolucionar dhe fryma krijuese e masave punonjëse në vitet e bllokadës imperialisto-revizioniste. Duke iu përgjigjur kërkesave të kohës, poetët u përpoqën të paraqesin atë hov që karakterizoi jetën shoqërore e politike të vendit.

Cilësitë e reja që fitoi poezia ishin rezultat i kërkimeve të gjata dhe këmbëngulëse, që nisën nga fundi i periudhës së më-

parshme dhe u kurorëzuan plotësisht në vitet 60. Në përparimin e krijimtarisë poetike është dora e të gjithë poetëve të shquar të sotëm; në të u derdh munda i poetëve me prirje krijuese dhe fizionomi të ndryshme artistike. Të ngrihet në një shkallë të re poezinë e ndihmuan krijimet e I. Kadaresë, të D. Agollit, të Ll. Siliqit, të F. Gjatës, të F. Arapit si dhe të poetëve të rinj.

Poezia e mori frymëzimin nga lufta për të çuar përpara revolucionin socialist, nga entuziazmi dhe fryma e sakrificës që shqoqti masat punonjëse në këto vite. Poetët bënë përpjekje të vizatonin pamjen e hovit krijues që përfshiu vendin, të tregonin luftën e vendosur dhe të ashpër kundër njollave të botës së vjetër në shoqërinë e sotme, të paraqitnin fizionominë morale të njeriut të ri, botën e tij shpirtërore. Thellimi i mëtejshëm i revolucionit ideologjik e kulturor dhe lufta kundër bllokadës së egër të armiqve përcaktoi brendinë kryesore të poezisë së viteve 60-70. Veprat më të mira të kësaj periudhe i përshkon patosi heroik, besimi në të ardhmen e bukur të vendit, bindja se çështja e socializmit në Shqipëri do të ngadhënjejë përfundimisht. Konfliktin e Shqipërisë socialiste me revizionistët modernë, në krye, poetët e panë në një perspektivë të gjerë historike; ata shprehën besimin e sigurt se populli shqiptar do të dilte fitimtar mbi armiqtë dhe treguan se burimi i gjallërisë së tij ishte bindja e thellë në forcën e pamposhtur të marksizëm-leninizmit, në drejtësinë e vijës së Partisë dhe në të tilla cilësi, si fryma e paepur, guximi dhe burëria, që kishin edukuar tek ai luftërat shekullore kundër armiqve të shumtë dhe të ndryshëm.

Në këtë periudhë temë e rëndësishme e krijimtarisë së poetëve të kohës vijoi të jetë edhe lufta kundër ideologjive të vjetra që vijnë nga thellësitë e shekujve, kundër traditave dhe zakoneve prapanike, kundër ndikimeve të fesë e të kanunit që pengonin emancipimin e plotë shpirtëror të masave punonjëse, sidomos të gruas. Në të njëjtën kohë poetët trajtuan edhe temën e luftës kundër burokratizmit, rutinës dhe praktikave që ndrydhnin iniciativën krijuese të masave.

Poezia e kësaj periudhe shquhet për përpjekjet këmbëngulëse të autorëve për të gjetur forma e mjete artistike që japin dorë për pasqyrimin e jetës në zhvillimin e saj revolucionar. Kështu, përveç përfshirjes në tematikën e veprave poetike të aspekteve dhe anëve të reja të aktualitetit, poetët arritën suk-

sese të ndjeshme edhe në lëmin e formës, ata futën në përdorim groteskun dhe fantastikën, shfrytëzuan krahasimet me përmasa të gjera, e shtjelluan subjektin ndonjëherë në plan konvencional, parapëlqyen fjalët e rëndomta, që fitojnë forcë shprehëse edhe pse nuk kanë një ngjyrim të veçantë poetik, përfshinë gjerësisht në krijimet epike elementin lirik dhe intonacione të ndryshme në rrëfim. Kërqime të reja pati edhe në llojet poetike ekzistuese. U shënua një pasurim i mëtejshëm i lirikës; përveç vjershave që i këndojnë jetës së re me nota patetiko-oratorike, mori përhapje lloji i vjershës që shquhet për karakterin konkret të përshkrimit të ngjarjeve dhe të njerëzve, për rrëfimin e thjeshtë dhe të qartë, për vënien në pah të ndryshimeve të jetës përmes fakteve të zakonshme. Si element i ri në këtë periudhë duhet theksuar zhvillimi më i gjerë i lirikës intime dhe i asaj të peizazhit. Përkrah lirikës bëri hapa të rëndësishëm përpara edhe poema, e cila hyri në radhët e llojeve letrare më të zhvilluara. Përveç I. Kadaresë, D. Agollit, Ll. Siliqit, F. Arapit, etj., poemën e lëruan edhe poetë të rinj. Kryet e vendit e zuri poema liriko-epike që shpesh ka pamjen e një monologu lirik. Brenda në këtë poemë u zbulua me anë të meditacioneve të thella lirike, asociacioneve dhe analogjive historike. Në këtë periudhë u shkruan edhe poema narrative, që flasin për fatin e një heroi, për veprat dhe sjelljen e tij.

Mbështetja në folklor vijoi të jetë një veçori e zhvillimit të poezisë edhe gjatë këtyre viteve. Një varg poetësh (D. Agolli, K. Jakova, A. Shehu, etj.) përfshinë në krijimtarinë e tyre mjaft elemente nga pasuria e poezisë gojore. Karakteristikë për këtë periudhë është shfrytëzimi në mënyrë krijuese i folklorit. Marrja e subjekteve apo e heronjve të folklorit u bë diçka e rrallë; u shfrytëzuan sidomos mjetet e përgjithshme të të menduarit artistik të popullit, parimet e organizimit të rrëfimit poetik etj.

Qëndresa heroike e masave punonjëse kundër bllokadës imperialisto-revizioniste, lufta kundër mbeturinave të botës së vjetër dhe shfaqjeve të ideologjisë borgjeze dhe revizioniste përcaktuan karakterin luftarak të veprave poetike që u shkruan në këto vite. Të ndriçuar nga udhëzimet e Partisë që letërsia të ruajë pastërtinë e vet ideore dhe të jetë armë e mprehtë në luftën e sotme ideologjike, poetët vunë të gjitha forcat në mbrojtje të fitoreve të rendit socialist dhe zhvilluan luftën ku-

ndër ideologjisë së huaj. Kjo u shpreh në pozitat e qarta ideore që zunë ata në pasqyrimin e jetës, në thellimin e frymës së partishmërisë dhe të tendenciozitetit klasor të krijimtarisë poetike. Megjithatë pati poetë që nuk iu përmbajtën në mënyrë konsekuente parimit të partishmërisë proletare dhe ranë në ndikimin e koncepteve dhe të formave të letërsisë dekadente reaksionare, që depërtuan nga jashtë. Në faqet e disa organeve, si në «Drita», «Nëntori» dhe «Zëri i rinisë» u botuan vepra të përshkuara nga fryma individualiste dhe e jetërsimit, krijime të pakuptueshme, të drejtuara një elite lexuesish, poezi për të cilat ishte karakteristike rendja pas formave pseudonovatore, që e zhvishnin artin nga roli i vet shoqëror edukativ. Ndonëse këto shfaqje nuk përcaktonin fizionominë e poezisë së re, prapë ato përfaqësonin rrezik jo të vogël, sepse flisnin për humbjen e frymës revolucionare tek disa krijues dhe për qëndrim liberal ndaj ndikimeve të letërsisë borgjezo dhe revizioniste. Ndikimet e huaja u goditën ashpër nga opinioni letrar; kjo dha dorë për forcimin e partishmërisë komuniste në krijimtarinë poetike.

1

Tema qendrore e poezisë së kësaj periudhe ishte ajo e atdheut socialist, e gjallërisë dhe e forcës së tij për të kapërcyer me guxim të gjitha vështirësitë dhe pengesat. Me veprat e tyre poetët synuan të ngrejnin më lart shpirtin e paepur të popullit përballë rrethimit borgjezo-revizionist, të forcojnë në ndërgjegjen e njerëzve optimizmin dhe frymën revolucionare. Poezia jetoi aktivisht me problemet dhe shqetësimet e mëdha të epokës, ajo i këndoi shpirtit të pamposhtur të popullit shqiptar, i cili, duke mos marrë parasysh vështirësitë dhe rreziqet e reja që i kanoseshin, doli hapur dhe me guxim kundër tradhtisë revizioniste. Sigurisht, lidhja e ngushtë me problemet e mëdha të jetës së vendit, patriotizmi dhe karakteri aktiv e shquanin edhe më parë poezinë. Në vitet e përleshjes së ashpër me revizionistët modernë këto veçori fituan karakter më luftarak. Në çdo gjë që shkruan poetët në këto vite, në çdo fjalë dhe figurë u shpreh devotshmëria e flaktë ndaj atdheut socialist dhe urrejtja e thellë kundër gjithë atyre që u orvatën të pengonin marshimin e socializmit në Shqipëri.

Një nga poetët më të shquar në këto vite ishte I. Kadareja, krijimtaria e të cilit hyri në një fazë më të lartë. Talenti poetik i tij u rrit më tej në luftën për të zgjeruar dhe pasuruar poezinë shqiptare të realizmit socialist. Ai botoi në këto vite një varg përmbledhjesh poetike si: «Përse mendohen këto male» (1964), «Vjersha dhe poema» (1966), «Motive me diell» (1968), të cilat u karakterizuan nga pasuria e problematikës dhe nga përdorimi i një figuracioni me ngërthesë të gjerë ideore dhe shprehimësi të veçantë. Poemat e tij më të shquara janë «Përse mendohen këto male» (1964) dhe «Shqiponjat fluturojnë lart» (1966). Në këto vepra I. Kadareja synoi të japë të tashmen në kontekstin e historisë shekullore të Shqipërisë. Qoftë kur iu drejtua së kaluarës historike, qoftë kur bëri objekt të pasqyrimin artistik ngjarjet e mëdha të historisë së re të vendit, poeti iu rresht tregimit të ngjarjeve konkrete, marrë në lidhjet e tyre shkakore apo kohore; kuptimin e ndodhive të jetës poeti e dha përmes figurave dhe imtësive shprehëse që ngërthejnë një kuptim të gjerë, shpesh simbolik. Në poezinë e I. Kadesë vendin qendror e zënë përsiatjet poetike, zhvillimi i idesë jo përmes paraqitjes së ngjarjeve, por me anë të rrëfimit lirik.

Tema e krijimeve të tij më të rëndësishme, kushtuar problemeve të mëdha të epokës, përcaktoi tonin solemn, në të cilin nuk mungojnë nota zemërimi apo ironie atëhere kur poeti sjell në mend shkaktarët e gjendjes së rëndë të masave të popullit në të kaluarën ose orvatjen e armiqve të sotëm për të ndaluar ndërtimin socialist në Shqipëri. Ky ton nuk e pengon poetin në përpjekjet e tij për të zbuluar thelbin e epokës, për të dhënë një pasqyrim sa më të saktë dhe me vërtetësi të historisë a të aktualitetit socialist.

**PËRSE MENDOHEN
KËTO MALE**

Në poemën «Përse mendohen këto male» u shprehën përsiatjet rreth forcës së pamposhtur të popullit shqiptar, rreth aspiratës së tij të patundur për jetë të lirë dhe të pavarur, rreth gjallërisë së tij të pashembullt nëpër dallgët e historisë.

Poema pasqyron historinë mijëravjeçare të shqiptarëve në formë shumë të sintetizuar ose më saktë jep thelbin e jetës së tyre historike që shprehet në luftërat e pareshtura që ata

kanë bërë për ekzistencë, jetë të lirë dhe për përparim shoqëror. Duke përdorur pamje poetike me përmasa të gjera, autori arriti ta vizatojë me ngjyra të gjalla figurën e madhërishtme të Shqipërisë së shumëvuahtur, por gjithnjë krenare dhe të pashmë. Që kur u shfaq në histori, populli shqiptar nuk pa ditë të qeta; mbi të vërshuan njëri pas tjetrit rreshe të egra dhe të shumta. Mjerimi, zia dhe uria kanë mbretëruar në trojet e shqiptarëve. Më se një herë armiq të ndryshëm, të ardhur nga anë e anës, iu turrën Shqipërisë si bisha të egra për ta copëtuar, për të shkretuar qytetet dhe fshatrat dhe për të zhdukur banorët e tyre. Poeti përdori figura që e japin me shumë shprehimësi idenë e ekzistencës së vështirë historike të shqiptarëve. Shekujt e kaluar, që nuk u treguan dashamirës ndaj Shqipërisë dhe i sollën shumë shqetësime, poeti i krahason me qentë e tërbuar, që sulen me tërbim mbi viktimat e tyre:

*Shekujt si qentë të kafshuan
ku mundën të të hanë.*

*Mes tyre tek shkoje,
ata të sulleshin,
dhëmbët e kohrave
në ije të nguleshin,¹*

Këtë krahasim të fortë dhe shumë shprehës poeti e përdor më se një herë, duke e plotësuar dhe zhvilluar për ta bërë akoma më të qartë:

*Dhe armiqtë e egër kafshonin kufijtë,
kafshonin supet e zhveshur, të zbehtë t'atdheut.²*

Por të këqijat shqiptarëve nuk u kanë ardhur vetëm nga pushtuesit e huaj të cilët janë përpjekur t'i kthejnë ata në skllëvër ose t'i zhduknin nga faqja e dheut. Shqiptarët kanë vuajtur edhe nga varfëria, sëmundjet dhe mynxyrat e shumta, që i ndoqën ata pa ndërprerje në rrugën e tyre historike. Vërshimet e hordhive të huaja linin pas si trashëgim gër-

1) I. Kadare, *Përse mendohen këto male*, Tiranë 1964, f. 46.
2) Po aty, f. 49.

madha e shkatërrime; ato kthenin në pluhur vlera të shumta materiale të krijuara me djersën dhe sakrificat e sa e sa brezave. Dhe nga këto rrënime që s'reshën asnjëherë, vendi mezi e merrte veten. «Ethet» dhe «malarja» «tretin trupin e Shqipërisë», vë re me dhimbje poeti. Këto nota bëhen edhe më të theksuara në vargjet ku rrëfëhet historia e dhimbshme e sa e sa djemve të popullit, që lanë eshtrat «rërave të Saharasë, duke kënduar këngën e urës së Qabesë!».

Megjithëse u ra shorti të bëjnë një jetë historike plot trazira dhe rreziqe, shqiptarët nuk u gjunjëzuan asnjëherë. Në çdo rrezik ata qëndruan si burrat dhe nuk kursyen gjakun për të mbrojtur jetën dhe lirinë e tyre. Atyre s'u është trembur syri as nga numri i madh i armiqve dhe as nga armatimet e tyre. Rrethanat historike nxitën dhe forcuan tek shqiptarët një frymë të jashtëzakonshme qëndrese. Poeti më se një herë e vë në pah aftësinë e habitshme të popullit shqiptar për t'u bërë ballë rresheve të historisë dhe për të dalë prej andej gjithnjë i gjallë dhe i fortë. Duke rrëfyer për vështirësitë dhe mjerimet e pareshtura me të cilat është mbushur historia e Shqipërisë, poeti thekson se, me gjithë faktorët e shumtë e të disfavorshëm nëpër shekuj, shqiptarët «nuk u thyen» dhe «nuk u përkulën». Forcën dhe gjallërinë e pashtershme të shqiptarëve poeti e dha në vargje, të cilat me ngjyra lapidare dhe në mënyrë të përgjithësuar, shprehën idenë qëndrore të poemës:

*Po ta vrisje në një breg
në tjetrin dilte,
sikur mbinte nga toka,
shqiptari i thatë
dhe përmbi trup
si shtesë e hekurt
i rritej e zezë
pushka e gjatë.*

*Me të në krahë
në male e fusha
endej ai në këto vende.
Më të gjatë shtatin ja bënte pushka.
megjithëse shpesh jetën më të shkurtër ja bënte!*

1) Po aty, f. 50-51.

Dy vargjeve të fundit poeti u ka dhënë një theks polemik: sikur t'u përgjigjej shpifjeve të armiqve dhe të keqdashësve të vendit, të cilët s'kanë pushuar edhe sot e kësaj dite, të shpifin për popullin shqiptar, duke e quajtur «popull të egër», që «nuk mund të rrojë pa pushkë», autori më se një herë i kthehet këtij motivi, duke vënë në dukje se shqiptarët ishin shtrënguar nga rrethanat e historisë të mos e lëshonin pushkën nga duart. Pushka, e cila i ka mbirë mbi shpinë, si një «asht i gjatë», është për poetin shenjë e «fatit të vështirë». që ka pasur si short shqiptari në histori.

E kaluara e popullit shqiptar përmes rrëfimit emocionues dhe konciz të poetit del si histori e rreptë, plot luftëra e beteja të pareshtura. Trazirat dhe vuajtjet nuk ia shuan shqiptarit ëndrrën për lumturi dhe jetë të lirë. Ishte kjo një ëndërr shumë modeste, ëndrra e një populli, që kishte njohur në historinë e vet pak ditë të bardha dhe shumë ngjarje të hidhura:

*...ëndërroje kaq pak lumturi,
sa në botë s'ka ëndërruar njeri.*

*Ëndërroje
një copë më shumë bukë,
një lugë më shumë shëllirë.
Ëndërroje shëllirën dhe bukën
dhe pak, fare pak, yndyrë,
që ta haje bashkë me pushkën.¹*

Edhe pas vitit 1912, kur shqiptarët fituan lirinë e pavarësinë kombëtare, historia, vë re poeti, u soll me ta po aq aspër si në shekujt e kaluar. Pas krijimit të shtetit kombëtar, klasat sunduese i rrëmbyen popullit frytet e gjakut që kishte derdhur, i rrëmbyen gjithçka të bukur që ia bën njeriut jetën të dashur, dhe i lanë vetëm një të drejtë: të rropatet për një copë bukë që të mbante veten gjallë. Realiteti i egër shoqëror i rendit çifligaro-borgjez mbyste tek njerëzit çdo përpjekje për kulturë dhe për përparim. Ata pak intelektualë të nder-

1) Po aty, f. 51.

shëm që kishte vendi, bridhnin poshtë e lart me ëndrra të she mbura. Bashkë me klasat e vjetra, amullinë dhe terrin që sundonte në Shqipëri e mbronin «minaret dhe kumbonaret», që «bekonin gjakmarrjen» dhe poetët reaksionarë, të cilët, me idealizimin e traditave fisnore-patriarkale në jetën e vendit, paralizonin energjitë e masave.

Forcat e vjetra, duke shenjtëruar gjithçka reaksionare, bëjnë çmos për ta mbajtur popullin në skllavërinë shoqërore e shpirtërore, në të cilën ai vazhdonte të rronte që prej kohësh. Por ato nuk arritën dot të zhduknin dëshirën e papërmbajtur të popullit për t'u çliruar nga zgjedha e rëndë e për të zënë vendin e tij të denjë në mes të popujve të lirë. Në ato vite populli luftoi për të hequr qafe jo vetëm armiqtë e huaj, por edhe mjerimin dhe injorancën. Ky motiv, motivi i aspiratës shekullore të popullit shqiptar për të zënë udhën e lirisë, të diturisë dhe të përparimit, merr jetë nga fundi i poemës; në këngën që përmyll poemën, Shqipëria pasqyrohet përmes figurës së maleve, vargu i gjatë i të cilëve i shëmbëllen poetit me një karvan, që ka humbur rrugën në errësi. Nga gjiri i popullit dolën njerëz të ndershëm dhe të guximshëm, që u përpoqën të çanin përpara, por e «humbën në terr udhën». Megjithatë përpjekjet nuk pushuan; në popull vlonte dëshira për çlirim:

*Dhe kështu vërtiteshin si karvani në shkretëtirë
gjersa qetësoheshin e urtësoheshin prapë,
.....*

*Por qetësia ish e gënjeshtër,
karvani i gjatë i maleve priste
ta printe përpara një udhëheqës,
priste Shqipëria
Partinë Komuniste.¹*

Kështu bëhet lidhja e përpjekjeve shekullore për liri dhe pavarësi me epokën e Luftës Nacionalçlirimtare kur populli

1) Po aty, f. 56.

shqiptar, në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë, fitoi mbi pushtuesit e huaj e tradhtarët dhe realizoi aspiratën e tij shekullore për drejtësi shoqërore. Poemën «Përse mendohen këto male» e përshkon bindja se populli shqiptar, ashtu si në të kaluarën, edhe në të ardhmen do t'u bëjë ballë me guxim rreziqeve dhe pengesave, që do të hasë në rrugën e tij drejt shoqërisë komuniste. Ai ka një gjallëri që rrallëkush e ka nga popujt e tjerë dhe kjo është garanci e sigurt e fitoreve të ardhme mbi armiqtë e ndryshëm. Kjo ide e rëndësishme rrjedh si përfundim logjik i rrëfimit emocionues mbi rrugën e vështirë të popullit shqiptar nëpër shekuj; poeti është i bindur thellë se Shqipëria do t'u bëjë ballë me guxim armiqtë të rinj: revizionistëve modernë.

Forma e sintetizuar përmes së cilës është dhënë historia shumëshekullore e Shqipërisë ka përcaktuar edhe veçoritë e poemës nga pikëpamja e llojit. «Përse mendohen këto male» është poemë liriko-epike. Karakteri epik duket në pamjet e përgjithësuara nga e kaluara, të cilat i bashkon ideja kryesore e veprës; këmbimi i pamjeve poetike, i nënshtrohet synimit të poetit për të vënë në pah në mënyrë sa më të plotë kuptimin e përvojës historike shekullore të popullit shqiptar. Në poemën «Përse mendohen këto male» I. Kadareja përdori si në poemat e tij të mëparshme një figuracion shumë shprehës. Figura e shekujve, që, si «qentë kafshuan ku mundën» apo «dhëmbët e kohërave, që nguleshin në ijët e Shqipërisë», shquhen nga fryma emocionale e theksuar. Shpesh autori përdor personifikimin e sendeve ose të nocioneve abstrakte. Kështu p.sh. Shqipëria përfytyrohet si qenie e gjallë. «Përtyrje legjenda në netët e acarta, nga uria haje këngët e tua prapë», i drejtohet Shqipërisë poeti. Karakter të përgjithësuar ka figura e shqiptarit, me pushkën që i ka mbirë në shpinë si eshtër e gjatë. Kjo është arritur, siç shihet, përmes përdorimit të fjalëve të thjeshta, të cilat fitojnë vlerë artistike në saje të ngarkesës së tyre të veçantë emocionale.

Poema ka strukturën e saj ritmiko-intonative, e cila rrjedh nga karakteri i përsiatjeve dhe i ndjenjave të shprehura në të. Për të zhvilluar në mënyrë sa më të gjallë përsiatjet e tij mbi të kaluarën e vështirë të atdheut, autori ka përdorur më shpesh vargun e lirë të kombinuar me jambin e gjatësive të

ndryshme. Krahas rimave të sakta (gjëmim-popullit tim, vjeshtë e tretë — xhadetë), janë futur në përdorim në mënyrë të shpeshtë edhe rimat e përafërta të tipit: vetëmi-shkretëti, çen-gitë — priftërinjtë, shtojzavallet — kokallat etj.

* * *

Duke folur për frymën e paepur të popullit shqiptar në shekuj, për vendosmërinë e tij për të kapërcyer vështirësitë e reja që i kanë dalë dhe do t'i dalin në rrugën e tij drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste, poetët thurën vargje të reja plot frymëzim për Partinë, që udhëhoqi popullin shqiptar në betejën për çlirimin e atdheut dhe për fitoren e revolucionit popullor dhe po udhëheq sot në betejat fitimtare kundër armiqtë të shumtë, të brendshëm dhe të jashtëm, që u orvatën t'i mohonin popullit tonë të drejtën për të jetuar i lirë dhe i pavarur, për të ndërtuar shoqërinë e vërtetë socialiste në vendin e tij. Poetët panë te Partia, udhëheqësen e urtë dhe tejzamëse të popullit, që siguron marshimin e tij të pandalshëm në rrugën e socializmit e të komunizmit.

Në poemën «Shqiponjat fluturojnë lart» (1966) I. Kadareja figurën e Partisë e vizatoi në plan të gjerë historik.

Themelimin e Partisë poeti e paraqiti si kthesë rrënjësore në fatet e vendit, si domosdoshmëri historike në rrugën e luftës shekullore të popullit shqiptar për jetë të lirë dhe të lumtur. Vepra u shkrua me rastin e 25-vjetorit të themelimit të Partisë. Autori synoi të shprehë idenë e karakterit madhështor dhe heroik të veprës së Partisë, të zbulojë rrënjët që ushqejnë forcën e saj. Në vegimin poetik të I. Kadesë faktet e historisë marrin një domethënie të përgjithshme historiko-filozofike; autori nuk tregon aq ngjarjet, sesa vihet në mendime për kuptimin dhe rëndësinë e tyre historike. Karakteristikë për strukturën e poemës është alternimi i lirë i çasteve lirike me përshkrimet poetike, i imtësive a skenave të së kaluarës me mendimin për të tashmen.

Në poemë Partia shfaqet si forcë që trashëgoi traditat hi-

storike-revolucionare të popullit shqiptar dhe përmbushi me veprën e saj aspiratat e tij shekullore për liri dhe drejtësi shoqërore. Poeti e përfytyron Partinë si rrap madhështor me rrënjët thellë në tokë. Me këtë figurë autori ka shprehur idenë se forca e Partisë qëndron në lidhjet e saj me popullin. Partia shpreh dhe përmbush ëndrrat më të shtrenjta të masave. Kjo ide plotësohet në vargjet që rreshtohen si përgjigje të apostrofës «Ku t'i kërkoj rrënjët e tua, Parti»? Idenë se vepra e Partisë është e pavdekshme poeti e nxjerr në pah përmes figurash që ngërthejnë një ngarkesë poetike-emocionuese të veçantë:

*Që të të shkulim ty,
duhet që të përmbysin
tërë këtë tokë të lashtë e të rëndë;
të përmbysin
kështjellat,
malet,
këngët,
të ngrenë nga balta e të rivrasin të rënët.¹*

Së këtëjmi rrjedh edhe patosi optimist i veprës, besimi i patundur në të ardhmen e vendit, në udhëheqjen e urtë dhe të drejtë të Partisë.

Ideja e kthesës historike që shënoi në jetën e vendit lindja e Partisë zbulohet në poemë me një forcë të rrallë poetike. Detyrën e vet poeti e ka zgjidhur me anë të analogjisë me dukuritë e ndryshme, që ngjallin një varg asociacionesh e idesh të thella poetike, si dhe me anë të përdorimit të imtësive shprehëse në ndërtimin e figurave artistike. Duke e përfytyruar të kaluarën e këtij populli si një jetë të mjerë, që shtrihej midis dy gurëve, gurit që i shërbente shqiptarit si jastëk dhe gurit të varrit, poeti pohon se Partia i dha një kuptim të ri ekzistencës së këtij populli, e frymëzoi atë me një ideal të ri, futi në të këngë dhe marshe të reja. Partia Komuniste Shqiptare doli në dritë në një çast të rëndë të jetës së popullit shqiptar, kur atij i kanosej rreziku i zhdukjes si komb. Historia

¹ I. Kadare, *Motive me diell*, Tiranë 1968, f. 115.

e thirri Partinë të udhëhiqte luftën më të lavdishme në historinë e shqiptarëve, luftën që do të kurorëzonte përpjekjet e tyre shekullore për liri, në emër të së cilës ata kishin derdhur lumenj gjaku. Poeti evokon vitet e rënda të pushtimit fashist; duke krijuar pamje të gjalla poetike, ai tregon me qartësi të veçantë rëndësinë historike që pati për fatet e vendit themelimi i Partisë më 8 nëntor 1941. Figurat shprehëse emocionale si p.sh. ajo e vjeshtës me leshrat e kuqërremta të qullura nga shtrëngatat, e barit të zi, e gjetheve të përgjakura, e rrezeve të diellit të gjakosura në telat me gjemba dhe e vetëtimës «në qiell të revolucionit me re dhe me suferinë», krijojnë atmosferën e kohës kur vendi po gulçonte nën peshën e rëndë të zgjedhës së huaj. Në mënyrën e vizatimit të viteve të pushtimit fashist dhe, në përgjithësi, në mënyrën e zhvillimit të idesë shfaqen disa nga veçoritë e të menduarit poetik të I. Kadesës, i cili u jep jetë jo vetëm objekteve të realitetit lëndor, por edhe ideve abstrakte, çka përcakton forcën, gjallërinë dhe karakterin aktiv emocional të figurave të poemës. Kështu përmes figurës së përbindëshave që «shtegtojnë mbi tri këmbë druri», të të varurve që tunden «si pendule të bardhë» të «orëve fatale» apo të «altit» që «si një sfinks i tmerrshëm» orvatet t'i presë rrugën Shqipërisë, është pikturuar atmosfera e terrorit të egër fashist, në kulmin e të cilit ilegalët u mblodhën të themelonin Partinë.

Vend qendror në poemë zënë vargjet kushtuar themelimit të Partisë. Mbledhja historike e përfaqësuesve të grupeve komuniste shërben si shtysë që nxit përsiatjet e poetit për epokën, për fatet e vendit dhe për përgjegjësinë që çasti historik u vinte shqiptarëve. Për poetin rëndësia e themelimit të Partisë qëndron në atë se për herë të parë në historinë e vendit lindi ajo forcë që do të realizonte aspiratat shoqërore të vegjëlisë, lindi Partia e popullit të thjeshtë, e vegjëlisë. Këtë ide autori e ka theksuar përmes një imtësie poetike shprehëse: themelet e Partisë u hodhën në një shtëpi të varfër tiranase. Ajo që e dallon themelimin e Partisë nga dhjetëra e dhjetëra ngjarje historike të së kaluarës është se Partia Komuniste e Shqipërisë lindi për të siguruar çlirimin kombëtar e shoqëror të popullit, masat e gjera u bënë djepi dhe burimi i forcës së saj.

Poeti rrëfen për themelimin e Partisë jo si soditës i së

kaluarës, por si njeri i interesuar aktivisht për të nxjerrë në pah në mënyrë sa më të qartë domethënien dhe kuptimin e madh historik të ngjarjes që formon brendinë e poemës. Duke folur për këtë ngjarje sikur të ishte i pranishëm në mbledhjen që vendosi themelimin e Partisë, poeti thotë se preokupimi kryesor i gjithë forcave të shëndosha të grupeve komuniste ishte që Partia të ngrihej mbi baza të shëndosha organizative dhe ideologjike:

Po vihen themelet e Partisë:

kujdes!

*Që në themele të mos hyjë lagështira e llumit,
që gurët të jenë
copra shkëmbinjsh me besë.¹*

Një nga tiparet e stilit të poemës së I. Kadaresë është përdorimi i asociacionit, lidhja që krijon poeti në imagjinatën e vet midis dukurive e fakteve të ndryshme. Kështu, llamba me vajguri në dritën e së cilës u hartua Thirrja e parë e Partisë drejtuar popullit shqiptar, i kujton poetit të kaluarën e mjeruar të vegjëlisë dhe në të njëjtën kohë i zbulon si në një vegim të ardhmen e ndritur të vendit, i parathotë hidrocentralet, fabrikat dhe kombinatet që projektonte Partia. Imagjinatës së poetit i shfaqen pranë njëra-tjetrës si nocione të afërta vetëtima dhe firma e themeluesit të Partisë, të cilën autori e përfytyron gjithmonë të kuqe dhe të shpejtë, që nga Thirrja e parë e Partisë për luftë kundër pushtimit fashist deri tek Letra e Hapur. Me këtë krahasim shprehet ideja e rolit të madh historik të shokut Enver Hoxha në luftën e popullit shqiptar për të fituar lirinë dhe për të mbrojtur e çuar përpara revolucionin.

Poemën «Shqiptonjat fluturojnë lart» e karakterizojnë notat patetike dhe romantika e së ardhmes, e cila shfaqet përmes asociacioneve ose në formën e ëndrrës. Kjo veçori e brendisë ka gjetur shprehje edhe në sistemin figurativ të veprës. Krahas metaforave, krahasimeve e tropeve, me një ngjyrë të theksuar liriko-emocionale është përdorur edhe ndonjë figurë

1) Po aty, f. 123.

e kësaj natyre që ngrihet deri në simbol, siç është figura e shqiptonjës, përmes së cilës poeti ka shprehur guximin, vru-llin dhe frymën revolucionare të Partisë, si një nga tiparet e saj më karakteristike. Për të nxjerrë më mirë në pah këtë tipar dhe për të theksuar idenë se komunistët qenë e vetmja forcë politike që u doli zot fateve të vendit, poeti ka përdorur kontrastin midis vrullit të fuqishëm të fluturimit të shqiptonjave në qiellin e stuhishëm të epokës dhe pamjes së neveritshme të jetës së plogësht të intelektualëve pseudopatriotë që, siç shprehet poeti, dinin vetëm «të cicëronin» si zogj, në një kohë kur atdheu «kish ethe». Duke evokuar ditën e lavdishme kur lindi Partia, poeti u jep udhë ndjenjave dhe mendimeve të tij që shprehen përmes një toni të ngritur, çka i bën vargjet përmbyllëse të tingëllojnë si ditiramb kushtuar Partisë.

Edhe temën për poemën «Vitet gjashtëdhjetë» (1969) I. Kadaresë ia sugjeroi lufta e popullit shqiptar me Partinë në krye kundër revizionistëve modernë, për të mbrojtur marksizëm-leninizmin dhe fitoret e arritura prej popullit shqiptar, për të çuar më tej revolucionin në Shqipëri. Poeti flet për guximin dhe frymën e lartë parimore të Partisë, e cila ngjalli admirimin dhe respektin e popujve dhe të revolucionarëve të të gjithë botës. Për të kryer detyrën e saj internacionaliste, Partia e Punës asnjëherë nuk iu është shmangur dhe nuk do t'u shmanget betejave për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit sado të vështira qofshin ato. Vitet 60 përfytyrohen nga autori si vite të tendosura, plot rreziqe për revolucionin socialist botëror. Thelbi i asaj që ndodhi në lëvizjen komuniste botërore zbulohet përmes figurave me ngërthesë ideore e emocionale të gjerë. Veprën kobëzezë të revizionistëve poeti e krahasoi me rolin famëkeq të Kalit të Trojës, kurse pushtuesit e Çekosllovakisë i cilëson «Ulksat dhe Menellajt e shekullit XX».

Kryesore në poemën e I. Kadaresë është pasqyrimi i luftës burrërore të Partisë kundër tradhtisë revizioniste. Për Partinë vitet 60 ishin vite të një prove të madhe, të cilën ajo e kaloi

me sukses thotë poeti sepse atë e ka shquar gjithnjë fryma revolucionare, sepse ajo është kalitur në luftërat dhe betejet heroike, që ka zhvilluar për të nxjerrë vendin nga robëria fashiste dhe për ta çuar në rrugën e ndërtimit të jetës së re dhe të lumtur:

*Këto vite të ashpëra si gurë monumentesh,
kjo kohë,*

*bijë tufanesh e nënë tufanesh
kish brenda të ngjeshura gjith alarmet, epikën
nga muret e Krujës*

te zjarret partizane.¹

Duke folur për ngjarjet që përshkuan jetën e vendit në këto vite, poeti vë në dukje rolin historik të shokut Enver Hoxha në luftën e forcave të shëndosha të lëvizjes komuniste botërore kundër tradhtisë së revizionistëve modernë. Në qëndrimin e guximshëm dhe frymën e lartë parimore të shokut Enver u shpreh kurajoja e madhe dhe bindja e thellë e Partisë së Punës në drejtësinë e vijës së saj, që mbështetet në forcën e pa-
mposhtur të ideve të marksizëm-leninizmit.

* * *

Në këto vite në një etapë më të lartë zhvillimi hyri edhe talenti i D. Agollit, krijimtaria e të cilit zë vend të shquar në poezinë e kësaj periudhe. Krijimtaria e D. Agollit shquhet nga lidhja organike me jetën e vendit, nga synimi për t'u bërë jehonë problemeve të mëdha të epokës dhe nga fryma e pasionuar. Në poemat e tij të para «Poema e rrugës» dhe «Poemë për babanë dhe për vete» dhe në përmbledhjet e tij poetike «Hapat e mija në asfalt» (1961), «Shtigje malesh dhe tro-
tuare» (1965), «Mesditë» (1969), gjeti mishërim ideja e pa-

1) I. Kadare, *Vjersha dhe poema*, Tiranë, 1976, f. 114.

triotizmit të flaktë të popullit, transmetuar si traditë e çmuar brezit të ri nga brezi i vjetër dhe lidhur me këtë u shpreh ideja e unitetit të popullit. Poet me temperament të spikatur qytetar, D. Agolli edhe në vitet 60 iu drejtua temës së popullit, të luftës dhe të përpjekjeve të tij për ndërtimin e jetës së re. Poemat «Devoll, Devoll», «Baballarët» dhe «Poema malore» lindën në atmosferën revolucionare, kur luftën për të çuar më tej revolucionin socialist populli e zhvilloi krahas luftës kundër bllokadës imperialisto-revizioniste. Këto poema janë ndër arritjet më të shënuara të poezisë shqiptare të realizmit socialist.

Tipar karakteristik i stilit të D. Agollit është thjeshtësia dhe qartësia. Përsiatjet e thella për atdheun, për jetën dhe përpjekjet e popullit, poeti i shpreh me fjalë të thjeshta, që kanë kuptim të përpiktë; ai u reshtet shprehjeve të kërkua dhe figurave retorike. Kësaj i përgjigjet edhe intonacioni i shtruar dhe i natyrshëm i rrëfimit poetik, që poeti ndërton në frymën e ligjërimit të përditshëm të popullit, mbi bazën e përvetësimit krijues të traditës popullore.

«Devoll, Devoll» (1964) i ngjan një monologu lirik që pohon lidhjet e ngushta shpirtërore të individit me popullin dhe me çështjen e socializmit. Dashuria e flaktë për atdheun formon patosin e poemës, të cilën e përshkon tejedanë si rrymë gurgulluese hareje për popullin që rron i lirë dhe i lumtur, krenaria që i zgjon poetit vetëdija se është «një plis» i këtij trualli, një ushtar i revolucionit. Duke folur për jetën e re të Devollit, poeti merr shkas të zbulojë qëndrimin e tij ndaj problemeve të rëndësishme që shqetësojnë vendin. Me gjithë elementin autobiografik, poema fiton në këto këngë një kuptim më të gjerë; ndjenjat dhe mendimet e poetit janë ndjenjat dhe mendimet e brezit të tij, heroi lirik është poeti qytetar që hyn në bisedë me atdheun dhe pohon kuptimin e misionit të poetit në shoqëri, të lidhjes së artit të vërtetë me jetën e popullit.

Që në vargjet e para të poemës D. Agolli pohon me plot gojën se talenti i tij është thirrur t'i qëndrojë besnik popullit, të sjellë në poezi një pjesë të botës së tij, të pasqyrojë frymën

dhe koloritin e jetës popullore, shqetësimet dhe ëndrrat e njerëzve të thjeshtë të punës:

Po, Devoll,
i tillë qenkam unë,
paskam marrë baltën tënde arave,
në një trastë leshi
ndënë gunë,
për t'ia sjellë
Lidhjes së Shkrimtarëve.¹

Poema është në fakt një farë kredoje poetike e autorit, i cili mbron atë lloj poezie që ka frymë dhe formë thellësisht kombëtare e popullore dhe që kryen një mision të lartë qytetar. Ideali i një poezie të mburjtur me idetë dhe shqetësimet e kohës, e cila mbetet kombëtare për nga brendia, fryma dhe forma e saj, përvijohet në mënyrë të natyrshme përmes tregimit lirik të autorit për veten dhe poezinë e tij. Duke pohuar që në krye se ai, ndonëse ka bredhur kontinenteve, mbeti prapëseprapë biri i Devollit, poeti shpreh idenë se arti i vërtetë, arti i madh, është i pandarë nga populli, nga jeta e tij; ai lind në truallin e mendimeve dhe të brengave të vendit:

Mbeti ajo baltë,
mbeti ai bar,
ai tërfil,
mbeti ai fyell,
ai mjaltë,
mbeti ai gjemb e trëndafil...²

Duke luftuar për një art që i qëndron besnik shpirtit të popullit, autori në të njëjtën kohë ngrihet kundër poezisë kozmopolite, e cila shpejt a vonë do të fishket si një bimë që i ka rrënjët e dala. Në poemë ka gjetur shprehje dashuria e poetit për folklorin, të cilin e çmon si një nga pasuritë më të mëdha artistike të popullit, si gurrë të pashtershme për lulëzimin e

1) D. Agolli, *Shtigje malesh dhe trotuare*, Tiranë 1965, f. 51.

2) Po aty, f. 51.

krijimtarisë letrare-artistike. Dashuria e poetit për traditën popullore shpreh idealin e tij për një poezi që ushqehet nga gura e kësaj tradite. Duke i dalë zot poezisë që shfrytëzon në mënyrë krijuese burimet e krijimtarisë poetike popullore, D. Agolli në të njëjtën kohë është kundër stilizimit të motiveve të folklorit. Autori ironizon ata poetë që kufizohen në imitim formal të modeleve të krijimeve popullore dhe të çdo lloj poezie që përshkohet nga fryma sentimentaliste dhe kultivon ndjenja të ngushta e të vogla. Ideja se poeti duhet të jetë syri dhe veshi i epokës, duhet të jetojë me shqetësimet e vendit dhe të popullit, është një nga idetë kryesore të veprës.

Përmes monologut lirik që evokon vitet e luftës dhe sakrificat e vegjëlisë që u ngrit në këmbë me ëndrrën e një shoqërie të re, autori ka zbuluar idenë se ngritja e socializmit është ideali i letërsisë së re. Kujtimi i atyre që ranë pa e parë të realizuar ëndrrën e tyre më të shtrenjtë, zgjon në poemë ndjenjën e detyrës qytetare dhe përcakton frymën solemne përmes së cilës shprehet vendosmëria e brezave për t'u qëndruar besnikë idealeve komuniste:

Hej,
Devoll,
sa armë zbraza unë
për këtë t'uruar komunizëm!
.....
Në shënjestër prap më kanë vënë
snajperët e shquar përtej deteve,
unë s'dridhem,
unë s'e ul zënë,
mbetem komunist për jet' të jetëve..¹

Në poemë problemi i qëndrimit të artistit ndaj realitetit socialist, problemi i besnikërisë ndaj popullit gërshetohet me problemin e shkrirjes sa më organike të inteligjencies së re me masat popullore e me idenë e të jetuarit me gëzimet dhe brengat e tyre. Artisti, në përgjithësi intelektual popullor,

1) Po aty, f. 57.

si bir i këtij vendi, duhet të rrojë me shqetësimet e jetës popullore; në figurën e inteligjencies së re poeti thekson si tipar thelbësor afërinë me masat, lidhjen organike me ndjenjat, mendimet dhe aspiratat e masave.

Heroi lirik i poemës «Devoll, Devoll» mishëron tiparet më të mira të njeriut tonë të rritur në epokën e socializmit, dashurinë e madhe për vendin dhe gatishmërinë për të dhënë jetën për mbrojtjen e fitoreve të socializmit; ai ka një botë shpirtërore të pasur, ushqen ndjenja dhe dëshira fisnike.

Në poemën «Devoll, Devoll» janë shfaqur në mënyrë më të qartë disa nga tiparet më të qenësishme të talentit të D. Agollit si poet me frymëzim spontan, që ka arritur të shprehë me mjeshtëri përmes një gjuhe të gjallë e të bukur mendimet dhe shqetësimet e njeriut tonë të përparuar. Lirizmi i ngrohtë dhe figuracioni i vetvetishëm, në të cilin ka gjetur pasqyrim koloriti i poezisë dhe i jetës popullore, janë dy anët më të forta të personalitetit të tij poetik.

BABALLARËT

Poemën «Baballarët» (1967) e përshkon ideja e rëndësishme se brezi i vjetër, që ka mbajtur mbi supet e tij brenëgat e atdheut, do të ecë gjithmonë në një hap me jetën e re dhe se brezi i ri, në dejtë e të cilit rrjedh gjaku i baballarëve, do ta mbajë dhe do ta shpjerë më tej, stafetën e revolucionit. Vepra është ndërtuar si apostrofë e gjerë, plot përsiatje të thella mbi kohën e sotme. Kryesore në poemë janë mendimet dhe ndjenjat e poetit që derdhen në mënyrë spontane dhe harlisin frymëzimin e tij. Alternimi i këtyre ndjenjave me shqetësimet dhe mendimet e baballarëve ka përcaktuar strukturën e poemës, që i ngjet një mozaiku lirik, pjesët e të cilit ndërrojnë herë pas here vendin e tyre, pa humbur gjallërinë e ngjyrave të tyre. Ato i lidh, duke krijuar përshtypjen e së tërës organike, ideja themelore e veprës, e cila ka përcaktuar frymën liriko-emocionale dhe atë notë singeriteti të natyrshëm, që përshkon ligjërimin poetik të autorit. Me anë të këtij ligjërimi të ngrohtë, autori ka vizatuar figurën e baballarëve dhe ka zbuluar dashurinë e madhe të brezit të ri ndaj tyre.

Tiparin thelbësor të baballarëve poeti e sheh në karakterin e paepur dhe shpirtin e tyre liridashës. E gjithë jeta e

baballarëve shquhet nga lidhja e ngushtë dhe e vazhdueshme me fatet e atdheut. Kjo lidhje ka përcaktuar dhe atë ndjenjë kujdesi të përhershëm për të tashmen dhe të ardhmen e vendit, që i ka karakterizuar gjithnjë ata. Kjo ide, që zë fill që në krye të poemës, zgjerohet në formë rrathësh koncentrikë dhe merr rëndësinë e një lajtmotivi:

*Në shpate ngjiti e nga shpatet zbrisni
të hollë si kosore e jataganë;
kutitë hapni e çibukët ndizni,
e gjunjët çlodhni,
baballarët tanë!*

*Ju shpien udhët në ara e qytete
dhe s'prehi kurrë
e s'rrini kurrë.*

.....

*Mendimi juaj zgjatet edhe zgjatet
nga kokrra e grurit
gjer te qeveria;
kapton luginat,
fushat edhe shpatet,
nga lëmi i fshatit
gjer te gjithësia...¹*

Vepra e bijve, të cilët ia ndryshuan rrjedhën historisë së vendit dhe po i zbukurojnë pamjen atdheut, u zgjon baballarëve kujtime që lidhen me të kaluarën dhe me të tashmen. Përjasja e kujtimeve për të kaluarën me mendimet e tyre për kohën dhe veprën e brezit të ri, ka ndihmuar të zbulohet ideja e hapit të madh që ka bërë vendi, duke kaluar në një fazë më të lartë të zhvillimit të vet historik.

Digresionet lirike janë një mjet i gjetur për të treguar patriotizmin si një nga tiparet më të qenësishme të brezit të vjetër, që, siç shprehet poeti, «Shqipërisë i doli zot me jataganë», si një nga traditat më të çmuara që ruajnë dhe trashëgojnë prej tyre brezat më të rinj. Këto tradita patriotike

1) D. Agolli, *Mesditë*, Tiranë 1969, f. 101-102.

e luftarake, që spikasin në karakterin e shqiptarit, autori i pohan shpesh përmes pyetjesh retorike, të cilat janë në harmoni me tonin e përgjithshëm të shtruar lirik:

*A s'ishit ju që me Selamnë
u derdhët kur rënkonte Vlora jonë,
nga grykat zutë topat italianë,
rrëzuar me tre plumba një balonë?
A s'ishit ju ata që me Bajramnë
e shndërruar në legjendë Dragobinë?
Me gjoks i pritët plumbat dhe murlanë,
me plagë e mbartët udhëve rininë?..¹*

Autori e ka shtrirë rrëfimin e tij për traditat patriotike të baballarëve nga epokat e kaluara deri në ditët e Luftës Nacionalçlirimtare; në këto ditë, thotë poeti, baballarët ishin përkrah djemve dhe i bënë vatrat e tyre djep të revolucionit. Autori i kthehet më se një herë kësaj ideje dhe e nxjerr në pah përmes imtësish shprehëse, të gjetura me takt artistik. Asociacionet që i zgjojnë poetit nekrologjitë për baballarët theksojnë idenë e rolit të brezit të tyre në vitet e luftës, e lidhjes së ngushtë të ëndrrave dhe të aspiratave të këtij brezi me luftën dhe idealet e Partisë. Në këtë lidhje e gjen poeti bazën e unitetit midis dy brezave në shoqërinë tonë:

*Dhe morëm pas ëndrrat tuaja të mira,
më të bukurat ëndrra shekullore
për lirinë e për tokat e lira,
për njerinë e për vatrat paqësore;
dhe i bashkuam me ëndrrën tonë të madhe,
me ëndrrën që quhej komunizëm².*

Tiparet e brezit të ri janë mishëruar në figurën e heroit lirik, që flet në emër të moshatarëve të tij. Shpesh në qëndrimin e tij lexuesi sheh qëndrimin e të gjithë të rinjve të sotëm ndaj brezit të vjetër e në një kuptim më të gjerë, ndaj traditave më të mira të së kaluarës që trashëgon shoqëria jonë.

1) Po aty, f. 104.

2) Po aty, f. 106-107.

Me këtë lidhet ideja kryesore e veprës se midis brezave në shoqërinë tonë nuk ekziston konflikti etër-bij, se marrëdhëniet midis tyre janë ndërtuar mbi bazën e idealeve dhe shqetësimeve të përbashkëta për fatet dhe të ardhmen e vendit. Brezi i ri, lindur dhe rritur në flakën e revolucionit, thotë poeti, është i lidhur ngushtë me popullin, me luftën për ndërtimin e socializmit, ai i ka përvetësuar dhe po i çon më tej traditat më të mira të krijuara nga brezat revolucionare të së kaluarës. Kjo është shprehur herë përmes fjalës së autorit dhe herë buro nga gjithë atmosfera emocionale e veprës. Poeti nuk e fsheh edhe ndonjë kontradiktë që ekziston midis brezave. Brezi i vjetër, për shkak të kushteve në të cilat u rrit dhe u formua, është i lidhur me disa tradita e zakone të prapambetura nga të cilat e ka të vështirë të ndahet. Kjo kontradiktë trajtohet në veprën si një nga kontradiktat joantagoniste të shoqërisë socialiste që shfaqen në procesin e luftës për triumfin e së resë, e që zgjidhen mbi bazën e unitetit të idealeve që frymëzojnë brezat e shoqërisë sonë. Poemën e përshkon fund e krye mendimi se brezi i vjetër dhe brezi i ri do të ecin si gjithmonë krahu për krahu në rrugën e revolucionit socialist.

Ideja e unitetit të brezave në shoqërinë tonë spikat më mirë në ato vargje të poemës që e pohojnë këtë në kontrast me marrëdhëniet që ekzistojnë midis etërve dhe bijve në vendet kapitaliste, ku pas «akullnajës» që ndan brezat e ndryshëm, fshihet degjenerimi moral e politik i shoqërisë borgjeze. Poeti fshikullon publicistët dhe sociologët borgjezë që yshtin brezin e ri kundër «etërve të mykur» dhe zbulon natyrën e egër dhe primitive të këtyre aventurierëve të rinj, autorë të krimeve, të luftërave dhe të agresioneve që kryhen sot, në emër të progresit në vende të ndryshme të botës. Duke folur për këto plagë të shoqërisë borgjeze-revizioniste, autori shpreh bindjen se do të dështojë me turp çdo orvatje për të ngjallur edhe në shoqërinë tonë «sherrin etër-bij». Ai fshikullon çdo njeri që i fshehur pas «petkut progresiv» guxon të përbuzë traditat fisnike të popullit tonë, si simbol i të cilave ngrihet në poemë figura e madhe e baballarëve. Kështu në ligjërimin lirik hyn një notë zemërimi e papërmbajtur që përcaktohet nga qëndrimi i prerë i poetit ndaj shfaqjeve të huaja.

Shqetësimi i baballarëve për çdo hap që hedh brezi i ri në jetë është i kuptueshëm për poetin, është shqetësimi i brezit të

mëparshëm për fatet e vendit, për sigurinë e lirisë dhe të pa-
varësisë së atdheut. Në kohën e sotme ka «diell e tramundanë-
dhe revolucionin e kërcenonjë vazhdimisht rreziqe, ndaj duhen
bërë sytë katër. Por, thotë poeti, brezi i vjetër duhet ta ndiejë
veten të qetë, se çështja e revolucionit është në duar të si-
gurtas; brezat më të rinj po e ngrenë më lart lavdinë e vendit
dhe po shpien më tej stafetën e revolucionit.

Duke shfrytëzuar me mjeshtëri një nga mënyrat karakte-
ristike të rrëfimit popullor, të mbushur me një ndjenjë sin-
geriteti të ngrohtë e urtësi të thellë, poeti në figurën madhë-
shtore të baballarëve ka zbuluar disa nga tiparet thelbësore
të karakterit të shqiptarëve.

Poema «Baballarët» është një vepër me ide të rëndësishme
dhe sjell kontribut të shquar në përpjekjet e shkrimtarëve për
të thelluar tiparet kombëtare të letërsisë.

Ideja e besnikërisë ndaj marksizëm-leninizmit dhe urrej-
tja e thellë për të gjithë ata që tradhtuan revolucionin socia-
list përbën patosin e poemës «**Dekada e revolucionarëve**» (1968)
të A. Shehut, në të cilën autori u bëri jehonë problemeve të
mprehta politike që shqetësonin popullin shqiptar. Në vepër
konflikti themelor i epokës — lufta midis revizionistëve mo-
dernë që braktisën revolucionin proletar dhe Shqipërisë so-
cialiste — del përmes ndjenjave të poetit, që marrin jetë nga
çastet dramatike që kalonte vendi:

*Na kërcitën nofullat prej urrejtjes ndaj tradhëtarëve.
Në zemër,
betimi ra i fortë si guri,
dhe nxorën majat bajonetat shqiptare
nga çdo majë mali
e nga çdo kallë gruri.¹*

¹ A. Shehu, *Vite pa thinja*, Tiranë 1970, f. 172.

Çdo imtësi e atyre viteve, çdo fakt i vendosmërisë së po-
pullit përballë bllokadës imperialisto-revizioniste është inkua-
druar në mënyrë të natyrshme në konceptin e përgjithshëm
të veprës. Ato japin me qartësi atmosferën e vigjilencës dhe
të mobilizimit të të gjitha forcave për vazhdimin e ndërtimit
socialist dhe për mbrojtjen e atdheut. «Dekadën e revolucio-
narëve» e karakterizon ligjërimi emocionues. Elementi lirik
është shkrirë në mënyrë organike me rrëfimin për ndodhitë
dhe faktet historike.

Në këtë periudhë u botuan shumë vjersha dhe poema, që
pasqyruan hovin revolucionar që ngjalli tek masat punonjëse
Letra e Hapur e KQ të Partisë, luftën e tyre për të çuar më
tej revolucionin ideologjik dhe kulturor. Ll. Siliqi, D. Agolli,
I. Kadareja, F. Arapi etj., me fjalën e tyre artistike i dhanë
dorë luftës për të spastruar shoqërinë socialiste nga çdo gjë
e vjetër dhe regresive që vinte nga thellësia e shekujve si dhe
nga shfaqjet e huaja ideologjike, rezultat i presionit të botës
imperialisto-revizioniste.

Krijimtaria poetike e Ll. Siliqit në këtë periudhë karakte-
rizohet nga synimi për të jetuar më intensivisht me problemet
e kohës. Poet me ndjeshmëri të madhe ndaj problemeve poli-
tike e shoqërore të kohës, Ll. Siliqi në këtë periudhë shkroi
vjersha dhe poema, të cilat shprehën frymën revolucionare
dhe gatishmërinë e masave për të kryer vepra heroike në emër
të fitores së plotë të normave dhe koncepteve socialiste në jetë.
Krahas pasurimit me motive të reja, krijimtaria e Ll. Siliqit
e këtyre viteve u dallua edhe nga rritja e mëtejshme artistike.
Duke pasur me vete një përvojë të gjerë jete dhe letrare, poeti
ngjeshi vargun e tij me mendim dhe u bë më i kursyer në përdorimin
e figurave. Në këtë periudhë ai botoi disa përmbledhje
poetike: «Këngë entuziaste» (1962), «Nga porti i ri deri ku
vlon malësia» (1967), «Poema e dritës» (1972).

BORIZANËT

Poema «Borizanët» (1967) është vepra më e shënuar që shkroi Ll. Siliqi në këto vite. Poema në pjesën më të madhe të saj ka pamjen e përshkrimit poetik të një udhëtimi në malësitë e Veriut që ishin përfshirë, sikurse i gjithë vendi, nga atmosfera e lëvizjeve revolucionare kundër gjithçkaje që pengon rrënjosjen e normave dhe të koncepteve socialiste në ndërgjegjen e njerëzve. Poeti i vuri vetes si detyrë të transmetojë frymën e entuziazmit që shpërtheu në të gjithë vendin pas Letrës së Hapur të KQ, të na flasë për hovin e paparë të energjive krijuese të masave punonjëse, për dukuritë e reja revolucionare që shfaqen edhe në jetën e krahinave më të largëta malore. Por për të gjitha ndryshimet e rëndësishme që kanë ndodhur në jetë, poeti nuk flet si rrëfimtari i ngeshëm. Ll. Siliqi i qëndron besnik prirjes themelore të talentit të tij: për gjithçka që i zë syri në atdheun tonë socialist ai flet plot hov ndjenjash, me figura dhe shprehje patetike. Kjo ka përcaktuar edhe natyrën e poemës, e cila i ngjet një fjale të zjarrtë. Vepra përbëhet prej një sërë këngësh që formojnë një cikël poetik.

Poeti i këndon frymës së vetëmohimit në jetë, lartëson revolucionarët, njerëzit «me diell në zemër», siç i quan poeti, të cilët rrojnë aktivisht me problemet e mëdha të jetës së vendit, të gatshëm për të bërë sakrificën më të lartë për ideallet socialiste. Tipi i revolucionarit është skicuar me disa viza në fillim të poemës. Në ndërgjegjen e këtij njeriu buisin ndjenja dhe mendime fisnike, ai jeton pas normave të moralit socialist.

*Ai jetën nuk e çon ba garravaç
nën peshë paragjykimesh,
ndërgjegjen kurrë nuk e paguan haraç,
s'vrapon si vraç mbas përfitimesh.
Në çdo furtunë asht gati me dhanë provën.¹*

Kur interesi i përgjithshëm e grishi atje ku kishte më tepër nevojë atdheu, heroi s'e bëri fjalë dysh dhe për të shpëtuar pronën e përbashkët, nuk kurseu as jetën.

1) Ll. Siliqi, *Nga porti i ri deri ku vlon malësia*, Tiranë 1967, f. 5.

Duke folur për aktin e lartë të heroit, poeti kujton me keqardhje ata njerëz të cilët dikur, në vitet e përlëshjes së guximshme me armiqtë e huaj, e kishin treguar veten si patriotë të denjë, por në kushtet e jetës paqësore u dhanë pas rehatisë mikroborgjeze, duke e bërë këtë qëllim të jetës së tyre, dhe humbën kështu cilësitë e revolucionarit të vërtetë. Këtë tip njeriu, «njeri pizhamë», që rron «zemërtrembur si rabeckë» e ankohet vend e pa vend, poeti e fton të shkundet nga pluhuri i së vjetrës, të ecë me ritmin e kohës, të marrë pjesë në përpjekjet e gjithë vendit për të ngritur më lart frymën revolucionare në punë dhe në jetë:

*Njeri në daç mes njerëzve me u dukë,
mos rri ma
Ndër pizhama strukël!*

.....

*Rrëmbe flamur'n e kuq!
Në zjarr të punës teren t'idhtët lotë
e davaritet çdo ankim i kotë.¹*

Grishje të zjarrtë që të flakin tej shijet dhe dëshirat e huaja për shoqërinë tonë, poeti u drejton edhe atyre të rinjve, që imitojnë modën e jashtme, duke i rënë ndesh frymës revolucionare që sundon në jetën e vendit.

Ndonjë fakt i veçantë negativ nuk errëson pamjen e ndritur edhe entuziaste që zotëron kudo, në të gjithë fushat e jetës dhe në çdo kënd të atdheut socialist. Në fantazinë e lexuesit ravizohet malësia, e përtërirë dhe e zbukuruar nga dora e njeriut tonë të ri. Kujtime për kohët e kaluara, kur malet ishin kështjella të lirisë së atdheut, kanë gjetur shprehje në vargje plot ngrohësi, që gërshetohen në poemë me vargje, në të cilat u këndohet maleve që fshehin në gjirin e tyre minerale të çmuara, burim i begatisë së sotme. Poeti jep me dy-tri viza pamjen e gëzuar dhe të gjallë të fshatit malor, ku feja e ka humbur pushtetin e vet të dikurshëm mbi ndërgjegjen e njerëzve, ku malësorët përfaquan normat socia-

1) Po aty, f. 8-9.

liste dhe shkelmuan me guxim zakonet prapanike, ku puna e përbashkët dhe e lirë e ka bërë të qeshur dhe të lumtur jetën e malësorëve, dikur të vuajtur dhe të shfrytëzuar.

Poeti shpreh jo vetëm mahnitjen e tij për heroizmin dhe cilësitë e mrekullueshme shpirtërore të njerëzve të rinj të malësisë; ai është i tëri me ta në luftën që bëjnë për revolucionarizimin e malësisë. Vëmendjen e poetit e tërheqin në radhë të parë elementet e reja që kanë nisur të shfaqen në jetën e malësisë pas Letrës së Hapur. Parulla «Të reja! Mos pranoni kurrë shitjen tuej me lekë», shkruar në shkëmb me shkronja të mëdha, sjell jehonën e luftës për zhdukjen e zakoneve prapanike, kryqi i «braktisur në sfond të tymit», dhe ylli i kuq që «mbrenda kullave të ngurta po i davarit tash retë e murrta», vasha e re që s'pranon të marrë «burrin rakitik», të caktuar si fat nga prindërit, i riu malësor që kuvendon plot krenari dhe lirshëm për përparimet që ka bërë malësia, kooperativistët që, në përpjekje për t'i marrë sa më shumë drithë tokës, luftojnë me këmbëngulje kundër thatësisës, duke bërë që të rijehojë entuziazmi i ditëve të luftës partizane, parcelat e mbjella me patate që gjelbërojnë në shpat pranë postës kufitare të gjitha këto zbulojnë idenë kryesore të poetit se Letra e Hapur përtëriti si fillad freskues jetën shoqërore dhe zbuloi tek njerëzit energji të reja, të pazbuluara. Letra e Hapur është për poetin:

*Busull ndër dallgët e furtunës,
e rrepta borizane e së vërtetës,
që fton
burrnisht me ecë ndër shtigje t'jetës.
Letra —
gjithmon Partia në timon,
stafeta e flamurit të Komunës.
Letra — i pavdekshmi Revolucion.¹*

Fryma patetike dhe toni oratorik përbëjnë veçoritë kryesore të poemës. Ngjarjet më të rëndësishme të jetës ndriçohen përmes figurave dhe kontrasteve të gjalla. Autori del shpesh

1) Po aty, f. 31.

si pjesëmarrës i ngjarjeve; kjo është arritur nëpërmjet ndërhyrjeve lirike ose të theksimit të pranisë së vetë poetit gjatë gjithë veprës. Brendia e ngritur emocionale ka përcaktuar edhe stilistikën e veprës, e cila shquhet nga figurat emocionuese, ndonëse vende-vende ka ndonjë notë deklamative.

Poema «Borizanët» e Ll. Siliqit është një nga veprat e para që solli në poezi entuziazmin revolucionar të masave punonjëse në luftë për shkatërrimin e traditave prapanike; ajo të emocionon me patosin e luftës për ndërtimin e mëtejshëm të shoqërisë socialiste.

Lufta për ngadhënjimin e plotë të socializmit në të gjitha fushat e jetës, procesi i vështirë i rrënjosjes së koncepteve dhe të shprehive të reja ka gjetur pasqyrim edhe në vjershat «Xha Qazoja», «Gjyshja», «Rojtari i pyjeve» të V. Zikos. etj. Te poezia «Xha Qazoja» autori flet për luftën e madhe që duhet të bëjnë njerëzit për të mposhtur konceptet dhe shprehitë e botës së vjetër. Heroi i veprës, xha Qazoja, megjithëse kooperativist, është i lidhur me punën vetjake. Kur i bëjnë thirrje që të heqë dorë nga tre dynymët, ai përpara se t'i bashkojë ato me pronën e kooperativës, u vë sëpatën mollëve në kopshtin e vet, ndonëse kjo i shkakton dhe mbje të madhe, sepse i kishte mbjellë e rritur me aq dashuri dhe mund. Me keqardhje e hidhërim flet poeti për këtë fakt që dëshmon për pushtetin ende të fortë të koncepteve të vjetra në ndërgjegjen e disa njerëzve:

*Ti vajte që nga rrënjët t'i shkurtoje,
t'i bëje zjarr (të bëri e vjetra tym!)
më mirë edhe dynymin mos dorzoje,
se do të bënim edhe pa atë dynym.*

*Ne s'kemi hall për tokën dhe për mollët,
(ti Qazo, këtë mirë le ta dish),
Ne duam trutë e zemrat të shartojmë
në trungun e përbashkët socialist¹.*

Ngazëllimi për shembjen e vatrave që përhapnin opiumin fetar, bindja se ideologjia revolucionare do të fitojë plotësisht

1) V. Ziko, Takim me malet, Tiranë 1970, f. 22.

zemrat e njerëzve edhe të përfaqësuesve të brezit të vjetër, formon patosin e vjershës «Gjyshja» (1970). Për vjershat e V. Zikos me këtë tematikë është karakteristike fryma e lehtë lirike pleksur me elemente tregimtare. Poeti shpreh ndjenjat dhe mendimet e tij, duke rrëfyer për ngjarje konkrete, për aspekte të luftës që bëjnë njerëzit kundër zakoneve dhe paragjytimeve të vjetra. Rrëfimi zakonisht është i përzemërt, i ngrohtë; aty-këtu, në të depërtojnë nota keqardhjeje për njerëzit e thjeshtë të cilëve feja u kishte trullësuar mendjen gjithë jetën.

Në poezinë «Ndër sytë e shoqeve shkëndia» të Ll. Siliqit shprehet hareja për lëvizjen e gjerë që nisi për çlirimin e plotë të gruas dhe të rejave. Sipas poetit nuk ka forcë që të pengojë rrymën e fuqishme revolucionare që do të dërrmojë verigat, të cilat pengojnë femrën të zerë plotësisht vendin që i takon në shoqëri.

*
* * *

Sikurse edhe më parë vëmendjen e poetëve në këtë periudhë e tërhoqi heroizmi i njerëzve në frontin e ndërtimit socialist, veprat dhe mendimet e tyre të larta, hovi që karakterizoi jetën e vendit në kushtet e thellimit të mëtejshëm të revolucionit ideologjik dhe kulturor.

Nga ndërtimi socialist e marrin lëndën një tok vjershash të F. Arapit, të cilat pasqyrojnë atmosferën revolucionare, që kishte përfshirë vendin në këto vite. Në themel të krijimeve të përmbledhjeve «Shtigjet poetike» (1962), «Ritme të hekurta» (1968) janë ndjenjat dhe mendimet që i ngjall poetit entuziazmi i jetës që e rrethon. Herë-herë vjershat e F. Arapit kthehen në një apostrofë të ngritur, që poeti i drejton klasës punëtore, e cila me përpjekjet dhe luftën e saj po e shndërron jetën e vendit. Në poezinë «Republikës» (1962) gjejmë jehonën e vrullit të pandalshëm me të cilin Republika marshon përpara, drejt caqesh të reja zhvillimi. Shndërrimin e madh që ka pësuar vendi poeti e jep përmes antitezës së gjerë. Madhështia e asaj që populli arriti në luftë kundër botës së vjetër, del nëpërmjet kujtimit të së kaluarës, kur Shqipëria dergjej në një-

rim dhe varfëri të madhe. Për Republikën, që po ndryshon çdo ditë, poeti flet me mburrje dhe gëzim të papërmbajtur. Në vjershën «Industriale» është pasqyruar përparimi i vrullshëm i vendit, poeti jep ritmin dinamik me të cilin po ndryshon pamja e atdheut:

*Ku ngrihej një kështjellë,
lartojmë një fabrikë
dhe një uzinë vigane, —*

ku falej një xhami.

*Përsëritje gjigande e shtatit të Atdheut:
nër themele uzinash derdhet
beton, hekur e këngë përzier.
Në skela të larta, të rënda
saldohen njëherësh*

hekur e ëndrra.

Dhe çdo skelë —

një hap vigan mes lartësive.¹

Poeti shpreh dashurinë për klasën punëtore, e cila përtërin dhe ushqen frymëzimin e tij me ndjenja, mendime, shpresa dhe ëndrra të reja. Ndjenjave delikate rinore të poetit, dëshirave romantike të dikurshme ua ka zënë vendin romantika e shndërrimit socialist të atdheut. Në krijimtarinë e F. Arapit aspektet e ndërtimit të jetës së re kanë dalë kryesisht me anë të përgasjes midis së tanishmes dhe së kaluarës. Në vjershën «Vargje për dritat», duke soditur pamjen e lulëzuar të jetës socialiste, poeti kujton të kaluarën e mjerë të atdheut të zhytur në errësirë dhe mjerim. Shtyllat e tensionit të lartë, pohon autori, në krahasim me kullat e vjetra janë «kulla të fuqishme», që do t'u qëndrojnë stuhive të shekujve. Shkrirja e gërshetimi i ndjenjave të autorit me përsëkrimin e pamjes së vendit ka përfutur një poezi të ndjerë liriko-epike. Një pjesë e mirë e vjershave të vëllimit «Ritme të hekurta» të F. Arapit janë lirika të peizazhit industrial. Në to transmetohet dinamika e ndryshimeve socialiste. Duke vizatuar pamjen e qyteteve e ndryshimeve socialiste, poeti kalon në përsiatje me karakter lirik. Në vjershën «E shkruar në Azotik» autori nga për-

1) F. Arapi, *Ritme të hekurta*, Tiranë 1968, f. 11.

shkrimi i uzinës së sodës kaustike hidhet në motive të tjera, nis e arsyeton lidhur me rolin e klasës punëtore në shndërrimin e kushteve materiale dhe të botës shpirtërore të njerëzve.

Krijimet poetike të D. Agollit me temë nga jeta e sotme shquhen nga dashuria për punonjësit e thjeshtë, nga poetizimi i punës së bujkut dhe i natyrës së vendit. Kur përshkruan me ngjyra plot freski jetën e gëzuar e të begatshme të fshatit të sotëm («Rapsodi vjeshte»), ose kur tregon historinë prekëse të druvarit, të cilit gjithë jeta i kaloi me sopatë krahut në pyll («Vdekja e druvarit») ose kur flet për takimin me kooperativisten e re, shoqen e fëminisë, që është bërë mjelëse e dalluar në fshat («Përsëri») poeti arrin të japë tiparet e jetës socialiste dhe të tregojë rritjen shpirtërore të njeriut tonë të ri. Në vjershat e veta D. Agolli priret nga vizatimi i skenave të gjalla të jetës së përditshme, nga përshkrimi i ndonjë personazhi konkret, nga gjuha e thjeshtë dhe konkrete dhe nga shfrytëzimi i mjeteve artistike të folklorit.

Në vjershat dhe poemat e D. Agollit, I. Kadaresë, V. Zikos, F. Arapit etj., fshikullohen rreptë mbeturinat e botës së vjetër, ndikimet e huaja ideologjike.

Ndeshja midis së resë dhe së vjetrës në «Balladë e ashpër» (1968) të D. Agollit paraqitet si luftë e vështirë që u shkakton lëndime edhe atyre njerëzve, të cilët, ndonëse janë me pushtetin popullor, nuk kanë këputur të gjitha fijet që i mbajnë të lidhur me mentalitetin e botës së vjetër. Vepra bën fjalë për një vajzë fshatare, e cila në çastet kur dasma është në kulmin e saj, refuzon të shkojë te burri që i kanë caktuar prindërit dhe bashkohet me të rinjtë dhe të rejat e fshatit që nisen vullnetarë për në hekurudhën Rrogoshinë-Fier. Elementi epik zë një vend të paktë në baladë. Në plan të parë kemi jo historinë dramatike të së resë, por brengën e autorit, i cili shpërthen me vargje plot ironi dhe revoltë tek sheh si zakonet prapanike vijnë ende t'i mbajnë njerëzit nën pushtetin e tyre. Poeti shpreh dhembje për fatin e hidhur të fshatares, e cila arriti të shpëtonte nga zgjedha e zakoneve prapanike, vetëm kur nisi beteja vendimtare për çlirimin e plotë të gruas. Në figurën e vajzës janë mishëruar tiparet karakteristike të rinisë së kohës së sotme: dashuria për jetën e re, optimizmi dhe besimi në fitoren e koncepteve revolucionare për jetën.

«Balladë e ashpër» me pohimin e fuqishëm të së resë dhe me satirizimin e traditave prapanike bën pjesë në krijimet më të realizuara kushtuar luftës për çlirimin e plotë të gruas.

Tema e luftës për zhdukjen e shfaqjeve dhe të koncepteve të vjetra në vjershat e I. Kadaresë u zbulua përmes krahasimesh të befasishme. Traditat dhe normat prapanike të malësisë poeti i krahason me «copëra imazhesh të botës së vjetër», me «paragrafë të përgjakur kanunesh» dhe «leckë legjendash». Revolucionari me vrullin e tij të pandalshëm flak tej mbeturinat e së kaluarës dhe çdo gjë që është e huaj për socializmin.

Ndër veprat që pasqyrojnë luftën për zhdukjen e shfaqjeve burokratike vlen të përmendet poema «Antiburokratike» (1968) e F. Arapit. Veçori e veprës është frymë dhe theksuar lirike. Kudo përreth poeti vëren se e reja në jetë është çdo ditë në përleshje me të vjetrën; kjo luftë ka për arenë dhe ndërgjegjen e heroit lirik, të cilin bëmat heroike të klasës punëtore e ndihmojnë të shkundë barrën e dëshirave dhe të shprehive të vjetra. Ndikimin e moralit proletar në ndërgjegjen e tij poeti e krahason me agimin e purpurt që dëbon nga dita hijet e natës. Duke përdorur imtësi të goditura nga jeta e përditshme, F. Arapi përshkruan luftën në ndërgjegjen e njerëzve dhe tregon se si në këtë luftë përtërihet jeta e njerëzve tanë.

Në poemë vend të mirë zë edhe elementi epik. Autori përshkruan edhe ndonjë episod nga lufta e ashpër dhe e vështirë e klasës punëtore kundër burokratizmit; janë këto vargje që flasin për shqetësimet që provon një punëtor para se të vendosë të dënojë mëndjemadhësinë edhe arrogancën që vë re në sjelljen e shokut dhe të eprorit të tij. Vargu i poemës në përgjithësi është energjik dhe i tendosur. Idenë e fitores së plotë të ideologjisë revolucionare mbi shfaqjet e huaja autori e pohon me forcë patetike.

*
* *

Ngjarjet e Luftës Nacionalçlirimtare zunë një vend me rëndësi edhe në tematikën e poezisë së kësaj periudhe. Vëmendjen e poetëve e tërhoqi në radhë të parë heroizmi i pashe-

mbullt që shfaqti populli shqiptar në ato vite, guximi i tij për t'u ngritur në luftë kundër armiqve të shumtë në numër e të armatosur deri në dhëmbë dhe për të fituar mbi ta. Kjo i bënte jehonë drejtpërdrejt qëndresës së paepur të vendit kundër bllokadës imperialisto-revizioniste, frymës së sakrificës që kërkonte koha nga njerëzit. Duke marrë temën për krijimet e tyre nga epopeja e luftës, poetët synuan të theksonin aspekte të reja, të patrajtuara më parë. Veç kësaj veprat që u shkruan në këto vite, u karakterizuan nga përpjekja për një konceptim më të thellë të ngjarjeve dhe të karaktereve të njerëzve, nga përdorimi i mjeteve të larmishme në vizatimin e figurës së heronjve.

Në vjershat «Poemë për shokun», «Kredo», «Këngë e njo-hur» dhe në baladën «Internacionale» të F. Gjatës evokohet atmosfera romantike e viteve partizane. Në «Poemë për shokun», (1972) flitet për një fakt të zakonshëm: një grup partizanësh nuk e lanë shokun e tyre të vranë në duart e armikut, por e marrin në vig, dhe, duke kapërcyer rrezeq të shumta, çajnë rrethimin dhe dalin në majë të malit, ku e varrosin në mes të pishave të larta. Poeti ngre lart solidaritetin partizan dhe frymën e paepur të luftëtarëve të lirisë përballë armiqve. Ngulmimin dhe vullnetin e fortë të partizanëve, që çajnë përpara «nën qiell të ngrirë», «me vigun e përgjakur në duar», të gatshëm për çdo sakrificë, e transmeton edhe ritmi i vargut, i rreptë dhe i prerë.

Në mënyrë të thjeshtë, pa fjalë të kërkuara, fizionomia shpirtërore e partizanëve përshkruhet edhe në vjershën «Horizonti» (1972). Megjithëse vitet e luftës ua shtuan atyre rrudhat dhe i bënë më të ngrysur, luftëtarët e lirisë ruajnë të pashuar në zemër besimin në rrugën e drejtë që kishin zgjedhur, në ardhjen e «Botës së re»:

*Dhe na mbetet vetëm shpresa e blertë
e dhembja krenare, e heshtur
që peshë zemrat ngre,
Ajo që na bën të ashpër, të rreptë edhe të drejtë.¹*

Figura e lartë morale e luftëtarit të lirisë shfaqet edhe në vjershën «Kredo», e cila përshkohet nga patosi romantik.

Krenaria për frymën e lartë patriotike të popullit në

1) F. Gjata, *Këngët e maliherit*, Vjersha, Tiranë 1975, f. 22.

vitet e luftës u shpreh në vjershën «Shkëndija e brigadës» (1969) e Ll. Siliqit. Në historinë e partizanës pesëmbëdhjetë-vjeçare, e cila u radhit krahas vëllezërve e motrave më të mëdha, poeti tregon se lufta e popullit për të fituar lirinë dhe të drejtën për jetë të lumtur, ishte e përgjithshme; në të morën pjesë jo vetëm të mëdhenjtë, por edhe fëmijët. Përsiatjet mbi fatin e pesëmbëdhjetëvjeçarëve në ditët tona i japin poezisë një frymë të theksuar lirike dhe nënvizojnë idenë e vijimësisë në kushtet e sotme të veprës së madhe heroike që populli shqiptar nisi në vitet e luftës çlirimtare antifashiste.

ALARME TË PËRGJAKURA Madhështia e epokës së luftës, kur vegjëlja u bë protagonistja e vetëdijshme e historisë, patriotizmi dhe heroizmi masiv popullor, si shfaqje karakteristike e kohës, janë aspektet themelore që ka ndriçuar F. Arapi në poemën e vet «Alarme të përgjakura» (1966). Për nga kompozicioni kjo vepër ka njëthurje të vetën; skenat epike të luftës shkrihen në të me ndërhyrjet e shpeshta lirike, të cilat shërbejnë si fije të padukshme që lidhin pjesët e ndryshme dhe i japin veprës unitetin i cili duket sikur i mungon.

Kështu që, edhe pse autori nuk ka gjetur dot gjithmonë çelësin për t'i intonuar ato si këngë të një poeme, vepra pikturon pamjen heroike të epokës së luftës dhe zbulon idenë e kthesës historike që shënon ajo për fatet e vegjëlisë.

Vepra hapet me një apostrofë plot emocion përmes së cilës poeti rikrijon figurën e atdheut të sflitur nga vuajtjet e uria. Pas kësaj figure, të konceptuar me përmasat e një metonimie të gjerë, qëndron populli; figura ndihmon për të zbuluar gjendjen e vendit në prag të pushtimit fashist, edhe për të shprehur idenë e përpjekjeve të pareshtura të popullit në rrugën e tij të vështirë historike drejt lirisë dhe përparimit shoqëror. Kjo hyrje shërben nga ana tjetër si prolog që pohon lidhjen e ngushtë të poetit me fatin e popullit dhe të atdheut të vet, të poetit që përjeton në mënyrë aq aktive dhe mbjet dhe brengat e popullit, sa i dridhet zemra për vendin e tij kur e sheh në hartë të vogël e të drobitur, «brinjë e lëkurë». Me këtë motiv nis pjesa e parë e veprës, në të cilën autori zbulon atë gjendje të rëndë shpirtërore që pllakosi popullin pas pushtimit fashist; ditët e rënda pas 7 prillit rikri-

johen në mënyrë të gjallë, në plan retrospektiv, kryesisht përmes zbulimit të gjendjes shpirtërore të heroit lirik, që e ndien veten si përfaqësues të vegjëlisë:

... Ku të vemi ne?...

Ne jemi të rëndë,

...
si ky vend.

Qëkur lindëm, një me të u shkrimë.

As e shkullim dot,

as e mbartim mbi shpinë...¹

Tragjedia e 7 prillit përshkruhet në poemë si diçka tronditëse, që revoltoi të gjithë njerëzit e ndershëm. Kjo është arritur përmes kontrastit të mprehtë që ka krijuar autori, duke dhënë me viza të shpejta nga njëra anë tradhtinë e mbretit që iku si cub, dhe nga ana tjetër, qëndresën e vegjëlisë, e cila u ngrit në mbrojtje të atdheut dhe shënoi me gjakun e saj rrugën drejt lirisë. Me një gjuhë të zgjedhur metaforike, përmes krahasimeve të papritura që bartin një ngërthesë ideore të gjerë, autori ka krijuar pamjen e kasaphanës së përbotshme që shkaktoi kapitali dhe ka treguar se tragjedia e popullit shqiptar nuk ishte veçse një akt i tragjedisë së madhe që po kalonin popujt, viktima të agresioneve fashiste. Në këtë gërshetim rrethanash, që formon sfondin historik të kohës, krijimi i Partisë është paraqitur poetikisht si një kërkesë e domosdoshme e kohës, si ngjarje që do të shënonte agimin e një kohe të re për vendin.

Poemën «Alarme të përgjakura» e përshkon ideja se lufta që udhëhoqi Partia kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarve ishte njëherazi dhe luftë për shpëtimin e masave të popullit nga shtypja shoqërore. Ky mendim është shprehur në mënyrë më të plotë në këngën e tretë të poemës, ku për Partinë flitet si Parti «e halleve dhe e derteve» të masave, si pjellë e vegjëlisë, si shprehëse e aspiratave dhe e ëndrrave të saj për ditë të bardha.

Ashpërsinë e luftës së masave nën udhëheqjen e komunistëve autori e jep me anë të disa skenave, të cilat shpesh piktur-

1) F. Arapi, *Poema dhe vjersha*, Tiranë, 1966, f. 6-7.

rohen me viza të shpejta. Ndonëse pasojnë njëra-tjetrën sipas rrjedhës kronologjike, nuk është kjo që i lidh ato në diçka të vetme, por mendimi dhe qëndrimi i autorit ndaj tyre, që shprehet kryesisht në formën e ndërhyrjeve lirike. Ky këmbim skenash epike dhe lirike i jep veprës karakterin e një afresku ku shkrihen ngjyrat e ashpra me tonet e buta. Kështu, pasi ka krijuar përmes një vargu paralelizmash pamjen e gjallë të shpërthimit të revoltës popullore kundër zgjedhës fashiste, poeti i drejtohet rinisë, brezit të «çunakëve» që mbushi sheshet e demonstratave dhe radhët e çetave partizane. Në figurën e brezit të ri, të dhënë në plan lirik, poeti ka ravizuar tiparet e asaj gjenerate që, siç shprehet ai, erdhi në jetë me «andra në këmishë» dhe «me andra në pantallona». Duke iu drejtuar vërsnikëve poeti ndihet krenar që atij i ra shorti të kryejë këtë mision të rëndë, por fisnik.

Pamjet epike F. Arapi i vizaton zakonisht në sfondin e gjallë të natyrës, e cila shpesh shkrihet me ngjarjet. Duke përdorur këtë mjet artistik, poeti ka vizatuar pamjen e luftës së Gjormit, në të cilën përveç motivit të heroizmit dhe të karakterit masiv popullor të luftës, tingëllon me forcë motivi i demaskimit të tradhtisë, i urrejtjes për këlyshët e fashizmit, i shprehur përmes notave të një zemërimi të papërmbajtur. Fill pas këtyre notave në poemë hyn një motiv gati elegjiak, ai i komisarit të rënë. Kënga për të është një vrushkull ndjenjash të ngrohta që, së bashku me këngën për heroinën Margarita Tutulani, i japin poemës një ngjyrim të theksuar liriko-emocional.

Figura e Shqipërisë partizane që u kacafyt me forcën më barbare të kohës, me Gjermaninë hitleriane, është dhënë me ngjyra shprehëse edhe në këngën që pason. Poeti krijon skena që zbulojnë me forcë poetike karakterin heroik dhe të vështirë të kësaj ndeshjeje të ashpër:

*Dorë e çuditshme kjo e historisë,
sonte hedh me grushte përmbi Drashovicë
dhe kryqet e thyer dhe yjet e kuq.*

*Dhe ndeshen këtu
Shqipërizë e vogël — nazizmi qikllop;...¹*

1) Po aty, f. 30.

Poema «Alarme të përgjakura» nuk i ka shpëtuar vende-
-vende frymës fragmentare, jo të gjitha këngët e saj janë të
një niveli. Figuracioni është i guximshëm dhe i freskët, por
disa figura janë të pagoditura e të pakapshme.

Te «Elegji partizane» dhe «Krevati i perandorit» D. Ago-
lli krijoi tipin e njeriut të thjeshtë, i cili, i frymëzuar nga
dashuria për vendin, rroku armën dhe luftoi me trimëri kundër
skllavëruesve të huaj. Karakteristike për të është modestia,
gatishmëria për të kryer detyrën ndaj atdheut pa mburrje
dhe zhurmë, lidhja e ngushtë me jetën popullore. Vjersha
«Krevati i perandorit» (1969) dallohet për frymën humori-
stike. Imtësitë me të cilat vizatohet figura e heroit, ndihmojnë
që të dalë në pah ideja e madhështisë së vegjëlisë, e aktit
të saj të lartë heroik në vitet e Luftës Nacionalçlirimtare. Në
karakterin e partizanit Meke, në thjeshtësinë dhe patriotizmin
e tij, poeti pikturoi popullin, i cili përshkoi një rrugë plot
sakrificë dhe heroizma deri në dëbimin e pushtuesve të huaj
nga vendi. Humorin e këndshëm popullor që përshkon veprën
e ndiejmë në notat me të cilat jepet portreti i partizanit Meke,
në sjelljen dhe në fjalët e tij si edhe në vetë atmosferën që
krijohet nga kontrasti i dy botëve. Stili i veprës është i thje-
shtë dhe i qartë, rrëfimi poetik mbështetet në intonacionet
e rrëfimit popullor.

*
* *

Në tematikën e poezisë së kësaj periudhe zuri vendin e
saj edhe historia e së kaluarës së popullit shqiptar. Interes ngja-
lli veçanërisht figura e Skënderbeut dhe qëndresa heroike e
popullit shqiptar nën udhëheqjen e tij kundër hordhive otoma-
ne. Këtë interes e nxiti edhe përkujtimi me madhësi në
gjithë vendin i 500-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar, që
u organizua në fillim të vitit 1968. Por evokimi i frymës së
paepur që shqiptarët shfaqën në luftë kundër armiqve të
shumtë që u ranë në qafë në rrugën e tyre historike u për-
ftua edhe nga nevoja për të mbajtur lart shpirtin e qëndresës
përballë rrethimit imperialisto-revizionist. Një sërë poetësh

si Ll. Siliqi, I. Kadareja, D. Agolli etj. shkruan vjersha dhe
balada që kanë në qendër figurën e Skënderbeut ose ngjarje
nga veprimtaria e tij luftarake. Ndër veprat poetike me temë
nga epoka zulmëmadhe e Skënderbeut vlen të shënohet «**Garda
krutane**» (1967) e K. Jakovës, Në këtë poemë autori u përpoq të
pasqyronte sprovën e rëndë që iu desh të përballonte popullit
shqiptar gjatë qëndresës kundër pushtuesve otomanë. Fry-
mën e lartë luftarake dhe patriotizmin e shqiptarëve poeti e ka
mishëruar në historinë e plakut të moçëm malësor Llesh Ga-
lanit, i cili i fal atdheut katër djemtë e vet dhe, megjithëse e di
se pak shpresa ka që ata të kthehen të gjallë nga lufta, i për-
cjell duke i porositur që të mos kursejnë asgjë për fitoren.

Themelin e subjektit e formon përshkrimi i betejave që
zhvillon me ushtrinë turke «garda krutane», e përbërë prej
Gjergj Aleksit, prej njerëzve të shtëpisë së Skurajve etj., dhe
prej fshatarësisë së lirë shqiptare, e cila kishte rrokur armët për
të mbrojtur jetën dhe pasurinë e vet. Skënderbeu del pak në
poemë, emri i tij mbahet në gojë në popull si simbol i heroizmit
dhe i trimërisë legjendare.

Me historinë e qëndresës burrërore të gardës krutane ve-
pra përçon idenë se populli shqiptar, ashtu siç u bëri ballë
sulmeve të tërbuara të ushtrive osmane në shekullin XV, edhe
sot nën udhëheqjen e Partisë do të bëjë copë e çikë planet e
armiqve që kanë si qëllim të mposhtin dhe të nënshtrojnë
Shqipërinë. Këtë mendim autori e ka vënë në gojën e rapso-
dit Gjetan Lalës, i cili duke i bërë jehonë kohës së sotme thotë
se Shqipëria do të dijë të sprapsë çdo sulm armik, ngado që
të vijë, se në rast rreziku:

*prap do të ngrihen gurë e dhe,
prap do lind një Skënderbe
që ta mbrojë t'shenjtin atdhe!¹*

Poema «Garda krutane» është hartuar sipas modeleve të
poezisë epike popullore. Kjo duket në radhë të parë në një
varg motivesh, si lamtumira e heronjve, fjalët që ata thonë
përpara dhe gjatë betejës etj. Vepra është shkruar në tetë-

1) K. Jakova, **Garda krutane**, Tiranë 1967, f. 92.

rokokëshin e poezisë popullore. Poema nuk u ka shpëtuar në metave. Në përshkrimin e betejave poeti ka përdorur vend e pa vend hiperbolat, krahasimet dhe figurat retorike. Episodi i tridhjetë vajzave që i japin fund jetës së tyre të shkëmbi i Lesterit për të mos rënë në duart e pushtuesve, me elementet e tepruara fantastike që ka, nuk është bindës. Veprën e ka dëmtuar edhe nënvizimi i imtësive etnografike në përshkrimin e heronjve dhe të ambientit të tyre.

Në baladën «Para bustit të Selam Musait» (1970) A. Shehu dha portretin tërheqës të luftëtarit popullor që ra për lirinë e vendit. Përmes imtësive të gjalla poeti ka arritur të nxjerrë në pah dashurinë e madhe të heroit për vendin, urrejtjen e thellë për të huajin, guximin dhe trimërinë e rrallë të këtij luftëtari që e priti vdekjen si kreshnik i vërtetë. Akti burror i Selam Musait kthehet në simbol të dashurisë së flaktë të shqiptarëve për liri dhe për atdhe. Kjo është arritur përmes përdorimit të imtësive që i japin figurës së heroit karakter legjendar e madhështor. Në vepër theksohet respekti për trimat, mirënjohja e popullit për flijimin e tyre.

Vjersha mbyllet me një pamje lapidare, në të cilën është mishëruar ideja e gjallërisë dhe e shpirtit të paepur të popullit shqiptar.

*Dhe rri, gjoksin hapur,
ballë çdo furtune,
Sharku si legjendë
telave të tundet.¹*

Shkruar me stil të thjeshtë e të qartë, në të cilin duket ndikimi i folklorit, (sidomos në figurat dhe në kadencën e vargut), balada gjeti pritje të ngrohtë në publik.

*
*
*

Vend të rëndësishëm në poezinë e kësaj periudhe zuri tema ndërkombëtare. Shumë vjersha flasin për miqësinë dhe solidaritetin e popullit shqiptar me popujt e tjerë që luftojnë kundër ndërhyrjes dhe agresionit imperialist për mbrojtjen e lirisë dhe të jetës së tyre.

1) A. Shehu, *Vite pa thinja*, Tiranë 1970, f. 12.

Figurën e popullit vietnamez, i cili, me gjithë epërsinë në armatime dhe në teknikë ushtarake të imperializmit amerikan dhe të mercenarve të Saigonit, qëndroi i pamposhtur, I. Kadareja e vizatoi me mjetet e groteskut:

*Nga ç'epos heroik dole kështu papritur
me flokët orizorë të djegur me napalm
gjysmë i lirë,
gjysmë i lidhur,
si një centaur i ri. Vietnam.¹*

Në vjershat «Lakuriqët e natës» e I. Kadaresë, «Vargje të kuq» e A. Shehut, «Tradhtia e lartë» e L. Qafëzezit etj., u stigmatizua qëndrimi i pabesë i revizionistëve ndaj çështjes së pavarësisë dhe të lirisë së popujve. Revizionistët modernë me ata sovjetikë në krye që kanë qëllim të shuajnë revolucionin socialist botëror, I. Kadareja i krahason me «lakuriqët e natës», këta zogj ogurzinj, që u kujtojnë njerëzve natën, terrin, që ka pjellë gjithnjë plane të kobshme kundër njerëzimit përparimtar.

*Kështu vërtiten nëpër qiell
si dezertorë nga një muzg tjetër
Më kot ndërgjegjes sonë i ndjell
të lashtat frikëra botë e vjetër.²*

— thotë poeti, i sigurt se armiqtë nuk do ta kthejnë dot prapa rrotën e historisë.

Duke dënuar planet dhe veprimet agresive të imperialistëve amerikanë dhe të drejtuesve të sotëm të Kremlinit, poetët shprehin në të njëjtën kohë besimin e tyre në forcën e pamposhtur të revolucionit dhe të komunizmit. Në vjershën «Stuhia e revolucionit» (1967) të Ll. Siliqit përmes vargjeve patetike pohohet ideja se rryma e stuhishme revolucionare do të flakë tej imperialistët, socialimperialistët dhe reaksionarët e ndryshëm, të cilët, siç thotë poeti, s'janë veçse «kolosë me këmbë argjile përmbri honit».

1) I. Kadare *Motive me diell*, Tiranë 1968, f. 31.

2) Po aty, f. 59.

Nga pikëpamja e tematikës, një vend të veçantë në poezinë e kësaj periudhe zënë krijimet e A. Gjakovës, A. Istrefit etj., kushtuar jetës së vëllezërvë kosovarë në kushtet e regjimit politik e shoqëror të Jugosllavisë së pasluftës. Në poemën lirike «... Dhe thonë se paqe ka në botë» (1967) të A. Gjakovës përmes historisë së Kosovës pas Luftës së dytë Botërore, tregohen vuajtjet dhe mundimet që hoqi populli i asaj krahine nga sundimet e revizionistëve. Rrëfimi poetik është i tendosur; në të sundojnë notat e dhembjes e të zemërimit. Poeti evokon me radhë episodet më prekëse të kësaj historie tragjike: mashtrimin e masave të popullit me anë të parrullës demagogjike «vllazni-bashkim», zinxhirin e gjatë të arrestimeve, të burgosjeve dhe të vrasjeve, masakrën e përgjakshme të lules së rinisë në Kosovë më 1945, dëbimin në masë të kosovarëve në Turqi etj. Në poemë me ngjyra të gjalla rikrijohet atmosfera e terrorit dhe e vrasjeve. Paraqitjen e vuajtjeve dhe të shtypjes së popullsisë e gjejmë edhe në vjershat «Nata në qytet», «Vrasja», «Grave të Drenicës» etj.

Në poezitë «Bir i sharrëxhiut» dhe «Balada e vorfën» poeti tregoi mjerimin dhe shfrytëzimin e egër të kosovarëve në Jugosllavinë e sotme. Rrëfimi i thjeshtë e plot dramatikë përshkruar me imtësi konkrete plot shprehimësi, janë karakteristike për këto vjersha, në të cilat vihet re ndikimi i Migjenit. Autori synon të paraqesë lakuriq gjendjen e mjeruar e poshtëruar të punëtorëve kosovarë në Beograd dhe në qytete të tjera të Jugosllavisë, shfrytëzimin e egër që ata pësojnë në regjimin revizionist:

*Në duert e çame, në gishtat e ngjyem,
pak të holla rrëshqasin në fundin e kangës,
dhe kur mendojnë se fitojnë,
humbjen fitojnë;
gjokse të shkokluem,
thasë prej njerëzish!*

Tek tregon për jetën plot brenga të punonjësve kosovarë, poeti vë në pah dashurinë e tyre të flaktë për vendlindjen. Notat e zymta dhe fryma e shqetësuar e rrëfimit shquan

1) A. Gjakova... Dhe thonë se paqe ka në botë, Tiranë 1962, f. 9.

dhe krijimet e A. Istrefit me temë nga jeta e popullsisë shqiptare në Jugosllavi. Në vjershën «Nëna e të burgosurit» poeti ka dhënë një pamje të përgjithësuar të kushteve të rënda në të cilat rrojnë kosovarët nën regjimin revizionist. Në historinë e nënës së të burgosurit është mishëruar tragjedia e sa e sa nënave shqiptare, bijtë e të cilave u zhdukën në burgjet dhe kampet e internimit. Pamjen e zymtë të shtypjes dhe të ndjekjeve e plotëson vjersha «Ku janë gishtat e mi?» (1962). Autori shkruan thjesht, pa figura të kërkuara. Ideja shprehet përmes hollësish shumë shprehëse:

*Melodia mesjetare derdhet nëpër biruca.
Fytyra të ngërdheshura e dhambëqitun me grushta ku,
bajnë roje në dyert tona —
në dyert e numrave tonë,
sepse ne s'kemi ma emna.*

*Emrat tonë u shndërruan në numra.
Unë jam numër.
Jam njëmijetreqindnjishi që flas me vetëveten.
Jam njëmijetreqindnjishi me brinjë të thyeme
e pa dhambë në gojë,
sepse unë qeshë ma i fortë se dhambët e mi!*

Ndonjëherë zëri i poetit kumbon me nota patetiko-oratorike. Në poezitë «Një stinë e thatë» dhe «Baladë kosovare» gjeti shprehje urrejtja ndaj xhelatëve të popullit kosovar dhe dhembja e autorit për shokët që u bënë fli.

Poezia satirike e kësaj periudhe fshikulloi me ashpërsi dukuritë negative dhe pohoi moralin socialist. Gjejmë në veprat e poetëve satirikë demaskimin e burokratizmit, të intelektualizmit, të patriarkalizmit, të konservatorizmit, të parazitizmit etj. Janë këto tema që ishin trajtuar edhe më parë në

1) A. Istrefi, *Net kosovare*, Tiranë 1967, f. 36.

poezinë satirike, por në këtë periudhë shkrimtarët i trajtuan më thellë nga ana ideore. Kështu, p.sh. duke vënë në shënjestër burokratizmin apo konservatorizmin, poetët u përpoqën të vinin në pah rrezikun që ato paraqesin për shoqërinë socialiste si shfaqje të huaja. Ky tipar shquan krijimet më të mira të kësaj periudhe të S. Çomorës, të D. Bubanit, të T. Milotit, të D. Agollit, të A. Banushit, të L. Qafëzezit etj.

Në satirën «Parazitët» (1972) S. Çomora fshikullon ata njerëz, të cilët vijnë vërdallë gjatë gjithë orarit zyrtar e s'bëjnë asgjë dhe, për të fshehur pazotësinë e tyre, kritikojnë ata që punojnë, duke e detyruar kolektivin të mirret me gjëra të parëndësishme. Këta, thotë poeti, janë si ato bimët parazitare që «rrinë e hanë nga buka e botës si s'ka më mirë». Në «Rubai për burokratin» (1966) T. Miloti përqesh tipin e burokratit. Vjersha është thurur si rrëfim i burokratit, i cili zbulon hapur veten e tij, mendimet dhe qëllimet që e udhëheqin në jetë. Në vjershën «Burokrati» (1967) D. Bubani vizatoi figurën e burokratit jo në mënyrë shabllone, si njeri të zhytur në shkresurina, që e përcjell popullin duke i thënë «eja nesër», por burokratin që përpiqet t'u përshtatet kushteve të reja të jetës. Ky burokrat tregohet i shkathët, nuk mungon asnjëherë në gjimnastikën e mëngjezit, madje ka pakësuar edhe formularët. Këtë tip, i cili shtiret sikur ecën me kohën, autori e ka vënë në lojë përmes imtësive të goditura. Përveç ca shfaqjeve të jashtme, shton poeti, asgjë nuk ka ndryshuar tek ai, as konceptet dhe as stili në punë. Në vjersha të tjera satirike D. Bubani shpotit edhe ata punonjës të cilët e humbasin kohën e vlefshme në punë, duke u marrë me muhabete të kota ose me gjëra të parëndësishme («Orët e vdekura», «I disiplinuari», «S'ka kohë të punosh» etj.)

Intelektualizmin si shfaqje të huaj për fizionominë morale dhe shpirtërore të njerëzve tanë, T. Miloti e fshikulloi në një varg krijimesh. Në vjershën «Xhubleta» vihen në lojë ata të rinj, të cilët, ndonëse mësojnë dhe fitojnë diplomën me paratë e popullit, pasi mbarojnë studimet, nuk pranojnë të shkojnë atje ku ka nevojë vendi, kurse në vjershën «Hamleti në terren» (1966) autori qesëndisi frikën para vështirësive të jetës si shfaqje që vihet re tek disa të rinj.

Në një varg krijimesh të formës së madhe u stigmatizuan përfaqësuesit e klasave shfrytëzuese. Në poemën «Rreshperët»

(1970) T. Miloti dha portretin satirik kolektiv të klasave të vjetra, që para Çlirimit i kishin qëndruar mbi zverk popullit. Krahas korrupsionit dhe jetës së zbrazët të «rreshperëve», autori vuri në dukje antipatriotizmin, që i çoi këta të bashkëpunonin me armiqtë e atdheut, me pushtuesit nazifashistë. Edhe në poemën e L. Qafëzezit «Kujdes kokën, zotërinj» (1972) fshikullohen përfaqësuesit e borgjezisë së madhe dhe të bejlerëve, që revolucioni popullor i hodhi në koshin e historisë. Autori tregon se pas grushtit që hëngrën nga populli, armiqtë nuk hoqën dorë nga ëndrrat e tyre për të ardhur në fuqi me ndihmën e të huajve. Për këtë qëllim pas Çlirimit ata u vunë shpejt në shërbim të agjenturave imperialisto-revizioniste, por çdo herë dështuan ashtu siç do të dështojnë edhe në të ardhmen. Në rojë të fitoreve të revolucionit vigjëlon një popull i tërë, i cili ka bërë hi dhe pluhur të gjitha komplotet që armiqtë e ndryshëm kanë kurdisur kundër Shqipërisë socialiste.

Me gjithë zgjerimin dhe thellimin e problematikës, krijimtaria satirike nuk iu përgjegj si duhet kërkesave të zhvillimit të jetës shoqërore. Në përgjithësi ajo eci ngadalë në këtë periudhë; kritika e të metave ishte e përciptë; pati raste kur humori e satira ishin të rëndomta.

PROZA

Letërsia e kësaj periudhe karakterizohet nga zhvillimi i gjerë i prozës. Si rezultat, nga njëra anë, i faktit që jeta në shoqërinë socialiste u bë më e gjallë dhe më e pasur dhe nga ana tjetër, i zhvillimit të brendshëm të krijimtarisë letrare, proza arrin pjekurinë e saj artistike. Kjo u shfaq në radhë të parë në aftësinë e prozatorëve për të përfshirë në veprat e tyre një lëndë të gjerë jetësore, që lidhet me veprimtarinë shoqërore-historike dhe punën ndërtimore të masave të gjera punonjëse. Shumica e veprave flasin për Luftën Nacionalçlirimtare dhe për ndërtimin e shoqërisë së re, shprehin synimin e autorëve për të dhënë ngjarjet madhështore të epokës, aktet heroike të njerëzve tanë, patriotizmin e tyre të flaktë dhe shpirtin e lartë të sakrificës përballë vështirësive që nxirrte lufta për ndërtimin e jetës së re. Prozatorët krijojnë karaktere të gjalla tipike të njerëzve të sotëm, paraqesin më thellë botën e brendshme, sjelljen dhe veprimet e tyre. Heronjtë e këtyre veprave janë paraqitur në konflikte të mprehta, në luftë me armiqtë e vendit dhe të masave punonjëse, me pushtuesit e huaj dhe me klasat shfrytëzuese, me shfaqjet e ideologjisë së vjetër reaksionare në ndërgjegjen e njerëzve dhe me ideologjinë borgjeze e revizioniste.

Për prozën e sotme, kjo periudhë ka qenë periudha kur nisi të zhvillohet romani — epike, i cili u dha dorë shkrimtarëve që ta pasqyronin në mënyrë të gjerë e në zhvillim revolucionar jetën, të paraqesin procesin e formimit të karakterit të njeriut në lidhje të ngushtë me jetën e popullit. Krahas këtij romani, në të cilin zbulimi i karaktereve të personazheve lidhet me zhvillimin e veprimit dhe me përshkrimin konkret e të hollësishëm të mjedisit ku ata veprojnë, u zhvillua edhe një lloj romani në të cilin ideja shprehet kryesisht përmes pamjeve të sintetizuara të jetës.

Proza e realizmit socialist e kësaj periudhe shquhet nga larmia e llojeve. Paralel me romanin, eci përpara edhe novela, tregimi, skica dhe përshkrimi. Në novelat dhe në tregimet e botuara në këto vite vihet re përpjekja për një ngërthesë më të madhe ideore dhe për një pasqyrim psikologjik të karaktereve të personazheve.

Hovi që mori proza artistike në këto vite u duk edhe në shtimin e mundësive të saj krijuese. Disa nga prozatorët e njohur, si Sh. Musaraj, J. Xoxa, S. Spasse, A. Abdihoxa etj., talenti i të cilëve u shfaq në mënyrë të plotë në këtë periudhë, krijuan romane që pikturonin pamje të gjera të luftës për ngadhënjimin e botës së re. Në mesin e viteve 60 e shfaqën veten si prozatorë të talentuar edhe poetët I. Kadareja, D. Agolli etj., të cilët dolën me romane dhe vëllime me tregime që e pasuruan prozën me karaktere dhe me ide të reja. Në këtë kohë vijnë të krijojnë edhe një varg prozatorësh të tjerë si N. Prifti, Dh. Xhuvani, T. Laço, D. Shaplo, A. Kondo, Gj. Zheji, V. Koreshi, A. Cerga, N. Jorgaqi, H. Petrela etj.

Pasurimi dhe zhvillimi i prozës vihet re edhe në lëmin e mjeteve artistike. Paraqitja e jetës me anë të pamjeve të gjera epike, prirja për të ndjekur procesin e formimit dhe të kalitjes së njeriut të ri, vizatimi i tij në lidhje të ngushtë me rrethanat e jetës, të rrokurit dhe nxjerrja në pah e asaj që është thelbësore në dukuritë shoqërore, të gjitha këto kërkonin një formim të shëndoshë ideor dhe zotërim më të mirë të mjeshtrisë artistike. Prozatorët bëjnë përpjekje këmbëngulëse për të ngritur nivelin e tyre ideor dhe profesional. Duke u mbështetur më mirë në mundësitë e mëdha që jep marksizëm-leninizmi për njohjen e ligjësorive të jetës shoqërore, ata ditën të depërtonin në proceset dhe dukuritë themelore të realitetit socialist dhe të krijojnë karaktere tipike me gjithë pasurinë e jetës së tyre të brendshme, në lidhjet e shumëllojshme reale me mjedisin, me jetën e popullit. Në romanet që përbëjnë arrijet më të rëndësishme të letërsisë së këtyre viteve, autorët ditën që rreth subjektit, i cili zakonisht është i lidhur me fatin e heroit qendror, të organizonin një lëndë të gjerë jetësore, duke futur në veprim një numër të madh personazhesh. Konfliktet që prozatorët vunë në themel të veprave të tyre janë reale dhe pasqyrojnë me vërtetësi ndeshjet dhe kontradiktat e jetës. Përpjekje të shënuara bënë prozatorët për të zotëruar sidomos

artin e kompozicionit në format e mëdha epike. Romanet më të mira që dolën në dritë në këtë periudhë, shquhen për kompozicion të goditur; në to është arritur që faktet dhe ngjarjet e jetës shoqërore e politike të inkuadrohen organikisht në subjekt dhe të organizohen në mënyrë të tillë që të dalë në pah me qartësi ideja.

Kuptohet se lufta për të siguruar nivel sa më të lartë ideor dhe artistik, kaloi përmes vështirësish të ndryshme. Në pasqyrimin e ngjarjeve të Luftës Nacionalçlirimtare dhe të ndërtimit socialist ndonjë autor zuri pozitë të gabuar ideore, çka e çoi në shtrembërimin e së vërtetës së jetës. Aty-këtu pati prirje për t'u veshur heronjve sa më shumë të meta duke zbehur forcën e ndikimit të tyre në masat. Këto prirje të dëmshme ideore u shoqëruan ndonjëherë me kërkime formaliste, me truke, që largonin vëmendjen nga ajo që është thelbësore në veprën artistike, nga brendia ideore.

I

Epoka e Luftës Nacionalçlirimtare dhe e revolucionit popullor, me problematikën e saj të gjerë dhe aktuale, vazhdonte të ishte një nga burimet e pashtershme që ushqeu zhvillimin edhe të prozës së kësaj periudhe. Zhvillimi i prozës është i lidhur ngushtë me kërkimet artistike për përgjithësimin e përvojës së luftës antifashiste e të revolucionit popullor. Kjo përvojë ashtu si dhe gjithë traditat e luftërave të popullit tonë për ekzistencë e për pavarësi kombëtare, fitonin në kushtet që po kalonte shoqëria shqiptare, një rëndësi e një kuptim të veçantë. Në ngjarjet e luftës letërsia gjeti një lëndë të pasur për të pohuar idenë e gjallërisë dhe të forcës së rrallë të qëndrësës së popullit shqiptar.

Pasqyrimi i ngjarjeve që lidhen me luftën kundër pushtuesve fashistë zuri vend të madh në tregimet. Në zhvillimin e tregimit gjatë kësaj periudhe ndodhën ndryshime të thella të brendshme. Ai forcoi tiparet e tij si lloj letrar, përsosi mundësitë analitike në pasqyrimin e kontradiktave të jetës dhe të fatit të heronjve në lidhjet e shumta dhe komplekse me botën që i rrethon, zgjeroi rrethin e subjekteve ku situatat e mprehta u transmetojnë ngjarjeve një dramalizëm të veçantë dhe the-

llësi psikologjike. Kjo i dha mundësi tregimit ta pasqyrojë Luftën Nacionalçlirimtare nga anë të ndryshme, të zgjerojë diazonin e aspekteve të revolucionit që hynë në kornizën e tij.

Tregimtarët e përqëndruan vëmendjen kryesisht në burimet e brendshme të heroizmit partizan, në pasqyrimin e forcës dhe të bukurisë shpirtërore të njerëzve të thjeshtë që morën krahë dhe u rritën shpirtërisht nën ndikimin e ideve të luftës.

Duke mbetur në kufijtë e llojit të vet, bazën e strukturës të të cilit e formon elementi epik narrativ, tregimi me temë luftën çlirimtare popullore mori ndonjëherë trajtën e miniaturës lirike, përmes së cilës synoi të zbulonte rrënjët dhe poezinë e heroizmit partizan, procesin e formimit tek përfaqësuesit e vegjëlisë të një ndërgjegjeje të re, të ushqyer nga idealet e revolucionit.

Pasqyrimi i shpirtit heroik dhe i qëndrueshmërisë morale që shfaqën luftëtarët e lirisë, të cilëve iu desh të kalonin sprova të vështira e të përballonin vuajtje mbinjerëzore, formon brendinë e disa prej tregimeve më të mira me këtë temë. Në tregimin «**E pabesueshmja**» (1966) të N. Priftit është poetizuar figura e një partizani të thjeshtë, përmes pasqyrimit të një akti jo të zakonshëm. Qëndrimin burrëror të partizanit autori e ka zbuluar si diçka tipike për kohën, si një veprim që do ta kryente çdo partizan po të ishte në vendin e heroit. Ngjarja zhvillohet brenda një kohe të shkurtër në sallën e një spitali partizan. Midis të plagosurve ndodhet edhe një partizan i ri, i cili pranon t'i presin dorën e gangrenizuar me një sharrë drush e pa narkozë. Kjo ngjarje e thjeshtë i ka dhënë mundësi shkrimtarit të theksojë heroizmin si një tipar të çmuar që skali lufta në karakterin e njerëzve. Figura e partizanit, bota e tij shpirtërore, burimi i heroizmit të tij të rrallë, janë zbuluar me lirizëm dhe vërtetësi psikologjike. Duke shfrytëzuar me mjeshtëri imtësitë, autori ka ndriçuar shpirtin e mrekullueshëm të partizanit që duron me stoicizëm të rrallë dhembjen e operacionit. Optimizmi, prirja për t'i marrë gjërat si me të qeshur, humori i lehtë dhe dashuria për jetën, që e ruan edhe në çastet më të vështira, japin në mënyrë të plotë fizionominë shpirtërore të partizanit të ri, i cili mendon vetëm për luftën. Ky mendim që mbush gjithë qenien e tij e shtyn të pranojë t'i pritë krahu i plagosur, i bindur se për luftën do të jetë më

i dobishëm me një dorë sesa pa asnjë. Kjo bindje buron nga besimi në idetë e Partisë. Për të zbuluar këtë autori shfrytëzon rrëfimin e çiltër, herë-herë naiv të partizanit, që pëson se ka ardhur në spital vetëm për të mos ia prishur komisarit, të cilin dëshiron ta pyesë edhe para se të vendosë t'i pritë ose jo dora. Po mjeti më i goditur artistik që zbulon forcën e karakterit të tij heroik, është monologu i brendshëm, sidomos kënga partizane që nisi ai të këndonte në çastin kur sharrë hyri në kockë. Një kuptim simbolik merr kori i partizanëve të tjerë të cilët ndiqnin pas derës gjendjen e shokut të tyre. Kjo këngë e fuqishme, madhështore dhe e rreptë shprehte idealin e jetës së mijëra partizanëve, ideal në emër të të cilit u kryen heroizma të rralla.

Fryma lirike që e përshkon, mjeshtëria e depërtimit në botën e brendshme të heroit, gjuha e gjallë dhe rrëfimi i shtruar, në frymën e ligjërit popullor, i japin tregimit një forcë të veçantë shprehëse emocionuese dhe e bëjnë një nga krijimet më të bukura të letërsisë sonë, kushtuar temës së heroizmit partizan. Zbulimi i karakterit të heronjve përmes pasqyrit të botës së tyre të brendshme bie në sy si tipar dallues i talentit të N. Priftit edhe në përmbledhjet e tij të kësaj periudhe: «Tregime» (1962), «Litar i zjarrtë» (1970) etj.

Tiparet heroike në karakterin e partizanëve, qëndrueshmëria morale dhe vendosmëria për të kryer detyrën duke kapërcyer pengesa të pashembullta, u pasqyruan edhe në një varg tregimesh si «Vdekja e shoferit» e «Kio» të A. Kondos, apo «Kur vinte pranvera» e A. Cergës.

Në tregimin «Vdekja e shoferit» (1968) të A. Kondos zbulohen tiparet thelbësore të figurës së komunistit: devotshmëria ndaj çështjes për të cilën lufton dhe vetëdija e lartë në përmbushjen e detyrës. Në qendër të veprës është një shofer komunist, i cili nën hundën e armikut transporton armë për shokët. Duke ndjekur udhëtimin e tij të fundit, lexuesi ndien edhe rrjedhën e mendimeve dhe të emocioneve të heroit në çastet e një dyluftimi të egër për jetë a vdekje me avionin gjerman që e gjurmon këmba-këmbës. Me anë të përqsjes së bukurive të pranverës me mendimet dhe ndjenjat që provon heroi, i cili është i vendosur ta çojë me çdo kusht deri në fund misionin që i kanë ngarkuar, autori pëson idenë së heroizmi i shoferit të ri i ka rrënjët në idealet e luftës me të cilat është

brumosur si komunist. Heroi shkon drejt vdekjes me vetëdije të qetë, edhe pse e do pranverën dhe jetën. Ajo që i jep forcë dhe që udhëheq të gjitha veprimet e tij, është synimi i patundur për të arritur sa më parë tek shokët, për t'u dorëzuar armët që u duheshin aq shumë. Ndjenja qytetare e detyrës përbën thelbin e karakterit heroik të shoferit.

A. Kondoja në tregimet e tij, të cilat i botoi në librat «Ura» (1968) dhe «Njerëz dhe gurë» (1970) poetizon zakonisht botën e madhe dhe forcën e rrallë shpirtërore të njerëzve të thjeshtë, për të cilët tregon në mënyrë të natyrshme, përmes një rrëfimi ku shtresat lirike dhe elementet publicistike shkrihen në një unitet të vetëm artistik.

Lufta Nacionalçlirimtare ishte një përmbysje e vërtetë që solli ndryshime të mëdha në të gjitha fushat e jetës; ajo nxiti lindjen e marrëdhënieve të reja midis njerëzve, formimin e normave të reja morale që iu kundërvunë moralit të shoqërisë së vjetër. Këto anë u përpoq që t'i rrokte e t'i shprehte artistikisht edhe proza e shkurtër. Humanizmi i lartë dhe ndjenja e madhe e dashurisë për shokun, si tipar i rëndësishëm i jetës partizane, u pasqyruan në tregimin «U gjykua një partizan» (1965) të D. Shaplllos. Autori e ka përshkruar heroin jo në ndeshje me armiqtë, por me vetveten. Subjekti i tregimit është i thjeshtë. Për pakujdesinë e doktorit, gjatë tërheqjes së spitalit në ditët e operacionit armik, një partizan i plagosur rëndë mbetet në borë dhe, për të mos u rënë në dorë gjermanëve, vret veten. Për këtë doktorin nxirret përpara gjyqit partizan, përballë shokëve të vet të luftës dhe të idealit. Duke e vendosur heroin në një situatë të tillë dramatike, autori ka zbuluar më mirë ndjenjat dhe përjetimet e heroit në këtë çast të vështirë të jetës së tij. Monologu i brendshëm, imtësitë psikologjike, gjithë situata, në të cilën del në pah ideja e veprës, ndihmojnë të zbulohen motivet e brendshme që e bëjnë doktorin të shkojë i qetë drejtë vdekjes, i bindur në drejtësinë e vendimit të shokëve, nga të cilët nuk do që ta ndajë as vdekja.

Duke përdorur dy plane, planin e paraqitjes së emocioneve dhe të mendimeve të anëtarëve të gjyqit partizan, që detyrohen të vendosin për dënimin me vdekje të shokut të tyre, si dhe planin e përshkrimit të botës së brendshme të doktorit, i cili, ndonëse nuk i kishte shkruar kurrë në mend se

do të vdiste nga plumbi i shokëve, gjen forca të kuptojë gabimin dhe të mbajë një qëndrim burrëror, autori ka zbuluar me forcë artistike idenë e drejtësisë së pagabuar partizane. Karakteristike për stilin e D. Shaplos si tregimtar janë lirizmi e psikologjizmi, të realizuar kryesisht përmes monologut të brendshëm ose imtësisë karakteristike të jashtme. Dialogu i tregimeve të D. Shaplos është lakonik, kurse në përshkrimin e tij spikasin ngjyrat e lehta. Këto tipare vërehen edhe në tregimet e tjera të këtij autori, të botuara në vëllimin «Në bregun e hijes» (1965).

Një sërë tregimesh me temën e luftës që panë dritë në këtë periudhë, u karakterizuan nga fryma e theksuar demaskuese; në to fshikullohen armiqtë, morali i tyre çnjerëzor dhe barbar («Larashi» i T. Laços, «Ura» e A. Kondos etj.). Interesimi për këtë temë u përcaktua nga kërkesat ideologjike të kohës. Në këto krijime shkrimtarët iu kundërvunë teorisë revizioniste të humanizmit abstrakt mbiklasor, nxorën në pah karakterin e rremë të këtyre parullave, thelbin e tyre kundërrivolucionar. Në tregimin «Larashi» (1965) të T. Laços natyra e vërtetë e armikut është zbuluar në një çast kur mund të pritej që nazisti, në mos zakonin, të ndërronte të paktën lëkurën. Por «ujku po ujk mbetet» pohon autori me gojën e plakut që i ka kthyer jetën robit gjerman e që shpërblehet prej tij në një mënyrë çnjerëzore. Biseda me vetveten, që i shkon aq shumë një plaku të vetmuar e të rrëguar, është gjetur prej autorit si një mjet i goditur për të paraqitur fizionominë e armikut edhe botën e brendshme të plakut. Në fillim plaku mendoi se, po të shpëtonte gjermanin, ky mund të ishte «... rob i vlefshëm për djemtë»¹. Me bujarinë karakteristike të shqiptarit e mjekon derisa e kthen në jetë. Qëllimi i plakut ishte fisnik dhe njerëzor, por ai e kupton shpejt se është gënjyer. «Po kush mund të mburret se krijoi një qen prej një ujku?». Në këtë plan zbulohet edhe figura e armikut, i cili nuk flet, por vetëm vepron. Ai është përshkruar në përputhje me thelbin e tij shoqëror e psikologjik; mosmirënjohja dhe egërsia me të cilën prridh dhe e ther me kosore plakun, janë në pajtim me natyrën e një fashisti të vendosur. Por, ndërsa ushtari

1) T. Laço, *Era e tokës*, Tiranë 1965, f. 25.

nazist është dhënë me vërtetësi ideore, lëkundjet dhe iluzionet e fshatarit plak nuk janë motivuar si shprehje e mungesës së vetëdijes së tij të zhvilluar politike.

T. Laçoja gjatë kësaj periudhe shkroi disa vëllime me tregime, si: «Era e tokës» (1965), «Rruga e bardhë» (1967), «Një natë shiu» (1969), «Ajri i ftohtë i mesnatës» (1972), në të cilat e shfaqti veten si tregimtar i formuar dhe me individualitetin e vet si krijues. T. Laçoja e përqendron vëmendjen në botën e brendshme të personazheve, në nuancat më të holla të ndjenjave e përjetimeve të tyre. Për karakterizimin e personazheve, sidomos të gjendjes së tyre shpirtërore, në tregimet e T. Laços një funksion të veçantë artistik kryen natyra, e cila vizatohet me një ndjenjë të ngrohtë poetike; në këto përshkrime çdo objekt i natyrës perceptohet si qenie e gjallë.

Rëfimit të T. Laços i jep një gjallëri të veçantë gjuha e punuar, pasuria e fjalës, metafora dhe nënteksi që kanë një forcë të veçantë sugjestionuese.

Karakter i çnjerëzor i armikut dhe dështimi i tij i plotë moral zbulohet dhe në tregimin «Ura» (1969) të A. Kondos. Brendinë e këtij tregimi e formon ideja e forcës së pashtershme të popullit, ngadhënjimi i kuptimit optimist për jetën mbi filozofinë e urrejtjes dhe të shkatërrimit që bart pushtuesi. Përballë njëri-tjetrit qëndron, në një anë, komisari që frymëzon masën e fshatarëve të ndërtojnë në një kohë rekord dhe pa mjetet e nevojshme, urën e shkatërruar nga armiku dhe në anën tjetër, majori nazist, i zënë rob, i cili gjatë tërheqjes kish dhënë urdhër të hidhej në erë ura, i vetmi mjet që lidhte krahinën me qytetin. Komisari mendon që në ndërtimin e urës të fusë në punë majorin, por majori s'pranon të rindërtojë atë që ka shkatërruar vetë. Megjithatë ura duhej ndërtuar. Në kushte të jashtëzakonshme, duke mos pasur ndihmë teknike dhe as beton, fshatarët, me besim të patundur në forcat e tyre e të frymëzuar nga komisari, e ngrejën urën. Fitorja e tyre shënon dështimin e armikut, falimentimin e filozofisë së tij cinike. Figura e komisarit dhe e masës janë zbuluar në kontrast me figurën e majorit. Optimizmi historik, besimi në fitore, guximi, vendosmëria dhe heroizmi që karakterizojnë fshatarët dhe komisarin partizan, i kundërvihen karakterit çnjerëzor të armikut, botë-kuptimit të tij reaksionar. Me anë të këtij kontrasti autori ka paraqitur frymën heroike të luftës si dukuri tipike masive. Ide-

ja e fitores së sigurtë të masave të udhëhequra nga komunistët, besimi në forcën e tyre të pashtershme morale, ideja e vigjilencës ndaj armikut që përshkojnë tregimin «Ura», i kanë dhënë tregimit një tingëllim aktual; kjo vepër dëshmon për frymën militante të prozës së shkurtër me temë nga lufta.

Në zhvillimin e tregimit për luftën si pasojë e një konceptimi ideor të gabuar të thelbit të heronjve dhe të ngjarjeve, pati edhe shfaqje të pasqyrit të shtrembër të epokës. Në disa tregime që vunë në qendër aspektet tragjike të luftës mbizotëron një atmosferë e zymtë shpirtërore; ngjarjet dhe karakteret u pasqyruan në to me një frymë objektivistë. U botuan vepra në të cilat imtësitë e përjetimeve të «heronjve» janë zgjedhur në funksion të zbulimit të pozitës tragjike të njeriut në luftë dhe të dobësisë së tij morale. Në disa raste tipi i partizanit është pasqyruar në dritën e një kuptimi abstrakt moral, i zhveshur nga forca morale dhe optimizmi historik që ishte karakteristike për heronjtë e vërtetë të kohës, të dalë nga radhët e vegjëlisë. Një kuptim i tillë gjeti shprehje sidomos në përmbledhjen me tregime «Zëra nga burime të nxehta» (1972) të S. Godos. Në tregimet e kësaj përmbledhjeje, sidomos në tregimin «Fushata», masa e partizanëve është paraqitur si një «zinxhir i murrme që zvarriset» me një pamje të sfillitur e të lodhur shpirtërisht, me një vetëdijë të turbullt, në të cilën janë fashitur idealet e vërteta që frymëzuan luftëtarët e lirisë, entuziazmi i lartë dhe shpirti heroik që i karakterizoi ata në ditët e sprovave të rënda në luftë kundër armiqve.

Këto dukuri ishin shfaqje të shkëputura në rrugën e zhvillimit të tregimit për luftën i cili në tërësinë e vetë pasqyroi Luftën Nacionalçlirimtare nga pozita të partishme, zbuloi thelbin e karakterit burrëror të partizanit, rrënjët e heroizmit të vetëdijshëm të luftëtarëve të lirisë, ndikimin e ideve të luftës në zgjimin dhe zhvillimin politik të masave popullore.

*
*
*

Pasqyrimi artistik i epopesë së luftës ka formuar një nga drejtimet kryesore të zhvillimit të romanit në këtë periudhë. Lufta Nacionalçlirimtare u përftua si përmbysje rrënjësore

me rrjedhime të thella politike e shoqërore në jetën e vendit dhe në fatin e klasave të ndryshme. Kjo solli që në romanet me këtë tematikë të zgjerohet kuadri i jetës së pasqyruar në to. Shëndërrimet e thella që ndodhën në jetën shpirtërore të shoqërisë shqiptare, formimi i vetëdijes revolucionare tek masat dhe rritja e tyre politike u paraqit si një proces ligjësor historik. Zhvillimi i romanit me këtë temë dhe tiparet e reja që mori, u përcaktuan nga gjerësia dhe thellësia e problematikës së trajtuar, nga rëndësia që fitonte përvoja historike e revolucionit popullor në rrethanat e luftës ideologjike të kohës, nga forcimi i historizmit të menduarit artistik të romancierëve.

Një nga tiparet që e dallon romanin për luftën në këtë periudhë është thellimi i realizmit, pasqyrimi më i plotë, përmes pamjeve me përmasa të gjera, i kontradiktave dhe i konflikteve themelore, i proceseve më karakteristike që formojnë brendinë e asaj epoqe.

Krahas forcimit të karakterit epik, zhvillimi i romanit për luftën është i lidhur si me prirjen e përgjithshme për të pasqyruar me thellësi psikologjike jetën shpirtërore të përfaqësuesve të shtresave të ndryshme shoqërore, ashtu dhe me prirjen për të shprehur përsiatje të thella filozofike mbi epokën, që u dhanë shpesh me anën e simboleve mbi të cilat kaloi funksioni i organizimit artistik e kompozicional të veprës. Rezultante e veprimit të këtyre prirjeve janë një varg ndryshimesh që ndodhën në zhvillimin e brendshëm dhe në poetikën e romanit. Mundësitë e mëdha epike të këtij lloji u dukën sidomos me zhvillimin e romanit shumplanësh. Në romanin epike rrethi i subjekteve u zgjerua shumë; edhe pse në të u përfshinë zakonisht disa vija, subjekti mori një karakter më intensiv dhe u bë më funksional lidhur me zbulimin e idesë artistike. Kjo është karakteristike për romane të tilla, si «Para agimit» i Sh. Musarajt. «Tri ngjyra të kohës» i A. Abdihoxhës etj., ku në qendër të subjektit është fati i heroit qendror, i cili tregohet në plan të shtrirë epik, në lidhje e në marrëdhënie me një mori personazhesh që i japin veprimit gjerësi.

Pasqyrimi i luftës nga anë të ndryshme përcaktoi dhe kërkimin e situatave e të konflikteve më dramatike, që japin mundësi për të zbuluar pasurinë e jetës së brendshme të heronjve, zgjimin shpirtëror të vegjëlisë, forcën e saj të rrallë morale, dilemat e atyre që u gjendën në udhëkryq si dhe ka-

tastrofën shpirtërore të atyre që iu kundërvunë procesit objektiv të zhvillimit të historisë.

Forcimi i karakterit epik, i dramatzimit dhe i qëndrimit emocional, thellimi i analizës psikologjike përcaktuan strukturën e romanit me temë Luftën Nacionalçlirimtare, në të cilën dallohen disa shtresa, si: narracioni i mirëfilltë dhe paraqitja objektive e fakteve dhe e ngjarjeve ose momentet mediativo-lirike, mendimi asociativ dhe monologu i brendshëm. Nga kjo pikëpamje është karakteristik romani «Komisari Memo». i D. Agollit, struktura e të cilit është përcaktuar nga parimi i sinkronizimit artistik të ngjarjeve që kalojnë nga një prerje kohore në tjetrën dhe nga introspekcioni si veçori i stilit të këtij autori. Larmia e elementeve strukturore, që u përcaktua nga veçoritë dhe gjerësia e problematikës së shtruar në romanin e sotëm për luftën, si dhe pasuria e lëndës jetësore që hyri në të, kërkoi dhe forma të reja kompozicionale. Përpunimi i këtyre formave ishte një nevojë e brendshme e shprehjes së përmbajtjes së re sidomos për ato vepra që e trajtuan temën e luftës në lidhjet e drejtpërdrejta me realitetin e ri historik, në përjasje me detyrat që ngjarjet e mëdha historike shtruan para shoqërisë shqiptare. Kjo detyrë artistike u zgjidh në vepra të tilla si romani: «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» ose «Kronikë në gur» të I. Kadaresë. Ideja e këtyre veprave nuk buron nga paraqitja objektive e ngjarjeve; ato nuk përshkruhen, por kalojnë në filtrën e mendimit, projektohen në plan moral e filozofik dhe marrin një kuptim përgjithësues, një veshje konvencionale a një tingëllim simbolik.

Brendia ideore e romaneve të kësaj periudhe për luftën, synimi për thellësinë psikologjike e për të zbuluar idenë artistike përmes përjasjes së dy kohëve, ka çuar në përzierjen e rrafshëve kohore, në përdorimin e shpeshtë të retrospektivës, në ngushtimin e segmentit kohor të zhvillimit të ngjarjeve etj. Kjo ka përcaktuar edhe një varg veçorish të tjera të formës, midis tyre edhe karakterin prej mozaiku të kompozicionit.

Të marra në tërësinë e tyre romanet e sotme për luftën formojnë eposin artistik të një epoke të lavdishme, kur zhvillimi i shoqërisë shqiptare ka qenë, në të gjitha aspektet, më intensiv se kurrë ndonjëherë më parë.

Romani «Para agimit» (1965) i Sh.

PARA AGIMIT

Musarajt doli në kohën e kërkimeve këmbëngulëse të prozës sonë për të pasqyruar në pamje të gjera epike lëvizjen e masave të vegjëlisë të udhëhequra nga komunistët.

Pjesëmarrës aktiv i lëvizjes popullore çlirimtare e militant i shtypit ilegal Sh. Musaraj në një varg krijimesh të viteve të luftës kishte treguar zgjimin e vetëdijes revolucionare të masave dhe kishte demaskuar qëndrimin tradhtar të klasave të larta, që iu bënë qole armikut. E njëjta problematikë e vendosur në kuadrin e gjerë të luftës së komunistëve për organizimin e forcave të gjalla të vendit, u trajtua edhe në romanin «Para agimit».

Në themel të subjektit të kësaj vepre qëndron konflikti i madh i kohës, konflikti midis pushtuesve dhe veglave të tyre, nga njëra anë, dhe popullit, nga ana tjetër. Duke vënë përballë tradhtisë e zvetënimit moral e politik të klasave të larta patriotizmin e vegjëlisë e cila, nën ndikimin e ideve të reja të përfaqësuar nga komunistët, doli në skenën e historisë si forcë vendimtare, autori ka pohuar idenë e rolit krijues historik të masave. Kjo përbën edhe bazën ideore të subjektit, nga e cila zënë fill edhe dy vijat e tij themelore. Në vijën e parë të subjektit ka gjetur pasqyrim tema e zgjimit të vetëdijes revolucionare të masave. Përmes saj është zbuluar roli i komunistëve në organizimin e popullit në luftë për çlirimin kombëtar e shoqëror, kurse në vijën e dytë tregohet se si krahas zgjerimit të lëvizjes popullore revolucionare erdhi duke rënë gjer sa u zhdruk fare ndikimi i nacionalizmit borgjez. Në roman pasqyrohet degjenerimi, falimentimi dhe demaskimi i plotë politik i klasës së çifligarëve, të tregtarëve të mëdhenj dhe të intelektualëve reaksionarë të cilët, duke bashkëpunuar me pushtuesin, u shndërruan përfundimisht dhe haptazi në forca antikombëtare.

Në qendër të romanit si protagonistë të vërtetë të ngjarjeve të mëdha historike janë komunistët. Duke u dhënë heronjve të vërtetë të kohës vendin qendror në vepër, autori u përpoq të zbulonte thelbin e tyre shoqëror e moral si heronj të një tipi të ri, të ndriçonte tiparet e vërteta që karakterizuan figurën e komunistit. Këtë tip të ri heroit e përfaqëson në vepër/Qemal Orhanaj; ai ka vetitë e luftëtarit aktiv

dhe energjik, në veprimtarinë e të cilit u shpreh roli i komunistëve si forca e vetme udhëheqëse e luftës për çlirim. Bruga e formimit të Qemalit si luftëtar i vetëdijshëm është paraqitur nga autori në lidhje të ngushtë me rrethanat e jetës shoqërore, ideore dhe politike të kohës. Ngjarjet e romanit shtrihen në një periudhë të gjatë kohe që nis nga vitet para pushtimit fashist e vjen deri në ditët e fitores. Nëpër këto ngjarje kalon edhe heroi i veprës. Etapat përmes të cilave kryhet procesi i formimit të tij si revolucionar përputhen me etapat që kalon shoqëria shqiptare, me çastet historike që jetonte vendi në këto vite dhe me kthesën e madhe që shënoi për fatet e popullit formimi i Partisë Komuniste Shqiptare.

Nën ndikimin e këtyre ngjarjeve, Qemal Orhanaj pëqet si revolucionar dhe bëhet militant e kuadër udhëheqës i lëvizjes. Ky i ri intelektual, që vjen nga gjiri i fshatarësisë punonjëse, në fillim kërkon të dijë shkaqet e gjendjes së vështirë të vendit, të amullisë së përgjithshme shpirtërore e intelektuale, të padrejtësisë e pabarazisë shoqërore që sundonte kudo, dhe në të njëjtën kohë përpigjet të mësojë për rrugët e vërteta të shpëtimit të popullit nga dhuna e shfrytëzimi. Por përgjigjen e këtyre pyetjeve ai nuk e gjen dot në diskutimet e pafund që zhvillohen në rrethet e intelektualëve të mykur, si Ajet Velo e zoti Bardhi me shokë, të cilët i bashkon urrejtja e papërmbajtur për komunizmin dhe për masat e gjera popullore, frika nga dhuna revolucionare që ishte e vetmja rrugë e shpëtimit të shoqërisë shqiptare nga gjendja pa rrugëdalje ku kishte hyrë ajo në fund të viteve 30.

Përvoja e jetës, pjesëmarrja në lëvizjen e përgjithshme demokratike të kohës dhe, nga ana tjetër, njohja nga afër me rrethet e intelektualëve pseudopatriotë e bindën shpejt Qemal Orhanajn se këta zotërinj rrihnin ujë në hayan në një kohë kur popullin e kishte drobitur mjerimi dhe vendi gjendej në zgrip të greminës. Ai e kupton se e vetmja forcë e aftë që mund të siguronte të drejtat demokratike dhe të mbronte lirinë e pavarësinë e atdheut ishin komunistët. Pas gjyqit të Tiranës, ku Qemali mbron me guxim bindjet e tij prej komunisti megjithëse nuk kishte asnjë lidhje organizative me grupet komuniste, jeta e heroit hyn në një fazë të re. Pas tragjedisë së 7 prillit 1939, Qemali e kupton se një diferencim

i thellë po bëhej në forcat politike të vendit lidhur me qëndrimin ndaj pushtimit fashist. Atij iu neveritën «baballarët e Kombit» dhe «elita intelektuale» me qëndrimin e tyre kapitullues. Ai ndeshet haptazi me pikëpamjet e Emira Velos, e cila përfaqëson vijën tradhtare të elitës duke ndjekur taktikën e «pritjes» dhe të besimit tek «patriotët e vjetër», si Midhat bej Frashërit me shokë, që orvateshin me të gjitha mënyrat të pengonte lëvizjen popullore. Qemali zgjedh rrugën e luftës së armatosur kundër pushtuesit. Te ky personazh ka gjetur pasqyrim procesi i lartësimit moral, i kalitjes politike dhe i pasurimit shpirtëror e intelektual të atyre pjesëmarrësve të lëvizjes, të cilëve u takoi të luftonin më shumë në kushtet e ilegalitetit në sektorin e propagandës së partisë.

Duke e pasqyruar jetën në dritën e konfliktit midis masave dhe pushtuesve të huaj e bashkëpunëtorëve të tyre, autori ka zbuluar edhe thelbin e ndryshimeve që ngjajnë në ato vite në jetën mendore të shoqërisë shqiptare. Romani «Para agimit» pasqyron përpjekjet e komunistëve për forcimin e ndikimit të tyre ideologjik tek masat dhe tregon se si ata me anë të shtypit ilegal dhe të mjeteve të tjera të propagandës përhapën idetë e luftës për çlirim kombëtar e shoqëror, të cilat hodhën rrënjë të thella në popull dhe u shndërruan në një faktor të ri të fuqishëm ideologjik, që iu kundërvu ideologjisë së falimentuar të nacionalizmit borgjez. Në zjarrin e kësaj lufte, në frontin e ndeshjes së ideve, në veprimtarinë praktike për organizimin dhe drejtimin e punës propagandistike dhe me debatet me rrethet e intelektualëve nacionalistë dhe me krerët e «Social-demokrates» dhe në polemikat me Emira Velon për fatet e atdheut dhe rolin e klasave të ndryshme shfaqen vetitë e reja që revolucionin përftoi në vetëdijen e Qemalit, si: intransigjenca e karakterit, zotësitë organizative, qartësia ideologjike, pjekuria politike, forca e logjikës, guximi dhe gjakftohtësia.

Autori e ka treguar rrugën e formimit të heroit si një proces aktiv dhe ligjësor, si pjesë të procesit të përgjithshëm të formimit të vetëdijes revolucionare tek masat, të cilat, nën ndikimin e ideve të reja, u zgjuan dhe fituan tipare të reja në karakterin e tyre. Duke e konceptuar heroin si pjesë të masës, shkrimtari edhe lidhjen e komunistëve me masat nuk e ka parë nga ana e jashtme dhe nuk mbeti vetëm në paraqitjen e bashkëpunimit dhe të ndihmës që u dhanë njerëzit e thjeshtë ko-

munistëve ilegalë, si Qemal Orhanaj me shokë. Besimi në forcën e pashtershme të masave, që u jep krahë dhe guxim komunistëve, është paraqitur në roman si ndjenjë e ushqyer nga vetë jeta, nga rrethanat e reja historike, kur masat e varfëra të qytetit dhe të fshatit, nisën të mbanin një qëndrim aktiv ndaj historisë e të luanin një rol vendimtar në zhvillimin e saj. Në përfitim të kësaj dukurie, si tipari më i qenësishëm i epokës së luftës, është shprehur historizmi i të menduarit të shkrimtarit. Duke kuptuar zgjimin e energjive të pashtershme të vegjëlisë si një proces të natyrshëm, të nxitur nga realiteti i ri shoqëror e politik i asaj periudhe, autori krijoi një radhë personazhesh, të cilat mishërojnë karakteret e heronjve të vërtetë të kohës dhe zbulojnë prirjen kryesore të zhvillimit historik në ato vite. Në vepër nuk është vetëm numri i madh i këtyre personazheve që shpreh gjerësinë e kësaj dukurie. Për të treguar se revolucioni zgjoi forcat krijuese të mbarë vegjëlisë, Sh. Musaraj ka përshkruar karaktere nga shtresa e mjedisit të ndryshme, që kalojnë nëpër rrugë të ndryshme për të fituar vetëdijen ideologjike dhe politike, por që rriten të gjithë nën ndikimin e ideve të luftës.

Ideja e zgjimit dhe e formimit politik të përfaqësuesve të popullit del në pah përmes historisë së njerit prej personazheve të rëndësishëm të veprës, të Nekie Talos. Përvoja e hidhur e jetës e ka bindur atë dhe njerëzit e radhës së saj se nga rrojtja në ankth e pasiguri, ku jo vetëm mungonte buka e gojës, por merrej nëpër këmbë dhe nderi e dinjiteti, do t'i shpëtonte vetëm lufta që bënin komunistët. Këtë bindje ajo e shpreh në mënyrë të thjeshtë kur pranohet në radhët e Partisë Komuniste Shqiptare. Pyetjes së njerës prej shoqeve të celulës se ç'është shtyn te ishte kaq e lidhur me Partinë, ajo iu përgjegg me fjalët më të zakonshme që ia thoshte zemra: «*Vuajtja, them unë, më shtyn që të jem kaq e lidhur. Ç'më shtyn tjetër? Vuajtja dhe nevoja që ka njeriu për pështetje, kur e përzënë me gurë nga të gjitha anët e s'di nga t'ia mbajë...*»¹.

E mbetur jetime, Nekies iu desh të punonte si hyzmeqare në derën e Galip bej Frakullës. Aty hoqi të zitë e ullirit dhe njohu shfrytëzimin dhe vuajtjet më të rënda. Në këtë familje

1) Sh. Musaraj, *Para agimit*, Vëll. II, Tiranë 1966, f. 74.

ajo njohu jo vetëm kërbacin e hanëmit, por luftoi për të mbrojtur dinjitetin e vet edhe nga vardisjet e mërzitshme të beut. Për të shpëtuar nderin, Nekija arratiset me të fejuarin, duke kaluar një jetë të vështirë, me frikën e vazhdueshme të ndjekjes së beut. Lëvizja që organizojnë komunistët vjen në jetën e saj si një rreze drite e shprese. Ajo lidhet ngushtë me luftën e komunistëve dhe nën ndikimin e tyre ripërtërihet shpirtërisht, fiton guxim dhe besim në vetvete. Gjatë jetës aktive që bën në gjirin e celulës, Nekija shkund druajtjen, pasivitetin, sentimentalizmin dhe dyshimin që kish në fillim se a do të vinte vallë bashkë me çlirimin e vendit edhe dita e shpëtimit të vegjëlisë nga shtypja shoqërore. Rruga e rritjes morale dhe e zgjimit të saj politik përfaqëson rrugën e çlirimit të mijëra grave që në të kaluarën ishin të ndrydhura nga pesha e mjerimit dhe e shtypjes së egër.

Procesi i zgjimit të vegjëlisë është shprehur edhe përmes një radhe personazhesh të tjerë si Demkos, Veledin Goxhos, Kopanit etj., të cilëve nën ndikimin e ideve komuniste iu hapën sytë. Ata zënë një vend të ri në jetë dhe fitojnë vetëdijen e rolit të klasës së tyre në zhvillimin e ngjarjeve.

Një meritë e veçantë e romanit është paraqitja e lëvizjes ilegale në qytet, gjë që ka ndihmuar të zbulohet më mirë jo vetëm roli i komunistëve që kryejnë një veprimtari të gjerë organizuese dhe sqaruese, por edhe devotshmëria ndaj çështjes së luftës e njerëzve të thjeshtë të popullit që i kthyen shtëpitë e tyre në baza të sigurta për ilegalët.

Përballë vegjëlisë që del në skenën e historisë si forcë e gjallë dhe aktive, në vepër janë pasqyruar edhe klasat e larta, të cilat u vunë në shërbim të pushtuesit. Tradhtinë e klasave të vjetra sunduese autori e ka parë si përfundim logjik të një procesi të filluar me kohë në shtresat e larta të shoqërisë shqiptare. Duke i dhënë një vend të gjerë paraqitjes së jetës politike dhe mendore të këtyre shtresave në prag të pushtimit fashist, autori ka zbuluar degjenerimin e plotë në të cilin ishte zhytur borgjezia e madhe dhe çifligarët si dhe falimentimin e nacionalizmit borgjez, i cili me kryeneçësi e pa marrë parasysh prirjen objektive të zhvillimit historik, bëri çmos të shtypë luftën çlirimtare të masave popullore. Në këtë sfond duken qesharake të gjitha përpjekjet e nacionalistëve për të marrë në dorë frenat e luftës dhe për të mbetur prapë kaluar

në Shqipërinë e çliruar. Përballë masave të popullit që kanë dalë në skenën e historisë dhe vepronë në përputhje me prirjet përparimtare, forcat e reaksionit mbesin në rolin e Don Kishotit. Këtu e ka burimin fryma satirike, me të cilën autori karakterizon përfaqësuesit «e ndritur» të nacionalizmit borgjez, intelektualët e shitur dhe gjithë puthadorët e pushtuesit. Në krye të krerëve të nacionalistëve borgjezë qëndron Midhat bej Frashëri, tipi i politikanit reaksionar, i cili pas namit të «patriotit të vjetër» kërkon të mashtrojë njerëzit dhe të mbulojë veprimtarinë e vet tradhtare dhe qëllimet e vërteta të organizatës «Balli Kombëtar», që u krijua për t'iu kundërvënë lëvizjes çlirimtare të masave. Mungesa e çdo ndjenje të vërtetë atdhetare, urrejtja e madhe për vegjëlinë dhe për komunizmin janë tiparet e tij thelbësore. Fytyrën e tij të vërtetë si mbrojtës i interesave të klasave sunduese ai e fshih pas fjalëve demagogjike se «nuk e zë gjumi për fatin e Shqipërisë». Thelbin e vërtetë të kësaj figure të urreyer autori e zbulon në situata të ndryshme që nxjerrin në pah kontrastin midis demagogjisë së tij «patriotike» dhe veprave prej tradhtari.

Kontrasti, ironia dhe sarkazmi janë mjetet që përdor me sukses autori për të zbuluar edhe fytyrën e eksponentëve të tjerë të «Ballit Kombëtar». Një efekt të fortë satirik krijon kontrasti midis qëndrimit prej frikacaku e njeriu pa parime që mban Galip bej Frakulla përparë gjyqit partizan dhe lëvdatave të papërmbajtura që i bën trakti ballist, duke e cilësuar si «kreshnik të vërtetë». Në figurën e tij autori ka theksuar tiparet e çifligarëve, të cilët, për interesat e tyre si klasë, kishin tradhtuar me kohë interesat e larta të atdheut. Sado që në thelb si krerët e «Ballit», ashtu edhe krerët e «Socialdemokratës» dhe intelektualët nacionalistë kanë të njëjtat tipare morale e politike, mbajnë të njëjtin qëndrim ndaj pushtuesit, ushqejnë të njëjtën përbuzje për «turmën amorfe» e të njëjtën urrejtje për komunizmin, atë në romanin e Sh. Musarajt dallohen mirë nga njëri-tjetri. Autori ka mundur t'i individualizojë me mjeshteri dhe të zbulojë në karakterin e secilit anë të veçanta të procesit të degjenerimit moral e politik të klasave të larta të shoqërisë. Duke iu shmangur uniformitetit në paraqitjen e armikut, autori na ka dhënë një galeri të tërë personazhesh negativë, bartës të veseve më të neveritshme të shtresave të zvetënuara të shoqërisë së lartë. Në figurën e Petrit Kasimatit,

oficerit të Simit dhe të Gestapos, ai ka zbuluar tipin e kriminelit të egër dhe cinik, që i bindet verbërisht padronit të huaj të cilit i shërben. Qëndrimi që mban në gjyqin partizan ndaj udhëheqësit të tij shpirtëror, Galip bej Frakullës, dhe akti i vetëvrasjes, pohojnë gjendjen e dëshpëruar e pa rrugëdalje në të cilën u ndodhën bashkëpunëtorët e pushtuesit kur populli i doli zot fatit të vendit. Këtë ide plotëson edhe vetëvrasja e Safet bej Backës, tek i cili autori vizatoi tipin e atyre «baballarëve të kombit», që deshën të hanin në dy çanakë, duke u hequr si përkrahës të lëvizjes dhe duke u shërbyer gjermanëve.

Mjaft laraman është edhe stani i intelektualëve nacionalistë. Përmes personazheve të tjerë nga kampi armik, avokat Velos, motrës së tij Emira Velos, zotit Banka e zotit Meçe etj., autori ka karakterizuar thelbin shoqëror e moral të intelektualëve pseudopatriotë dhe ka zbuluar botën e tyre të vogël shpirtërore dhe interesat e tyre të ngushta. Avokat Velon zhvillimi i ngjarjeve e intereson sa ato lidhen me karrierën dhe fitimet e tij. Në ditët e para të pushtimit fashist ai nuk tronditet aspak prej fatkeqësisë që i ra vendit mbi krye, por shqetësohet nëse punët do të ecnin në atë rrugë që do t'i siguronte një pozitë më të mirë dhe fitime më të mëdha. Këto motive përcaktojnë qëndrimin e tij ndaj luftës që bën vegjëlia dhe i venë vulën figurës së tij morale e politike. I zhveshur nga çdo qëllim i lartë në jetë e nga çdo ndjenjë fisnike del edhe zoti Banka, tipi i gazetarit dallkauk, që për të ruajtur lëkurën është gati ta kthejë fletën nga fryn era.

Në mënyrë më të plotë autori ka vizatuar figurën e Emira Velos, të vajzës intelektuale që nuk mundi të shkëputej nga klasa e saj dhe mbeti deri në fund skllave e koncepteve dhe e paragjykimeve shoqërore me të cilat ishte ushqyer e rritur. Përmes fatit të saj shkrimtari ka mishëruar idenë se në atmosferën e helmuar të shtresave të larta të shoqërisë, mbytet çdo ndjenjë e vërtetë, siç është ndjenja e patriotizmit që e shtyn në fillim Emira Velon të afrohet me Qemal Orhanajn e të marrë pjesë në demonstratën kundër pushtuesit fashist. Lëkundjet dhe luftën e brendshme që zhvillohet tek ajo, autori i shikon si pasojë të kontradiktës midis pozitës së saj shoqërore dhe qëllimeve të luftës që bëjnë masat të udhëhequra prej komunistëve. Duke qenë e lidhur ngushtë me interesat e klasës së vet, Emira nuk arrin të kuptojë perspekti-

vën e zhvillimit historik dhe të shohë ç'i ndan komunistët nga «Balli Kombëtar» dhe organizatat e tjera tradhtarë. Tragjedia e Emira Velos qëndron në faktin se ajo nuk mundi ta kuptonte kurrë forcën e idealit që frymëzonte komunistët dhe nuk mundi të shkëputej nga koncepti për masat si një «turmë e verbër». Kjo ka përcaktuar evolucionin e figurës së saj nga një simpatizante e lëvizjes në një armike të betuar të saj. Shkrimtari e ka zbuluar këtë proces me vërtetësi psikologjike: sa më e ashpër bëhet lufta, aq më tepër largohet Emira prej asaj; ajo tmerrohet nga veprimtaria aktive e popullit. Fundi i Emira Velos është fundi i gjithë atyre forcave që iu kundërvunë historisë, luftës së masave për çlirimin kombëtar.

Romani «Para agimit» është menduar si një pamje e shtrirë e epokës së Luftës Nacionalçlirimtare. Autori ka përfshirë në të një lëndë të gjerë, fakte e ngjarje të shumta, ndonëse nuk ka arritur gjithmonë t'i zgjedhë ato e t'i përpunojë sa duhet artistikisht. Si kompozicionin ashtu edhe subjektin e veprës më tepër sesa konflikti dramatik, i ka përcaktuar kronologjia e zhvillimit të ngjarjeve. Duke ndjekur ecurinë në kohë të ngjarjeve, autori i ka vendosur heronjtë në lidhje të ngushtë me to dhe, për të krijuar atmosferën e epokës, përdor shpesh dokumente dhe fakte të njohura historike. Por të gjitha këto janë në shërbim të idesë artistike të veprës në të cilën, ndryshe nga veprat artistiko-dokumentare, fantazia krijuese e shkrimtarit luan rolin kryesor. Kjo duket edhe në ndërtimin e figurës së atyre personazheve, të cilët edhe pse përfaqësojnë persona të njohur historikë, janë inkuadruar në mënyrë organike në subjektin e romanit. Figurat e disa karaktereve nuk janë vizatuar gjithmonë me forcën e duhur artistike. Kjo ka ndodhur edhe me heroin kryesor të veprës, Qemal Orhanajn, karakteri i të cilit zhvillohet deri në një farë vendi dhe më tej ecën në vijë horizontale.

Duke pasqyruar me vërtetësi prirjet themelore të kohës dhe duke vënë në qendër figurat e komunistëve, të heronjve të vërtetë që nxori jeta, romani «Para agimit» zë një vend të rëndësishëm në radhën e veprave që trajtojnë temën e Luftës Nacionalçlirimtare dhe është një shprehje e pasurimit të mëtejshëm ideor dhe artistik të prozës sonë të gjatë në përgjithësi.

TRI NGJYRA TË KOHËS

Një pamje të gjerë të jetës shqiptare gjatë viteve të luftës jep edhe romani në katër vëllime «Tri ngjyra të kohës» (1965-1972), i A. Abdihoxhës.

Me këtë vepër autori ka paraqitur jetën e asaj kohe në shfaqjet e saj më të ndryshme. Krahas skenave që pasqyrojnë luftën e masave popullore kundër pushtuesit e reaksionit, të cilët marrin, sidomos në librin e fundit të romanit, përpjesëtimet e një afresku ku shfaqet karakteri masiv popullor i Luftës Nacionalçlirimtare dhe zbulohet fryma e qëndresës heroike dhe e vetëmohimit të rrallë të gjithë popullit, autori ka pikturuar edhe skena nga jeta e shtresave dhe e mjedisve të ndryshme shoqërore dhe ka krijuar tipa që bartin psikologjinë e rrethit shoqëror të cilit i përkasin. Të gjitha ngjarjet dhe situatat që ngërthen subjektin e romanit, rrjedhën e jetës shoqërore dhe politike të kohës, autori ka synuar t'i përftojë në dritën e perspektivës historike. Jo rastësisht nyjat e subjektit dhe ato të biografisë së personazheve zënë fill shumë kohë më parë sesa të hynte në vepër tema e përleshjes së ashpër me armikun. Libri i parë i romanit, që mbyllet me skenat tronditëse të tërheqjes së ushtrisë mbretërore më 7 prill të vitit 1939, zbulon parahistorinë e ngjarjeve dhe të karaktereve që zhvillohen më pas, në situatën e re që krijon pushtimi fashist i vendit dhe qëndresa heroike që i bënë fashizmit masat popullore të udhëhequra nga komunistët.

Romani i A. Abdihoxhës pasqyron kontradiktën kryesore të epokës. Përmes konfliktit politiko-shoqëror që përshkon jetën e vendit asokohe autori ka ndjekur fatet e personazheve, të cilët në përputhje me qëndrimin që mbajnë ndaj problemeve themelore të kohës, rreshtohen në njërin ose në tjetrën anë të barrikadës, me popullin ose kundër tij.

Me tipin e Ahmet bej Cërlës, të prefektit demagog dhe të pseudopatriotit, autori ka treguar se klasa e çifligarëve, si bartëse tradicionale e korrupsionit politik, gjeti tek fashizmi mbrojtësin e interesave të saj jetike dhe bashkëpunoi me të për të mbytur lëvizjen e vegjëlisë, prej së cilës rrezikohej e ardhmja e saj si klasë sunduese. Nga ana tjetër, romani pohon idenë se në veprimtarinë e Ahmet beut dhe të përfaqësuesve të tjerë të klasës çifligare, fashizmi gjeti aleatin e vet më të afërt për të shtypur lëvizjen e masave për çlirimin ko-

mbëtar. Në portretin e beut, nëpunës i lartë në aparatën burokratike të monarkisë zogiste, i cili do të lozë në ngjarjet e mëvonshme rolin e veglës politike të fashizmit, autori ka theksuar që në fillim disa nga tiparet më thelbësore të klasës së cilës i përkiste prefekti i Elbasanit. Kontrasti që krijojnë skenat ku paraqitet qëndrimi mospërfillës i Ahmet beut ndaj gjendjes së mjeruar të masave, të cilat po shuheshin nga uria dhe epidemitë, dhe imtësitë që hedhin dritë mbi jetën e velur të prefektit, ndihmojnë për të zbuluar më mirë fizionominë shoqërore dhe morale të funksionarëve antipopullorë të shtetit zogist dhe për të kuptuar më thellë rrënjët e tradhtisë kombëtare të bejlerëve dhe të borgjezisë së pasur. Si motiv i veprimeve, i mendimeve dhe i ndjenjave të Ahmet beut janë interesat e pronës dhe të klasës së tij. Shqetësimet për fatet e kësaj klase, të cilat i kërcënonin zgjimi i vegjëlisë dhe përhapja e ideve të reja përparimtare, ushqejnë tek beu i shkolluar pikëpamjen obskurantiste lidhur me «sëmundjet shpirtërore» që sjell me vete, sipas tij, përhapja e kulturës në popull. Por natyra e vërtetë e beut shfaqet në mënyrë më të plotë kur nis lufta e organizuar e masave kundër fashizmit dhe veglave të tij. Duke qenë i bindur se kjo luftë është një ndeshje për jetë ose vdekje midis vegjëlisë dhe klasave shfrytëzuese, Ahmet beu përqendron të gjitha forcat e tij për të shkatërruar lëvizjen popullore çlirimtare në krahinën e Elbasanit. «Komunizmi na qëndron mbi kokë si çekan... Lufta ime është një grimë kontributi për qëndrueshmërinë e klasës sonë»¹, deklaroi ai, i vendosur në qëndrimin e tij antipopullor.

Kuptimi konkret historik i rolit që luajti klasa e çifligarëve në zhvillimin e ngjarjeve në vitet e luftës u shpreh edhe në figurën e Kahreman bej Cërlës. Ndonëse në pamje të parë, pasioni i shfrenuar për të grumbulluar kapitale e për të bërë karrierë me sipërmarrjen e tij tregtare duket sikur e dallon atë prej të ungjijt, në thelb, ka shumë gjëra të përbashkëta me Ahmet beun. Pasi ka pranuar pas disa lëkundjesh detyrën e komandantit të çetës balliste, sidomos pas vrasjes së Ahmet beut, ai e ndjeu më mirë instiktin e pronës, gjakun e klasës

1) A. Abdihoxha, «Tri ngjyrat e kohës» vëll. III, Tiranë 1969, f. 279.

dhe detyrën që ka ndaj saj. Rrëfimi për tradhtinë e turpshme të forcave balliste, që zbulon Kahreman beu në sy të njerëzve të klasës së vet në një çast dëshpërimi të thellë, është një mjet i goditur me anë të të cilit autori i heq maskën e patriotizmit pas së cilës fshihej veprimtaria antikombëtare e organizatës së «Ballit Kombëtar».

Në përputhje me prirjen për të pasqyruar luftën si një ngjarje që ndikoi në mënyrë të ndryshme në shtresat dhe klasat që përbënin shoqërinë e atëhershme shqiptare, A. Abdihoxha i ka dhënë mjaft vend në vepër paraqitjes së lëkundjeve dhe dyshimeve që provojnë përfaqësuesit e shtresave të mesme para se të përcaktojnë qëndrimin e tyre ndaj ngjarjeve të mëdha që përshkojnë jetën e vendit. Nga kjo pikëpamje është mjaft e goditur figura e Mal agait. I mbyllur në rrethin e ngushtë të interesave të veta si kërmilli në guaskën e tij, Mal agai s'do t'ia dijë as për Shqipërinë e as për popullin. Në çastet kur masat gjakosen me fashistët në rrugët e qytetit, Mal Tyxhari vrapon në qilar për të fshehur qeskat me florinj, që përbëjnë të vetmin qëllim të jetës së vet. Përqasja e këtyre dy skenave ka nxjerrë në pah me mprehtësi thelbin e karakterit të këtij tregtari të mesëm, i cili interesohet për ngjarjet përreth vetëm kur rrezikohen fitimet e tij. Atëherë Mal Agai bëhet bishë dhe është gati që çdo flori ta kthejë në ballist e në polic, për të mbytur lëvizjen e vegjëlisë që rrezikon interesat e pronës e të familjes së tij. Pasiguria për të ardhmen zgjon tek ai ndjenjën e mallit për të kaluarën, kur fatet e vendit i kishte në dorë paria. Mosbesimi, frika dhe dyshimi që ka ai ndaj çdo ndryshimi në jetë, ndaj çdo gjëje të re, sidomos ndaj luftës së masave popullore, buron prej urrejtjes që ushqen për to e prej konceptit reaksionar që ka për popullin si një masë e verbër, e pazonja të lozë ndonjë farë roli në jetën politike. Shkrimtari e ka vizatuar Mal agën si një anadollak e konservator edhe në jetën familjare, si pjellë e një ambienti shoqëror të prapambetur e patriarkal.

Por, siç ka vënë re me të drejtë kritika, shkrimtari nuk e ka parë gjithmonë drejt nga ana ideore vlerën e vërtetë të përfaqësuesve të shtresave të mesme në jetën politike, ndonjërin prej tyre autori e vizatoi me ngjyra tërheqëse. Kjo ka cenuar vërtetësinë ideore të veprës. Në dëm të pasqyrimin të figurave të organizatorëve të lëvizjes ilegale në qytet dhe

në përgjithësi të lëvizjes masive popullore, që ishte forca e vërtetë e gjallë e zhvillimit historik, shkrimtari i dha një vend të gjerë në tre vëllimet e para të veprës zbulimit të botës dhe ndjesive të vogla të një kategorie intelektualësh të lëkundur e pasivë. Synimi për të pasqyruar rrugën e gjatë dhe me zigzage që iu desh të kalonte një pjese të inteligjencies për të zënë vendin e vet në konfliktin e madh të kohës, është i justifikuar brenda kuadrit të përgjithshëm të veprës, por në punë e sipër shkrimtari shpesh është harruar pas ndjekjes së kësaj ane të jetës dhe nuk ka mundur ta vendosë atë në vendin e vërtetë në kuadrin historik. Në figurën e doktor Besim Kodrës autori deshi të zbulonte tipin e intelektualit apatik në pikëpamje politike, në fillim të lëkundur dhe me ndjenjë qytetare të pazhvilluar, të plogësht e të paaftë për të kuptuar tendencën e zhvillimit të ngjarjeve. Mirëpo ndryshimi i këtij karakteri nuk është paraqitur në mënyrë të plotë dhe bindëse, kthesa e tij vjen papritur dhe mbetet e pamotivuar në plan ideor dhe psikologjik. Autori e lidh këtë kthesë herë pas here me motive individuale, që burojnë nga një kuptim sentimental i qëndrimit të mjekut ndaj Skënderit. Vendi i madh që i është dhënë një figure tjetër intelektual nga shtresat e mesme borgjeze, interesimi i tepruar për jetën e tij shpirtërore dhe sidomos mënyra se si është karakterizuar Makasen Tyxhari, kanë bërë që të krijohet një përfytyrim jo i vërtetë për rolin dhe qëndrimin e intelektualëve antipopullorë prej shtresave të privilegjuara ndaj fateve të atdheut. Në vend që të vinte theksin në thelbin objektivist negativ të karakterit shoqëror të personazhit dhe të zbulonte natyrën e tij të vërtetë reaksionare, egoizmin dhe individualizmin si shfaqje tipike të psikologjisë së një liberali borgjez që mban qëndrim aristokratik ndaj popullit, autori ka përshkruar me nuancat më të holla lektisjet shpirtërore dhe flirtin e tij me Filen. Si pasojë është zbehur thelbi social-politik i këtij karakteri.

Përballë tradhtisë së klasave të larta shfrytëzuese, zvetënimin moral e politik të pinjollëve të saj dhe lëkundjeve të pafund të intelektualëve borgjezë, A. Abdihoxxha ka synuar të zbulojë veprën e vegjëlisë, figurën morale të popullit të thjeshtë. Në kuadrin e gjerë të veprës qëndresa e masave dhe rritja e lëvizjes së tyre, që i ngjan një orteku të papërmbajtur, vjen si një zhvillim i përgatitur nga ndryshimet politike dhe

ideore që ngjanë në shoqërinë shqiptare. Zgjimim e vetëdijes politikoko-klasore të masave, shndërrimin e tyre në një forcë historike aktive, autori ka synuar ta zbulojë lidhur ngushtë me idetë e luftës çlirimtare që përhapën komunistët. Nën ndikimin e këtyre ideve njerëzit e popullit nisën të fitonin një kuptim të ri për pozitën e tyre shoqërore, të nxënë se lufta e komunistëve kundër fashizmit e bashkëpunëtorëve të tij ishte lufta e tyre, të merrnin zemër e guxim, t'u dilnin zot fateve të tyre dhe të vendit.

Me anë të paraqitjes së zhvillimit shpirtëror të Skënder Shpatës, të Spiro Shtegut dhe të shokëve të tyre të luftës, tregohet roli i ideve të Partisë në ripërtritjen shpirtërore të masave, në rritjen e ndërgjegjes së tyre politike dhe në formimin e tipareve dhe të cilësive të reja morale në karakterin e përfaqësuesve të vegjëlisë. Jeta e vetëdijshme nga pikëpamja politike për Skënder Shpatën fillon atëherë kur takohet me komunistët. Nën ndikimin e ideve të tyre jeta e tij merr një kuptim e drejtim të ri. Leximi i veprave marksiste, pjesëmarrja në lëvizjen greviste të punëtorëve të fabrikës, ku punonte, e, më vonë pjesëmarrja në lëvizjen antifashiste, i hapin hyzmeqarit të dikurshëm horizontin dhe e ndihmojnë të mbajë një qëndrim aktiv ndaj jetës e të shndërrohet në një komunist të vendosur. Duke synuar të zgjerojë përfytyrimin tonë për rolin dhe ndikimin e komunistëve në mjediset e ndryshme të jetës së atëhershme shoqërore, autori e ka vendosur heroin në situata disi të veçanta. Skënder Shpata e shfaq veten si komunist i vërtetë në punën e madhe që bën për të nxitur ushtarët shqiptarë të dezertojnë nga radhët e ushtrisë kuislinge dhe në veprimtarinë e madhe që zhvillon si agjikator në kamp, ku gjenden mijëra të burgosur, të cilët i organizon dhe i kthen në një masë kompakte e të vendosur për t'i qëndruar terrorit fashist. Skënderi si organizator i masave dhe si komisar është paraqitur lidhur ngushtë me figurën e madhe të popullit, të këtij heroi dhe protagonistit të vërtetë të ngjarjeve heroike të dimrit të viteve 1943-1944, pasqyrimi i të cilave formon brendinë e librit të katërt të romanit. Me një rreze drite, që ndjek gjurmë pas gjurme rrurogën e jetës së Skënder Shpatës, autori ka ndriçuar disa nga tiparet më të qenësishme të heroit dhe ka theksuar ato veti që gdhendi lufta në karakterin e tij: forcën e rrallë dhe qëndrimin

heroik përpara vdekjes, vuajtjeve e torturave çnjerëzore, vendosmërinë dhe guximin, besimin dhe sigurinë në fitore, aftësitë organizuese.

Duke gërshetuar shtjellimin në plan epik të subjektit me zbulimin në plan psikologjik të botës së personazheve, autori i romanit «Tri ngjyra të kohës» edhe në krijimin e figurës së Skënderit ka ecur në rrugën e thellimit të karakterizimit psikologjik të heroit. Por jo të gjitha situatat në të cilat është vënë Skënderi janë vizatuar në përputhje me të vërtetën e jetës, disa syresh janë të stisura. E kërkuar është edhe vetë historia e dashurisë së Skënderit me vajzën e Mal Tyxharit.

Në përputhje me prirjen e tij artistike për ta pasqyruar jetën në gjerësi e për ta rrokur atë në shfaqjet e saj më të ndryshme, autori ka depërtuar në mjedise shoqërore nga më të larmishmet dhe ka pasqyruar aspekte të ndryshme që zbulojnë kuadrin e gjerë të jetës së kohës.

Përmes fatit të personazheve të ndryshme dhe skenave të gjalla nga jeta e fshatit, autori ka zbuluar aspekte të jetës prej qeni që bënte nën thundrën e beut fshatarësisë e varfër dhe ka treguar se përfaqësuesit e kësaj klase erdhën në radhët e revolucionit popullor gradualisht, duke kaluar përmes revoltës spontane dhe lëkundjeve tipike për ta.

Merita e romanit të A. Abdihoxhës qëndron në karakterin polifonik të tij dhe në prirjen për ta dhënë sa më të plotë kuadrin e jetës shqiptare të kohës, për të krijuar personazhe me një domethënie të gjerë shoqërore.

KOMISARI MEMO

Ndryshe nga A. Abdihoxha, i cili synoi të japë prirjet themelore të jetës shoqërore në vitet e pushtimit fashist, D. Agolli në romanin «Komisari Memo» (1970) i vuri vetes qëllimin të tregojë rolin udhëheqës dhe drejtues të komuniteteve, punën e tyre të madhe për t'i bërë masat popullore të vetëdijshme për qëllimet e luftës. Subjektin e romanit e formojnë kryesisht ngjarje që lidhen me procesin e shndërrimit të masave fshatare në një forcë plotësisht të ndërgjegjshme, kalimin e tyre nga veprime të veçuara e të pavetëdijshme në luftë të organizuar dhe të ndriçuar nga ndërgjegjja politike. Këtë dukuri autori e shikon si një nga sferat ku u shfaq roli historik i komunistëve, të cilët i dhanë lëvizjes spontane

të masave karakterin e një lufte të udhëhequr nga një program i qartë politik dhe nga një organizim e disiplinë e hekurt.

Këtë ide shkrimtari e ka shprehur me anë të kompozicionit të goditur që lidh njëra me tjetrën ngjarjet e subjektit, fijet e të cilit shtrihen në dy rrafshe kohore. Këto ngjarje vijnë njëra pas tjetrës si një zinxhir kujtimesh që u zgjon bashkëluftëtarëve të afërt të komisarit të batalionit partizan «Shkreptima» udhëtimi për në fshat, ku shpien bustin e tij. Dialogu i heshtur me bustin e komisarit, i cili «vjen» në fshatin e lindjes pas kaq vjetësh i derdhur në bronx, i ka dhënë gjithë romanit një ngjyrë të fortë emocionale. Subjekti i romanit ngërthen një pjesë të jetës dhe të luftës së Memo Kovaçit dhe të batalionit partizan, ku ai u dërgua si komisar, por bren dia ideore e veprës, që buron prej tërësisë së marrëdhënieve të karaktereve që veprojnë në roman, si dhe prej vlerësimit ideor-emocional që jep autori për to, është shumë më e gjerë.

Personazhi që lidh fijet e subjektit dhe shërben për të shprehur idenë themelore të veprës është komisar. Komisari si tip letrar ka tërhequr prej kohësh vëmendjen e D. Agollit, i cili e ka paraqitur në disa nga krijimet e tij poetike. Në poemën «Balladë e re për komisarin» dhe në balladën «Komisari» përmes figurës së komisarit poeti ka synuar të përgjithësojë forcën përtëritëse të ideve të Partisë që këndellën aspiratat më të shtrenjta të vegjëlisë dhe të pohojë vazhdimësinë në ditët tona të patosit heroik-romantik që karakterizoi synimet dhe veprën e komisarëve.

Po me atë ndjenjë të ngrohtë, por në një sfond shumë më të gjerë, D. Agolli e rikrijoi tipin e komisarit në romanin «Komisari Memo». Duke vënë në qendër të ngjarjeve Memo Kovaçin, autori është përpjekur që përmes këtij personazhi të zbulojë rolin e komunistëve gjatë luftës si organizatorë, udhëheqës dhe edukatorë politikë të masave. Komisari Memo është dhënë kryesisht përmes veprimit, në punën për riorganizimin e Këshillave Nacionalçlirimtare në një zonë ku është ende i fortë ndikimi i «Ballit Kombëtar», në përpjekje për të futur shpirtin e organizimit dhe të disiplinës në batalionin partizan, në luftë me shfaqjet e anarkizmit dhe me frymën e çakllëkut që karakterizon komandantin e këtij batalioni, në ndeshje të hapur me armikun në fushën e betejës. Kjo ka

ndihmuar të dalin më mirë në pah tiparet e karakterit të tij, si heroizmi i vetëdijshëm dhe qartësia e qëllimeve, thjeshtësia, gjakftohtësia dhe logjika e fortë, besnikëria ndaj çështjes për të cilën lufton dhe besimi në fitore, ëndrra fisnike për një botë të re.

Si komunist Memo Kovaçi e shfaq veten në rrethanat e ndërlikuara në të cilat vepron. Në cilësitë që e shquajnë atë si udhëheqës të tipit të ri, si njeri të aksionit revolucionar, si dhe në drejtësinë e ideve që mbron, qëndron forca e ndikimit të tij tek masat. Për rrezën e gjerë të veprimit të kësaj force dëshmon edhe kthesa që ndodh në bindjet e doktor Borovës, i cili, në sajë të punës së Memos, çlirohet nga iluzioni i gabuar se mund të mbante pozitë neutrale, në një kohë kur gjithë populli është hedhur në luftë për çlirimin e vendit, kupton se lëvizja që udhëheqin komunistët u përgjigjet interesave të vërteta të popullit e të kombit.

Idenë e forcës së madhe ndikuese të komunistëve në masat si dhe rëndësinë e udhëheqjes politike të Partisë gjatë luftës autori e ka shprehur në mënyrë më të plotë, duke i dhënë një vend të gjerë në vepër pasqyrimin të rolit të Memo Kovaçit si komisar i batalionit partizan «Shkreptima». Anëtarë thelbësorë të karakterit të komisarit dalin në marrëdhëniet e tij me komandantin Rrapo dhe me masën e luftëtarëve. Episodet që përfshin kjo vijë e subjektit kanë rëndësi kryesisht për të pohuar epërsinë e luftës së ndriçuar nga vetëdija politike mbi rebelimin spontan, epërsinë e organizimit dhe të disiplinës mbi anarkinë. Duke pasqyruar futjen e elementit të vetëdijshëm në ndërgjegjen e masave popullore, në procesin e luftës së tyre për çlirimin kombëtar e shoqëror, D. Agolli zbuloi njëkohësisht edhe rolin e komunistëve në këtë proces si dhe rëndësinë e udhëheqjes politike të Partisë për shndërrimin e çetave të veçuara të kaçakëve në reparte luftarake dhe të organizuara të Lëvizjes Nacionalçlirimtare.

Me ardhjen e komisarit Memo, në batalionin që komandon Rrapo Tabani ndodhin ndryshime të rëndësishme që ia shndërrojnë karakterin veprimtarisë së njësitit, duke e inkudruar atë në luftën e përgjithshme antifashiste që bënte populli i udhëhequr nga Partia. Përmes formave të organizuara të punës për edukimin ideologjik dhe politik të masës së luftëtarëve, komisarit Memo ndihmon të formohet tek ta një kuptim

i ri për luftën dhe rolin e tyre në të dhe ndikon që njerëzit të çlirohen dalngadalë nga disa shfaqje, paragjykime e lëkundje karakteristike për psikologjinë e shtresës shoqërore nga vijnë.

Idenë e rolit historik që luajnë komunistët për të zgjuar vetëdijen klasore të masave fshatare dhe për të shkëputur nga ndikimi i «Ballit Kombëtar» elementë të veçantë që për arsye të ndryshme, ndonjëherë krejt të rastit, u bashkuan përkohësisht me të, autori e ka zbuluar në figurën e Arifit. Ndryshimi që ndodh në bindjet dhe qëndrimin e këtij fshatari, i cili, pasi e kuptoi të vërtetën, i ktheu pushkën xhaxhait të vet ballist, është rezultat i ndikimit të rrethanave të reja dhe i punës edukative politike që bëhet në batalion. Komisarit, ka të qartë se atë kategori fshatarësh ku bën pjesë Arifi e lidhin me luftën interesat e saj themelore, prandaj mënjanon dyshimet dhe mosbesimin e komandantit e të disa partizanëve të tjerë ndaj tij dhe e ndihmon Arifin që të gjejë rrugën e vërtetë të shpëtimtimit.

Autori e ka karakterizuar komisarin edhe përmes veçori-ve e imtësive individuale që theksojnë lidhjen e ngushtë me jetën e popullit, e, në mënyrë të veçantë, me jetën e fshatit dhe që zbulojnë humanizmin e tij të lartë. Por ideja e rolit udhëheqës të Partisë dhe e lidhjeve të saj me masat do të dilte më e plotë në qoftë se komisarit do të ishte paraqitur më i lidhur me atë forcë që e ushqeje dhe e rriti atë si kuadër udhëheqës. Ndonjëherë, theksimi i tepruar prej autorit i aftësive individuale të komisarit, ka çuar në atë që të krijohet përshtypja sikur ky qëndron mbi masat, të cilat shohin tek ai njerinë që di dhe rregullon çdo gjë.

Romani «Komisari Memo» nuk pasqyron historinë e rritjes dhe të ndryshimit të karakterit të komisarit. Në bazë të kompozicionit të veprës qëndron zbulimi i anëve të ndryshme të këtij karakteri. Parimi i ndriçimit gradual e nga anë të ndryshme të fizionomisë shoqërore dhe shpirtërore të komisarit formon bazën e kompozicionit të të gjithë veprës. Sipas kësaj mënyre është paraqitur në vepër edhe figura e komandantit Rrapo, tiparet e të cilit zbulohen në rrethana të ndryshme dhe ndriçohen nga kënde të ndryshme, si përmes gjykimeve të komisarit dhe të partizanëve për të, përmes tregimit të shkrimtarit dhe sidomos përmes dialogut dhe monologut të heroit. Rrapo Tabani është personazhi më i spikatur i romanit; që

në faqet e para për të flitet si për një komandant popullor që i ka shtënë armikut tmerr, por që s'pranon në çetën e tij komisar politik. Duke poetizuar jo shpirtin rrebel dhe anarkist, por trimërinë dhe heroizmin e ndriçuar nga një ideal i lartë, D. Agolli me karakterin e komandantit shprehu idenë se në procesin e edukimit masat popullore shfaqin vetitë e tyre të çmuara, si: patriotizmin tradicional, karakterin e paepur dhe trimërinë.

Si tip Rrapo Tabani përfaqëson fshatarin e varfër, që, i revoltuar ndaj shtypjes së rëndë shoqërore dhe zgjedhës së të huajit, u hodh në aksione të armatosura kundër pushtuesit dhe veglave të tij. Tek Rrapoja bashkohet trimëria, patriotizmi popullor dhe urrejtja shekullore e fshatarit kundër shtypjes e padrejtësisë shoqërore me paditurinë dhe mungesën e vetëdijës politike. Tiparet e karakterit të tij nuk janë paraqitur si bashkim mekanik virtytesh e cenesh, por janë zbuluar si veti të formuara historikisht në psikologjinë e shtresës shoqërore nga vjen Rrapo Tabani. Përvoja e hidhur e jetës në regjimet antipopullore, kur fshatarin e varfër e grabiste dhe e mashtronte që nga më i larti deri tek më i ulëti nëpunës, vitet e kaluara në burgjet e Zogut kanë ngjallur në vetëdijen e Rrapos mendimin se të gjithë njerëzit e mësuar, janë finokë, por jo trima. Ky është një nga shkaqet përse komandanti Rrapo i sheh me dyshim masat që merr komisari për t'i ngritur nga ana arsimore e politike partizanët. Për këtë shkak ai mban qëndrim të rezervuar ndaj komisarit, derisa bindet se Memos krahas shkollës nuk i mungon edhe trimëria. Riedukimi i Rrapo Tabanit nuk është përshkruar si shndërrim që ndodh kryesisht në botëkuptimin e heroit. Duke i qëndruar besnik së vërtetës së jetës, shkrimtari tregon se komandanti nisi të hiqte dorë nga shfaqjet tipike për një komandant komitësh, jo sepse fitoi menjëherë vetëdijen e re ideologjike, por u detyrua nga autoriteti i komisarit dhe nga respekti që nis të ketë për të. Me komandantin Rrapo autori ka krijuar jo vetëm një tip me domethënie të gjerë shoqërore, por e ka vizatuar atë me plasticitet e veçori individuale të papërsëritshme. Imtësitë e përdorura për individualizimin e këtij personazhi kanë ndihmuar të shprehet me forcë artistike patosi që buron prej vlerësimit ideor pohues të thelbit të karakterit të heroit. Rrapo Tabani është karakterizuar kryesisht përmes

zbulimit të botës së tij të brendshme. Ndjenjat e tij të pastra, ndershmëria dhe singëriteti, dashuria prindërore për bashkëluftëtarët, brengat vetjake dhe vuajtjet shpirtërore, janë zbuluar përmes rrëfimit të tij, në formën e bisedës, të fjalimeve që mban para batalionit ose të monologut të brendshëm që ka një ngjyresë të theksuar emocionale. Si shprehës i interesave dhe i aspiratave të vegjëlisë, me besim të patundur në çështjen për të cilën lufton, Rrapo Tabani bën për vete masën e luftëtarëve, që mendon dhe ndien si ai. Për individualizimin e figurës së komandantit Rrapo, autori ka shfrytëzuar me mjeshtëri edhe mjetet e ligjëritimit popullor, të cilat kanë sjellë në vepër një kolorit të gjallë lokal dhe frymën karakteristike të humorit fshatar.

Krahas komisarit dhe komandantit në roman janë paraqitur edhe përfaqësuesit e masës së luftëtarëve, të cilët sado që vetëm janë skicuar, pasqyrojnë nga anë të ndryshme procesin e zgjimit politik të vegjëlisë. Autori ka meritën se këto figura nuk i paraqiti si një masë të padiferencuar, por i vizatoi me tiparet e tyre individuale.

Në kontrast me figurën e komandantit Rrapo dhe të luftëtarëve të batalionit partizan, autori ka vizatuar në plan satirik figurën e Salih Protopapës, që mishëron tiparet e fshatarësisë së pasur, e cila për të ruajtur interesat e saj si klasë shfrytëzuese u bashkua me pushtuesin dhe u bë vegël e tij. Bota e ulët morale, cinizmi dhe egërsia e komandantit ballist, janë zbuluar si shfaqje të thelbit të karakterit të tij shoqëror.

Romani «Komisari Memo» pasqyron me vërtetësi dhe forcë artistike atmosferën e viteve të luftës, konfliktet shoqërore-politike të kohës, emancipimin politik të masave dhe rolin e madh të ideve të Partisë në këtë proces. Këto e bëjnë atë një nga arritjet më të shënuara të prozës sonë të gjatë me temën e Luftës.

GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR

Rrënjët historike të qëndresës burrërore dhe të karakterit të papërkulur e liridashës të popullit shqiptar, vlerat aktuale të traditave heroike të luftës së fundit, idenë e gjallërisë së shqiptarëve në histori i zbulon me forcë të veçantë artistike romani «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» (1964) i Ismail Kadaresë. Në va-

riantin e parë ideja e qëndresës heroike të popullit shqiptar qëndronte si mënjane, e shtyrë nga vendi i madh që iu dha gjeneralit të ushtrisë armike. Kuptimi abstrakt i armikut si «qenie njerëzore» që në rrethana të caktuara bëhet i arsyeshëm, kishte çuar pa dashur në idenë se armiku mund të ndryshojë thelbin e tij. Kritika e kohës vuri në dukje se kthesa e gjeneralit pas disa muajve të qëndrimit në Shqipëri dhe shndërrimi i tij nga një përfaqësues i një ushtrie imperialiste agresive në një njeri që merr anën e popujve të vegjël, viktima të agresionit imperialist, dhe që nis të kuptojë luftën e tyre të drejtë për mbrojtjen e lirisë, ishin të pamotivuara si nga ana shoqërore, ashtu edhe nga ana psikologjike. Në variantin e ri, të ripunuar të romanit, që u botua në vitin 1967, autori e konceptoi ndryshe karakterin e gjeneralit dhe vuri në qendër të veprës konfliktin midis tij dhe popullit shqiptar, duke mënjeluar kështu konfliktin gjeneral-prift që në variantin e parë shërbente si konflikt themelor për të shpënë përpara veprimin.

Në themel të romanit është vënë ideja e qëndresës heroike dhe e shpirtit të panështruar të popullit shqiptar si një nga veçoritë më të qenësishme të karakterit të tij kombëtar, por, krahas kësaj, në vepër kanë gjetur pasqyrim edhe motive të tjera. Tema e demaskimit të fashizmit si dukuri regresive shoqërore dhe politike, si ideologji e luftërave pushtuese imperialiste dhe e shfarosjes së popujve, si murtajë e keqe që i solli fatkeqësi e mjerime jo vetëm popullit tonë, por edhe popullit italian, motivet e rënies morale dhe të krizës së thellë shpirtërore që jetuan masat punonjëse italiane, bashkëzërojnë me temën qendrore të romanit dhe i japin idesë një theks të veçantë polemik demaskues.

Zbulimi i idesë në romanin «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» arrihet përmes një kompozicioni që me zhvendosjen e ngjarjeve krijon përshtypjen e aksionit. Parë në këtë vështrim romani nuk ka subjekt në kuptimin e zakonshëm që i japim kësaj fjale. Udhëtimi i gjeneralit dhe i priftit për të mbledhur eshtrat e ushtarëve të tyre, shërben vetëm nga ana e jashtme për të lidhur episodet dhe ngjarjet që kanë të bëjnë me të kaluarën dhe me të sotmen, sepse në thelb ato i lidh ideja qendrore e veprës. Kujtimet e të afërmeve të ushtarëve të vrarë dhe të shokëve të tyre që kanë mbetur gjallë,

episodet që mbushin letrat dhe ditaret e tyre, historitë për ngjarjet që dëgjon gjenerali nga vendësit, përshtypjet dhe asociacionet e tij të dhëna shpesh përmes monologut të brenshëm, bisedat dhe dialogët e mprehtë, imtësitë e goditura që flasin me nëntekstin që bartin, janë gjetur në përputhje me konceptin e përgjithshëm artistik të veprës. Përmes këtyre elementeve të shkrirë në mënyrë organike, duke shfrytëzuar mundësitë që i ka dhënë zgjidhja e gjetur kompozicionale, autori ka zbuluar idenë se armiqtë duhet të nxjerrin mësim nga historia dhe të mos i harrojnë disfatat e turpshme që pësuan në këtë vend të vogël me një popull që e ka në gjak trimërinë, dëshirën e fortë për jetë të lirë. Figura e popullit, lufta dhe qëndresa e tij heroike, patriotizmi popullor, janë dhënë në vepër në plan simbolik. Simbol i traditave shekullore liridashëse të popullit tonë është akti i malësorit Nik Martini dhe i çetave të malësorëve që buisën nga të katër anët e vendit dhe, pa i organizuar njeri, u turrën drejt detit t'i dilnin zot atdheut. Jehona e patriotizmit popullor që shpërtheu në ditët e para të pushtimit në përçasje me kujtimet që ruan gjenerali nga këto ditë kur larg atdheut të vet kishte dëgjuar lajmin se «Shqipëria i priti me lule divizionet fashiste», krijon një kontrast të fortë dhe fut në vepër një notë sarkazmi të mprehtë.

Duke polemizuar hapur me pikëpamjet reaksionare të priftit dhe të të gjithë armiqtë të popullit shqiptar, të cilat pohonin se shqiptarët janë një popull primitiv dhe i egër, që ka lindur me dashurinë për armën, romani «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» ka pasqyruar drejt tiparet thelbësore të karakterit të shqiptarëve. Vepra shtjellon mendimin se kanë qenë veçoritë e zhvillimit kombëtar-historik ato që kanë selitur në karakterin e shqiptarëve tiparet e një populli luftëtar, i cili ka qenë i detyruar të mbajë vazhdimisht armën në dorë për t'u mbrojtur nga sulmet e pareshtura të hordhive të ndryshme pushtuese.

Figurën e popullit autori e ka ndriçuar edhe në një plan tjetër; ai ka zbuluar krahas karakterit të fortë, heroik të shqiptarit edhe shpirtin e tij bujar, fisnikërinë e ndjenjave dhe të mendimeve. Për këto anë të karakterit të popullit tonë hedhin dritë skenat dhe episodet të cilat pasqyrojnë aspekte të qëndrimit të shqiptarëve ndaj armiqtë të mundur që mbetën nëpër fshatrat tona.

Ideja e romanit se fitorja e popullit shqiptar ishte kurorë-zimi i një lufte të drejtë dhe heroike në të cilën ai shfaq dashurinë e madhe për liri e jetë të pavarur, është zhvilluar, nga njëra anë, përmes figurave e pamjeve që në mënyrë të përgjithësuar zbulojnë shpirtin luftarak dhe të përkulur të shqiptarit, dhe, nga ana tjetër, përmes paraqitjes së disfatës së turpshme të armikut. Përqasja e disfatës së armikut me fitoren historike të popullit e ka thelluar idenë e veprës dhe e ka forcuar tingëllimin e saj politik, aktual. Përveç episodeve dhe imtësive që dëshmojnë se fashizmi gjeti vdekjen kudo që shkeli në Shqipëri, theksin aktual të romanit e ka forcuar në mënyrë të veçantë disfata morale që pëson vetë gjenerali gjatë kohës që qëndron në Shqipëri për të mbledhur eshtrat e armatave fashiste. Dramën e gjeneralit e thellon konflikti me realitetin që ndesh ai në çdo hap në Shqipëri, konflikti me popullin tonë. Se shqiptarët do t'u tregojnë gjithnjë grushtin pushtuesve të huaj, për këtë i flet gjeneralit jo vetëm e kaluara, e cila i shfaqet në çdo varr që hap, por edhe e tashmja, të cilën nis ta njohë përmes kontakteve të drejtpërdrejta me shqiptarët, i flet qetësia, krenaria dhe mospërfillja e tyre, që ia shuajnë entuziazmin e ditëve të para, kur zbriti në tokën shqiptare. Gjenerali vjen në Shqipëri me krenarinë e përfaqësuesit të një vendi dhe të një ushtrie të madhe dhe me urrejtjen për popullin shqiptar. Por krenaria dhe solemniteti e lënë shpejt. Që në ditët e para ai provon se sa e rëndë është të ndeshesh kudo me disfatën e turpshme, dëshmitë e së cilës i mbledh nëpër mijëra thasë najloni. Si ushtarak atë e trondit fundi i hidhur dhe qesharak i armatave «të pathyeshme», të udhëhequra prej kolegëve të tij, të cilët, sipas tij, u katandisën të ruanin pulat nëpër shtëpitë e fshatarëve shqiptarë, duke bërë kështu «leckë» dinjitetin e «Italisë së madhe» dhe të ushtrisë së saj.

Ndjesitë dhe shqetësimet që formojnë jetën e brendshme të personazhit, të zbuluar kryesisht përmes monologut ose bisedës me priftin, lidhen me krizën dhe zhgënjimin që pëson gjenerali gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri, ku i takon jo vetëm të mbledhë frytet e dështimit të djeshëm të kolegëve të tij, por edhe të shohë dështimin e vet. Kriza e tij e thellë shpirtërore dhe dështimi i plotë moral është fundi logjik i konfliktit të mprehtë me popullin shqiptar. Qëndrimin e

gjeneralit ndaj popullit tonë e përcakton që në fillim ndjenja e hakmarrjes dhe e urrejtjes që i zgjojnë listat e pafund të ushtarëve të vrarë. Kjo ndjenjë e shtyn atë të shohë tek çdo shqiptar një armik, të mendojë se në çdo hap do t'i kurdisin një provokacion dhe e bën të ushqejë paragjykime për popullin tonë si për një popull të egër, i destinuar të zhduket «për shkak të etjes që ka për asgjësim ose vetasgjësim». Mbi bazën e këtyre paragjykimeve atij i faniten në mendje gjëra të paqena dhe i lëvrijnë në vetëdije mendime të zymta e të frikshme. Qëndrimi i gjeneralit ndaj kryepunëtorit të cilin e përbuz dhe e urren, sidomos pasi merr vesh se ka qenë partizan, shqetësimet e vazhdueshme që e mendojnë, frika e hakmarrjes nga ana e shqiptarit, ndjenja e frikës që i shtie pamja e rëndë dhe e ashpër e maleve tona, episodet e ndryshme që zbulojnë herë-herë në plan satirik kotësinë e dyshimeve të gjeneralit, i cili vihet në pozitë qesharake, nxjerrin më mirë në pah qëndrimin e tij ndaj popullit dhe vendit tonë.

Personazhi tjetër me rëndësi është prifti. Sado që nuk i ka dhënë vendin që zë gjenerali, përmes priftit autori ka paraqitur armikun e egër të popullit shqiptar. Suksesin e autorit në krijimtarinë e këtij personazhi e përcaktoi fakti që thelbi shoqëror që përfaqëson prifti u derdh në një karakter të gjallë, të vizatuar me ngjyra individuale-psikologjike. Mjetet* që ka përdorur shkrimtari për të zbuluar fizionominë klasore dhe morale të priftit janë zgjedhur në vartësi të veçorive individuale të karakterit të tij shoqëror dhe të brendisë ideore të veprës. Ndërsa botës së shqetësuar shpirtërore të gjeneralit i shkon aq përshtat monologu i brendshëm, i njëjti mjet artistik nuk do të ishte i përshtatshëm për të zbuluar natyrën e ftohtë dhe cinike të priftit. Mentalitetin thellësisht reaksionar, armiqësinë e vjetër ndaj shqiptarëve prifti e shfaq haptazi dhe prerazi në bisedat me gjeneralin. Anë të tjera të botës së tij shpirtërore e morale dalin përmes aluzioneve rreth tij, e përmes ndonjë imtësie që hedh dritë, sidomos për të kaluarën e zezë politike të priftit. Të prifti autori ka përgjithësuar jo vetëm tiparet e armiqve të përbetuar të popullit tonë, por edhe veçoritë karakteristike të klerit që ka shërbyer si agjent i fashizmit. Duke mbrojtur pikëpamjen reaksionare të pabarazisë natyrore të popujve dhe të drejtën e popujve të mëdhenj për të sunduar popujt e vegjël e të prapambetur, që përbën thel-

bin e politikës ekspansioniste të borgjezisë imperialiste, prifti për ligj armiqësinë midis popujve dhe luftërat e popujve me nivel të lartë zhvillimi për të nënshtruar popujt e tjerë. Nga kjo pozitë niset ai kur gjykon për popullin tonë, për historinë e tij dhe për luftën e fundit çlirimtare që iu desh të bënte për të mbrojtur lirinë dhe individualitetin e vet kombëtar. Të kaluarën e popullit shqiptar prifti e shpjegon si një histori të errët luftërash e gjakderdhjesh, të nxitura nga instinkte të egra e primitive, karakteristike, sipas tij, për popujt me nivel të ulët zhvillimi shoqëror e shpirtëror. I verbuar nga urrejtja për popullin tonë dhe i tërbuar nga disfata që pësoi fashizmi në Shqipëri, prifti nuk mund të mos ngojosë traditat e virtytet më fisnike e më të çmuara, të shqiptarëve. I nisur nga bindjet e veta reaksionare dhe idealiste, ai mohon frymën e qëndresës heroike të shqiptarëve ndaj pushtuesve të huaj; gatishmërinë e popullit shqiptar për të mbrojtur me armë atdheun e shpjegon si prirje të trashëguar për luftë e shkatërrim, si instinkt barbar që gjoja shquaka shqiptarët. Gjykimeve të tij për shqiptarët, për traditat dhe zakonet e tyre prifti mundohet t'u vërë një bazë filozofike dhe për këtë mbështetet në teoritë e ideologëve të borgjezisë reaksionare. Sipas priftit, prirja për luftë është kaq e thellë tek shqiptarët, saqë është kthyer tek ata në një nevojë të brendshme. Në bazë të kësaj logjike të priftit, agresioni fashist kundër Shqipërisë ishte një akt i drejtë dhe një rast «fatlum» për popullin shqiptar, i cili edhe, kësaj here nuk diti të përfitonte nga «e mira» që sillte me vete sundimi i një populli «të qytetëruar». Edhe faktet e realitetit të ri në Shqipëri prifti i sheh në dritën e teorive që formojnë bazën e botëkuptimit të tij politik. Për të vigjilenca dhe vendosmëria e popullit tonë për t'u bërë ballë synimeve të imperialistëve dhe revizionistëve është shfaqja e pasionit të shfrenuar të shqiptarëve për luftë. Profecisë skeptike të priftit për zhdukjen e pashmangshme të Shqipërisë i kundërvihet ideja e gjallërisë së pashuar të popullit shqiptar nëpër shekuj, që buron prej karakterit të paepur dhe prej forcës të pashtershme morale që ruan populli në gjirin e tij. Duke synuar të zgjidhë në plan të përgjithshëm problemin e fateve historike të popullit tonë, romani «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» e pohon me forcë të madhe idenë e frymës së pamposhtur të shqiptarëve, ide që del si përfundim logjik nga kundërvënja e fak-

teve të historisë së tyre të lashtë dhe të re me konceptet dhe paragjykimet e priftit. Prifti është paraqitur jo vetëm si përfaqësues tipik i një force ideologjike e politike të caktuar, por edhe nga ana individuale. Fytyra e ulët morale, falsiteti dhe hipokrizia e priftit dalin më mirë në dritë përmes imtësive që flasin për lidhjet e tij me të venë e kolonelit Z. Pas pamjes së ftohtë, si të ngrirë të priftit, fshihen pasionet dhe ndjenjat e vërteta që vlojnë në shpirtin e tij të zi.

Romani «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» përbën një dukuri të re, origjinale në historinë e zhvillimit të romanit tonë në përgjithësi. Në këtë vepër shkrimtari nuk i vuri vetes për detyrë të tregonte nëpërmjet një subjekti të organizuar epokën e luftës; ai ka dashur të zbulojë në plan simbolik-konvencional karakterin luftarak, frymën e qëndresës dhe gjallërinë e popullit tonë në histori. Kjo ka përcaktuar edhe veçoritë e formës edhe mjetet artistike që ka zgjedhur shkrimtari.

Duke përdorur si formë për zbulimin e idesë së veprës historinë e mbledhjes së eshtrave dhe duke vënë në qendër reaksionin psikologjik, mendimet, ndjenjat dhe shqetësimet e një gjenerali të huaj, autori i dha vendin kryesor mendimit dhe arsytimit të vazhdueshëm, që zotëron mbi veprimin. Kjo ka bërë që monologu i brendshëm dhe dialogu të jetë mënyra kryesore përmes së cilës del në pah ideja e romanit, kurse rrëfimi për ndodhitë dhe ngjarjet, analiza e situatave objektive dhe paraqitja e drejtpërdrejtë e gjykimeve të autorit të jenë mënjeluar thujtë fare nga romani. Për të ndriçuar anë të ndryshme të karakterit të personazheve dhe të realitetit që pasqyron, autori ka shfrytëzuar me sukses nëntekstin dhe imtësitë artistike, që plotësojnë mungesën e karakterizimit analitik të personazheve e të situatave.

Romani «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» shquhet edhe për gjuhën e stilistikën e vet. Krahasimet e papritura, personifikimet fantastike, metaforat, grotesku dhe hiperbola, të përdorura me mjeshtëri, i japin gjuhës së veprës një forcë të madhe shprehëse. Në rrugën e pasurimit artistik të romanit tonë të shprehëse. Në rrugën e pasurimit artistik të romanit tonë të ri, vepra «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» është një arritje e rëndësishme e letërsisë sonë dhe një sukses i shënuar për shkrimtarin, i cili me këtë vepër hyri në prozën tonë si një talent me origjinalitet të spikatur.

Në romanin «Kronikë në gur» (1971), tema e Luftës Nacionalçlirimtare është parë nga I. Kadareja në një aspekt tjetër. Vepra në thelb nuk është një roman për luftën, edhe pse ngjarjet që përfshihen nga pikëpamja kohore i përkasin asaj periudhe dhe janë parë në dritën e atyre proceseve e përmbysjeve që solli revolucioni popullor në jetën e shoqërisë shqiptare. Brendinë ideore të romanit e formon mohimi i botës së vjetër me gjithë amullinë dhe mentalitetin e saj të ndryshkur, i provincializmit në shfaqjet e tij më tipike. Imtësitë që krijojnë sfondin historik dhe japin atmosferën e jetës mendore e politike të kohës kur kishte nisur lëvizja çlirimtare antifashiste e masave popullore, e udhëhequr prej komunistëve, çastet dhe episodet e shkëputura nga lufta, pamja e përtëritjes që sjell revolucionin në kontrast me tërë atë botë të mykur dhe të fosilizuar, ndihmojnë të zbulohet në mënyrë më të mprehtë ideja artistike e veprës.

Romani është ndërtuar si një këmbim pamjesh e skenash nga jeta e një qyteti, në dukje të palidhura midis tyre. Nga ana e jashtme ato i lidh figura e rrëfimitarit të ngjarjeve, të cilat në përcëptimin e heroit, marrin trajta të gjithfarshme dhe shfaqen herë në forma e përpjesëtime hiperbolike, herë groteske e herë simbolike. Për ngjarjet rrëfëhet në mënyrë naive, por pas këtij naiviteti prej fëmije fshihet një ironi therëse, çka ka përcaktuar edhe disa nga veçoritë e stilit të kësaj vepre. Dukuritë tipike të një mjedisi provincial e të prapambetur, të një jete që vërtitet në një qark thashethemesh, meskiniteti, paragjykimesh, bestytnish e zakonesh prapanike, janë zmadhuar në lentën e shkrimtarit dhe kanë dalë në pah me tërë shëmtinë dhe karakterin e tyre regresiv. Këtë botë që po jepte shpirt, megjithëse përpëlitej me dëshpërim për t'i shpëtuar dënimit të historisë, shkrimtari e ka dhënë me ngjyra të gjalla, me anë imtësish që, edhe pse janë marrë nga një realitet konkret, humbasin konkretësinë e tyre të drejtpërdrejtë dhe fitojnë një kuptim simbolik.

Vetë jeta e qytetit ku shkrimtari ka vendosur ngjarjet simbolizon në një kuptim më të gjerë jetën e varfër në çdo pikëpamje të shoqërisë shqiptare që u vu në lëvizje dhe e çau guaskën brenda së cilës gjëllinte, vetëm kur komunistët zgjuan masat e përgjumura dhe të drobitura nga zgjedha shekullore

ekonomike e shpirtërore dhe i drejtuan energjitë e tyre në hullinë e luftës kundër fashizmit dhe kundër, gjithë botës së vjetër. Dinamizmi i brendshëm i veprës buron prej kësaj ndeshjeje të ashpër midis forcave të errësirës dhe filizave të reja që sapo kanë buluar në jetën e shoqërisë dhe që përfaqësojnë progresin dhe të ardhmen e saj.

I. Kadareja nuk përshkruan skena dhe pamje konkrete nga lëvizja antifashiste e masave popullore; ai jep vetëm disa çaste që transmetojnë parandjenjen e përmbysjes së madhe që po afrohej, dhe reaksionin e botës së vjetër ndaj kësaj ngjarjeje. Nga kjo pikëpamje është kuptimplotë gjesti makabër i shehut, i cili, kur pa se partizanët po hynin në qytet, nxjerr sytë me gozhdë, duke bërtitur: «nuk dua të shoh komunizmin». Në kontrast me tërbimin e forcave të errësirës, shkrimtari ka dhënë përmes imtësish shprehëse entuziazmin me të cilin i pret populli çlirimtarët. Përçqasja e diellit dhe e horizonteve të hapura me komunizmin i jep romanit një tingull optimist dhe forcon idenë e rolit të madh të revolucionit popullor që e nxori vendin nga errësira mesjetare në udhën e gjerë të socializmit, të progresit dhe të emancipimit të vërtetë.

Romani «Kronikë në gur» ka një kompozicion origjinal. Ai i ngjan një poliedri, çdo faqe e të cilit, si pjesë organike e së tërës, plotëson idenë dhe kuadrin e përgjithshëm të veprës. Forca e fjalës artistike e I. Kadaresë, figuracioni i gjallë dhe lakonizmi i shprehjes, spikat dhe në këtë vepër, si tipar i prozës së tij.

* * *

Epopeja e Luftës Nacionalçlirimtare gjeti pasqyrim jo vetëm në prozën artistike, në poezi dhe në dramë, por dhe në një varg veprash dokumentare që sjellin një material të gjerë autentik me vlerë njohëse për këtë epokë të mbushur me ngjarje heroike e me rrjedhime të thella në jetën politike e shoqërore të vendit.

Duke filluar sidomos nga mesi i viteve 60, proza dokumentare për luftën pati një ngritje të shënuar; në radhët e saj erdhën një varg autorësh, shumica pjesëmarrës të Luftës

Nacionalçlirimtare. Në tërësinë e tyre veprat dokumentare për luftën rikrijojnë mbi bazën e një lënde të gjerë faktike përpjekjet heroike të njësiteve partizane e të masave popullore për të çliruar vendin nga zgjedha nazifashiste. Njëpërmjet këtyre fakteve dhe ngjarjeve të jetuara dhe të plotësuar nga dokumentet e kohës, autorët kanë zbuluar disa aspekte themelore të luftës popullore antifashiste, si: karakterin e saj masiv, heroizmin e njerëzve të thjeshtë dhe vetëdijen e tyre të lartë politike, rolin pararojë të komunistëve. Nga pikëpamja e llojeve vendin kryesor në këtë prodhim të gjerë e zënë biografitë e dëshmorëve, kujtimet dhe ditaret për ngjarjet e luftës, në të cilat faktet e vërteta janë elementi bazë që ka përcaktuar strukturën dhe natyrën e këtyre veprave. Krahas kësaj nuk mungojnë dhe përpjekjet për të dhënë përgjithësime artistike, duke vizatuar me anë të imtësive shprehëse figurat e luftëtarëve të lirisë që mishërojnë në karakterin e tyre tipare thelbësore të masës së luftëtarëve e të komandantëve trima. Por edhe në këto raste elementi i trilluar është përdorur në atë masë që nuk ua ndryshon këtyre veprave natyrën e tyre si prozë dokumentare.

Si gërshetim i kujtimeve të autorit nga koha e luftës, i fragmenteve të një ditari, i portreteve të luftëtarëve e të njerëzve të thjeshtë, vizatuar me dy-tre viza dhe i dokumenteve të kohës është ndërtuar libri i Sh. Peçit «**Kujtime dhe dokumenta nga Lufta Nacionalçlirimtare**», (vëll. I, 1959, vëll. II, 1961). Vepra rikrijon atmosferën heroike të kohës së luftës, zbulon forcën e ideve të Partisë, patriotizmin e flaktë si një veti të çmuar të njerëzve të thjeshtë të popullit, heroizmin e luftëtarëve të njësiteve partizane, shpirtin e lartë të sakrificës, besimin e tyre të patundur në fitore dhe vendosmërinë me të cilën ata përballojnë vështirësitë e luftës.

Episodet nga luftimet e ashpra të batalioneve e të brigadave partizane, sidomos të Brigadës V, janë disa nga faqet më të bukura të këtij libri me vlera të shquara njohëse për historinë e lavdishme të këtij formacioni partizan. Portretet e dëshmorëve e të luftëtarëve të thjeshtë që autori i skicon me dashuri, duke u ndalur në ndonjë prej tipareve të tyre më të qenësishme ose në ndonjë nga momentet më karakteristike të jetës e të heroizmit të tyre, hyjnë si intermexo në rrjedhën e tregimit për ngjarjet.

Autori në përgjithësi kallzon me një gjuhë të thjeshtë e pa zbukurime, që rrjedh natyrshëm.

Mbresat e gjalla të viteve të luftës, kujtimet dhe jehona e betejave partizane formojnë brendinë e librit «Njëqind episode partizane» (1963) të R. Bedos. Përshtypjet e kujtimet e asaj kohe, autori i zgjedh e i përpunon, duke i theksuar ato imtësi që i japin dorë të zbulojnë më mirë karakterin masiv të heroizmit partizan, burimet morale të akteve të trimërisë së luftëtarëve të lirisë, forcën shpirtërore dhe vetitë e larta të karakterit të tyre burrëror. Si rrjedhim i kësaj shumë prej akteve të heroizmit të luftëtarëve të veçantë marrin një kuptim përgjithësues. Në veçori ka një galeri të tërë luftëtarësh, të dhënë në çastet më dramatike të jetës së tyre. Heroizmi i partizanëve dhe i njerëzve tanë të thjeshtë në luftimet për çlirim të Kosovës, të Malit të Zi, të Bosnjës e të Sanxhakut, është paraqitur nga R. Bedoja si mishërim i atyre traditave e virtyteve të popullit tonë trim e patriot, që shkëlqyen me një dritë të re në vitet e Luftës Nacionalçlirimtare. Kjo ide bashkon tregimin për gjestin e partizanit Goxho Aliu, të këtij luftëtari të njëzetës që ka rrokur pushkën e të birit dëshmor dhe nuk pranon ta lëshojë atë e të ndahet nga brigada, me rrëfimin për vdekjen heroike të malësorit Haxhi Vladi, që shkon drejt litarit sypatrembur, me një merak të vetëm se nuk po vdiste si i ati në sheshin e luftës. Mishërim i virtyteve tradicionale të trimërisë e burrësisë është edhe akti i malësorit vullnetar që, për të mos u koritur përpara shokëve, nuk tërhiqet po i vë gjoksin autobлиндës armike.

Në një sërë episodesh të tjera R. Bedoja ka treguar se me ç'vendosmëri e shpirt të rrallë sakrifice partizanët përballuan të ftohtët dhe urinë, se me ç'besim të thellë në fitore përshkuan ata rrugën e luftës, duke treguar shembuj heroizmi e trimërie të rrallë.

Në vargun e veprave dokumentare që u kushtohen jetës dhe aktivitetit të dëshmorëve dhe heronjve të luftës shquhet «**Qemal Stafa**» (1973) e N. Jorgaqit. Jeta dhe lufta e heroit janë dhënë në këtë vepër në sfondin e ngjarjeve të jetës së vendit në vitet 30-40 të shekullit XX, të lidhura ngushtë me lëvizjen demokratike dhe me lëvizjen punëtore e komuniste në Shqipëri. Figura e Qemalit konceptohet në kuadrin e luftës së forcave përparimtare për shembjen e botës së vjetër e për ndërtimin

e botës së re, për shpëtimin e vendit nga katastrofa kombëtare që i kanosej pas pushtimit fashist.

Për jetën dhe aktivitetin revolucionar të heroit autori rrëfen me hollësi, duke na dhënë kështu veprën më të plotë gjer më sot për këtë militant të shquar komunist.

Në libër mbizotëron rrëfimi për heroin e për ngjarjet e kohës, si dhe gjykimet dhe interpretimet e autorit; me këto janë shkruar në mënyrë organike faktet e njohura, dokumentet e kohës, kujtimet e vlerësimet e bashkëkohësve. Kjo i ka dhënë veprës një kohezion të brendshëm e një njësi që zakonisht u mungon librave të tjera të këtij lloji.

Figura e Qemalit në vepër është dhënë në procesin e formimit të tij si revolucionar. Duke e ndjekur jetën e heroit që nga fëmënia e vitet e shkollës, në pjesëmarrjen e tij aktive në lëvizjen komuniste e antifashiste gjer në çastin e fundit, autori ka treguar se si u formua karakteri i këtij militanti revolucionar, si u zhvilluan e u thelluan në ndërgjegjen e tij tiparet më të mira të luftëtarit të vendosur për idealet e çlirimit të vegjëlisë nga zgjedha shpirtërore e materiale. Me vërtetësi janë paraqitur në vepër vitet kur heroi, i pakënaqur nga realiteti, shoqëror, ishte në kërkim të idealit të jetës së tij, të cilin e gjen në luftën për fitoren e komunizmit. Autori ka treguar se tek idetë e revolucionit e të komunizmit Qemali vjen jo thjesht përmes leximeve. Atë e afrojnë me këto ideale përvoja e jetës dhe sidomos kontaktet me lëvizjen punëtore e me militantët e saj. Lidhur me këtë autori e ka zbuluar figurën e Qemalit si tipin e revolucionarit, tek i cili njohuritë teorike marksiste nuk kishin mbetur si një stoli e jashtme, por qenë kthyer në bindje të thella të brendshme. Tiparet e Qemalit si revolucionar, si komunist dhe si udhëheqës i tipit të ri spikasin sidomos në disa momente kyçe të jetës së tij e të jetës së vendit, të cilat autori i ka paraqitur me gjallëri të veçantë.

Lufta që zhvillon revolucionari i ri kundër obskurantizmit fetar e klerit reaksionar në gjimnazin e Shkodrës, qëndrimi heroik në burg dhe para gjyqit të Tiranës, puna e madhe me të rinjtë dhe intelektualët për të demaskuar fashizmin dhe ideologjinë e tij, episodet nga jeta ilegale, roli i tij në përpjekjet e forcave të shëndosha të grupeve komuniste për themelimin e Partisë, aspektet e veprimtarisë energjike të Qemalit për organizimin e rinisë komuniste dhe së fundi vdekja e tij burrërore,

janë ato faqe të jetës së heroit që autori i ka ndriçuar më mirë. Përmes tyre ai ka zbuluar tiparet e karakterit të këtij militanti komunist, qartësinë dhe guximin revolucionar, ndjenjën e vetëmohimit dhe shpirtin e lartë të sakrificës, logjikën e fortë dhe besimin e madh në të ngjarjet e ndritur të popullit, horizontin e gjerë dhe botën e pasur shpirtërore.

Vepra e N. Jorgaqit e pasuron prozën tonë dokumentare me lëndën e pasur njohëse që ngërthen, me përshkrimet e gjalla të situatave e të ngjarjeve, me dashurinë e madhe përmes së cilës autori ka dhënë figurën e heroit të popullit, Qemal Stafa.

2

E kaluara e vendit, sidomos rrojtja e rëndë, plot mjerim dhe brenga e masave punonjëse në rendin çifligaro-borgjez, në këtë periudhë, zuri vend në krijimtarinë e autorëve që lërojnë në kryesisht llojet e shkurtra të prozës.

Në tregimet me këtë tematikë, N. Priftin e intereson fati i njerëzve të thjeshtë që vuajnë nën zgjedhën shoqërore dhe politike dhe mbajnë qëndrim ndaj shkaqeve të mjerimit të tyre. Në disa krijime autorin e ka tërhequr drama e kurbetliut, që linte shëndetin e rininë në dhe të huaj për të fituar një copë bukë, gjendja e rëndë e gruas në shoqërinë me klasa dhe solidariteti që lindte midis masave të shtypura përballë shfrytëzimit dhe dhunës së egër të klasave të pasura. Ndër veprat e N. Priftit me temë nga e kaluara shquhet tregimi «Njeriu që ndiqte kuajt» (1970). Heroi i tregimit, Vlash Zaka, përfaqëson fshatarin e varfër të Myzeqesë, që vuante nën shtypjen e bej-fshatarin e varfër të Myzeqesë, që vuante nën shtypjen e bej-lerëve dhe të tregtarëve. Ai është njeriu i thjeshtë, që gjithë jetën e ka kaluar me punë; për të është i huaj parazitizmi i tregtarit, i kryetarit të komunës, i xhandarit dhe i njerëzve të tjerë që e kalojnë kohën në kafene, me muhabete të kota e me kumar.

Portreti i Vlash Zakës përshkruhet me viza të gjalla. Figurën e karakterit të tij autori e jep që në faqet e para, kur nis e tregon për të: «Ai nuk dinte të ecte si gjithë njerëzit, ai dinte vetëm të vraponte... Më thjesht se aq nuk mund të rronte nje-

riu... Pylli dhe lumi e tërhiqnin më shumë se çdo gjë tjetër¹. Subjekti i tregimit është i thjeshtë: një tregtar kërkon një kalë të mirë, që gjendet në pyll e që mund ta kapë Vlasi, sepse vetëm ai është gjuajtës i rrallë kuajsh. Në vepër tregohen përjekjet rraskapitëse gjatë një dite të heroit për të kapur kalin. Është kjo një garë e vërtetë midis kalit dhe fshatarit të cilën autori e përshkruan me ngjyra shprehëse: «Ndërsa Vlasi vraponte, dielli ecte nëpërmjet pemëve, dukej e zhdukej si një fytyrë e qeshur fëmije që është kureshtar të shikojë se si do të përfundojë kjo garë e rrallë e njeriut me kafshën. Ecte kali, qeni, njeriu dhe dielli»². Në mbrëmje, kur vete të dorëzojë kafshën, tregtari i jep si shpërblim për punën e rëndë vetëm një grusht orizi. I fyer thellë në dinjitetin e tij prej punonjësi të ndershëm, heroi refuzon shpërblimin qesharak, zgjidh kalin dhe e lë të lirë. Ky veprim që shënon zgjidhjen e tregimit është dënimi që njeriu i punës i bën shoqërisë çnjerëzore e parazitë, është në një farë mënyre protestë kundër klasave të privilegjuara që nuk e çmonin punën e njerëzve të thjeshtë. Epërësia morale e njerëzve të thjeshtë, ndjenja e lartë e dinjitetit që i shquan ata, këto janë idetë që nënvizon autori. Rrëfimi shquhet nga nota epike që gërshetohen me imtësitë psikologjike. Kontrasti që ka përdorur autori si mjet artistik për të zbuluar idenë gjen mbështetje në atë kontradiktë shoqërore morale e psikologjike, që përbën bazën e tregimit. Gjuha e pasur ndihmon që tipari thelbësor i heroit të shfaqet me shumë qartësi. Tregimi «Njeriu që ndiqte kuajt» ngërthen një përgjithësim të gjerë artistik dhe hyn në radhën e tregimeve të shquara të letërsisë së sotme.

Nga e kaluara e kanë marrë temën edhe një sërë tregimesh të Dh. Xhuvanit. Karakteristike për stilin e këtij autori janë ngjyrat e ngjeshura realiste, dramatizmi i situatave dhe i skenave, synimi për të zbuluar psikologjinë e personazheve. Tregimi «Trasta me gurë» (1971) është thurur në formë kujtimesh nga koha e kaluar. Rrëfimi në vetë të parë i ka dhënë dorë shkrimtarit të zbulojë në mënyrë shumë të gjallë vuajtjet e mëdha që hiqnin masat në rendin çifligarë-borgjez. Në fatin e bariut të mitur të fshatit dhe të familjes së tij, që hanin

1) N. Prifti, *Litar i zjarritë*, Tiranë 1970, f. 3, 4.
2) Po aty, f. 13, 14.

bukë vetëm një herë në ditë para se të binin për të fjetur, autori dha tragjedinë e dhembshur të fshatarësisë së varfër para Çlirimit, kur bejlerët e shikonin njerëzit si kafshë pune, dhe, për hiçgjë, u merrnin nëpër këmbë nderin dhe dinjitetin.

* * *

Jeta e popullit në regjimet antipopullore gjeti pasqyrim edhe në një varg romanesh. Në disa vepra të formës së madhe epike u arrit të jepej një kuadër pak a shumë i plotë dhe i gjallë i kushteve të rënda në të cilat gjëllinte vegjëlja, i dhunës dhe i shtypjes së egër shoqërore që sundonte në vend. Autorët bëjnë përpkje për të pasqyruar aspekte të reja të jetës së shoqërisë shqiptare para Çlirimit, për të treguar mentalitetin e psikologjinë e klasave dhe të shtresave të ndryshme shoqërore, marrëdhëniet midis tyre etj. Duke përshkruar gjen-djen e vështirë të masave të shfrytëzuara, zgjedhën e egër që rëndonte mbi ta, romancierët në të njëjtën kohë vunë në dukje cilësitë e mrekullueshme mendore e shpirtërore të njerëzve të thjeshtë, ndershmërinë dhe pastërtinë morale që i shquan ata, aspiratën e tyre të zjarritë për drejtësi shoqërore.

Romani «Lumi i vdekur» (1965) i J. Xoxës është e para vepër e letërsisë së sotme që jep në mënyrë të plotë gjen-djen e fshatit shqiptar në prag të revolucionit popullor, kontraktat e mprehta shoqërore, që përshkonin jetën e tij, mjerrimin e madh, në të cilin gjëllinte vegjëlja. Ngjarjet që janë pasqyruar në roman i përkasin periudhës 1938-1939, kur u shtua varfëria e popullit, kur kriza e brendshme u acarua së tepërmi dhe u afrua rreziku i pushtimit fashist. Ishte koha, kur «skamja i hidhte ata (fshatarët — shënim i redaksisë) vazhdimisht në kthetrat e çifligarëve, të fshatarëve të pasur, të tregtarëve e të fajdexhinjve... Ndarja e padrejtë e tokave, shfrytëzimi i pamëshirshëm nga çifligarët, institucionet fetare dhe përdorimi i veglave dhe i metodave primitive në bujqësi ishin shkaku i varfërisë së madhe të masave fshatare...»¹. Varfërinë

1) Historia e PPSH, Tiranë 1968, f. 12.

e masave popullore autori e pikturoi me një patos të thellë kritik. Në qendër të veprës është shtypja e egër çifligaro-borgjeze, atmosfera e zyrtë e jetës së fshatit shqiptar. J. Xoxa pasqyron në romanin e vet përfaqësuesit e klasave e të shtresave më të ndryshme të shoqërisë shqiptare të kohës, si: bujkun pa tokë, beun, tregtarin, priftin, xhandarin dhe elementët revolucionarë, të dalë nga gjiri i fshatarësisë. Duke i vënë në situata tipike, autori i përshkruan këto karaktere shoqërore me veçori individuale të spikatura. Tek ta mishërohen anë të ndryshme të jetës si varfëria, shtypja e egër shoqërore, thelbi reaksionar i pushtetit të kohës, arbitrariteti i të pasurve, zgjimi i fshatarëve të varfër dhe shfaqja tek ta e frymës së solidaritetit klasor. Pasqyrimi i këtyre anëve të jetës përbën një nga meritat e romanit. Me gjithë gamën e gjerë të aspekteve që janë përfshirë në të, romani «Lumi i vdekur» mbetet në themel një roman shoqëror, një tablo realiste e kontraktave shoqërore të kohës. Kritika e marrëdhënieve që sundonin në shoqërinë e kohës, e moralit, e ideologjisë së klasave shfrytëzuese dhe e gjithë regjimit çifligaro-borgjez është arritur në roman përmes pasqyrimit realist të jetës. Autori përshkruan me imtësi natyrën klasore dhe psikologjike të personazheve, që shfaqen si përfaqësues tipikë të klasave, të shtresave e të grupeve të ndryshme shoqërore, e njëherazi si individë të pajisur me një psikologji të caktuar, me fizionominë e tyre të veçantë shpirtërore.

Subjekti i romanit është i thjeshtë. Familja e Pilo Shpiragut, e këtij bujku myzeqar pa tokë, është detyruar të lërë fshatin Grizë. E dëbuar prej beut, e gjendur në mes të katër rrugëve ajo bie në grackën e reshperëve të Fierit, të cilëve u leverdis që një bujk t'u mbajë gjatë dimrit fermën e ngritur mbi tokën e marrë me kontratë nga beu. Mbetur pa mjete jetese, Pilo Shpiragu vendoset aty me gjithë familjen. Por, pa ardhur mirë dimri tjetër, atë e dëbojnë reshperët dhe kështu ndodhet prapë në mes të katër rrugëve, më keq se herën e parë, kur mori rrugën për të siguruar një jetesë më të sigurt se ajo nën beun. E raskapitur dhe e drobitur nga hallet e brengat që nuk i ndahen, familja e Pilos nisët sërish për udhë, por, kësaj here e varfëruar tej mase, me një gomar e gjysëm plaçka me vete. Midis këtyre dy pamjeve shtrihet një vit i tërë përpjekjesh të Pilo Shpiragut dhe i bujqve të tjerë për të mbajtur gjallë veten. Gjatë kësaj kohe Pilo Shpiragu u ndesh me Suat bej Vërdhomën

dhe me reshperët Gaq Gjanica e Lip Gjanica, të cilët e shfrytëzuan dhe e rropën deri në fund. Në këtë kohë Piloja bie në konflikt gjithashtu me fshatin Trokth, ku ndodhet ferma e ku gjen bujq të varfër e të mjerë si ai vetë. Hyn në marrëdhënie me muhaxhirë të tjerë, por nga një krahinë tjetër, me kosovarët, me të cilët e njeh udha dhe e lidh skamja. Subjekti i romanit gërshetohet me ngjarje që lidhen, zhvillohen nga marrëdhëniet e Pilo Shpiragut me mjedisin përreth. Vijat e subjektit, janë dy: vija e marrëdhënieve të fshatarëve me çifligarët dhe tregtarët, nga njëra anë, dhe vija e dashurisë së Vitës, vajzës së Pilos, me Adilin, nga ana tjetër. Megjithatë romani është i ndërtuar si një e tërë, ku planet dhe konfliktet shoqërore e psikologjike kanë unitet. Kjo ka ardhur, sepse jeta është parë në mënyrë të plotë dhe synimi kryesor i autorit është të rrokë marrëdhëniet shoqërore në tërë kompleksitetin e tyre.

Në vijën e parë të subjektit, që tregon marrëdhëniet pronesore midis fshatarëve dhe beut, J. Xoxa ka mundur të përfshijë në veprimin e romanit të gjitha klasat dhe grupet shoqërore të kohës, të cilat janë përshkruar me veçoritë e tyre thelbësore klasore. Këto veçori gjejnë shprehje në qëndrimin e tyre si ndaj problemeve të rëndësishme shoqërore ashtu edhe ndaj problemeve moral-etike. Personazhet që përfaqësojnë këto shtresa janë vizatuar me tiparet e tyre kryesore shoqërore, por autori ka theksuar një tipar themelor me të cilin është përpjekur të shprehë në mënyrë të koncentruar thelbin e karakterit të personazhit. Në faqet e romanit ky tipar zhvillohet dhe thellohet, por vetë personazhi është po ai, veçse i paraqitur në rrethana të tjera. Lidhur me krijimin e figurës së Pilo Shpiragut autori ka vepruar ndryshe. Autori e ka gdhendur Pilon në mënyrë të hollësishme. Në karakterin e tij është sintetizuar në shkallën më të lartë thelbi i karakterit të bujkut pa tokë, jeta e të cilit është një luftë e gjatë për ekzistencë. Piloja provon vështirësitë dhe brengat që ishin tipike për jetën e gjithë fshatarësisë së varfër të asaj kohe, ushqen iluzionin se në sajë të përpjekjeve të veta edhe në kushtet shoqërore ekzistuese mund të shpëtonte nga varfëria, iluzion që ishte karakteristik për shumë fshatarë të varfër pa vetëdije klasore. Duke rënë në përpjekje e konflikte të ashpra me shfrytëzuesit, ai arrin të kuptojë se sa të brishta ishin ëndrrat e tij dhe mbushet plot

zemërim e urrejtje ndaj shkaktarëve të mjerimit në të cilin ndodhet.

Piloja, sikundër ka vërejtur kritika, është edhe bujku që e nxjerr bukën me djersën e vet, edhe fshatari individual, që e ka të theksuar ndjenjën e pronës. Marrëdhëniet e tij me beun dhe tregtarin, nga njëra anë, dhe marrëdhëniet me bujqit e tjerë të fshatit, nga ana tjetër, kanë përcaktuar natyrën e ndërlikuar të vetëdijes së tij. Duke rrojtur me ndjenja e synime kaq kontradiktore, ai shfaqet një karakter i individualizuar me mjeshtëri. Ai është bujku që shfrytëzohet egërsisht prej klasave sunduese, por që njëherazi është në kontradiktë edhe me klasën e vet. Konflikti i Pilos me fshatarët buron nga individualizmi i tij si fshatar pa vetëdije klasore. Ai rri i veçuar nga bota. I ndrydhur në hallet e tij, Piloja më shumë vepron sesa flet. Jeta e tij është një zinxhir goditjesh që merr nga rendi ekzistues. Duke e paraqitur Pilon në marrëdhënie të shuman-shme, autori ka mundur të zbulojë në mënyrë të plotë ndjenjat dhe mendimet e tij. I vështruar kështu, ai është në harmoni me synimin e autorit, i cili i ka vënë si detyrë vetes të zbulojë gjendjen dhe jo reagimin e heroit ndaj mjerimit të madh në të cilin ndodhet. Por në të njëjtën kohë Pilo Shpiragu është nga të paktët heronj të veprës që arrijnë një pikë të re në zhvillimin e vet shpirtëror. Ai është «i lodhur» dhe dihet se pas një lodhjeje të tillë vjen kriza. Piloja nis të kuptojë zhgënjimin e tij të hidhur: nis të kuptojë se tyxhari nuk doli më i mirë se beu, se armiku i tij është jo vetëm Suat bej Vërdhoma, por të gjithë shfrytëzuesit e veglat e tyre; bejlerët dhe tregtarët, priftërinjtë dhe kryepleqtë. Në të njëjtën kohë ai arrin të kuptojë gjithashtu se për të armik është edhe individualizmi i tij, që e shtyn të qëndrojë larg bujqve të tjerë, që shtypen e shfrytëzohen sikurse ai. Piloja nis t'i kuptojë të gjitha këto, por kjo ngjet kur ai ndodhet përsëri në mes të katër rrugëve. Të tëra këto shënojnë një kthesë në jetën e tij. Ai do të fillojë një etapë të re, gjatë së cilës do të kuptojë interesat e tij klasore, por kjo nuk hyn në kornizën e romanit, kjo i përket perspektivës historike.

Nëse Pilo Shpiragu si karakter është i konceptuar në mënyrë të gjerë, në fatin e të cilit si në një fokus përqendrohen konfliktet themelore të fshatit shqiptar të paraçlirimit, Koz Dynjaja është një portret monumental, që simbolizon përpje-

kjet e pareshtura të fshatarësisë së varfër shqiptare për tokë e liri. Duke njohur mirë fizionominë e vërtetë të beut e të tregtarit, të kishës e të të pasurve të fshatit, i ndriçuar nga përvoja e tij e vitit 1924 kur kishte ndarë pronat e bejlerëve, për të cilin veprim ishte edhe dënuar, ai nuk pushon së përhapuri të vërtetën rreth skamjes së fshatarësisë dhe rreth rrugëve të shpëtimit të saj. Koz Dynjaja mishëron urtësinë popullore, ai lufton me kthjelltësinë e kryengritësit që e ka të qartë kundër kujt ngre krye; këtë luftë ai e bën me mënyrën që i sugjeron përvoja e njeriut të rrahut nga jeta, që është ndeshur me armiqtë e klasës. Urtësia e Kozit, forca e arsyes së tij, që shquhet në atë mungesë të vetëdijes klasore të përgjithshme, mënyra popullore e të folurit dhe forca e madhe e fjalës janë në pajtim me qëndrimin e tij të vendosur dhe besimin e patundur në ndryshimin e gjendjes. I sigurt se zhvillimi i jetës do të ecë në favor të masave, Koz Dynjaja ironizon të gjithë armiqtë e veçjelisë, sidomos beun dhe kishën. Kozi njih jo vetëm të kaluarën dhe të tanishmen, por ka të qartë edhe perspektivën. Ai është i ndërgjegjshëm se luftën pas tij do ta vazhdojnë brezat e rinj, prandaj ushqen tek bijtë e tij e tek të rinjtë e fshatit frymën e protestës dhe të solidaritetit klasor. Ai është një farë udhëheqësi shpirtëror i fshatit. Si karakter Koz Dynjaja ka natyrën komplekse të Pilo Shpiragut, por në një drejtim tjetër. Edhe ai hyn në marrëdhënie të shumëfishta me mjedisin, por kompleksiteti i tij nuk është i bujkut që punon vetëm në emër të ekzistencës vetjake, por i kryengritësit. Edhe biografia, edhe fundi i tij në roman, kur arrestohet nga karabinierët, flet për gjerësinë e tij si karakter. Me Koz Dynjanë J. Xoxa e pasuroi letërsinë shqiptare me figurën monumentale e njëkohësisht jetësore të fshatarit kryengritës.

Suat bej Vërdhomën si personazh e karakterizon ndërgjegjja e forcës që i jep pasuria. Ato që e udhëheqin në jetë nuk janë motivet morale dhe etike, por politike. Suat bej Vërdhoma është bej finok, ai nuhat se rreziku kryesor për të dhe klasën e tij është bashkimi i fshatarëve, prandaj bën ç'është e mundur që të shtypte çdo shfaqje solidariteti midis tyre. Si personazh ai është individualizuar bukur, përmes veprimeve të tij kur shfaqet në fshat në çastet kulminante, si dhe përmes gjuhës që flet. Suat bej Vërdhoma është pronari që njih në majë të gishtërinjve gjendjen reale të punëve të veta, di men-

dimet dhe dëshirat e bujqve, gjendjen shpirtërore të njerëzve në fshat.

Pilo Shpiragu e Koz Dynjaja, Suat bej Vërdhoma e tregtarët Gjanica përbëjnë hallkat kryesore të marrëdhënieve shoqërore e të lidhjeve njerëzore të pasqyruara në roman. Por përveç këtyre, në roman ka një sërë personazhesh të tjerë, të cilët ndryshojnë prej njëri-tjetrit nga qëndrimet e ndryshme që mbajnë ndaj çështjeve kryesore të jetës së fshatit, siç është: konflikti brendapërbrenda vëllezërve Shpiragu, konflikti midis Shpiragajve e Tafilajve, konflikti në familjen Tafilaj, midis këtyre të fundit e fshatit, midis fshatit dhe priftit e kryeplakut, për të mos zënë në gojë konfliktin kryesor, konfliktin me beun, qehallarët, tregtarët, qeverinë. Në qëndrimin ndaj këtyre konflikteve zbulohen veçoritë karakteristike të psikologjisë së fshatarëve, në të cilën është shprehur jo vetëm pozita e tyre klasore, por edhe jeta e përvoja individuale.

Një vend me rëndësi në subjektin e veprës zënë skenat masive, në të cilat zbulohen disa tipare të karakterit popullor, dalin në pah si qëndrimi afetar i popullit ashtu edhe paragjykimet e tij patriarkale, shpirti i revoltës kundër shtypësve dhe dashuria e ngrohtë që lidh njerëzit e varfër, si humori ashtu edhe optimizmi i tyre në jetë.

Përveç problemit të gjendjes së rëndë të masave punonjëse në regjimet antipopullore të së kaluarës, vepra rreh edhe një problem tjetër të lidhur ngushtë me të parin, atë të aspiratës së njerëzve për lumturi. Patosi i luftës për jetë të lumtur e të lirë shprehet në fatin e Vitës, në rrugën e saj në jetë. Marrëdhëniet midis Adilit dhe Vitës paraqesin interes të veçantë nga pikëpamja e idesë themelore të romanit. Si Vita ashtu edhe Adili, me ndjenjat dhe veprimet e tyre, shprehin protestën kundër shoqërisë së kohës. Dashuria e tyre mohon normat prapanike, paragjykimet fetare e krahinore, gjithë moralin e vjetër që ndrydhte jetën shpirtërore të individit. Duke i detyruar heronjtë të arratisen, autori pohon idenë se e drejta e njeriut për të dashuruar është e porealizueshme në kushtet e sundimit të moralit të vjetër. Ideja e dashurisë së vërtetë dhe të madhe, që u jep krahë njerëzve të kapërcejnë vështirësitë dhe pengesat që hasin, ideja fisnike se njerëzit duhet ta ngrenë jetën e tyre ashtu siç ua do zemra, është ideja kryesore që rrjedh nga zhvillimi i kësaj vije të subjektit. Është pikërisht bindja se ka të drejtë ta

ndërtojë jetën vetjake ashtu siç ia dikton zemra, është forca e karakterit, thellësia e ndjenjave dhe këmbëngulja në arritjen e qëllimit që e bëjnë Vitën një figurë interesante dhe tërheqëse. Përpunimi i thellë psikologjik i këtij personazhi, zbulimi i ndjenjave dhe i gëzimeve njerëzore përmes krahasimeve të goditura të marra nga natyra myzeqare, e kanë bërë këtë personazh të gjallë dhe të besueshëm.

Ideja e veprës është shprehur përmes një kompozicioni të goditur e mjetesh të pasura të shprehjes artistike. Autori nuk e ndërlikon veprimin e romanit, që rrjedh në mënyrë të shtruar e të qetë, me çaste të rralla dramatizmi. Në pjesën e parë përshkruhet gjendja e fshatit shqiptar, mekanizmi i marrëdhënieve midis fshatarëve dhe pronarëve, ekspozohen të gjitha personazhet dhe problematika e romanit. Në pjesën e dytë të veprës i kushtohet vëmendje përshkrimit të fatkeqësive natyrore dhe përçarjes së fshatarëve, kurse në të tretën tregohen shkëndijat e para të revoltës kolektive, përpjekjet e beut që të shuajë çdo orvatje për bashkimin dhe premisat e një gjendjeje, e cila do të karakterizohet nga rrethana të reja politike e shoqërore që po lindnin. J. Xoxa e shfaq veten vrojtues të hollë të natyrës, të mjediseve, të tipareve, të dokeve dhe të zakoneve, prandaj dhe mjeti kryesor që përdor është përshkrimi i hollësishëm, përmes të cilit sikur kërkon të nxjerrë nga sendet dhe marrëdhëniet midis njerëzve, domethënien që qëndron e fshehur nën sipërfaqe. Pikturimin e kujdesshëm të njerëzve dhe të natyrës autori e thyen vetëm me ndërhyrje që kanë karakterin e përsiatjeve, të cilat ndonjëherë nuk janë përdorur me vend. Edhe në përshkrimet autori nuk e ruan gjithmonë sensin e masës. Nga fundi i romanit ecuria e sigurt e subjektit, karakteristike për veprën, sikur dobësohet, në subjekt nisin të duken elemente të rastësisë.

Karakteristikë për «Lumin e vdekur» është larmia e mjeteve të gjuhës. Shkrimtari e punon me kujdes frazën dhe kjo përbën një nga meritat e veprës. Ashtu sikundër gjen ngjyra për të dhënë vërtetësinë e një pamjeje jetësore, ashtu kërkon edhe mjetet e shprehjes gjuhësore, që japin mundësi për një paraqitje të gjallë të jetës. Së këtejmi del edhe ajo frazeologji e pasur, që e bën veprën një kontribut në pasurimin e gjuhës së letërsisë artistike.

Stili është në harmoni me synimin e autorit për të dhënë

një pamje sa më të plotë e të gjithanshme të jetës së përditshme të fshatit myzeqar, ku çdo gjë duket se është ngurtësuar dhe nuk po pëson asnjë ndryshim. Në romanin e J. Xoxes fryma epike gërshetohet me lirizmin, i cili është i pranishëm edhe në paraqitjen e marrëdhënieve shoqërore, por më gjerë ai derdhet në përshkrimet e bukurisë së natyrës e të botës së ndjenjave e të mendimeve njerëzore. Autori kërkon krahasime e figura simbolike, me anë të të cilave synon të shprehë hapur idenë e veprës, por ndodh që përdorimi i tyre kthehet në qëllim më vete, gjë që cenon ndonjëherë karakterin e natyrshëm të përshkrimit.

Novatorizmi i «Lumit të vdekur» qëndron në gjerësinë e paraqitjes së jetës së fshatarësisë, në pasqyrimin e thellë të karaktereve njerëzore, në zbulimin e psikologjisë së tipave të ndryshëm shoqërorë, në ngjyrat e gjalla që e bëjnë përshkrimin plastik, në gjuhën e pasur në fjalë dhe shprehje. Sikundër ka vërejtur kritika, në romanin e J. Xoxes gjetën zgjidhje problemet e romanit shqiptar-paraqitja në mënyrë sa më të gjerë e realitetit, thellimi i realizmit, karakteri shumëplanësh dhe fryma epike. Të gjitha këto e bëjnë romanin «Lumi i vdekur» dukuri të shënuar të letërsisë sonë të realizmit socialist.

Romani «**Të munduarit**» (1961) i H. Petrelës pasqyron ngjarje të një të kaluarë të largët. Vëmendjen e autorit e tërhoqi jeta e fshatit shqiptar në periudhën e fundit të sundimit otoman. Ngjarjet e subjektit zhvillohen në vitet 1906-1911. Në qendër të veprës është pasqyrimi i gjendjes së fshatarësisë së varfër të Shqipërisë së Mesme, i jetës dhe i dertëve të saj. Autori rreh të vizatojë një pamje të gjerë të procesit të rrënimt të vegjëlisë fshatare në dhjetëvjeçarin e parë të këtij shekulli, të përshkrues marrëdhëniet shoqërore dhe format e shfrytëzimit të egër të agallarëve. Romani është më tepër një kronikë e jetës së disa familjeve fshatare gjatë një periudhe prej pesë vjetësh.

Në qendër të romanit është Rrem Heshja, i cili punon si shërbëtor tek pasaniku i fshatit, sheh Brahimi, e më pas shkon në ushtrinë turke, bedel për të birin e agait. Rrema rropatet gjithë ditën e ditës në punë për të ndihmuar familjen. E cila bën përpjekje të dëshpëruara për të mos lënë t'i ikë nga duart ai çikë mall i vënë me sakrifica e mundime të parrëfyera. Autori

është përpjekur ta japë këtë figurë në zhvillim. Në faqet e para të romanit Rrem Heshja shfaqet si njeri me paragjykimet dhe iluzione patriarkale. Ai kujton se sheh Brahimi, duke e marrë si shërbëtor, i do të mirën atij dhe familjes së tij. Por shërbimi në ushtrinë turke, ku njihet me egërsinë e oficerëve turq, që shtypin me zjarr dhe hekur aspiratat çlirimtare të popujve të Ballkanit dhe sidomos njohja me një shqiptar nga krahina e Vlorës, e ndihmuan atë jo vetëm të kuptojë se çfarë përfaqësonte sundimi i huaj, por edhe kush është sheh Brahimi. Në skenën e fundit të romanit ai vret aganë, që i ka rrënuar jetën dhe me këtë, si të thuash, shfren edhe urrejtjen për të zitë që kishte hequr gjithë familja dhe fshati i tij.

Megjithëse në qendër të romanit autori vuri Rrem Heshjen, të gjithë vijat e subjektit përqendrohen te Sheh Brahimi, i cili zë vend shumë të madh në vepër. Sheh Brahimi është tipi i agait të fshatit. Dinak, mizor dhe lakmitar i pangopur, ai përdor të gjitha mjetet, pushtetin që i jep pasuria që ka, mashtrimet, intrigat etj., për të rrënuar pa mëshirë fshatarët e varfër, të cilëve për një qese misër, u merr tokën apo ullishtën ose i detyron të lënë kockat, duke punuar si argatë në tokat e tij. Sheh Brahimi është vizatuar me ngjyra individuale: ai sintetizon moralin e psikologjinë anadollake të shtresës së fshatarëve të pasur të krahinave të Shqipërisë së Mesme. Ky aga mizor s'ka fare skrupuj në mjetet që përdor për t'u pasuruar; ai është i egër, i pabesë dhe gjithë veprimet e tij i fsheh pas frazave hipokrite se është i gatshëm për t'iu gjendur çdo njeriu që është në hall.

Krahas pasqyrimin të gjendjes së shtypur të fshatarësisë, në roman i kushtohet vëmendje edhe lëvizjes patriotike, por të dy këto probleme nuk kanë gjetur në roman një shkrirje të natyrshme. Problemi i shtypjes kombëtare ka mbetur si diçka anësore në roman. Kjo ka bërë që edhe karakterizimi i personazheve të mos jetë i plotë. Sheh Brahimi, një nga personazhet kryesore, është realizuar kryesisht në aspektin e marrëdhënieve me vegjëlinë, kurse shërbimet që i bën pushtetit të huaj, me të cilin është i lidhur politikisht dhe ideologjikisht, nuk tregohen në roman.

Karakteristike për romanin është rrëfimi i shtruar, që ndonjëherë të lë përshtypjen e një paraqitjeje faktografike të jetës. Kompozicioni është deri diku i shkapërderdhur, gjë që ka

ardhur nga kapërcimet e shpejta e të pamotivuara. Gjuha e personazheve ndihmon për të krijuar atmosferën e një jete të mbyllur provinciale dhe për të pasqyruar mënyrën e të menduarit të fshatarit të kohës.

Rëndësia e romanit të H. Petrelës qëndron në materialin jetësor që sjell nga jeta e fshatarit për një periudhë historike pak të trajtuar deri më sot, në skalitjen e disa tipave, sidomos sheh Brahimit, i cilin hyn në radhën e figurave të goditura të prozës sonë.

* * *

Vëmendjen e një vargu autorësh e tërhoqën ngjarjet e historisë kombëtare, sidomos lufta heroike e popullit shqiptar, me Gjergj Kastriotin, Skënderbeun, në krye kundër pushtuesve otomanë për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së vendit. Epokës së Skënderbeut, përpjekjeve të Heroit Kombëtar për të siguruar bashkimin e të gjithë princave shqiptarë kundër rrezikut që i kanosej vendit, heroizmit të masave popullore, që përbënin shtyllën e qëndresës përballë dyndjeve të pareshtura të sulltanëve, u janë kushtuar romanet «Kështjella» i I. Kadaresë, «Në muret e Krujës» i Gj. Zhejit etj. Duke iu drejtuar fakteve të historisë së shek. XV, autorët e këtyre veprave e ndalën vështrimin në aspektet që kanë rëndësi aktuale. Në lëndën që jepte epoka e lavdishme e Skënderbeut, prozatorët synuan të vinin në pah gjallërinë e popullit shqiptar ndër shekuj, shpirtin e pamposhtur dhe dashurinë e tij të zjarrtë për jetë të lirë dhe të pavarur. Në këtë mënyrë ata i bënë jehonë gatishmërisë së masave për të shkatërruar planet e armiqve dhe forcuan shpirtin e tyre të paepur përballë vështirësive të shkaktuara nga bllokada.

KËSHTJELLA

Kjo lidhje e së kaluarës me kërkesat ideologjike të aktualitetit është realizuar me mjeshtëri artistike në romanin «Kështjella» të I. Kadaresë, që u botua në vitin 1970. Patosi i veprës është qëndresa e guximshme e shqiptarëve dhe fitorja kundër bllokadës që i imponuan armiqtë. Duke evokuar luf-

tën heroike çerekshekullore kundër forcës ushtarake më të madhe e më të tmerrshme të kohës, romani bën analogji midis ngjarjeve të rëndësishme të shekullit XV dhe të epokës së sotme kur populli shqiptar po i bën ballë me trimëri bllokadës imperialisto-revizioniste. Me lartësimin e guximit dhe të trimërisë legjendare të shqiptarëve është lidhur ngushtë tema e dënimit të agresorit, e luftës së padrejtë që ai ndërmoi kundër Shqipërisë, e dënimit të motiveve ideologjike e morale që e frymëzonin atë në veprimet çnjerëzore. Me këtë ide romani u bën jehonë problemeve të kohës së sotme kur në shumë zona të botës popujt luftojnë kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit dhe neokolonializmit.

Subjekti i romanit me pak fjalë është ky: një kështjellë shqiptare e shekullit XV nuk pranon t'u dorëzohet turqve, të cilët, kur shohin se nuk u ecën as me lajka, as me premtime, as me ndërmjetësimet e «miqve», organizojnë rrethimin. Kampi ushtarak turk bën përgatitje për të pushtuar kështjellën e rrethuar, të cilën e kërcënon uria. Mblidhet këshilli i luftës dhe merret vendimi për sulm. Në fillim bëhen qitje me top, pastaj nis mësymja, e cila dështon. Përsëri bëhet mbledhja e këshillit të luftës, i cili vendos që repartet e akënxinjve të fillojnë nga operacionet ndëshkimore. Në të njëjtën kohë forcat e xhenios hapin llagëme për të marrë kalanë nga brenda. Por edhe ky plan, në sajë të vigjilencës së kështjellës, dështon. Bëhen përpjekje për t'i prerë ujin kështjellës, por njerëzit qëndrojnë të palëkundur, duke përdorur me kursim ujin e pu-seve. Edhe armët e reja që venë në përdorim nuk u sjellin dobi turqve. Më në fund ndërmerret sulmi vendimtar, pas dështimit të të cilit kryekomandanti turk vret veten dhe trupat otomane largohen me turp. Të gjitha këto ngjarje jepen në formë të dendësuar. Ato ngjasin brenda një periudhe të shkurtër, gjatë një stine, siç theksohet disa herë në roman. Autori nuk i ka vënë vetes detyrë të paraqesë me hollësi epokën historike ose të krijojë një pamje të shumanshme të jetës shqiptare të asaj kohe; romani jep vetëm karakteristikat kryesore të epokës. Ai që organizon subjektin është konflikti politik, tipik për historinë e Shqipërisë, e cila ka çarë rrugën e historisë me shpatë në dorë. Përmes këtij konflikti autori arrin të pasqyrojë në dyqind e ca faqe të romanit thelbin e një epoke, kur feudalizmi ushtarak turk që ishte turrur me një vrull të pa-

përmbajtur drejt Perëndimit, u ndal në muret e Krujës e nuk bëri çap tutje.

Kampi i turqve përshkruhet në një mënyrë të tillë që zbulon si tiparet e veçanta të një agresioni osman të shekullit XV, ashtu edhe atë element të përbashkët në qëllimet dhe format që karakterizon agresionet e të gjitha kohëve. Romani ka arritur të krijojë me realizëm atmosferën e një pushtimi ushtarak turk të shekullit XV. Kampi ushtarak turk është paraqitur si qenie e gjallë që i kundërvihet kështjellës. Në roman përshkruhen mënyrat e ndryshme të presionit kundër kështjellarëve. Duke karakterizuar planet e armiqve, autori ka zbuluar thelbin agresiv, brutal, të egër, të otomanëve. Forca dhe organizimi ushtarak i tyre pasqyrohet lidhur ngushtë me motivet ideologjike e filozofike nga të cilat ata udhëhiqen, me moralin, etikën, zakonet e tyre, po ashtu edhe me kontradiktat që i brejnë. Në veprë veç betejave, sulmeve, sprapsjeve, jepet edhe gjendja shpirtërore e armiqve. Por këto përshkruhen në mënyra të ndryshme; aspektin e parë autori e realizon me përshkrimin e drejtpërdrejtë të përgatitjeve të sulmeve, të akteve diversioniste e të veprimeve të kryekomandantit, Tursun Pashës, ndërsa të dytin, gjendjen shpirtërore, e pasqyron përmes komenteve të personazheve rreth asaj që ndodh, përmes paraqitjes së drejtpërdrejtë të gjendjes shpirtërore të disave prej udhëheqësve të ushtrisë turke, sidomos të kronikanit Mevlan Çelebi dhe të kryeveqilharxhit.

Kampi ushtarak paraqitet si fuqi e organizuar shumë mirë. Nga mënyra e sulmeve, dhe nga armët që përdor, armiku shfaqet si forcë luftarake e pathyeshme. Numri i njerëzve, larmia e trupave të stërvitura, përpunimi i tyre psikologjik, armët e reja shkatërruese dhe në përgjithësi teknika ushtarake, i japin pamjen e një force vigane, së cilës nuk mund t'i bëjë ballë asnjë ushtri. Por me përshkrimin objektiv të përgatitjes për sulm dhe të vetë sulmit, romani e ul dhe e denigron këtë forcë. Në këto skena autori zbulon qëllimet dhe moralin e ulët të kësaj lufte, motivet e fitimit, të lavdisë e të karrierës që frymëzojnë njerëzit në kampin armik, karakterin e saj çnjerëzor dhe regresiv në të gjitha drejtimet — politike, ideologjike, moral-etike. Nga një forcë në dukje monolite, kampi nis e shthuret. Në këto faqe del përherë e më në pah se kampi i armikut përbëhej prej forcash të cilat brenda ba-

shkësisë së interesave politike, kanë edhe synime të veçanta, që rrjedhin nga karakteri i hierarkisë feudale, i dallimeve shoqërore, i nivelit material e kulturor, i mentalitetit dhe i psikologjisë së njerëzve. Këto kontradikta i gjejmë kudo. Kështilli i luftës ndahet në dy grupe kundërshtare, në radhët e ushtarëve nxjerrin krye aty-këtu shfaqje pakënaqësie si zhgënjimi i një pjese të ushtarëve etj. Kryekomandanti Tursun Pasha qëndron mbi të gjithë dhe përdor autoritetin e tij për të mbajtur ekuilibrin midis këtyre forcave. Personazhet kryesorë paraqiten si përfaqësues tipikë të grupeve të ndryshme, të botëkuptimeve e të pikëpamjeve të ndryshme brenda një kampi. Kryeveqilharxhi e kryemekaniku vënë në shërbim të idesë së tyre çnjerëzore ekonominë dhe shkencën; prapa robit prej intelektualit ata fshehin natyrën e egër prej pushtuesi, gjë që komandantët e trupave e shfaqin fare hapur, me një cinizëm të përbindshëm.

Fizionomia e personazheve përcaktohet kryesisht nga ideja që mishërojnë, gjë që i bën racionalë. Në të njëjtën kohë ata janë konceptuar edhe si individë, me psikologjinë e sjelljen e tyre karakteristike. Kjo zbulohet përmes përshkrimit të veprimeve, fjalës dhe mënyrës se si ato e mbajnë veten në çaste të rëndësishme të jetës në kamp, nga mënyra se si e shikon secili luftën dhe rezultatin e saj. Autori zbulon interesat materiale që mbron secili grup brendapërbrenda ushtrisë armike. Për Tursun Pashën marrja e kështjellës do të thotë lartësimi i tij në hierarkinë ushtarake. Të tjerët, kryeveqilharxhi, kryemekaniku, myftiu, astrologu etj., synojnë të tregojnë epërsinë e fushës së tyre të veprimit. Veçoritë e karaktereve të tyre i ka përcaktuar qëndrimi ndaj një sërë çështjesh, si çështjes së raportit midis njeriut dhe armës, midis politikës dhe ekonomisë etj. Këtyre çështjeve romani u jep përgjigje duke treguar vlerësinë e tyre nga karakteri i marrëdhënieve që sundojnë në shoqërinë me klasa, nga ligjet objektive të zhvillimit shoqëror e historik. Kjo problematikë e gjerë është një tjetër shfaqje e analogjisë historike të veprës.

I. Kadareja ia heq kampit të turqve aureolën e një force kompakte e të pamposhtur dhe këtë e arrin duke e përqëndruar vështrimin e vet te figura e kryekomandantit, Tursun Pashës, i cili përpiqet të fitojë me çdo kusht. Veçoritë e tij individuale e shoqërore historike janë tipike dhe të gjetura me

mprehtësi nga autori. Figura e Tursun Pashës hedh dritë mbi gjithë shoqërinë, pjellë e së cilës është. Egërsia e pakufishme, egoizmi, cinizmi, dëshira e zjarrtë për të qenë i gjithëpushtetshëm, vënë në pah tek ai tiparet e një feudali ushtarak, që ka mundur të ngrihet me sukses në shkallët e hierarkisë feudale osmane. Iluzionit se do të fusë në dorë shpejt e pa vështirësi kështjellën, iluzion që ai ushqente në fillim kur shkeli në Shqipëri, dalngadalë ia zë vendin realiteti i ashpër: disfata e ushtrisë së tij. Kjo në roman realizohet nëpërmjet një toni të mprehtë ironik, që arrihet jo vetëm me anë të vlerësimeve të drejtpërdrejta dhe të imtësive të goditura, por edhe me anë të motivit të rrugës që bën zakonisht Tursun Pasha në çastet kur betejetat për të marrë kështjellën janë në kulmin e tyre. Kjo rrugë nga tenda e shtabit tek vrojtimi i betejave, rrugë nëpër të cilën pashai është i detyruar të kthehet çdo herë me turp e i mundur, fut një nëntekst të thellë ironik. Duke e përsëritur disa herë këtë motiv, autori ia ka hequr Tursun Pashës aureolën e një «heroi». Vetëvraska e tij është kulmi i ironisë, e cila lind jo vetëm nga vështrimi prej lartësisë së kohës sonë, por edhe nga kontrasti midis sigurisë që shquante turqit në arritjen e qëllimeve nga njëra anë, dhe dështimit të tyre të plotë, nga ana tjetër.

Autori në veprë i jep rëndësi krijimit të atmosferës së kohës dhe e arrin atë me mjete artistike të goditura. Në pjesën e parë të romanit «Kështjella» është paraqitur atmosfera e ethshme e luftës, e përpunimit ideologjik, e dredhive politike, e pompozitetit, një atmosferë që flet vetëm për fitore. Gjendja që pasqyrohet më vonë është në kundërshtim me këtë atmosferë sigurie, në të gjejmë një atmosferë tjetër, «mërzinë e luftës».

Në figurën e kështjellës në mënyrë monumentale, me një stil epik, është shprehur ideja e karakterit të paepur dhe e unitetit të shqiptarëve, e vigjilencës, e gatishmërisë për çdo sakrificë në emër të lirisë dhe të pavarësisë, e optimizmit dhe e besimit të tyre të patundur në fitore. Fjala e kështjellarit në hyrje të çdo kapitulli të romanit është zëri i historisë, që lidh të kaluarën me aktualitetin dhe me të ardhmen. Në fjalët e kështjellarit shprehet fizionomia shpirtërore e kështjellës, që nuk zihet kurrë në befasi, nuk gënjehet nga lajkat, por qëndron vigjilente para veprimeve të armiqve dhe merr

masa kundër çdo diversioni ushtarak e ideologjik. Kështjella nuk pranon të dorëzohet. Ajo merr parasysht çdo sakrificë, është e ndërgjegjshme për misionin dhe vlerën historike të qëndresës së saj dhe del fitimtare. Kështjellari vetëm rrëfen për kështjellën, por rrëfimi është si një dritare që lejon të përfytyrohet gjendja morale e shpirtërore e popullit dhe lidhjet e tij me forcat popullore jashtë kështjellës, të komanduara nga Skënderbeu.

Nuk është vështirë të kuptohet se pikërisht me qëndresën e kështjellës përballë furisë së mësymjeve të egra të turqve, romani bën aluzion të hapur për kohën tonë. Vepra bën analogji të drejtpërdrejtë me qëndresën e popullit shqiptar përballë bllokadës imperialisto-revizioniste, me unitetin, kompaktësinë, heroizmin dhe forcën morale, që e karakterizon atë në ditët tona. Analogjia historike duket jo vetëm në plan të përgjithshëm; ajo shfaqet herë pas here edhe në indin e veprës, e cila mbetet një roman historik.

Gjuha e romanit është e saktë dhe shprehëse. Nëpërmjet saj autori jep atmosferën e kohës, pa e stilizuar atë në frymën e epokës që ka pasqyruar; ajo s'përmban imtësi etnografike, siç ngjet zakonisht në romanet historike. Fraza është plot metafora e krahasime të gjalla e në të njëjtën kohë koncize. Stili është ndërtuar mbi asociacione, në të njëjtën kohë autori e përshkruan realitetin historik duke përdorur edhe imtësitë konkrete. Ky stil ka gjetur shprehjen e vet sidomos në skenat ku paraqiten lëvizjet e ushtrisë, sulmet kundër kështjellës, të cilat janë ndër faqet më të bukura të veprës. Kompozicioni është i thjeshtë e i qartë, ai nxjerr në pah konfliktin dhe idenë themelore.

«Ali Pashë Tepelena» (1970) e S. Godos hyn në vargun e atyre veprave letrare ku gjejmë të gërshetuar të dhënat e dokumenteve historike e të gojëdhënave popullore me vlerësimet e sakta shkencore dhe me imtësitë artistike, karakteristike këto për letërsinë. «Ali Pashë Tepelena» është një kontribut i ri në letërsinë tonë dokumentare. Autori përmes historisë së heroit kryesor tregon se populli shqiptar e ka çarë rrugën së historisë me shpatë në dorë. Kur ka qenë puna për lirinë e pavarësinë, ai nuk i është trembur armikut, sado i fuqishëm dhe i egër që ka ndodhur ky.

Duke treguar jetën dhe veprat e Ali Pashë Tepelenës,

njerit prej personaliteteve feudale më të rëndësishme të Shqipërisë së shekujve XVIII-XIX, autori hedh dritë në gjithë epokën e tij. Aliu është parë si pjellë e anarkisë feudale të periudhës së rënies së Perandorisë Osmane. Dëshirën e heroit për pavarësi dhe për të përqëndruar në duart e veta pushtetin, duke u shkëputur nga Porta e Lartë e duke u zgjeruar në kurriz të feudalëve të tjerë, shkrimtari e shpjegon me rrethanat historike. Për autorin forcimi i pozitave të Ali Pashë Tepelenës ishte forcimi i klasës së çifligarëve, interesat e të cilëve mbronte shteti i pashait të Janinës.

Meritë e S. Godos është se, duke përfshirë në veprën e tij një informacion të bollshëm, të mbështetur në dokumente dhe duke vlerësuar në dritën e metodës materialiste-dialektike ngjarjet dhe personat historikë, ka dhënë me vërtetësi, krahas figurës komplekse të Aliut, edhe kuadrin e epokës, të gjendjes politike e shoqërore, të qëndresës dhe të luftës, të zakonave dhe të traditave. Përveç strukturës shoqërore-ekonomike të shekullit XVIII-XIX, në roman vizatohet edhe atmosfera politike e Ballkanit dhe e gjithë Evropës me konfliktet midis Fuqive të Mëdha, që e përshkonin.

Ideja se shqiptari është shtrënguar nga rrethanat historike të papërshtatshme që të mos heqë armën nga dora dhe ideja se shtylla e luftës për krijimin e shtetit shqiptar të pavarur mund të ishin jo Fuqitë e Mëdha, por populli vetë, masat e gjera fshatare, të cilat, siç thotë vepra, mbajnë mbi kurrizin e tyre tërë botën, kjo del në vepër nëpërmjet rrëfimit objektiv të jetës së Ali Pashës dhe të bëmave të tij. «Kur erdhi dita që të kërkonte mbështetjen e tyre, e pa mirë se në ç'themele kishte ngritur në të vërtetë sundimin e tij dhe ç'do të thoshte ajo heshtje e popullit, që zgjati 35 vjet me radhë», – thotë autori duke vënë në dukje me të drejtë se Ali Pasha dështoi në përpjekjet e tij për t'u shkëputur nga Porta e Lartë, në këto përpjekje nuk pati përkrahjen e masave të gjera fshatare. Arsye tjetër është përçarja midis drejtuesve shqiptarë.

Meritë tjetër e veprës është krijimi i figurës së Aliut me gjithë karakterin e tij të ndërlikuar. Ali Pashë Tepelena është përshkruar si separatist, që arrin në luftë me sulltanin dhe rivalët e tij të bëhet çifligari më i madh, tregtari më i pasur dhe ushtaraku më despotik. Ai del kurdoherë në armiqësi e në luftë të heshtur apo të deklaruar me sulltanin, por,

në të njëjtën kohë, edhe i ndarë me një hendek të madh nga populli, të cilin e shtyp me egërsi. Fizionominë e Ali Pashës autori e nxjerr në pah duke treguar qëllimet politike, por në vizatimin e personalitetit të tij fiton rëndësi edhe pasqyrimi i tipareve morale që e shquanin atë. Aliu vizatohet mbi të gjitha si njeri shumë i zgjuar, vëzhgues i mprehtë i jetës, që ka një intuitë të hollë, luftëtar i patrembur dhe gjakftohtë, organizator i aftë, njeri me karakter të fortë dhe energjik. Krahas kësaj, në figurën e tij vërehen edhe tiparet e një sundimtari mizor, dinak, ambicioz, që përdor çdo mjet në arritjen e qëllimeve. Qëndresa kundër sulltanit, rebelimi i tij që zgjati një jetë të tërë, përbëjnë anën pozitive të veprimtarisë së Aliut, e cila objektivisht i dha dorë zgjimit të mëtejshëm të ndjenjës kombëtare. Megjithatë jo të gjitha veprimet dhe përjetimet e Ali Pashës janë motivuar nga pikëpamja historike dhe psikologjike. Kështu p.sh. nuk shpjegohet deri në fund dhe arsyeja pse ndjenja e kombësisë dhe ideja e shtetit shqiptar qëndroi e fjetur për një kohë të gjatë në ndër-gjegjen e Ali Pashë Tepelenës dhe doli sheshit vetëm në dy vitet e fundit të jetës së tij. S. Godo ka mundur të pasqyrojë drejt raportin midis historisë dhe individit. Vërtetësia shkencore dhe realizmi janë ndër meritat kryesore të veprës. Plot kolorit e gjallëri dalin në libër edhe figurat e Hankos, Shani-shasë, Thanas Vajës dhe të disa luftëtarëve të tjerë.

Si vepër tipike letrare-historike, «Ali Pashë Tepelena» ka stilin e vet, të përcaktuar nga brendia e veçantë që përbëhet prej informacionit historik, përshkrimeve të ngjarjeve e të betejave, dhe tablove artistike. Vlerësimin e personalitetit të Ali Pashës ose të ngjarjeve autori i bën në pjesë të veçanta, ndarazi nga rrëfimi kryesor, në të cilin mjaft vend zënë vlerësimet dhe interpretimet me karakter politik, historik, shoqëror dhe psikologjik. Nga stili këto pjesë ndryshojnë. Në disa kapituj, si p.sh. në kapitullin ku flitet drejtpërdrejt për faktorët e daljes në skenë të Ali Pashë Tepelenës etj., stili i afrohet atij të veprave historike.

Veçori e stilit është edhe mënyra popullore e rrëfimit, që shfaqet në faktin se për ngjarjet e rëndësishme historike, për hapat ushtarake apo diplomatike të Aliut, për ngjitjet dhe zbrictjet e tij e të personaliteteve të tjera, flitet me gjuhën e njerëzve të thjeshtë, në të cilën vihet në pah ajo që është krye-

sorja dhe lihen mënjanë gjërat e dorës së dytë. Kjo bie në sy sa herë flitet për Fuqitë e Mëdha, për veprimet e qëndrimet e Ali Pashës ndaj tyre; në këto pjesë përdoren ironia, që buron nga urtësia dhe përvoja popullore, dhe në të njëjtën kohë i shkon qëndrimin të heroit ndaj të huajve. Në ligjërimin popullor i ka rrënjët edhe fraza aforistike e autorit, sentencat, të cilat kanë nëntekst. Shkaqet e ngjarjeve, autori nuk nxiton t'i thotë haptazi, por lë të nënkuptohen. Një vend të mirë në vepër zënë kujtimet e Ali Pashë Tepelenës, të cilat jepen të perifrazuara, herë-herë të shoqëruara nga vlerësimet e autorit, që ndonjëherë duken objektivist. Kjo ndodh se autori nuk nxitohet të vlerësojë mendimet dhe veprimet e heroit pa plotësuar qarkun e informacionit. Pasi sjell fakte e të dhëna të mjaftueshme, autori ndërhyr me shprehje aforistike, figura ose përdor metodën e një historiani.

Vepra e S. Godos është përpjekja e parë në letërsinë tonë të realizmit socialist për të dhënë të plotë figurën dhe epokën e Ali Pashë Tepelenës. Rëndësia e saj qëndron gjithashtu në vërtetësinë historike dhe në interpretimin materialist-dialektik të historisë dhe në lidhjen e ideve të saj me aktualitetin. Vepra pasuron letërsinë tonë dokumentare dhe zë një nga vendet e merituar në gjininë e saj.

3

Vend të rëndësishëm në prozën e kësaj periudhe zë pasqyrimi i jetës së shoqërisë socialiste. Në qoftë se më parë kjo temë sapo nisi të lërohej, në vitet 60-70 u zgjerua në mënyrë të ndjeshme hapësira e jetës aktuale në prozën artistike. Shkrimtarët synuan të tregojnë përtëritjen që solli socializmi në jetën e njerëzve të thjeshtë, fizionominë e tyre të re shpirtërore e morale, përshkruajnë punën dhe përpjekjet e masave punonjëse për ndërtimin e jetës së lumtur. Prozatorët arritën të pasqyronin edhe dukuritë e reja që shfaqen në jetën e shoqërisë si rezultat i thellimit të revolucionit ideologjik e kulturor.

Konfliktet dhe aspektet e ndryshme të jetës shoqërore gjetën pasqyrim në veprat e llojeve të ndryshme. Kjo periudhë u karakterizua nga një zhvillim i mirë i tregimit, i cili u

drejtua përherë e më shumë paraqitjes së proceseve dhe dukurive shoqërore aktuale. Në përpjekje për të trajtuar sa më gjerë temën e ndërtimit socialist, tregimi arriti të jepte përgjithësim të rëndësishme realiste dhe të motivonte më mirë nga ana psikologjike qëndrimin dhe veprat e heronjve. Veçori e tregimit me temë aktuale të kësaj periudhe është lirizmi dhe fryma publicistike, që solli me vete futjen në pëlhurën artistike edhe të të dhënave dokumentare.

Një varg autorësh, Dh. S. Shuteriqi, N. Prifti, A. Kondo prekën në tregimet e tyre temën e përmbysjes së botëkuptimit të vjetër në vetëdijen e njerëzve nën ndikimin e shndërrimeve socialiste e të ideologjisë proletare, temën e formimit të njeriut të ri, ndërtues i ndërgjegjshëm i shoqërisë socialiste.

Heroi i tregimit «Zot e rob» (1963) të Dh. S. Shuteriqit nisi të kuptojë se ç'kishte qenë jeta e tij më parë vetëm pasi pushteti i ri e shpronësoi të zotin e tij, i cili për të kishte qenë «i madh sa një zgërbonjë rrap». Fshatari, të cilit gjatë jetës plot vuajtje e halle i ishte rrënjësuar aq thellë psikologjia prej skllavi sa të mos e kuptonte dot jetën e vet pa aganë, shtojcë e të cilit ishte bërë, sapo vihet përballë jetës së re që solli çlirimin e njerëzve, ndien zgjimin e ndërgjegjes së tij shoqërore, hidhet të hakmerret kundër agait, i cili ia kishte shkatërruar jetën. Akti i tij është përcaktuar nga kushtet e reja shoqërore-historike, të cilat bëjnë të mundur që ai të ngrëjë krye për herë të parë në jetë. Krahas vërtetësisë shoqërore-historike, akti i heroit ka vërtetësi edhe nga pikëpamja psikologjike. Ai vendos të mos i nënshtrohet agait, kur ky nuk i jep leje të shohë nipin e tij të vetëm, që sapo ka lindur, pra kur e preku në ndjenjat më të thella njerëzore. Po aq vërtetësi ka edhe skena e përfundimit tragjik të vetë fshatarit. Ideja e çlirimit shpirtëror të njeriut punonjës është mishëruar si në pasqyrimin e gjerë të forcave shoqërore pas Çlirimit, ashtu edhe në dhënien më gjerë të psikologjisë së personazheve, sidomos të personazhit qendror, Uanit. Autorin, edhe këtu si përgjithësisht në tregimet e tij, e tërheqin ngjarje jo të zakonshme, njerëz me biografi interesante. Synimi për të pasqyruar kolizione dramatike, saktësia e gjuhës, pakëz racionale, por plot shprehje të bukura, janë tipare të stilit të Dh. S. Shuteriqit si tregimtar. Këto shfaqen edhe në tregimin «Zot e rob», i cili është ndër krijimet e tij më të shquara.

Në tregimin «Litar i zjarrtë» (1970) të N. Priftit gjejmë fshatin e Myzeqesë në ditët e para pas Çlirimit. Komiteti i fshatarëve të varfër bën ndarjen e tokës. Miço Semës i propozojnë të marrë pesë hektarë nga të Sak Topanxhës, armik i popullit, që është arratisur në pyll. Ndërsa ndonjëri ngurron të marrë tokën, Miçoja nuk ka frikë, ai i merr pesë hektarët që i kanë caktuar, sepse ka besim te pushteti i ri. Ky është optimizmi spontan i njeriut të varfër, që e ndien veten të çliruar nga zgjedha e shoqërisë së vjetër. Realizmi i tregimit qëndron në paraqitjen me vërtetësi të ngjarjes e të mjedisëve dhe në motivimin psikologjik të veprimeve të personazheve. Figura e fshatarit të varfër, që fiton besim në forcën e vet, në forcën e pushtetit të vet dhe në të ardhmen, është vizatuar me ngjyra psikologjike e nota lirike, karakteristike për prozën e autorit.

Ngjarjet në tregimin e A. Kondos «Kënga e re, gjyshja dhe unë» (1968) rrëfohen me ton poetik. Autori tregon për njerëzit e popullit që marrin frymë lirisht, sepse pushteti popullor i shpëtoi nga vuajtjet dhe brengat e pafund që hiqnin në shoqërinë e vjetër. Ideja e veprës ka dalë në pah përmes kujtimeve të autorit për gjyshen e vet të moshuar, së cilës i kishte kaluar jeta me brenga dhe halle. Tregimi përshkohet nga një frymë romantike që ka gjetur shprehje në ëndrën poetike për botën e re. Vendin qëndror e zë njeriu i thjeshtë, të cilin socializmi e shpëtoi nga mjerimet dhe ia shtoi dashurinë për jetën. Me lakonizëm e asociacione shprehëse është dhënë atmosfera e gëzuar e kohës, që e përtërin shpirtërisht dhe e bën optimiste edhe gjyshen. Synimin për të zbuluar psikologjinë e personazheve, autori e arrin duke përdorur ngjyrrat lirike.

Individualizmit si shfaqje të psikologjisë mikroborgjeze, D. Shaplo në tregimin «Kubeja» (1965) i kundërvuri botëkuptimin socialist, marrëdhëniet e reja njerëzore, që zunë të shfaqen në jetë. Heroi i tregimit, një zanatçi privat, nuk pranon të hyjë në kooperativë, sepse për të është e huaj ndjenja e punës kolektive. Sa më tepër ngul këmbë për të qëndruar si zanatçi më vete, duke rënë ndesh jo vetëm me interesat e shoqërisë, por edhe me dëshirën e gruas dhe të të birit, për të ecur me frymën e kohës, aq më tepër humbet ai çdo ndjenjë njerëzore dhe bëhet krejt i huaj për mjedisin.

Në karakterin e heroit është mishëruar psikologjia tipike e zanatçit i cili gjithë jetën ishte mësuar të mos shihte përtej pragut të dyqanit të vet. Mbyllja në guaskën e interesave të ngushta ekonomike, mungesa e besimit në shndërrimet e reja të jetës, është vizatuar me imtësi të mprehtë psikologjike. Vend më vete zë në tregim figura e kubesë, e pazarit të vjetër të qyteteve tona në të kaluarën, dhënë me plasticitet. Tregimi përmes këtyre figurave, të zanatçit dhe të kubesë, krijon një pamje të gjallë të kohës, duke fituar vërtetësinë e një dokumenti. Individualizmi i heroit has në kundërshtimin e së shoqes dhe të të birit. Midis tyre lind një konflikt, që arrin kulmin në fund, kur i biri largohet nga shtëpia, në shenjë mospajtimi të hapur me të atin. Por konflikti kryesor i tregimit rrjedh nga kontradikta që lind midis heroit, i cili nuk është çliruar ende nga ideologjia e vjetër dhe ecjes përpara të të gjithë jetës së vendit. Idriz Sinanin e nxjerr jashtë edhe kubeja, së cilës dikur ai i përkiste kokë e këmbë; në kube janë vendosur zanatçinjtë e kooperuar. Kujdesin kryesor autori ia ka kushtuar shtjellimit të veprimit, përshkrimit të hollësisëm të mjedisit, paraqitjes së mendimeve dhe veprimeve të personazheve, të cilët janë dhënë me gjallëri. Në zgjidhjen e konfliktit autori i ka mbetur besnik së vërtetës së jetës. Rrëfimi i brengës së heroit ka një notë të butë njerëzore. Stili është i shtruar, gjuha e saktë.

Pohimi i qëndrimit socialist ndaj punës, zhvillimi i cilësive të reja shpirtërore të njerëzve tanë përmes luftës kundër pikëpamjeve mikroborgjeze — këto tema janë trajtuar në shumë tregime të këtyre viteve. Në qëndër të krijimeve të T. Laços është masa, e cila lufton kundër njerëzve me mentalitet individualist, egoistëve, burokratëve dhe njerëzve me koncepte intelektualiste. Autori ka vizatuar portrete të qëlluara të njerëzve tanë, që luftojnë plot vetëmohim në sektorë të ndryshëm të ndërtimit socialist. I tillë është Elmazi («Era e tokës», 1965), i cili pasi çmobilizohet nga ushtria, kërkon të punojë në fshat. Figurën e fshatarit kooperativist që e sheh kuptimin e jetës në punën për lulëzimin e pronës së përbashkët, autori e ka pikturuar me ngjyra të kursyera. Në tregimin «Brezat e gurtë» (1967) konflikti që ndizet rreth hapjes së tarracave mbi një kodër «shterpë», konflikt në dukje i vogël, shpreh ndeshjen e dy qëndrimeve të kundërta: e qëndri-

mit individualist dhe të atij kolektivist. Atmosfera e kësaj ndeshjeje është krijuar nëpërmjet vizatimit të një sërë personazhesh, ku secili është karakter tipik. Gjejmë midis tyre edhe njeriun që kërkon qoshe të rehatshme, edhe të riun përparimtar, por që nuk ka shumë besim te njerëzit, edhe prapanikun që është lidhur ngushtë me të vjetrën. Në tregimin «Pikojnë kokrrat e kimbura» (1969) kemi portretin e luftëtares për të renë. Brigadierja Esma është në konflikt me të atin, i cili kërkon të marrë sa më shumë prej shoqërisë dhe ti japë asaj sa më pak. Esmaja është një vajzë me botë të pasur dhe e zgjuar, që di jo vetëm të arsyetojë drejt, por edhe të veprojë me takt. Njohës i mirë i dukurive të reja që shfaqen në fshatin kooperativist të kësaj periudhe, autori ka mishëruar në personin e Esmasë njeriun përparimtar, fjalëpakë, që ndikon tek të tjerët me thjeshtësinë, drejtësinë dhe të përmbajturit e vetvetes përballë çështjeve të ndërlikuara e delikate që nxjerr jeta.

Monologu i brendshëm, kompozicioni i thjeshtë, koloriti popullor, janë tiparet e tregimeve të T. Laços. Në të njëjtën kohë në të vërehet edhe një notë publicistike, gjë që bën që ndonjëherë kthesa psikologjike të mos motivohen sa duhet.

Në tregimet e kësaj periudhe të Dh. Xhuvanit zotëron tema e klasës punëtore. Heronjtë në shumicën dërmuese të tregimeve veprojnë në mjedise kantieresh ndërtimi. Autori rreh problemin e edukimit të ndërgjegjes së njerëzve në procesin e punës e të veprimtarisë shoqërore. Në tregimin «**Zhurma të forta**» (1971) idenë se njeriu e gjen lumturinë e vërtetë në punën e përditshme për të mirën e shoqërisë, Dh. Xhuvani e pohon duke e paraqitur heroizmin si tipar karakteristik të njeriut të ri. Ideja është realizuar me anë të nxjerrjes në pah të gjendjes shpirtërore të heroit. Rexhoja është tipi i njeriut «të fortë» që e ha punën «me dhëmbë». Por ai është edhe njeri me ndjenja të bukura, i pëlqen muzika me nota të forta. Thelbin e karakterit të tij autori e zbulon përmes dashurisë që ushqen Rexhoja për muzikën klasike. Me këtë pasion për muzikën lidhet edhe nyja e veprimit të subjektivit. Tek po hynte një ditë në galeri, duke dëgjuar nga altoparlanti një pjesë të Bethovenit, ndien pa pritur erën e gazit, jep alarmin, vrapon të shpëtojë shokët, por pëson aksident, humb dëgjimin. Për shkak të gjymtimit ndërron profesion, bëhet

ndërtues, por prapë e dashuron muzikën. Tek Rexhoja autori ka mishëruar një punëtor me botë të pasur shpirtërore. Vandin kryesor në tregim e zë vizatimi i portretit të këtij njeriu. Për të rëfeket në dhomën e qendrës së zërit të një kantieri, nga dritarja e së cilës duket Rexhoja, duke rrezuar barakat e fundit pas mbarimit të veprës. Rexhoja është aty afër, praninë e tij e ndiejmë, por atë vetë nuk e shohim. Pasuria e imtësive psikologjike dhe gjetja e një kompozicioni të përshtatshëm ndihmon që figura e heroit të përshkruhet me viza të gjalla. Kuptimi i thellë i jetës që spikat në dramatzimin e konfliktit të brendshëm dhe në vizatimin me vërtetësi të mjediseve të punës, është tipar tjetër i tregimit.

Ideja se klasa punëtore me shembullin, me botëkuptimin dhe me mënyrën e saj të jetesës, ndikon pozitivisht në mbarë shoqërinë gjeti shprehje në shumë tregime të kësaj periudhe të Dh. Xhuvanit. Te «**Një njeri më shumë**» (1971) ky ndikim zbulohet përmes historisë së një ahengxhiu të ri, i cili e ndien gjithnjë e më fort se këngët e vjetra sentimentale që ekzekuton bashkë me shokët e vet, janë diçka anakronike, që bie ndesh me vullin dinamik dhe frymën revolucionare që karakterizon shoqërinë tonë. Kontakti me klasën punëtore, me atmosferën e gjallë krijuese dhe plot optimizëm të kantierit të ndërtimit, i zgjojnë fizarmonicistit të ri dëshira dhe aspirata të reja. Ai e kupton se as këngët që luan bashkë me shokët e vet, as kënga që krijon vetë, nuk shkojnë me kohën. Tronditja shpirtërore që ai provon kur sheh se jeton larg realitetit të ri, përbën konfliktin e tregimit. Në fund djaloshi shkëputet nga shokët dhe shkon të punojë në kantier. Forca artistike e tregimit qëndron në përshkrimin e atmosferës së kantierit, në shprehimësinë e imtësive të veçanta.

Epërsia morale e njeriut të ri, qëndrimi i tij i papajtuashëm me shfaqjet e konservatorizmit në jetën familjare formon brendinë e tregimit «**Sezoni dimëror i kafe «Rivierës»**» (1969) të I. Kadaresë. Tregimi është më shumë një monolog i gjatë i një kamerieri të ri, i cili rrëfen për ditët e punës në lokalin e vet. Subjekti shtillet rreth marrëdhënieve të tij me klientët nga njëra anë dhe me kolektivin, nga ana tjetër. Si kamerier atij i qëllon të shohë shpesh se në lokalin ku shërben, festohen fejesa me mblesëri, ku marrin pjesë dhe intelektualë që shtiren si njerëz të emancipuar. Si njeri i mbrujtur

me koncepte të reja, ai është kundër zakoneve prapanike, dhe për këtë arsye bie në konflikt me drejtuesit e ndërmarrjes, konformizmi i të cilëve e indinjoi. Ai nuk qëndron indiferent ndaj të metave që sheh dhe mban qëndrim duke hyrë kështu në konflikt me burokratët, qofshin klientë apo drejtues të lokalit. Të lejohen ose të mos lejohen në lokal «gëzime» fejesash me mblesëri, ku zbatohet një variant «modern» i kanunit të lashtë, rreth kësaj çështjeje ngjizet konflikti i tregimit. Konflikti është i fortë; heroi largohet nga puna dhe vete në Komitetin e Partisë në radhë të parë për të sqaruar çështjen parimisht, pastaj për të kërkuar të drejtën e vet. Kamerieri është tipi i një djaloshi të ri, që dashuron çdo lloj pune dhe për këtë bie ndesh edhe me familjen, e cila nuk e pëlqen punën e tij si kamerier. Me gjithë hapësirën e ngushtë të tregimit, në të ka larmi tipash. Klientët, punonjësit e lokalit (teto Naja, përgjegjësi), janë tipa të ndryshëm që i bashkon konformizmi, që shfaqet tek çdo njëri prej tyre me nuanca të ndryshme. Veçori e tregimit është toni optimist dhe humori i situatave dhe i tipave. Kontrasti midis atmosferës së gëzuar të jetës sonë, i gjallërisë së rrugëve të kryeqytetit nga njëra anë dhe atmosferës së neveritshme, që zotëron në tavolinat e «gëzimeve» të fejesave me mblesëri, përcakton në një shkallë të madhe forcën asociative dhe ritmin e brendshëm të tregimit, ku spikat ironia ndaj botës së vjetër. Autori na shfaqet njohës i mirë dhe vëzhgues i mprehtë i tipave të mjediseve të ndryshme, sidomos i atyre tipave që thelbin e tyre prej anadollaku e fshehin pas pamjes moderne.

Mjaft tregime të kësaj periudhe trajtojnë problemin e emancipimit të femrës. Në shumicën e tyre mbizotëron pasqyrimi i konflikteve që morën jetë nga lufta kundër patriarkalizmit, zakoneve prapanike e paragjyqimeve fetare. Tregimet «Perdet e rënda të maleve», «Shkallët e gurta» dhe «Tetë letrat e Valtit» të Dh. S. Shuteriqit i përshkono ideja se pozita inferiore e gruas në lëmin e marrëdhënieve familjare si shprehje e pabarazisë ekonomike është përforcuar nga zakonet prapanike («Perdet e rënda të maleve»). Në tregime të tjera, pa nënvleftësuar faktorin subjektiv, autori vë në dukje rolin e shndërrimeve ekonomike, sidomos të kolektivizimit të bujqësisë, në përmbysjen e mentaliteteve të vjetra («Shkallët e gurta»). Subjekti i tregimit «Tetë letrat e Valtit» (1968) është i thjeshtë.

Martini, postieri i fshatit, shpërndan në një ditë tetë letra, gjë që nuk i kishte ndodhur asnjëherë tjetër. Njëpërmjet këtyre letrave, vajzat e fshatit që kanë shkuar në aksionin për ndërtimin e hekurudhës njoftojnë të fejuarit e tyre se ato prishin fejesat e bëra sipas kanunit. Dy fshatarëve që janë tepër të moshuar për t'u martuar rishtazi, letrat u njoftojnë diçka të rëndë, kurse pesë të tjerëve, që janë më të rinj u hapen sytë nga këto letra, ata fitojnë diçka në pikëpamje morale për të cilën do të luftojnë dhe vetë në të ardhmen, fitojnë dinjitetin e tyre. Tregimi është ndërtuar si monolog i gjatë i postierit, në të cilin ndihet thellë humori dhe optimizmi. Edhe personazhet e tjera shfaqen përmes monologut, ndërtuar në bazë të intonacionit të gjuhës së popullit. Tregimin e karakterizon gërshetimi i dramatismi me lirizmin dhe me paraqitjen groteske të botës së vjetër. Në këtë subjekt të thjeshtë nyja kryesore është figura e Martinit, në karakterin e të cilit spikat optimizmi dhe humori i hollë, me të cilin populli vë në lojë vulgaren dhe të vjetrën. Si lajmëtar i shndërrimeve të reja që kanë ndodhur në mentalitetin e malësorëve, Martini na shfaqet me një optimizëm që fiton deri diku kuptimin e një simboli, sepse edhe atë si njeri e trazojnë po ato shqetësime që ai u sjell njerëzve si postier. Sikurse ata, edhe Martini ka problemin e vet; ai dashuron, por nuk ka ndonjë dramë, si të tjerët. Figurën e tij e përshkon tej e ndanë lirizmi i thellë, që buron nga shndërrimi i shpejtë i botës dhe i jetës përreth. Tregimi «Tetë letrat e Valtit» shquhet për shkrirjen e rëfimit artistik me elementet e reportazhit.

Pasqyrimi i ndryshimit të psikologjisë së heronjve nën veprimin e rrethanave shoqërore, është problemi që rrihet edhe në tregimin «Naja me fshesë» (1972) të N. Priftit. Babai fshatar nuk e lë të bijën të marrë pjesë në grupin artistik të fshatit jo se është kundër pjesëmarrjes së të rejave në jetën kulturore, por sepse don të bëjë presion mbi kryesinë e kooperativës që nga kjo të përfitojë diçka; ta vendosë vajzën në punë me ditë fikse. Edhe i vëllai mban po atë qëndrim ndaj së motës, por i shtyrë nga një motiv tjetër, ai ka frikë se mos e motra bën dashuri. Përballë tyre vihet vetë Naja, që përfaton tipin e vajzës kooperativiste me koncepte të reja mbi jetën dhe vendin e femrës në fshat. Tregimi shquhet për këtë vështrim të ri të kontradiktave të jetesës e të psikologjisë

së njeriut të sotëm. Naja lufton vetë për dinjitetin dhe çlirim e saj. Me fjalët që thotë ajo shkul nga mendjet e të tjerëve pikëpamjet e mykura mbi vendin e femrës në shoqëri. Tregimi është ndërtuar i thjeshtë, në rrëfimin e shtruar që ndërpritet nga ndonjë digresion në tërësi mbisundon toni i qetë. Këto veçori karakterizojnë në përgjithësi N. Priftin si tregimtar.

Në tregimet e A. Cergës vend qendror zënë të rinjtë e sotëm, jeta dhe punët e tyre. Heroi i shumë veprave të këtij autori është i riu që po hyn në jetë dhe në punën ndërtimore për lumturinë e Atdeut gjen edhe lumturinë e vet. Në më të shumtën e tregimeve tema e rinisë ndërthuret me temën e lumturisë. Lidhur me këtë veçori të veprës së A. Cergës është poetizimi i ndjenjave rinore, i sinjeritetit, i miqësisë, i dashurisë, i ëndrrave të të rinjve në jetë. Në tregimin «Oxhaku» (1971) flitet për një malësor të ri të cilit, posa vjen në një kantier ndërtimi, i ngarkojnë detyrë ngritjen e një oxhaku 75 m. të lartë. Kjo ishte për të prova e parë në jetë. Vështirësitë që kapërcen gjatë kryerjes së detyrës së rëndësishme që i besuan, mbështetja që gjen te punëtori më i vjetër, Agroni, dhe brigada e montatorëve, e cila punon e jeton në harmoni si një familje, e mbushin jetën e heroit me një kuptim të ri dhe e ndihmojnë të gjejë rrugën e lumturisë së vërtetë. Në këtë tregim, ashtu si edhe në shkrime të tjera të autorit, bie në sy si veçori karakteristike fryma e humanizmit socialist, besimi te forcat e njeriut tonë, siguria se ai është i zoti të ngadhënjejë mbi vështirësitë që has në jetë. Autorin e ka tërhequr më tepër bota e ndjenjave të personazheve dhe në pajtim me këtë ka ndërtuar edhe konfliktin e veprës, në themel të të cilit është vënë lufta e emocioneve të njeriut për të fituar besimin në vetvete e për të gjetur rrugën e lumturisë në jetë. Në vepër, e cila rrjedh si rrëfim lirik i historisë së ngritjes së oxhakat, fryma poetike është gërshetuar me notat publicistike. Por dramatismi, të cilin e kërkon vetë ngjarja që formon bazën e subjektit, ka dalë i zbehtë. Me këtë është i lidhur edhe një farë prolisiteti në përshkrim ndonjëherë dhe përdorimi jo me shumë kursim i mjeteve gjuhësore.

Në tregimin «Familja e madhe» (1971) A. Cerga kuptimin që ka puna dhe kolektivi në jetën e njeriut tonë e pasqyroj në një aspekt tjetër. Heroi i tregimit është një mësues i ri, i cili

për shkak të një fatkeqësie të natyrës, humbet gjithë familjen; dhimbjen e thellë ai e kapërcen dhe gjen sërish lumturinë jo duke u larguar nga fshati ku e lëndonin çdo çast kujtimet e hidhura, por duke qëndruar pikërisht në atë shkollë me të cilën e lidhte dashuria më e madhe, dashuria për punën, për nxënësit dhe për shokët që u bënë për të familja e dytë.

Nëpërmjet përshkrimit të takimit të dy rezervistëve dhe të një nëne të thjeshtë fshatare në tregimin «Kush është?» (1968) të N. Jorgaqit zbulohet ideja se populli ynë është edhe popull ushtar, që krahas punës ndërtimore vigjilon në mbrojtje të interesave të atdeut. Në themel të tregimit është konflikti në ndërgjegjen e dy rezervistëve të cilët për shkak të vështirësive të motit, në kohë pushimi janë larguar pa leje nga vendi i stërvitjes dhe janë strehuar në një shtëpi fshati, ku ndodhet vetëm një plakë me nipin e mbesën, kurse të gjithë të tjerët kanë shkuar në stërvitje. Sjellja e tyre dënohet jo vetëm nga rezervistët në stërvitje, por edhe nga fshatarja patriotë, e cila u kujton atyre se mbrojtja e atdeut është mbi të gjitha. «Jemi në gojën e ujkut — thotë nëna, — ... shihni detyrën ju, se hasmi këtë kohë pret». Nëna, me gojën e së cilës flet ushtria popullore, ka njohur mjerimet e ndryshme që i kanë shkaktuar Shqipërisë armiqët. Me karakterin e saj duket sikur është simbolizuar Atdeu, ndonëse kjo nuk ka qenë në konceptin artistik të autorit. Tregimi shquhet për vërtetësinë e situatave dhe të konfliktit që zhvillohet në ndërgjegjen e personazheve.

Vëmendjen e V. Koreshit e ka tërhequr sidomos tema e njeriut të punës dhe e lidhjeve të tij të thella shpirtërore me punën krijuese. Në shkrimet e veta V. Koreshi poetizon njeriun e punës dhe vetë punën në shoqërinë tonë të çliruar nga marrëdhëniet e vjetra të shtypjes dhe të shfrytëzimit.

Ideja e shndërrimeve të mëdha që ndodhën pas Çlirimit në mënyrën e jetesës në tregimin «Ndërrimi i qiejve» (1972) të V. Koreshit është zbuluar nëpërmjet fatit të heroit. Ziku, punëtor për mirëmbajtjen e rrugëve, shquhet si njeri i dhënë pas punës. Ai merr pjesë aktive në ndërtimin e jetës së re që vlon përreth, rron me ngjarjet e reja dhe zë shoqëri me gjithë punëtorët e rinj që vijnë nga krahina të ndryshme për të punuar në minierë. Kjo nuk u pëlqen disa malësorëve të cilët si robër të zakoneve të vjetra, nuk e shohin me sy të mirë kri-

jimin e një mënyre të re jetese në zonat e thella, prandaj dhe shpifin për Zikun, duke thënë se ka braktisur familjen. Por tashmë këtyre njerëzve nuk u shkon më fjala si më parë dhe dështojnë në përpjekjet e tyre për të ndaluar ngadhënjimin e së resë në ndërgjegjen e njerëzve.

Gatishmëria me të cilën Ziku pret njerëzit e rinj që vijnë në minierë shpjegohet me faktin se në të kaluarën ai kishte bërë një jetë të rëndë. Ende i ri, 18 vjeç, kishte qenë i detyruar sipas zakonit, të martohej me një grua të ve njëzetentëvjeçare, bashkëshorten e të vëllait, duke i bërë kështu fli rininë e vet urdhrit të kanunit. Tani burrë dyzetvjeçar, vihet përsëri përballë zakoneve të vjetra që rezistojnë ende, por tashmë i sfidon ato me besim të thellë në jetën e re e me energji të reja që atij i japin shndërrimet shoqërore. I përtërirë nga vrulli i ndërtimit socialist, ai del fitues përfundimisht kundër mbrojtësve të traditave patriarkale. Afrimi i Zikut me punëtorët që vijnë për herë të parë në minierë, miqësia që ai u shfaq atyre është në një farë mënyre protesta e tij e vonuar kundër botës së vjetër që i shkaktoi një plagë, e cila ende pikon gjak. Heroi e pret krahëhapur jetën e re, ndonëse buzëqeshja e tij është nemitur.

Shtrirja e subjektit, problematika e gjerë dhe personazhet i japin tregimit dendësinë e një romani. Heroi i veprës është punuar me kujdes, autori ka mundur të japë kompleksitetin e botës së tij të brendshme, çka ka bërë që figura e tij të vizatohet e gjallë dhe e plotë. Për zbulimin e idesë së tregimit interes paraqet ndihmësi i Zikut djaloshi Maxhun, i cili me fatin e tij të lumtur e thekson tragjedinë shpirtërore të Zikut. Jeta e Maxhunit, që formon një paralele me jetën e Zikut, shërben si kornizë e subjektit të tregimit. Historia e djaloshtit tetëmbëdhjetëvjeçar që hyn në jetë në një mënyrë krejt të kundërt me atë të Zikut dhe ka përpara një të ardhme të gëzuar, zbulon idenë e rëndësisë së madhe të socializmit në jetën e njerëzve të thjeshtë.

Në qendër të tregimit «**Si një këngë që u këndohet trimave**» (1972) autori ka vendosur figurën e një fillrojtësi. Bota e bukur shpirtërore e heroit, ndjenja e gëzimit që i jep puna dhe ndjenja e detyrës që shkon gjer në vetëmohim, janë dhënë nga autori përmes një subjekti të thjeshtë ku vendin kryesor nuk e zë veprimi ose përshkrimi i ngjarjes, por zbulimi i

mendimeve dhe i përjetimeve të fillrojtësit, i cili kuptimin dhe bukurinë e jetës e gjen në punën e tij të thjeshtë në shërbim të njerëzve. Një atmosferë poezie mbështjell gjithë figurën e heroit, dhe një rrymë lirizmi të ngrohtë përshkon naracionin, dialogët e monologët e heroit si dhe përshkrimet e goditura të natyrës, dhënë me ngjyra të lehta. Me të njëjtat mjete, me thellësi mendimi e ndjenje, ka dhënë autori në tregimin «**Duart e një burri**» edhe figurën e një minatori për të cilin jeta s'ka kuptim jashtë minierës prej së cilës e largon përkohësisht një aksident, që i ndodh.

Nëpërmjet ravgimeve të heroit për t'u kthyer në minierë, duke arritur me përpjekje mbinjerëzore të përdorë përsëri martelin me duart e gjymtuara, autori ka treguar se vetëm në punë njeriu i vërtetë gjen vetveten, se puna i jep jetës së tij një kuptim të madh.

Në historinë e heroinës së tregimit «**Duke dalë nga një natë e gjatë**» (1972) V. Koreshi ka pohuar idenë se në klimën e jetës së re që krijon socializmi, fitorja e normave të reja morale dhe emancipimi shpirtëror i femrës është një proces që nuk mund të pengohet, sado i fortë qoftë pushteti i kanunit dhe qëndresa që bën e vjetra.

Në fillim të viteve 70 tregimin e shkurtër e lëruan dhe një radhë autorësh të rinj, në krijimtarinë e të cilëve vend qendror zunë njerëzit e punës. Duke e lidhur biografinë e tyre me historinë e Atdheut, penat e reja në prozë synuan të jepnin përgjithësime të gjera, gërshetuan shpesh tonin liriko-filozofik me frymën epike. Problemin e ndryshimeve në ndërgjegjen e njeriut të sotëm autorët e rinj e rrahën jo vetëm në krijimet në prozë kushtuar pasqyrimin të punës socialiste, por edhe në tregimet që trajtojnë problemin e luftës kundër shfaqjeve të botëkuptimit dhe të psikologjisë mikroborgjeze e patriarkale. Në tregimin me temën e punës autorët e rinj shpesh vunë në qendër «**moshatarë të kohës sonë**». Duke i thurur veprat e tyre si biografi të heronjve, ata lidhin fatet e heronjve me historinë e ndërtimit të shoqërisë së re dhe mishërojnë në karakterin e tyre vetitë morale shpirtërore të përfaqësuesve të brezit të ri, që lindi dhe u formua në epokën e socializmit.

*
* *
*

Luftën për rrënjosjen më thellë në jetë të ideologjisë socialiste e vuri në qendër të vet edhe romani. Problemet që nxori në këtë periudhë ndërtimi i plotë i shoqërisë socialiste u rrahën në romanet: «Juga e bardhë» i J. Xoxës, «Përsëri në këmbë» dhe «Fan Smajli» të Dh. Xhuvanit, «Tokë e ashpër», i T. Laços, «Kullat» i Gj. Zhejit, «Zjarret» i S. Spasses etj.

Tipar karakteristik për romanet me temë aktuale është se shumica e tyre u shkruan në bazë të përshtypjeve të freskëta të ngjarjeve. Ato ishin jehonë e drejtpërdrejtë dhe e shpejtë e ndryshimeve dhe e proceseve të reja shoqërore që sollën në jetë aksionet revolucionare pas Letrës së Hapur, e sidomos pas Kongresit V të Partisë. Ky tipar shquan edhe romanin «Juga e bardhë» (1971) të J. Xoxës, i cili përbën një kontribut të ri në pasqyrimin e gjerë të realitetit socialist në letërsinë e sotme dhe në lërimin e romanit shumëplanësh.

JUGA E BARDHË

Vepra përshkruan luftën e Partisë dhe të fshatarësisë punonjëse për forcimin e kooperativave bujqësore, për rrënjosjen e plotë të normave socialiste në jetë dhe të qëndrimit socialist ndaj pronës së përbashkët, për nxitjen dhe zhvillimin e mendimit krijues të masave kundër shfaqjeve të burokratizmit dhe të konservatorizmit. Krahas problemit të shndrrimeve ekonomike dhe social-psikologjike autori është përpjekur të shtrojë dhe të zgjidhë edhe probleme etiko-morale. Romani përshkruan jetën myzeqare në periudhën kur Partia dhe pushteti morën masa për forcimin e mëtejshëm të kooperativave. Lufta për organizim sa më të mirë të ekonomisë së kooperativës kundër frymës lokaliste shpie përpara veprimin e romanit, organizon subjektin. Autori pohon idenë e epërsisë së moralit socialist dhe të frymës së kolektivizmit mbi individualizmin dhe psikologjinë e pronës private.

Romani «Juga e bardhë» ka ngjarje të shumta. Veprimi shtjellohet kryesisht në Pirgan, një fshat i largët, ku jeta rrjedh e qetë në pamjen e jashtme, por brendapërbrenda saj ziejnë kontradikta të ndryshme. Subjektin e veprës e formon

rruga e vështirë që kalon ky fshat për të vendosur sërish normat socialiste të marra nëpër këmbë nga kryetari i kooperativës. Në themel të konfliktit të romanit qëndron ndeshja midis kooperativistëve dhe Kiu Koroziut, i cili është larguar nga rruga e drejtë dhe zbaton praktika të shtrembra që pengojnë ecjen përpara të kooperativës. Në roman janë përfshirë edhe aspekte të tjera të luftës për bashkimin e kooperativave, vështirësitë e reja që lindën gjatë përpjekjeve për ta çuar kooperativën përpara, në rrugën e lulëzimit e të zhvillimit të mëtejshëm.

Konflikti themelor i veprës zbulohet në librin e parë përmes pasqyrimin të ngjarjeve të fshatit Pirgan dhe zgjidhet me demaskimin e Kiu Koroziut, gjë që arrihet me punën e palodhur dhe këmbëngulëse të Adnanit, komunistit të dërguar në fshat për të ndihmuar forcimin e kooperativës së bashkuar. Ndeshja midis forcave të shëndosha dhe Kiu Koroziut e rrethit të tij zhvillohet me mprehtësi të veçantë kryesisht në librin e parë. Kjo luftë i shtrëngon njerëzit të zënë pozita të qarta në luftën që përshkon jetën e fshatit, çka ka bërë që të dalin mirë në pah pasionet, tronditjet, shqetësimet e përpjekjet e njerëzve dhe personazhet të vizatohen me ngjyra të gjalla. Me këtë lidhet interesimi i lexuesit për librin e parë. Edhe pse në librin e dytë përshkruhen shumë ngjarje dhe fakte, tregohen karaktere me interes, konflikti themelor nuk ka zhvillim të përqëndruar dhe organizimin kompakt të librit të parë. Në librin e dytë ajo që e ka përcaktuar ecurinë e veprimit nuk është fati i njerëzve të angazhuar në luftë për të zgjidhur çështjet e mprehta që shqetësojnë fshatin, por më shumë ngjarjet e renditura njera pas tjetrës.

Ideja kryesore është zbuluar kryesisht në librin e parë, përmes historisë së marrëdhënieve që zhvillohen midis Kiu Koroziut dhe Adnanit. Edhe personazhet e tjera si Shpresa etj. lozin rol në shtjellimin e subjektit dhe në pohimin e idealit pozitiv që e përshkon veprën.

Kiu Koroziu, kryetar i kooperativës së Pirganit, i cili zë një vend të rëndësishëm në roman, është skalitur me mjeshtëri nga autori. Ai përfaqëson drejtuesin e shkëputur nga masa, që vepron në mënyrë arbitrare, në kundërshtim me rregullat që më elementare të jetës socialiste. Kiu Koroziu është bërë në fshat një «tiran i vogël», që vendos dhe vepron siç i do qejfi.

Ai është mishërim i qëndrimeve më negative në kuptimin shoqëror e moral. Plot të meta dhe cene, ambicioz dhe intrigant, Kiu Koroziu është përshkruar nga autori si rast i veçantë në shoqërinë tonë, por edhe pse ndeshet rrallë në jetë, në mendimet, synimet dhe veprimet e veta ai mishëron me gjallëri të veçantë tiparet karakteristike të burokratit, që ka degjeneruar ideologjikisht. Kiu Koroziu nuk ka kontradikta të brendshme, atë nuk e bren ndërgjegjja; është i vendosur në qëllimin që ndjek për të ruajtur sundimin e vet në Pirgan, të cilin e shikon si «çiflig të vogël». Qëndrimi i Kiu Koroziut ndaj problemit të bashkimit të kooperativave, përpjekjet e vazhdueshme të tij për të penguar bashkimin e kanë burimin në kuptimin individualist që ka ai për kolektivizimin. Këtë shpirt individualist prej mikroborgjezi e nxjerr në pah zhvillimi i ngjarjeve. Sa më tepër goditet individualizmi, psikologjia mikroborgjeze, aq më e qartë bëhet fizionomia e Kiu Koroziut si njeri me shprehje dhe koncepte të huaja për socializmin.

Autori ka arritur të tregojë dëmin e madh të koncepteve dhe të metodave burokratike që përdor Kiu Koroziu, të cilat janë krejt të huaja për rendin socialist. Si rezultat i metodave të gabuara të drejtimit, u krijua një gjendje shumë e rëndë në kooperativë, e cila nisi të numërohet në rreth ndër të prapambeturat. Nën nxitjen e kryetarit në ndërgjegjen e disa fshatarëve gjallërohen mbeturinat e psikologjisë së vjetër, si individualizmi, rendja pas interesit vetjak, ndjenja e pronës private etj. Mospërfillja e mendimit të masës, hakmarrja ndaj atyre që guxojnë të kritikojnë të metat e kanë çuar Kiu Koroziun në konflikt me njerëzit, të cilët i druhen, por nuk e duan.

Shkrimtari e ka vizatuar këtë figurë me mjete të goditura artistike. Një rol të rëndësishëm në karakterizimin e Kiu Koroziut lot ligjërimi, i cili e jep bukur mentalitetin dhe psikologjinë e tij. Gjuha e tij plot kolorit, që buron nga shprehjet dhe krahasimet popullore, zbulon me ngjyra të gjalla thelbin e karakterit shoqëror prej burokrati të pandreqshëm.

Kiu Koroziu është dhënë i formuar si karakter. Autori nuk na thotë asgjë për të kaluarën e tij, për shkaqet themelore që e prunë në këtë gjendje. Vëmendja e J. Xoxës është përqendruar në zbulimin e tipareve negative të Kiut, të cilat ishin shfa-

qje të një stili dhe metode burokratike, që e shkëputën nga njerëzit, që e kishin zgjedhur si kryetar, shfaqje e një mënyre të gabuar të të kuptuarit të rolit dhe të kompetencave të tij si drejtues. Aty-këtu autori lë të nënkuptohet se këto tipare ishin shprehje të botëkuptimit mikroborgjez, i cili ishte tulatur gjatë jetës partizane dhe nxori krye në karakterin e tij më pas. Kiu Koroziu është tipi i përsosur i burokratit që vepron në mënyrë arbitrare, i drejtuesit që ka humbur ndjenjën e së resë dhe nuk zbaton porosinë e Partisë lidhur me zhvillimin e kooperativave. Ai është dhënë në situata të tilla që ndihmojnë për të dalë në pah si duhet thelbi i tij negativ si karakter historiko-shoqëror. J. Xoxa e ka paraqitur konfliktin në thellësi dhe me vërtetësi. Autori nuk druhet të tregojë vështirësitë dhe të metat që duhet të kapërcejnë kooperativistët në luftë për zhvillimin e ekonomisë së tyre të përbashkët.

Në fillim të romanit shumica e kooperativistëve duken të topitur; të paktën janë ata që guxojnë të kritikojnë veprimet arbitrare të kryetarit, i cili ka mundur përkohësisht të paralizojë forcat e shëndosha. Kapërcimin e të metave dhe përmirësimin rrënjësor të gjendjes autori e lidh me gjallërimin e jetës së organizatës-bazë të Partisë, e cila në luftë kundër shtrembërimeve burokratike mbështetet në mendimin e masës, që asnjëherë nuk e humbi besimin në drejtësinë e vijës së Partisë. Skenat e mbrëmjes ndanë zjarrit në shtëpinë e thjeshtë të xha Likos, i cili i zbulon Adnanit, instruktorit të partisë, gjendjen e vërtetë të punëve në fshat, mënyra e të treguarit të tij plot urtësi dhe natyrshmëri, janë më të bukurat në roman.

Veprimtaria e organizatës-bazë të Partisë luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e subjektit dhe zbulimin e karakterit të Adnanit. Adnani është një komunist i ndershëm, me shpirt të pastër, që e do popullin dhe lufton me të gjitha forcat për zbatimin e vijës së Partisë dhe të masave të pushtetit. Ai i kapërcen të gjitha pengesat që i dalin dhe kurthet që i vëngre Kiu Koroziu. Në luftën e vet këmbëngulëse kundër veprimeve arbitrare dhe shkeljeve të demokracisë socialiste që vë re në Pirgan ai mbështetet fuqimisht në përkrahjen e masës; në luftë e sipër fiton përvojë dhe mëson të kuptojë më mirë metodat që përdor Kiu Koroziu për të ndrydhur mendimin dhe energjitë e kooperativistëve. Karakteri i Adnanit si

udhëheqës dhe drejtues i zoti i masave është vizatuar në mënyrë të plotë në librin e parë, kurse në librin e dytë ka dalë statik, megjithatë ai mbetet një nga heronjtë kryesorë të romanit. Ai përshkruhet në një varg situatash të realizuara, si në bisedat me Shpresën, në planet që harton për punën dhe lumturinë e njerëzve etj. Për shkak se në librin e dytë veprimi ecën rryshëm dhe lënda nuk është organizuar si duhet rreth një boshti, bie edhe interesi për Adnanin si personazh me rëndësi në roman.

Në librin e dytë, problematika e romanit zgjerohet e pasurohet në mënyrë të ndjeshme. Duke zbuluar idenë se rrënjosja e ideologjisë socialiste në ndërgjegjen e njerëzve dhe vendosja e normave socialiste në jetë arrihen përmes një lufte të gjatë e të vazhdueshme, J. Xoxa ka pasqyruar aspekte nga lufta kundër burokratizmit, kundër fesë dhe zakoneve prapanike, nga lufta për emancipimin e plotë të femrës, nga lufta e kooperativistëve për të futur kulturën në jetë etj.

Vend të rëndësishëm në roman zë Shpresa, e cila, si karakter, zbulohet kryesisht në marrëdhëniet me Yllin. Dashuria e tyre është e lidhur me punën, me dëshirën për lulëzimin e përparimin e kooperativës. Përmes kësaj vije të subjektit, autori ka arritur të tregojë edhe aspekte të tjera të jetës, si luftën për afrimin e fshatit me qytetin, zhdukjen e kontrastit midis tyre etj. Dashuria e dy të rinjve përshkruhet me ngjyra poetike. Ajo jepet në sfondin e natyrës së bukur dhe të lulëzuar. Shpesh episodet lirike e freskojnë romanin, fusin në të atmosferën e gëzuar të jetës dhe vrullin rinor. Shpresa mishëron tiparet pozitive të së resë së ditëve tona. Ajo është e lidhur me punën, me shqetësimet e kooperativistëve; në faqet e romanit Shpresa del si një luftëtare e gjallë për emancipimin e femrës dhe armike e vendosur e çdo gjëje të vjetër. Sikurse Ylli, edhe Shpresa është kundër metodave burokratike të Kiu Koroziut, mbron normat e demokracisë socialiste në jetën e kooperativës. Bota e pasur shpirtërore e Shpresës është pikturuar me ngjyra poetike tërheqëse. Por vija e subjektit që lidhet me ngjarjet e jetës së Shpresës dhe të Yllit, me marrëdhëniet e tyre të cilat sa vinë e ndërlikohen, pa u motivuar sa duhet artistikisht, vende-vende ka dalë jo bindëse. Konflikti që lind midis Shpresës, e cila kërkon ta bëjë të fejuarin me-demos traktorist, dhe Yllit që nuk pranon të ndërrojë pro-

fesion është pak i besueshëm. Këtë e thekson episodi i djegies së Yllit gjatë përpjekjeve për të shuar traktorin, gjë që tingëllon si diçka fatale. Edhe procedimi i ngjarjeve më pas si apasionimi i tepruar, deri në sentimentalizëm i Shpresës ndaj kujtimeve, rrobave dhe shtëpisë së Yllit nuk pajtohen tërësisht me konceptimin e shëndoshë ideor të jetës së pasqyruar në roman. Kontradikta që lind në ndërgjegjen e Shpresës midis dashurisë që ka për fshatin e njerëzit e tij dhe vendimit për të mos u kthyer më në fshat, gjithashtu nuk është e motivuar nga ana psikologjike. Edhe martesja e saj me Spartakun, vjen e papërgatitur në vepër dhe duket si një zgjidhje mekanike.

Romani «Juga e bardhë» i J. Xoxes ka njëthurje të ndërlikuar. Në librin e parë kompozicioni vjen më i ngjeshur, faktet gërshetohen më mirë rreth një boshti qendror. Autori është mjeshtër i përshkrimit, i dialogut dhe i karakterizimit të personazheve përmes ligjërimit popullor të figurshëm, ndonëse ndonjëherë frazeologjia popullore përdoret me tepri. Gjuha e J. Xoxes karakterizohet nga shprehje dhe fjalë të reja, që pasqyrojnë jetën dhe psikologjinë e njeriut të sotëm.

Me gjithë disa zgjatje pa vend, që hera-herës e mekin interesin e lexuesit, «Juga e bardhë» është një vepër me merita artistike. Autori rreh probleme të rëndësishme të jetës së fshatit të sotëm dhe ka krijuar një varg personazhesh me domethënie të gjerë njohëse dhe me vlerë të shquar artistike.

Me romanin «Përsëri në këmbë»
PËRSËRI NË KËMBË (1970) Dh. Xhuvani doli para lexuesit si prozator plotësisht i formuar. Ai dha kontribut me vlerë në përpjekjet e gjithë letërsisë sonë në krijimin e heroit pozitiv të kohës. Dh. Xhuvani, synon më tepër të hetojë psikologjinë e heronjve të vet, të cilët i përshkruan me imtësi të gjalla. Për nga stili, proza e tij qëndron midis prozës analitike e sintetike.

Edhe në romanin «Përsëri në këmbë» si në veprat e mëparshme të Dh. Xhuvanit, njerëzit e punës, të parë në dritën e një shndërrimi të vazhdueshëm, zënë vend qendror, por në këtë roman detyrën e formimit të cilësive të reja shpirtërore e morale tek njerëzit, autori e lidh me rrethanat e jetës së vendit pas Kongresit V të PPSH, me thellimin e luftës në frontin ideologjik, me luftën për të rrënjosur në ndërgjegjen

e njerëzve koncepte revolucionare. Kjo veçori e romanit ka gjetur shprehje në konceptimin e heroit, i cili në karakterin e vet mishëron njeriun e ri, të kalitur gjatë viteve të luftës për socializëm, por akti i tij heroik në vitet e revolucionarizimit të mëtejshëm të jetës së vendit kumboi me një aktualitet të veçantë. Jeta e heroit ka përcaktuar edhe subjektin, i cili ka formën e një spiraleje, ku çdo rreth përbën një hap drejt qëllimit të afërt, pas arritjes së të cilit nis lufta për plotësimin e një qëllimi tjetër. Hapet kështu një rreth tjetër e lëvizja vazhdon në këtë mënyrë derisa të plotësohet ajo që vepra kërkon të pohojë; njeriu ynë merr pjesë aktive në jetën socialiste dhe në këtë luftë pëson ndryshime edhe vetë. Në vepër zotëron ideja e rolit të punës në edukimin e njeriut.

Heroi kryesor Din Hyka, një vullnetar që ka marrë pjesë në ndërtimin e hekurudhave të para, pëson aksident gjatë një udhëtimi; mbetet pa këmbë. Pas kurimit në spital, kthehet në shtëpi. Bën vetë protezë, del nga rrethi i ngushtë i shtëpisë, por jeta e invalidit e mërzit, prandaj vete të kërkojë punë. Nuk kënaqet duke punuar si biletar në një sallon bilardoje, ku disa herë e mëshirojnë dhe, pasi ikën që andej, futet në punë në magazinën e një ndërmarrjeje ekonomike. Pasi vë rregull atje, arrin që pjesët e ndërrimit për automjete të hedhura në magazinë, për të cilat ndërmarrja kishte nevojë të ngutshme (është koha e bllokadës), t'i kthejë në jetë e të bëhet kështu nismëtar i një pune tepër të vlefshme për shoqërinë që e bën atë të ndihet plotësisht «brenda radhëve» të ndërtesave aktive të socializmit, në gjirin e punës ndërtimore, që vlon në të katër anët e atdheut. Në faqet e fundit të veprës Dini kthehet nga puna në shtëpi pa ndihmën e shkopit, me këmbët e veta, çka ka një kuptim simbolik. Dini ia arriti qëllimit që i kishte vënë vetes; ai u bë sërish pjesëtar aktiv dhe i vlefshëm i shoqërisë.

Dini si karakter shfaqet kryesisht përmes ndjenjave. Në plan të parë del bota e tij e brendshme, prandaj dhe në vepër vend me rëndësi zënë emocionet që ai provon, lufta e brendshme, tronditjet dhe hovet shpirtërore. Me anë të rrëfimit të thjeshtë të realizuar përmes dialogëve, dhe më pak me anë të përsiatjeve të heroit, autori ka arritur të japë tipin e gjallë të punëtorit të ditëve tona. Ai nuk është vështruar në mënyrë të njëanshme, d.m.th. vetëm në fatkeqësinë dhe vetminë e tij,

por në raport të përhershëm me jetën dhe njerëzit që ka përreth. Fatkeqësia e individit dhe jeta personale e tij, forca e karakterit dhe e vullnetit të tij si njeri i ditëve tona, lufta e brendshme e tij, kundrohën të lidhura ngushtë me qëndrimin e shoqërisë socialiste ndaj individit, me mundësitë që shoqëria i ka krijuar atij për t'i vënë vetes qëllime të larta e për t'i arritur ato, edhe kur ndodhet në rrethana të vështira jetësore. Raporti shoqëri-individ zë vend me rëndësi në faqet e librit. Lufta e heroit shkon përpara nën veprimin e ngjarjeve të jetës. Sikundër ka theksuar kritika, Dini është një dritare nëpër të cilën shohim si vlon shndërrimi dinamik i shoqërisë. Nuk është e rastit që në roman del herë pas here figura e një qyteti në rindërtim, gjithashtu nuk është e rastit që personazhe të tjera e episode të veçanta kalojnë si pa u vënë re. E para, sepse «në rindërtimin» është vetë njeriu i ditëve tona, i cili po formohet me koncepte socialiste për jetën, e dyta, sepse autorit i intereson më shumë raporti i individit me shoqërinë në tërësi e jo lidhjet e veçanta midis anëtarëve të saj. Prandaj dhe subjekti ka një vijë, atë të heroit kryesor. Personazhet e tjera janë të pranishëm në vepër aq sa lidhen me të; ata janë kalimtarë, ndonëse disa prej tyre veprojnë më shumë sesa vendi që zenë. Të tillë janë: Xhelo Partizani, malsorja vullnetare e hekurudhës, Sokrati që mishëron si personazh karakterin e burokratit, zoti Zylfi, xha Teloja, bashkudhëtarët në tren.

Romanin «Përsëri në këmbë» e përshkon fryma e humanizmit socialist, i cili shfaqet në historinë e heroit, në qëndrimin e kujdesshëm dhe plot vëmendje të shoqërisë ndaj njeriut. Sigurisht, në roman shumë vend zë përshkrimi i heroit, i cili tek mjedisi kërkon mbështetje morale, por problemi njerëzor është shkrirë aq mirë me atë shoqëror sa që fatkeqësia e heroit kalon në plan të dytë. Qëllimi i tij për të qenë plotësisht brenda radhëve të ndërtesave të jetës së re del në roman si tipar thelbësor i kohës, si synim i përhershëm i njeriut tonë të ri.

«Përsëri në këmbë» karakterizohet nga thjeshtësia e subjektiviteti, nga karakteri i qetë i konfliktit e nga dinamizmi i brendshëm. Mjetet artistike janë të kursyera dhe kjo është në pajtim me synimin për të parë lëvizjet e botës së brendshme të heroit. Vepra është e prirur për të qenë roman psikologjik-shoqëror, por nuk mungon ndonjë notë liriko-filozofike. Mjaft

imtësi marrin fuqi simbolike (vdekja e ish-partizanit Xhelo, kthimi në shtëpi pa shkop i Dinit). Gjuha e veprës është e thjeshtë, pa zbukurime stilistike, por me një farë monotonie.

«Përsëri në këmbë» qëndron në radhën e krijimeve në prozë me temë të sotme, si vepër ku është zgjidhur një problem me rëndësi i letërsisë së sotme, ai i heroit pozitiv. Din Hyka hyn me dinjitet në galerinë e heronjve pozitivë që ka krijuar letërsia jonë.

*
* *
*

Romani «Tokë e ashpër» (1971) i T. Laços bën fjalë për kolektivizimin e zonave të thella malore. Autori përshkruan vështirësitë dhe luftën këmbëngulëse të komunistëve të fshatit dhe të shokëve të ardhur nga qyteti për të ngritur kooperativën. Përpyekjet për të shkukur nga ndërjegjja e njerëzve psikologjinë e pronës private dhe për t'i edukuar ata me frymën kolektivistë, formon problemin kryesor në të cilin është drejtuar vëmendja e shkrimtarit.

Ngritjen e kooperativës autori e përshkruan si proces të vështirë dhe të mundimshëm. Përpara se të bashkojnë tokën dhe mjetet e punës, pjesës më të madhe të fshatarëve i duhet të flakë mëdyshje dhe luhatje, që e kanë burimin në mënyrën e vjetër individuale të jetesës. Në luftë me vetveten, me mentalitetin e pronarit të vogël, ata japin fjalën për të hyrë në kooperativë, duke treguar me këtë besimin e patundur që kanë të rendi socialist dhe në vijën e Partisë. Lufta për ta futur fshatin në rrugën e kolektivizimit nuk ka arenë vetëm shpirtërat e njerëzve. Në radhë të parë ajo zhvillohet kundër elementëve armiq, të cilët, duke shfrytëzuar mbeturinat e ideologjisë së vjetër në ndërjegjen e njerëzve, orvaten t'i pengojnë këta të hyjnë në kooperativë. Logjika e luftës klasore i flak këta elementë jashtë shoqërisë.

Në romanin e T. Laços krahas luftës për kolektivizimin e fshatit janë shtruar edhe probleme të tjera shoqërore, si: problemi i emancipimit të plotë të femrës dhe i ngritjes së personalitetit të saj, në luftë kundër zakoneve prapanike dhe mentalitetit mikroborgjez.

Në vepër duket njohja e mirë e jetës së fshatit, e rrethave reale në të cilat zhvillohet lufta për shndërrimin e plotë socialist të mënyrës së të punuarit dhe të jetuarit të njerëzve. Kjo i ka dhënë mundësi autorit të ndërtojë subjektin e romanit mbi një konflikt dramatik, që përcaktohet nga kontradiktat shoqërore dhe psikologjike që marrin jetë në procesin e luftës për zhvillimin e mëtejshëm të fshatit. T. Laço është përpjekur të përshkruajë dhe anë të reja të kontradiktave të jetesës së fshatit, por nuk ka arritur gjithnjë t'u japë zgjidhje origjinale konflikteve të pasqyruara në vepër dhe të hyjë në thellësi të botës së brendshme të karaktereve të paraqitura në roman. Meritë e autorit është se ka ditur të japë mjedisin fshatar me imtësitë konkrete jetësore të cilat krijojnë atmosferën e hareshme që sjell me vete puna kolektive, vështirësitë që ndeshin njerëzit në luftë për të krijuar të ardhmen e tyre të re dhe njëkohësisht gëzimin e jetës kolektive që ka nisur të ushtojë në fshat. Skenat dhe pamjet nga jeta e fshatit përshkohen nga fryma lirike.

Në romanin «Tokë e ashpër» veprojnë një varg personazhesh të realizuara nga ana artistike, midis të cilëve spikat Rizai, Kliti, Ferhati, Dania, Vera, Bidoja etj. Në karakterin e Rizait autori pikturoi tipin e bujkut që është dashuruar me tokën, të cilën e punon duke mos kursyer forcat e veta. Si bujk i mirë, ai kërkon të nxjerrë nga ajo sa më shumë prodhime, dhe, për këtë qëllim, zbaton metoda të reja në punët e bujqësisë. Por, i mësuar në mënyrën e vjetër të jetesës, Rizai nuk do të hyjë në kooperativë, ai nuk ka besim se kooperativa do ta shpëtojë fshatarin nga hallet që e kanë ndjekur gjithë jetën në shoqërinë me klasa. Autori i kushton me të drejtë mjaft vëmendje procesit të riedukimit të Rizait, i cili më në fund flak dyshimet dhe hyn në rrugën e kolektivizimit. Kalimi i heroit nga ekonomia individuale në kooperativë është përshkruar me vërtetësi, ndonëse çasti kulminant, vendimi për t'u bashkuar me shumicën e fshatit, mund të jepet përmes një analize më të thellë psikologjike.

Vend të rëndësishëm në roman zënë sekretari i Partisë, Ferhati, dhe kryetari i kooperativës, të cilët bëjnë një punë të madhe për kolektivizimin e fshatit. Përmes kësaj veprimtarie autori ka treguar luftën për të bindur njerëzit për epër-

sinë e gjithanshme të kooperativës, në krahasim me mënyrën e vjetër individuale të të jetuarit dhe të të punuarit, ndeshjen midis elementëve të përparuar me fshatarët që nuk janë çli-ruar ende nga mentaliteti prapanik, nga njera anë, dhe me armiqtë e rendit socialist, nga ana tjetër. Te Shabani autori ka treguar se ç'forma të shëmtuara ka marrë tek ky njeri ndjenja e pronës private, por në figurën e këtij personazhi ka shpëtuar ndonjë notë patologjike, çka ka zbehur thelbin e tij shoqëror.

Në subjektin e romanit një vend të mirë zë vija e Klitit, e agronomit të ardhur nga qyteti për të ndihmuar fshatarët në organizimin e punës së kooperativës, si edhe vija e Ledias dhe e Arbenit, e cila zhvillohet mbi bazën e konfliktit që lind midis tyre për shkak se ky i fundit nuk e lë të fejuarën të shkojë në fshat. Krahas kësaj vije të subjektit, merr jetë edhe një vijë tjetër, ajo e Verës dhe e Bidos. Në roman jepen peripe- citë që rrjedhin nga martesja me pahir, arratisja dhe episodi i pajtimit të Verës me të atin, Ganon.

Dy problemet e mëdha që rreh shkrimtari, kolektivizimi i fshatit dhe çështjet etiko-morale, nuk janë shkrirë në më-nyrë organike në subjektin e romanit, çka ka përcaktuar një farë shkapërderdhje të veprimit; me këtë të metë është lidhur dhe kompozicioni jo aq kompakt i romanit.

Grupi i të rinjve, të ardhur nga qyteti, është vizatuar me ngjyra romantike. Bisedat e tyre gazmore e plot sinqeritet, muzika që lot një rol të rëndësishëm në jetën e tyre, skenat e dashurisë rinore midis Ledias dhe Klitit, i japin veprës një frymë të lehtë poetike.

«Tokë e ashpër» është një roman me vlerë. Në faqet e tij është pasqyruar me vërtetësi lufta për kolektivizimin e fsha- tit malor dhe, lidhur ngushtë me këtë, lufta për rrënjosjen e ideologjisë socialiste në të gjitha sferat e jetës. Vepra është shkruar me gjuhë të zgjedhur.

Romani «Kullat» (1969) i Gj. Zheit hyn në radhën e atyre veprave që në gjurmët e ngjarjeve, trajtuan temën e emanci- pimit të femrës, të luftës kundër zakoneve prapanike, të pohimit të plotë të normave socialiste në fshatrat e zonave malore, ku mbeturinat patriarkale në jetën familjare ishin të forta. Ideja e rëndësishme shtjellohet përmes veprimit dhe përsiatjeve të autorit. Ngjarjet që përbëjnë subjektin e ro-

manit zhvillohen në fshatin Gruz. Veprimi nis me vajtjen në fshat të një ekipi, vijon me historinë e dashurisë së Majës me Xhelën, ndërpritet nga digresionet, përmes të cilave zbu- lohet jeta e rëndë e njerëzve në të kaluarën, me hasmëritë midis kullave, me zakonet e egra të kanunit, me martesat me pahir. Në fund veprimi lidhet përsëri me fillin kryesor të rrëfimit, me historinë e heroinës së romanit, të Majës dhe të marrëdhënieve të saj me të atin. Te Maja autori dha ti- pin e malësoreve të re, që është rritur dhe formuar në kushtet e jetesës socialiste. Ajo ka marrë pjesë në ndërtimin e hekur- udhës, ku ka njohur shumë shoqe dhe shokë, nga të cilët ka mësuar mjaft gjëra të reja dhe të dobishme për veten dhe për jetën e fshatit. E pasuruar me një përvojë të re, ajo kthe- het tashmë e ndryshuar në fshat, ku sjell një frymë të shë- ndoshë përparimi. Figura e kësaj vajze është vizatuar nga autori me lirizëm dhe vërtetësi. Natyra e saj e hedhur, syni- met e bukura poetike që ushqen në shpirt, historia e dhemb- shur e nënës së saj të vdekur, fati i vetë Majës, së cilës i du- het të kapërcjë shumë pengesa për të realizuar dashurinë — këto dhe imtësi të tjera të gërshetuara në mënyrë të natyr- shme në roman, e bëjnë në sytë e lexuesve Majën personazh të besueshëm. Maja është një aktiviste e dalluar shoqërore, ajo mban qëndrim aktiv ndaj luftës së ashpër që zhvillohet në jetë midis së resë dhe së vjetrës dhe me sa ka mundësi, jep kontributin e vet për zgjidhjen e problemeve të fsha- tit.

Përveç Majës në roman ka një varg personazhesh të tjera, që mishërojnë tipa të ndryshëm fshatarësh, si motra e Ma- jës, Lezja, dajë Kurti, Dedja, hallë Filja, që sillen plot dhem- shuri me të mbesën. Disa syresh janë vizatuar pak a shumë në mënyrë të plotë, kurse shumica janë personazhe episodike. Ndër ta interes në roman paraqet Xhizja, e ëma e Majës, e cila nuk pati fat në dashuri. Historia e këtyre njerëzve, vikti- cila të zakoneve prapanike, del në pah përmes paraqitjes edhe të forcave të vjetra shoqërore të fshatit, si Xhafa etj., të cilët kundërshtojnë të renë, duke nxitur meritë e vjetra midis fshatarëve dhe duke mbrojtur traditat prapanike në jetën familjare.

Interes paraqet i ati i Majës, Dan Mteshi, në fatin e të cilit autori zbuloi tragjedinë e shumë fshatarëve, të cilët, ndo-

nëse qëndronin në mbrojtje të normave të vjetra morale, ishin edhe viktimat e tyre. Dan Mteshi na shfaqet përmes qëndrimit ndaj së bijës, Majës, si dhe përmes historisë së vet jetës së tij. Për të motivuar sjelljen që mban ai ndaj vajzës së vet, autori i ka dhënë rëndësi jo vetëm përshkrimit të ndjenjave dhe të koncepteve të tij, të formuar nën ndikimin e kanunit, por edhe zbulimit të shkaqeve vetjake që kanë përcaktuar këtë qëndrim — martesës së tij të pafat me Xhizen, e cila donte një tjetër. Qëndrimi i Danit ndaj së bijës del i motivuar nga pikëpamja artistike, ai është në pajtim të plotë me karakterin dhe formimin e tij shpirtëror. Por në roman është theksuar së tepërmi egërsia e Danit, i cili në çastin e zgjidhjes së konfliktit nuk provon pothuajse asnjë brejtjeje ndër-gjegjeje për vuajtjet që i shkakton së bijës. Vetëm në fund të romanit, në ndër-gjegjen e Danit nxjerrin krye ndjenjat njerëzore. Flakja e sëpatës në pyll, zgjimi i ndjenjave atërore, çlirimi i tij nga pesha e moralit të vjetër çnjerëzor janë të përligjura. Ato flasin për ndikimin përtëritës të shoqërisë tek individit, për ngadhënjimin e humanizmit socialist dhe për zgjidhjen në rrugë të drejtë në rendin socialist të kontradiktave joantagoniste.

Stili i romanit është konciz; tiparet e tij karakteristike janë analizat psikologjike dhe fryma lirike. Përpjekjet e shkrimtarit për njëthurje tërheqëse të subjektit dhe për të përdorur një gjuhë simbolike janë në përgjithësi me vend, por, aty-këtu mjetet artistike nuk janë përligjur dhe kanë dalë artificiale (biseda e kullave, personifikimi i tyre në frymën e përrallave etj.)

Luftën kundër shfaqjeve të huaja ideologjike, sidomos kundër burokratizmit dhe konservatorizmit, ka për temë edhe romani «Zjarret» (1972) i S. Spasses. Në heroin kryesor të veprës së vet Spassja u përpoq të paraqiste karakterin e intelektualit të dalë nga gjiri i popullit dhe të formuar gjatë viteve të ndërtimit socialist. Atë e shquajnë një varg tiparësh pozitive, që janë karakteristike për të gjithë intelektualët popullorë, si: devotshmëria ndaj socializmit, ndër-gjegjja e lartë në punë, zelli i veçantë me të cilin përmbush detyrat që i ngarkohen. Por, duke mishëruar tek Kujtim Morava tipin e intelektualit të lidhur ngushtë me punën dhe me jetën e ve-

ndit, S. Spasse e drejtoi vëmendjen e vet në çështjen e revolucionarizimit të mëtejshëm të heroit, në karakterin e të cilit, sipas asaj që na njofton autori, nisën të shfaqeshin, pas mbarimit të Fakultetit të Veterinarisë dhe caktimit me punë në dikasterin e bujqësisë, disa veti negative, si: mendjemadhësia, mbivlerësimi i teorisë dhe përbuzja për njerëzit e bazës, besimi i tepruar në vetvete etj. Në këtë gjendje e gjen heroin Letra e Hapur e KQ të Partisë. Thirrja e Partisë drejtuar popullit për të zhvilluar një luftë të ashpër kundër burokratizmit dhe shfaqjeve të tjera të huaja, i jep shkas heroit të shqyrtojë me sy kritik sjelljen dhe qëndrimet e tij në jetë. Autori e çon heroin në fshat me qëllim që kontakti i gjallë me jetën, me masat t'i zhdukë të metat. Në roman tregohen vështirësitë që iu deshën Kujtimit t'i kapërcejë në luftë për të çuar përpara ekonominë e kooperativës së Marikajt. Ai ndeshet me paragjykimet e vjetra shoqërore, që pengojnë fshatarët të vënë të gjitha forcat për përparimin e kooperativës, ndeshet me ndikimin e zakoneve prapanike dhe të fesë, me prirjen e një pjese të fshatarëve për t'u kënaqur më pak. Në luftë për të zhdukur këto të meta që pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të kooperativës, heroi hedh tej shfaqjet intelektualiste, lidhet ngushtë me fshatarët, nga përvoja e të cilëve përpiqet të përfitojë sa më tepër, bëhet më modest në jetë. Sa më tepër kridhet në punë për zgjidhjen e problemeve të kooperativës, sa më afër njihet me malësorët, aq më qartë sheh të metat e veta të dikurshme. Lidhur me këtë rëndësi merr në faqet e romanit mjeti i refleksionit, që i shërben autorit për të treguar ndryshimet që ngjasin në ndër-gjegjen e heroit.

Por rëndësia e romanit të S. Spasses qëndron jo aq në pasqyrimin e procesit të riedukimit të heroit, sesa në paraqitjen e jetës së një kooperative malore, të kontradiktave dhe të konflikteve që përshkojnë fshatin në mesin e viteve 60, të përpjekjeve që bëjnë njerëzit për të kapërcyer pengesat që u dalin. Vend të rëndësishëm në roman zënë rrugën e përparimit dhe të lulëzimit të gjithanshëm dhe në këtë luftë tërheqin pas vetes masën e fshatarëve, të cilët nuk janë çliruar plotësisht nga mbeturinat e mentalitetit të vjetër. Në tipin e

Zogës autori dha fshataren e emancipuar, që lufton me guxim dhe vullnet të pathyer për rrënjosjen e koncepteve dhe të normave socialiste në jetën e fshatit. Zoga përfaqëson njeriun me karakter të fortë dhe energjik, që i është kushtuar tërësisht çështjes së zhvillimit të fshatit. Si e tillë ajo është dhënë e formuar. Për procesin e brumosjes revolucionare të saj lexuesi merr vesh aty-këtu nga tregimet e fshatarëve për të kaluarën e jetës së tyre. Veçori dalluese e Zogës është besnikëria ndaj çështjes së Partisë, urrejta e thellë për armiqtë e fshatarësisë së varfër dhe në përgjithësi për botën e vjetër të kanunit dhe të obskurantizmit fetar, dashuria e madhe që ushqen për bashkëfshatarët, të cilët i ndihmon me të gjitha forcat të shkëputen nga mentaliteti i vjetër patriarkal dhe mikroborgjez.

Vendosmërinë e fshatarëve për të ecur përpara me hapa të shpejtë në rrugën e përparimit dhe të zhvillimit të kooperativës, autori e tregoi edhe përmes një vargu personazhesh të tjera, në karakterin e të cilëve u mishëruan tiparet e njeriut të ri të fshatit malor.

Në subjektin e romanit vendin kryesor e zënë aksionet e ndryshme, të cilat jepen në renditjen e tyre kohore. Pothuaj të gjitha figurat e elementëve përparimtarë vizatohen në lidhje me përpjekjet e përgjithshme që bëhen për të nxjerrë kooperativën nga prapambetja. Kjo ka bërë që në karakteret e heronjve në plan të parë të dalë e përbashkëta dhe më pak veçoritë e tyre individuale. Ndryshe qëndron puna me personazhet e tjera, sidomos me përfaqësuesit e brezit të fshatarëve të vjetër dhe të atyre që nuk kanë besim ndaj rendit të ri; në përshkrimin e figurave të këtyre personazheve autori ka mundur të gjejë viza më individuale.

Forcimi i socializmit në fshatin malor arrihet përmes luftës së ashpër klasore, sepse përfaqësuesit e botës së vjetër bëjnë çmos për të mbrojtur interesat e tyre. Patër Gjoni dhe bashkëpunëtorët e tij, në fillim përpiqen fshehurazi të pengojnë ngadhënjimin e plotë të jetës së re, por, kur e shohin se po u vjen fundi, tërbohen dhe hidhen në veprime armiqësore të hapura, duke u orvatur të vrasin elementët përparimtarë të fshatit. Me patër Gjonin S. Spasse tregoi rolin e shëmtuar të klerit katolik, i cili gjithë jetën ishte përpjekur të

mbante fshatarët në terr. Në veprimtarinë e vet kundër rendit të ri patër Gjoni ka përkrahjen e fshatarëve me paragjykime të vjetra shoqërore dhe ideologjike, si Leç Kabashi dhe Ndoc Gjon Prela.

5

Veprat më të mira të prozës së kësaj periudhe nxorën me të drejtë në plan të parë dukuritë pozitive tipike të realitetit socialist. Po krahas kësaj, u shkruan dhe vepra, në të cilat u fshikulluan shfaqjet e huaja në jetë dhe në ndërgjegjen e njerëzve. Në këto vite mbisunduan llojet e shkurtra, tregimi dhe skica satirike. Shkrimet më të mira demaskojnë burokratizmin («Një ëndërr e prapambetur» e Q. Buxhelit, «Një ditë pune e shefit tim» dhe «Për një pëllëmbë çarçaf» të M. Kallamatës). Autorët synuan të tregonin se burokratizmi, si shfaqje e huaj, pengon zhvillimin e iniciativës dhe të mendimit krijues të masës. Por shpesh kritika e shfaqjeve burokratike ishte e përciptë, forca artistike e veprave e mekët. Vend të rëndësishëm në prozën satirike zuri demaskimi i traditave dhe i zakoneve prapanike që pengonin emancipimin e plotë të gruas dhe luftën për rrënjosjen e normave socialiste në jetën familjare. Interesimi për këto tema u përcaktua nga lufta që bënte gjithë shoqëria për të shkukur mbeturinat e patriarkalizmit dhe të moralit të shoqërisë çifligaro-borgjeze. Në tregimet «Buall i kënetës» (1969) dhe «Fotografia e gjyshit» (1971) të M. Kallamatës efekti komik rrjedh nga pozita qesharake në të cilën bien bartësit e ideologjisë së vjetër kur zbulohen orvatjet e tyre të kota për të mbrojtur traditat dhe konceptet prapanike. Në tregimet «Një ndodhi në plazh» (1962) dhe «Nihilisti» (1969), Q. Buxheli bëri objekt të satirës ata tipa që përulën përpara lustrës së jashtme të kulturës borata tipa që nënvleftësojnë çdo gjë që lidhet me traditat dhe gjeze dhe nënvleftësojnë çdo gjë që lidhet me traditat dhe vlerat kombëtare. Ideja kryesore e tregimit «Njeriu që ndal kohën» (1969) i po këtij autori është fshikullimi i qëndrimit të huaj mikroborgjez ndaj pronës së përbashkët.

Element i ri në zhvillimin e prozës satirike është shfaqja e romanit. Në këtë periudhë botohen disa romane si «Fshati midis ujërave» i K. Jakovës, «Karriera e zotit Maksut» i Q. Buxhelit, «I fundit i oxhakut» i M. Kallamatës.

Në romanin «Fshati midis ujërave» (1972) stigmatizohet aparati i shtetit reaksionar të Zogut. Duke përdorur episode dhe imtësi të goditura, K. Jakova jep me ngjyra të gjalla satirike jetën dhe veprimtarinë e nëpunësve dhe të oficerëve të regjimit, tiparet e tyre karakteristike si egërsinë, parazitizmin, interesimin për leverdinë vetjake, të gjitha këto të gërshtuara me vetëkënaqësinë dhe kapadailëkun. Autori vizatoi disa karaktere satirike. Nga përfaqësuesit e nëpunësve të regjimit antipopullor vend të gjerë në roman zë toger Myftar Selimi. Rrethkomandanti i xhandarmërisë mishëron me qartësi të madhe frymën obskurantiste dhe reaksionare të regjimit zogist, interesat e të cilit i mbron me besnikëri dhe fanatizëm të verbër. Si vegël e bindur e regjimit, ai ushqen një urrejtje të thellë ndaj fshatarëve, të cilët i shikon si kafshë dhe shtyp me egërsi shfaqjet më të vogla të pakënaqësisë së popullit. Për të nënshtruar bujqit e Gurëshoshës së Vogël ai përdor të gjitha mjetet, nga lajkat dhe intrigat e deri tek dajaku. Dëshira për të mbajtur sa më të shtrënguar litarin në fyt të popullit, bashkohet tek ai me pasionin për të fituar pasuri. Në vizatimin e kësaj figure autori ka ndjekur parimin e theksimit të këtij pasioni deri në atë pikë që zbulon në mënyrë sa më të plotë shëmtinë morale e shpirtërore të bartësit të tij. Historia pa sukses e kërkimit të qypave me florinj, që sipas legjendës qëndronin të fshehur prej shekujsh diku në pyll, dhe sidomos rrahja publike e fshatarëve, si hakmarrje për rrengun e kurdisur, nxjerr në pah me qartësi të veçantë fizionominë e rrethkomandantit, në karakterin e të cilit është shprehur në mënyrë të përqëndruar psikologjia dhe morali i mbrojtësve të regjimit çifligaro-borgjez. Në roman ka episode satirike, që zbulojnë me gjallëri fytyrën e vërtetë të regjimit të kohës si regjim që e kishte zhveshur popullin nga të drejtat më elementare, duke e lënë fatin e tij në duart e xhandarëve injorantë dhe mizorë që për hiç gjë merrnin nëpër këmbë nderin dhe dinjitetin e njerëzve. Autori e ka pikturuar rrethkomandantin jo vetëm si shtypës të pashpirt të masave punonjëse, por edhe mendjetrashë dhe pa kulturë. Në pjesën më të madhe veprimi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të vërë në dukje se përfaqësuesit e aparatit shtypës të Zogut ishin një hiç nga pikëpamja intelektuale. Skenat humoristike të romanit vënë në dukje epërsinë mendore të fshatarëve mbi

rrethkomandantin. Në duelin që zhvillohet midis tij dhe banorëve të Gurëshoshës së Vogël në pikëpamje morale dalin ngadhënjimtarë këta të fundit.

Si mbrojtës i regjimit të egër dhe obskurantist, karakteri i rrethkomandantit plotësohet edhe nga personazhe të tjera, përfaqësues të aparatit shtypës së Zogut, si Taf Kapia, tagërmbledhësi etj., në karakterin e të cilëve autori ka mishëruar gjithë shëmtinë morale dhe shpirtërore të regjimit në fuqi, thelbin e tij antipopullor.

Vëmendje të madhe shkrimtari i ka kushtuar pasqyrimin të halleve dhe të brengave të fshatarëve, dëshirës së ligjshme të tyre për të rrojtur të lirë dhe të lumtur, ndjenjës së solidaritetit që zhvillohet tek ta në luftë kundër armikut të përbashkët që do t'u rrëmbejë tokat. Në kushtet kur nuk gëzojnë asnjë të drejtë, arma së cilës ata i drejtohen shpesh për të demaskuar veprimet arbitrare, janë shpotitë therëse. Për t'u hakmarrë për padrejtësitë që u bëhen, fshatarët u punojnë lloj-lloj rrengje nëpunësve dhe elementëve reaksionarë të fshatit.

Mendjemprehtësia dhe shpirti praktik i masës është treguar përmes karakterit të Preng Sherrit, i cili në një farë mënyre mund të merret si personazhi qendror i romanit. Sa herë që fshatit i kanosej ndonjë e keqe, Preng Sherri gjen rrugëdalje të sugjeruar nga zgjuarsia popullore që e fut në punë për të mbrojtur fshatarët nga veprimet arbitrare dhe planet e fshehta të Taf Kapisë, toger Tares dhe armiqve të tjerë të Gurëshoshës së Vogël. Në skenat ku ai shfaqet si lejtërë të Gurëshoshës së Vogël. Në skenat kundër shtypësve dhe shfrytëzuesve të fshatarësisë, duke përdorur mjete të marra nga arsenal i shakave popullore, Preng Sherri si personazh ka vërtetësi psikologjike, por në ato faqe ku nis të lozë rolin e organizatorit të masave, që i ka të qarta qëllimet dhe rrugët e çlirimit të fshatarësisë nga zgjedha çifligaro-borgjeze, ai bëhet i pabesueshëm.

Mjeshtëria e K. Jakovës u shpreh në përshkrimin e jetës së fshatit, në episodet plot humor spontan ku vihet në lojë rrethkomandanti, xhandarët, pasaniku i fshatit, Vyk Shyti, prifti etj.; autori përdori shprehje dhe mjete humoristike të zakonshme e ndonjëherë banale. Në faqet e fundit zhvillimi i veprimit të romanit del i pamotivuar. Megjithatë, i marrë në

përgjithësi, romani «Fshati midis ujërave» flet për pjekurinë që ka nisur të fitojë proza jonë satirike.

Për periudhën e monarkisë çifligaro-borgjeze rrëfen edhe romani «**Karriera e Zotit Maksut**» (1971) i Q. Buxhelit, Shkrimtari ka dhënë një pamje satirike të veprimtarisë së aparatit administrativ, ka treguar mediokritetin, ngathtësinë mendore dhe arbitraritetin e nëpunësve, të cilët kanë vetëm një preokupim, si të bëjnë karrierë. Për t'u ngjitur sa më lart në shkallën administrative, ata bëhen puthadorë të neveritshëm të regjimit reaksionar, pranojnë t'u marrin nëpër këmbë dinjitetin dhe nderin. I tillë është «heroi» i romanit, Maksut Ramo, kryetar i komunës së Tarinës, që rron me ëndërrën e tij për të bërë karrierë diplomatike, gjë që kërkon ta arrijë, duke ua bërë qejfin eprorëve të vet. Autori ka përdorur gjerësisht hiperbolën dhe konvencionin. Vetë historia që çon përpara veprimin — ardhja në komunë e dy aventurierëve në vend të historianit të huaj, që ishte ngarkuar për të mbledhur të dhëna për biografinë e xhaxhait të mbretit dhe të gjitha episodet e lidhura me këtë ngjarje — kanë në një farë shkalle karakter konvencional. Përmes një vargu skenash dhe situatash të stërmadhuara zbulohet thelbi antipopullor dhe reaksionar i aparatit administrativ, parazitizmi dhe ngushtësia mendore e nëpunësve të qeverisë, amullia në të cilën dremiste vendi gjatë regjimit çifligaro-borgjez. Por autori nuk ka përdorur gjithnjë me vend mjetet artistike që ka zgjedhur; hiperbolizimi i tepruar ka çuar në atë që disa episode të dalin të kërkuara dhe forca satirike të jetë e mekët.

Siç shihet, autorët satirikë iu drejtuan së kaluarës së popullit. Veprat e formës së madhe epike kushtuar pasqyrit të dukurive negative të jetës së sotme, ende nuk kanë zënë vendin e duhur në prozën satirike. Përpjekjet e para në këtë drejtim nuk qenë gjithnjë me sukses, për shkak se nuk u tregua me qartësi perspektiva e jetës dhe lufta e forcave të shëndosha të shoqërisë socialiste kundër bartësve të së keqes («Kur qesh tërë qyteti»).

DRAMA

Ashtu si llojet e tjera letrare, edhe drama bëri hapa të rëndësishëm përpara. Karakteristikë për dramaturgjinë e kësaj periudhe është forcimi i saj i mëtejshëm në pozitë e realizmit socialist. Pjesa më e madhe e shkrimtarëve që punojnë në këtë fushë iu rreshtën në veprat e tyre ndikimeve sentimentaliste e melodramatike, që haseshin jo rrallë në dramën e periudhës së mëparshme. Ata arritën të krijojnë karaktere të gjalla e plot vërtetësi, që në mendimet dhe synimet e tyre shprehin veçori thelbësore të jetës së shoqërisë. Forcimi i mëtejshëm i pasqyrit realist në dramë erdhi si rezultat i ngritjes së nivelit ideor dhe artistik të krijuesve, i njohjes më të thellë të konflikteve të vërteta të jetës dhe i zotërimit më të mirë të mjeshtërisë artistike.

Veprat më të mira në dramë i përshkon fryma e mprehtë e aktualitetit. Paraqitja e luftës kundër mbeturinave të ideologjive të vjetra të patriarkalizmit dhe kundër ndikimeve të fesë, paraqitja e luftës kundër shfaqjeve të ideologjisë borgjeze dhe revizioniste, pasqyrimi i hovit që mori jeta shoqërore në vitet e thellimit të mëtejshëm të revolucionit ideologjik e kulturor dhe i atmosferës së shëndoshë ideologjike e morale, në të cilën po rritet dhe formohet njeriu ynë i ri, formon përmbajtjen e veprave më të mira të dramaturgjisë. Në betejat e masave për të siguruar ngadhënjimin e plotë të ideologjisë socialiste dhe zhvillimin e pandalshëm të shoqërisë socialiste drejt caqesh të reja i morën temat e tyre dramaturgët.

Dramaturgjia e kësaj periudhe ishte e larmishme. Krahas dramës familjare-shoqërore u lëvrua drama shoqërore-politike. Dukuri e re në këtë fushë të krijimtarisë letrare është drama, e cila duke vënë në themel të subjektit ngjarje të mprehta shoqërore, u përpoq që t'u bënte jehonë të menjëhershme kërkesave të kohës. Pasqyrimi i konflikteve, që mirr-

nin shkas nga lufta kundër patriarkalizmit dhe koncepteve të huaja ideologjike, i dha dramës së kësaj periudhe karakter më të spikatur epik. Forcimi i elementeve epike në dramë erdhi si rrjedhim i përpjekjeve për ta rrokur jetën në mënyrë sa më të plotë, i shtrimit të problemeve të mprehta klasore, i synimit të autorëve për ta lidhur heroin me masën, e cila hyn në skenë si një forcë aktive. Komedia, ndonëse nuk pati ndonjë zhvillim të madh, u përpoq të fshikullonte ashpër ato shfaqje që pengonin rënjosjen e plotë të koncepteve dhe të marrëdhënieve socialiste në jetë. Gjithashtu, pasurimi në përmbajtje i dramës solli një larmi formash e stilesh dhe ndihmoi në shfaqjen më të plotë të prirjeve artistike të dramaturgëve. Në dramat e L. Papës vërejmë një kundrim poetiko-filozofik të realitetit dhe një mbështetje të shëndoshë në truallin kombëtar. Komeditë e S. Çomorës shquhen për saktësinë dhe elegancën e gjuhës, për humorin e hollë që buron nga situatat e vizatuara me mjeshtëri. Duke ruajtur secili individualitetin e vet, D. Agolli dhe N. Prifti dallohen për atmosferën e gjallë të jetës që sjellin me veprat e tyre, për koloritin kombëtar që spikat në gjuhë dhe në transmetimin në skenë të mendimit dhe të humorit popullor, në krijimin e situatave, të cilat, ndonëse përshkohen nga një dramatikizëm i fortë, zhvillohen në mënyrë të qetë, pa gjëra të befasishme.

Në dramat e kësaj periudhe u vunë re edhe elemente të reja të formës, siç qenë përdorimi i digresioneve dhe i retrospektivës, përdorimi i korit si element funksional etj.

Zhvillimi i dramës në këtë periudhë u karakterizua nga lufta e ashpër kundër ndikimeve të huaja që u shfaqën në krijimtarinë letrare si rezultat i presionit të letërsisë dhe të artit borgjez dhe revizionist. Në mesin e viteve 60 u botuan disa drama, të përshkuara nga fryma e huaj ideore. Një nga shfaqjet e gabuara ishte nxirja e realitetit socialist, paraqitja e njerëzve tanë si egoistë, pa qëllime të larta në jetë, që shikojnë në radhë të parë interesin e tyre, që u mungon fryma e solidaritetit dhe shpirti i sakrificës për të mirën e përgjithshme dhe për njëri-tjetrin. Këto ndikime u përhapën me teorizime të gabuara për një «realizëm të gjerë», për nevojën e një lufte të ngutshme kundër «shabllonizmit dhe skematizmit» që gjoja pengonin përparimin e dramës sonë etj. Konceptet dhe shfaqjet e huaja u dënuan me forcë nga Ple-

numi XV i KQ të PPSH, i cili porositi krijuesit të shtojnë kujdesin për pastërtinë ideore të krijimtarisë letrare.

Dramaturgjisë sonë dëm të ndjeshëm i shkaktoi sidomos veprimtaria antiparti, antisocialiste dhe antikombëtare e F. Paçramit dhe e pasuesve të tij, të cilët u përpoqën të përhapnin tek njerëzit e artit dhe të letërsisë frymën e nënshtrimit ndaj letërsisë dekadente borgjeze dhe revizioniste, t'u hapnin dyert ideve dhe motiveve të huaja për artin tonë. Heroit pozitiv, luftëtarit për lumturinë e popullit, ata i kundërvunë një hero të lëkundur, me shpirt të dyzuar, plot dyshime dhe brejtje ndërgjegjeje. Duke u bërë thirrje dramaturgëve për të lënë mënjane konfliktin midis nesh dhe armiqve dhe për të pasqyruar konfliktet «midis nesh», armiku i Partisë F. Paçrami synoi ta shtynte letërsinë në rrugën e errësimit të realitetit socialist. Kështu, u krijuan jo pa qëllim keqkuptime e qëndrime të gabuara lidhur me kontradiktat. Kontradiktat joantagoniste u ngatërruan me ato antagoniste. Sipas F. Paçramit dhe pasuesve të tij, drama jonë duhet të merrej me kontradiktat joantagoniste, të cilat, sipas tyre, duhej të trajtoheshin si antagoniste. Përpjekjeve të ligjshme të shkrimtarëve të sotëm për të kërkuar mënyra të reja për të pasqyruar pasurinë dhe dinamikën e jetës socialiste, armiqtë e Partisë u munduan t'ua ndryshonin udhën e t'i drejtonin në rrugën e pseudonovatorizmit. Nën ndikimin e teorizimeve të gabuara në disa drama u hoq dorë nga vizatimi i plotë realist i personazheve, nga ndërtimi i veprimit dramatik mbi një konflikt jetësor, nga zhvillimi i motivuar i konfliktit. Në këtë mënyrë u hap rruga e pasqyrimin të njëanshëm subjektivit të jetës, u absolutizuan format konvencionale, gjë që çoi në shtrembërimin e së vërtetës së jetës, në emër gjoja të shprehjes sa më të gjerë të ndeshjes së ideve. Edhe gjuha, si mjet i rëndësishëm individualizues, u shndërrua në një të folur të thatë, pa jetë, intelektualiste dhe abstrakte. Copëzimi i veprimit dramatik e dëmtoi kompozicionin e disa dramave, i ktheu ato në një grumbull episodesh të shkëputura.

Teorizime të gabuara pati lidhur dhe me komedinë, sidomos për problemin e pasqyrimin në të të kontradiktave të realitetit socialist. Në ndonjë vepër që trajtonte problemin e luftës kundër shfaqjeve të burokratizmit, kontradiktat joantagoniste u trajtuan si antagoniste dhe zgjidhja e tyre u la

në mes, sepse rëndësi gjoja në krijimtari ka «shtrimi i kontradiktës dhe jo zgjidhja».

Elementët liberalë futën konfuzion edhe lidhur me heroin pozitiv. Sipas teorizimeve të tyre specifika e komedisë e përjashton praninë e heroit pozitiv. Heroi pozitiv në komedinë tonë të re është një personazh real që vepron e lufton për fitoren e së resë, të asaj që është përparimtare. Ai sjell frymën e shëndoshë të opinionit të përparuar shoqëror, optimizmin e jetës socialiste; si bartës i së resë, ai i kundërvihet së vjetrës dhe fiton mbi të. Ky personazh lidhet me karakterin pohues të komedisë, i cili buron nga vetë realiteti, ku e reja ndeshet me të vjetrën dhe ngadhënjën mbi të.

Drama e kësaj periudhe në përgjithësi u zhvillua drejt. Shkrimtarët, duke u mbështetur në realizimet më të mira të dramës së mëparshme, vijuan të ecin në rrugën e treguar nga Partia, duke dhënë kështu vepra me dinjitet artistik, që e pasuruan dramaturgjinë tonë të realizmit socialist.

1

Vend të madh në dramaturgjinë e kësaj periudhe zuri tema e jetës së sotme, lufta e njerëzve tanë për ngadhënjimin e plotë të normave të moralit socialist në të gjitha sferat e jetës («Cuca e maleve» e L. Papës. «Flakë në shtëpi» e Z. Cikullit etj.).

CUCA E MALEVE

«Cuca e maleve» (1967) e L. Papës është një nga dramat që pasqyroi me forcë artistike luftën për çlirimin e gruas. Por vepra nuk kufizohet me këtë problem; vend kryesor në të zuri ndeshja midis forcave të vjetra të malësisë, mbeturinave të klasave shfrytëzuese, dhe rendit socialist që forconte çdo ditë e më shumë pozitën e veta edhe në zonat e thella malore. Kjo luftë zhvillohet midis popullit dhe përfaqësuesve të klasave shfrytëzuese. Të grumbulluara në organizatat terroriste, forcat reaksionare të cilat në të kaluarën kishin shtypur dhe shfrytëzuar me egërsi vegjëlinë malësore, pas Çlirimit bënë çmos për të mbajtur njerëzit larg jetës së re. Në krye të bandave terroriste janë ish-pronarë tokash, të cilët

orvaten me çdo mjet për të rifituar pozitën e humbura. «Ne do të kthehemi prapë në trojet tona»¹, — thotë njeri syresh. Armiqtë L. Papa i vizaton me ironi; duke gjetur imtësi mjaft shprehëse, ai tregon se këta njerëz, për të arritur qëllimin e tyre bëjnë çmos, përdorin të gjitha mënyrat, nga shpifjet e deri tek vrasjet. Në luftën e tyre kundër socializmit forcat e vjetra të malësisë shfrytëzojnë kanunin dhe fenën. Duke ditur autoritetin e madh të pushtetit në masat, armiqtë nuk guxojnë të shpallin hapur qëllimet e tyre politike, por fshihen pas kanunit; ata e shpallin veten si mbrojtës të zakoneve të malësisë, sepse si thotë ish-pronari, Nikë Kacori «zakoni mund të jetë kurthi më i mirë për me i futë në lak fshatarët»². Ndër të parët që bie në këtë kurth është Pali, vëllai i Cucës, njeri i ndershëm, por i verbuar nga zakonet e vjetra, të cilat e pengojnë të shohë agimin e jetës së re në malësi. Dyluftimi që zhvillohet në ndërgjegjen e tij, zbulon dramën e njeriut të ndershëm, skllav i normave të vjetra morale. Nën ndikimin e fjalës së Partisë besimi i tij në drejtësinë e normave patriarkale nis e tronditet çdo ditë e më shumë dhe, më në fund, ai e kupton të vërtetën e jetës.

Në luftën e saj për të futur në ndërgjegjen e njerëzve koncepte të reja, Cuca gjen mbështetjen e të rejave fshatare, të etura për dije, ka në anën e vet të riun komunist Fizin, i cili e përkrah dhe e do atë. Cuca mundi të fitonte mbi predikimet e Don Markut, i cili mashtronte malësorët në interes të forcave reaksionare, në sajë të përkrahjes që i dhanë elementët përparimtarë të fshatit.

Meritë e dramës «Cuca e maleve» është pasqyrimi me vërtetësi i karaktereve të personazheve. Cuca përfaqëson të rrenë, të dalë nga gjiri i popullit, që lufton me frymë të përpur për idealet e Partisë. E mallkuar që në lindje nga njerëzit e fesë, të cilët i kishin caktuar si fat ose të bëhej murgeshë, ose të martohej me një njeri me të cilin e kanë fejuar që në djep, por nuk e njeh. Cuca lind sërish pas Çlirimit. Përmbysja e madhe që solli revolucionin popullor hapi shtigje të reja për këtë vajzë me karakter të fortë. Si përfaqësuese e malë-

1) L. Papa, Drama, Tiranë 1971, f. 34.

2) Po aty, f. 19.

Autori e shtroi drejt problemin e gruas malësore që nuk gëzon asnjë të drejtë në familjen e burrit, por nuk e zgjidhi drejt. Fitorja e heroinës nuk vjen si rezultat i zhvillimit të natyrshëm të veprimit. Heroina nuk gjen në veten e saj forca për të luftuar kundër opinionit konservator. Shtysën për të luftuar për çlirimin e vet do t'ia japë Zana, e cila me she-mbullin e saj e nxit që të ngrejë krye kundër zakoneve të vje-tra. Duke i njohur heroinës të drejtën të zërë vendin që i përket si anëtare e barabartë e familjes vetëm në qoftë se arrin të marrë nishan si burrat, autori pranon një zgjidhje të problemit të emancipimit të femrës që nuk del tërësisht nga kuadri i moralit të vjetër. Këputja e perit që zgjidh konfliktin në dramë, është një truk artificial për të justifikuar kthesën e Gjeloshit.

Në dramën «Shtëpia në rrugicë» e T. Laços (dramë 1971) rrihet problemi i luftës kundër patriarkalizmit dhe zakoneve poshtëruese për gruan. Ngjarja zhvillohet në një familje qy-tetare mikroborgjeze në të cilën sundojnë mënyra e vjetër e jetesës, konceptet konservatore për gruan dhe për rolin e saj në shoqëri. Veçoritë e këtij mjedisi janë mishëruar te Ollga, bartëse e moralit mikroborgjez; ajo është ruajtëse fanatike e traditave të vjetra, e jetës së ngushtë mikroborgjeze në të cilën siç thotë ajo, «nuk ta turbullonte gjakun njeri. Vinte mbrëmja, mbyllje portën tënde dhe nuk merakosesh me se ç'bëhej përtej portës!». Këtij mjedisi mikroborgjez, që rron me thashetheme, intriga, pazarllëqe e shkuesira, i kundër-vihet morali i shëndoshë i njerëzve tanë, i punëtorit Luan dhe i gruas së tij, Shpresa, si dhe i Artanit, mësuesi i ri. Në ndeshjen e dy botëkuptimeve triumfon e reja. Rajmonda, vaj-za e Ollgës, kundërshton fejesën me shkuesi që duan t'i impo-nojnë prindërit dhe shkon pas njeriut që dashuron. Autori është përpjekur ta motivojë këtë zgjidhje që vjen si rezultat, nga njëra anë, i ndikimit të opinionit të ri shoqëror që po depërton edhe në këtë shtëpi, duke bërë për vete Rajmondën, dhe, nga ana tjetër, si rezultat i vetë përmbysjes që ka ndo-dhur në shoqërinë tonë, i grushteve të rënda që iu dhanë zakoneve prapanike. Në dramë mjedisi mikroborgjez është përshkruar me ngjyra të gjalla. Personazhi më i goditur është Ollga, ndërsa i shoqi Andrea, intelektual me origjinë nga një familje e varfër, është kontradiktor në mendimet e veprimet

e tij. Kjo ka bërë që si tip ai të dalë i papërcaktuar. Figurat e personazheve pozitive janë të zbehta, fjalët e tyre tingë-llojnë ndonjëherë si deklarata.

*
* * *

Në vitet 60-70 u shkruan një sërë dramash nga jeta dhe lufta e punëtorëve kundër burokratizmit dhe konserva-torizmit. Autorët e këtyre dramave bënë përpjekje për të dhënë me vërtetësi konfliktet që zhvillohen në gjirin e kla-sës punëtore. Ndër veprat që synuan të paraqesin më thellë e me intësi të goditur botën e brendshme të njerëzve të punës është drama «Mbas dy vjetësh» (1969) e Dh. Xhuvanit, ku tipi i punëtorit pasqyrohet në mënyrë të plotë, si në jetën e tij intime ashtu dhe në marrëdhënie me të tjerët. Heroi i dramës, Ademi, traktorist, ka koncepte mikroborgjeze për pronën e për gruan, karakteristikë për fshatarësinë individuale nga ra-dhët e së cilës vjen. Shokët e tij të punës luftojnë për ta bërë Ademin punëtor të vërtetë, punëtor, në mendime e në ndjenja, por ky e ka të vështirë të bëjë menjëherë kthesën. Autori e vë heroin në përpjekje me shokët, me gruan, me vetveten e na tregon se si në këtë ndeshje dalin në pah me qartësi koncep-tet e tij të gabuara për jetën, për veten dhe për shoqërinë.

Tema e klasës punëtore, sidomos e heroizmit të saj, u traj-tua në disa drama dokumentare, autorët e të cilave, duke iu përgjigjur flakë për flakë realitetit, fiksuan fakte dhe ngjarje reale («Heronjtë e Linasit» e S. Pitarkës, «Lavdi ushtarit» e K. Jakovës etj.). Në këto drama u pasqyrua sakrificat e lartë që kryejnë heronjtë për interesin e përgjithshëm. Jeta e kaluar e heroit, rruga e formimit dhe e zhvillimit të ndër-gjegjes së tij dhe ngjarje të tjera nga biografia vetëm sa për-menden ose mbeten jashtë kuadrit të veprimit, çka në një farë shkalle ngushtoi sferën e veprimit dhe nuk dha mundësi për përgjithësime të gjera artistike. Vizatimi i zbehtë i heronjve, dialogu i papunuar e deklarativ, mungesa e një subjekti or-ganik janë arsytet që disa nga këto vepra patën jetë të shkur-tër në skenat e teatrove të vendit.

Tema e dramës «Flakë në shtëpi» (1968) e Z. Cikilit është

lufta kundër burokratizmit dhe egoizmit mikroborgjez. Ahmeti, drejtor ndërmarrjeje, duke u nisur nga dëshira për të nxjerrë sa më shumë përfitime personale dhe duke mos përfillur kërkesat dhe shëndetin e punëtorëve, e ka dëmtuar punën dhe ka komprometuar emrin e ndërmarrjes. Duke rendur pas shifrave të planit, ai la mënjanë cilësinë e prodhimit, gjë që sjell shumë anomali në prodhim dhe në jetën e ndërmarrjes. Këto gabime flasin se Ahmeti ka nisur të largohet nga morali proletar. Pikëpamje të huaja për moralin tonë vihen re edhe te Astriti, mjek i ri, i cili përpiqet të nxjerrë sa më shumë përfitime nga profesioni i tij, duke shpërdoruar besimin e të sëmurëve. Këto dy qëndrime të huaja në shoqërinë tonë, shpërblimet që merr Ahmeti në rrugë jo të drejtë në fabrikë dhe fitimet që bën Astriti në kurriz të të sëmurëve, bashkohen diku ato, siç thotë Flutura, bija e Ahmetit — bashkohen «atje ku fillon dyshimi për fitoret tona»¹. Konflikti midis bartësve të mbeturinave të moralit të vjetër dhe kolektivit të shëndoshë punëtor shtrihet dhe në familjen e vetë Ahmetit, kundër të cilit ngrihet Flutura. Ndeshja atë e bijë nis atëhere kur Flutura sheh se i ati po largohet çdo ditë e më shumë nga ideali për të cilin kishte luftuar si partizan. Këtë konflikt autori e sheh si konflikt, të lindur nga kontradikta joantagoniste. Ahmeti tronditet nga kritikata e shokëve, sidomos të së bijës, dhe nis të mendojë për gabimet e tij. Shokët dhe e bija e konsiderojnë atë si njeri që ka gabuar dhe prandaj përpiqen ta shpëtojnë. Kurse konflikti i dytë, konflikti midis Fluturës dhe Astritit, merr karakter të mprehtë, që përfundon me prishjen e familjes së tyre. Flutura dashuron Astritin, sepse kujtonte se edhe ai, sikurse ajo, ushqente dëshirën për të ushtruar sa më denjësisht profesionin humanitar të mjekut. Por, kur e njeh nga afër Astritin, zbulon tek ai anë negative, si: mendjemadhësinë dhe lakminë për fitime, me të cilat s'mund të pajtohet, vëren një mospërputhje midis sjelljeve e veprave të tij. Por ajo që e hidhëron më fort është qëndrimi prej pronari që Astriti mban ndaj saj. Pasi bindet se rruga e saj në jetë ndahet me atë të Astritit, Flutura, e ndërjegjishme për hapin e vështirë që po bën, flak tutje gjithë urrejtje

1) Z. Cikuli, **Flakë në shtëpi**, Tiranë 1968, f. 72.

unazën që ishte për të hallkë skllavërimi. Zgjidhja e këtij konflikti është motivuar nga pikëpamja ideore. I rritur në një familje tregtarësh të mëdhenj, të shpronësuar nga pushteti popullor, Astriti mishëron në karakterin e vet veçoritë thelbësore të klasës prej nga rrjedh, si: lakminë për fitime, egoizmin dhe interesimin për leverdinë personale. Ai është njeri i huaj për shoqërinë socialiste, e cila e flak tutje si armik. Duke vënë përballë mendimet e kundërta të Fluturës dhe të Astritit, autori hedh dritë mbi karakteret e ndryshme të tyre, zbulon figurën morale të intelektuales së re. Flutura dallohet për zgjuarsinë, pjekurinë, guximin për të luftuar kundër normave të vjetra morale. Atë e shqetësojnë ndryshimet që vëren në bindjet e të atit, e trondisin shfaqjet tipike prej intelektual borgjez që zbulon tek i fejuari. E pajisur me një gjykim të fortë, ajo, ndonëse me dhembje, nuk ngurron të zbulojë shkaqet e vërteta të këtyre ndryshimeve. Në luftë me konceptet borgjeze ajo mbron dinjitetin vetjak. Veprimi i saj i fundit, ndarja nga Astriti, është plotësisht i motivuar.

2

Ashtu si edhe në llojet e tjera letrare, në dramën e kësaj periudhe një vend të mirë zuri e kaluara historike e vendit. Dramaturgët që e morën lëndën për veprat e veta në të kaluarën, bënë përpjekje për ta paraqitur me vërtetësi kohën, për të rrokur kuptimin e ngjarjeve historike. Kjo u dha dramave historike një frymë aktuale. Ato u bënë jehonë e problemeve të kohës, luftës së popullit shqiptar për të mbrojtur fitoret socialiste.

Një nga dramat më të mira me temë historike është trilogjia «Gjergj Kastrioti» (1973) e M. Markajt, që pasqyron luftërat e popullit shqiptar për liri, të udhëhequra nga Gjergj Kastrioti. Vendin kryesor në vepër e zë problemi i mbrojtjes së vendit nga sulmet e armiqve dhe qëndresa heroike e pashembullt e popullit gjatë 25 vjetëve.

Autori në trilogjinë e tij e ka konceptuar drejt konfliktin e madh historik. Ai vë ballë për ballë dy forca të kundërta,

nga njëra anë, ushtritë e bashkuara shqiptare nën udhëheqjen e Skënderbeut dhe, nga ana tjetër, turqit dhe venedikasit, me të cilët bashkohen edhe disa princa shqiptarë me prirje separatiste. Autori përshkruan me besnikëri mjedisin feudal, marrëdhëniet midis princave, egoizmin e njerit dhe tekati e tjetrit, zënkat personale, të cilat shndërrohen në konflikte të mëdha, që i sjellin vendit dëme. Prapa rivalitetit të princave shqiptarë shkrimtari shikon dorën e Senatit të Venedikut dhe politikën e pabesë të sulltanëve turq, që përpiqen të përçajjnë princat shqiptarë, të hedhin farën e vëllavrasjes, të thyejnë me dredhi ushtrinë e Skënderbeut dhe kështu të gjunjëzojnë shqiptarët. Ushtria shqiptare e vogël, por trime, bën një luftë të pashembullt në dy fronte dhe del fitimtare «sepse», — si thotë Skënderbeu, — *fara arbërore qëlloi një farë e rrallë njerëzore, që nuk e shtypin dot mokrat armike, qofshin osmane, e qofshin venedike*»¹.

Heroin kombëtar, Gjergj Kastriotin, M. Markaj e ka pasqyruar drejt nga pikëpamja historike; për të ai është një personalitet i shquar historik, përfaqësues i atij grupi të feudalëve shqiptarë, që, ndryshe nga grupi tjetër i feudalëve ishin për luftën kundër pushtuesve osmanë. Skënderbeu jepet si një udhëheqës i talentuar e me autoritet, që gëzon dashurinë dhe respektin e ushtarëve dhe të komandantëve, që garancinë e fitores së shqiptarëve e sheh në bashkimin e princave shqiptarë dhe që frymëzohet nga një ide e madhe, siç ishte mbrojtja e lirisë dhe e tokave shqiptare.

Si udhëheqës realist e largpamës, Skënderbeu i kupton mirë vështirësitë dhe pengesat që ka përpara. Armiqtë i kurdisin komplete si ai i pyllit të Kërrabës, nxisin sedrën e fyer të princave shqiptarë dhe lakminë e tyre për prona. Kundrejt atyre që tradhetojnë interesat e Atdheut, Skënderbeu tregohet i ashpër dhe i pamëshirshëm, qofshin këta edhe të gjakut të tij, siç qe rasti me të dy nipërit, Gjergj Ballshën dhe Hamzanë. Ndryshe vepron me Moisi Golemin, sepse si ky «të dytë

1) M. Markaj, **Gjergj Kastrioti**, Tiranë 1973, f. 165.

nuk ban nana» dhe Arbëria ka nevojë «për krahë të fuqishëm që ta mbrojnë». Prandaj e fal dhe i kthen titujt dhe nderimet:

*Më dhimka kur të shoh përdhe plandosur,
Shqiponjë krahë thyer, trim i Dibrës!*

Si diplomat i shkathët, Skënderbeu arrin të diktojë hipokrizinë e anadollakëve, që, të nisur nga pozitat e shtetit të madh, në dukje e nënvleftësojnë, por në të vërtetë i tremben luftës së popullit shqiptar. Por në të njëjtën kohë ai bën që të dështojë edhe politika dhelparake e Venedikut. I guximshëm dhe largpamës, ai nuk ngurron të hapë luftë në dy fronte, jo vetëm kundër Turqisë, por edhe kundër Venedikut, megjithëse kjo ndërhyrje do të largonte nga Lidhja ndonjë prej anëtarëve të saj të pavendosur. Skënderbeu e mbështeste forcën e tij te komandantët trima e, sidomos te ushtarët e thjeshtë, që ishin të ndërgjegjshëm për qëllimet e luftës. Në tërësi figura e Skënderbeut ka vërtetësi, ajo është bindëse, autori ka arritur ta japë atë me ngjyra individuale.

Personazh i denjë përkrah Skënderbeut është Kont Urani, të cilin autori e përshkruan si mik e këshilltar besnik, dhe si bashkëluftëtar të afërt të Skënderbeut. Me pak viza krijohet figura e patriotit, i cili mbi gjithçka edhe mbi interesat vetjake, vë ato të atdheut. Njeri thellësisht i ndershem edhe në politikë, atë e revoltojnë intrigat e paturpshme të Venedikut. Në këshillin e princave shqiptarë, kur po shqyrtohej krimi i Lekë Dukagjinit, ai ngrihet mbi dhimbjen e tij dhe mbi ndjenjën e hakmarrjes për vrasjen e të nipit. Si njeri që shikon larg, ai e këshillon Skënderbeun për rrezikun e luftës në dy fronte dhe e qorton me guxim se la në Berat si kryekomandant një çunak, të kunatin, Muzak Topinë.

Me realizëm të fortë është zbuluar në dramë dhe roli i Venedikut, që shtirej sikur e përkrahte Skënderbeun, por në të vërtetë «e kishte halë në sy» — thuhet në dramë. Këtë rol autori e tregon përmes figurave të senatorëve. Venieri e Pal Loredani mishërojnë pabesinë e politikës së shtetit të tyre, që me dhelpëri dhe tradhti u përpoq të siguronte hegjemoninë

1) Po aty, f. 309.

e vet mbi rrugët detare. Si dhelpira të vjetra, senatorët venedikas gjejnë çastin e përshtatshëm për të nxitur Lekë Dukagjinin që të ndahet nga princat e tjerë shqiptarë. Ndërhyrjet dhe intrigat e Pal Loredanit e tendosin situatën dramatike që kurorëzohet me vrasjen e Zaharisë.

Ndër momentet e realizuara mirë në dramë është dhe ai i tradhtisë së Moisi Golemit. Autori zbulon mirë shkaqet e vërteta të aktit të tij, sidomos rolin dinak të Dafinës, e cila herë e nxit, herë e prek në sedër, herë e josh me premtimet e dashurisë, herë tregohet se po sakrifikon për madhështinë e tij dhe e shtyn deri aty Moisiun, sa të veprojë ashtu si nuk dëshiron ai. Se ç'përfaqëson kjo pabesi për Lidhjen e Shqiptarëve, autori e thotë përmes qëndrimit që mbajnë fshatarët di-branë.

Drama ka skena të bukura, të realizuara me mjeshtëri artistike. Një skenë e tillë, është ajo që zhvillohet në prani të sulltan Mehmetit me tetë kapedanët shqiptarë, të zënë rob me pabesi nga Ballabani. Duke theksuar me forcë situatën dramatike dhe qëndresën burrërore të trimave të cilët u torturuan në mënyrë barbare, autori njëkohësisht zbulon forcën e karakterit, qëndresën stoike dhe optimizmin e tyre. Me imtësi të gjetura me vend, autori vë në pah tiparet individuale të secilit prej tyre. Moisi Golemi, heroi tragjik «vështrim trishtuar e hijerëndë» në çastet e fundit të jetës ka një mllef edhe kundër perëndisë, sepse ai nuk le pas asgjë; Vlasi i Gjuriës, këshilltari i kryetrimt, po vdes i qetë se e kreu detyrën me nder deri në fund dhe se po lë pas dy pasardhës, ushtarë të mirë të Skënderbeut; Progon Gurbaneshi, mendimtari i lirë, përbuz sa sulltanin aq edhe pushtetin e perëndisë dhe me stoicizmin e tij ngre kultin e njeriut që nuk mposhtet nga vështirësitë e jetës; hokatari Nik Lundari, njeri i thjeshtë, e pret vdekjen buzagaz dhe i qetë.

Veprimi në të tri pjesët ecën në mënyrë të natyrshme, zhvillimi i karaktereve është i motivuar, por mund të bëhej një zgjedhje më e kujdesshme e materialit, të hiqesh ndonjë përsëritje ose skenë e tepërt.

Gjuha e veprës është e pasur dhe e përpunuar, stilistika e larmishme, ndonëse ndonjëherë e rënduar me figura. Aty këtu ka monologë proliksë, që e ngadalësojnë veprimin.

Kronika e dramatizuar «Gjergj Kastrioti» krijon mirë

atmosferën heroike të luftërave të popullit tonë në shekullin XV, ajo të emocionon me skenat dhe heronjtë të krijuar me frymëzim e si e tillë mbetet një nga veprat më interesante që pasqyrojnë epokën zulmëmadhe të Skënderbeut.

*
* *

MARGA

Ngjarjet e dramës «Marga» (1971)
e L. Papës lidhen me lëvizjen revolucionare që u zhvillua në Shqipëri nga

viti 1924 e deri në prag të revolucionit popullor.

Marga është e veja e një komiti, i cili ka luftuar kundër padrejtësive të beut dhe për këtë është dënuar nga pushteti reaksionar. Bashkë me koburen e të shoqit, ajo ka trashëguar urrejtjen ndaj shfrytëzuesve si dhe amanetin që të vazhdojë luftën kundër tyre. Me këtë ndjenjë ushqen të mbesën dhe të birin e vetëm, Mitin, që më vonë bëhet komunist, dhe vdes si i tillë. Këtë urrejtje ajo do t'ua zgjojë edhe bashkëfshatarëve të saj, që vuajnë në një mjerim të papërshtatshëm.

Janë vitet e një shtypjeje të rëndë që i jep shkas revoltës spontane të fshatarëve e të kaçakëve, të cilët shpërthejnë hambarët e bejlerëve dhe nxjerrin kafshatën e gojës «me grykë të kobures». Kjo frymë vjen e rritet me përhapjen në popull të ideve revolucionare demokratike nga anëtarët e shoqërisë «Bashkimi». Tani lufta për bukën lidhet me luftën për tokën dhe protesta e paorganizuar e fshatarësisë, e shkrirë me përpjekjet e punëtorëve argatë, vjen e rritet për ditë e më tepër derisa shpërthen në kryengritjen e armatosur të qershorit të vitit 1924. Pjesa e dytë e dramës ka aspekte realiste nga jeta e fshatit shqiptar pas dështimit të revolucionit. Në të flitet për regjimin e terrorit dhe të urisë, për prapambetjen e madhe ekonomiko-kulturore të vendit, për politikën antikombëtare të regjimit zogist, që po u hapte çdo ditë e më shumë dyert fuqive imperialiste. Në dramë përshkruhet thellimi i diferencimit në gjirin e fshatarësisë, si rrjedhim i varfërimit të fshatarëve, kalimi i fshatarëve pa tokë në gjendjen e argatëve stinorë, shfrytëzimi i dyfishtë nga beu dhe shoqëritë e huaja. Jeta në mundime i mësoi shumë gjëra popullit; për-

voja e luftës së paorganizuar në fillim, u mëson se, për të përmbysur bejlerët, fshatarët dhe punëtorët duhet të bashkohen rreth një udhëheqjeje revolucionare, rreth një «bariu» — si thotë një nga personazhet e veprës. Autori pasqyron përpjekjet e grupeve të para komuniste për themelimin e Partisë Komuniste Shqiptare. Ngritja e celulës së Partisë në atë kasolle që dikur kishte shërbyer si strehë e komitëve, simbolizon idenë e vijimësisë së traditës revolucionare. Drama mbyllet me këngën optimiste të korit, që paralajmëron fillimin e betejave fitimtare.

Në dramën «Marga» pasqyrohet lufta e klasave si dhe shkaqet shoqërore-ekonomike që qëndronin në themel të kësaj lufte. Kjo i ka lejuar autorit të ndërtojë drejt konfliktin dramatik e të ndjekë zhvillimin, rritjen dhe pikën e tij kulminante që përputhet me shpërthimin e revolucionit popullor, të udhëhequr nga Partia. Në paraqitjen e konfliktit ka një farë avancimi në kohë; përveç kësaj ngjarjet janë vendosur në një mjedis jo shumë të lokalizuar e konkret.

Heroina e dramës, Marga, është vizatuar në mënyrë shumë plastike. Më shumë se një karakter konkret dhe i individualizuar, Marga është një simbol, një figurë që përgjithëson cilësitë më të bukura të gruas shqiptare, si guximin dhe dashurinë e saj për liri. Jeta e vuri Margën para shumë provave që e bënë atë të fortë dhe të papërkulur. Marga ka një zemër të madhe, ajo vuan e ndien për gjithë popullin, shqetësohet për djemtë e tjerë, barabar si për djalin e vet. L. Papa na e jep Margën me një botë të brendshme që sa vjen e bëhet më e pasur, përkrah me rritjen e luftës popullore kundër shtypjes e shfrytëzimit. Nga përfaqësuese e lëvizjes fshatare spontane, që ka besim vetëm te kaçakët, Marga, pas themelimit të Partisë, kalon në pozita ideologjike më të përparuara. «*Populli do të luftojë kundër pendëzezëve dhe bejlerëve. Dhe do të fitojë, se është kockë e fortë*» — thotë ajo, pasi e ka kuptuar se çështja e çlirimit të vegjëlisë kishte marrë rrugën e zgjidhjes. Autori e pasqyroi në mënyrë bindëse zhvillimin e Margës nën ndikimin e rrethanave të jetës, të përhapjes së ideve komuniste. Me anë të këtij personazhi L. Papa ka krijuar lidhjen midis brezave të ndryshëm të luftëtarëve për çlirimin e popullit. Megjithëse ndonjëherë karakteri i saj merr tipare të jashtëzakonshme, të ngjashme me ato të heronjve legje-

ndarë të folklorit dhe, në pjesën e dytë pothuajse nuk zhvillohet, Marga është figurë e bukur dhe mjaft emocionuese.

Krahas Margës, në dramë ka edhe karaktere të tjera që mishërojnë veçoritë tipike të fshatarësisë së varfër dhe rrugën e vështirë, me lëkundje dhe me dyshime, me rënie dhe me ngritje, që përshkoi ajo deri sa gjeti udhëheqjen e vërtetë, Partinë Komuniste. Gori përfaqëson fshatarin kaçak që varfëria e ktheu në argat mëditës. Duke njohur peshën e egër të shtypjes klasore, ai hyn menjëherë në lëvizjen komuniste dhe, ndër të parët, miraton thirrjen e Partisë, i bindur se «askush nuk ka parë keq nga lufta për liri». Përmes personazheve të tjera autori tregon se në radhët e fshatarëve ka të tillë që në fillim hynë në luftë spontanisht, pa njohur akoma qëllimet e saj, të shtyrë vetëm nga interesat klasore të çastit (Koli, Leka, Hilli), ka edhe ndonjë skeptik, si Loli, por, të gjithë këta, në zjarrin e luftës fitojnë vetëdijen e interesave të tyre si klasë.

Futja në skenë e masave popullore, pasqyrimi i anëve themelore të jetës së vendit, krijimi i tipave dhe i mjedisëve të ndryshme, i jep veprës një karakter epik. Drama shquhet në përgjithësi për frymën popullore, që shprehet në krijimin e karaktereve me psikologjinë tipike të fshatarit të kohës dhe për gjuhën e pasur me frazeologji popullore. Personazhet karakterizohen me anë të një dialogu të gjallë, shprehen në konciz, mjaft emocionues, që ndihmon me vizatimin e fizionomisë individuale të personazheve.

Pirroja, një nga personazhet e rëndësishëm, është përfaqësues i shoqërisë «Bashkimi», që përhap në fshat idetë revolucionare. Ai u prin fshatarëve në luftë në ditët e revolucionit të vitit 1924 dhe më vonë, si përfaqësues i ndërgjegjshëm i proletariatit, hedh në popull idenë e bashkimit nën udhëheqjen e Partisë. Në skenën e fundit ai u bën thirrje fshatarëve të ngrihen në luftë për çlirimin e tyre. «*Dy janë rrugët, o të nënshtrohemi e të hiqemi zvarrë, o të fitojmë drejtat tona me forcë*», — thotë Pirroja, i bindur se tani të shokët janë përgatitur për luftën e fundit çlirimtare. Kjo figurë është ndër përpjekjet e para në dramaturgjiri për të dhënë karakterin e komunistit të viteve 30.

Heronjtë pozitivë në dramë në përgjithësi janë realizuar mirë, por kjo s'ndodh me personazhet që përfaqësojnë kampin

armik, të cilët janë dhënë të zbehtë. Përjashtim bën Dani, por edhe ky, më shumë se karakter konkret, është një figurë simbolike. Si tip, Dani përfaqëson frikacakun dhe lajkatarin; ai është mishërimi i degjenerimit dhe i korrupsionit të klasave sunduese, që u vunë në shërbim të armikut dhe në mënyrë të ndërgjegjshme tradhtuan interesat e atdheut.

Subjekti i shtrirë përcaktoi një ndërtim origjinal të dramës, e cila ka dy pjesë, që përfshijnë dy etapa të rëndësishme të luftës së popullit, të ndara secila në disa tablo, që ngërthejnë një sërë episodesh. E tillë është p.sh. tabloja e dytë («Këngë komiti»), ku bëhet fjalë për traditat luftarake të popullit tonë ose tabloja e katërt e cila jep pamjen e Revolucionit të Qershorit etj. Megjithëse autori me anë të figurës së Margës përpiqet të krijojë lidhje midis tablove, shtrirja e veprimit në një periudhë të gjatë kohe ka sjellë në dramë një farë fragmentarizmi. Element i ri që autori solli në dramën e këtyre viteve është kori, rolin e të cilit nuk e kufizon vetëm në atë të gjyqtarit që moralizon ose pohon dhe mohon veprimet e heronjve; kori luan rol aktiv në skenë, ai jeton me problemet e popullit. Drama «Marga» është një vepër me vlerë të shquar artistike dhe njohëse.

*
* *
*

Në dramën «Mulliri i Kostë Bardhit» (1971) të Naum Priftit trajtohet problemi i zgjimit dhe i rritjes së ndërgjegjes revolucionare të fshatarësisë në vitet e Luftës Nacionalçlirimtare. Ngjarjet zhvillohen menjëherë pas themelimit të Partisë dhe pas fillimit të veprimitarisë së çetave të para partizane. Te Kostë Bardhi, njeri i ndershëm dhe punëtor, që rron me djer-sën e tij, autori ka paraqitur ata fshatarë, që ndonëse e ndiejnë shtypjen e beut dhe ziejnë përbrenda nga urrejtja për pushtuesin, nuk e kanë të qartë se ç'duhet të bëjnë. Para se të lidheshin me Lëvizjen Nacionalçlirimtare, këtyre fshatarëve iu desh të çliroheshin nga mëdyshjet dhe ngurrimet që kishin. Rrugën që ndjekin e ndryshimet që ngjasin në vetëdijen e tyre, autori i zbulon me vërtetësi përmes historisë së Kostë Bardhit. Dështimet e shumta në jetë, shtypja e egër,

e kanë bërë Kostë Bardhin skeptik dhe kanë forcuar në karakterin e tij frymën individualiste, aq sa ta ndiejë veten në fillim të përjashtuar nga ngjarjet e rëndësishme politike që përshkojnë jetën e vendit. Mbyllur në guaskën e tij, heroi ushqen iluzionin se në shoqërinë ku ai jeton ... «po të mos i biesh në qafë tjetrit, nuk ka pse të të ngasë»¹. Kështu ai shpreson t'i shpëtojë grushtit të beut. Këtë qëndrim asnjans do të mbajë edhe pas pushtimit fashist, prandaj e qortoi djalin e vet, Skënderin i cili u pushua nga puna për shkak se kishte goditur kryemjeshtrin italian. Por, megjithatë thellë në ndërgjegjen e tij, Kosta ndien admirim e krenari për qëndrimin e guximshëm të të birit. Tek Kostë Bardhi autori ka dhënë një karakter njerëzor të ndërlikuar. Jeta e ka bërë të ashpër, të ngrysur, plot frikë përpara pasigurisë që kërcënonte njerëzit e punës në fshat apo në qytet, por nga ana tjetër ai ka një zemër të dhembshur, që vuan për fatkeqësitë e familjes e të bashkëfshatarëve të tij dhe një karakter burrëror që nuk nënshtrohet as para kërcënimeve të beut. Në fatin e heroit autori përgjithësoi rrugën plot zigzage që ndoqi një pjesë e fshatarësisë derisa formoi ndërgjegjen revolucionare. Rol të madh në pajisjen e fshatarësisë me ndërgjegjen e interesave të veta luajti Partia. Kjo ide realizohet përmes figurës së mësuesit. Ndryshe nga Kosta, i cili mendon të vrasë beun, i bindur se në këtë mënyrë mbron të drejtën e tij, mësuesi është i mendimit se «s'mund të ketë drejtësi të vogël mbi një padrejtësi të madhe... sepse për fukarain s'ka ligje dhe drejtësi, ... Qeveria është e të pasurve dhe domosdo interesat e tyre do të mbrojnë, prandaj, thotë ai, ... duhet të bashkohemi, si një grusht i vetëm dhe të luftojmë, por jo tek e tek se ashtu s'fitojmë gjë»². Fjalët bindëse të mësuesit si dhe aksionet e para me sukses të çetave e bëjnë Kostë Bardhin të ndërrojë mendim dhe, pushkën të cilën e ruante të fshehur që ta përdorte për të mbrojtur nderin, t'ia japë të birit për të qëlluar me të armiqtë e masave punonjëse. «Merre, o bir! — i thotë — Syri yt shikon më larg dhe dora juaj godet më mirë»³. Pasi arrin të kuptojë se fatet e familjes së tij, janë të lidhura ngu-

1) N. Prifti, **Mulliri i Kostë Bardhit**, Tiranë 1971, f. 7.

2) Po aty, f. 53.

3) Po aty, f. 57.

shtë me ato të gjithë atdheut, Kostë Bardhi, më në fund, hi-dhet pa rezerva në anën e luftës. Rruga e vështirë e formimit tek ai i bindjeve të reja, është dhënë në mënyrë bindëse, përmes imtësive dhe episodeve të gjetura me vend.

Shahin bej Miluka, si karakter është konceptuar dhe vi-zatuuar nga autori në mënyrë origjinale. Shahin beu nuk është beu që e mbarështon në mënyrën e vjetër, anadollake çifligun e vet, por një bej i tipit të ri, modern, i cili kërkon të shfrytë-zojë tokat e tij sipas metodave të reja kapitaliste. Këtë ndry-shim autori e jep jo vetëm nga ana e jashtme, përmes veprim-tarisë që zhvillon në qytet dhe në pronat e tij në fshat, por dhe në mënyrën e të menduarit. Parimi që e udhëheq në veprimet e tij është tipik për një afarist borgjez. «Kryesorja në jetë sot — thotë ai — është të dish të fitosh, nga çdo gjë të fitosh»¹. Sipas filozofisë së tij reaksionare, «... jeta është një libër llogaritje me debi-kredi dhe asgjë tjetër. A jeni i zoti të jeni gjithmonë kreditor?»² Për të arritur këto synime, ai men-don se klasa e tij duhet, para së gjithash, të shkundet nga dembellëku anadollak e indiferentizmi dhe të vërë në veprim të gjitha energjitë për t'u pasuruar. Shahin beu sheh te pu-shtuesit fashistë mbrojtësit e interesave të klasës së vet, e cila është e zhveshur nga çdo ndjenjë kombëtare. Për t'ia shpërblyer nderet fashizmit, ai e këshillon të nipin, Robertin, të bëhet oficer dhe t'i shërbejë me besnikëri pushtuesit italian. Por Shahin beu dhe klasa e tij dështojnë në qëllimet e tyre për të ruajtur sundimin e tyre klasor, qoftë duke u mbë-shtetur edhe tek të huajt. Katastrofën morale të Shahin beut, që paraprind katastrofën e tij politike e shoqërore, autori e paraqet në takimin me Kostë Bardhin. Kosta, ndonëse i shpro-nësuar nga beu, por krenar se ka ruajtur dinjitetin e tij, së bashku me urrejtjen e vet i përplas atij në fytyrë edhe akuzën si tradhtar i atdheut «... Ne argatë dhe ju zotërinj? Jo, Sha-hin Miluka. Ajo qyqe më s'këndon»³ — i flet plot siguri Kostë Bardhi Shahin bej Milukës. Në ndërgjegjen e Kostë Bardhit fiton ndjenja e atdhedashurisë mbi ndjenjën e pronës vetjake.

1) Po aty, f. 26.

2) Po aty, f. 47.

3) Po aty, f. 67.

Përpara interesave të luftës për çlirimin e Shqipërisë mulliri humbet në sytë e Kostës vlerën e tij. «Pesëdhjetë mullinj të më rreshtosh këtu, s'e kthej djalin nga rruga, se ia dhashë vetë uratën kur iku në mal... Hiqmu nga sytë! Unë jam me dëjmetë dhe me ta do të mbetem, daç i gjallë, daç i vdekur»¹

Përveç Kostë Bardhit dhe Shahin bej Milukës, në dra-më veprojnë dhe një radhë personazhesh episodike. Intere-sante dhe e punuar me dashuri është figura e Sokratit, vëllait të Kostë Bardhit, tek i cili autori ka mishëruar fatin e hidhur të mërgimtarëve tanë. Jeta e vështirë e kurbetit ia mprehu Sokratit gjykimin kritik, kurse përvoja e mbledhur në rav-gimet e lodhshme në vendet e huaja ia forcuan ndjenjën kla-sore, aq sa ai nuk ushqen iluzione as për klasat sunduese, as për pushtuesit fashistë. Sokrati nuk u thye, sepse e mbajti gjallë shpresa në të ardhmen. Stoicizmi i tij i ka rrënjët në forcën shpirtërore të popullit. Në karakterin e Sokratit ba-shkohet urtësia popullore, rezultat i një përvoje të hidhur me shkohet urtësia popullore, rezultat i një përvoje të hidhur me ndjenjën e humorit që i jep forcë të durojë shuplakat e je-ndjes dhe të mbajë një qëndrim ironik ndaj armikut. I viza-tuar me ngrohtësi, Sokrati, ndonëse personazh episodik, mbetet personazh i dashur për lexuesin.

Drama «Mulliri i Kostë Bardhit» shquhet për pasqyri-min e thellë dhe të gjallë të Luftës Nacionalçlirimtare. Te-ndosja dramatike vjen e rritet derisa shpërthen me skenën e djegies simbolike të kullës, që paralajmëron betejat e ardhme dhe provat e vështira nëpër të cilat do të kalonte populli. Ve-primi zhvillohet në mënyrë të ngjeshur situatat janë bindëse dhe ndihmojnë në zhvillimin logjik të karaktereve. Dialogu dhe veprës është i natyrshëm dhe i ngjeshur me mendim. The-i vëllësia e mendimit, vizatimi i gjallë e me vërtetësi i karakte-reve, në të cilat janë pasqyruar veçoritë thelbësore të jetës shqiptare të kohës, e bëjnë veprën e N. Priftit një nga dramat më të goditura të kësaj periudhe.

1) Po aty, f. 68, 69.

Në këtë periudhë u shkruan disa komedi të cilat u vunë në skenë dhe patën sukses të lexuesit. Ndër komeditë më të mira duhen përmendur: «Karnavalet e Korçës» dhe «Dy me zero» të S. Çomorës, «Fytyra e dytë» e D. Agollit «Dasmë pa nuse» e N. Priftit etj.

KARNAVALET E KORÇËS

S. Çomora temën e komedisë «Karnavalet e Korçës» (1961) e mori nga realiteti shqiptar i viteve 30. Me anë të imtësive satirike shprehëse të situatave të goditura komike, autori pikturoi ambientin e tregtarëve të pasur korçarë, mënyrën e jetesës, mentalitetin dhe psikologjinë e tyre. Komedia satirizon hollë vanitetin, fodullëkun dhe moralin hipokrit të borgjezisë, e cila vë mbi të gjitha, edhe mbi ndjenjat e lidhjet gjinore, interesin material. Idenë e tij autori ka mundur t'a nxjerrë në pah jo duke përshtuar veprimtarinë praktike të tregtarëve. Në komedi klasa e pasur e tregtarëve është pasqyruar nga ana e jetës familjare, nga pikëpamja e lidhjeve morale e jetësore që e karakterizojnë. Veprimin e komedisë e çojnë përpara përpjekjet që bëjnë tregtari i pasur korçar, Nikollaq Jorganxhiu, dhe gruaja e tij për të fejuar çupën e tyre, Afrovitin. Duke treguar këtë ngjarje të rëndomtë, shkrintari ka mundur të vizatojë disa personazhe me kolorit nga rrethi i tregtarëve korçarë, të zbulojë me mjeshtëri fizionominë e tyre të vërtetë.

Personazhi kryesor i komedisë është Nikollaq Jorganxhiu. Ai është njeri me rëndësi në qytet, njeri që ka lidhje me autoritetet më të larta të vendit, siç është prefekti, të cilin e ka mik të ngushtë. Tipari i tij kryesor është etja për para. Veç dyqanit të madh që ka në Korçë dhe një zyre tregtie që mban të hapur në Selanik, ai nuk ka krupë të shtojë mallin e vet me kamatën që u mbledh nëpunësve të vegjël, të cilët i shehin atij rrogat e disa muajve, që duhet të marrin nga shtëpi. Dhe këtë gjë ai e quan shfaqje humane, zemërgjerësi të madhe nga ana e vet. Në bisedë me profesor Janin, N. Jorganxhiu kërkon që këtë veprimtari të tij edhe të tjerët ta shikojnë si vepër filantropie. «Hajde se më shite zotrote katër rroga që bëjnë dyzet napolona, — i thotë ai profesorit, — unë të

dhashë në dorë tridhjetë dhe fitova dhjetë... E zemë... Po ana tjetër?... Sikur mos ndodhesha unë hazër me dorë në xhep, zotërote ose ai tjetri, që është hallexhi me një tufë fëmijë, s'do të kishit as bukën e gojës... Të rrimë shtrembër e të flasim drejt... Janë me qindra familje këto që po ndihmojmë»¹. Edhe marrëdhëniet në familjen e vet ai i shikon duke u nisur nga fakti se ç'dëm apo dobi mund të nxjerrë nga to. Ky është plani kryesor, në të cilën zbulohet karakteri i N. Jorganxhiut. Në radhë të parë në komedi del qëndrimi që ai mban ndaj çështjes së fejesës së çupës së vet. Për të kryesorja është që çupën edhe ta fejojë, por edhe të paguajë sa më pak për prikën e saj; për këtë hyn në pazarllëk me doktor Kristaqin, por ky pazarllëk përfundon pa rezultat, sepse tregtari dorështrënguar kërkon nga dhëndrri të zbrësë nga shuma e prikës pesëdhjetë napolonat e pianos, që i ka blerë çupës. Por për këtë shkak, që të paguajë sa më pak për fejesën, ai, megjithëse e heq veten prej soji, pranon t'ia japë çupën profesor Janit, që rrjedh nga një familje punonjësish. Replika me të cilën mbyllet vepra, nxjerr sheshit fytyrën e tij prej shfrytëzuesi të vërtetë, që edhe marrëdhëniet me të afërmit i mat me kutin e moralit borgjez, në se ka leverdi apo humbje prej tyre. Atë nuk e shqetëson fati i vajzës, që i ka mbetur në shtëpi, se sa shpenzimet që po bën për fejesën e saj. S. Çomora është përpjekur ta pasqyrojë në mënyrë sa më të plotë këtë tip. Si tregtar i pasur dhe spekulator N. Jorganxhiu ka edhe filozofinë e vet. Për të, paraja është zot i botës, ajo që vendos fatin e njerëzve dhe të gjithë shoqërisë.

N. Jorganxhiu është dhe përfaqësues i klasës së lartë të kohës, i zhveshur nga dashuria për vendin dhe popullin. Antipatriotizmi i tij shprehet në mënyrën se si e shikon politikën armiqësore të Italisë fashiste ndaj Shqipërisë. N. Jorganxhiu e merr në mbrojtje të vet këtë politikë dhe shan shqiptarët që nuk duan t'u nënshtrohen presioneve të qeverisë së Romës. «Janë zemëruar italianët dhe s'na japin ndihmën!... Buda-llallëk i madh nga ana jonë! ... Do të ngordhim! ... Po rri, mor lapangjоз ç'të duhet? ... Është fuqi e madhe! Jepja, mor qerrata, çfarë kërkon, dhe fut në xhep ndonjë kacidhe të

1) S. Çomora, **Tri komedi**, Tiranë 1970, f. 38.

*mbash shpirtin gjallë!*¹ — me këto fjalë fyese shprehet ai për bashkatdhetarët e vet.

Portretin e N. Jorganaxhiut si përfaqësues të reshperëve të mëdhenj e plotëson e shoqja, Olimbia, dhe vajza e tyre, Afroviti. Te këto dy personazhe, autori ka mishëruar shpirtligësinë, zbrazësinë shpirtërore, vanitetin e qarqeve të larta të shoqërisë së kohës. Tipari kryesor i Olimbisë është fodullëku; për të, si grua borgjeze dhe injorante, rëndësi ka që të mbahet sa më me të madh, ashtu si ç'ia do soji. Edhe kur ia mbush mendjen të shoqit për të sjellë piano për çupën, këtë e bën më shumë për t'u dukur se «xheç është» dhe nga zilia, kur merr vesh se një familje tjetër e pasur i kishte blerë vajzës piano që prej kohësh. Historia me D itkën, mësuesen e gjuhës franceze, nxjerr në shesh në anën tjetër shpirtligësinë e këtyre njerëzve, që mendojnë se vetëm ata kanë të drejtë të jenë të lumtur në jetë. Ndjenja e dinjitetit vetjak, fisnikëria dhe bukuria shpirtërore e D itkës e tërbojnë Olimbinë bashkë me të bijën, bëjnë që ata të heqin maskën e tyre prej «bamirësesh».

Tek prefekti kemi nëpunësin e aparatit shtetëror të Zogut, kapadai dhe batakçi, shërbëtor besnik i regjimit reaksionar. Me këtë personazh autori stigmatizoi sistemin e ryshfetit dhe të mashtrimit, që lulëzonte në aparatit shtetëror, thelbin reaksionar e antipopullor të veprimtarisë së nëpunësve të regjimit të atëhershëm. Në sjelljen dhe marrëdhëniet e N. Jorganaxhiut me prefektin, që zënë një vend të madh në komedi, del në pah me qartësi të madhe fizionomia morale e nëpunësve të lartë, të cilët, në sajë të postit, nxirrnin përfitime për vete në formë dhuratash dhe ryshfetesh. Nga ana tjetër, prefekti si personazh ka rëndësi për të njohur tipin e nëpunësit të kohës, me nivel të ulët mendor, me mentalitet dhe shije anadollake. Si mbrojtës i interesave të regjimit reaksionar, ai shtyp me egërsi çdo shfaqje pakënaqësie të popullit. Kur vegjëlja kërkoi që t'u jepej fund spekulimeve dhe veprimëve mashtruese të tregtarëve të drithit, që kishin akaparuar tërë prodhimin e tregut dhe me këtë e kishin rritur shumë shtrenjtësinë e jetës, prefekti dërgoi xhandarët e vet, të cilët hidhen gjithë tërbim kundër punëtorëve, çirakëve dhe studentëve, duke arrestuar shumë prej tyre.

1) Po atë, f. 37.

Në komedinë «Karnavalet e Korçës» janë nxjerrë edhe një varg personazhesh pozitive, si profesor Jani, Ditka, dhe hamejtë. Ata me moralin e shëndoshë, me përpjekjet për të fituar bukën e gojës me djersë e mund, me ndjenjat e tyre të pastra i kundërvihen falsitetit dhe hipokrizisë, që mbretëronin në shoqërinë borgjeze. Marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin ata i mbështesin jo në interesin material, por në ndjenjat e vërteta njerëzore. Profesor Jani, megjithëse ia ka nevojën N. Jorganaxhiut, refuzon propozimin që i bëhet, sepse nuk pajtohet me konceptet që ka ai mbi jetën dhe dinjitetin e njeriut. Ndjenja e tij për D itkën është e sinqertë dhe fisnike.

Komedia e S. Çomorës është një vepër me kumbim të gjerë shoqëror. Këtë frymë asaj ia japin problemi i rëndësishëm që trajton dhe personazhet tipike që ka krijuar. Si N. Jorganaxhiu, ashtu edhe e shoqja me të bijën, janë personazhe të cilat mishërojnë në botën e tyre të brendshme cilësitë karakteristike të klasës së tyre. Prefekti është një karakter tipik, tek ai gjetën mishërim cilësi qenësore që shquanin përfaqësuesin e lartë të aparatit burokratik e policor të kohës. Meritë e shkrimtarit është se në gojën e çdonjerit prej tyre vuri një gjuhë të individualizuar, në pajtim me formimin, edukatën, shijet dhe aspiratat e tij në jetë.

Komedinë «Karnavalet e Korçës» e shquan një komizëm i natyrshëm. Efekti komik del këtu jo nëpërmjet gjërave të kërkua e të komizmit të jashtëm, por nga vetë thelbi i situatës jetësore, që është marrë si subjekt i veprës dhe nga karakteret shoqërore të personazheve, që zbulohen në rrethana tipike. Autori iu shmang elementeve të farsës, skenave natyraliste, dhe e ndërtoi veprën e vet mbi një konflikt shoqëror, të dhënë me vërtetësi. Në këtë vështrim S. Çomora, si autor i disa pjesëve komike, e pasuroi dramaturgjinë e re me një vepër të shquar.

Komedia «**Dy me zero**» (1969) ka një humor të shëndoshë, që është shprehur përmes situatave e dialogëve të gjetur bukur. Personazhet kryesore, Ana dhe Aristoteli, janë vizatuar si njerëz të gjallë me anët e mira dhe me dobësitë e tyre. Karakterin e Anës, një grua me dëshira e aspirata mikroborgjeze, tirane e vërtetë në familje, autori e ka dhënë në plan satirik. Ndërsa Aristoteli përshkruhet me viza humoristike, ai është njeri i lëkundur, që nuk pajtohet me shfaqjet e huaja

që vë re në familjen e vet, por nuk ka guxim për të luftuar kundër tyre. Pjesa u largohet elementeve të jashtme komike; efekti i saj buron nga thelbi i karaktereve të personazheve, nga marrëdhëniet që krijohen midis tyre, nga mendimet e veprimet e tyre kontraktore. Me vajtjen e të gjithë personazheve në aktin e tretë në hekurudhë, në një mjedis të ri, i cili nuk kryen asnjë funksion në komedi, autori i ka dhënë një zgjidhje jo bindëse konfliktit.

Në komedinë «**Një nuse për Stasin**» (1971) të T. Laços fshikullohen fejesat me shkuesi. Duke demaskuar këtë zakon, autori lufton për martesën me njohje e me dashuri. Problemi zhvillohet përmes një fabule të thjeshtë: Stasi, një nëpunës i ndërjegjishëm i dhënë shumë pas punës, e la mënjanë çështjen e martesës dhe e kaloi një pjesë të mirë të jetës si beqar. Edhe idilin me fqinjën, Anastasinë, ia mbyti që në lindje rrethi familjar, sidomos e motra, Krisa. Në të njëjtën kohë, njerëzit e familjes vunë të gjitha forcat për t'i gjetur një nuse dhe këtë punë ia ngarkojnë Sofos, një matrapaz i vërtetë, i cili gjen «një thëllëzë» nga fshati dhe përfundon fejesën. Por llogaritë nuk dalin ashtu siç ishin menduar, marrëveshja prishet dhe krushqit, që kanë ardhur të caktojnë ditën e dasmës, kthehen të turpëruar. Idenë e vet, lidhur me anakronizmin e fejesave me shkuesi, autori e zbulon përmes situatave dhe karaktereve që kanë vlerë përgjithësuese. Stasi në vetvete nuk pajtohet me mënyrën e të vepruarit të së motrës Krisës dhe të shkuesit, por nuk ka forca të kundërshtojë hapur dhe në mënyrë të vendosur, dhe si rrjedhim bie në pozitë e njerëzve me koncepte të mykura. Është presioni i rrethit konservator familjar që e detyron të ndrydhë në veten e tij ndjenjën e simpatisë që ushqente për Anastasinë dhe të pranojë fejesën e papërshtatshme, e cila më në fund nuk bëhet. Stasi është viktimë e zakoneve prapanike; autori qesëndis mungesën e vullnetit për t'iu kundërvënë prepotencës të së motrës dhe dinakërisë së shkuesit.

Fshikulli i shkrimtarit bie mbi «tregtarët» e ndjenjave të njerëzve, mbi Krisën dhe Sofon. Krisa është gruaja autoritare, plot koncepte konservatore lidhur me familjen, grua fodulle dhe injorante, me besim të tepruar në vetvete. Prishja e fejesës është një dackë për të, por dackën më të fortë e merr nga e bija që fejohej me një mësues fshati dhe përmbys pla-

net e nënës për një krushqi «të fisme». Sofoja demaskohet në të gjitha episodet e komedisë.

Elementëve konservatorë u kundërvihet opinioni i shëndoshë shoqëror. Të rinjtë e fshatit me ndërhyrjen e tyre e ndihmojnë Klaudën, «nusen» për Stasin, të kuptojë se atë po e trajtojnë si plaçkë dhe se në këmbim të jetës komode e mikroborgjeze në familjen e Stasit, ajo do të humbasë lirinë, të drejtën për të krijuar familjen me njeriun që do ta dojë e do të respektojë. Megjithëse autori është përpjekur të argumentojë ndërhyrjen e të rinjve në zgjidhjen e konfliktit, personazhet pozitive në komedi janë të zbehtë.

Komedia rrjedh në mënyrë të qetë, por veprimi ecën tepër i shtruar, prishja e fejesës nuk del sa duhet e motivuar. T. Laçoja ka dhënë një tablo gjithë kolorit të jetës korçare dhe ka vizatuar me ngjyra të gjalla disa karaktere.

Në veprën «**Fytyra e dytë**» (1963) D. Agolli pasqyron luftën kundër burokratizmit dhe patriarkalizmit. Vëmendja e autorit përqendrohet në ndeshjen e koncepteve burokratike e konservatore, nga njëra anë, me ideologjinë socialiste, nga ana tjetër. Komizmi i veprës qëndron në faktin se armik të papajtueshëm të burokratizmit e shpall veten Bektash Shkoza, tip i burokratit të vërtetë, i cili lufton «burokratizmin» me fraza të përfryra dhe citate të mbledhura nga veprat marksiste, që ka lexuar përciptazi. Ai kudo, vend e pa vend, ka dëshirë ta nxjerrë veten si njeri të ndershëm e parimor, që ka mbajtur parasysh gjithnjë të mirën e përgjithshme, që i ka hapur kurdoherë rrugën së resë, kurse, në të vërtetë, ai i është kundërvënë asaj me veprimet e tij burokratike. Kjo kontraktë midis thelbit të karakterit dhe shfaqjes, midis asaj që thotë e asaj që bën, e bën Bektashin një personazh komik. Se ç'përfaqëson Bektashi si tip shoqëror, kjo del në shesh në darkën e 25-vjetorit të martesës, kur e bija, Ariana, e përbuz të fejuarin që i ka gjetur i ati, dhe kur një i ftuar, pasi dehet, zbulon disa fakte të hidhura që zbulojnë te Bektashi një burokrat të vërtetë, i cili është hakmarrë kundër atyreve që s'kanë pranuar t'i shkojnë pas qejfit. I egërsuar nga demaskimi, Bektashi hidhet në sulm kundër atyre që dëmtojnë interesat e tij, bën çmos për ta transferuar inxhinierin e ri Aleks Kolën, duke e diskredituar para punëtorëve, vetëm e vetëm, se ai, me dashurinë që ushqen për Arianën, përmbys

planin që Bektashi kish thurur për «lumturinë» e saj. Bektashi dëshon në qëllimet e veta. Goditjen e parë ai e merr nga Kosta, sekretari i Partisë, ndërsa në tablonë e fundit, në Bregas, kur ndodhet midis punëtorëve, të cilët nuk ngurrojnë t'ia thotë të vërtetën në sy, ai sheh se është larguar nga normat e moralit socialist dhe shtrëngohet të pohojë se ka mbetur prapa nga jeta.

Bektash Shkoza është një karakter i ndërlikuar. I vështruar kryesisht në plan satirik, ai jepet si njeri i shkëputur nga jeta, që ka humbur shumë cilësi të njeriut të shoqërisë sonë, dhe është kthyer në një burokrat, karrierist, konservator dhe hakmarrës. Në të gjithë veprimtarinë e tij Bektashi shkon në kundërshtim me parimet e shoqërisë sonë, ndonëse fytyrën e vet prej burokrati e njeriu patriarkal e fsheh pas një fytyrë të dytë. Kjo e bën atë edhe qesharak, por edhe të rrezikshëm. Duke e paraqitur me dy fytyra, autori sikur do të theksojë rrezikshmërinë e tij.

Për D. Agollin problemi i luftës kundër burokratizmit është i lidhur me luftën kundër intelektualizmit dhe patriarkalizmit. Te Muhameti, ndihmësi i afërt i Bektashit, autori ka treguar teknokratën, që është shkëputur nga puna dhe kolektivi, kurse te Halili është pasqyruar tipi i fshatarit patriarkal. Ndonëse dukuritë që mishërohen në këto personazhe janë pengesë për zhvillimin e shoqërisë, autori nuk i vë në të njëjtin plan. Figura e Halilit është zbuluar në plan humoristik; ai është përfaqësues i popullit të thjeshtë që ende nuk është çliruar nga pikëpamjet dhe shprehitë e botës së vjetër. Jeta ka ecur përpara dhe në fshat, por Halili, ndonëse e ndien të renë, është akoma nën ndikimin e paragjykimeve të vjetra. Autori qesh me Halilin që ka mbetur prapa nga koha, qesh me shpirtin hokatar të fshatarit, me zgjuarësinë dhe çiltërsinë e tij. Halili është i ndërgjegjshëm se nuk është zhveshur nga konceptet konservatore, dhe, duke pranuar se ende nuk është shkëputur prej syresh, bën një farë autokritike. Përveç patriarkalizmit tek Halili gjejmë edhe disa koncepte, që lidhen me mentalitetin mikroborgjez. Ai e kritikon Bektashin për rehatinë personale, por ndonjëherë këtë e bën, duke u nisur nga një farë emire.

Autori i ka karakterizuar personazhet e vet, në radhë të parë, përmes gjuhës; ai ka theksuar në karakteret e tyre një

tipar të përbashkët. Konservatorizmi «modern» i Bektashit ka shumë gjëra të përbashkëta me patriarkalizmin e Halilit. Ata i lidh qëndrimi i njëjtë ndaj dashurisë dhe martesës me dashuri. Por këta dy personazhe kanë edhe tipare vetjake. Bektashi jo vetëm mendon e vepron si burokrat e konservator, por edhe mbron konceptet e tij, megjithëse këtë e bën me fjalë të thata, pa jetë, që s'thonë gjë me vlerë (rasti kur këshillon Andrean apo kushëririn e tij.) Halili, bartës i disa mendimeve prapanike, dallohet për zgjuarësinë e humorin me të cilin vë në lojë buzagaz edhe veten. Si tip popullor, ai është i natyrshtëm dhe tërheqës.

Në veprë Bektashit dhe Halilit u kundërvihen Andrea, Ariana, Aleks Kola dhe kolektivi punëtor, por, në përgjithësi, këto personazhe nuk luftojnë kundër qëndrimeve të huaja që vënë re tek Bektashi ose e bëjnë luftën me deklaratat moralizuese. Andrea që i kundërvihet që në krye Bektashit, është njeri i kohës, parimor dhe i ndërgjegjshëm, njeri punëtor, që mishëron cilësitë tipike të njeriut tonë, por autori nuk i ka dhënë mundësi këtij personazhi të shpalosë aftësitë e tij. Aleks që ka arsye të ndeshet me Bektashin dhe me Mehmetin, jo vetëm për shkak se i nxjerrin pengesa për projektin e Bregasit, por edhe në plan vetjak, nuk luftojnë me të gjitha forcat për të mbrojtur të drejtat e tij. Konflikti zgjidhet në mënyrë jobindëse. Kthesa e Bektashit nuk përlligjet, sepse nuk vjen si rezultat i veprimit dramatik, autori i zbut në mënyrë artificiale të metat e Bektashit, i cili në fund ndreqet dhe kësaj zgjidhet konflikti i veprës.

Vepra dallohet për moralin e shëndoshë i cili buron prej situatave komike, që krijohen nga kontrasti midis fjalës dhe veprimeve të personazheve.

KREU IV

ZHVILLIMI I LETËRSISË SHQIPTARE TË REALIZMIT SOCIALIST PAS PLENUMIT IV TË KQ TË PPSH

I

Pas Plenumit IV të KQ të PPSH, që u mbajt në qershor 1973, letërsia pati një zhvillim të dukshëm. Ajo eci në traditat më të mira të letërsisë sonë të realizmit socialist, njohu edhe arritje të reja, duke shpurë më tej sidomos disa lloje: si romani, poema, tregimi etj. Në veprat e kësaj periudhe u forcua fryma e partishmërisë proletare, karakteri kombëtar e popullor dhe u përsos më tej mjeshtëria artistike. Karakteristike për krijimtarinë e këtyre viteve ka qenë lufta e ashpër ideestetike kundër ndikimeve të huaja, sidomos të natyrës liberale, që ishin vënë re në vepra të veçanta para Plenumit IV. Lufta për të ruajtur pastërtinë ideologjike të letërsisë ka qenë dhe është e vazhdueshme, veçanërisht në kushtet e rrethimit imperialisto-revizionist, të agresionit ideologjik. Si rezultat i kësaj lufte të drejtuar nga Partia, letërsia ka ecur më tej si në sasi, ashtu edhe në cilësi. Shkrimtarët kanë treguar kujdes më të madh për trajtimin e temave dhe problemeve të rëndësishme e të mprehta të realitetit aktual dhe historik; në vepra ka hyrë denjësisht heroi pozitiv; ka pasur përparime në shtrimin dhe zgjidhjen e drejtë të kontradiktave. Sidomos në disa gjini të veçanta ka shenja të dukshme të rritjes së nivelit artistik si në përfshirjen e realitetit, ashtu edhe në ndërtimin e veprave, në skalitjen e figurave dhe në evoluimin e stilit dhe të gjuhës letrare.

Sukseset janë arritur duke luftuar shfaqjet që kritikoi Plenumi IV, siç janë: hermetizmi dhe formalizmi, të cilat u dukën në poezi; objektivismi dhe humanizmi abstrakt, që u

vunë re në krijime të veçanta në prozë; largimi nga realiteti dhe nga heroi pozitiv, shtrembërimi i së vërtetës jetësore, që u shfaq në dramën e armikut të Partisë, F. Paçramit dhe të ndonjë pasuesit të tij. Kështu, përmes kësaj lufte të vazhdueshme, u forcua përmbajtja klasore e veprave dhe letërsia shqiptare e realizmit socialist shënoi një hop të mëtjeshëm cilësor, që vjen duke u kristalizuar.

Rëndësi të veçantë në forcimin e mëtjeshëm të letërsisë në këtë periudhë pati fjala e shokut Enver Hoxha «Shkrimtarët dhe artistët janë ndihmës të Partisë për edukimin komunist të njerëzve tanë», mbajtur në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të Partisë më 20 Dhjetor 1974. Në fjalën e tij shoku Enver Hoxha trajton një varg problemesh të rëndësishme që u dalin shkrimtarëve tanë në ngritjen më lart të rolit edukues të veprave letraro-artistike, në thellimin e problematikës dhe të frymës së tyre militante.

Problematika që ka tërhequr vëmendjen e krijuesve tanë është e lidhur me aktualitetin socialist, me luftën e popullit tonë për të qëndruar dhe për të çarë rrethimin imperialisto-revizionist; ajo zë fill në punën e njeriut punonjës që ndërton socializmin dhe ka formuar tiparet e tij morale. Krijimtaria është e lidhur me problemin e heroizmit dhe të formimit të mëtjeshëm moral të njeriut, me zhvillimin e luftës së klasave dhe të unitetit moralo-politik të popullit; ajo karakterizohet nga fryma e fizionomia kombëtare dhe nga ndjenjat e internacionalizmit proletar.

Veçoritë politike dhe shoqërore që kanë qenë përcaktuese në jetën e vendit tonë në këta katër vjet, kanë hedhur dritën e tyre edhe në veprat letrare. Ndonëse letërsia ka ende zbrazëti e nuk u është përgjigjur sa duhet ritmeve të kohës (mungesa ndihen veçanërisht në trajtimin e temës së punës), (mungesa ndihen veçanërisht nga Lufta Nacionalçlirimtare për të Autorët i kanë kthyer sytë nga Lufta Nacionalçlirimtare për të gjetur subjekte e ide të reja, për të mbajtur gjallë frymën e heroizmit popullor. Një vëmendje më të dukshme sesa për e heroizmit popullor. Një vëmendje më të dukshme sesa për para kanë treguar shkrimtarët edhe për temat historike, apo nga e kaluara e vendit tonë. Këto vepra kanë vlejtur për të njohur më mirë epokat, përpjekjet e popullit gjatë historisë e për të përqsasur kohët.

Proza, poezia dhe drama kanë luajtur rol të ndjeshëm në edukimin revolucionar të masave. Niveli i tanishëm është i tillë që lejon të thuhet se plotësohen më mirë kërkesat estetike të lexuesit, të cilat vijnë gjithmonë në rritje.

Duke theksuar luftën kundër shfaqjeve liberale, nuk është lënë pas dore edhe lufta kundër dukurive konservatore. Skematizmi është luftuar gjithashtu me forcë ndonëse vërehen ende shfaqje të tij.

Arritjet e letërsisë shqiptare të realizmit socialist të kësaj periudhe mund të përmbliidhen shkurtimisht në këto drejtime kryesore:

Së pari, në forcimin e partishmërisë proletare dhe të karakterit kombëtar, duke luftuar për të zhdukur shmangiet që viheshin re, sidomos para Plenumit IV. Kjo ka sjellë forcimin e përmbajtjes klasore revolucionare të veprave, një militantizëm më të theksuar, karakteristikë e periudhës së ndeshjeve të mëdha ideologjike.

Janë skalitur me bukuri artistike në veprat më të mira karakteret dhe mjediset; populli dhe përfaqësuesit e vet të klasave mike, punëtorë e fshatarë, si edhe të shtresës së inteligjencies popullore kanë hyrë më mirë e më thellë në strukturën e veprave letrare.

Së dyti, në skalitjen më të plotë të figurës së heroit pozitiv, i cili conceptohet në lidhje të ngushtë me realitetin, përmes motivimesh më të thelluara social-psikologjike. Është treguar vëmendje e veçantë për të vizatuar karaktere komunistësh, me rolin transformues të tyre në shoqëri.

Së treti, në forcimin e vështimit realist, të mbështetur në një kuptim të qartë klasor të dukurive shoqërore. E sotmja, lufta dhe historia janë konceptuar drejt nga pikëpamja e luftës klasore dhe në mjaft vepra është zbuluar e zgjidhur drejt kontradikta themelore e kohës. Ka pasur përmirësime në paraqitjen e raportit midis kontradiktave antagonistë dhe jo-antagoniste.

Së katërti, në pasurimin e mëtejshëm të letërsisë me individualitete letrare. Në përpjekje për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave të kohës, u kristalizuan stilet e autorëve të njohur dhe në fushën e poezisë dhe të tregimit kanë dalë talente të reja me fizionomi krijuese të vetën. Nën ndikimin e brendisë së re, gjinitë dhe llojet letrare kanë ecur përpara; në

disa raste, struktura e veprave është bërë më komplekse dhe tipat e subjekteve e të konflikteve janë shtuar dhe pasuruar. Karakteristike për këtë periudhë ka qenë zhvillimi i shënuar i romanit dhe i poemës.

Mjetet shprehëse artistike janë pasuruar dhe janë bërë më të larmishme; janë përdorur me sukses forma të zhdërvjellëta të ndërtimit të veprave. Dialogu, monologu i brendshëm, pasazhet përshkruese, poetike e meditative, kanë gjetur një përdorim më harmonik në lëmin e formës, si kujdesi më i madh për stilin e gjuhën, për përpunimin e vargut në përshtatje me kërkesat estetike të kohës dhe me traditën më të mirë poetike flasin për një ngritje të ndjeshme të mjeshtërisë artistike.

Dobësitë dhe të metat e letërsisë së kësaj periudhe janë: pasqyrimi në letërsi ende në mënyrë jo të plotë i aktualitetit marrë në zhvillimin e tij revolucionar, zbehtësia e mendimit dhe mungesa e thellimit në karaktere të disa vepra; ndonëse më pak se në periudhën para Plenumit IV të KQ të PPSH, edhe në këto vite, pati vepra që vuanin nga pasqyrimi jotipik i realitetit, gjë që shfaqej në zgjedhjen e figurave qendrore edhe të ngjarjeve. Ndonjëherë kontradiktat antagonistë u shtruan dhe u zgjidhën përciptazi; si pasojë e kësaj, në disa drama lufta ideologjike me armikun në sfera të ndryshme të jetës nuk doli me thellësinë e duhur. Në një varg krijimesh poetike, bie në sy një farë uniformiteti dhe njohje e cekët e jetës, kurse në llojet e shkurtra të prozës, në tregimin dhe novelën, vërehet ngushtësi tematike, autorët nuk kanë pasqyruar gjithmonë dukuri tipike të jetës. Prapambetja e ndjeshme vihet re në lëmin e satirës dhe të humorit; lloji i komedisë ka ecur me ritme shumë të ngadalshme.

Këto janë të meta të rritjes; tipar dallues i krijimtarisë letrare në këto vite është zhvillimi i vrullshëm, pjekuria e mëtejshme e saj ideologjike dhe artistike.

Në këtë periudhë përparim të dukshëm pati romani; krahas tij u zhvillua më tej tregimi. Më pak u lërua novela, ndonëse midis veprave të botuara ka pasur novela të një niveli të mirë artistik.

Përparimi i prozës është vënë re si në sasi ashtu edhe në cilësi. Pas Plenumit IV të KQ të PPSH janë botuar shumë romane; ritmi i botimit të romaneve nga viti në vit është shtuar në mënyrë të theksuar. Dalja në dritë e shumë romaneve dhe rritja e nivelit artistik të tyre është fryt i grumbullimit të përvojës nga ana e shkrimtarëve, i nevojës së pasqyrimin të realitetit në shumanshmërinë e tij, në tablo të gjera epike, të cilat japin historinë e formimit të karaktereve dhe të veprimtarisë së masave në periudha të caktuara historike. Lloji i romanit është zhvilluar në luftë kundër shfaqjeve të huaja. Duke ecur në gjurmët e romaneve tona më të mira, si «Kënetë», «Lumi i vdekur», «Para agimit», «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», «Komisari Memo» etj., romani i viteve të fundit e ka theksuar më tej përmbajtjen e tij ideore, në të janë gdhendur më mirë karakteret e personazheve dhe është arritur kështu një ngritje e shënuar cilësore. Pothuaj janë mënjnuar rastet e kompozicioneve të copëzuara, pa kriter të shëndoshë artistik; ka një përpjekje më serioze për të pasuruar mënyrën e ndërtimit të veprimit. Në përputhje me pikësynimet ideore të shkrimtarit dhe me lëndën jetësore, janë përdorur stile dhe mënyra të ndryshme krijuese. Te disa autorë forma narrative ndërthurret me stilin meditativ dhe poetik, ku mbisundon mënyra e të treguarit të drejtpërdrejtë, i cili karakterizohet nga hove lirike dhe nga prirja për të përdorur detajin artistik («Përballimi» i T. Laços); por ka raste kur, me këtë mënyrë krijimi, jepen drama sociale e psikologjike dhe tregimi gërshetohet me lirizmin dhe humorin («Njeriu me top» i D. Agollit). Në raste të tjera kemi të bëjmë me gërshetimin e mënyrës tradicionale të të treguarit me një vështrim të figurshëm të jetës, me një lloj bashkimi të lirë të episodeve që i nënshtrohen idesë poetike («Dimri i madh» i I. Kadaresë). Në këto vite është lëvruar me sukses romani historik me tablo të gjera, ku analiza e karaktereve dhe përshkrimi i veprimit mbështeten mjaft te dokumentacioni («Skënderbeu» i S. Godos). Mënyrat krijuese të zbatuara në roman, kanë dallimet dhe nuancat e tyre, ajo që karakterizon romanin e kësaj periudhe është zhvillimi i tij si roman social, me një shtrirje të gjerë epike. Proza jonë e gjatë shquhet nga një larmi subjektsh, që shërbejnë për ndriçimin e karaktereve të personazheve, të cilat zbulohen përmes marrëdhënieve që krijohen midis tyre.

Së këtejmi rrjedh epizmi, si tipar i rëndësishëm i romanit shqiptar të realizmit socialist.

Romanet e kohëve të fundit shquhen nga ndërtimi polifonik e kompozicioni i përqendruar. Në qendër të tyre zakonisht është vendosur një figurë qendrore, mbi të cilin vepron ndikimi i shoqërisë. Ka romane ku është e vështirë të përcaktohet se cila është figura qendrore, sepse autori u kushton po atë kujdes e vëmendje njëkohësisht disa personazheve. Në një varg veprash karakteret janë të «objektivizuara», por ka raste kur autori shkrihet me personazhin, atëhere vepra përshkohet nga një frymë e theksuar lirike.

Romani ka kapërcyer shumë shfaqje të skematizmit dhe të deskriptivizimit, por, megjithatë, këto të meta nuk janë zhdukur plotësisht. Ndeshen ende vepra skematike, në të cilat kontradiktat janë parashtruar dhe zgjidhur në mënyrë artificiale ose mungon trajtimi i një problemi të rëndësishëm artistik.

Romani ynë është zhvilluar në rrugë realiste. Pasurimi i përmbajtjes dhe i formës flet për gjallërinë dhe forcën vepruese të këtij lloji në letërsinë tonë të realizmit socialist.

Aktualiteti, i parë jo vetëm në temën e jetës së sotme, por edhe në temën e Luftës Nacionalçlirimtare, ka qenë në qendër të vëmendjes së shkrimtarëve. Tema e Luftës Nacionalçlirimtare është trajtuar në romanet: «Njeriu me top» i D. Agollit, «Nëntori i një kryeqyteti» i I. Kadaresë, «Zgjimi i Nebi Surrelit» i Dh. Xhuvanit, «Shtigjeve të zëna» i M. Kallamatës etj. Motivet e patriotizmit popullor bashkohen në këto vepra me motivet shoqërore e klasore. Shkrimtarët i ka tërhequr problemi i shndërrimit moral e politik të njeriut nën ndikimin e ideve të Partisë, problemi i pjesëmarrjes së masave të popullit në luftë. Autorët e këtyre veprave kanë nënvizuar idenë se fitorja u arrit me sakrificat të mëdha dhe se në zjarrin e luftës u kalitën karakteret e njerëzve; lufta ishte një sprovë e madhe e ndërgjegjes revolucionare. Në «Shtigjeve të zëna» dhe në ndonjë roman tjetër u pasqyrua fryma e solidaritetit partizan.

Në tërësi romanet që kanë për temë Luftën Nacionalçlirimtare dallohen për vërtetësi dhe për zbulimin e anëve të reja të kësaj epoke. Lidhja me të sotmen bëhet ose nëpërmjet vijave të subjektit, që ndriçojnë problemin e luftës kundër zakoneve të vjetra dhe të forcimit të unitetit moralopolitik të

popullit («Njeriu me top») ose nëpërmjet vënies në dukje të heroizmit të masave, të guximit dhe të pastërtisë morale të njerëzve, të dalë nga gjiri i popullit («Shtigjeve të zëna», «Nëntori i një kryeqyteti», «Njeriu me top»).

Ndër romanet që flasin për Luftën Nacionalçlirimtare, romani «Njeriu me top» (1975) i D. Agollit dallohet për idenë e rëndësishme, për subjektin origjinal, për vërtetësinë e imtësive dhe për gjallërinë e dialogut në frymë popullore. Në vështrim të parë, ngjarja që rrëfëhet në roman, ndonëse është e vërtetë, autentike, duket e jashtëzakonshme. Por në këtë fakt jo të rëndomtë, autori ka ditur të zbulojë një të vërtetë të madhe të rëndësishme mbi revolucionin popullor. Fshatari Mato Gruda, figura e të cilit është realizuar bukur në vepër, në fillim u kthen grykën e topit hasmëve të tij të vjetër, por pastaj, nën ndikimin e ideve të revolucionit popullor, të ngjarjeve të reja që zhvillohen në sytë e tij dhe, sidomos, të vrasjes së shokut të tij, komunistit Murat Shtaga, e cila e preku thellë, e kthen grykën e topit kundër gjermanëve. Krisma e topit bashkohet me breshërinë partizane; Mato Gruda plagoset për vdekje, por i biri bashkohet me partizanët, dhe lufton së toku kundër armikut, pushtuesve nazifashistë dhe veglave të tyre.

Tragjizmi i Mato Grudës e ka burimin te një plagë e vjetër e së kaluarës, të cilën e zhdok revolucioni. Kthesa e Mato Grudës është bindëse dhe jepet me anë të ngjarjeve që ndjekin njëra tjetrën. Por vepra mund të përfitonte po të tregohesh më mirë lufta e brendshme e heroit dhe ideja përgjithësuese, që shprehet përmes persiatjesh etj., të merrte përpjesëtime më të gjera.

Me gjithë sukseset e arritura në pasqyrimin e epokës së luftës çlirimtare antifashiste, duhet pohuar se në këtë fushë ka ende zbrazësi. Mungojnë vepra që të pasqyrojnë më thellë këtë ngjarje të rëndësishme historike; ka pak heronj pozitivë, të skalitur me mjeshtri artistike, ka munguar një konceptim më i thellë filozofik i ngjarjeve dhe i fakteve të jetës («Nëntori i një kryeqyteti»). Në ndonjë vepër personazhet janë vizatuar zbehtas («Shtigjeve të zëna») ose kthesa shpirtërore e heroit nuk motivohet sa duhet («Zgjimi i Nebi Surrelit»). Ndër të metat e vërejtura në romanet e viteve të fundit është

paraqitja jotipike e realitetit («Përballë hekurave të kryqëzuara»).

Tema e ndërtimit socialist dhe e ditëve të sotme është trajtuar në mjaft romane, prej të cilëve disa kanë tërhequr vëmendjen e lexuesve. Shndërrimet socialiste, vendosja e marrëdhënieve të reja midis qytetit dhe fshatit, lufta kundër revizionizmit dhe mobilizimi i masave për përmbushjen e detyrave të ndërtimit socialist kanë hyrë në tematikën e disa romaneve, si: «Përballimi» i T. Laços, «Mars» i V. Koreshit, «Dimri i madh» i I. Kadaresë, «Dueli i madh» i A. Abdihoxhës, etj. Romani i R. Pulahës «Rruga Budi 723» i është kushtuar problemit të familjes socialiste.

Romani «Përballimi» (1975) i T. Laços pasqyron vitet e para pas Çlirimit, hapat e para të qytetit dhe të fshatit në rrugën e jetës së re, luftën e Partisë kundër kulakëve dhe kundër psikologjisë së pronës private që mbante të lidhur me të kaluarën një pjesë të fshatarësisë punonjëse. Masat e pushtetit për grumbullimin e drithit, sigurimi i bukës për klasën punëtore dhe masat punonjëse të qytetit, lufta kundër spekulimit dhe tregut privat përbëjnë bazën, mbi të cilën ngrihet subjekti. Vepra shquhet për realizëm, për skalitjen e karaktereve të komunistëve, si: Martin Kreka e Miti Vozari, dhe të përfaqësuesve të fshatarësisë së varfër, si Tarja. Lufta e klasave përcakton edhe konfliktin e veprës, në të cilin duhet të kishin gjetur më mirë vend përpjekjet e Partisë për përmirësimin e jetës së fshatarëve të varfër. Romani «Përballimi», si vepër që paraqet me vërtetësi një periudhë të caktuar historike, ka zënë vend të denjë në prozën e sotme.

Romani i I. Kadaresë «Dimri i madh» (1977) është varianti i ripunuar, i romanit «Dimri i vetmisë së madhe», që u botoi më 1973. Në bazë të vërejtjeve të opinionit shoqëror dhe letrar, autori e përmirësoi veprën, duke plotësuar disa mungesa dhe duke ndrequr disa pjesë që e dëmtonin frymën e saj të përgjithshme. Përpunimi i kësaj vepre flet për kuptimin e drejtë dhe thellimin nga shkrimtarët tanë në mësimet e Plenumit IV të KQ të PPSH dhe në vëllimin e 19-të të Veprave të shokut Enver Hoxha. Romani «Dimri i madh» ka hyrë në letërsinë tonë si vepër me vlerë që pasqyron përmes një ndërtimi shumëplanësh fillimin e viteve 60, luftën e Partisë dhe të popullit kundër revizionizmit modern dhe kundër

blokadës imperialisto-revizioniste. Në botimin e dytë të romanit, autori i lidhi më mirë ngjarjet historike (Mbledhja e 81 partive në Moskë, qëndrimi i guximshëm dhe parimor marksist-leninist i Partisë dhe i shokut Enver Hoxha dhe i udhëheqësve të tjerë të Partisë) me ngjarjet që përshkruajnë jetën e përditshme në Shqipëri në atë periudhë, me frymën revolucionare që shquante masat punonjëse në ato ditë të stuhishme dhe me mobilizimin e tyre për të përballuar situatat e krijuara. Luftën e Partisë kundër revizionistëve modernë e përkrahu i gjithë populli; punëtorët shfaqën urrejtjen e tyre për tradhtinë e udhëheqësve sovjetikë dhe miratuan plotësisht vijën e Partisë; me ta u bashkuan edhe masat punonjëse, të moshuarit dhe të rinjtë, të cilët shtrënguan më fort rradhët e tyre rreth Partisë. Në vepër, figura e shokut Enver është e gdhendur me një stil konciz dhe të saktë; urtësia dhe mprehtësia e udhëheqësit të Partisë del përmes dialogut dhe imtësive psikologjike të cilat ndihmojnë që figura e shokut Enver Hoxha në ndërgjegjen e lexuesve të dalë e gjallë, e fuqishme, e skalitur me vërtetësi. Qartësia e mendimit, mprehtësia e fjalës, besnikëria ndaj parimeve marksiste-leniniste, lidhja me tokën mëmë janë tipare që karakterizojnë shokun Enver, si tipin e udhëheqësit revolucionar, që përjeton dramën e komunizmit, por e ka të qartë perspektivën e luftës kundër armiqve të socializmit, sepse mbështetet te parimet e pamposhtura të marksizëm-leninizmit dhe te populli i tij.

Romani ndërtohet sipas një dramaturgjie të brendshme që vjen e rritet paralel me zhvillimin e subjektit (ngjarjet në Pasha Liman, tradhtia e revizionistëve sovjetikë dhe qëndrimi i tyre antimarksist dhe antishqiptar). Në roman spikat me forcë patriotizmi i njerëzve të popullit dhe i ushtarëve që mbrojnë atdheun.

Subjekti i «Dimrit të madh» ka disa vija: vija e ngjarjeve të rëndësishme politike të epokës, vija e familjes Struga, vija e marrëdhënieve të gazetarit, Besnikut, me Zanën, vija e familjes reaksionare, vija e të rinjve etj. Autori ia ka dalë në përgjithësi si detyrës për të hartuar roman me ndërtim shumëplanësh, ku episodet shpesh vijnë e ngjiten si në një afresk ose mozaik me përmasa të gjera.

Stili i I. Kadaresë është narrativ dhe i figurshëm, me disa vegime metaforike. Ndonjëherë kalohet caku i shikimit rea-

list dhe metaforat bëhen të pakapshme. Ndarja e Besnikut me Zanën mund të ishte motivuar më mirë dhe ajo që ka më tepër rëndësi, është nevoja që karakteri i Besnikut të ishte pajisur me tipare më pozitive.

Romani «Dimri i madh», së bashku me vepra të tjera në prozë e në gjini të ndryshme, militon në luftën kundër revizionistëve dhe hap shtigje për vepra të reja mbi këtë temë.

Formimit moral të njeriut punonjës, vendosjes së marrëdhënieve të reja socialiste në familje, luftës kundër pasojave të kanunit dhe kundër lidhjeve të vjetra konvencionale midis njerëzve, i ka kushtuar romanin e vet «Mars» (1975) V. Koreshi, shkruar me një stil konciz e gjuhë të punuar. Nevoja e motivimit më të thelluar psikologjik të kthesave shpirtërore, si në këtë vepër, ashtu edhe në mjaft vepra të tjera, mbetet një kërkesë artistike që shtrohet përpara krijimtarisë letrare të kohëve të fundit.

Romani me temën e ditëve tona, ka ecur përpara; janë shkruar vepra, që vizatojnë tablo dhe heronj tipikë për periudhën plot epicitet e luftë klasash që ka kaluar vendi ynë vitet e fundit. Arritje të rëndësishme janë shënuar në krijimin e figurave të komunistëve dhe në forcimin e brendisë së romanit përmes paraqitjes së situatave dramatike.

Të metat që janë vënë re në romanet me këtë temë shfaqen në një farë ahistorizmi dhe shmangieje nga vërtetësia («Në kërkim të së vërtetës»), në elementet artificiale në thurjen e subjektit dhe në ecurinë e konfliktit («Dueli i madh»). E metë e rëndësishme, është sidomos trajtimi i pamjaftueshëm i temës së klasës punëtore dhe i fshatarësisë punonjëse, numri relativisht i pakët i heronjve pozitivë, që përfaqësojnë ndërtuesit aktivë të shoqërisë socialiste.

Edhe jeta e vështirë e masave të popullit para Çlirimit, fati i rëndë i gruas shqiptare në shoqërinë me klasa dhe aspekte të tjera të realitetit shoqëror të periudhave të kaluara, kanë tërhequr vëmendjen e prozatorëve tanë, të cilët kanë shkruar disa romane, si: «Shembja e idhujve» i S. Drinit, «Legjenda e vadave» i A. Cergës etj.

Romani «Legjenda e vadave» (1974) tregon gjendjen e mjeruar të fshatarësisë në të kaluarën. Në themel të subjektit është vendosur konflikti midis fshatarëve dhe beut shfrytëzues,

i cili ka rrëmbyer burimin e vetëm të ujit të fshatit. Në luftën e heroit kryesor të romanit, Fanit, i cili mbetet vetëm në luftën kundër beut për të hapur vadën, autori është përpjekur të gërshetojë diçka reale dhe legjendare, gjë që nuk është përlligjur deri në fund. Edhe «vetmia» e Fanit nuk është e besueshme, as edhe brenda konceptimit realist të jetës. Megjithatë romani ka faqe të shkruara me vull poetik dhe ka vlera edukuese.

Vend të rëndësishëm në pasqyrimin e së kaluarës zë romani «**Shembja e idhujve**» (1975), i cili është një nga veprat më të mira të kësaj periudhe. Subjekti e formojnë ngjarje nga jeta e malësisë së Veriut në vitet 30. Autori me një stil konciz ka skalitur karaktere tipike malësorësh, të dhënë në mjedise tipike e me ngjyrë lokale, dhe në marrëdhënie shoqërore të vizatuara me vërtetësi. Konflikti i mprehtë dhe i besueshëm që qëndron në bazë të subjektit, zë fill në luftën midis fshatarëve të ndershëm, që nisnin dalngadalë të fitojnë ndërgjegjen e tyre klasore, dhe mësuësit përparimtar, bartës mendimesh të reja, nga njëra anë, dhe figurës komplekse e tinzare të priftit e të kapedanit nga ana tjetër. Kjo vepër jep një copë jetë të gjallë nga ajo kohë. Përmes pasqyrimin me besnikëri të manevrave të klerit dhe të forcave të vjetra të malësisë, vepra i bën jehonë jetës së sotme, luftës ideologjike që zhvillohet në kushtet aktuale kundër mbeturinave të botës së vjetër. Romani flet se autori e zotëron mjeshtërinë letrare. Mungesa e një ritmi më të gjallë të rrëfimit ka bërë që veprimi të mos jetë aq dinamik dhe i shkathët. Pasqyrimi më i mirë i jetës në shumanshmërinë e saj (puna e fshatarëve, dhe disa anë të tjera të fshatit) do t'ia ngrinte vlerën këtij romani.

Romani historik ka zënë një vend të dukshëm në prozën e kësaj periudhe. Shkrimtarët që punojnë në këtë fushë subjektet për veprat e tyre i kanë marrë nga periudha të rëndësishme të historisë kombëtare, kryesisht nga epoka e Skënderbeut dhe nga Rilindja. Këto vepra, mbi të gjitha, trajtojnë problemin e unitetit moralo-politik të popullit, të luftës kundër pushtuesit të huaj si dhe të heroizmit të figurave të njohura historike, që kanë luftuar për të mbrojtur interesat e popullit. Romani historik ka arritur suksese në analizën e plotë dhe me vërtetësi të periudhave dhe ngja-

rjeve të së kaluarës, në paraqitjen e marrëdhënieve të shumëllojshme, në lidhje të ngushtë me prirjet themelore të epokës, në pasqyrimin artistik të betejave dhe të skenave konkrete, në të cilat zbulohet karakteri i personazheve. Rikrijimi i historisë në dritën e problemeve analoge të jetës së sotme, ka ndihmuar për të kuptuar më mirë ngjarjet aktuale. Në themel të veprave më të mira qëndron ideja se fryma heroike e popullit përballë armiqve të ndryshëm është farkëtuar në luftërat e rrepta dhe të parreshtura për liri, që kanë bërë shqiptarët, të bashkuar rreth një qëllimi të lartë, gjatë gjithë historisë së tyre.

Romani historik më i dalluar i kësaj periudhe, është «**Skënderbeu**» (1975) i S. Godos. Në vepër janë pasqyruar ngjarje që lidhen me luftën e popullit shqiptar, nën udhëheqjen e Skënderbeut, kundër pushtuesve osmanë. Rrjedha e historisë, betejat për mbrojtjen e vendit, marrëdhëniet midis princërve shqiptarë, raportet politike e diplomatike me shtetet e huaja, përshkrimi i luftës masive nën drejtimin e prijësve të shquar, bota psikologjike e personazheve, baticat dhe zbaticat e luftës kundër pushtuesit, këto janë aspektet që formojnë subjektin e veprës. Meritë e romanit është pasqyrimi me besnikëri i epokës, dhënia me realizëm i disa figurave qendrore, si: Skënderbeu, Vrana Konti, Moisi Golemi etj. si dhe përshkrimi i gjerë i skenave të betejave, të cilat shfaqen me veçantitë e tyre. Autori tregon shpirtin luftarak e patriotik të masave të popullit, të dhëna më të shumtën e herës në pamje të përgjithshme, si dhe veprimtarinë dhe qëndrimet e prijësve ushtarakë, tregon unitetin moral të popullit, si faktorin themelor të luftës për mbrojtjen e atdheut. Realizmi i veprës qëndron në pasqyrimin me vërtetësi të kësaj periudhe historike, me kontradiktat, grindjet dhe me qëndrimin separatist të disa princërve, që karakterizojnë epokën. Brenda kuadrit të luftës patriotike, tipat historikë dhe marrëdhëniet midis njerëzve janë dhënë me tipare të përcaktuara shoqërore, gjë që përbën një veçori pozitive që po shquan përherë e më shumë krijimtarinë letrare me temë historike.

Personaliteti i shumanshëm i Skënderbeut del i gjallë përmes veprimit dhe përsiatjeve, përmes marrëdhënieve të tij me popullin dhe përmes çasteve psikologjike që provon

ai dhe që jepen në dinamikën e tyre. Vepra mbështetet në një dokumentacion të pasur historik, ndonëse në thurjen e ngjarjeve është futur në punë edhe trillimi, i cili mund të ishte përdorur më gjerë, natyrisht pa prekur stilin e autorit. Krijimi i më shumë figurave imagjinare, krahas atyre historike, do të ishte në të mirë të romanit.

Përshkrimi të figurës së Shote Galicës, të luftës së malësorëve kundër pushtuesve si dhe të synimeve anti-shqiptare të serbomëdhenjve i është kushtuar romani «Prijsja e komitëve» (1975) i S. Krasniqit, një vepër me interes për temën që trajton dhe rrjedhshmërinë e rrëfimit të ngjarjeve.

Shkrimtari S. Spasse vitet e fundit ka trajtuar temën e Rilindjes Kombëtare. Në romanin «Zgjimi» (1974) autori ka synuar të japë luftën e shtresave të ndryshme të popullit dhe të disa udhëheqësve të Rilindjes Kombëtare kundër pushtuesve turq dhe kundër shovinizmit grek e veglave të tyre. Romani «Zgjimi», (1974) pasqyron luftën për përhapjen e gjuhës shqipe, përshkruan me ngrohtësi figurën e Themistokli Gërmenjit, të Margës, të Gjokë Shqiptarit etj. Vepra përshkohet nga patosi patriotik; ndonëse jo të gjitha pjesët kanë të njëjtin nivel, romani zgjon interes dhe emocion. Kthimi i Mistos në atdhe, dashuria për fjalën shqipe, figurat e njerëzve të thjeshtë, bota e brendshme e Margës, fryma shoqërore që përshkon veprën, përbëjnë anët pozitive të romanit. Çastet e frymëzimit të natyrshëm u shprehën edhe në stilin, vende-vende, të vrullshëm e poetik.

Me gjithë këto të meta e dobësi, romani me temë historike, i marrë në tërësi, ka shënuar suksese. Autorët që punojnë në këtë fushë kanë dhënë tablo të gjera realiste, në të cilat bie në sy një depërtim i thelluar në histori.

Romani satirik ka zënë një vend të dukshëm në krijimtarinë letrare të këtyre viteve. Janë botuar disa romane, si «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo» i D. Agollit, «Në hijen e dordolecëve» i M. Kallamatës, «Takim me djajtë» i T. Aliaj. Problemet kryesore që janë trajtuar në këto romane lidhen me luftën kundër burokratizmit, me luftën për kapërcimin e kontradiktave joantagoniste në shoqërinë tonë. Shumica e veprave të këtij lloji i kushtohet pasqyrimin të kontradiktave antagoniste; në to satirizohen orvatjet e

klasave shfrytëzuese të përmbysura për të kthyer të kaluarën («Në hijen e dordolecëve»), pasqyrohet ndeshja e dy botëve, në këtë anë dhe matanë kufirit («Takim me djajtë») etj.

«Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo» është një vepër e mprehtë satirike, e cila nëpërmjet situatave komike, vë në lojë figurën e një burokrati vanitoz. Këtë tip autori e ka vendosur midis njerëzve të shëndetshëm shpirtërisht, të cilët e dinë se ç'përfaqëson ai dhe tallen me të. Bashkë me «heroïn» në roman satirizohen edhe disa servilë, njerëz të pavendosur e karrieristë, që sillen rreth tij, duke i kryer shërbime të ndryshme. Subjekti është i thjeshtë, me pamje plot kontraste të jetës së përditshme.

Në këtë periudhë u vërejt një zhvillim i dukshëm i romanit me temë mbrojtjen e vendit dhe veprimtarinë e punonjësve të sigurimit. Siç dihet, ky roman që flet për ndjekjen dhe zbulimin e agjentëve të armikut, të akteve kriminale etj., ndryshon në thelb nga romani policor, i cili ka marrë përhapje të gjerë në Perëndim. Duke ruajtur fabulën e zhdërvjellët, elementin e të papriturës etj., romani ynë me temë veprimtarinë e punonjësve të sigurimit, trajton problemin e mbrojtjes së rendit popullor në emër të një qëllimi të lartë shoqëtor dhe tregon se si tek ne punonjësi i sigurimit dhe i policisë, janë të lidhur ngushtë me popullin dhe luftojnë për të mbrojtur interesat e tij. Fabula tërheqëse, mbizotërimi i ngjarjes mbi zbulimin e botës shpirtërore të personazheve janë karakteristike për këto romane, ku vërehet tani një prirje më realiste dhe harmonizim më i mirë i veprimit me botën e personazheve. Kjo temë është trajtuar me sukses edhe në gjini të tjera, si në tregimin dhe novelën.

Sukseset dëshmojnë pjekurinë artistike të romanit dhe mundësitë e mëdha që ka kjo gjini për një zhvillim më të hovshëm në të ardhmen.

Vitet e fundit është lëvruar gjerësisht edhe lloji i tregimit. Subjekte nga më të ndryshmet kanë tërhequr vëmendjen e tregimtarëve të njohur dhe të rinj. Shkrimtarët që punojnë në këtë fushë kanë dhënë episode nga qëndrimi heroik i nje-

rëzve të popullit në vitet e luftës kundër fashizmit, kanë vizatuar portrete të punonjësve të ditëve tona, kanë pasqyruar cilësitë e tyre të larta morale. Në disa tregime përmes konflikteve të mprehta është trajtuar problemi i luftës kundër burokratizmit. Tregimtarët kanë rrahur edhe probleme morale, problemin e familjes dhe të dashurisë, kanë goditur qëndrimet mikroborgjeze. Meskiniteti është luftuar si mbeturinë e shëmtuar e së kaluarës me të cilën shoqëria jonë nuk mund të pajtohet. Humanizmi socialist, si veçori thelbësore e letërsisë sonë, spikat në mjaft vepra. Tregimtarët kanë rrokur edhe temën e jetës dhe të përpjekjeve të klasës punëtore; shpesh ata kanë arritur të vizatojnë me ngjyra të gjalla figurën e punëtorit të ditëve tona, por në trajtimin e temës së klasës punëtore vihen re zbrazëti të ndjeshme. Krahas tregimtarëve të njohur, si N. Prifti, Dh. S. Shuteriqi, T. Laço, A. Kondo në këtë periudhë janë bërë të njohur me vëllimet e tyre një varg prozatorësh të rinj, si K. Kosta, Z. Çela, N. Lera etj.

Rruga e tregimit në këto vite ka qenë rrugë e përparimit të mëtejshëm. Tregimtarët kanë përsosur mjetet shprehëse; ata kanë përdorur më mirë dialogun dhe e kanë pasuruar gjuhën. Karakteristikë për tregimin e sotëm është ndjenja poetike që e përshkon; ngjarja që rrëfëhet në të plekset shpesh me lirizmin e cila shton ritmin poetik të rrëfimit. Disa prozatorë kanë arritur të thurin me zotësi subjekte dramatike. Fabulat në përgjithësi janë të thjeshta, pa ndërlikime, kjo është shenjë e pjekurisë së tregimit të sotëm.

Në rrugën e forcimit të vet të mëtejshëm tregimit të sotëm i duhet të kapërcejë disa dobësi, si mangësi ideore që shfaqen në pozicionin e paqartë të shkrimtarit; ndonjëherë nuk del në pah si duhet shkaku që e ka shtyrë autorin të pasqyrojë ngjarjen. Në disa tregime bie në sy një farë fryme libeske e zgjidhje artificiale e konflikteve. Mjaft tregime vuajnë nga një lloj skematizmi dhe deskriptivizmi, nga uniformiteti në tema dhe në kompozicion etj. Megjithë këto të meta, tregimi po ecën në rrugën e zhvillimit të tij të mëtejshëm.

Në tregimet e N. Priftit, A. Kondos është rrahur më tepër tema e Luftës Nacionalçlirimtare, gërshetuar kjo me temën e sotme; tema historike është lëvruar nga Dh. S. Shuteriqi dhe N. Prifti.

Vëllimi i N. Priftit «Njerëz të kësaj toke» (1975) flet për

koherencën e stilit të shkrimtarit, i cili vazhdon rrugën e tij të krijimit duke sjellë ngjarje dhe episode të reja. Krahas subjekteve që zhvillohen me ritëm të shtruar dhe me një lirizëm të lehtë, ky autor e ka pasuruar krijimtarinë e tij edhe me subjekte që kanë karakter dramatik. Virtytet morale të njerëzve të thjeshtë të popullit dalin me qartësi si në tregime me temë historike nga koha e luftës kundër pushtuesve austro-hungarezë («Zjarre pranë kënetës»), ashtu edhe në tregime që bëjnë fjalë për luftën popullore antifashiste («Muratori nga Borova») ose në tregime që pasqyrojnë periudhën fill pas Çlirimit («Mermergdhendësi»). Tregimi i fundit shkruar me një ritëm të qetë, bukurinë e ka në zgjidhjen e konfliktit, kur tregohet se si usta Petroja, njeri i heshtur dhe pa bujë, ngre një obelisk prej mermeri të kuq, me yll në majë, për të rënë e fshatit. Kur i thonë se për punën që ka bërë do ta shpërblejnë, ai nuk pranon në asnjë mënyrë. «Është paguar...», përgjigjet ai, duke treguar me dorë në drejtim të vorrezave të dëshmoreve, midis të cilave është vendosur obelisku.

Problemin e mprehtë të luftës kundër prepotencës dhe injorancës N. Prifti e ka trajtuar në tregimin «Mjeku i lokalitetit», ku përshkruhet mirë figura e mjekut këmbëngulës e të shkathët, i cili ndeshet me prapambetjen e fodullëkun dhe i shpie deri në fund përpjekjet e tij për të shpëtuar njerëzit.

Përparim në krijimtarinë e tij si tregimtar ka shënuar A. Kondoja me vëllimin «Njeriu që propozoj për hero» (1973), në të cilin, ashtu si edhe në tregimet e N. Priftit, realiteti i sotëm pasqyrohet në lidhje të ngushtë me ngjarjet e Luftës; ato shihen nga autori si aspekte të revolucionit tonë. Veçoria e tregimeve të A. Kondos qëndron tek pasuria e materialit jetësor, e prototipave në të cilët është mbështetur gjatë krijimit të personazheve, te karakteri dokumentar, që shquan disa prej tyre. A. Kondoja bën pjesë ndër ata shkrimtarë, në procesin krijues të të cilëve bie në sy shfrytëzimi i drejtpërdrejtë i fakteve. Lidhur me këtë, për krijimtarinë e A. Kondos, si edhe të ndonjë tjetri, paraqet rëndësi çështja që në disa raste të përcaktohet më mirë kufiri midis tregimit e reportazhit, gjë që lidhet me zgjerimin e rolit të trillimit krijues.

Në vëllimin e tij të fundit me tregime A. Kondoja jep portrete letrare, që zgjojnë emocione, si te tregimi «Sekretari», ku bëhet fjalë për heroizmin e thjeshtë dhe gjakftohtë-

sinë e një sekretari partie gjatë Luftës, te tregimi «Ai që dashuronte fëmijët dhe detin», ku të prek ndjenja e humanizmit socialist. Në tregimin «Njeriu që propozoj për hero» pasqyrohet jeta e një njeriu që u rrit bashkë me ngritjen e industrisë socialiste, e një njeriu me tipare të larta morale, si thjeshtësia dhe puna pa bujë. Vend të dukshëm në tregimet e A. Kondos zë tema e klasës punëtore, e naftëtarëve.

Krijimtaria e Dh. S. Shuteriqit në këto vite karakterizohet nga larmia e temave. Vëmendjen e lexuesit më shumë e kanë tërhequr tregimet për jetën e sotme si dhe tregimet me temë historike. Përmbledhja «Një mal me këngë» (1975) dëshmon për mjeshtërinë e autorit në thurjen e tregimit; disa tregime të tërheqin për frymën e tyre të freskët, për imtësitë e bukura poetike dhe për gjuhën e stilitin e zgjedhur. Heroizmi i një shoferi («Leksi i Gogos»), kujtimet e jetës me çobanjtë («Kujtime stanesh»), akti i një çobani që bleu kumborë për bagëtitë se donte të dëgjonte këngë në male («Një mal me këngë»), puna këmbëngulëse e një skulptori («Tani të rroj») janë temat e tregimeve më të mira të përmbledhjes. Disa tregime rikrijojnë figura të njohura historike. Ndër tregimet që sjellin diçka të re në pasurimin tematik të prozës së shkurtrës është «Dispeçerja», ku vizatohet bota e brendshme e një vajze të re të ditëve tona, së cilës i duhet të mësohet me një mjedis të ri, të përballojë thumbat dhe qesënditë e njerëzve meskinë dhe të fitojë mbi elementët e prapambetur në sajë të mbështetjes së kolektivit punëtor, i cili e ndihmon që të bashkohet me njeriun që do. Krahas krijimeve me vlerë ideore dhe artistike, te ky autor në këtë periudhë hasen edhe tregime të zbehta e të sipërfaqshme.

Për krijimtari të pasur në fushën e tregimit u shqua në këto vite edhe T. Laçoja. Vëllimi i tij «Pylli në vjeshtë» (1976) shquhet për tregime, të shkruara me mjeshtëri; ato trajtojnë kryesisht tema etiko-morale, kjo i ka dhënë dorë shkrimtarit të vërë në pah virtytet e njeriut të popullit në të kaluarën, e njerëzve të ditëve tona. Vëmendjen e autorit e tërhoqi lufta kundër meskinitetit, kundër frymës së ngushtë dhe prapanike në jetë, temë kjo e rrahur prej tij edhe në tregimet e mëparshme. Përmbledhja e fundit me tregime e T. Laços flet për përsosjen e mëtejshme të stilit dhe të gjuhës së tij. Rrëfimi i qartë dhe i kuptueshëm, i pleksur me përshkrime poetike

të shpirtit të njeriut ose të natyrës, përbën një nga veçoritë dalluese kryesore të talentit të këtij autori. Ndër veprat më të goditura të T. Laços duhet përmendur tregimi «Valltari», ku përshkruhet ndjenja prej artisti të vërtetë e një gdhendësi që e heq vallen me pasion dhe gëzohet kur sheh një të ri më të zotin se vetja, tregimi «Të dielat e mërgimtarëve», në të cilin flitet për shpirtin patriotik të të mërguarve, që dilnin e këndonin të dielave nga malli për mëmëdhenë etj. Jo të gjitha tregimet janë të një niveli; megjithatë, në përgjithësi, vëllimi dëshmon për pjekurinë e shkrimtarit, i cili në këtë periudhë ka dhënë kontribut të ndjeshëm edhe në fushën e romanit e të dramës.

Tipa të rinj, konflikte të mprehta shoqërore e morale dhe zbulimi më i plotë i botës shpirtërore të njeriut tónë karakterizojnë krijimet e penave të reja në fushën e tregimit. Rrealizmi dhe ngrohtësia në përshkrimin e jetës së fshatit, pasqyrimi i konflikteve në themel të të cilave qëndron ndeshja midis ndjenjës së drejtësisë e të së vërtetës dhe së keqes e burokratizmit, paraqitje e epërsisë të së resë mbi të vjetrën shquajnë tregimet e K. Kostës. Heronjtë e tij janë njerëz që kanë dashuri për punën, fshatarë me personalitet, që e mbrojnë deri në fund të drejtën dhe fitojnë mbi shpërdoruesit, mbi elementët e burokratizuar (tregimi «Dademadhja»). Ideja e tregimeve «Anika» dhe «Pasi dëgjova këngën e një gruaje» është humanizmi socialist që shpëtoi njerëzit e thjeshtë nga zakonet e vjetra prapanike dhe ndihmoi për krijimin e familjes së re, përmes lidhjeve të vërteta morale.

Në tregimet e tij Z. Çela shpreh mbresat dhe vëzhgimet nga jeta e punëtorëve dhe sharrëxhinjve. Për stilitin e këtij autori është karakteristik vështrimi poetik i ngjarjes, e cila ndonëse në disa raste është e zakonshme dhe me pak fabul, jep mundësi për zbulimin e mendimeve dhe të psikologjisë së njerëzve. Për një çift të ri që shkon të jetojë e të punojë atje ku e kërkon atdheu flitet në tregimin «Në një qytet», kurse në tregimin «Tomë Zheku, njeri i lumtur» vizatohet figura e një punëtori që ngrihet mbi dëshirat e vogla meskine. Lartësimi i pastërtisë morale të njerëzve tanë dhe demaskimi i frymës meskine është problemi që rrihet në tregimin «Drita që pikon në pyll». Probleme të moralit të ri trajtohen edhe në tregimin «Lirika e qiellit të drunjtë». Në mjaft tregime të

Z. Çelës një vend të mirë zë peizazhi, i cili ndihmon për zbulimin e botës së brendshme të njeriut. Freskia e temave, rrëfimi i këndshëm, ndonëse nganjëherë disi i njëllojshëm, shquajnë tregimet e N. Lerës. Tregimi «Era e pishave» është një përshkrim i goditur i jetës së përditshme të një mësueseje. E zhgënjyer nga i dashuri, ajo gjen përkrahjen e njerëzve tanë të mirë, të cilët e ndihmojnë të marrë veten nga hidhërimi dhe të zërë vendin e saj në jetë. Në krijimtarinë e autorit të ri tërheqin vëmendjen tregimet që flasin për njerëz të thjeshtë, bartës të cilësive të larta morale.

Në novelën e këtyre viteve është trajtuar kryesisht tema e Luftës Nacionalçlirimtare dhe ngjarje të ditëve tona; vend më të vogël në të zuri tematika historike.

Novela «Nusja e humbëtirës» (1975) e R. Pulahës i kushtohet një ngjarjeje pak të jashtëzakonshme, përmes të cilës ndriçohet problemi i cilësive morale, si kriteri më i lartë i vlerësimit të njeriut në vitet e kthesës revolucionare. Një vajzë fshatare, Belen sipas zakonit të vjetër, e kanë fejuar me një djalë që ajo nuk e njeh, Ganiun. Vajza ka brengën e saj, po nuk ngrihet dot kundër zakonit, ndonëse për djalin i kanë folur mirë. Dasmorët, që po çonin Belen tek shtëpia e dhëndrrit, i ndihmojnë një korrieri partizan të plagosur, i cili është nisur me një mision të ngutshëm. Në shtëpinë e dhëndrrit ngjet diçka e papritur: Ganiu, lë dasmën dhe niset me korrierin, se i di rrugët dhe është njeri i besuar i luftës. Belja e çmon bukurinë e gjestit dhe heroizmin pa bujë të Ganiut dhe nis ta dashurojë atë. Autori tregon se si e reja nis të hyjë në jetë në ato vite përmes humanizmit popullor të përforcuar në luftë. Tema e freskët dhe origjinale e kësaj novele ka gjetur mishërimin e duhur artistik.

Si prototip për personazhin kryesor të novelës «Nusja dhe shtetrrethimi» (Nëntori 1976) e E. Kadaresë ka shërbyer «Heroina e Popullit» Liri Gero. Shpresa është një vajzë e popullit, me shpirt të pastër, e lidhur me njerëzit, trime dhe aktiviste e palodhur e lëvizjes popullore. Në këtë novelë heroizmi, delikatesa dhe bukuria shpirtërore e kësaj «nuseje» u kundërvihen epërsisë dhe brutalitetit fashist.

Në novelën e viteve të fundit vëmendje u është kushtuar gjithashtu pamjeve dhe tipave nga jeta e sotme. Midis novelave që pasqyrojnë punën për ndërtimin e socializmit vend të

dukshëm zë novela e Sh. Musarajt «Dritë» (1973), në të cilën tregohet puna këmbëngulëse dhe entuziaste e rinisë së një fshati për të ngritur hidrocentralin. Konfliktet është real dhe joantagonist; të rinjtë luftojnë për t'ia mbushur mendjen kryetarit të kooperativës Fasli Gurit, për rëndësinë e ngritjes së hidrocentralit. Në novelë ka pasuri të leksikut dhe të frazeologjisë popullore. Ashtu si edhe në vepra të tjera që shtrojnë problemin e kthesës shpirtërore të njerëzve, edhe këtu vërehen dobësi në paraqitjen e shndërrimeve në ndërgjegjen e njerëzve; ato nuk janë kurdoherë të thelluara e ndonjë herë vetëm deklarohen. Megjithatë, novela «Dritë», me nivelin e saj ideoartistik dhe gjuhën e rrjedhshme, kontribuon në trajtimin e temës së fshatit, për të cilën ka pak vepra.

Për jetën e sharrëxhinjeve, për punën e tyre të vështirë rrëfehët me një narracion të shtruar e të qartë dhe optimizëm të brendshëm në novelën «Borë në bjeshkë» (1974) e Vito Koçit. Nga përshkrimet konkrete që flasin për njohje të mirë të jetës, del ideja e punës si burim i jetës, jepet bukuria e saj. Personazhet janë tipa të gjallë e plot jetë; kjo gjë është arritur, në përgjithësi, me realizëm dhe pa zbukurime.

Në novelën «Erë e fortë» (1976) A. Cerga pasqyron luftën kundër zakoneve prapanike, me gjithë ashpërsinë e saj; në vepër kontradiktat antagonistë zgjidhen drejt. Sipas zakonit të vjetër barbar, një grua shtatzënë, për dënim e mbyllin në bodrum, gjë që vë në rrezik jetën e saj dhe të fëmijës që pret. Por forcat përparimtare e nxjerrin atë nga errësira dhe e shpëtojnë. Drita e së resë ndriçon mendjen e pleqve, që si viktimë e zakonit të vjetër kishin dënuar pa të drejtë gruan e re.

Zgjerimi i problematikës, përligjja më e mirë e kthesave shpirtërore, ndjekja e ritmeve të jetës, përbëjnë sot detyrat artistike, zgjidhja e të cilave do të krijojë mundësitë e një zhvillimi më të mbarë të kësaj gjinie.

Si e gjithë krijimtaria letrare, pas Plenumit IV të KQ të PPSH, edhe novela ka ecur përpara, duke luftuar ndonjë shfaqje të huaj që është vënë re në ndonjë vepër të veçantë si p.sh. në novelën «Dit dhe net që mund të vijnë» e T. Laços, ku mungon shpirti luftarak i popullit dhe zotëron një ndjenjë pasiviteti. Në këto vite ka pasur edhe tregime të cekëta dhe të njëanshme, pa brendi të shëndoshë dhe pozicion të përcak-

tuar ideor. Të metat e novelës janë të pjesshme. Karakteristikë e prozës së shkurtër dhe në këtë mes dhe e novelës, është forcimi i frymës ideore dhe rritja e mëtejshme e nivelit artistik.

4

Gjatë kësaj periudhe u vërejt një jetë e gjallë në fushën e poezisë; krahas poetëve të njohur, si D. Agolli, I. Kadareja, Ll. Siliqi, F. Gjata, F. Arapi etj., dalin përpara publikut lexues me poema a përmbledhje vjershash një varg poetësh të rinj, si A. Istrefi, N. Gjetja, N. Papeleka. Përveç kësaj po bëjnë emër në faqet e shtypit ose me libra poezish edhe një sërë autorësh më të rinj.

Veçori dalluese e poezisë së këtyre viteve është forcimi i përmbajtjes së saj; në këtë fushë u luftuan shfaqjet e huaja, si shtrembërimi i përmbajtjes në krijime të veçanta, kuptimi i gabuar i problemit të burokratizmit dhe i kontradiktave, mjetet hermetike dhe formaliste që u vunë re në raste të veçanta si dhe përdorimi i tepruar i figurave artistike, gjë që errësonte brendinë e poezisë dhe çonte ndonjëherë në manierizëm.

Duke kapërcyer shfaqjet e huaja dhe duke u mbështetur gjithnjë e më fort në traditën kombëtare pozitive, poezia arriti suksese në përmbajtje e në formë. Në fjalën e tij të 20 Dhjetorit 1974, shoku Enver Hoxha i porositi poetët, sidomos të rinjtë, që të mos mbesin në ide të përgjithshme, por t'i materializojnë pamjet e jetës; për këtë qëllim, ata duhet të studiojnë me ngulm «dibrin e madh të jetës». Sikurse në gjinitë e tjera, edhe në poezi u shtrua si kërkesë e domosdoshme forcimi i realizmit dhe i botëkuptimit revolucionar.

Autorët më me përvojë kanë lëvruar me sukses poemën, e cila ka ecur në gjurmët më të mira të dhjetëvjeçarit të kaluar. Prirja për të pasqyruar realitetin me anë të tablove poetike të sintetizuara, që u shfaq më qartë në fund të viteve 50 e në vitet 60, ka ardhur duke u thelluar dhe pasuruar më tej. Disa nga poemat më të mira kanë pasqyruar ngjarje të rëndësishme të realitetit aktual e historik dhe kanë dhënë pamje poetike me përmasa të gjera dhe të plota («Nënë Shqipëri» e

D. Agollit), ose kanë trajtuar probleme të mprehta politike të aktualitetit («Vitet gjashtëdhjetë» e I. Kadaresë). Në këto vite u thelluan dhe u bënë akoma më organike lidhjet e poetit me shoqërinë. Përparimi i poezisë në vitet 60 u shfaq në sintezën e mendimit dhe të fakteve, por në disa raste u vu re një abstragim i tepruar nga jeta konkrete, gjë që ishte një farë reagimi ndaj deskriptivizmit, nga i cili vuanin disa poezi. Në disa poema të këtyre viteve u bë më mirë dhe më me efekt emocional gërshetimi i fakteve, i episodeve dhe i ngjarjeve me mendimin dhe ndjenjën («Drejt qindra shekujsh shkojmë» e F. Arapit, «Poemë për Zaho Kokën» e P. Jorgonit, «Poemë për Karadakun» e A. Istrefit etj.), poezi të A. Çaçit, A. Gjakovës, V. Zikos etj.

Në poemë ka mbizotëruar lloji liriko-epik, në të cilin spikat fryma epike, gërshetuar me një lirizëm të thellë, që ka dhënë dorë për zbulimin e botës së brendshme të heroit lirik në sfondin e ngjarjeve të jetës socialiste. Lirizmi del edhe në vargjet ku poetët u drejtohen atdheut, ngjarjeve, njerëzve si dhe, në pjesët ku meditojnë rreth fakteve, polemizojnë me armikun, kujtojnë të kaluarën ose i drejtohen së sotmes. Fryma lirike përshkon edhe vargjet, ku poetët flasin për të ardhmen. Në rrugën e vet drejt suksesesh të reja, poemës liriko-epike në këto vite iu desh të kapërcejë një varg të metash; në disa vepra ka munguar pikënisja filozofike dhe mendimi poetik është organizuar dobët. Krijime të veçanta kanë vuajtur nga fragmentarizmi, nga niveli artistik jo i njëjtë i pjesëve të ndryshme.

Megjithëse poema tregimtare, poema me subjekt, pothuajse nuk u lërua fare, në disa poema liriko-epike të këtyre viteve ka hyrë organikisht një lloj fabule e domosdoshme për të shprehur mendimin poetik. Forcimi i mendimit dhe i përgjithësimit në poezi ka qenë një dukuri pozitive, por është vënë re monotoni formash, ka munguar lënda e duhur konkrete për të dhënë realitetin me ngjyra të freskëta dhe të gjalla.

Zhvillim të mirë njohu edhe poezia lirike; u botuan shumë vëllime, cikle poetike dhe poezi të veçanta. Por, me gjithë përparimin e vërejtur në brendi dhe në formë, është vënë re se sasia nuk ka qenë kurdoherë në raport të drejtë me cilësinë. Janë krijuar edhe vjersha të rëndomtë, të përgjith-

shme, me brendi të varfër, pa formë të bukur dhe pa gjuhë të përpunuar.

Në tërësinë e vet lirika ka qenë militante; tematika e saj është pasuruar. Numri i të rinjve që lëvrojnë lirikën është i madh. Temat e preferuara të vjershëve lirike janë dashuria për Partinë, lufta kundër imperializmit e revizionizmit. Poetët i kanë kënduar atdheut, kanë evokuar aktin vetëmohues të dëshmorëve, kanë lartësuar frymën heroike dhe gadishmërinë e njerëzve tanë për mbrojtjen e vendit. Edhe motivet e natyrës dhe të dashurisë kanë zënë vendin e tyre në lirikën e këtyre viteve.

Poezia ka pasur një zhvillim të dukshëm edhe në fushën e formës artistike. Në krijimet më të mira është pasuruar vargu; prirja për ta përfshirë jetën në aspekte të shumta, ka bërë që disa herë kompozicioni i poemave të fitojë një karakter të ndërlikuar. Në lirikë është zgjeruar sfera e interesave të heroit lirik, i cili është dhënë me imtësi jetësore. Sukseset e arritura në fushën e vargut lidhen me shfrytëzimin e traditave më të mira kombëtare, sidomos me arritjet e poezisë sonë të realizmit socialist, dhe me përpjekjet për t'iu përgjigjur kërkesave estetike të kohës. Metri i poezisë është bërë i larmishëm, ai ka shprehur më mirë pasurinë e ritmeve të jetës dhe individualitetin krijues. Pas Plenumit IV të KQ të PPSH është luftuar me vendosmëri për qëndrueshmërinë e vargut që sugjeroi përvoja e poezisë së realizmit socialist, me atë rregullësi dhe ato kritere estetike që burojnë nga praktika dhe janë të domosdoshme për kohën.

Tipat e metrit që kanë zotëruar në poezinë e kësaj kohe shquhen nga rregullsia ritmike, nga muzikaliteti që krijon pasuria ritmike dhe pasuria e rimave. Llojet e rimave që mbështeten në prosodinë e poezisë popullore, përdoren rëndom. Por kjo rregullsi, në vijat e saj të përgjithshme, ka evoluar; nga vargu tipik klasik, silabotonic, me theksa që përsëriten në mënyrë të barabartë nga vargu në varg, është kaluar në një varg më të shumëllojshëm, i cili jep dorë për të shprehur më mirë pasurinë e brendisë, lëvizjen e vrullshme të mendimit. Megjithatë janë krijuar edhe mjaft poezi me varg krejt të rregullt, gjë që është plotësisht e natyrshme. Kthimi te vargu i matur, me rimë e me ritëm, ka qenë karakteristik për poezinë e mjaft të rinjve në vitet e fundit. Me sukses

është përdorur edhe vargu i lirë, kur është konceptuar drejt brenda një rregullsie të caktuar poetike.

Poezia e kësaj periudhe është larguar nga mbingarkesa figurative, nga shfaqjet e hermetizmit ose të simbolizmit, ndonëse mbeturina të këtyre shfaqjeve vihen re ende, aty-këtu. Një vend të sigurt në arsenalin e mjeteve poetike ka zënë epiteti, krahasimi i qartë dhe metaforat që burojnë nga përjasjet e dukurive jetësore, nga synimi për të materializuar idetë ose për të zbuluar kuptimin e përgjithshëm të fakteve dhe të dukurive të jetës. Animizmi në përgjithësi është përdorur më me efekt, si mjet i gjallërimit dhe i humanizimit të botës që na rrethon. Figurshmëria e poezisë është pasuruar në sajë të mbështetjes në folklor, të zgjedhjes më me kujdes të fjalës poetike, të përdorimit më me kriter të tropeve dhe të gërshetimit më të mirë të mjeteve të ndryshme të shprehjes.

Janë shkruar mjaft poema e vëllime poetike, ndër të cilat vend të dukshëm zë poema «Nënë Shqipëri» dhe vëllimi «Fjala gdhend gurin» të D. Agollit.

Poema madhore «Nënë Shqipëri» (1975) është një nga krijimet më të bukura të poezisë sonë të re. Ajo është një poemë e madhe epike, e përshkruar nga nota të ndjeshme lirike dhe si e tillë bën pjesë në llojin e poemës liriko-epike. Poemën e përshkon mendimi i partishëm, i mburjtur me idealin komunist dhe me pasqyrimin konkret të realitetit të Shqipërisë socialiste. Shqipëria jepet përmes një simboli të thjeshtë e të kuptueshëm, të nënës, te e cila hero i lirik merr frymëzim dhe gjen prehje. Ky është lajtmotivi që ndihmon për të dalë në temat dhe në motive nga më të ndryshmet, të cilat lidhen me mendimin qendror.

«Nënë Shqipëri» është një himn kushtuar atdheut dhe, njëkohësisht, një histori e sintetizuar poetike e rrugës së Shqipërisë socialiste, një portret i saj me përmasa të gjera. E sotmja me të kaluarën, me historinë, lidhet me fije të shumta, përmes ngjarjesh dhe figurash historike, të dhëna në disa çaste kulminante të rrëfimit poetik. Idetë kryesore të poemës, në qoftë se do t'i përmbledhnin shkurt janë: forca e njeriut, tonë qëndron në lidhjet e tij me popullin, me tokën mëmë, me çështjen e ndërtimit të socializmit; shoqëria jonë ka si qëllim kryesor të saj të mbrojtë dhe të bëjë më të lumtur njeriun; historia e çlirimit të popullit nga shtypja, historia e

ngritjes dhe e përparimit të punëtorëve, të fshatarëve si dhe e shtresave të tjera lidhet me ekzistencën e Partisë dhe me drejtësinë e vijës së saj marksiste-leniniste; zhvillimi i parë i jetës sonë dhe në përgjithësi, i shoqërisë socialiste, forcimi i vendit është arritur përmes luftës klasore, e cila ka qenë faktor përparimi, këndej buron edhe thirrja për vigjilencë, për të mos harruar strehën, për të luftuar burokratizmin e mendjemadhësinë, për të qenë i thjeshtë, për të ruajtur diktaturën e proletariatit dhe demokracinë socialiste; lumturia e popullit dhe e çdo individi është e lidhur me fatet e komunizmit, me Partinë, me çdo pëllëmbë toke të këtij vendi, me punën, me pyjet dhe lumenjtë, me bukuritë e pashoqe të atdheut; poezia duhet të jetë e fuqishme si jeta jonë, rrugët e kërkimit të saj janë të vështira, por poeti i Shqipërisë socialiste duhet të punojë dhe të jetë këmbëngulës për t'ia arritur krijimit të një poezie për popullin.

Poema «Nënë Shqipëri» shquhet për interpretimin e fakteve përmes botës lirike të poetit. Singëriteti dhe imtësitë e befashme me anë të të cilave karakterizohen aspekte të rëndësishme të jetës, e bëjnë veprën komunikuese dhe të ngrohtë. Poema është një shembull tipik i ndërtimit polifonik, ku mendimi shprehet përmes frymëzimit të lirë dhe të vetvetishëm; ajo ka një arkitekturë, në dukje të lirë, por të menduar dhe funksionale. Faktet dhe idetë politike e shoqërore, çastet konkrete ndërthuren me parantezat dhe hovet lirike të poetit. Procedimi i rrëfimit poetik, i cili ndjek rrugën e zhvillimit historik të vendit në momentet e saj kyçe, thyhet nga përqsasjet e së kaluarës me të soimen. Në poemë ka një gërshetim të harmonishëm të pamjeve të sintetizuara me zbulimin e botës së brendshme të heroit lirik, të epikës me lirikën e, ndonjëherë, edhe me satirën. Këmbimi i këtyre planeve të rrëfimit poetik ka përcaktuar ecurinë e veprës.

Vargu mbështetet në traditën dhe, njëkohësisht, sjell diçka të re në poezinë tonë të sotme; është një varg i shtruar, me ritëm e rima të përhershme, me një rregullsi theksash poetikë, të cilët, duke ruajtur vazhdimësinë e tyre, krijojnë muzikalitet. Vargu ndryshon brenda një uniteti ritmik dhe nuk ka kapërcime të papërligjura. Poema «Nënë Shqipëri», së bashku me krijimet e tjera të rëndësishme të kësaj peri-

dhe, dëshmon për forcën dhe gjerësinë që mori arti ynë, i frymëzuar nga mësimet e Partisë. Vepra të tilla dëshmojnë për pjekurinë artistike të poetëve tanë, që u arrit në luftë për përparimin e mëtejshëm të letërsisë.

Vëllimi me vjersha e poema «Fjala gdhend gurin» (1977) i D. Agollit përmbledh krijime të viteve 70. Është po ai personalitet poetik që zhvillohet më tej, duke ruajtur freskinë, pasurinë e motiveve poetike, gjuhën e zgjedhur dhe muzikalitetin e vargut. Në këtë vëllim tërheq vëmendjen pasuria e mendimeve dhe e ndjenjave; gjejmë në të dashurinë e poetit për vendlindjen, për fshatin e qytetin, gjejmë grishjen e tij drejtuar të rinjve që të ecin në rrugën e revolucionit («Babanë tënd e kisha shok»). I nisur nga bukuria e natyrës shqiptare, heroit lirik flet me ngrohtësi për vendin («Patat e egra»), ai përqsas bukurinë e natyrës me atë të njeriut, dhe përmes kësaj zbulon synimet e pastra morale të njerëzve tanë («Mollët»). Bota e heroit lirik del qartë në kapitullin «Kënga e njeriut». Poezia e D. Agollit është militante; ajo është shkruar me një ndjenjë të lartë qytetare dhe përgjegjësi për rolin shoqëror të artit. Në kapitullin «Kënga e buzëqeshjes» vihet në lojë burokratizmi e servilizmi («Servili vajton shefin»), demaskon konservatorët e liberalët, mblesët dhe vanitozët («Pleshti»). Poemat «Komunistët» dhe «Nëntoriada», të shkruara me ton polemik, janë përgjithësimet poetike të rrugës historike të Partisë e të Atdheut, të luftës së popullit shqiptar kundër borgjezisë reaksionare e revizionistëve. Te «Komunistët» gërshetohet më mirë patosi qytetar me botën lirike të poetit, ndërsa në poemën «Nëntoriada», me gjithë meritat, vërehen përsiatje motivesh dhe mungojnë disa kulme emocionale.

Prirjet kryesore të zhvillimit të poezisë në këtë periudhë u shprehën me një qartësi brendie dhe stili, edhe në përmbledhjen poetike «Koha» (1976) të I. Kadaresë, në të cilën ndeshim temat e preferuara të poetit, si jeta e sotme dhe e kaluara historike e atdheut, historia e popujve të tjerë, për të cilën poeti mediton, duke marrë shkas nga fakte të thjeshta. Te «Koha» vihet re pjekuria politike e autorit, prirja e tij për të trajtuar tema të rëndësishme, të marra nga ngjarjet e mëdha politike e shoqërore të kohës. Në këtë përmbledhje bie në sy eleganca poetike e I. Kadaresë; poeti

e çastit poetik të nevojshëm për të shprehur idenë artistike, karakterizojnë vëllimin poetik «Shqipja rreh krahët» (1975) të N. Gjetjes.

Në lëmin e poezisë satirike janë botuar disa vëllime me vlerë, që trajtojnë luftën kundër burokratizmit, probleme morale e shoqërore etj. Vëllimi «Shigjeta» (1975) i D. Bubanit ka merita ideore dhe artistike. Lëvrimi i fabulës dhe i gjinive të tjera humoristike-satirike ka shquar këtë lloj poezie. Por, në përgjithësi, poezia satirike, ka ecur në këto vite me ritme të ngadalshme.

Si përfundim, poezia shqiptare e realizmit socialist shkoi në këto vite përpara dhe i forcoi pozitat e saj; u thellua partishmëria komuniste, u zgjerua rrethi i problemeve të trajtuara, u rrit mjeshtëria artistike. Zëra të shumtë të rinj iu shtuan emrave të brezave poetikë, tashmë të njohur gjërisht në masat e lexuesve.

5

Sikurse llojet e tjera, edhe dramaturgjia ka ecur në rrugë të drejtë; ajo u zhvillua në luftë kundër shtrembërimeve, që u vunë re në disa drama të botuara para Plenumit IV të KQ, si heqja dorë nga pasqyrimi i heroit pozitiv dhe interesi për heroin e lëkundur, nxirja e realitetit, paraqitja në frymë të gabuar e marrëdhënieve familjare, zbatimi i mjeteve artistike, që jipnin një pasqyrim jorealit të jetës.

Përparimi i dramës u shfaq në forcimin e brendisë ideore të veprave që u botuan ose u vunë në skenë, në përpjekjet për të pasqyruar aspekte të reja nga epopeja e luftës dhe nga jeta socialiste, sidomos punën ndërtimore të njerëzve tanë, heroizmin e klasës punëtore. Në dramën dhe komeditë e K. Jakovës, T. Laços, R. Pulahës, F. Krajës, V. Zikos, H. Minarollit, L. Qafëzezit etj., janë trajtuar tema nga Lufta Nacionalçlirimtare dhe ndërtimi socialist; autorët kanë vënë në qendër heroin pozitiv dhe kanë zgjidhur përgjithësisht drejt kontradiktat e jetës. Kontradiktat antagonistë, që lidhen me luftën e ashpër që zhvillon populli shqiptar kundër rrethimit imperialisto-revizionist dhe me ashpërsimin e luftës klasore brenda vendit, janë pasqyruar drejt në dramën e sot-

me, ndonëse ka pasur raste kur kontradiktat nuk janë konceptuar në mënyrë të thelluar; pas fakteve e ngjarjeve nuk është dhënë ndeshja midis koncepteve, që janë në luftë me njëra-tjetrën. Kontradiktat joantagoniste janë paraqitur të skematizuara, jo përmes problemesh të mprehta aktuale. Disa nga këto drama shquhen për mjeshtëri artistike, për dialog të natyrshëm e të gjallë dhe për një thurje interesante të konfliktit. Skenat që pasqyrojnë veprimet e individëve të veçantë janë gërshetuar më mirë me skenat masive. Personazhet shpeshherë janë skalitur mirë; përmes pasqyrimin të veçorive të karakterit të tyre, është dhënë atmosfera e kohës. Por janë vërejtur edhe dobësi artistike. Në disa drama kthesat shpirtërore nuk janë motivuar, nuk janë dhënë shkaqet shpirtërore dhe morale që kanë përcaktuar rrugën e personazheve ose ecurinë e dramës.

Tematika e Luftës Nacionalçlirimtare është rrahur në drama, si «Gjëmimi i atij dimri» i T. Laços, «Mësim nga historia» i L. Qafëzezit etj.

«Gjëmimi i atij dimri» («Nëntori», XII, 1967) është ndër dramën më me vlerë ideoartistike të këtyre viteve. Në subjektin e saj plekset lufta e një fshati, me komunistët në krye, kundër pushtuesve nazistë dhe ballistëve, me luftën për të mposhtur zakonet e vjetra dhe sidomos për të shkatërruar orvatjet e armikut që synonte të përcante popullin me anë të lidhjeve fisnore dhe krushqive. Subjekti i dramës është i thjeshtë: fshatarët ruajnë të fshehur një partizane të plagosur. Përmes rrëfimit të kësaj ngjarjeje spikat heroizmi i fshatarëve, ndeshja e tyre me armikun, ngurrimi i ndonjerit (Hodoja) dhe kthesa e tij e plotë shpirtërore. Në dramë kanë rol të rëndësishëm skenat masive, ndonëse ishte e nevojshme një gërshetim më i mirë i tyre me skenat, ku karakteret hyjnë në marrëdhënie të veçantë me njëri-tjetrin. Drama është shkruar me gjuhë të zgjedhur dhe me imtësi poetike. Me frymën popullore që e përshkon, me çastet heroike dhe situatat dramatike, drama zgjon emocione te lexuesit.

Në dramën «Mësim nga historia» (1977) e L. Qafëzezit rrëfëhet për një ngjarje të ndërlikuar. Personazhi qendror Asim Zagora, njeri i lidhur me luftën dhe me Partinë, jeton përkohësisht një gjendje shpirtërore të rënë, kur i thonë që shoku i tij i fëminisë është spiun, gjë që ai nuk do ta

besojë. Autori kritikon këto qëndrime dhe fton për frymë revolucionare e për vigjilencë. Faktet e detyrojnë heroin të bindet. Pas kësaj ai e merr veten, afrohet me shokët dhe gjatë kryerjes së një aksioni vritet në luftë me armikun. Drama zhvillohet në një sfond të pasur historik; autori përshkruan mjedisë popullore, figura komunistësh edhe figura të armiqve. Drama ka një platformë historike, mbi të cilën ndërtohet subjekti, me natyrë social-psikologjike. Motivimi më bindës nga ana shoqërore i veprimeve të Asim Zagorës dhe ndërtimi jo aq kompakt përbëjnë të metat e dramës.

Ndër dramat e tjera me temë nga Lufta Nacionalçlirimtare duhet përmendur «Bashkë me agimin» (1975) e K. Jakovës, «Me gjuhën e pushkës» e H. Minarollit etj. Megjithëse sjellin ide dhe tipa të rinj, dramat me këtë temë nuk japin një pasqyrim të shumanshëm e të thelluar të kësaj periudhe përmes karakteresh dhe situatash të fuqishme.

Në dramën e këtyre viteve një vend të mirë zuri jeta e vendit në vitet e para pas Çlirimit. Në dramën «Lulet e shegës» (1976) të K. Jakovës me karaktere të qarta dhe ngjyra realiste pasqyrohet atmosfera e ndezur politike në vitet e para pas vendosjes së pushtetit popullor, përpjekjet e njerëzve të Partisë, të pushtetit për të konsoliduar fitoret dhe për të shpënë deri në fund luftën e klasave. Figura e Lajes, e gjallë, energjike, që vepron me zgjuarsi dhe gëzon dashurinë e njerëzve të thjeshtë, me të cilin ajo ka të bëjë në punën e përditshme, fiton zemrën e lexuesit dhe të spektatorit. Botën e njerëzve të rinj që luftojnë e dashurohen, përpjekjet e tyre për mbrojtjen e rendit të ri, autori i ka dhënë me anë të imtësive poetike. Figurat e armiqve, tregtarë, a kulakë, përshkruhen me vërtetësi përmes dredhive dhe manovrave për të ruajtur paratë dhe pozitën e tyre. Drama ka kolorit veprimi, ecën në mënyrë të natyrshme. «Lulet e Shegës» nis si dramë sociale-psikologjike, por pastaj ngjarjet zhvillohen në mënyrë të përshpejtuar me zbulime të papritura, gjë që bën ndesh në veçoritë kryesore që e shquajnë si gjini.

Problemin e luftës për kolektivizimin e trajton drama «Shënomëni dhe mua» (1976) e H. Minarollit. Përpjekjet e gjithë vendit për të përfunduar kolektivizimin e bujqësisë autori i lidh me luftën kundër diversantëve që veprojnë fshehurazi dhe duan të pengojnë ngritjen e kooperativës.

Në dramë ka një varg figurash të qarta; ajo përshkohet nga humori dhe shquhet për gjuhën e individualizuar të personazheve.

Nga një mjedis punëtor e ka marrë F. Kraja subjektin për dramën e vet «Djem të mbarë» (Drama 1975). Autori trajton problemin e vështirësive që has futja e gruas në punë për shkak të koncepteve patriarkale. Dashuria që lind midis heroinës dhe një minatori të ri, pengohet përkohësisht nga hija e zakonit të hakmarrjes, i cili tërhiqet përpara sulmit të normave morale socialiste. Por ajo që ka rëndësi është vizatimi i disa tipave punëtorësh dhe i atmosferës së qendrës së punës; gjë që ndeshet jo rëndom në dramaturgjinë tonë. Vepra përshkohet nga optimizmi rinor dhe nga romantika e punës. Gërshetimi jo fort i përligjur i temës së futjes në punë të gruas në një front të vështirë prodhimi, me problemin disi të konsumuar të hakmarrjes e që del papritur në marrëdhëniet midis dy të rinjve përbën të metën e dramës.

Në këtë periudhë u shkruan pak komedi. Komedia «Zonja nga qyteti» (1976) e R. Pulahës shquhet për problemin që ka kapur dhe për realizimin artistik. Ajo është në gjurmët e komedive tona më të mira. Në këtë vepër, të shkruar me humor, ku gjejmë mprehtësi situatash dhe dialog të bukur e të goditur fshikullohet ndjenja mikroborgjeze e atyre prindërve që duan t'i mbajnë fëmijët e tyre larg nga jeta e madhe, duke u siguruar ndonjë vend të ngrohtë në qytet. Personazhi kryesor i komedisë, Ollga, ka disa të meta, nga të cilat ajo shërohet nga kontakti me realitetin e gjallë, me njerëzit e mrekullueshëm të fshatit socialist. Në komedi jeta e fshatit është dhënë plot kolorit; situatat komike janë të natyrshme dhe gjuha është e pasur me frazeologji popullore.

Ndonëse me vështirësi, edhe dramaturgjia, sikurse edhe gjinitë e tjera të krijimtarisë letrare, po ecën më tej në rruqën e vet. Prirjet themelore të dramës së sotme janë synimi për të depërtuar në dukuritë dhe zhvillimet e reja të jetës, për të zbuluar kontradiktat e saj, për të dhënë në mënyrë sa më të plotë mendimet dhe ndjenjat e njerëzve tanë të punës.

*
* * *

Letërsia shqiptare e realizmit socialist, siç u pa edhe më sipër, ka pasur një zhvillim të vullshëm. Njohja më e thellë e jetës, përvetësimi më organik i mësimave të marksizëm-leninizmit dhe të mësimave të Partisë, kalitja më e mirë ideologjike e shkrimtarëve, përparimi në fushën e mjeshtërisë kanë përcaktuar arritjet e reja dhe të ndjeshme të krijimtarisë letrare.

Kongresi VII PPSH, që u mbajt në nëntor 1976, vuri në dukje rezultatet e dukshme të letërsisë dhe të artit tonë, epërsinë e pakrahasueshme të realizmit socialist mbi artin borgjez dhe revizionist, që shquhet nga çoroditja dhe mungesa e perspektivës. Në punimet e tij Kongresi u kushtoi vëmendjen e duhur edhe problemeve që lidhen me zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë në kushtet e luftës së sotme klasore dhe në dritën e kërkesave të larta estetike të shoqërisë sonë. Problemet që shtroi Kongresi kanë të bëjnë me thellimin e partishmërisë komuniste, me forcimin e karakterit kombëtar e popullor, me nevojën e trajtimit më të gjerë të temave të mëdha dhe me njohjen më të thellë të jetës dhe të punës së masave punonjëse.

Orientimet e Kongresit VII, mësimet e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha u ndriçojnë rrugën krijuese për të arritur suksese të reja edhe më të mëdha; ato sigurojnë ruajtjen dhe pasurimin e mëtejshëm të parimeve të realizmit socialist, u ndihmojnë njerëzve të letërsisë dhe të arteve të mbajnë të mprehtë luftën klasore dhe të ngrejë më lart frymën revolucionare që përshkon veprimtarinë e tyre.

TREGUESI I EMRAVE DHE I VEPRAVE

- Abdihoxha, Ali**, 76, 142, 144, 145, 261, 269, 279, 387.
 - «*Dueli i madh*» 387, 389.
 - «*Një vjeshtë me stuhi*» 142.
 - «*Tri ngjyra të kohës*» 269, 279-284.
- Agolli, Dritëro**, 6, 16, 20, 76, 97, 98, 102, 103, 104, 120, 122, 206, 214, 215, 216, 217, 230, 231, 232, 235, 239, 246, 252, 253, 258, 261, 270, 284, 289, 352, 377, 384, 385, 386, 392, 400, 401, 403, 405.
 - «*Baballarët*» 215, 231, 234-238.
 - «*Babanë tënd e kisha shok*» 405.
 - «*Balada e ashpër*» 246, 247.
 - «*Baladë e re për komisarin*» 385.
 - «*Devoll-Devoll*» 204, 215, 231-234.
 - «*Elegji partizane*» 252.
 - «*Ëndrra*» 103.
 - «*Fjala gdhend gurin*» 403, 405.
 - «*Fytyra e dytë*» 214, 377-379.
 - «*Hapat e mia në asfalt*» 102, 122, 230.
 - «*Këmishët*» 103.
- «*Kënga e buzëqeshjes*» 405.
 - «*Kënga e njeriut*» 405.
 - «*Komisari Memo*» 204, 205, 206, 270, 284-289, 384.
 - «*Komunistët*» 405.
 - «*Kongo-Kongo*» 122.
 - «*Krevati i perandorit*» 252.
 - «*Malësori*» 103.
 - «*Mesditë*» 230, 235.
 - «*Mëngjez*» 102.
 - «*Mollët*» 405.
 - «*Në kafe*» 122.
 - «*Në shtigjet e tua*» 103.
 - «*Në rrugë dolla*» 97.
 - «*Nënë Shqipëri*» 400, 403-405.
 - «*Nëntoriada*» 405.
 - «*Nga fletorka e shënimeve*» 103.
 - «*Nga këngët e xha Taqit*» 103.
 - «*Njeriu me top*» 384, 385, 386.
 - «*Patat e egra*» 405.
 - «*Përsëri*» 246.
 - «*Pleshti*» 405.
 - «*Poema e udhës*» 97, 98, 99, 230.
 - «*Poema malore*» 231.
 - «*Poemë për babanë dhe*

- për vete» 97, 98, 230.
 — «Rapsodi vjeshte» 246.
 — «Reklama» 122.
 — «Servili vajton shefin» 405.
 — «Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo» 392, 393.
 — «Shtigje malesh dhe tro-tuare» 230, 232.
 — «Vdekja e druvarit» 246.
 — «Zhurma e erërave të dikurshme» 208.
- Alia, Ramiz.** 199.
Aliaj, Tasim. 392.
 — «Takim me djajtë» 392, 393.
- Arap, Fatos.** 215, 216, 217, 239, 244, 245, 246, 247, 249, 250, 400, 401, 407.
 — «Alarme të përgjakura» 204, 215, 249, 252.
 — «Antiburokratike» 247.
 — «Drama e partizanit pa emër» 208.
 — «Drejt qindra shekujsh shkojmë» 401, 407.
 — «E shkruar në Azotik» 245.
 — «Industriale» 245.
 — «Poema dhe vjersha» 250.
 — «Republikës» 244.
 — «Ritme të hekurta» 244, 245.
 — «Shtigje poetike» 244.
- Asdreni.** 12.
Bala, Vehbi. 36, 89, 90, 100, 101.
 — «Doli nëna në çardak» 89.
 — «Gjaku i falun» 90.
 — «Kur kthei Drita në këso-llë» 89.
- Banushi, Aleksandër.** 36, 76, 101, 102, 124, 125, 258.
 — «Allafranga me tanuz» 125.
- «Brigadierja në tribunë» 101.
 — «Këngë për traktoristët» 102.
 — «Më rreh zemra për dy vasha» 125.
 — «Vesel Spathari» 124.
- Barbys, H.** 13.
Bedo, Resul. 130, 299.
 — «Nga Kuçi në Vishegrad» 130.
 — «Njëqind episode partizane» 299.
- Bubani, Dionis.** 76, 96, 100, 101, 104, 120, 125, 186, 192, 258, 408.
 — «Armiku i grave» 192.
 — «Burokrati» 258.
 — «Burri përparimtar» 125.
 — «I disiplinuar» 258.
 — «Njeriut të madh e të thjeshtë» 120.
 — «Orët e vdekura» 258.
 — «Përpara pushkatimit» 196.
 — «Rrugë pa rrugë» 125.
 — «Sëmundja e rrezikshme» 192.
 — «S'ka kohë të punosh» 258.
 — «Shigjeta» 408.
 — «Shtegu i harruar» 101.
- Bulka, Nonda.** 70, 102, 124, 125.
 — «Atdhedashuri» 124.
 — «Partinë mbi të gjitha» 102.
 — «Rubai të Çurçillit» 125.
 — «Vaji» 124.
- Buxheli, Qamil.** 43, 347, 350.
 — «Dueli» 208.
 — «Karriera e zotit Maksut» 347, 350.
 — «Kënga e Asim Zenelit» 43.
 — «Kur qesh tërë qyteti» 350.
 — «Nihilisti» 347.
- «Njeriu që ndal kohën» 347.
 — «Një ëndërr e prapambetur» 347.
 — «Një ndodhi në plazh» 347.
- Cerga, Agim.** 261, 264, 328, 389, 399.
 — «Erë e fortë» 399.
 — «Familja e madhe» 328.
 — «Kur vinte pranvera» 264.
 — «Legjenda e vadave» 389.
 — «Oxhaku» 328.
- Cikuli, Zisa.** 354, 359, 360.
 — «Flakë në shtëpi» 354, 359-361.
- Çaçi, Aleks.** 20, 29, 36, 44, 63, 64, 70, 76, 100, 101, 104, 105, 120, 401.
 — «Ashtu Myzeqe» 104, 105.
 — «Dy vëllezër, një luftë, një varr» 63.
 — «Kanali i Myzeqesë» 101.
 — «Klithmat e dheut» 44.
 — «Ku e gjeta» «Kushtrimin e lirisë» 63.
 — «Kujtimet të martirit komunist Ali Demi» 46.
 — «Gruri» 63.
 — «Lumi i popullit» 44.
 — «Margarita Tutulani» 36.
 — «Me ty Stalin» 120.
 — «Më këmbë janë ngritur» 44.
 — «Muhabet me një katundar të çliruar» 63.
 — «Nata e fundit e një martiri» 64.
 — «Ngrehu o Margaritë» 45.
 — «Përpara në luftë» 44.
 — «Po duket majë malit» 44.
 — «Syri i nënës» 44.
 — «U lag me gjak» 44.
 — «Unë dolla sot» 100.
- Çajupi, Andon Zako.** 12, 73.
- Çela, Zija.** 394, 397, 398.
 — «Drita që pikon në pyll» 397.
 — «Lirika e qiellit të drunj-të» 397.
 — «Në një qytet» 397.
 — «Tomë Zhegu, njeri i lum-tur» 397.
- Çomora, Spiro.** 76, 125, 186, 214, 258, 352, 372-375.
 — «Dy me zero» 375-376.
 — «Karnavalet e Korçës» 214, 372.
 — «Kol Drithëroku» 125.
 — «Parazitët» 258.
 — «Racizëm» 125.
- De Rada, Jeronim.** 12.
Drini, Skënder. 389.
 — «Shembja e idhujve» 389, 390.
- Frashëri, Naim.** 12, 72, 73.
Frashëri, Sami. 13.
Godo, Sabri. 268, 317, 384, 391.
 — «Ali Pashë Tepelen» 317-320.
 — «Fushata» 268.
 — «Skënderbeu» 384, 391.
 — «Zëra nga burime të nxehta» 268.
- Gorki, Maksim.** 13.
Grameno, Mihal. 12.
Gurakuqi, Mark. 76, 99, 100, 101, 109.
 — «Gjeto Plaku» 109.
 — «Mjeku partizan» 99.
- Gjakova, Agim.** 256, 401.
 — «Balada e varfjën» 256.
 — «Bir i sharrëxhiut» 256.
 — «Dhe thonë se paqe ka në botë» 256.
 — «Grave në Drenicë» 256.
 — «Nata në qytet» 256.

- «Në kërkim të së vërtetës» 389.
- «Vrasja» 256.
- Gjata, Fatmir.** 6. 16, 20, 36, 41, 42, 70, 75, 76, 91, 95, 130, 133, 134, 139, 141, 147, 151, 155, 159, 161, 162, 164, 165, 216, 248, 400.
- «Ato maja rripa-rripa» 41.
- «Balada e prindërve» 95.
- «Bije bryma përmbi male» 95.
- «Burim në mal» 95.
- «Çeliku» 130.
- «Ç'ke që qan, moj nënë-zë?» 95.
- «Djaloshi» 130.
- «Dhembja e nënës» 95.
- «Horizont» 248.
- «Internacionale» 248.
- «Këneta» 7, 155, 159, 160, 163, 165, 384.
- «Kënga e partizanit Benko» 91, 95.
- «Këngë e njohur» 248.
- «Kënga e rinisë» 41.
- «Këngët e maleve» 41, 96.
- «Këngët e maliherit» 248.
- «Kredo» 248.
- «Kudo malet buçasin» 41.
- «Kushtrimi» 41.
- «Lufton nëna» 130.
- «Mora pushkën, më nuk prita» 95.
- «Nusja» 133.
- «Përmbysja» 75, 139, 142.
- «Plaku dhe i riu» 42.
- «Poemë për shokun» 248.
- «Rinia e prindërve» 134.
- «Roja» 95.
- «Rrethimi» 134.
- «Rrugët e maleve» 95.
- «Tana» 151.
- «Uji fle, hasmi, s'fle» 147, 159.
- Gjetja, Ndoc.** 400, 408.
- «Shqipja rreh krahët» 408.
- Hoxha, Enver.** 3, 9, 14, 15, 17, 20, 30, 47-57, 71, 199, 201, 202, 381, 388, 400, 412.
- «Fjalimi i tradhtarit, mbajtur më 22 nëntor 1942» 53, 55.
- «Kështu luftoi populli shqiptar» (Shteg më shteg me çetat partizane e vullnetare, që luftojnë me tërbim okupatorin fashist) 50.
- «Krijimi i Shoqërisë Anonime Bujqësore» 48.
- «Luftëtari trim Haxhi Lleshi dhe çeta e tij kreshnike» 50.
- «Myslim Peza, Baba Faja Martaneshi» 50.
- «Nga Kongresi i Përmetit në çlirimin e plotë të Shqipërisë» 52.
- «28 Nëntori, dita e bashkimit të popullit shqiptar kundër zaptuesit fashist» 55.
- «Populli i Tiranës nderoi kujtimin e heroit të popullit Vojo Kushi» 50.
- «Pa mëshirë» 55.
- «Shoqëria SASTEB, — kusëri kolosale e organizuar nga Merlika e fashizmi për të rrëmbyer kafshatën e gojës së fakir-fukarasë» 48.
- «7 prill, dita e zisë dhe dita e luftës» 49, 55.
- «Tre heronj për lirinë e At-dheut» 50.
- «Vendimet historike të mbledhjes së dytë të

- KANÇ-it mbajtur në qytetin e Beratit» 52.
- Istrefi, Adem.** 256, 257, 400, 401, 407.
- «Baladë kosovare» 257.
- «Ku janë gishtat e mi» 257.
- «Net kosovare» 257.
- «Nëna e të burgosurit» 257.
- «Një stinë e thatë» 257.
- «Poemë për Karadakun» 401, 407.
- Jakova, Kolë.** 6, 16, 20, 36, 41, 42, 43, 70, 76, 91-94, 177, 179, 181, 182, 183, 186, 213, 217, 253, 347, 348, 359, 408, 410.
- «Bashkë me agimin» 410.
- «Dom Gjoni» 70, 177.
- «Fshati midis ujërave» 213, 347, 348-350.
- «Garda krutane» 253.
- «Halili dhe Hajria» 70, 179, 181.
- «Heronjtë e Vigut» 43, 91, 92.
- «Kënga e tre heronjve» 42.
- «Lavdi ushtarit» 359.
- «Lulet e sheqës» 410.
- «Përballë hekurave të kryqëzuar» 387.
- «Shqiponja partizane» 43.
- «Toka jonë» 76, 181, 183, 185.
- Jorgaqi, Nasho.** 261, 299, 329.
- «Kush është?» 329.
- «Qemal Stafa» 299-301.
- Jorgoni, Perikli.** 401, 407.
- «Poemë për Zaho Kokën» 401, 407.
- Kadareja, Elena.** 398.
- «Nusja dhe shtetrrrethimi» 398.
- Kadare, Ismail.** 6, 16, 20, 76, 96, 102, 104, 114, 115, 119, 120, 208, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 225, 226, 229, 239, 246, 247, 253, 255, 261, 270, 289, 296, 312, 325, 384, 385, 387, 388, 400, 401, 405, 406.
- «Dimri i madh» 384, 387, 388, 389.
- «Ëndërr industriale» 114, 115, 118.
- «Ëndërrime» 119, 120, 121.
- «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» 206, 213, 270, 289-296, 384.
- «Ishujt e Italisë» 96.
- «Kështjella» 312-317.
- «Koha» 405.
- «Kronikë në gur» 213, 270, 296-297.
- «Kthimi i shqiptarëve nga lufta» 406.
- «Lakuriqët e natës» 255.
- «Laokoonti» 406.
- «Leninit» 120, 121.
- «Lulemollët» 406.
- «Mësueset e fshatit» 406.
- «Motive me diell» 219, 226, 255.
- «Nëna» 96.
- «Nëntori i një kryeqyteti» 385.
- «Nisja e shqiptarëve për në luftë» 406.
- «Përse mendohen këto male» 204, 219-225, 229.
- «Pushtimi i Çekoslovakisë» 406.
- «Sezioni dimëror i Kafe Rivierës» 325.
- «Shekulli im» 115.
- «Shënime për brezin tim» 114, 116, 118.
- «Shqipëria dhe tri Romat» 406.

- «Shqiponjat fluturojnë lart» 215, 219, 225.
- «Vallja shqiptare» 406.
- «Vitet gjashtëdhjetë» 229-230, 401.
- «Vjersha dhe poema» 219, 230.
- Kallamata, Miço.** 167, 192, 347, 385, 392.
- «Bull i kënetës» 347.
- «Fotografia e gjyshit» 347.
- «I fundit i oxhakut» 213, 347.
- «Kthimi i astronautit» 167.
- «Lart e poshtë» 167.
- «Në hijen e dordolecëve» 392, 393.
- «Një ditë pune e shefit tim» 347.
- «Për një pëllëmbë çarçaf» 347.
- «Simfoni e pambaruar» 167.
- «Shtigjeve të zëna» 385, 386.
- Koçi, Vito.** 399.
- «Borë në Bjeshkë» 399.
- Kollumbi, Gaço.** 129.
- «Ditari partizan» 129.
- Kondo, Anastas.** 205, 261, 264, 265, 266, 267, 321, 322, 394, 395, 396.
- «Ai që dashuronte fëmijët dhe detin» 396.
- «Kënga e re, gjyshja dhe unë» 322.
- «Kio» 264.
- «Njerëz dhe gurë» 265.
- «Njeriu që propozoj për hero» 395, 396.
- «Sekretari» 395.
- «Ura» 265, 266, 267.
- «Vdekja e shoferit» 264.
- Koreshi, Vath.** 261, 329, 331, 387, 389.
- «Duart e një burri» 331.
- «Duke dalë nga një natë e gjatë» 331.
- «Mars» 387, 389.
- «Ndërrimi i qiejve» 329.
- «Si një këngë, që u këndohet trimave» 330.
- Kosta, Koço.** 394, 397.
- «Anika» 397.
- «Dademadhja» 397.
- «Pasi dëgjova këngën e një gruaje» 397.
- Kraja, Fadil.** 357, 408, 411.
- «Djem të mbarë» 411.
- «Fisheku në pajë» 357-358.
- Krasniqi, Sulejman.** 392.
- «Priësja e komitëve» 392.
- Kristoforidhi, Konstandin.** 73.
- Kuqali, Gjikä.** 63, 64.
- «Gjaku» 64.
- «N'atë dhomë matanë» 64.
- «Njëzet e pesë vjeç djalë» 64.
- Laço, Teodor.** 6, 205, 261, 266, 267, 323, 324, 332, 340, 358, 376, 384, 387, 394, 396, 397, 399, 408, 409.
- «Ajri i ftohtë i mesnatës» 267.
- «Brezat e gurtë» 323.
- «Dit dhe net që mund të vijnë» 399.
- «Era e tokës» 267, 323.
- «Gjëmimi i atij dimri» 409.
- «Larashi» 266.
- «Një natë shiu» 267.
- «Nië nuse për Stasin» 376-377.
- «Përballimi» 384, 387.
- «Pikojnë kokrrat e krimbura» 324.

- «Pylli në vjeshtë» 396.
- «Rruga e bardhë» 267.
- «Shtëpia në rrugicë» 358-359.
- «Të dielat e mërgimtarëve» 397.
- «Tokë e ashpër» 332, 340-342.
- «Valltari» 397.
- Lera, Nasi.** 394, 398.
- «Era e pishave» 398.
- Levonja, Besim.** 43, 177, 178.
- «Cani Hoxhë» 177.
- «Mine Pezës» 43.
- «Prefekti» 177.
- Luca, Ndreke.** 186, 190, 191.
- «Shtatë shaljanët» 190, 191, 192.
- Majakovski, Vladimir.** 13.
- Markaj, Misto.** 361.
- «Gjergj Kastrioti» 361-365.
- Meto, Memo.** 33-35.
- «Do dal malit» 34.
- «Këngë për liri» 34.
- «Ne po vuajmë e po heqim» 35.
- «Për liri» 35.
- «U hap lajmi, ulërima» 34.
- Migjeni.** 12, 72, 73.
- Miloti, Tonin.** 124, 125, 258, 259.
- «Hamleti në terren» 258.
- «Jeta» 124.
- «Kolonialistët» 125.
- «Maksut shkollari» 125.
- «Në hanë» 125.
- «29 Nëntori» 124.
- «Rubai për burokratin» 258.
- «Rreshperët» 258.
- «Xhubleta» 258.
- «Zylyf Esnafi» 125.
- Minarolli, Hamza.** 408, 410.
- «Me gjuhën e pushkës» 410.
- «Shënomëni dhe mua» 410.
- Mjeda, Ndre.** 12.
- Musaraj, Shefqet.** 6, 20, 29, 36, 37, 39, 43, 60, 61, 62, 70, 76, 123, 148, 150, 166, 261, 269, 270, 271, 399.
- «Armiku s'ngopet me gjak» 60.
- «Ç'kërkoj gjeti» 166.
- «Dje dhe sot» 36, 61, 62.
- «Djemtë e fshatit» 62.
- «Do bëhen zgjedhjet» 70, 123, 124.
- «Dritë» 399.
- «Epopeja e Ballit Kombëtar» 36, 37, 41, 65, 124.
- «Hesapet e Mete Agait» 166.
- «Isha unë, Çobo Rapushi» 150.
- «Kolona e pestë po i tepron gjynahet» 61.
- «Llaz Qesarati» 148.
- «Marifete nga të fashizmit» 60.
- «Marshi i Divizionit I Sulmues» 43.
- «Marshi i Korparmatës» 43.
- «Mustafa Kruja fsheh dieclin me shoshë» 60.
- «Në pragun e lirisë» 62.
- «Nëna e Zijait» 62.
- «Ngjarje e komente» 60.
- «Nuk qethet dashi me shelegë» 166.
- «Para agimit» 204, 205, 206, 213, 270, 271-278, 384.
- «Peshqeshi i Vitit të Ri» 166.
- «Punë pa punë» 166.

- «Shteg më shteg me partizanët e Divizionit të I S» 62, 63.
 - «Të reja nga kryeqyteti, Njëpër Tiranë» 166.
 - «Uthull për inatçinjtë» 166.
 - «Ver' e vjetër në vozë të re» 166.
 - «Zëri i Vlorës» 60.
Noli, Fan. 12, 72.
Papa, Loni. 354, 365.
 - «Cuca e maleve» 204, 205, 354-357.
 - «Drama» 355.
 - «Marga» 365-368.
Papleka, Ndoc. 400, 407.
 - «Ecim» 407.
Peci, Shefqet. 35, 298.
 - «Kujtime dhe dokumente nga Lufta Nacionalçlirimtare» 298.
 - «Mallakastra brigje-brigje» 35.
 - «Memo Metos» 35.
 - «Mesaplik, luginë e fortë» 35.
 - «Shqipëri vend i bekuar» 35.
 - «U ngreva dhe dola» 35.
Petrela, Hasan. 310.
 - «Të munduarit» 310-312.
 - «Kronikë e viteve të paharruara» 213.
Pitarka, Sulejman. 76, 186, 191, 359.
 - «Familja e peshkatarit» 186.
 - «Heronjtë e Linasit» 359.
 - «Trimi i mirë me shokë shumë» 190.
Postoli, Foqion. 12.
Priifti, Naum. 76, 152, 153, 167, 175, 205, 261, 263, 301, 302, 321, 322, 327, 328, 352, 368, 394, 395.
 - «Brazda e fundit» 153.
 - «Çezma e floririt» 175, 176.
 - «Çupa më e vogël» 153.
 - «Detyra e re» 167.
 - «E fejuara» 152.
 - «E pabesueshmja» 263.
 - «Jase Kapllani dhe gratë» 167.
 - «Lëkura e ujkut» 167.
 - «Litar i zjarrtë» 264, 302, 322.
 - «Mermergdhendësi» 395.
 - «Mjeku i lokalitetit» 395.
 - «Mulliri i Kostë Bardhit» 368-372.
 - «Muratori nga Borova» 395.
 - «Naja me fshesë» 327.
 - «Njerëz të kësaj toke» 394.
 - «Njeriu që ndiqte kuajt» 301.
 - «Një ndër të shumtët» 153.
 - «Rrethimi i bardhë» 208.
 - «Shtëpia e teto Prekos» 167.
 - «Telegrami» 167.
 - «Tregime» 264.
 - «Zenel Dauti» 153.
 - «Zjarre pranë kënetës» 395.
Pulaha, Ruzhdi. 387, 398, 408, 411.
 - «Nusja e humbëtirës» 398.
 - «Rruga Budi 723» 387.
 - «Zonja nga qyteti» 411.
Qafëzezi, Luan. 76, 90, 91, 99, 100, 101, 255, 258, 259, 407, 408, 409.
 - «Flamur fitoresh» 102.
 - «Komunisti» 90, 91.
 - «Kujdes kokën, zotërinj» 259.
 - «Mësim nga historia» 409.
 - «Operacioni» 99.
 - «Pa malet nuk ka maja» 407.
 - «Tradhtia e lartë» 255.
Rino, Ndreko. 129.
 - «Dy luftime fitimtare» 130.
 - «Në kodrat e Bal-Bardhit» 130.
 - «Në kodrat e Çernecit» 130.
 - «Pëllëmb e gjak» 129, 130.
Sako, Zihni. 36, 70, 76, 88, 89, 130, 131, 147.
 - «Automatiku i Aliut» 131.
 - «Babai» 131.
 - «Balena» 131.
 - «Bereqeti» 147.
 - «Federali» 36.
 - «Komisari» 88.
 - «Maro nëna» 89.
 - «Medalja e Trimërisë» 131.
 - «Pajtimi me gjak» 131.
 - «Taqi nga Suha» 131.
 - «Vjersha» 89.
Siliqi, Drago. 76, 96, 100, 101, 102, 104, 110, 120.
 - «Helmësi» 96.
 - «Këngë e re për dashurinë e vjetër» 110, 111.
 - «Kur pyesja nanën» 100.
 - «Motrës» 100.
 - «Një ulli në breg të Jonit» 102.
 - «Plaga» 96.
 - «Pranvera erdhi, por s'lu-
 lëzoi» 96.
Siliqi, Lllazar. 6, 16, 20, 36, 45, 70, 76, 84, 100, 102, 106, 107, 108, 111, 120, 122, 215, 216, 217, 239, 240, 243, 249, 253, 255, 400, 405, 406, 407.
 - «Atdheu» 100.
 - «Borizanët» 215, 239, 240-243.
 - «Brankos» 45.
 - «Gjikës» 45.
 - «Heroit Vojo Kushi» 45.
 - «Ju flet Tirana» 406.
 - «Këngë entuziaste» 239.
 - «Mesazhi» 406.
 - «Mësuesi» 76, 108.
 - «Miku» 76, 106.
 - «Monologu i veteranit» 407.
 - «Ndër sytë e shoqeve shkëndia» 244.
 - «Në Mauzole» 120.
 - «Nga porti i ri deri ku vlon malësia» 239, 240.
 - «Pezës» 45.
 - «Poema e dritës» 239.
 - «Prishtina» 84, 85-88.
 - «Ringjallja» 111-114.
 - «Rruga e lumtunisë» 45, 85, 121.
 - «Sa malet rrofsh, ushtri e madhe e paqes» 122.
 - «Sado të rrjedhin vitet» 407.
 - «S'flen ma Shqipnia» 45.
 - «Sfidë» 407.
 - «Sonetet e protestës» 407.
 - «Stuhia e revolucionit» 255.
 - «Sytë e Naimit» 407.
 - «Shkëndija e brigadës» 249.
 - «Vjersha dhe poema» 85, 107.
 - «Xhavitit» 45.
Spasse, Sterjo. 6, 16, 20, 70, 75, 76, 155, 168, 170, 171, 173, 261, 332, 344, 392.
 - «Afërdita» 156.

- «Afërdita përsëri në fshat» 76, 155, 156.
- «Ata nuk ishin vetëm» 75, 155, 168, 170, 171, 173.
- «Zgjimi» 392.
- «Zjarret» 332, 344-347.
- Spiru, Nako.** 57, 59.
- «Akoma dy fjalë për Ballin» 58.
- «Çështje të ditës» 58.
- «Kriminelët» 58.
- «Mbi bashkëpunimin e popullit shqiptar» 58.
- «Përgjigjemi» 59.
- «Rruga jonë» 59.
- Stërmilli, Haki.** 12, 70.
- Shaplo, Dalan.** 76, 135, 152, 154, 261, 265, 322.
- «Brenga e një partizani» 135.
- «Kubeja» 322.
- «Në bregun e hijes» 266.
- «Në shtëpinë e vjetër» 155.
- «Një kafe me pak» 155.
- «Përtëritje» 155.
- «U gjykua një partizan» 265.
- Shehu, Agim.** 120, 217, 238, 254, 255.
- «Dekada e revolucionarëve» 238, 239.
- «Para bustit të Selam Muisait» 254.
- «Vargje të kuq» 255.
- «Vite pa thinja» 238, 254.
- Shehu, Mehmet.** 43, 126.
- «Kujtime nga jeta e Brigadës I Sulmuese» 126.
- «Marshi i Brigadës I Sulmuese» 43.
- Shuteriqi, Dhimitër, S.** 6, 16, 20, 36, 46, 70, 75, 76, 100, 101, 130, 132, 135, 137, 138, 146, 174, 205, 321, 326, 394, 396.
- «Çlirimtarët» 75, 157.
- «Dispeçerja» 396.
- «Ditët e sprasme të Gjergj Golemit» 174.
- «Dyshimet e Jonuz Raxhës» 132, 135.
- «Fyelli i Tanës» 174, 175.
- «Gruri i ri» 101.
- «Këngë për sulmuesen e tisazhit» 101.
- «Kujtime stanesh» 396.
- «Ky çuni i madh i Salë Cenit» 146.
- «Leksi i Gogos» 396.
- «Lufta» 46.
- «Një mal me këngë» 396.
- «O Ptoleme» 46.
- «Perdet e rënda të maleve» 326.
- «Për cil po bien këto dautlle» 132.
- «Shkallët e gurta» 326.
- «Tani të rroj» 396.
- «Tetë letrat e Valtit» 326, 327.
- «Xha Demi» 135.
- «Zot e rob» 321.
- Varfi, Andrea.** 29, 43, 90, 99, 100, 101, 102, 124.
- «Biri i Partisë» 90.
- «Derdhet gruri si flori» 101.
- «Ëndërr partizane» 99.
- «Ëndrra e Mahmut bej Pilafit» 124.
- «Heroit Hajdar T. Goriçani» 102.
- «Hymni i Ushtrisë Nacionalçlirimtare» 43.
- «O diell i jetës sonë» 102.
- Xoxa, Jakov.** 6, 20, 70, 76,

- 133, 134, 136, 146, 174, 175, 206, 261, 303-310, 332.
- «Juga e bardhë» 332-337.
- «Kapedani» 174, 175.
- «Kurorat e Masar Beut» 133, 134.
- «Lumi i vdekur» 206, 213, 303-310, 384.
- «Përsheshi i Paput» 146.
- «Tre pleqtë dhe Mihali katër» 136.
- Xhaxhiu, Muzafer.** 99.
- «Partizanët» 99.
- Xhuvani, Dhimitër.** 76, 152, 153, 173, 174, 261, 302, 324, 325, 332, 337, 359, 385.
- «Fan Smajli» 332.
- «Këmbana e fundit» 153.
- «Mbas dy vjetësh» 359.
- «Mbi degën e prerë» 154.
- «Miku» 154.
- «Në gjolet e Gjyralës» 174.
- «Një njeri më shumë» 325.
- «Për pak tokë dhe një grua» 173.
- «Përsëri në këmbë» 204, 205, 213, 332, 337-340.
- «Trasta me gurë» 302.
- «Tuneli» 208.
- «Zgjimi i Nebi Surrelit» 385, 386.
- «Zhurma të forta» 324.
- Zaloshnja, Moisi.** 167.
- «Bakllavatë e Sheme Shagirit» 167.
- «Hallo Makbulja ka shkelur xhindet» 167.
- Ziko, Vangjush.** 76, 102, 103, 186, 188, 243, 246, 401, 408.
- «Gjyshja» 243, 244.
- «Motra Katerinë» 188, 190.
- «Rojtari i pyllit» 243.
- «Rroga e parë» 103.
- «Takimi me malet» 243.
- «Vajza fjongëkuqe» 104.
- «Xha Qazoja» 243.
- Zheji, Gjergj.** 312, 332, 342.
- «Kullat» 213, 261, 332, 342-344.
- «Në muret e Krujës» 312.

TRYEZA E LËNDËS

	Faqe
PARATHËNIE	3
HYRJA (K. Bihiku)	5
KREU I. FILLIMET E LETËRSISË SHQIPTARE TË REALIZMIT SOCIALIST (K. Bihiku)	27
KREU II. LETËRSIA SHQIPTARE E PERIUdhËS SË FORMIMIT TË PLOTË TË REALIZMIT SOCIALIST (K. Bihiku)	67
— Poezia	84
— Proza	126
— Dramaturgjia	177
KREU III. LETËRSIA SHQIPTARE E PERIUdhËS SË FORCIMIT DHE TË PASURIMIT TË REALIZMIT SOCIALIST	196
— Hyrja (D. Shaplo)	196
— Poezia (J. Bulo, L. Kokona, K. Bihiku)	215
— Proza (J. Bulo, A. Myftiu, D. Shaplo)	260
— Dramaturgjia (D. Siliqi)	351
KREU IV. ZHVILLIMI I LETËRSISË SHQIPTARE TË REALIZMIT SOCIALIST PAS PLENUMIT IV TË KQ TË PPSH (D. Shaplo)	380
Treguesi i emrave dhe i veprave	413

NDREQJE GABIMESH

Faqe	Rreshti		Është shkruar	Duhet lexuar
	Nga lart	Nga poshtë		
42	—	1	3)	2)
42	—	1	2)	1)
115	8	—	Pikërisht	piketat
121	1	—	e shpëtuar	për të shpëtuar
121	10	—	përpjetë	përjetë
122	—	8	vitin	vitet
146	2	—	dukeshin	shuheshin
169	—	3	gëllitje	gjëllitje
273	8	—	të pengonte	të pengonin
379	—	11	Mehmetin	Muhametin
394	—	18	e cila	i cili